



RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT TË PËRPUTHSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË.

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	HYRJA	3
	a. Objektivat dhe qëllimi	3
	b. Identifikimi i çështjes	3
	c. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	3
	d. Përgjegjësitë e audituesve	4
	e. Kriteret e vlerësimit	4
	f. Standardet e auditimit	4
	g. Kriteret e vlerësimit	4
	h. Standardet e auditimit	4
II.	PËRSHRIMI I AUDITIMIT	5
III.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	6
1	Mbi zbatimin e detyrave të lëna në auditimet e mëparshme.	6
2	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë <i>ekzekutive</i> , si dhe bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.	7
3	Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese të Autoritetit Portual, Këshilli Drejtues e Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.	9
4	Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.	17
5	Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).	47
6	Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të Autoritetit Portual, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet e prore. Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.	84
7	Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave.	100
8	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit	177
9	Zbatimi i dispozitave ligjore për dhënien me qira të ambienteve dhe trojeve të depozitimit	190
10	Respektimi i dispozitave ligjore në lidhjen dhe zbatimin e kontratave me subjektet private që operojnë në port, si dhe zbatimi i tarifave përkatëse	199
11	Administrimin e mbetjeve urbane të rrezikshme.	223
12	Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr.8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit	238



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

	Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.	
13	Auditimi i databazës së sistemit të hyrje-daljeve në territorin e APD	240
IV.	KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT	244
V.	ANEKSE	257



I. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr.579/1 prot., datë 18.05.2018, i ndryshuar, nga data 14.05.2018 deri më datë 27.07.2018, në subjektin Autoritetin Portual Durrës për periudhën nga data 01.05.2016 deri më datë 30.06.2018, u krye auditimi “Përputhshmërisë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërisë me përbërje:

1. F. I., Përgjegjës grupi,
2. I. S., Auditues,
3. J. Zh., Auditues,
4. B. D., Auditues,
5. B. H., Auditues

a. Titulli: Projekt Raport mbi auditimin e “Përputhshmërisë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërisë në Autoritetin Portual Durrës.

b. Marrësi: Autoritetin Portual Durrës, me drejtor A. B.

c. Objektivat dhe qëllimi: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH, është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që Autoriteti Portual Durrës, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, duke audituar përputhshmërinë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërinë e transaksioneve, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Institucionit. Auditimi ka për qëllim *promovimin e transparencës*, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore. Gjithashtu, projekti i auditimit ka për qëllim *promovimin e përgjegjshmërisë*, ndaj devijimeve të raportimit dhe ndaj shkeljeve të kuadrit ligjor, në mënyrë që të mund të merren veprime korigjuese dhe personat përgjegjës të përgjigjen për veprimet e tyre.

Auditimi i përputhshmërisë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë (*sipas ISSAI 400, p 18*).

d. Identifikimi i çështjes: Institucioni duhet të ketë organizimin e duhur, për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rriten e cilësisë së shërbimit ndaj qytetareve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, eficiencë dhe efektivitet.

e. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të auditur lidhur me çështjen nën auditim:

-Të bëjnë të frytshëm dhe më të orientuar në drejtim të ekonomisë së tregut Autoritetin Portual, të rrisin konkurrencën, ta zhvillojnë ekonomikisht atë përmes investimeve të drejtpërdrejta nga sektori privat, për zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe modernizimin e portit.

-Të shndërrojnë portin nga “port shërbimi” në “port administrues toke”, për të rritur pavarësinë tregtare të portit.

- Të përafrojnë shërbimet dhe infrastrukturën portuale me praktikat ndërkombëtare, për standarde të njëjta ndërmjet shteteve.



f. Përgjegjësitë e audituesve: Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimin, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

g. Kriteret e vlerësimit: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”; Ligji nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për Koncesionet”, i ndryshuar ; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”; Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 7843, datë 13.7.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar; Ligji nr. 8510, datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtë kontraktore të organeve të administratës shtetërore”, i ndryshuar”, Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”; Ligji nr. 8116, date 29.03.1006 “Kodi i procedurës civile i Republikës e Shqipërisë”, i ndryshuar”; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; VKM nr. 596, datë 10. 09. 2004 “Për Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij”, i ndryshuar; VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit, i ndryshuar”; VKM nr. 781, datë 14.11.2007, të ndryshuar, pika 2.5 “Kuponi tatimor, fatura tatimore, prezantimi grafik”; VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”; VKM nr. 27, datë 19.01.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe dhënies së koncesioneve”, i ndryshuar; VKM NR. 783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 442/2, datë 12.03.2010 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimit në Autoritetin Portual Durrës”, Udhëzimi i KM nr. 2, datë 08.05.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”; udhëzimi APP nr. 3, datë 27.01.2015 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, Statuti dhe Rregullorja e brendshme e Autoritetit Portual Durrës etj.

h. Standardet e auditimit:

- ISSAI100- (Parimet themelore të auditimit të sektorit publik).
- ISSAI400- (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë).
- Kodi etik i KLSH.



II. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

Ligji nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr.596, datë 10. 09. 2004 “Për Miratimin e Statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij”, i ndryshuar; si edhe të gjitha ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore të dalta në shërbim të tyre.

Objekti i Institucionit është:

-Të bëjë të frytshëm dhe më të orientuar në drejtim të ekonomisë së tregut Autoritetin Portual, të rrisë konkurrencën, të zhvillohet ekonomikisht përmes investimeve të drejtpërdrejta nga sektori privat, për zvogëlimin e shpenzimeve publike dhe modernizimin e portit.

- Të shndërrojë portin nga “port shërbimi” në “port administrues toke”, për të rritur pavarësinë tregtare të portit.

- Të përafrojë shërbimet dhe infrastrukturën portuale me praktikat ndërkombëtare, për standarde të njëjta ndërmjet shteteve.

- Të sigurojë nivel shërbimesh të shkallës së lartë, në mënyrë që të plotësojë me një kosto të arsyeshme nevojat e përdoruesve.

- Të garantojë një nivel të lartë sigurie dhe mbrojtje të mjedisit.

- Të sigurojë një shkallë të lartë pavarësie për menaxhimin e portit, si dhe për operatorë të ndryshëm, që kryejnë shërbimet në port.

- Të sigurojë qiradhënie ose koncesion për disa pajisje të caktuara për veprimtarinë e portit.

- Të bashkërendojë veprimtarinë detare dhe sistemin e transportit sipas legjislacionit në fuqi.

Objekti, qëllimi dhe fushëveprimi i auditimit është përputhshmëria (pajtuueshmërisë) dhe rregullshmërisë e operacioneve financiare të subjektit për periudhën nga 01.05.2016 deri më datë 30.06.2018.

Qëllimi i auditimit është hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimit të gjetjeve, si dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e aktivitetit të APD.

Është audituar aktiviteti i Institucionit për periudhën e auditimit, fokusuar kryesisht në operacione financiare, por jo vetëm. Konkretisht janë audituar shpenzime për investime, shpenzimet operative, shpërblimet dhe pagat, aktiviteti i shoqërive ve stivadore, shoqërive të kontraktuara për shërbime, programimi dhe realizimi i planbiznesit, zbatimi i marrëveshjeve konçensionare. Është audituar vendimarrja e organeve drejtuese, si dhe menaxhimi financiar dhe kontrolli.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, u përgatit Projektraporti i Auditimit.

III. GJETJET DHE REKOMANDIMET



Në vijim një përmbledhje e konstatimeve:

1. Mbi realizimin e rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm.

Titulli i gjetjes: Mos zbatim dhe realizim i plotë i rekomandimeve të KLSH-së të dhëna nga auditimet e mëparshme.

Situata: KLSH me shkresën përcjellëse me nr. 415/14 prot, datë 09.10.2016 dhe me shkresën nr. 415/25, datë 26.01.2017 ka rekomanduar 68 masa gjithsej, nga këto: 33 masa organizative, 35 masa zhdëmtimi me vlerën 220,329 mijë lekë dhe të ardhura të munguara 4 masa në vlerën 170,825 mijë lekë. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

a. Masa organizative: Janë rekomanduar 33 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 33 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 6, janë në proces zbatimi 3, janë zbatuar pjesërisht 5 dhe nuk janë zbatuar 19 masa.

b. Masa për shpërbllim dëmi: Janë rekomanduar 35 për vlerën 220,329 mijë lekë nga të cilat janë pranuar 35 masa ose 100 % e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 5 masa, në vlerën 6,572 mijë lekë ose 3%, janë në proces zbatimi 2, në vlerën 8,018 mijë lekë ose 3.6 %, nuk janë zbatuar 22, në vlerën 197,591 mijë lekë ose 89.7%, janë zbatuar pjesërisht 6, në vlerën 8,147 mijë lekë ose 3.7%.

c. Të ardhura të munguara, si dhe realizim shpenzimesh jo në përputhje me parimin e efijencës monetare: Janë rekomanduar 4 nga të cilat nga të cilat janë pranuar 4 masa ose 100 % e tyre. Nuk janë realizuar 4 masa.

d. Masa disiplinore. Nuk ka rekomanduar specifikisht, por shkresën nr. 415/25, date 26.01.2017 i është lënë në kompetencë të Drejtorit të Përgjithëm Ekzekutiv, marrjen/ose jo të masave disiplinore ndaj personelit, duke marrë në konsideratë shkeljet ligjore dhe përgjegjësi respektive të cituara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të performancës së punës së tyre, si dhe të masave disiplinore të dhëna më parë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se Drejtori i Përgjithshëm nuk ka dhënë asnjë masë.

Kriteri: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, neni 15, pika c, ku përcaktohet:

Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas rastit, në fillim, përgjatë dhe/ose në përfundim të veprimtarisë, duhet:

c) t’u rekomandojë drejtuesve të njësive të audituara apo organeve të kompetencës të ndërmarrin, në mënyrën dhe rrugët e përcaktuara nga ligji, masa strukturore dhe organizative, duke përfshirë edhe nisjen e procedurave disiplinore apo administrative.

Ndikimi/efekti: Mos efijencë në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për Autoritetin Portual Durrës.

Shkaku: Mos korrektesë institucionale e drejtorit të Autoritetit Portual Durrës në zbatimin e dispozitave ligjore ne fuqi.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi: Nga Autoriteti Portual Durrës, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.



Në mënyrë të detajuar zbatimi i rekomandimeve është paraqitur në Procesverbalin nr. 21, datë 27.07.2018 mbajtur me personat përgjegjës.

2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e Këshillit Drejtues dhe Drejtorisë ekzekutive, si dhe bazueshmërinë ligjore të vendimeve të marra dhe realizimin e tyre.

1. Titulli i gjetjes: Mosfunksionimi i Këshillit Konsultativ

Situata: Nga auditimi i dosjes së Këshillit Konsultativ, u konstatua se nuk është zhvilluar asnjë mbledhje e dokumentuar. Në APD nuk ka dokumentacion që vërteton se ky këshill është i organizuar dhe funksionon në zbatim të nenit 16, pika 1 të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003, për këshillimin e Këshillit Drejtues të portit. Nuk ka asnjë dokumentacion ku të vërtetohet se përpara nxjerrjes së vendimeve për ndryshim tarifash portuale dhe jo vetëm, të jetë marrë këshillim nga Këshilli Konsultativ në konformitet me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003, i ndryshuar, neni 4 pika 5, neni 10 pika 2, neni 11 pika 1 gërma d, neni 16 pika 1 gërma a, neni 31 pika 3, përsa i përket dhënies me qira të ambienteve. Referuar observacionit datë 12.09.2018 janë prezantuar 3 mbledhje të Këshillit Konsultativ.

Kriteri: neni 16, pika 1 të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003, për këshillimin e Këshillit Drejtues të portit; urdhri nr.1018/1, datë 25.06.2014, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës (Sot MIE).

Ndikimi/efekti: Mosmarrja e konsulencës së nevojshme të Menaxhimit të lart nga Këshilli Konsultativ në kundërshtim neni 16, pika 1 të ligjit nr.9130, datë 08.09.2003, i ndryshuar.

Shkaku: Mos monitorim i mjaftueshëm i këshillit konsultativ nga Këshilli Drejtues dhe Ministri.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi: Këshilli Drejtues të marrin masat e nevojshme për funksionim e Këshilli Konsultativ, në zbatim të Ligjit nr.9130, datë 08.09.2003, i ndryshuar.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Në organizmin dhe funksionimin e këshillit drejtues dhe të vendimarrjes të drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv, u konstatuan dhe shkelje që i përkasin vendimarrjes për planbiznesin, strukturën organizative dhe nivelin e pagave, shpërblimeve, emërtimin e drejtorit të auditit të brendshëm etj, të cilat janë trajtuar në mënyrë të hollësishme në pikat respective përgjat projektraportit dhe për arsye të dublikimit nuk i trajtojmë në këtë pikë.

-Këshilli Drejtues, në përcaktim të nenit 10 dhe 11 të ligjit nr.9130, datë 8.09.2003 “Për autoritetin portual”, përbëhet nga 7 anëtarë, me përfaqësues nga institucione të ndryshme. Nga dokumentacioni rezulton se këshilli drejtues i APD përbëhet nga 2 përfaqësues të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, 1 përfaqësues i Bashkisë Durrës, 1 përfaqësues i prefekturës dhe 3 përfaqësues të sektorit privat.

Përgjithësisht veprimtaria e Këshillit Drejtues, i është përmbajtur përcaktimeve dhe detyrimeve ligjore, si dhe kompetencave të tij në përcaktim të nenit 10 dhe 11 të ligjit nr.9130, datë 8.09.2003 “Për autoritetin portual”, dhe në statutin e autoritetit. Pavarësisht nga sa u citua më sipër u konstatuan dhe shkelje të akteve ligjore dhe nën ligjore si më poshtë vijon:

-Këshilli Drejtues megjithëse është mbledhur dhe ka analizuar problematikat me karakter rregullator, portual dhe financiar të shoqërisë, në opinionin e grupit të auditimit vlerësohet se



problematikat e diskutuara ne këto takime dhe konkluzionet e nxjerra nuk janë përcjellë për njohje dhe vlerësim tek Ministria e linjës, duke mos e informuar në kohë dhe orientuar drejt organin vendimmarrës në zgjidhjen e problematikave, nëpërmjet përshpejtimit të reformave të sektorit siç parashtrohet në Ligjin nr.9130, datë 8.09.2003 “Për autoritetin portual”.

-Gjatë periudhës 01.05.2016 deri 31.12.2016, Këshilli Drejtues, ka pësuar ndryshime në përbërje të tij dhe konkretisht:

G. B., kryetar deri më 23.12.2016, përfaqësues i MTI; F. S., zv/kryetar, përfaqësues i MZHETTS deri më 16.09.2016; J. K. përfaqësues i MIE; A. R., përfaqësues i prefekturës Durrës, anëtar deri më 13.07.2016; A. B., përfaqësues i Prefekturës Durrës anëtar nga data 13.07.2016; A. B., përfaqësues i MZHETTS anëtar nga data 16.09.2016; I. F. përfaqësues biznesi privat, anëtar i riemëruar nga data 10.03.2016; I. C. zv/kryetar përfaqësues i Bashkia Durrës nga data 20.10.2016; N. J. anëtar nga data 10.03.2016-07.06.2016; M. Ç. përfaqësues i MIE anëtar nga data 23.12.2016; A. R., përfaqësues i prefekturës Durrës anëtar deri më 13.07.2016; A. R. përfaqësues i biznesit privat anëtar nga data 23.12.2016. Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Drejtues, është mbledhur 11 herë dhe ka marrë në total 26 vendime. Nga sekretarja e Këshillit Drejtues është mbajtur protokollin e mbledhjes dhe procesverbalet përkatëse. Janë zbardhur vendimet e marra, përkatësisht me numër vendimesh nga nr.15 deri nr.40.

3 -Për periudhën 01.01.2018 deri 30.06.2018, Këshilli Drejtues përbëhet nga 7 anëtarë: G. Ll. përfaqësues i MIE , I. C. zv/kryetar, përfaqësues i Bashkisë Durrës, G. K., përfaqësues i MIE, E. M., përfaqësues i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, A. R., përfaqësues Biznesi Privat, I. F., përfaqësues Biznesi Privat, A. R., përfaqësues i prefekturës Durrës, i emëruar anëtar nga data 27.04.2018, A. B., anëtar deri në datën 22.02.2018.

Gjatë kësaj periudhe, Këshilli Drejtues, është mbledhur 8 herë dhe ka marrë në total 13 vendime. Nga sekretarja e Këshillit Drejtues është mbajtur protokollin e mbledhjes dhe procesverbalet përkatëse. Janë zbardhur vendimet e marra, përkatësisht me numër vendimesh nga nr. 1 deri nr. 13.

Vendimet janë marrë mbi, ndryshimin e strukturës organizative dhe organigramën e APD, ndryshimin e strukturës së pagave të punonjësve, organizimin dhe ndryshimin në emërimet të punonjësve të auditit të brendshëm, për lirim nga detyra të Drejtorit të APD, për miratimin e plan biznesit të APD viti 2018, për emërimin e drejtorit ekzekutiv të APD, për ndryshimin e strukturës organizative dhe organigramën e APD, për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e laboratorit mjedisor në APD, për kalimin në përgjegjësi të APD të kinoklubit “Mujo Ulqinaku” etj.

Këshilli Konsultativ

Këshilli Konsultativ i Autoritetit Portual Durrës, është ngritur në bazë të urdhrin nr.1018/1, datë 25.06.2014, të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE). Nuk ka një rregullore për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Konsultativ në përputhje me legjislacionin e Autoritetit Portual.

-Nga auditimi i protokollit të mbledhjeve të Këshillit Konsultativ, u konstatua se për periudhën objekt auditimi ky Këshill ka zhvilluar vetëm 1 mbledhje me datë 10.04.2018, mbi diskutimin e tarifave portuale por nuk ka rezultuar me vendimartje.

Për më tepër, referuar kësaj mbledhje në dosjen e këshillit konsultativ ka thjesht një procesverbal zhvillimi mbledhje, por nuk ka material me propozime dhe relacione përkatëse mbi tarifave portuale, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit nr.9130, datë 08.09.2003, i ndryshuar.

Pra si konkluzion nga këshilli konsultativ nuk ka gjetur zbatim neni 16, pika 1 të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003, i ndryshuar.



3. Auditim mbi hartimin, shqyrtimin dhe miratimin e planit të biznesit nga organet drejtuese të Autoritetit Portual, Këshilli Drejtues e Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.

Titulli i gjetjes: Nuk është marrë miratimi për planin e biznesit nga Ministri përkatës.

Situata: Planet e biznesit për vitet 2016 miratuar me vendimin nr.3, datë 15.02.2016 të KD dhe 2018 miratuar me vendimin nr.7, datë 06.03.2018 të KD, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra gjatë viteve objekt auditimi, saktësisht për vitin 2016 plani i biznesit është ndryshuar me vendimin nr.14, datë 11.04.2016 të KD, vendimin nr.25, datë 30.08.2016 të KD, vendimin nr.26, datë 30.09.2016 të KD, vendimin nr.38, datë 02.12.2016 të KD, për vitin 2017 plani i biznesit është ndryshuar me vendimin nr.7, datë 07.04.2017 të KD, për vitin 2018 plani i biznesit është ndryshuar me vendimin nr.8, datë 19.04.2018 të KD, vendimin e datës 13.06.2018 të KD, nuk janë të miratuara nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE), veprim në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr.9130, datë 08.09.2003 “Për autoritetin portual”, ku citohet: “*Autoriteti portual i paraqet ministrit për miratim një plan biznesi 3 deri 5-vjeçar, i cili azhurnohet çdo vit*”, dhe nenin 25 pika 3 ku citohet: “*Autoriteti portual i paraqet ministrit pasqyrat financiare, të revizionuara, përpara mbledhjes vjetore dhe është i detyruar t'i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko-financiare*”. Për pasojë APD ka zhvilluar aktivitetin e saj ekonomiko financiar të pa miratuar nga organi kompetent, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE), duke tejkalluar kompetencat që i jep ligji. Në këto kushte, në opinionin e grupit të auditimit veprimtaria e APD nuk ka patur dhe nuk ka monitorimin e duhur pasi plani i biznesin nuk është i miratuar nga organi kompetent për këtë, duke u zbatuar në mënyrë të padrejtë nga Dretjorët e Përgjithshëm G. Sh., A. L., dhe A. B..

Kriteri: Ligji nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”.

Ndikimi/efekti: Veprimtari ekonomike e APD e pa miratuar nga Ministri.

Shkaku: Mosndjekje e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, të miratojnë planin e biznesit dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, tek Ministri, si dhe të marrin masa për zbatimin rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Titulli i gjetjes: Realizimi i planit të biznesit

Situata: Nisur nga verifikimi i zërave të detajuar të planeve të biznesit për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ka mjaft zëra të cilat kanë një parashikim mjaft të dobët dhe larg realizimit. Referuar sa më sipër, për një pjesë të zërave grupi i auditimit shpreh opinionin se është e pajustificueshme mungesa e planifikimit (tatimi i fitimit, amortizimi, etj), duke krijuar kështu një pasqyrë jo reale të situatës ekonomiko financiare që parashikohet të ketë Autoriteti Portual Durrës. Kjo ka sjellë si pasojë ndryshime mjaft të shpeshta të planit të biznesit të Autoritetit Portual Durrës.

- Nga auditimi i investimeve kapitale të kryera nga Autoriteti Portual Durrës për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ato nuk janë trajtuar sipas parimit të prioritarizmit, por janë kryer në mënyrë rutinë pa impakt pozitiv në arritjen e objektivave, çka për APD përbën risk të lartë mbi realizimin e atyre investimeve jetësore dhe me rëndësi funksionale. Kjo qasje rezikon që në të ardhmen ta përballë Autoritetin Portual Durrës me pamundësinë e kryerjes së atyre investimeve kapitale të cilat do të mundësonin vazhdimësinë normale të aktivitetit, duke e vënë përballë një situatë me pasoja vështirësisht të recuperueshme.



Si dhe

Miratimi i treguesve për investime dhe shpenzime, referuar kapaciteteve dhe nevojave reale të tyre janë planifikuar tej kapaciteteve reale të realizimit të tyre. Konkretisht investimet për shpenzime, janë planifikuar tej kapaciteteve reale të domosdoshmerisë dhe impaktin në Cash Flow-n e APD-së, duke mos evidentuar vlerën e lartë të mungesës së likujditeteve, referuar kjo vendimit të KD nr.7, datë 06.03.2018 (Ku gjendja debitoreve në momentin e marrjes së këtij vendimi është në vlerën 399,445,145 lekë).

Konkretisht, thellimi i basenit të akuarimit të portit është një investim kyç periodik në aktivitetin e APD, i cili gjithashtu ka një vlerë të mjaft të konsiderueshme. Realizimi i investimeve të tjera jo prioritare ka risk të kompromentojë realizimin e këtij investimi.

- Nga auditimi u konstatua se në asnjë rast nuk janë parashikuar të ardhurat nga provizionet edhe pse për periudhën objekt auditimi ka patur të ardhura nga ky zë, duke ndikuar negativisht në pasqyrimin e saktë të situatës të pritshme financiare të Autoritetit Portual Durrës.

Kriteri: Ligji nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”.

Ndikimi/efekti: Risk i mosrealizimit të investimeve prioritare për aktivitetin e APD.

Shkaku: Parashikim i dobët i planit të biznesit, si dhe realizim pa u mbështetur në prioritete.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: -Nga ana e të gjitha strukturave të APD në vijimësi të tregohet kujdes maksimal në parashikimin vjetor të planit të biznesit, me qëllim dhënien e një pasqyre parashikimi sa më të saktë të aktivitetit ekonomiko-financiar vjetor.

-Në vijimësi të merren masa për kategorizimin e investimeve, duke i klasifikuar ato në prioritare dhe jo prioritare, me qëllim realizimin fillimisht të atyre investimeve me rëndësi jetike për zhvillimin normal të aktivitetit të Autoritetit Portual Durrës.

Titulli i gjetjes: Fondet IPA janë përdorur për mbulimin e investimeve dhe shpenzimeve të pasqyruara në plan biznesin.

Situata: Nga auditimi u konstatua se fondet IPA janë përdorur për mbulimin e investimeve dhe shpenzimeve të pasqyruara në plan biznesin, ndërkohë që Fondet IPA janë fonde përpara aderimit në bashkimin Europian. Janë Grante dhe nuk ka se si të perdoret nga fondet Grande termi Kursim, pasi janë fonde falas dhe kuptimi i saj janë që të dish ti përdorësh ti shpenzosh konform kushteve të percaktuara në kontrata.

IPA-është instrumenti para Anëtarësimit (Para Aderimit), është një mekanizëm i bashkëdyzuar i krijuar nga BE për të ofruar ndihmë efikase Ballkanit Perendimor. IPA ndihmon vendet candidate që të implementojnë legjislacionin e BE. Pra nuk ka dhe nuk mund të ketë KURSIM në termin GRANTE.

Kriteri: Qëllimi i përdorimit të fondeve IPA.

Ndikimi/efekti: Argumentimi i investimeve dhe shpenzime me fondet IPA.

Shkaku: -

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Këshilli drejtues dhe drejtori i përgjithshëm ekzekutiv të marrin masa për ruajtje destinacionin e përdorimit të fondeve IPA.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

APD është organi drejtues i portit të Durrësit. Autoriteti Portual Durrës është person juridik publik i cili funksionon në bazë të ligjit nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”. Statuti i APD është miratuar me VKM nr.596 datë, 10.09.2004 “Për miratimin e Statutit të



APD dhe riorganizimin e tij”, i cili përcakton edhe mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tij. Në kuptim edhe të ligjit nr. 9130 “Për Autoritetin Portual”, AP i kalon e drejta e administrimit të pronës shtetërore dhe çdo e drejtë e lidhur me të, duke respektuar strukturën e organizimit si “port administrues toke”. Autoriteti Portual i Durrësit kërkon të nxisë investimet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në zhvillimin dhe modernizimin e tij.

2016

-Me Vendimin nr. 3, datë 15.02.2016 të Këshillit Drejtues është miratuar plani i biznesit të zhvillimit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2016.

-Me shkresën nr. 625 prot datë 19.02.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të APD i është dërguar Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës për miratim Plani i Biznesit për vitin 2016. *Për këtë nuk ka asnjë përgjigje nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, e për pasojë Plani i Biznesit i vitit 2016, mbi të cilin APD ka kryer aktivitetin e saj ekonomik-financiar është i pa miratuar nga organi kompetent, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.*

-Me Vendimin nr. 14, datë 11.04.2016 të Këshillit Drejtues është ndryshuar plani i biznesit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2016.

Ky ndryshim konsiston në miratimin e fondit për procedurën e prokurimit me objekt: “Auditim dhe verifikim i gjendjes kontabël për AAM dhe AAJM dhe përputhja me inventarin fizik për vlerën bruto dhe neto të tyre” me vlerë ekonomike 4,375,000 lekë pa TVSH, si dhe shtimin e zërit të investimeve për dy investime në vlerë totale 1,600,000 lekë.

-Me Vendimin nr. 25, datë 30.08.2016 të Këshillit Drejtues është ndryshuar plani i biznesit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2016.

Ky ndryshim konsiston në heqjen e 12 zërave të shpenzimeve në vlerën totale 148,434,715 lekë

-Me Vendimin nr. 26, datë 30.09.2016 të Këshillit Drejtues është ndryshuar plani i biznesit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2016.

Ky ndryshim konsiston në miratimin e fondit në vlerën 7,650,150 lekë pa TVSH për realizimin e furnizimit me objekt “Litarë çeliku dhe aksesore montimi”, miratimin e fondit për realizimin e shërbimit me objekt “Pajisje me Dëshmi Aftësie të punonjësve të FSPD për mbajtje arme”, si dhe miratimin e fondit për sponsorizime nga 3,000,000 lekë të parashikuar në 4,000,000 lekë.

-Me Vendimin nr. 38, datë 02.12.2016 të Këshillit Drejtues është ndryshuar plani i biznesit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2016.

Ky ndryshim konsiston në miratimin e fondit prej 30,000,000 lekë për emergjencat e APD, miratimin e shpërblimit të fundvitit në vlerën 35,000,000 lekë, miratimin e honorareve për Këshillin drejtues në vlerën 1,410,000 lekë, si dhe miratimin e një shtese në zërin “Transferime, udhëtime, dieta” në vlerën 1,000,000 lekë.

- *Për 4 rastet e ndryshimit të planit të biznesit gjatë vitit 2016, u konstatua se nuk është marrë miratimi nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.*

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur realizimi vjetor për vitin 2016:

Plan Biznesi 2016					
	Zërat	Parashikimi	Ndryshimi i fondit	Realizimi në vlerë	Realizimi në %
1	Të ardhurat	1,894,729,087	-	2,186,383,379	115%
2	Shpenzimet	1,793,027,156	77,710,150	2,043,337,879	114%
	Fitimi	101,701,931		143,045,499	141%

Burimi: APD



Nga sa më sipër rezulton se për vitin 2016 Autoriteti Portual Durrës ka realizuar të ardhurat në vlerën 2,186 milion lekë, kundrejt parashikimit prej 1,895 milion lekë ose e shprehur në përqindje 115%. Pra të ardhurat janë tejkaluar me 15% nga parashikimi. Në lidhje me shpenzimet ato janë realizuar në vlerën 2,043 milion lekë kundrejt 1,793 milion lekë të parashikuara. Pra rezulton një tejkalim i shpenzimeve me 14%. Edhe pse ky tejkalim nuk ka ndikuar në daljen e rezultatit pozitiv financiar, ky rezultat do të ishte më i favorshëm për Autoritetin Portual Durrës nëse do të ishin mbajtur nën kontroll shpenzimet e kryera. Autoriteti Portual Durrës për vitin 2016 ka dalë me rezultat pozitiv financiar në vlerën 143 milion lekë, kundrejt parashikimit prej 102 milion lekë ose e shprehur në përqindje 141%.

Nga auditimi analitik i zërave të planit të biznesit të APD për vitin 2016 u konstatua se ka mjaft zëra të cilat janë të realizuar në një nivel mjaft të ulët krahasuar me vlerën e miratuar dhe një pjesë e zërave kanë një tejkalim mjaft të lartë krahasuar po ashtu me parashikimin e bërë. Në zërat e të ardhurave me realizim mjaft të ulët kundrejt parashikimit mund të listojmë zërat: “Sherbimi i drejtimit të mjetit” me 37%, “Të ardhura - qera mjetet” me 35%, “Penalitete dhe gjoha të arkëtuara” me 12%, “Të ardhura të tjera financiare” me 34%.

Në zërat e të ardhurave me realizim më të lartë kundrejt parashikimit mund të listojmë zërat: “Tarifë për shërbime të veçanta” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 8,419,694 lekë, “Të ardhura-Qera afatgj sheshet” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 1,872,212 lekë, “Të ardhura-Qera ambjente tjëra” me 228%, “Të ardhura mbroj.zjarr&shpëtim” me 16263%, “Të ardhura shitje tjëra” me 2800%, “Të ardhura nga Uji” me 302%, “Te ndryshme” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 19,509,700 lekë, “Fitim nga kembimet valutore” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 293,178,106 lekë.

Në zërat e shpenzimeve me realizim mjaft të ulët kundrejt parashikimit mund të listojmë zërat: “Materiale të para dep” me 24%, “Trajnime” me 16%, “Shpenzime pritje & përfaqesime” me 4%, “Amortizimi Makineri Paisje” e planifikuar në vlerën 87,851,920 lekë por e parealizuar, “Amortizime Makineri Paisje Elektrike” me 12%.

Në zërat e shpenzimeve me realizim më të lartë kundrejt parashikimit mund të listojmë zërat: “Gjoha dhe dëmshpërblime” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 9,448,503 lekë, “Humbje nga këmbimet valutore” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 229,693,938 lekë, “Amortizime Makineri Paisje Oficine” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 6,667,722 lekë, “Amortizime Mjete Transp, Grejfera” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 37,970,727 lekë, “Amortizime Mjete Automekanizma” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 40,235,460 lekë, “Amortizime AK. Konteniere” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 1,327,474 lekë, “Instalime tek, Mak, Pai, Ins, Veg” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 50,439,102 lekë, “Amortizimi Paisje Kompjuterike” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 1,912,263 lekë, “Provizione për rreziqe e shpenzime” me 929%, “Tatim mbi fitimin” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 54,412,360 lekë.

2017

-Me Vendimin nr.3, datë 12.01.2017 të Këshillit Drejtues është miratuar plani i biznesit të zhvillimit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2017.

-Me shkresën nr.93 prot datë 16.01.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të APD i është dërguar Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës për miratim Planit i Biznesit për vitin 2017. Miratimi për këtë ka ardhur me shkresën nr.239/1 prot datë 25.01.2017 të Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

-Me Vendimin nr.7, datë 07.04.2017 të Këshillit Drejtues është ndryshuar plani i biznesit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Ndryshimi konsiston në një shtesë në fondin e pagave prej 7,094,439 lekë, shtesë në fondin e sigurimeve shoqërore me 1,184,771 lekë, shtesë në fondin e shpërblimeve me 733,000 lekë, si dhe është hequr nënçeri “Aktivitetet promocoional brenda territorit të portit” me vlerë 6,000,000 lekë.

Për këtë ndryshim të bërë në planin e biznesit nuk është marrë miratimin nga ana e Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur realizimi vjetor për vitin 2017:

Plan Biznesi 2017					
	Zërat	Parashikimi	Ndryshimi i fundit	Realizimi në vlerë	Realizimi në %
1	Të ardhurat	1,905,384,335	-	2,125,646,742	112%
2	Shpenzimet	1,858,028,038	9,012,210.00	2,010,425,650	108%
	Fitimi	47,356,297		115,221,092	243%

Burimi: APD

Nga sa më sipër rezulton se për vitin 2017 Autoriteti Portual Durrës ka realizuar të ardhurat në vlerën 2,126 milion lekë, kundrejt parashikimit prej 1,905 milion lekë ose e shprehur në përqindje 112%. Pra të ardhurat janë tejkaluar me 12% nga parashikimi. Në lidhje me shpenzimet ato janë realizuar në vlerën 2,010 milion lekë kundrejt 1,858 milion lekë të parashikuara. Pra rezulton një tejkalim i shpenzimeve me 8%. Edhe pse ky tejkalim nuk ka ndikuar në daljen e rezultatit pozitiv financiar, ky rezultat do të ishte më i favorshëm për Autoritetin Portual Durrës nëse do të ishin mbajtur nën kontroll shpenzimet e kryera. Autoriteti Portual Durrës për vitin 2017 ka dalë me rezultat pozitiv financiar në vlerën 115 milion lekë, kundrejt parashikimit prej 47 milion lekë ose e shprehur në përqindje 243%.

Nga auditimi analitik i zërave të planit të biznesit të APD për vitin 2017 u konstatua se ka mjaft zëra të cilat janë të realizuar në një nivel mjaft të ulët krahasuar me vlerën e miratuar dhe një pjesë e zërave kanë një tejkalim mjaft të lartë krahasuar po ashtu me parashikimin e bërë. Në zërat e të ardhurave me realizim mjaft të ulët kundrejt parashikimit mund të listojmë zërat: “Shërbimi i drejtimit të mjetit” me 37%, “Të ardhura-Qera afatgj sheshet” me 16%, “Të ardhura - qera sheshe tranz” me 41%.

Në zërat e të ardhurave me realizim më të lartë kundrejt parashikimit mund të listojmë zërat: “Tarifë për shërbime të veçanta” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 9,031,895 lekë, “Të ardhura-Qera ambjente tjera” me 220%, “Të ardh. nga shitja aktiveve AA” me 350%, “Të ardhura mbroj. zjarr&shpëtim” me 176%, “Penalite dhe gjoha të arkëtuara” me 415%, “Të ndryshme” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 716,203 lekë, “Të ardhura nga interesat” me 141%, “Të ardhura të tjera financiare” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 3,276,616 lekë, “Fitim nga këmbimet valutore” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 206,697,475 lekë.

Në zërat e shpenzimeve me realizim mjaft të ulët kundrejt parashikimit mund të listojmë zërat: “Materiale të para dep” me 50%, “Pastrimi + dizifektim + gjelberim” me 30%, “Transferime, udhetim, dieta” me 39%, “Shpenzime tjera per personelin” me 42%, “Subvencione të dhëna (sponsorizime)” me 13%, “Shpenzime pritje & perfaqesime” me 4%, “Amortizime Makineri Paisje Elektrike” me 13%, “Provizione për rreziqe e shpenzime” me 35%, “Amortizimi Makineri Paisje” të planifikuara në vlerën 13,470,937 lekë por të përealizuar.

Në zërat e shpenzimeve me realizim më të lartë kundrejt parashikimit mund të listojmë zërat: “Blerje /shpenzime të materiale (TVSH karbu)” me 181%, “Trajnime” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 17,368,809 lekë, “Të ndryshme (rivlersim aseti+ fond emergjence)” me 264%, “Fond shpërb. nga ristrukt.&inv” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

998,760 lekë, “Vlera kont. e AQ të shitura” me 350%, “Gjoha dhe dëmshpërblime” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 957,040 lekë, “Humbje nga kembimet valutore” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 33,602,448 lekë, “Amortizimi AQ pa trupëzuar” me 150%, “Amortizime Makineri Paisje Oficine” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 5,420,791 lekë, “Amortizime Mjete Transp, Grejfera” me 180%, “Instalime tek, Mak, Pai, Ins, Veg” me 1025%, “Amortizimi Paisje Kompjuterike” me 216%, “Provizione për zhvl e AQ” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 47,035,614 lekë, “Provizione për zhv. akt qark” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 22,023,777 lekë, “Për zhvlerësimin e AQ afatshk.” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 1,056,625 lekë, “Tatim mbi fitimin” të paplanifikuara por të realizuara në vlerën 34,594,557” lekë.

2018

-Me Vendimin nr.7, datë 06.03.2018 të Këshillit Drejtues është miratuar plani i biznesit të zhvillimit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2018.

-Me shkresën nr.23 prot datë 07.03.2018 të Kryetarit të Këshillit Drejtues të APD i është dërguar Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës për miratim Plani i Biznesit për vitin 2018. *Për këtë nuk ka asnjë përgjigje nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, e për pasojë Plani i Biznesit i vitit 2018, mbi të cilin APD po kryen aktualisht aktivitetin e saj ekonomik financiar është i pa miratuar nga organi kompetent, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës.*

-Me Vendimin nr.8, datë 19.04.2018 të Këshillit Drejtues është ndryshuar plani i biznesit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2017.

-Me vendimin të datës 13.06.2018 të Këshillit Drejtues është ndryshuar plani i biznesit ekonomik-financiar të APD-së për vitin 2018.

Për ndryshimet e bëra në planin e biznesit nuk është marrë miratimin nga ana e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmblëdhur parashikimi vjetor për vitin 2018 (për periudhën 01.01.2018 – 30.04.2018):

Plan Biznesi 2018					
	Zërat	Parashikimi	Ndryshimi i fundit	Realizimi në vlerë	Realizimi në %
1	Të ardhurat	1,805,843,437	-	511,148,181	28%
2	Shpenzimet	1,695,650,984	3,757,240	452,769,971	27%
	Fitimi	110,192,453		58,378,209	53%

Burimi: APD

Nga sa më sipër rezulton se për vitin 2018 Autoriteti Portual Durrës ka parashikuar të ardhura në vlerën 1,806 milion lekë, shpenzimet në vlerën 1,696 milion lekë, e për pasojë një rezultat financiar pozitiv në vlerën 110 milion lekë. Deri në datën 30.04.2018 të ardhurat janë realizuar në vlerën 511 milion lekë ose 28% e parashikimit vjetor. Ndërsa shpenzimet janë në vlerën 453 milion lekë ose 27% e parashikimit vjetor. Deri në datën 30.04.2018 APD rezulton me fitim në vlerën 58 milion lekë ose 53% e parashikimit vjetor.

Nga sa më sipër grupi auditimit del në përfundim se:

1. Planet e biznesit për vitet 2016 miratuar me vendimin nr.3, datë 15.02.2016 të KD dhe 2018 miratuar me vendimin nr.7, datë 06.03.2018 të KD, si dhe të gjitha ndryshimet e bëra gjatë viteve objekt auditimi, saktësisht për vitin 2016 plani i biznesit është ndryshuar me vendimin nr.14, datë 11.04.2016 të KD, vendimin nr.25, datë 30.08.2016 të KD, vendimin nr.26, datë 30.09.2016 të KD, vendimin nr.38, datë 02.12.2016 të KD, për vitin 2017 plani i



biznesit është ndryshuar me vendimin nr.7, datë 07.04.2017 të KD, për vitin 2018 plani i biznesit është ndryshuar me vendimin nr.8, datë 19.04.2018 të KD, vendimin e datës 13.06.2018 të KD, nuk janë të miratuara nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE), veprim në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr.9130, datë 08.09.2003 “Për autoritetin portual”, ku citohet: “*Autoriteti portual i paraqet ministrit për miratim një plan biznesi 3 deri 5-vjeçar, i cili azhurnohet çdo vit*”, dhe nenin 25 pika 3 ku citohet: “*Autoriteti portual i paraqet ministrit pasqyrat financiare, të revizionuara, përpara mbledhjes vjetore dhe është i detyruar t'i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko-financiare*”. Për pasojë APD ka zhvilluar aktivitetin e saj ekonomiko financiar të pa miratuar nga organi kompetent, Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës (sot MIE), duke tejkaluar kompetencat që i jep ligji. Në këto kushte, në opinionin e grupit të auditimit veprimtaria e APD nuk ka patur dhe nuk ka monitorimin e duhur pasi plani i biznesin nuk është i miratuar nga organi kompetent për këtë, duke u zbatuar në mënyrë të padrejtë nga Dretjorët e Përgjithshëm G. Sh., A. L., dhe A. B..

2. Nisur nga verifikimi i zërave të detajuar të planeve të biznesit për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ka mjaft zëra të cilat kanë një parashikim mjaft të dobët dhe larg realizimit. Gjithashtu ka mjaft zëra të cilat janë të parashikuar dhe nuk janë realizuar, si dhe zëra të cilat nuk janë parashikuar por janë realizuar. Referuar rasteve të përmendura më sipër, për një pjesë të tyre grupi i auditimit shpreh opinionin se është e pajustificueshme mungesa e planifikimit (tatimi i fitimit, amortizimi, etj), duke krijuar kështu një pasqyrë jo reale të situatës ekonomiko financiare që parashikohet të ketë Autoriteti Portual Durrës. Kjo ka sjellë si pasojë ndryshimet mjaft të shpeshta të planit të biznesit të Autoritetit Portual Durrës.

3. Nga auditimi i investimeve kapitale të kryera nga Autoriteti Portual Durrës për periudhën objekt auditimi, u konstatua se ato nuk janë trajtuar sipas parimit të prioritarizmit, por janë kryer në mënyrë rutinë pa impakt pozitiv në arritjen e objektivave, çka për APD përbën risk të lartë mbi realizimin e atyre investimeve jetësore dhe me rëndësi funksionale. Kjo qasje rezikon që në të ardhmen ta përballë Autoritetin Portual Durrës me pamundësinë e kryerjes së atyre investimeve kapitale të cilat do të mundësonin vazhdimësinë normale të aktivitetit, duke e vënë përballë një situatë me pasoja vështirësisht të rekuperueshme.

Si dhe

Miratimi i treguesve për investime dhe shpenzime, referuar kapaciteteve dhe nevojave reale të tyre janë planifikuar tej kapaciteteve reale të realizimit të tyre. Konkretisht investimet për shpenzime, janë planifikuar tej kapaciteteve reale të domosdoshmerisë dhe impaktin në Cash Flow-n e APD-së, duke mos evidentuar vlerën e lartë të mungesës së likuiditeteve, referuar kjo vendimit të KD nr.7, datë 06.03.2018 (Ku gjendja debitoreve në momentin e marrjes së këtij vendimi është në vlerën **399,445,145 lekë**).

Konkretisht, thellimi i basenit të akuarimit të portit është një investim kyç periodik në aktivitetin e APD, i cili gjithashtu ka një vlerë të mjaft të konsiderueshme. Realizimi i investimeve të tjera jo prioritare ka risk të kompromentojë realizimin e këtij investimi.

4. Referuar Vendimi Keshilli Drejtues nr.8, datë 19.04.2018 “Për një ndryshim në plan Biznesin e zhvillimit ekonomik-financiar të APD-së, për vitin 2018”, konstatohet se:

-Në pikën 1 të vendimit, citohet ...miratim i ndryshimit..., nuk pasqyron janë shtesa apo ndryshim zërash.

-Nuk argumentohet impakti që do të kenë keto shtesa në treguesit financiare të APD-së.

-Nuk pasqyrohet që do ndryshojë treguesi i zërit të investimeve, në pikën 2, në vlerën **93,382,304 lekë** i miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 7, datë 06.03.2018 “Mbi miratimin e plan biznesit për vitin 2018”, nga këto ndryshime (shtesa në zërin investime).

-Sa të ardhura do të shtohen APD-së, nga Magazina 4-5, çfarë të ardhurash do të ketë shfrytëzimi i sheshit pas Terminali Lindor? Mungon analizë kosto-përfitim.



-Çfarë kërkesash ka nga subjektet private për këtë magazine i aktivitetit të APD-së apo për dhenie me qera? Mungon analizë kosto-përfitim.

-A janë diskutuar me parë këto ndryshime ne zërat e plan biznesit 2018, ne GMS (Grupin e Menaxhimit Strategjik), detyrim i percaktuar ne nenin 27, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”?

-Ndryshimi i zërave të Plan Biznesit (Investimeve) është dërguar per miratim në MIE? Mungon miratimi nga MIE.

-Në pikën 1.4 të vendimit nr. 8, datë 19.04.2018, shtesë në fondin 3,757,240 lekë për udhëtim e dieta, si është planifikuar kjo shtesë?

-Në pikën 2 të vendimit citohet se..... për shtesën e fondeve për pikën 1.4 do të përballohen nga ...kursimi i fondit të kursyer në zërin Fondet e IPA.....

Kjo vendimmarrje është në kundërshtim me Vendimin e KM, Nr.23, Dt.Aktit:12.01.2011, Dt.Miratimit:12.01.2011, Flet.Zyrtare Nr.4, Faqe:44; Ndryshuar me: Vendimin e KM, Nr.850, Dt.Aktit:14.12.2011, Dt.Miratimit:14.12.2011, Flet.Zyrtare Nr.176, Faqe: 9981; Vendim i KM, Nr.707, Dt.Aktit:21.08.2013, Dt.Miratimit:21.08.2013, Flet.Zyrtare Nr.145, Faqe: 6247.

5. Fondet IPA janë përdorur për mbulimin e investimeve dhe shpenzimeve të pasqyruara në plan biznesin, ndërkohë që Fondet IPA janë fonde përpara aderimit në bashkimin European. Janë **Grante** dhe nuk ka se si të perdoret nga fondet Grande termi **Kursim**, pasi janë fonde falas dhe kuptimi i saj janë që të dish ti përdosh ti shpenzosh konform kushteve të percaktuara në kontrata.

IPA-është instrumenti para Anëtarësimit (Para Aderimit), është një mekanizëm i bashkëdyzuar i krijuar nga BE për të ofruar ndihmë efikase Ballkanit Perendimor. IPA ndihmon vendet kandidate që të implementojne legjislacionin e BE. Pra nuk ka dhe nuk mund të ketë KURSIM në termin GRANTE.

6. Nga auditimi u konstatua se nuk në asnjë rast nuk janë parashikuar të ardhurat nga provizionet edhe pse për periudhën objekt auditimi ka patur të ardhura nga ky zë, duke ndikuar negativisht në pasqyrimin e saktë të situatës të pritshme financiare të Autoritetit Portual Durrës.

Me observacionin dërguar me shkresën përcjellëse nr. 3476/1 datë 10.09.2018 mbi projektraportin e auditimit, protokolluar në KLSH me nr. 579/4, datë 12.09.2018 për mosmiratimin e planit të biznesit nga ana e Ministrisë, nga APD është observuar se: “procedura e komunikimit me Ministrin e linjes eshte kryer, pavaresisht mos reagimit ne kohe, duke kuptuar miratimin ne heshtje te vendimeve te paraqitura nga ana e Drejtorise Ekzekutive”

Se pari: Pretendimi juaj eshte ne kundërshtim me ligjin nr. 44/2015, date 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative te Republikes se Shqiperise”, neni 97, pika 2, ku ne menyre eksplicite citohet: “Pala ka te drejte te kerkoje nga Autoriteti Publik, i cili nuk ka nxjerre aktin administrativ te kerkuar, nje konfirmim me shkrim se kerkesa e saj konsiderohet te jete miratuar ne perputhje me piken 1 te ketij neni. Konfirmimi permban tekstin e kerkeses, daten e paraqitjes se saj dhe faktin qe organi publik nuk ka njoftuar vendimin e tij brenda afatit te percaktuar sipas pikes 1 te ketij neni”.

Se dyti: Ju nuk keni paraqitur gjate auditimit dhe ne fazen e observacioneve asnje shkrese percjellëse derguar ne MIE per miratimin e planeve te biznesit dhe ndryshimeve te tyre, trajtuar me gjere ne procesverbale dhe projektraportin e auditimit.

Mosmiratimi i planit të biznesit nga Ministri, është veprim në kundërshtim me nenin 27 të ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për autoritetin portual”, ku citohet: “Autoriteti portual i



paraqet ministrit për miratim një plan biznesi 3 deri 5-vjeçar, i cili azhurnohet çdo vit”, dhe nenin 25 pika 3 ku citohet: “Autoriteti portual i paraqet ministrit pasqyrat financiare, të revizionuara, përpara mbledhjes vjetore dhe është i detyruar t’i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko-financiare”.

Për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

4. Mbi zbatimin e strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Titulli i gjetjes: Zgjidhje të kontratave të punësimit pa shkaqe të arsyeshme, me pasojë efekt financiar negativ.

Situata: Për periudhën objekt auditimi, APD është palë në 41 procese gjyqësore, nga të cilët 16 janë në shkallën e parë të gjykimit, 14 janë në gjykatën e apelit, ndërsa 11 kanë përfunduar dhe janë humbur nga APD. Vlera e paguar nga APD për proceset gjyqësore të humbura në periudhën objekt auditimi është 13,819,956 lekë prej vlerës totale 15,090,788 lekë ku vendimi ka marrë formë të prerë. *Për periudhën objekt auditimi, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, Autoriteti Portual Durrës është penalizuar nga vendimet e gjykatave në vlerën 13,819,956 lekë, dhe mbetet ende për tu paguar diferenca prej 1,270,832 lekë. Vlera 13,819,956 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e APD.*

Ndikimi/efekti: Efekt financiar negativ në vlerën **13,819,956 lekë**.

Shkaku: Mos zbatim i dispozitave ligjore në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punësimit.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandimi:

Nga APD të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbartimore, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për Institucionin, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

Titulli i gjetjes: Nuk është marrë miratimi për strukturën e pagave në Ministri.

Situata: Nga auditimi u konstatua se për vendimet e marra nga ana e Këshillit Drejtues të APD në lidhje me ndryshimet e strukturës organike dhe nivelit të pagave të APD, nuk është marrë miratimi nga Ministri përkatës, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 “Kompetencat e organeve kolegjiale”, pika 1/a, ku citohet: *“Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregëtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga Ministri përkatës”,* me Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, Neni 53 “Aktet nënligjore”, pika 2 “Ministri, në zbatim të këtij ligji, ngarkohet të nxjerrë urdhra dhe udhëzime për këto çështje: b) të përcaktojë nivelin e pagesave, sipas nenit 25 pika 2”, dhe me rregulloren organizative dhe menaxhimit e Autoritetit Portual Durrës pika 4/7/c “Këshilli Drejtues vendos dhe rishikon sistemin e pagave të anëtarëve të tij, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe punonjësve të APD, dhe bën rekomandimet tek Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës”. Për pasojë menaxhimi i lartë ka angazhuar, rekrutuar dhe shpenzuar punonjës dhe shpenzime për paga dhe shpërblime pa marrë miratimin përkatës nga Ministri, si i vetmi autoritet ligjor.



Për këtë mbajnë përgjegjësi G. Sh., A. L. dhe A. Q. në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv për periudhat respektive, dhe A. B. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv në Autoritetin Portual Durrës.

Kriteri: Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”.

Ndikimi/efekti: Miratim pa kompetencën e duhur.

Shkaku: Mosndjekje e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Në vijimësi nga organet drejtuese të Autoritetit Portual Durrës të merren masat për miratimin e strukturës së pagave në Ministrinë e linjës, duke respektuar kështu kompetencat institucionale të akorduara në legjislacionin përkatës.

Titulli i gjetjes: Dhënia e shpërblimeve vjetore.

Situata: Nga auditimi u konstatua se për periudhën 2016-2017 janë dhënë shpërblime në masën e një page mujore për punonjësit e APD në 3 raste në total në vlerën 99,624,687 lekë.

- Dhënia e shpërblimit për vitet 2016 dhe 2017 nuk është miratuar nga Ministri përkatës, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 pika 1/a, ku citohet: “*Organet kolegjiale drejtuese të njësisve të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Ministri përkatës*”.

- Dhënia e shpërblimeve nuk është bazuar në performancën e punonjësve, veprim në kundërshtim me Vendimin Këshillit Drejtues nr. 9, datë 18.03.2016 “Për politikën dhe procedurat e përfitimit të shpërblimeve suplementare dhe të ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës”, neni 4 “Përfitimi i shpërblimit”, pika 4.1, ku citohet: “*Shpërblimi për arritje të rezultatit pozitiv, akordohet i diferencuar. Masa e shpërblimit suplementar është në përpjestim, me kontributin e dhënë dhe performancën e punonjësve sipas formularit të vetëvlerësimit, si dhe dosjeve personale, të cilat miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv*”.

- Dhënia e shpërblimit në muajin Dhjetor 2016, është në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6, pika 1/a, ku citohet: “*Organet kolegjiale drejtuese të njësisve të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës*”.
Meqënëse për vitin 2016, punonjësit kanë marrë një shpërblim në muajin gusht, nuk duhet të ishte akorduar shpërblim i dytë. Vlera e shpërblimit prej **33,821,301 lekë përbën efekt financiar negativ** për Autoritetin Portual Durrës.

Kriteri: Ligji nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”. Vendimi nr.9, datë 18.03.2016 të Këshillit Drejtues të APD-së “Për politikën dhe procedurat e përfitimit të shpërblimeve suplementare dhe të ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës”.

Ndikimi/efekti: Miratim pa kompetencën e duhur dhe efekt financiar negativ për APD në vlerën **33,821,301 lekë**.

Shkaku: Moszbatim i përpiktë i ligjit.

Rëndësia: E lartë.



Rekomandim: Nga organet drejtuese të Autoritetit Portual Durrës të analizohet vlera **33,821,301 lekë**, e cila përbën efekt financiar negativ për Autoritetin Portual Durrës, si dhe në të ardhmen nga APD të akordohet dhënia e shpërblimeve vjetore jo më shumë se një pagë mujore në vit bazuar në performancën individuale të punonjësve, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Ministri përkatës.

Titulli i gjetjes: Shpërblimet e Këshillit Mbikëqyrës.

Situata: Nga auditimi u konstatua se Këshilli Drejtues me vendimin nr. 38 datë 02.12.2016 ka miratuar shpërblim për anëtarët e vet, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, neni 5 “Interesat private”, pika 1/a, ku citohet: “*Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre*”. Në dy rastet e tjera të dhënies së shpërblimit (korrik 2016 dhe korrik 2017) për Autoritetin Portual Durrës nuk ka një miratim të cilësuar për dhënie shpërblimi për Këshillin Drejtues, por nga Këshilli Drejtues është miratuar plani i biznesit për APD në fillim të çdo viti, ku është përfshirë zëri i shpërblimeve vjetore si dhe vlera për Këshillin Drejtues. Për pasojë edhe dy shpërblimet e tjera të përfituara nga Këshilli Drejtues për periudhën e audituar, konsiderohen të miratuara nga vetë Këshilli Drejtues, e për pasojë ky shpërblim është dhënë në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit. Për vlerën totale prej 4,364,500 lekë të përfituar nga Këshilli Drejtues në trajtën e shpërblimit financiar për periudhën 2016-2017, nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij, për pasojë grupi i auditimit shprehet me rezervë për përfitimin financiar të Këshillit Drejtues (organi kolegjal i APD) referuar ligjit për organet kolegjale.

Kriteri: Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligji nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Shpërblim financiar për të cilin nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij.

Shkaku: Mosndjekje e dispozitave ligjore.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **4,364,500 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpërblimin financiar të këshillit drejtues për periudhën 2016-2017, shpërblim i cili në opinionin e grupit të auditimit nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij nga ky organ. Vlerë e cila ka rënduar buxhetet e viteve respektive.

Titulli i gjetjes: Punësime mbi planin strukturor.

Situata: Nga auditimi u konstatua se titullari i Autoritetit Portual Durrës për periudhën 01.05.2016-30.06.2018, ka lidhur në 16 raste kontrata pune mbi planin strukturor të miratuar nga Këshilli Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 5,671,164 lekë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij”, Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 18.03.2016 “Rregullore organizative dhe menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës”.

Kriteri: Ligji nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e



tij”, Vendimi i Këshillit Drejtues nr.08, datë 18.03.2016 “Rregullore organizative dhe menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës”.

Ndikimi/efekti: Efekt financiar negativ në vlerën 5,671,164 lekë.

Shkaku: Punësime mbi planin strukturor të miratuar.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **5,671,164 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në punësimin e punonjësve mbi strukturën organike të miratuar nga Këshilli Drejtues për periudhën 01.05.2016-30.06.2018, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për APD, si dhe në të ardhmen të tregohet kujdes maksimal për mostejkalim të strukturës organizative të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Titulli i gjetjes: Shpërblim i punonjësve me masë disiplinore në fuqi.

Situata: Nga auditimi u konstatua se për periudhën 01.05.2016-30.06.2018, kanë përfituar shpërblim 36 punonjës në vlerën totale **4,072,460 lekë**, edhe pse gjatë vitit ushtrimor kanë marrë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 18.03.2016 të miratimit të Rregullores “Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimit suplementardhe ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës”, Kreu II, neni 5, pika a, ku citohet: *“Përfundimisht nga e drejta e përfitimit të shpërblimit, gjatë vitit ushtrimor, punonjësit ndaj të cilëve ju është akorduar një masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”.*

Vlera totale prej **4,072,460 lekë**, e dhënë si shpërblim për punonjësit të cilët gjatë vitit ushtrimor kanë marrë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.9, datë 18.03.2016, përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e APD.

Kriteri: Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 9, datë 18.03.2016 të miratimit të Rregullores “Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimit suplementardhe ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës”

Ndikimi/efekti: Efekt financiar negativ në vlerën 4,072,460 lekë.

Shkaku: Shpërblim i punonjësve me masë disiplinore në fuqi.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **4,072,460 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpërblimin e punonjësve të cilët gjatë vitit ushtrimor kanë marrë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për APD për periudhën 01.05.2016-30.06.2018, si dhe në të ardhmen të tregohet kujdes maksimal për shpërblimin e vetëm atyre punonjësve të cilët nuk janë nën masën “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”.

Titulli i gjetjes: Mangësi në dosjet e personelit.

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i 27 dosjeve të personelit, saktësisht dosjet: A. B., A. K., E. K., S. T., P. Ç., K. M., D. A., B. V., E. J., S. S., I. H., E. Gj., A. Xh., S. K., E. K., A. A., K. M., F. M., J. D., F. S., A. S., R. D., G. B., E. B., Z. M., E. H. dhe A. Gj., u konsatuan mangësi në administrimin e dokumentacionit, në kundërshtim me VKM nr.117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe me nenin 3 të Kontratës individuale të punës. Dokumentacioni i munguar është: Inventari i dosjes, në 13 raste; D\dëshmi penaliteti, vërtetim nga prokuroria dhe nga gjykata e rrethit, në 10 raste; raport mjekoligjor në 7 raste; listë notash në 8 raste; çertifikatë



familjare, në 9 raste; librezat e punës në 7 raste; ID personale, në 8 raste; adresa e vendbanimit, në 9 raste; dokument që të vërtetojë shlyerjen e detyrimeve të OSHEE, në 11 raste; librezat e sigurimeve shoqërore, në 12 raste; diploma e arsimit të lartë, në 4 raste.

Gjithashtu në dosjet e audituara u konstatua se në 3 raste, dokumentat janë fotokopje të panoterizuara, veprim në kundërshtim me VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen dhe administrimin e dosjes së personelit", lidhja 1, pika 4, në të cilën citohet: "*Dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri dhe janë pjesë përbërëse e dosjes*".

Kriteri: VKM nr.117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit".

Ndikimi/efekti: Dosje personeli të paplotësuara.

Shkaku: Nga Drejtoria e burimeve njerëzore nuk janë marrë masa për plotësimin e dosjeve.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masa të nevojshme për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në VKM 117, datë 05.03.2014.

Titulli i gjetjes: Pagesa për orët jashtë orarit zyrtar.

Situata: Nga auditimi u konstatua se pagesat për orët shtesë jashtë orarit zyrtar, janë kryer në përfundim të muajit gjatë të cilit janë kryer orët shtesë, duke mos u përpjekur në asnjë rast që këto orë shtesë të kompensohen me ditë pushimi brenda 2 muajve nga kryerja e orëve shtesë, veprime në kundërshtim me VKM nr. 463, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002 "Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", të ndryshuar", pika 5, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "*Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i kërkohej të kryejnë orë shtesë.... Titullari i institucionit detyrohet t'ia japë kërkuarët këtë pushim, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë. Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompensohet me shtesë mbi pagën normale", si dhe me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16 datë 20.07.2011 "Mbi zbatimin e Vendimit nr. 463, datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave", pika 2 "Për të kryer një detyrë të caktuar jashtë kohës normale të punës për të gjithë punonjësit e administratës, titullari i institucionit miraton urdhërin përkatës për detyrën që duhet të kryhet, kohëzgjatjen e saj dhe punonjësit që ngarkohen në kryerjen e kësaj detyre. Njësitë e personelit në bashkëpunim me eprorin e punonjësit që caktohet të punojnë jashtë kohës normale të punës, marrin masa të duhura për të siguruar realizimin e detyrës së caktuar, si dhe për të përcaktuar kohën e kryerjes së pushimit të përlllogarit sipas pikës 1 të këtij udhëzimi. Në asnjë rast, punonjësi i administratës publike që kryen veprimtari administrative nuk kompensohet financiarisht për kohën e punuar mbi kohën normale të punës, por kompensohet vetëm me orë/ditë pushimi", si dhe pika 3 "Nëpunësi dhe punonjësi i administratës që kryen veprimtari operacionale, si rregull, kompensohet me orë/ditë pushimi. Mund të kompensohen financiarisht punonjësit që kryejnë veprimtari të drejtpërdrejtë operacionale vetëm kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme: a) kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë të punuara, për shkak të natyrës së veprimtarisë operacionale, ndërprerja e së cilës çënon funksionalitetin e institucionit, b) kur institucioni ka fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të tij".*



Për pasojë vlera prej **385,656 lekë** e paguar për orët shtesë përbën **efekt financiar negativ** për Autoritetin Portual Durrës.

Kriteri: VKM nr.463, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.511, datë 24.10.2002 të këshillit të ministrave “për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar”, Udhëzimi nr.16 datë 20.07.2011 të Ministrisë së Financave “Mbi zbatimin e Vendimit nr.463, datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave”

Ndikimi/efekti: Efekt financiar negative në vlerën 385,656 lekë.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **385,656 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në dhënijen e orëve shtesë për punonjësit në kundërshtim me VKM nr. 463, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar”. Në vijimësi nga Autoriteti Portual Durrës të merren masat e nevojshme për zëvendësimin e orëve shtesë mbi kohën normale të punës me ditë pushimi. Shpërblimi financiar të aplikohet vetëm në ato raste kur zëvendësimi me ditë pushimi, për shkaqe të përligjura, çenohet funksionaliteti i institucionit.

Titulli i gjetjes: Mungesa e procedurave për rekrutimin e stafit.

Situata: Nga auditimi u konstatua se rregullorja organizative dhe e menaxhimit të APD nuk përmban procedura për rekrutimin e punonjësve të rinj dhe kriteret për vlerësimin e performancës së punonjësve, si dhe nuk përfshin përshkrimet e punës për çdo funksion të caktuar pune. Në opinion të grupit të auditimit mënyra e ndjekur nga APD për rekrutimin e punonjësve nuk është transparente, pasi përveç sa më sipër, nuk janë konstatuar gjurmë të publikimit të vendeve vakante. Me Vendimin nr.2, datë 10.01.2018 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim nëstrukturën e pagave të APD-së”, në pikën 2 të këtij vendimi është cituar: “Drejtoria Ekzekutive e APD-së të marrë masat e nevojshme për hartimin, miratimin dhe zbatimin e menjëhershëm të përshkrimeve të punës për çdo pozicion, në përputhje me Strukturën Organizative dhe Rregulloren “Për organizimin dhe menaxhimin e APD”.

Kriteri: Vendimi i Këshillit Drejtues nr.9, datë 18.03.2016 të miratimit të Rregullores “Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimit suplementardhe ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës”

Ndikimi/efekti: Punësime jo transparente.

Shkaku: Mungesa e një rregulloreje rekrutimi.

Rëndësia: E mesme.

Rekomandim: Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa për hartimin e një rregulloreje për rekrutimin e punonjësve të rinj si dhe vendosjen e kriterëve për vlerësimin e performancës së punonjësve, duke përfshirë përshkrimet e punës për çdo funksion të caktuar pune, me qëllim krijimin e procedurave transparente dhe rekrutimin e një stafi sa më profesional.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Marrëdhëniet e punës në APD janë rregulluar me anë të kontratës kolektive dhe kontratave individuale.

Në APD ekziston kontrata kolektive e punës e cila hartohet çdo tre vjet. Kontrata e fundit kolektive është nënshkruar në datën në 09.05.2017, ndërmjet ish-Drejtorit të APD dhe Sindikatës të Pavarur të APD.

Nga auditimi u konstatua se afati i vlefshmërisë së kontratës paraardhëse ka qenë nga data 15.06.2012 deri më 18.06.2016, pra për periudhën 18.06.2016 deri më 09.05.2017



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

marrëdhëniet e punës së punonjësve nuk kanë qenë të rregulluar me kontratë kolektive trajtuar kjo edhe në auditimin e mëparshëm të KLSH, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 173.

Në vija të përgjithshme struktura e Autoritetit Portual Durrës paraqitet si më poshtë:

Periudha	Nr.Mesatar	Paga mesatare	Fondi i pagave (në 000 lekë)	Realizim fondi i pagave (në 000 lekë)	Në përqindje
2016	439	75465	411177	397552	96.7
2017	459	82250	466956	453038	97
2018 (deri 30.04)	453	82624	158168	149716	94.7

Burimi i të dhënave: APD

Nga sa më sipër konstatohet se për vitin 2016 numri mesatar i punonjësve është 439, për vitin 2017 është 459 dhe për vitin 2018 (deri 30.04) është 453. Paga mesatare për vitin 2016 është 75,465 lekë, për vitin 2017 është 82,250 lekë dhe për vitin 2018 është 82,624 lekë. Fondi pagave nuk rezulton të jetë tejkaluar në asnjë prej viteve objekt auditimi. Për vitin 2016 realizimi i fondit të pagave është në nivelin 96.7%, për vitin 2017 është në nivelin 97% dhe për vitin 2018 është në nivelin 94.7%.

Struktura organizative dhe ajo e pagave për periudhën objekt auditimi kanë ndryshuar me vendime të Këshillit Drejtues sipas viteve si më poshtë:

Viti 2016

Vendimi nr.22, datë 30.08.2016 i Këshillit Drejtues “Mbi ndryshimin e strukturës organizative, organigramës dhe numrit të punonjësve të APD-së”. Është vendosur shtesa e pozicionit “Këshilltar Kordinativ i Këshillit Drejtues të APD” dhe heqja e pozicionit “Specialist” në njësinë e hipotekimit të pronave.

Vendimi nr.36, datë 30.11.2016 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën organizative dhe organigramën e APD-së”. Është vendosur ndryshimi i strukturës organizative dhe organigramës së APD-së, pa ndryshim të numrit të punonjësve. Kërkesa për këtë është bërë nga ana e ish-Drejtorit të Përgjithshëm të APD me shkresën me nr.3272 prot, datë 24.11.2016. Sipas relacionit, është kërkuar ndryshimi (rritje) i kategorisë së pagave për 15 pozicione pune, si dhe indeksimi i pagave të APD me 10% të vlerës së tyre në proporcion me rritjen e inflacionit në 5 vitet e fundit.

Vendimi nr.37, datë 30.11.2016 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në Vendimin nr.13 datë 05.05.2015 “Mbi strukturën e pagave të punonjësve të APD””. Është vendosur miratimi i strukturës së pagave”.

Viti 2017

Vendimi nr.2, datë 12.01.2017 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën organizative dhe organigramën e APD-së”. Është vendosur ndryshimi i strukturës së APD pa ndryshuar numrin e punonjësve.

Vendimi nr.5, datë 07.04.2017 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën organizative dhe organigramën e APD-së”. Është vendosur ndryshimi i strukturës dhe organigramës si dhe shtimi i numrit të punonjësve nga 444, në 452. Shtesa do të bëhet me 2 punonjës në sektorin e “Hipotekimit të pronave”, një ekonomist dhe 3 zjarrëfikës në sektorin e PMNZH si dhe 1 person tek laboratorit mjedisor.



Vendimi nr.6, datë 07.04.2017 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën e pagave të punonjësve të APD-së”. Është vendosur ndryshimi i strukturës së pagave të punonjësve të APD.

Viti 2018

Vendimi nr.1, datë 10.01.2018 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën organizative dhe organigramën e APD-së”. Është vendosur ndryshimi i strukturës organizative në përputhje me propozimin e bërë nga APD, me një total prej 455 punonjësish.

Vendimi nr.2, datë 10.01.2018 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën e pagave të APD-së”. Është vendosur ndryshimi i strukturës së pagave të punonjësve të APD. Gjithashtu në pikën 2 të këtij vendimi është cituar: “*Drejtoria Ekzekutive e APD-së të marrë masat e nevojshme për hartimin, miratimin dhe zbatimin e menjëhershëm tëpërshkrimeve tëpunës për çdo pozicion, në përputhje me Strukturën Organizative dhe Rregulloren “Për organizimin dhe menaxhimin e APD”*”.

Vendimi nr.9, datë 19.04.2018 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën organizative dhe organigramën e APD-së”. Ndër të tjera është vendosur shtimi i përkohshëm i numrit të punonjësve me 10 punonjës në sektorin operativ të mirëmbajtjes teknike deri në realizimin e procedurës tenderuese me një operator privat.

Vendimi nr.10, datë 19.04.2018 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën e pagave të APD-së”. Është vendosur ndryshimi i strukturës së pagave të punonjësve të APD.

Miratimet e strukturës së pagave.

Nga auditimi u konstatua se për vendimet e marra nga ana e Këshillit Drejtues të APD në lidhje me ndryshimet e strukturës organike dhe nivelit të pagave të APD, nuk është marrë miratimi nga Ministri përkatës, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 “Kompetencat e organeve kolegjiale”, pika 1/a, ku citohet: “*Organet kolegjiale drejtuese të njëjësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregëtare, me kapital mbi 50% shtetëror, miratojnë nivelet e pagave të punonjësve të tyre, brenda kufirit minimal e maksimal të caktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësive të tyre financiare dhe pas miratimit nga Ministri përkatës*”, me Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, Neni 53 “Aktet nënligjore”, pika 2 “*Ministri, në zbatim të këtij ligji, ngarkohet të nxjerrë urdhra dhe udhëzime për këto çështje: b) të përcaktojë nivelin e pagesave, sipas nenit 25 pika 2*”, dhe me rregulloren organizative dhe menaxhimit e Autoritetit Portual Durrës pika 4/7/c “*Këshilli Drejtues vendos dhe rishikon sistemin e pagave të anëtarëve të tij, Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe punonjësve të APD, dhe bën rekomandimet tek Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës*”. Për pasojë menaxhimi i lartë ka angazhuar, rekrutuar dhe shpenzuar punonjës dhe shpenzime për paga dhe shpërblime pa marrë miratimin përkatës nga Ministri, si i vetmi autoritet ligjor.

Për këtë mbajnë përgjegjësi G. Sh., A. L. dhe A. Q. në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv për periudhat respektive, dhe A. B. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv në Autoritetin Portual Durrës.

Shpërblimet e akorduara për APD.

Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi janë dhënë shpërblime në masën e një page mujore për punonjësit e APD në 3 raste në total në vitet 2016-2017, në mënyrë të detajuar si më poshtë:

Me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv G. Sh. nr.2434 prot, datë 31.08.2016 “Mbi dhënien e shpërblimit për punonjësit e APD-së”, në zbatim të vendimit të



Këshillit Drejtues nr.18, datë 29.07.2016 “Mbi miratimin e bilancit dhe shpërndarjes së fitimit neto për vitin 2015”, në vlerën totale **30,626,924 lekë**. Nga të cilat **29,336,924 lekë** për stafin e APD dhe **1,290,000 lekë** për Këshillin Drejtues.

Me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr.3392 prot, datë 07.12.2016 “Mbi dhënien e shpërblimit për punonjësit e APD-së”, në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues nr.38, datë 29.07.2016 “Mbi një ndryshim në Plan Biznesin Ekonomik Financiar të APD-së për vitin 2016”, në vlerën totale **35,240,301 lekë**. Nga të cilat **33,821,301 lekë** për stafin e APD dhe **1,419,000 lekë** për Këshillin Drejtues.

Me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr.1967 prot, datë 24.07.2017 “Mbi dhënien e shpërblimit për punonjësit e APD-së”, në zbatim të vendimit të Këshillit Drejtues nr.8, datë 19.07.2017 “Mbi miratimin e bilancit dhe shpërndarjes së fitimit neto për vitin 2016”, në vlerën totale **33,757,462 lekë**. Nga të cilat **32,101,962 lekë** për stafin e APD dhe **1,655,500 lekë** për Këshillin Drejtues.

Nga sa më sipër:

- Dhënia e shpërblimit për vitet 2016 dhe 2017 nuk është miratuar nga Ministri përkatës, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 pika 1/a, ku citohet: “*Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës*”.

Për pasojë, shpërblimet janë dhënë në tejkallim të kompetencave që ju jep ligji, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Portual Durrës për periudhat respektive (G. Sh. për shpërblimin gusht 2016, A. L. për shpërblimet dhjetor 2016 dhe korrik 2017).

- Dhënia e shpërblimeve nuk është bazuar në performancën e punonjësve, veprim në kundërshtim me Vendimin nr. 9, datë 18.03.2016 të Këshillit Drejtues të APD-së “Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimeve suplementare dhe të ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës”, neni 4 “Përfitimi i shpërblimit”, pika 4.1, ku citohet: “*Shpërblimi për arritje të rezultatit pozitiv, akordohet i diferencuar. Masa e shpërblimit suplementar është në përpjestim, me kontributin e dhënë dhe performancën e punonjësve sipas Formularit të Vetëvlerësimit, si dhe Dosjeve personale, të cilat miratohen nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv*”.

- Dhënia e shpërblimit në muajin dhjetor 2016, është në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 pika 1/a, ku citohet: “*Organet kolegjiale drejtuese të njësive të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës*”. Meqenëse për vitin 2016, punonjësit kanë marrë një shpërblim në muajin gusht, nuk duhet të ishte akorduar shpërblim i dytë. Vlera e shpërblimit prej **33,821,301 lekë përbën efekt financiar negativ** për Autoritetin Portual Durrës.

Ky veprim ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Portual Durrës.

Shpërblimet për Këshillin Drejtues.

- Krahas shpërblimit të punonjësve, Këshilli Drejtues me vendimin nr.38 datë 02.12.2016 ka miratuar shpërblim për veten e vetë, në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, pjesa e tretë “*Garantimi i paanshmërisë së administratës*”.



publike”, Neni 30 “Pengesat ligjore”, ku citohet: “Nëpunësi publik ose anëtar i organit kolegjial nuk përfshihet në një procedurë administrative vendimmarrës, në rastet kur: a) ka një interes personal të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë në vendimmarrjen në shqyrtim”, me Ligjin nr.9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. i ndryshuar, Neni 5 “Interesat private”, pika 1/a, ku citohet: “Interesat privatë të zyrtarit janë ata interesa që përputhen, përmbajnë, bazohen ose burojnë nga të drejta dhe detyrime pasurore të çdo lloj natyre”. Edhe pse në dy rastet e tjera të përmendura të dhënies së shpërblimit për Autoritetin Portual Durrës nuk kemi një miratim të cilësuar për dhënie shpërblimi për Këshillin Drejtues, nga ana tjetër vetë Këshilli Drejtues ka miratuar planine biznesit për APD në fillim të çdo viti, ku është përfshirë zëri i shpërblimeve vjetore si dhe vlera për Këshillin Drejtues. Për pasojë edhe dy shpërblimet e tjera të përfituara nga Këshilli Drejtues për periudhën e audituar, konsiderohen të miratuara nga Këshilli Drejtues, e për pasojë ky shpërblim është dhënë në kushtet e konfliktit të mundshëm të interesit.

Këshilli Drejtues në tre raste për periudhën objekt auditimi ka përfituar vlerën totale prej 4,364,500 lekë në trajtën e shpërblimit financiar.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të këtij shpërblimi nga anëtarët e Këshillit Drejtues në vlerën 4,364,500 lekë.

Në këto kushte grupi i auditimit shprehet me rezervë për përfitimin financiar të Këshillit Drejtues (organi kolegjial i APD) referuar ligjit për organet kolegjiale.

Masat e shpërblimeve për Këshillin Drejtues janë dhënë në tejkallim të kompetencave që jep ligji, pasi nuk kanë marrë miratim nga Ministri përkatës, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, neni 6 pika 1/a, ku citohet: “Organet kolegjiale drejtuese të njësisve të fondeve speciale, të institucioneve publike, të ndërmarrjeve shtetërore dhe të shoqërive tregtare, me kapital mbi 50 për qind shtetëror, miratojnë masën e shpërblimit të punës, por jo më shumë se një pagë mujore në vit, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga ministri përkatës”, çka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Portual Durrës për periudhat respektive (G. Sh. për shpërblimin gusht 2016, A. L. për shpërblimet dhjetor 2016 dhe korrik 2017).

Proceset gjyqësore të largimeve nga puna.

-Për periudhën objekt auditimi, në APD janë punësuar gjithsej 186 punonjës, si dhe i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës 153 punonjësve. Më poshtë paraqiten punësimet dhe largimet sipas viteve respektive:

	2016	2017	2018
Punësime	42	74	70
Largime	29	81	43

Burimi: APD

Nga auditimi u konstatua se rregullorja organizative dhe e menaxhimit të APD nuk përmban procedura për rekrutimin e punonjësve të rinj dhe kriteret për vlerësimin e performancës së punonjësve, si dhe nuk përfshin përkrahjet e punës për çdo funksion të caktuar pune. Në opinion të grupit të auditimit mënyra e ndjekur nga APD për rekrutimin e punonjësve nuk është transparente, pasi përveç sa më sipër, nuk janë konstatuar gjurmë të publikimit të vendeve vakante. Me Vendimin nr.2, datë 10.01.2018 i Këshillit Drejtues “Për një ndryshim në strukturën e pagave të APD-së”, në pikën 2 të këtij vendimi është cituar: “Drejtoria



Ekzekutive e APD-së të marrë masat e nevojshme për hartimin, miratimin dhe zbatimin e menjëhershëm të përkrahjeve të punës për çdo pozicion, në përputhje me Strukturën Organizative dhe Rregulloren “Për organizimin dhe menaxhimin e APD”. Me urdhrin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm të APD nr.892, datë 01.03.2018, është ngritur një grup pune i përbërë nga drejtorët e drejtorive për hartimin, miratimin dhe zbatimin e përkrahjeve të punës. Deri në momentin e auditimit, nuk ka asnjë dokument përfundimtar për këtë. Duhet theksuar se për periudhën nga data 10.01.2018, kur KD ka vendosur për hartimin e përkrahjeve të punës, deri në qershor 2018, janë rekrutuar 75 punonjës.

Largimi i punonjësve shpesh herë ka sjellë hapjen e proceseve gjyqësore, ku punonjësit e larguar kanë paditur Autoritetin Portual Durrës për largime të padrejta nga puna.

Për periudhën objekt auditimi, APD është palë në 41 procese gjyqësore, nga të cilët 16 janë në shkallën e parë të gjykimit, 14 janë në gjykatën e apelit, ndërsa 11 kanë përfunduar dhe janë humbur nga APD. Vlera e paguar nga APD për proceset gjyqësore të humbura në periudhën objekt auditimi është 13,819,956 lekë nga 15,090,788 lekë për të cilat vendimi ka marrë formë të prerë. *Si përfundim, për periudhën objekt auditimi, si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme, Autoriteti Portual Durrës është penalizuar nga vendimet e gjykatave në vlerën 13,819,956 lekë, dhe mbetet ende për tu paguar diferenca prej 1,270,832 lekë. Vlera **13,819,956 lekë** përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e APD.*

Punësime mbi planin strukturor.

- Nga auditimi u konstatua se APD për periudhën objekt auditimi ka lidhur kontrata pune mbi planin strukturor të miratuar nga Këshilli Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 5,671,460 lekë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të Autoritetit Portual Durrës dhe për Riorganizimin e tij”, Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 18.03.2016 “Rregullore organizative dhe menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës”. *Këto veprime ngarkojnë me përgjegjësi A. L. dhe A. Q. në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv për periudhat respektive.*

Në mënyrë të detajuar pasqyrohen më poshtë:

1- Për periudhën 06.03.2017-02.06.2017 në strukturën e APD ka një pozicion specialist, në Sektorin PIU të Projektit BEI-BERZH më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 281,384 lekë për APD.**

2- Për periudhën 01.06.2017-31.08.2017 në strukturën e APD ka një pozicion specialist, Sektori Prognozës dhe Statistikave, Drejtoria Ekonomisë, financës dhe administrimit, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 314,530 lekë për APD.**

3- Për periudhën 01.08.2017-13.09.2017 në strukturën e APD ka një pozicion specialist, Sektori Koordinimit të Projekteve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Promocionit dhe Prokurimeve më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 132,083 lekë për APD.**

4- Për periudhën 11.02.2017-07.04.2017 në strukturën e APD ka një pozicion Këshilltar Administrativ më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 313,287 lekë për APD.**

5-Për periudhën 11.02.2017-07.04.2017 në strukturën e APD ka një pozicion Arshivist, ndërkohë që në strukturën e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues nuk është, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 468,922 lekë për APD.**



6-Për periudhën 27.02.2017-01.09.2017 në strukturën e APD ka një pozicion Inspektor në Sektorin e Administrimit të Territorit dhe Ambienteve, Drejtoria Ekonomike, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 469,134 lekë për APD.**

7-Për periudhën 22.02.2017-16.03.2017 në strukturën e APD ka një pozicion Specialist në Sektorin e Kontratave dhe Ceshetjeve Ligjore, Drejtoria Juridike, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 74,847 lekë për APD.**

8-Për periudhën 13.03.2017-25.11.2017 në strukturën e APD ka pozicione Operator Vinçi në Drejtorinë e Shërbimeve Operacionale, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 614,600 lekë për APD.**

9-Për periudhën 06.03.2017-04.09.2017 në strukturën e APD ka një pozicion specialist në sektorin e Monitorimit të Kontratave Koncesionare, në Drejtorinë e Shërbimeve Operacionale, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 579,956 lekë për APD.**

10-Për periudhën 06.03.2017-04.09.2017 në strukturën e APD ka një pozicion Inspektor në Drejtorinë e Shërbimeve Operacionale, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 550,533 lekë për APD.**

11-Për periudhën 24.03.2017-07.04.2017 në strukturën e APD ka një pozicion punonjës zjarrëfikës, reparti PMZSH, Drejtoria e Mjedisit, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 32,134 lekë për APD.**

12- Për periudhën 04.04.2017-12.09.2017 në strukturën e APD ka një pozicion specialist, Drejtoria e Mjedisit, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 475,691 lekë për APD.**

13- Për periudhën 08.05.2017-26.08.2017 në strukturën e APD ka një pozicion Specialist në Laboratorin Mjedisor, Drejtoria e Shërbimeve Operacionale, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 286,180 lekë për APD.**

14- Për periudhën 10.05.2017-10.11.2017 në strukturën e APD ka një pozicion Dispecer Operacional, Drejtoria e Shërbimeve Operacionale, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 533,107 lekë për APD.**

15- Për periudhën 10.05.2017-10.11.2017 në strukturën e APD ka një pozicion Drejtues Automjeti, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Promocionit dhe Prokurimeve, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 213,773 lekë për APD.**

16- Për periudhën 08.05.2017-04.08.2017 në strukturën e APD ka një pozicion specialist në sektorin e Administrimit të Ambienteve, Drejtoria Ekonomisë, financës dhe administrimit, më shumë nga struktura e miratuar nga ana e Këshillit Drejtues, me pasojë **efekt financiar negativ në vlerën 331,003 lekë për APD.**

Shpërblim i punonjësve nën masën “Paralajmërim për pushim nga puna”.

- Nga auditimi u konstatua se për periudhën objekt auditimi, kanë përfituar shpërblim 36 punonjës në vlerën totale **4,072,460 lekë**, edhe pse gjatë vitit ushtrimor kanë marrë masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.9, datë 18.03.2016 të miratimit të Rregullores “Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimit suplementardhe ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës”, Kreu II, neni 5, pika a, ku citohet: “Përjashtohen nga e drejta e përfitimit të



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

shpërblimit, gjatë vitit ushtrimor, punonjësit ndaj të cilëve ju është akorduar një masë disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna””.

Në muajin gusht 2016 kanë marrë shpëblim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 18.03.2016, gjithsej 16 punonjës në vlerën **989,680 lekë**. Më poshtë jepet tabela e detajuar:

Nr.	Punonjësi	Masa “Paralajmërim për largim nga puna”	Shpërblimi gusht 2016
1	E. H.	Nr. 60, dt. 07.01.2016	80,000
2	D. D.	Nr. 62, dt. 07.01.2016	79,400
3	F. Xh.	Nr. 554, dt. 16.02.2016	82,280
4	B. H.	Nr. 731, dt. 02.03.2016	54,000
5	A. D.	Nr. 732, dt. 02.03.2016	54,000
6	Gj. V.	Nr. 733, dt. 02.03.2016	54,000
7	S. H.	Nr. 734, dt. 02.03.2016	54,000
8	E. Gj.	Nr. 735, dt. 02.03.2016	54,000
9	I. K.	Nr. 736, dt. 02.03.2016	54,000
10	J.D.	Nr. 737, dt. 02.03.2016	54,000
11	R. K.	Nr. 738, dt. 02.03.2016	54,000
12	A. G.	Nr. 739, dt. 02.03.2016	54,000
13	Sh. D.	Nr. 740, dt. 02.03.2016	54,000
14	O.Sh.	Nr. 854, dt. 16.03.2016	65,000
15	M. Xh.	Nr. 1107, dt. 04.04.2016	89,000
16	Q.K.	Nr. 1554, dt. 20.05.2016	54,000
		Total	989,680

Në muajin dhjetor 2016 kanë marrë shpëblim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.9, datë 18.03.2016, gjithsej 32 punonjës në vlerën **2,810,440 lekë**. Më poshtë jepet tabela e detajuar:

Nr.	Punonjësi	Masa “Paralajmërim për largim nga puna”	Shpërblimi dhjetor 2016
1	E. H.	Nr. 60, dt. 07.01.2016	86,200
2	D. D.	Nr. 62, dt. 07.01.2016	85,400
3	B.H.	Nr. 731, dt. 02.03.2016	59,000
4	A. D.	Nr. 732, dt. 02.03.2016	59,000
5	Gj.V.	Nr. 733, dt. 02.03.2016	59,000
6	S. H.	Nr. 734, dt. 02.03.2016	59,000
7	E. Gj.	Nr. 735, dt. 02.03.2016	59,000
8	I. K.	Nr. 736, dt. 02.03.2016	59,000
9	J. D.	Nr. 737, dt. 02.03.2016	59,000
10	R. K.	Nr. 738, dt. 02.03.2016	59,000
11	A. G.	Nr. 739, dt. 02.03.2016	59,000
12	Sh. D.	Nr. 740, dt. 02.03.2016	59,000
13	O.Sh.	Nr. 854, dt. 16.03.2016	72,000
14	M. Xh.	Nr. 1107, dt. 04.04.2016	96,000
15	Q. K.	Nr. 1554, dt. 20.05.2016	54,000
16	B. Dh.	Nr. 2730, dt. 03.10.2016	177,000
17	F. S.	Nr. 2900, dt. 21.10.2016	143,680
18	R. Gj.	Nr. 2892, dt. 21.10.2016	114,440
19	E. K.	Nr. 2896, dt. 21.10.2016	109,960
20	A. C.	Nr. 2901, dt. 21.10.2016	93,480
21	E. M.	Nr. 2894, dt. 21.10.2016	88,560



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

22	M. R.	Nr. 2891, dt. 21.10.2016	90,960
23	Sh. Xh.	Nr. 2897, dt. 21.10.2016	112,000
24	T.Gj.	Nr. 2899, dt. 21.10.2016	107,000
25	L. K.	Nr. 2893, dt. 21.10.2016	95,720
26	L.M.	Nr. 2895, dt. 21.10.2016	90,680
27	A. B.	Nr. 2890, dt. 21.10.2016	91,240
28	S. D.	Nr. 2898, dt. 21.10.2016	88,560
29	I.T.	Nr. 3132, dt. 11.11.2016	89,840
30	B. V.	Nr. 3258, dt. 23.11.2016	91,240
31	A. M.	Nr. 3280, dt. 24.11.2016	94,880
32	A. N.	Nr. 3323, dt. 01.12.2016	147,600
		Total	2,810,440

Në muajin korrik 2017 kanë marrë shpëblim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.9, datë 18.03.2016, gjithsej 3 punonjës në vlerën **272,340 lekë**. Më poshtë jepet tabela e detajuar:

Nr.	Punonjësi	Masa "Paralajmërim për largim nga puna"	Shpërblimi korrik 2017
1	K. G.	Nr. 199, dt. 23.01.2017	92,360
2	J. Xh.	Nr. 200, dt. 23.01.2017	85,660
3	A. C.	Nr. 228, dt. 25.01.2017	94,320
		Total	272,340

Vlera totale prej **4,072,460 lekë**, e dhënë si shpëblim për punonjësit të cilët gjatë vitit ushtrimor kanë marrë masë disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna", në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 18.03.2016 të miratimit të Rregullores "Për politikat dhe procedurat e përfitimit të shpërblimit suplementardhe ndihmave financiare në Autoritetin Portual Durrës", Kreu II, neni 5, pika a, ku citohet: "Përjashtohen nga e drejta e përfitimit të shpërblimit, gjatë vitit ushtrimor, punonjësit ndaj të cilëve ju është akorduar një masë disiplinore "Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna"', përbën **efekt financiar negativ** për buxhetin e APD.

Për këtë mbajnë përgjegjësi G. Sh. në cilësinë Titullarit të APD për shpërblimin në muajin gusht 2016, A. L. në cilësinë e Titullarit të APD për shpërblimet në muajin dhjetor 2016 dhe korrik 2017, si dhe A. K. në cilësinë e Drejtorit të Burimeve Njerëzore në periudhat e mësipërme.

Mangësitë në dokumentacionin e dosjeve të personelit.

- Nga auditimi me zgjedhje i 27 dosjeve të personelit u konsatuan mangësi në dosje në kundërshtim me VKM nr.117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit" dhe me nenin 3 të Kontratës individuale të punës. Dosjet e audituara janë: A. B., A. K., E. K., S. T., P. Ç., K. M., D. A., B.V., E. J., S. S., I. H., E. Gj., A. Xh., S. K., E. K., A. A., K. M., F. M., J. D., F. S., A. S., R. D., G. B., E. B., Z. M., E. H. dhe A. Gj.. Mangësitë e konstatuara në dokumentacionin e dosjeve janë si më poshtë:

1. Inventari i dosjes, në 13 raste;
2. Dëshmi penaliteti, vërtetim nga prokuroria dhe nga gjykata e rrethit, në 10 raste;
3. Raport mjekoligjor në 7 raste;
4. Listë notash në 8 raste;
5. Çertifikatë familjare, në 9 raste;



6. Libreza e punës në 7 raste;
7. ID personale, në 8 raste;
8. Adresa e vendbanimit, në 9 raste;
9. Dokument që të vërtetojë shlyerjen e detyrimeve të OSHEE, në 11 raste;
10. Libreza e sigurimeve shoqërore, në 12 raste;
11. Diploma e arsimit të lartë, në 4 raste.

Gjithashtu në dosjet e audituara u konstatua se në 3 raste, dokumentat janë fotokopje të panoterizuara, veprim në kundërshtim me VKM nr. 117, datë 05.03.2014 "Për përmbajtjen dhe administrimin e dosjes së personelit", lidhja 1, pika 4, në të cilën citohet: "Dokumentat duhet të jenë origjinale ose fotokopje të vërtetuara me noteri dhe janë pjesë përbërëse e dosjes".

Për mangësitë e konstatuara në dosje mbajnë përgjegjësi K. M. me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe A. K. në cilësinë e ish-Drejtorit të Burimeve Njerëzore.

Pagesa për punë jashtë orarit zyrtar.

Për periudhën objekt auditimi u verifikuan pagesat e kryera për punët jashtë orarit dhe rezultuan si më poshtë:

Punonjësi	Muaji	Orë Shtesë	Vlera (në lekë)
K. M.	Prill 2018	40	40,739
M. D.	Prill 2018	40	33,307
I. K.	Prill 2018	40	29,883
J. V.	Prill 2018	40	24,091
F. H.	Mars 2017	40	45,068
J. K.	Mars 2017	40	19,318
F. H.	Maj 2017	40	45,068
J. K.	Maj 2017	40	19,318
F. H.	Qershor 2017	40	45,068
J. K.	Qershor 2017	40	19,318
B. M.	Qershor 2017	26	11,629
B. L.	Qershor 2017	40	19,318
B. M.	Korrik 2017	30	14,213
B. L.	Korrik 2017	40	19,318
TOTAL			385,656

Nga auditimi u konstatua se pagesat për orët shtesë jashtë orarit zyrtar janë kryer në përfundim të muajit gjatë të cilit janë kryer orët shtesë, duke mos u përpjekur në asnjë rast që këto orë shtesë të kompesohen me ditë pushimi brenda 2 muajve nga kryerja e orëve shtesë, veprime në kundërshtim me VKM nr.463, datë 16.06.2011 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 511, datë 24.10.2002 të këshillit të ministrave "për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore", të ndryshuar", pika 5: "Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të institucionit qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nëpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t'i kërkohej të kryejë orë shtesë.... Titullari i institucionit detyrohet t'ia japë kërkuessit këtë pushim, brenda 2 (dy) muajve nga kryerja e orëve shtesë. Në rastet kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë në punë, nëpunësi apo punonjësi i administratës, që kryen veprimtari operacionale, ka të drejtë të kompesohet me shtesë mbi pagën normale", si dhe me Udhëzimin nr.16 datë 20.07.2011 të Ministrisë së Financave "Mbi zbatimin e Vendimit nr.463, datë 16.06.2011 të Këshillit të Ministrave", pika 2 "Për të kryer një detyrë të caktuar jashtë kohës normale të punës për të gjithë punonjësit e administratës, titullari i institucionit miraton urdhërin përkatës për detyrën që duhet të kryhet, kohëzgjatjen e saj dhe punonjësit



që ngarkohen në kryerjen e kësaj detyre. Njësitë e personelit në bashkëpunim me eprorin e punonjësit që caktohet të punojë jashtë kohës normale të punës, marrin masat e duhura për të siguruar realizimin e detyrës së caktuar, si dhe për të përcaktuar kohën e kryerjes së pushimit të përlogaritur sipas pikës 1 të këtij udhëzimi. Në asnjë rast, punonjësi i administratës publike që kryen veprimtari administrative nuk kompesohet financiarisht për kohën e punuar mbi kohën normale të punës, por kompesohet vetëm me orë/ditë pushimi”, si dhe pika 3 “Nëpunësi dhe punonjësi i administratës që kryen veprimtari operacionale, si rregull, kompesohet me orë/ditë pushimi. Mund të kompesohen financiarisht punonjësit që kryejnë veprimtari të drejtpërdrejtë operacionale vetëm kur plotësohen dy kushtet e mëposhtme: a) kur është e pamundur dhënia e pushimit për orët shtesë të punuara, për shkak të natyrës së veprimtarisë operacionale, ndërprerja e së cilës çënon funksionalitetin e institucionit, b) kur institucioni ka fonde të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të tij”.

Për pasojë vlera prej **385,656 lekë** e paguar për orët shtesë përbën **efekt financiar negativ** për Autoritetin Portual Durrës.

Për këtë mbajnë përgjegjësi A. B. në cilësinë e Titullarit të APD dhe K. M. në cilësinë e eprorit direkt për orët shtesë të paguara në muajin prill 2018, A. L. në cilësinë e Titullarit të APD dhe A. K. në cilësinë e eprorit direkt për orët shtesë të paguara në muajt maj-korrik 2017.

Titulli i gjetjes: Punësimi/Emërimi i Drejtorit të Auditit Brendshëm është kryer në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe nenin 16 “Kompetencat e Këshillit Drejtues”, pika 14 , “Rregulloren e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Drejtues të APD-së”, si dhe ka përfituar padrejtësisht pagë nga grupi B1 në A2 me një vlerë 190,910 lekë.

Situata: Punësimi/Emërimi i Drejtorit të Auditit Brendshëm sipas pikës 2 të Vendimit Këshillit Drejtues nr.3 datë 10.01.2018 , është kryer në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr. 114/2015 ”Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe nenin 16 “Kompetencat e Këshillit Drejtues”, pika 14 , “Rregullore e Funksionimit të Këshillit Drejtues të APD-së” . Nuk provohet përvija 5-vjecare si auditues, në zbatim të nenit 11, pika 2.b. Në dosjen e personelit nuk është e depozituar librezë e punës për bërë të mundur verifikimin e kushtit ligjor me një përvijë 5-vjecare, librezë e cila nuk u vu në dispozicion edhe pse u kërkua nga grupi i auditimit.

Caktimi i pagës së Drejtorit Auditit Brendshëm në nivelin A2, që i përket pozicionit të N/Drejtorit të Përgjithshëm të APD-së, sipas pikës 2 të Vendimit Këshillit Drejtues nr.3, datë 10.01.2018, është i pa argumentuar ligjërisht. Pa relacion shpjegues për përgjegjësitë shtesë dhe detyrat shtesë që do të ketë për këtë rritje page nga niveli B1 që i përket kategorisë së pagave të Drejtorëve të Drejtorive në kategorinë A2 që i përket pagës të N/Drejtorit të Përgjithshëm të APD-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Auditit Brendshëm janë të mirëpërcaktuara në Ligjin me nr. 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Kreu V “Të drejtat dhe Përgjegjësitë e Audituesve të Brendshëm”, neni 14 “Përgjegjësitë e Drejtuesve të Njësisë së Auditit Brendshëm”.

Vlera 190,910 lekë përbën dëm ekonomik për APD dhe buxhetin e shtetit dhe duhte të dëmshpërblehet nga E. K..

Kriteri: Ligji nr. 114/2015”Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe “Rregullore e Organizimit dhe Funksionimit të Këshillit Drejtues të APD-së”



Shkaku: Mos vlerësim sa dhe si duhet i përvojës si auditues dhe performancës së punës të drejtorit të auditit nga Këshilli Drejtues

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 190,910 lekë nga E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejtë të nivelit të pagës nga B1 në A2. **Vlera 190,910 lekë përbën dëm ekonomik për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij.**

Titulli i gjetjes: *Përfitim padrejtësisht pagese për orët jashtë orarit nga Drejtori i Drejtorisë së Auditit Brendshëm*”.

Situata: Është kryer pagesë në favor të E. K. me detyrë drejtor i drejtorisë së auditit të brendshëm për punë jashtë kohës normale të punës, për punë të pa kryer dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore për 64 orë në vlerën 80,454 lekë. Kjo vlerë është përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe në konflikt interesi me detyrat funksionale, si të përfituesit dhe të urdhëruesit, konkretisht: Për muajin prill 2018 është kryer pagesë për punë jashtë kohës normale të punës për 32 orë në datat 7, 14, 20 dhe 28/04/2018, në vlerën 32,000 lekë. Për muajin mars 2018 është kryer pagesë për punë jashtë kohës normale të punës për 32 orë në datat 3, 10, 17, 24/03/2018, në vlerën 40,227 lekë. Dokumenti financiar (Kërkesa për orë shtesë) e nënshkruar nga Drejtori Drejtorisë së Auditit të Brendshëm për ore shtesë dhe Drejtori i Përgjithshëm, është i pa miratuar nga titullari (Kryetari i Këshillit Drejtues), veprim në kundërshtim me:

- nenin 4/26 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe pikën 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” të Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

-nenin 22 “Veprimtaritë e Kontrollit”, pikat b “...ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin dhe kontrollin...”, pika c “...sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nënpunësit autorizues dhe të nënpunësit zbatues...”, pika ç “sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nënpunësit autorizues dhe të nënpunësit zbatue...” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

-pikën 17 “Kontrolle para faktit” të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në këtë rast nuk është marrë miratimi para faktit nga titullari (Kryetari i Këshillit Drejtues).... me qëllim që të garantohet ligjshmëria dhe rregullshmëria e vendimeve financiare. Ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, pra para se të ndodhë një transaksion i caktuar.

-VKM nr. 463, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit ne Institucionet Shtetërore” të ndryshuar, në të cilën citohet a) pika 5. “Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të Institucionit Qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nënpunësit apo punonjësit të administratës publike mund t’i kërkohet të kryejë orë shtesë....”

-pikën 2 të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011 “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 463, datë 16.06.2011” në të cilën citohet...”Në asnjë rast, punonjësi i administratës publike që kryen



veprimtari administrative nuk kompesohet financiarisht për kohën e punuar mbi kohën normale të punës, por kompesohet vetëm me orë/ditë pushimi”.

Përpos sa mësipër nga verifikimi në sistem nuk provohet që E. K. të ketë kryer orë jashtë orarit të punë.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, VKM nr.463, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit ne Institucionet Shtetërore” të ndryshuar, Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”

Shkaku: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka rekrutuar drejtorin e Auditit të Brendshëm, duke realizuar në këtë mënyrë konflikt interesi institucional ndërmjet Tij dhe Drejtorit të Auditit të Brendshëm, duke kompromentuar kryerjen e detyrave funksionale respektive, si dhe është kryer abuzim në mënyrë flagrante me detyrën.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës 80,454 lekë nga E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit Brendshëm. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejtë të pagesës për orët jashtë orarit për vitin 2018, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimi përkatës disiplinor. ***Vlera 80,454 lekë përbën dëm ekonomik për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij.***

Titulli i gjetjes: Pagesë në vlerën 1,533.91 euro ndaj kompanisë “E.A.G.”, tarifë për pjesëmarrje në trajnim, mos kthim paradhënie në vlerën 1,500 euro dhe mos mbyllje shpenzime të kryera bazuar nga dokumentacioni justifikues, pagesë në vlerën 54,690 lekë bileta avioni për pjesëmarrje në trajnimin me objekt “Monitorim, Vlerësim dhe Auditimi i Performancës së Projekteve të BE” në Berlin 14-15 qershor 2018, të E. K. me detyrë drejtor i drejtorisë së auditit të brendshëm.

Autorizimi dhe lejimi i këtij shpenzimi nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është kryer në tejkalim të kompetencës së Tij, pasi është Këshilli Drejtues që vendos për aktivitetin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe është shpenzim i pa miratuar dhe i pa pajustificuar për aktivitetin e APD-së, shpenzim e cili duhet të përballohej si kosto personale. Konkretisht: - Me kërkesën për transaksion datë 29.05.2018, nëpërmejt Bankës I., është kryer pagesa në vlerën 1,533.91 euro ndaj kompanisë “E.A.G.”, tarifë për pjesëmarrje në trajnim “Monitorim, Vlerësim dhe Auditimi i Performancës së Projekteve të BE” në Berlin 14-15 qershor 2018, bazuar në urdhrin nr. 2012, datë 08.05.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, me anën e të cilit është vendosur pjesëmarrja në këtë trajnim e E. K. me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm (në datat 13-17 qershor). Bashkëlidhur praktikës është e-maili i ardhur nga organizatorët e trajnimit në e-mailin personal të E. K. (jo në e-mailin zyrtar të APD-së dhe jo në e-mailin institucional të Drejtorit të Auditit të Brendshëm) dhe fatura për pagesën e tarifës së pjesëmarrjes. Nga auditimi u konstatua se nuk ka një ftesë zyrtare të ardhur në protokollin Autoritetit Portual Durrës, për pjesëmarrje në këtë trajnim. Pjesëmarrja në këtë aktivitet nuk i shërben aspak ngritjes profesionale të punonjësve të APD-së, e cila do të jetë një vlerë e shtuar për institucionin, por ngritje profesionale individuale, e cila duhet të përballohet me kosto personale.

Urdhri nr. 2012, datë 08.05.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, është jashtë kompetencës së tij, pasi është Këshilli Drejtues që vendos për aktivitetin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe shpenzim i pa miratuar dhe i pa pajustificuar për aktivitetin e APD-së, e cila duhet të përballohej si kosto personale.



Me mandat pagesën nr. 49, datë 05.06.2018, E. K., me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm ka marrë paradhënie në vlerën 1,500 euro për udhëtimin në Berlin, Gjermani bazuar në urdhrin e titullarit nr. 2012, datë 08.05.2018. Deri në datën 30.06.2018, nuk është kthyer paradhënia dhe nuk janë mbyllur shpenzimet e kryera bazuar në dokumentacionin justifikues. Moskthimi i paradhënies brenda 10 ditëve është në kundërshtim me urdhrin e brendshëm nr.1467, datë 11.05.2012 “Mbi trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe në kundërshtim me pikën 66 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

Me kërkesën nr. 483 prot., datë 22.05.2018 të E. K., me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm, është kërkuar blerje e një bilete avioni me specifikimet:

Nisje nga Tirana më datë 13.06.2018 jo më parë se ora 3 dhe jo më vonë se ora 5 e mëngjesit. Kthimi nga Berlini më datë 17.06.2018 jo më para se ora 8:00 dhe jo më vonë se 9:00.

Bazuar në kërkesën e Drejtorit të Auditit është hartuar ftesa për ofertë, kërkesa të cilat janë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kjo pasi oraret e kërkuara nga E. K. ulin konkurrencën pasi vetëm një kompani ajrore udhëton në oraret e specifikuara prej tij. Gjithashtu këto kritere të kërkuara nuk kanë asnjë arsyetim ligjor apo që i përmbahen axhendës së aktiviteteve.

Vlera **54,690** lekë për blerjen e kësaj bilete përbën dëm ekonomik.

Vlera 3,034 euro dhe 54,690 lekë përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga E. K..

KONFLIKTI I INTERESIT INSTITUCIONAL

-Marrëdhëniet e punës së E. K. me detyrë drejtor i drejtorisë së auditit të brendshëm janë të rregulluara me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 3, datë 10.01.2018, për emërimin në këtë detyrë.

-Kontratën individuale të punës nr. 175/1, datë 17.01.2018 të lidhur ndërmjet E. K. në cilësinë e punëmarrësit dhe A. Q. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e punëdhënësit. Kontrata e punësimit duhet të ishte lidhur ndërmjet Këshillit Drejtues dhe drejtorit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, ashtu sic është lidhur dhe për Drejtorinë e Përgjithshëm dhe Zv/Drejtorët.

-Lidhja e kontratës dhe shpërblimi për orët shtesë që në fakt nuk i ka kryer (referuar sistemit), **Si dhe**

-Shpenzimet e kryera **3,033.9 euro dhe 54,690 lekë për** “Monitorim, Vlerësim dhe Auditimi i Performancës së Projekteve të BE” në Berlin 14-15 Qershor 2018, të urdhëruar jashtë kompetencës së Drejtorit të Përgjithshëm, si dhe të përfituara padrejtësisht nga Drejtori i Auditit të Brendshëm.

Referuar sa mësipër

Është realizuar konflikt interesi institucional ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Auditit të Brendshëm, duke kompromentuar kryerjen e detyrave funksionale respektive, si dhe abuzim në mënyrë flagrante me detyrën.

Në opinionin e grupit të auditimit

Audituesit e Drejtorisë së Auditit të APD-së, në zbatim të dispozitave që ju jep ligji duhet; të ruajnë gjithmonë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre; të sillen gjithmonë me profesionalizëm, në përputhje me Ligjin dhe me rregullat e etikën e profesionit të tyre; të ushtrojnë gjithmonë standardet më të larta të integritetit dhe kujdesit; të jenë të mirë-informuar në lidhje me zhvillimet ligjore përkatëse; të përpiqen që të jenë dhe që të shihen si konsekuentë, të pavarur dhe të paanshëm; t'i shërbejnë dhe ta mbrojnë gjithnjë interesin e publikut, dhe jo të futen në konflikt interesi institucional dhe aq me keq të përfitojnë



padrejtësisht vlera monetare për punë të pakryer dhe shpenzime për kualifikime personale dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, si në rastin konkret, duke kompromentuar misionin e audituesit.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkon me përgjegjësi A.B. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, të cilët me veprimet dhe mosveprimet e tyre, kanë realizuar mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të APD-së dhe të Shtetit në vlerën **3,033.9 euro dhe 135,144 lekë (54,690 lekë + 80,454 lekë)**, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga E. K.

Përpos sa më sipër;

Drejtori i Auditit të Brendshëm në tejkalim të kompetencave dhe jashtë tagrit ligjor të funksionit të detyrës ka urdhëruar me email-in e datës 30.03.2018 P. C., me detyrë N/Drejtor i Përgjithshëm dhe në cilësinë e nëpunësit autorizues për diferenca në inventar, “*ndaj A. R. nuk mund të aplikohet asnjë masë me natyrë financiare apo proçeduese deri në përfundim të hetimit dhe gjykimit nga ana jonë*”. Ky urdhër është dhënë në cilësinë e sinjalizuesit, emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm me urdhrin nr.1839, datë 02.05.2018 dhe urdhrin nr. 1485, datë 11.04.2018. Pra Drejtori i Auditit ka dhënë urdhrin 11 ditë përpara se të kishte tagrin ligjor si sinjalizues. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me urdhrin e zhdëmtimit nr. 1004, datë 06.03.2018 “*Mbi masat e lëna nga rezultatet e inventarizimit të fundvitit*”, ku shprehimisht thuhet “*personat e sipërcituar, bazuar në nenin 91 të Udhëzimit nr.30, mund të kundërshtojnë rezultatet e inventarizimit. Nëse jo, duhet të proçedohet me pagesat e shumave përkatëse*”, si dhe në kundërshtim me nenin 4, pika 23 dhe nenit 17 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”.

Neni 4, Pika 23 “*Nëpunësi autorizues është nëpunës i nivelit të lartë*”, neni 17, pika 1 “*Çdo punonjës informon më shkrim eprorin e vet ose eprorin e nivelit më të lartë, njofton nëpunësin autorizues*”

Është fakt se që prej 30.03.2018 deri në 16.07.2018 nuk ka asnjë rezultat mbi përfundimin e këtij hetimi të ndërmarrë duke sjellë si pasojë mos daljen e përgjegjesisë për diferencat e rezultuara nga procesi i inventarizimit në vlerën 107,747.96 lekë.

Si konkluzion të argumenteve të përmendur më sipër, grupi i auditimit konstaton se veprimet e lartëpërmendura të E. K., janë shkelje e rëndë e legjislacionit në fuqi dhe përbëjnë një shprehje flagrante të mos zbatimit të Ligjit dhe të abuzimit me detyrën.

KLSH do të denoncojë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë mos përmbushjen e të rregullt të detyrës, me pasojë prekjën e interesave të ligjshme të Autoritetit Portual Durrës dhe të Shtetit.

Kriteri: Ligji nr.114/2015”Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimi nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Shkaku: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka rekrutuar drejtorin e Auditit të Brendshëm, duke realizuar në këtë mënyrë konflikt interesin institucional ndërmjet Tij dhe Drejtorit të Auditit të Brendshëm, duke kompromentuar kryerjen e detyrave funksionale respektive, si dhe abuzim në mënyrë flagrante me detyrën.

Autorizimi dhe lejimi i këtij shpenzimi nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv është është kryer në tejkalim të kompetencës së Tij, pasi është Këshilli Drejtues që vendos për aktivitetin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe është shpenzim i pa miratuar dhe i pa pajustificuar për aktivitetin e APD-së, shpenzim e cili duhet të përballohej si kosto personale.



Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,034 euro dhe 54,690** lekë nga E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit Brendshëm. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejt pagese për pjesmarrje në trajnimin me objekt “Monitorim, Vlerësim dhe Auditimi i Performancës së Projekteve të BE” në Berlin 14-15 qershor 2018, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimi përkatës disiplinor. **Vlera 3,034 euro dhe 54,690 lekë përbën dëm ekonomik për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij.**

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

“Pagesë për orët jashtë orarit të pa kryera dhe shpenzime udhëtime dhe dieta dhe trajnime të pajustificuara për Drejtorin e Drejtorisë së Auditit Brendshëm”, viti 2018.

Për muajin Prill 2018 është kryer pagesë për punë jashtë kohës normale të punës për 32 orë në datat 7, 14, 20 dhe 28/04/2018, në vlerën 32,000 lekë. Për muajin Mars 2018 është kryer pagesë për punë jashtë kohës normale të punës për 32 orë në datat 3, 10, 17, 24/03/2018, në vlerën **40,227** lekë. Nga auditimi konstatohet se kjo pagesë është përfituar padrejtësisht, në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe në konflikt interesi me detyrën funksionale si të përfituesit dhe të urdhëruesit. Konkretisht:

“Kërkesa për orë shtesë të Drejtorit të Auditit të Brendshëm, e datës 30.04.2018, total 32 orë paguar në listë pagesën e muajit Prill në vlerën **40,227 lekë.**

Kërkesa për orë shtesë të Drejtorit të Auditit të Brendshëm, e datës 29.03.2018, total 32 orë paguar në listë pagesën e muajit Mars në vlerën **40,227 lekë.**

Shuma totale 80,454 lekë

Janë në kundërshtim me :

1. Dokumenti financiar (Kërkesa për orë shtesë) e nënshkruar nga Drejtori Drejtorisë së Auditit të Brendshëm për ore shtese dhe Drejtori i Përgjithshëm, është i pa miratuar nga Titullari (Kryetari i Këshillit Drejtues), veprim në kundërshtim sipas përcaktimit në nenin 4/26 të Ligjit nr.10296, dt.08.07.2010 ‘Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin’ dhe pikës 36 “Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve” të Udhëzimit nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

2.Nenin 22” Veprimtaritë e Kontrollit”, pikat b...ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin dhe kontrollin....., pika c... sistemin e dy nënshkrimeve, i cili nuk lejon që angazhimi financiar të kryhet pa marrë nënshkrimet e nënpunësit autorizues dhe të nënpunësit zbatues... pika ç. sistemin e dy nënshkrimeve,i cili nuk lejon që pagesa të kryhet pa marrë nënshkrimet e nënpunësit autorizues dhe të nënpunësit zbatues..... të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

3.Në kundërshtim me VKM nr. 463, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit ne Institucionet Shtetërore” të ndryshuar, në të cilën citohet a)**pika 5. Me kërkesë të eprorit të drejtpërdrejtë dhe me miratimin e titullarit të Institucionit Qendror, nga i cili varet institucioni përkatës, nënpunësit apo punonjësit të administrates publike mund t’i kërkohet të kryejë orë shtesë**

...

4. Në kundërshtim me piken 17 “Kontrolle para faktit” të Ligjit nr. 10296, date 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”. Në këtë rast nuk është marrë miratimi para faktit nga Titullari (Kryetari i Këshillit Drejtues)....**me qëllim që të garantohet ligjshmëria**



dhe rregullshmëria e vendimeve financiare. Ato duhet të kryhen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha fazat e procesit para marrjes së vendimit për përdorimin e fondeve publike, pra para se të ndodhë një transaksion i caktuar.

5. Në kundërshtim me pikën 2 të Udhëzimit nr. 16, datë 20.07.2011 “Mbi zbatimin e VKM-së nr. 463 datë 16.06.2011” në të cilën citohet... *Në asnjë rast, punonjësi i administratës publike që kryen veprimtari administrative nuk kompensohet financiarisht për kohën e punuar mbi kohën normale të punës, por kompensohet vetëm me orë/ditë pushimi.*

Përpos sa mësipër nga verifikimi në sistem nuk provohet që E. K. të ketë kryer orë jashtë orarit të punës.

Si dhe

- Me kërkesën për transaksion datë 29.05.2018, I. Bank është kryer pagesa prej 1,533.91 euro ndaj E.A.G., tarifë për pjesëmarrje në trajnim “Monitorim, Vlerësim dhe Auditimi i Performancës së Projekteve të BE” në Berlin 14-15 qershor 2018, bazuar në urdhrin nr. 2012, datë 08.05.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, me anën e të cilit është vendosur pjesëmarrja në këtë trajnim e E. K. me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm (në datat 13-17 qershor). Bashkëlidhur praktikës është e-maili i ardhur nga organizatorët e trajnimit në e-mailin personal të E. K. (jo në e-mailin zyrtar të APD-së dhe jo në e-mailin institucional të Drejtorit të Auditit të Brendshëm) dhe fatura për pagesën e tarifës së pjesëmarrjes. Nga auditimi u konstatua se nuk ka një ftesë zyrtare të ardhur në protokollin Autoritetit Portual Durrës për pjesëmarrje në këtë trajnim. Pjesëmarrja në këtë aktivitet nuk i shërben aspak ngritjes profesionale të punonjësve të APD-së, e cila do të jetë një vlerë e shtuar për institucionin, por ngritje profesionale individuale, e cila duhet të përballohet me kosto personale.

Urdhri nr. 2012, datë 08.05.2018 i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, është jashtë kompetencës së tij, pasi është Këshilli Drejtues që vendos për aktivitetin e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe shpenzim i pa miratuar dhe i pa pajustificuar për aktivitetin e APD-së, e cila duhet të përballohej si kosto personale.

Me mandat pagesën nr.49, datë 05.06.2018, E. K., me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm ka marrë paradhënie në **vlerën 1,500 euro** për udhëtimin në Berlin, Gjermani bazuar në Urdhrin e Titullarit nr. 2012, datë 08.05.2018, deri në 30.06.2018 nuk është kthyer paradhënia dhe nuk janë mbyllur shpenzimet e kryera bazuar nga dokumentacioni justifikues. Moskthimi i paradhënies brenda 10 ditëve është në kundërshtim me Urdhrin e Brendshëm nr.1467, datë 11.05.2012, “Mbi trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit” dhe në kundërshtim me pikën 66 të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, “Paradhënia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga Nënpunësi Zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera tek Nënpunësi Zbatues ose i deleguari i tij. Kur paradhënia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjësit. Paradhënia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë”.

Çdo shpenzim i kryer në kuadër të këtij udhëtimi përbën dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga E. K. pasi ka shkelur dispozitat ligjore, i cili me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka realizuar mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Autoritetit Portual Durrës në vlerën 1,500 euro (ose çdo shpenzim që do të rimburohet për këtë shërbim jashtë vendit), vlerë e cila përbën dëm ekonomik për Autoritetin Portual dhe buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.



Me kërkesën nr.483 prot., datë 22.05.2018 të E. K., me detyrë Drejtor i Auditit të Brendshëm, është kërkuar blerje e një bilete avioni me specififikimet:

Nisje nga Tirana më datë 13.06.2018 jo më parë se ora 3 dhe jo më vonë se ora 5 e mëngjesit. Kthimi nga Berlini më datë 17.06.2018 jo më vonë se ora 8:00 dhe jo më vonë se 9:00.

Bazuar në kërkesën e Drejtorit të Auditit është hartuar ftesa për ofertë, kërkesa të cilat janë në kundërshtim me nenin 20 të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar, “*Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre*”, kjo pasi oraret e kërkuara nga E. K. ulin konkurrencën pasi vetëm një kompani ajrore udhëton në oraret e specifikuar prej tij. Gjithashtu këto kritere të kërkuara nuk kanë asnjë arsytim ligjor apo që i përmbahen axhendës së aktiviteteve.

Gjithashtu shpenzimi i kryer për blerjen e kësaj bilete në vlerën **54,690** lekë përbën dëm ekonomik.

Vlera 3,034 euro dhe 54,690 lekë përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga E. K.

KONFLIKTI INTERESIT

-Marrëdhëniet e punës së E. K. me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm janë të rregulluara me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.3, date 10.01.2018, për emërimin në këtë detyrë.

-Kontratën individuale të punës nr. 175/1, date 17.01.2018 të lidhur ndërmjet E. K. në cilësinë e punëmarrësit dhe A. Q. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e punëdhënësit. Kontrata e punësimit duhet të ishte lidhur ndërmjet Këshillit Drejtues dhe Drejtorit të Auditit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, ashtu sic është lidhur dhe për Drejtorin e Përgjithshëm dhe Zv/Drejtorët.

-Lidhja e kontratës dhe shpërblimi për orët shtesë që në fakt nuk i ka kryer (referuar sistemit), ***Si dhe***

-Shpenzimet e kryera ***3,033.9 euro dhe 54,690 lekë për*** “Monitorim, Vlerësim dhe Auditimi i Performancës së Projekteve të BE” në Berlin 14-15 Qershor 2018, të urdhëruar jashtë kompetencës së Drejtorit të Përgjithshëm si dhe të përfituara padrejtësisht nga Drejtori i Auditit të Brendshëm.

Tregon konflikt interesin institucional ndërmjet Drejtorit të Përgjithshëm dhe Drejtorit të Auditit të Brendshëm, duke kompromentuar kryerjen e detyrës funksionale, si dhe abuzim me detyrën.

Në opinionin e grupit të auditimit

Auditët e Drejtorisë së Auditit të APD-së, në zbatim të dispozitave që ju jep ligji duhet; të ruajnë gjithmonë nderin dhe dinjitetin e profesionit të tyre; të sillen gjithmonë me profesionalizëm, në përputhje me Ligjin dhe me rregullat e etikën e profesionit të tyre; të ushtrojnë gjithmonë standardet më të larta të integritetit dhe kujdesit; të jenë të mirë-informuar në lidhje me zhvillimet ligjore përkatëse; të përpiqen që të jenë dhe që të shihen si konsekuente, të pavarur dhe të paanshëm; t’i shërbejnë dhe do ta mbrojnë gjithnjë interesin e publikut, dhe jo të futen në konflikt interesi institucional dhe aq me keq të përfitojnë padrejtësisht vlera monetare për punë të pakryer dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, si në rastin konkret, duke kompromentuar misionin e audituesit.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkon me përgjegjësi A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe E. K. me Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, kanë realizuar mospërmbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e



KONTROLLI I LARTË I SHËTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

ligjshme të APD-së dhe të Shtetit në vlerën **3,033.9 euro dhe 135,144 lekë (54,690 lekë + 80,454 lekë)**, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga E.K.

Përpos sa më sipër;

Drejtori i Auditit të Brendshëm në tejkalim të kompetencave dhe jashtë tagrit ligjor të funksionit të detyrës ka urdhëruar me email-in e datës 30.03.2018 P. C., me detyrë n/Drejtor i Përgjithshëm dhe në cilësinë e nëpunësit autorizues, “*ndaj A. R. nuk mund të aplikohet asnjë masë me natyrë financiare apo proçeduese deri në përfundim të hetimit dhe gjykimin nga ana jonë*”. Ky urdhër është dhënë në cilësinë e sinjalizuesit, emëruar nga Drejtori i Përgjithshëm me urdhrin nr.1839, datë 02.05.2018 dhe urdhrin nr.1485, datë 11.04.2018, pra Drejtori i Auditit ka dhënë urdhrin 11 ditë përpara se të kishte tagrin ligjor si sinjalizues. Veprimi i mësipërm është në kundërshtim me urdhrin e zhdëmtimit nr. 1004, datë 06.03.2018 “Mbi masat e lëna nga rezultatet e inventarizimit të fundvitit”, ku shprehimisht thuhet “*personat e sipërcituar, bazuar në nenin 91 të Udhëzimit nr. 30, mund të kundërshtojnë rezultatet e inventarizimit. Nëse jo, duhet të proçedohet me pagesat e shumave përkatëse*”, si dhe në kundërshtim me nenin 4, pika 23 dhe nenin 17 pika 1 dhe 2 të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Neni 4, Pika 23 “nëpunësi autorizues është nëpunës i nivelit të lartë”, Neni 17, pika 1 “Cdo punonjes informon më shkrim eprorin e vet ose eprorin e nivelit më të lartë, njofton nëpunësin autorizues”

Është fakt se që prej 30.03.2018 deri në 16.07.2018 nuk ka asnjë rezultat mbi përfundimin e këtij hetimi të ndërmarrë duke sjellë si pasojë mos daljen e përgjegjesisë për diferencat e rezultuara nga procesi i inventarizimit në vlerën 107,747.96 lekë.

Si konkluzion të argumenteve të përmendur si më sipër, grupi i auditimit konstaton se veprimet e lartëpërmendura të E. K., janë shkelje e rëndë e legjislacionit në fuqi dhe përbëjnë një shprehje flagrante të zbatimit të gabuar të Ligjit dhe të abuzimit me detyrën.

KLSH do të denoncojë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë mos përmbushjen e të rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave të ligjshme të Autoritetit Portual Durrës dhe të Shtetit.

Theksojmë se:

Punësimi/Emërimi i Drejtorit të Auditit Brendshëm sipas pikës 2 të Vendimit Këshillit Drejtues nr. 3 datë 10.01.2018 , është në kundërshtim me nenin 11 te Ligjit nr. 114/2015”Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik” dhe në kundërshtim me nenin 16 “Kompetencat e Këshillit Drejtues”, pika 14 , “Rregullore e Funksionimit të Këshillit Drejtues të APD-së” .

Nuk provohet përvija 5-vjecare si auditues, neni 11, pika 2.b. Në dosjen e personelit nuk është e depozituar librezja e punës për bërë të mundur verifikimin e kushtit ligjor me një përvijë 5-vjecare, librezë e cila nuk u vu në dispozicion edhe pse u kërkua nga grupi i auditimit.

Ndryshimi i Pagës nga B1 në A2

POZICIONI PUNES	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QERSHOR	TOTALI
A2	80,455	177,000	177,000	177,000	177,000	177,000	965,455
B1 (me vite pune)	67,727	149,000	149,000	149,000	149,000	149,000	812,727
B1 (pa vite pune)	64,545	142,000	142,000	142,000	142,000	142,000	774,545

Diferenca = 190.910 lekë

Sipas Kontratës Individuale të Punës E. K. nuk ka dorëzuar Librezë Pune.

Shënim *

149.000 është paga se bashku me vite pune (25 vite)

142.000 është paga pa vite pune



Në muajin Janar janë 10 ditë pune

Vlera 190.910 lekë përbën Dëm Ekonomik, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet nga E. K. Përpos sa mësipër.

Me e-mail-in e datës 11.06.2018 ora 12:05 PM, të Përgjegjësës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, M. D., i është kërkuar E.K. si më poshtë:

“Bazuar në nenin 3 të Kontratës individuale të punës ju lutem të bëni dorëzimet e listës së dokumentacionit të bashkangjitur për të plotësuar dosjen individuale duke qenë se jemi në auditim nga KLSH një mungesë e tillë është konstatuar dhe nga ata dhe na është lënë porosi. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar e tij. Ju faleminderit”.

Me e-mail-in e datës 11.06.2018 ora 12:08 PM, E. K., drejtuar Përgjegjësës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, M. D., është dërguar përgjigja si më poshtë:

“Kaq dokumente bëjnë 10,000 lekë. Na jepni një paradhënie ju dhe ata të KLSH. Certifikatën nxirreni online nga sistemi se keni akses, bëni një shkresë prokurorisë, gjykatës dhe zyrës së gjendjes gjyqësore se më kurseni lekët. Të tjerat jua jap pa kundërshpërblim. Librezën ma shihni se me shumë gjasa jua kam sjellë”.

Me e-mail-in e datës 11.06.2018 ora 1:32 PM, të Përgjegjësës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, M. D., i është kërkuar E. K. si më poshtë:

“Drejtor ju lutem se duhet të plotësoj dosjen... Dokumentacioni i dorëzuar është i mangët, ka fotokopje të panoterizuar, jo të vlefshme, librezën e punës nuk e ke dorëzuar”.

-Në kundërshtim me nenin 14 “Përgjegjesit”, nuk janë shtuar detyra dhe përgjegjësi të cilat do të bënit te mundur argumentimin ligjor për ndryshimin e pagës nga B1 në A2. Kalimi i pagës nga B1 në A2, pagë e barazuar me Zv/drejtorët, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 24, datë 15.03.2006 ndryshuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 40, datë 02.12.2016.

Në opinionin e grupit të auditimit

Caktimi i pagës së Drejtorit Auditit Brendshëm në nivelin A2, në pozicionit të n/Drejtorit të Përgjithshëm të APD-së, sipas pikës 2 të Vendimit Këshillit Drejtues nr. 3, datë 10.01.2018, është i pa argumentuar ligjërisht. Pa relacion shpjegues për përgjegjësitë shtesë dhe detyrat shtesë që do të ketë për këtë rritje page nga niveli B1 në kategorinë e Drejtoreve të Drejtorive në kategorinë A2 të N/Drejtorit të Përgjithshëm të APD-së. Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorit të Auditit Brendshëm janë të mirëpërcaktuara në Ligjin me nr. 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Kreu V “Të drejtat dhe Përgjegjësitë e Audituesve të Brendshëm”, neni 14 “Përgjegjësitë e Drejtuesve të Njesisë së Auditit Brendshëm”.

Shkelja e dispozitave ligjore për emërimin e E. K. në Detyrën e Drejtorit të Auditit të Brendshëm pa verifikuar afatin 5-vjeçar, pa konkurs, pa lidhur kontratën e punësimit ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Drejtues (Referuar Vendimit Këshillit Drejtues nr. 3, datë 10.01.2018) G. Ll., I. C., G. K., E. M..

Në përgjigje të observacionit me nr.3328/1 prot, datë 01.08.2018 (protokol APD) në lidhje me procesverbalin nr. 6, datë 27.07.2018, si dhe me nr. 3476/1 prot, datë 10.09.2018 (protokol APD), protokolluar në KLSH me nr.579/4 datë 12.09.2018 për projekt raportin e auditimit të bërë nga E. K. me detyrë Detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, ju sqarojmë se nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja, të argumentuara ligjërisht dhe të shoqëruara me dokumentacion vërtetues, për pasojë nuk janë marrë në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit. Me argumentet se më poshtë:



-Pretendimi se dokumentacioni për përvojën e punës është fotokopje i dokumentacionit justifikues e shpjegues dërguar me shkresën nr. 3426 prot., datë 03.08.2018, nuk qëndron, pasi;

- dokumentacioni është i fotokopjuar dhe nuk është i noterizuar në kundërshtim me Ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar neni 39, pika f, për pasoj janë dokumente të pavlefshëm për tu marr në konsideratë.

-Edhe pse është kërkuar disa herë gjatë auditimit, në observacionet në nivel procesverbali dhe në fazën e projektraportit nuk është dorëzuar librezë e punës, dokumenti që provon më së miri përvojën 5-vjecare si audites.

Konkretisht:

Me e-mail-in e datës 11.06.2018 ora 12:05 PM, të Përgjegjësës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, M. D., i është kërkuar E. K. si më poshtë:

“Bazuar në nenin 3 të Kontratës individuale të punës ju lutem të bëni dorëzimet e listës së dokumentacionit të bashkangjitur për të plotësuar dosjen individuale duke qenë se jemi në auditim nga KLSH një mungesë e tillë është konstatuar dhe nga ata dhe na është lënë porosi. Dokumentacioni duhet të jetë origjinal ose fotokopje e noterizuar e tij. Ju faleminderit”.

Me e-mail-in e datës 11.06.2018 ora 12:08 PM, të E. K., drejtuar Përgjegjësës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, M. D., është dërguar përgjigja si më poshtë:

“Kaq dokumente bëjnë 10,000 lekë. Na jepni një paradhënie ju dhe ata të KLSH. Certifikatën nxirreni online nga sistemi se keni akses, bëni një shkresë prokurorisë, gjykatës dhe zyrës së gjendjes gjyqësore se më kurseni lekët. Të tjerat jua jap pa kundërshtim. Librezën ma shihni se me shumë gjasa jua kam sjellë”.

Me e-mail-in e datës 11.06.2018 ora 1:32 PM, të Përgjegjësës së Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, M. D., i është kërkuar E. K. si më poshtë:

“Drejtor ju lutem se duhet të plotësoj dosjen... Dokumentacioni i dorëzuar është i mangët, ka fotokopje të panoterizuar, jo të vlefshme, librezën e punës nuk e ke dorëzuar”.

-Në opinionin e grupit të auditimit audituesit duhet të kërkojnë dhe auditojnë zbatimin e dispozitave ligjore dhe jo të ti shkelin me arrogancë ato, duke kërkuar dhe lekë për vënien në dispozicion nga zyrat që ai auditon dhe aq më tepër nga KLSH.

-Pretendimi se drejtuesi i auditit është në nivel shumë të lartë drejtues, duke marr në konsideratë organogramën organizative dhe nisur nga kërkesat në rritje të përgjegjësive, llogarisë, cilësive profesionale dhe individuale, shkallës së kualifikimeve dhe arsimimit, diskrecionit përzgjedhës të këshillit drejtues, kjo nuk qëndron me argumentet si më poshtë:

-Në organogramën organizative, këshilli drejtues nuk është shprehur në asnjë rast për nivel shumë të lartë, të lart të mesëm dhe të ulët të personelit.

-Cilësitë profesionale dhe individuale në nivel shumë të lartë, nuk i vlerëson dot për veten e vet drejtuesi auditues, por duhet të shprehen organet drejtues dhe punonjësit që janë audituar. Në asnjë dokument, pse jo dhe verbalisht nga grupi i auditimit nuk është konstatuar një gjë e tillë. Por përkundrazi, veprimet e mësipërme flasin për të kundërtën. Këshilli Drejtues nuk ka zbatuar dispozita ligjore për të filtruar kandidatura me audites profesionale dhe integritet (dhe jo persona të rekrutuar nga subjekti me paradhanije shërbimesh me gjoja humbje bagazhesh neper aviona, trajnime dhe ore jashte orarit te punes).

-Pretendimi se kontratën e punës unë e kam lidhur me z. A. Q. dhe jo z. A. B.

Grupi i auditimit nuk arrin të kuptojë se si një audites me kaq cilësi profesionale dhe individuale të vet deklaruar (në nivel shumë të lartë), keq interpreton atë që në Projekt Raportin e auditimit është shprehur në mënyrë eksplicite se “Marrëdhëniet e punës së E. K. me Detyrë



Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm janë të rregulluara me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.3, date 10.01.2018, për emërimin në këtë detyrë.

-Kontratën individuale të punës nr. 175/1, date 17.01.2018 të lidhur ndërmjet E. K. në cilësinë e punëmarrësit dhe A. Q. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e punëdhënësit” Fq 40 dhe 41.

-Pretendimi se në vendimin nr.3, datë 10.01.2018, pika 4 thuhet që, efektet e këtij Vendimi fillojnë menjëherë, por në fakt me urdhërin e brendshëm nr.175, datë 17.01.2018, të Drejtorit Ekzekutiv A. Q., kontrata e punës dhe marrëdhënjet financiare kanë filluar në datën 18 Janar 2018, pra 10 ditë me vonesë dhe pse unë efektivisht kam qenë në punë. Ky fakt nuk është konstatuar nga ana juaj dhe as janë propozuar korrigjimet përkatëse, nuk është aspak korrekt, dhe për më tepër nuk është profesional dhe është hartaur pa përgjegjësi. Në dijenin tuaj mardhënjët e punës rregullohen nga Ligji nr. 7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontrata kolektive të punës nr. 3197 prot., datë 05.04.2016, si dhe kontrata individuale të punës.

Pa nënshkruar kontratën e punës drejtori i auditit me Cilësitë profesionale dhe individuale të vetdeklaruar “në nivel shumë të lartë”, si ka mundësi që ka filluar punë, dhe aq më tepër nuk është paguar:

Për më tepër:

-me observacion nuk ka paraqitur asnjë dokument që e provon paraqitjen në punë si: Listë prezencën, procesverbalin e marrjes në dorëzim të detyrës, ose ndonjë dokument tjetër që mund të vërtetojë pjesëmarrjen e tuaj në punë, por pretendohet efekt financiar negativ ndaj Jush nga ana e A.P.D.-së (në fakt e kundërta është e vertet që Ju, keni përfituar padrejtesisht vlera monetare nga APD, në shkelje flagrante me detyren funksionale).

-Pretendimi se njësisia është përgjegjëse ligjrisht për veprimet e saj vetëm ndaj I.L.D.K.P.K.I. – së dhe as unë dhe as Znj. F. M. nuk jemi kontaktuar asnjëherë për tju dhënë informacion audituesve të K.L.S.H. – së në lidhje me këtë proces administrativ. Procesi është zhvilluar transparent, i hapur dhe plotësisht ligjor, mbështetur në dispozitat e Kodit të Procedurës Administrative dhe në harmoni me cdo ligj tjetër. Në datë 19 Korrik 2017, ky proces është përmbyllur dhe punonjësja A. R. ka rezultuar pjesërisht përgjegjëse në lidhje me aktin e zhdëmtimit Nr.1004, datë 06.03.2018 “Mbi masat e lëna nga rezultati i inventarizimit të fundvitit”, si dhe nga ana tjetër A. R. ka shprehur dakortësinë e saj me këtë vendim. **Meqë materiali konsiderohet konfidencial, ne mund tju vemë në dispozicion vetëm në bazë të një kërkesë ligjore të mirë argumentuar dhe bindese, jo vetëm nuk që qëndron, nuk është aspak korrekt, është a profesional dhe në tejkallim të kompetencave si drejtor i auditit të brendshëm me argumentet si më poshtë vijojnë.**

Së pari: Grupi i auditimit nuk arrin të kuptojë se si një audites me kaq cilësi profesionale dhe individuale të vet deklarara “në nivel shumë të lartë”, si ka kurajo burokratike ta konsiderojë rezultatin e inventarizimit konfidencial dhe të klauzot vënien në dispozicion **vetëm në bazë të një kërkesë ligjore të mirë argumentuar dhe bindese**, në kundërshtim me Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 26 “Aksesi mbi dokumentet zyrtare”, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “**KLSH ka të drejtë për të pasur aksesë në të gjitha dokumentet zyrtare, shkresore apo elektronike, në bazat elektronike të të dhënave si dhe cdo informacion apo dokumentacion tjetër të subjekteve të audituara të parashikuara në këtë ligj, që mund të bëjnë sekretë shtetëror apo konfidencial, dhe që konsiderohen të nevojshme në funksion të ushtrimit të kompetencave dhe detyrave të tij ligjore**”.

Për dijenin Tuaj, grupi i auditimit ka ushtruar auditim në zbatim të programit të auditimit të miratuar nga Kryetrai i KLSH me nr. 579/1 prot, datë 18.05.2018, i ndryshuar, ku janë



përcaktuar qartë drejtimit e auditimit, ku specifikisht në pikën 6 është pëfcaktuar se “.....Invetarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemit të rezultave të pasqyrave vjetore”.

Së dyti: Auditimi i APD nga KLSH është pranuar dhe mirëpritur nga organet drejtuese si: Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, si dhe i gjithë stafi, jo vetëm duke vënë në dispozicion dokumentacionin e kërkuar, por edhe duke bashkëpunuar në mënyrë shumë korekte me grupin e auditimit.

Së treti. Ju nuk përcaktoni statusin Tuaj juridik dhe referencën ligjore që rrezultatin e inventarizimit e konsideroni konfidencial dhe vënijen në dispozicion mund ta bëni vetëm në bazë të një kërkesë ligjore të mirë argumentuar dhe bindese. Në dijenin e grupit të auditimit kjo nuk është kërkuar nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithëm Ekzekutiv.

Mos ndoshta kompetencat Tuaja zoti drejtor i auditit, i tejkalojnë ato të Këshilli Drejtues, Drejtorit të Përgjithëm Ekzekutiv dhe të Aksionarit, si dhe janë mbi Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, Ligjin nr.10296, dt.08.07.2010 ‘Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjinnr. 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Ligjin nr. 9130 datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 596, datë 10.09.2004, Udhëzimin nr. 30, dt. 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, si dhe rregulloren e organizmit dhe të funksionimit të APD.

-Pretendimi se as unë dhe as Znj. F. M. nuk jemi kontaktuar asnjëherë për tju dhënë informacion audituesve të K.L.SH, në lidhje me këtë procedurë administrative, ju bëjmë me dije se grupi i auditimit është ballafaqura dhe ka kërkuar sqarime me drejtorin ekonomik, juridik si dhe me të gjitha personelin që kanë përgjegjisi sipas hierrakisë në mbështetje të rregullores dhe përgjegjësive respektive të tyre.

Për me tepër, në dijeninë Tuaj, procesverbali është portokolluar në APD dhe referuar kodit të procedurës administrative, janë dokumente zyrtare dhe kanë funksion: Njoftues, ballafaques, provues pse jo dhe akuzues.

-Pretendimi për mos kthimin e paradhënies është shumë qesharak kur shpreheni se “....unë kam marrë një paradhënie, por sic kam vënë në dijeni, në udhëtim në kthim një pjesë e bagazheve të mia është dërguar gabimisht në një shtet tjetër dhe po presë kthimin e tyre, pasi brenda këtij bagazhi janë dhe dokumentet justifikues për këto shpenzime”

-Ju mqs pretendoni se keni kaq kaulitet profesional dhe individual të vet deklaruar “nivel kaq të lart profesional dhe individual”, presupozohet se e njihni shume mire legjislacionin, dhe referuar këtij legjislacioni për ta provuar këtë duhet të këshit paraqitur në institucionin Tuaj:

-Kërkesën (deklarimin) që keni bërë tek kompania ajrore për mos mbritje e bagazheve në referim të Ligjit nr. 10040, date 22.12.2008 “Kodi ajror në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, neni 128, pika f.

-Në rast të mos mbritjes, kërkimin për dëmshpreblim nga kompania, në referim të Ligjit nr. 10040, date 22.12.2008 “Kodi ajror në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar”, neni 128, pika f.

-Z drejtor!

Me “nivel kaq të lart profesional dhe individual”, kaluan 4 muaj që keni marr paradhënijen (05.06.2018 deri më shtator 2018), akoma bagazhet tuaja kanë humbur drejtimin dhe po bredhin neper shtete të tjera, pra bagazhet tuaja po bredhin botën dhe Ju me cilësitë që keni nuk po zbatoni dot procedurat ligjore për kthimin ose dëmshpërblimin e tyre.

-Pretendimi për mos patje konflikt interesi.

Grupi i auditimit është shprehur për konflikt interesi institucional, ndërmejt drejtor të përgjithshëm dhe drejtorit të auditit, rasti kur drejtori i auditit me detyrimin ligjor për të



audituar subjektin (drejtorin e përgjithshëm dhe stafin e tij), korruptohet (bihet) nga subjekti auditues me vlera monetare te perfituara padrejtesisht Si: Ore jashte orarit, paradhenije te pakthyera per shpenzime udhetimi, trajnime personale etj, per kete kini te drejt, grupi i auditimit duhet te ishte shprehur **edhe se**

Drejtori i Auditit jo vetëm ka shkelur dispozitat ligjore, por ka vertetuar moszbatimin ne menyre flagrante te ligjit dhe me veprimet dhe mosveprimet e tij, ka realizuar mos përmbushje të rregullt të detyrës, duke dëmtuar interesat e ligjshme të Autoritetit Portual Durrës dhe te Shtetit.

Për sa trajtuar mësipër, obserbacioni jo vetëm nuk është i argumentuar nga ana ligjore dhe dokumentare, por nuk është aspak korrekt, dhe për më tepër nuk është profesional dhe është hartuar pa përgjegjësi dhe pa përgjegjshmëri.

Siç provohet dhe nga sa përshkruam më lartë, grupi i auditimit konstaton se veprimet e lartpërmendura të E. K., janë shkelje tjetër e rëndë e legjislacionit në fuqi dhe përbëjnë një shprehje flagrante të zbatimit të gabuar të Ligjit dhe të abuzimit me detyrën.

Në lidhje me observacionin me nr. 3344/1 prot, datë 31.07.2018 të dërguar nga A. K. në cilësinë e ish-Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Promocionit, për procesverbalin nr. 23 me nr. 3344 prot, datë 27.07.2018, me observacionin me nr. 3344/2 prot, datë 31.07.2018 të dërguar nga A. M. dhe D. P., për procesverbalin nr. 23 me nr. 3344 prot, datë 27.07.2018, me observacionin me nr. 3344/3 prot, datë 02.08.2018 të dërguar nga K. M. me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Promocionit, për procesverbalin nr. 23 me nr. 3344 prot, datë 27.07.2018, me observacionin me nr. 3344/4 prot, datë 02.08.2018 të dërguar nga A. B. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe nga A. Q. në cilësinë e ish-Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, për procesverbalin nr. 23 me nr. 3344 prot, datë 27.07.2018, si dhe me observacionin dërguar me shkresën përcjellëse nr. 3476/1 datë 10.09.2018 mbi projektraportin e auditimit, protokolluar në KLSH me nr. 579/4, datë 12.09.2018, sqarojmë se:

-Në lidhje me mosmarrjen e miratimit per strukturen e pagave nga Ministri, si dhe per dhenien e shperblimeve vjetore, nga APD është observuar se APD është institucion i krijuar me ligj të veçantë dhe se nuk i nënshtrohet ligjit Nr.10405, datë 24.3.2011, ne kuptimin e nenit 6, pika 1/a "Kompetencat e organeve kolegjiale". Sqarojmë se edhe pse i APD eshte organizuar dhe funksionon me ligj të veçantë ne statusin juridik te tij, kjo nuk e perjashton nga zbatimi i akteve ligjore dhe nenligjore specifike si ligji Nr.10405, datë 24.3.2011, etj. Për pasojë observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me observacionin mbi dy punonjësit A. M. dhe D. P. të cilët nuk kanë marrë masë disiplinore, por kanë marrë shpërblim, obsevacioni merret në konsideratë dhe do të reflektohet në Raportin Final të Auditimit.

-Në lidhje me një pjesë të punonjësve të cilët janë konsideruar nga grupi i auditimit si punësim mbi strukturë, janë paraqitur fakte të reja nga APD dhe merren në konsideratë dhe do të reflektohet në Raportin Final të Auditimit.

-Në lidhje me observacionin mbi dosjet me dokumenta fotokopje, sqarojmë se dosjet e personelit të konstatuara me materiale fotokopje i perkasin stafit aktual. Grupi i auditimit në mënyrë të arsyeshme nuk ka përmendur dokumentat fotokopje të personave të larguar. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

-Në lidhje me rekrutimin ne pune te punonjesit A. K., observacioni merret ne konsiderate dhe eshte reflektuar Raportin Perfundimtar.



-Ne lidhje me pagesat e orëve shtesë, sqarojmë se nuk ka asnjë dokument që të dëshmojë se këto orë nuk janë kompesuar me ditë pushimi për shkak të pamundësisë. Për këtë arsye observacioni nuk merret në konsideratë.

5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit sponsorizime, etj).

Titulli i gjetjes: Pagesa për vendime gjyqësore

Situata: Për periudhën objekt auditimi referuar llogarisë se kontabilitetit 463001 “Kreditor konflikt gjyqësor”, nga APD janë likjuar 19 raste në vlerën 132,064 mijë likujdime vullnetare për vendimet gjyqësore në shkallën e parë dhe të dytë, edhe pse për dy raste është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga APD, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Tiranë dhe Avokatura e Shtetit, para likujdimit duhet të kishte kërkuar në objektin e rekursit dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga zyra e përbarimit, duke kundërshtuar në këtë mënyrë veprimet përbarimore.

Theksojmë se në Gjykatën e Lartë janë gjithsej 58 çështje që janë në shqyrtim. Nga të cilat:

A. 37 çështje pune që priten të merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, nga të cilat:

- në 14 raste vendimi ka qenë në favor të APD-së
- në 21 raste vendimi nuk ka qenë në favor të APD-së
- 2 raste është pranuar padia pjesërisht por dëmshpërblimet nuk janë dhënë maksimale

B. 8 çështje që priten të merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë me palë të paditur APD

- në 3 raste vendimi ka qenë në favor të APD-së në shkallën e parë të gjykimit
- në 5 raste vendimi nuk ka qenë në favor të APD-së

C. 13 çështje që priten të merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë me palë paditëse APD

- 4 raste vendimi në favor të APD-së
- 7 raste vendimi nuk është në favor të APD-së + 2 raste të humbura pjesërisht nga APD.

Kriteri: Ligji nr.8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar.

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Rëndimi i mundshëm i buxhetit të APD

Shkaku: Mos ndjekja e procedurave ligjore nga APD, MTI dhe avokatura e shtetit

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi:

Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa për ndjekur me përgjegjësi të gjitha procedurat gjyqësore dhe në veçanti për ato çështje që janë me rekurs në Gjykatën e Lartë me përfaqësim tekniko-juridik me profesionist me eksperiencë, për minimizuar dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i vendimeve në disfavor të APD, si dhe në të ardhmen për çështje e ankimuar të zbatohet me rigozitet Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar.

Titulli i gjetjes: Përdorimi i automjeteve

Situata: Nga verifikimi i kryer mbi përdoruesit e automjeteve dhe detyrave të tyre në strukturën e APD rezultoi se Magazinieri i FSPD M. K. nën drejtimin e Drejtorit të FSPD kryen edhe detyrën e Shoferit për automjetin AA897RK, duke çënuar kryerjen me cilësi të detyrës funksionale për të cilën ai është emëruar në APD, në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe



Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Cënimi i kryerjes së detyrave funksionale

Shkaku: Ushtrimi i dy funksioneve brenda drejtorisë

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrin masa që punonjësit e APD të ushtronjë detyrën funksionale konform strukturës organizative të miratuar nga Këshilli Drejtues, si dhe përgjegjësi specifike të vendit të punës referuar kontratës individuale.

Titulli i gjetjes: Pjesëmarrje në panairë

Situata: Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë u konstatuan pagesa të kryera për pjesëmarrje në panairë të ndryshme. Bashkëlidhur praktikës mungonin kërkesat e kryera nga sektori i promovimit, si dhe nuk është kryer asnjë analizë kosto përfitim nga pjesëmarrja në këto aktivitete në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar

Ndikimi/efekti: Kryerja e shpenzimeve pa u analizuar përfitimi institucional

Shkaku: Mungesë analize kosto-përfitim

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: APD dhe Sektori i Promocionit dhe Trajnimeve të marrin masa që përpara marrjes së vendimeve dhe kryerjes së shpenzimeve për pjesëmarrje në aktiviteteve promovimi, si për shembull panairë, të analizojnë përfitimet potenciale nga pjesëmarrja në këto aktivitete duke i krahasuar me kostot përkatëse.

Titulli i gjetjes: Kthim paradhënie me vonesë

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me arkë u konstatuan 15 raste të kthimit të paradhënies së marrë për të mbuluar shpenzimet e kryera për udhëtime dieta me vonesë, vonesë e cila shkon nga 1 muaj deri në 1 vit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, “*Paradhënia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga nëpunësi zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera te nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij. Kur paradhënia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjësit. Paradhënia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë*”.

Kriteri: Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, “*Paradhënia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga nëpunësi zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera te nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij. Kur paradhënia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjësit. Paradhënia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë*”



Ndikimi/efekti: Paradhënie të pa mbyllura për një kohë të gjatë

Shkaku: Mos kthimi i paradhënieve brenda afateve të përcaktuara

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: APD dhe drejtoria Ekonomike të marrin masa që në të ardhmen të gjithë punonjësit e APD që dërgohen me punë jashtë vendit të kthejnë paradhëniet e marra për mbulimin e shpenzimeve brenda afateve të përcaktuara.

Titulli i gjetjes: Shpenzime të pa justifikuara

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera me arkë u konstatua se:

-Me mandat arkëtimin nr. 31, datë 21.06.2018, M. D. ka kthyer diferencën nga paradhënia e marrë për udhëtimin në Hamburg. Bashkëlidhur praktikës u konstatua se në shpenzimet e këtij udhëtimi është faturuar edhe pagesa e qëndrimit në hotel në Mynih prej 135 euro. Pagesë e kryer në mënyrë të paligjshme, pasi ky shpenzim duhet të mbulohej nga kompania e fluturimit, si pasojë e vonesave në oraret e fluturimeve.

- Me mandat arkëtimin nr. 32, datë 21.06.2018, I. Gj. ka kthyer diferencën nga paradhënia e marrë për udhëtimin në Hamburg, bashkëlidhur praktikës u konstatua se në shpenzimet e këtij udhëtimi është faturuar edhe pagesa e qëndrimit në hotel në Mynih prej 79 euro dhe shpenzimet për taksinë në vlerën 137.9 euro. Pagesë e kryer në mënyrë të paligjshme, pasi ky shpenzim duhet të mbulohej nga kompania e fluturimit.

Në gjykimin profesional, grupi i auditimit, nuk ka kërkuar zhdëmtimin e vlerave të mësipërme pasi ka marrë në konsideratë materialitetin e këtyre vlerave në raport me totalin e shpenzimeve operative.

Kriteri: Dokumentacioni justifikues

Ndikimi/efekti: Shpenzime me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Përfshirja e shpenzimeve që nuk duhet të rimbursohen nga APD

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa në të ardhmen, që shpenzimet për udhëtim dhe dieta për jashtë shtetit të mirë programohen nga sektori përkatës dhe të ndiqet me rigorozitet zbatimi i tyre.

Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa në të ardhmen, që pasojat financiare që vijnë nga kompanitë e fluturimeve, të bëhen prezente në kohën e duhur, duke kërkuar zbatimin Ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi ajror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe duke kërkuar dëmshpërblimin nga agjencitë ku APD ka prerë biletat e udhëtimit.

Titulli i gjetjes: Përdorim jo eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike.

Situata: Me kërkesën për transaksion datë 13.05.2017 është kryer pagesa prej 15,360,000 lekë ndaj kompanisë “Th. H.” shpk. Bashkëlidhur praktikës fatura tatimore nr. 636 (41181239), datë 06.03.2017, bazuar në kontratën nr. 2371, datë 22.08.2016 me objekt “Trajtimi i stafit operacional dhe menaxherial të Autoritetit Portual Durrës”, lidhur midis kontraktuesit “Th. H.” shpk, përfaqësuar nga E. Y., dhe Autoritetit Portual Durrës, përfaqësuar nga G. Sh..

Vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e APD. APD nuk duhet të miratonte këtë fond që në planin e biznesit të vitit 2016. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 5, 8, pasi Menaxhimi i Lartë, nuk ka përcaktuar qartë domosdoshmërinë e planifikimin e këtij fondi dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike etj. APD ka një sektor trajnimi të mirë strukturuar dhe të plotësuar me stafin përkatës për të cilën APD shpenzon shuma të konsiderueshme.

Për pos sa mësipër



Përfitimimi i institucionin nga ky shpenzim duke investuar në kualifikimin e stafit, në kushtet kur vetëm gjatë një periudhe prej 18 muaj janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me 124 punonjës është jo ekzistente. Për sa më sipër mban përgjegjësi Këshilli Drejtues që ka miratuar Planin e Biznesit dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv për lidhjen e kontratës dhe kryerjen e një shpenzimi të panevojshëm me pasojë **dëmin ekonomik në vlerën 15,360,000 lekë**.

Kriteri: Ligji 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 5, 8.

Ndikimi/efekti: Shpenzime me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e APD-së

Shkaku: Përdorim jo eficient, efektiv dhe ekonomik i burimeve financiare publike.

Rëndësia: e lartë

Rekomandim: Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **15,360,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzimet për "Trajtimi i stafit operacional dhe menaxherial të Autoritetit Portual Durrës", të kryera nga kompania "Th. H." shpk. Vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e APD. APD nuk duhet të miratonte këtë fond që në planin e biznesit të vitit 2016. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 5, 8, pasi menaxhimi nuk ka përcaktuar qartë domosdoshmërinë e planifikimin e këtij fondi dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike etj. APD ka një sektor trajnimit të mirë strukturuar dhe të plotësuar me stafin përkatës për të cilën APD shpenzon shuma të konsiderueshme. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëmin ekonomik**.

Titulli i gjetjes: Parregullsi në procedurën e sponsorizimit

Situata: Për periudhën objekt auditimi rezulton se ka vetëm 2 procedura sponsorizimi, procedura të cilat janë miratuar para ardhjes së rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së. U audituan të dyja procedurat dhe tek procedura e sponsorizimit të Shoqatës Kulturore S.B. u konstatua shpenzimi i kryer për një nga zërat e parashikuar është tejkualuar me 100,000 lekë. Pagesa e kryer duke tejkualuar limitin e vendosur në kontratën e sponsorizimit prej 100,000 lekë është përfitim i pa drejtë nga Shoqata S. B. dhe përbën dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga përfituesi i shumës. Pagesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar", i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 21, datë 26.08.2016.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar.

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin dhe kontrollin financiar", i ndryshuar, Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 21, datë 26.08.2016 .

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik

Shkaku: Tejkualim i vlerës së preventivuar

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **100,000 lekë** nga Shoqata Kulturore "S.B.". Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës së sponsorizimit nr. 2637, datë 22.09.2016, si përfitim i padrejtë nga kjo shoqëri pasi ka tejkualuar shpenzimin që do të mbulonte kontrata.

Titulli i gjetjes: Konsum karburanti



Situata: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk vërtetohet plotësisht kryerja e shpenzimeve për karburantin, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi. Konkretisht fletë-udhëtimet nuk përputhen me distancën e dokumentuar dhe rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr për çdo drejtues mjete etj. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke krijuar në këtë mënyrë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit një **dëm ekonomik** në vlerën **167,716 lekë**.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligji nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik

Shkaku: Përdorimi i automjeteve jo sipas destinacioneve të deklaruara.

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtohet vlera **167,716 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpenzimet për karburant për automjetet e APD, për të cilat nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Titulli i gjetjes: Pagesa të kryera pa urdhër titullari

Situata: Me kërkesën për transaksion datë 21.09.2016 është kryer pagesa prej 2,820 euro si tarifë pjesëmarrje në Konferencë në Roterdam për tre persona (3* 940 euro) bazuar në Urdhrin nr. 2568, datë 16.09.2016, të Drejtorit Ekzekutiv me 2 pjesëmarrës. Bashkëlidhur pagesës gjendet gjithashtu fatura e pjesëmarrjes në konferencë edhe për G. B., i cili nuk është në urdhrin e titullarit dhe pagesa e kryer është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar. Vlera e paguar prej 940 euro përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Shpenzime të pa autorizuara

Shkaku: Kryerje pagese të pa bazuar në urdhrin e titullarit

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **940 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e kryer për pjesëmarrje të G. B. me detyrë ish-kryetar i këshillit mbikëqyrës në konferencën “Asambleja e Qytet-Porteve për vitin 2016” në Roterdam, pasi nuk është përshirë në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr. 2568, datë 16.09.2016 i



Drejtorit Ekzekutiv. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Titulli i gjetjes: Pagesa të kryera për pjesëmarrje në panairt e punës

Situata: Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me arkën, u konstatuan 4 pagesa të kryera për pjesëmarrje në panairt “Work and Study” dhe “Panair i punës” me motivin se është mundësi promovimi për aktivitetin e APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja në tregun e punës. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është e pa shoqëruar me kërkesë nga sektori përkatës mbi përfitimet e mundshme si dhe del jashtë qëllimit dhe objektivit kryesor të vet institucionit. APD ka një strukturë punonjësish të mirë përcaktuar dhe të miratuar me Vendimet përkatëse të Këshillit Drejtues dhe nuk ka mundësi ekspozimi të vendeve vakante të punës. Pagesat e kryera në vlerën 8,948 euro përbejnë dëm ekonomik dhe është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Shpenzime me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Pagesa për pjesëmarrje në panair jashtë objektivit institucional

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **8,948 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesat e kryera për pjesëmarrje në panairt “Work and Study” dhe “Panair i punës” me motivin për promovimin e aktivitetit të APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja në tregun e punës, që në fakt këto pagesa nuk ka lidhje me objektivat institucionale por me një pjesëmarrje pa qëllim në vetvete. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Titulli i gjetjes: Pagesë e faturuar më shumë se shpenzimet reale.

Situata: Me kërkesën për transaksion datë 29.09.2016, është kryer pagesa prej 2,394 euro kundrejt A...për biletë avioni dhe hotel në Amsterdam për 2 veta bazuar në Urdhrin nr. 2568, datë 16.09.2016. Nga kryqëzimi i dokumentacionit me arkën rezulton se bashkëlidhur praktikës së tërheqjes së dietave nga Anëtari i Këshillit Drejtues (5*60 euro = 300 euro) është fatura e hotelit ku kanë qëndruar gjatë kryerjes së shërbimi me vlerë 477.01 euro. Vlera e paguar më shumë prej **646 euro** (800 euro - 477.01 euro = 322.99 euro * 2 persona) përbën dëm ekonomik, e cila duhet të zhdëmtohet nga përfituesi pasi është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Pagesë më tepër se shpenzimet reale të kryera

Shkaku: Pagesë e kryer pa verifikuar shpenzimin real të kryer

Rëndësia: e mesme



Rekomandimi: Të kërkohej në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **646 euro** nga operatori “A...”. Ky vlerë ka të bëjë me përfitimim e padrejtë nga kjo shoqëri pasi ka faturuar më shumë se shpenzimet reale të kryera gjatë shërbimit.

Titulli i gjetjes: Pagesa për udhëtime për individ jo staf të APD

Situata: Bazuar në Urdhrin nr. 1734/2 prot., datë 04.06.2018 dhe kërkesën e M. D., me detyrë Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, është hartuar urdhri i prokurimit nr. 2407, datë 04.06.2018 për blerjen e biletave për Hamburg për 4 persona nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.

Urdhri nr. 1734/2 prot., datë 04.06.2018 përcakton pjesëmarrës në aktivitet:

- A. B., Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
- I. G., Përgjegjës i prokurimeve
- M. D., Përgjegjëse e Sektorit të BNJZHK-së
- E. C., Moderatore Projektsh (jo punonjëse e APD)

Vlera e biletave të avionit është 289,900 lekë (4*72,475 lekë).

Pagesa e kryer për biletën e E. C. është një kosto jo e ligjshme për APD, pasi nuk është punonjëse e institucionit. APD nuk ka pse shpenzon për individë që nuk janë punonjës dhe që nuk ka asnjë tagër ligjor të përfaqësojë institucionin në aktivitete kombëtare apo ndërkombëtare.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar,

Udhëzimi i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Pagesë në dëm të buxhetit të APD

Shkaku: Pagesë e kryer për udhëtimin e individëve jo punonjës së APD

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi:

Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **72,475 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e biletave të udhërimit për Hamburg te E. C. me detyrë moderatore projektsh (jo punonjëse e APD). Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Titulli i gjetjes: Pagesa jo në përputhje me kuadrin ligjor

Situata: Me kërkesën për transaksion datë 21.05.2018 është kryer pagesa 248,167 lekë për E. C., bazuar në urdhrin nr. 1699, datë 24.04.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm A. B., “Mbi kryerjen e pagesës për prezantimin e kryer nga moderatori në kuadër të projektit SUPAIR”, dhe kërkesën e Drejtorit Teknik B. V.. Me E. C. është lidhur një Marrëveshje Shërbimi nr. 1233/1, datë 13.04.2018 (në anglisht) dhe 1233/2, datë 13.04.2018 (në shqip), ku konstatohet se asnjë nga këto dokumente nuk është në regjistrin e protokollit të institucionit. Gjithashtu marrëveshja bazë e projektit “SUPAIR” nuk është nënshkruar midis APD dhe donatorit deri më datën 27.07.2018, datë në të cilën përfundoi auditimi, si dhe nuk është kryer asnjë disbursim. Pagesa e kryer është e pabazuar ligjërish. Praktika e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003, “Për Autoritetin Portual” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

Kriteri: Ligji nr. 9130, datë 08.09.2003, “Për Autoritetin Portual” i ndryshuar dhe Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”

Ndikimi/efekti: Shpenzime me pasojë dëm ekonomik



Shkaku: Shpenzime jo në përputhje me kuadrin ligjor

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi:

Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **248,167 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e kryer për E. C., për prezantimin e projektit “SUPAIR”, pasi marrëveshja bazë e projektit “SUPAIR” nuk është nënshkruar midis APD dhe donatorit deri më datën 27.07.2018, datë në të cilën përfundoj auditimi, si dhe nuk është kryer asnjë disbursim.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Titulli i gjetjes: Pagesa për shpenzime udhëtimi për jo staf të APD

Situata: Me urdhër transfertën datë 21.06.2018 nëpërmjet bankës I., është kryer pagesa ndaj A... shpk në vlerën 317,000, bazuar në faturën tatimore nr. 5604 (62832504) datë 29.05.2018 për 4 bileta udhëtimi me avion (4*79,250 lekë). Bazuar në urdhrin e titullari nr. 2285, datë 25.05.2018 Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv A. B., ka caktuar personat që do të marrin pjesë në trajnimin e organizuar nga ESPO group në datat 31 maj - 2 qershor 2018. Përfaqësues në këtë aktivitet do të ishin:

1. A. B. – Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
2. B. V. – Drejtor Teknik
3. Sh. I. – Sekretare e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv
4. E. C. – Moderatore Projektsh (jo në strukturën dhe organikën e APD)

Pagesa e kryer për trajnimin e E. C. është një kosto jo e ligjshme për APD, pasi nuk është punonjëse e institucionit dhe APD nuk ka pse shpenzon për trajnimin e individëve jo punonjës dhe që nuk ka asnjë tagër ligjor të përfaqësojë institucionin në aktivitet kombëtare apo ndërkombëtare.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Pagesë në dëmtim të buxhetit të APD

Shkaku: Pagesë e kryer për udhëtimin e individëve jo punonjës së APD

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **79,250 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e biletave të udhëtimin për Rotterdam te E. C. me detyrë moderatore projektsh (jo punonjëse e APD). Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Titulli i gjetjes: Mos bërja hyrje e aparateve celular në magazinë

Situata: Autoriteti Portual Durrës ka lidhur marrëveshje me kompaninë V.. Sh.A datë 20.04.2014, për Autoritetin Portual Durrës S. B. dhe për V... Sh.A Ch. B., nëpërmjet të cilës punonjësit e Autoriteti Portual Durrës janë pajisur me numër telefon celular me parapagim, me afat deri në 19.04.2017. Deri në fund të periudhës së auditimit kjo marrëveshje ka ndryshuar 8 herë. Nga kjo marrëveshje APD ka përfituar 29 aparate celular në vlerën **2,801,350 lekë**, aparate të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinën e APD dhe nuk janë pjesë e inventarëve të saj në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Vlerë e aparateve celular prej 2,801,350 lekë përbën dëm ekonomik.



Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Mos bërja hyrje e vlerave materiale

Shkaku: Mungesa në zërin e inventarëve

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **2,801,350 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me 29 aparatet celular që nuk janë bërë hyrje në magazinë, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Situata: Nga auditimi i procedurës me blerje me vlera të vogla “Blerje e legjislacionit Financiar” me fond limit 800,000 lekë me fitues operatorin e renditur të dytë “2 ...” me ofertë 754,400 lekë pa TVSH, rezulton se çmimet e librave janë shumë herë më të lartë se çmimi i tyre referencë në treg, i cili është caktuar nga vetë autorët e librave si dhe 3 nga librat nuk janë dorëzuar në APD. Grupi i auditimit ka bërë diferencën midis vlerës së faturuar dhe çmimit real të librave dhe rezulton se shoqëria “2...” ka përfituar pa të drejtë vlerën 799,680 lekë me TVSH (905,280 lekë – 105,600 lekë) dhe për pasojë i ka shkatuar APD-së dhe buxhetit të shtetit dëm ekonomik.

Kriteri: Çmimet e tregut të librave

Ndikimi/efekti: Dëm ekonomik

Shkaku: Çmime më të larta se ato të tregut

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës, arkëtimin e vlerës **799,680 lekë** ndaj operatorit “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri pasi ka faturuar vlera të librave më të larta se ato të tregut.

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “**Dekori i APD-së me rastin e festave të fund vitit**”, viti 2016 me fond 800,000 lekë , u konstatua se operatori që është renditur i pari “2...” shpk me ofertë 679,800 lekë pa TVSH nuk vërtetohet se janë sjell mallrat e kërkuara.

Kriteri: Specifikimet e vendosura në ftesë për ofertë.

Ndikimi/efekti: Shpenzim me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Mallra jo sipas specifikimeve

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **815,760 lekë**, nga operatorit “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk provohet se janë sjell mallrat e kërkuara nga APD.

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.



Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “**Blerje Skedë Kontrolli me SN:CUVC 6SE7090-0XX84-0AB0**” me fond limit 800,000 lekë, viti 2017, u konstatua se operatori i renditur i pari nuk është paraqitur. Është njoftuar operatori që është renditur i dyti, B... i cili në datë 05.01.2017 ka sjellë skedën e kontrollit shoqëruar me faturën tatimore 28 (32899178), datë 05.01.2017 me vlerë 878,400 lekë me TVSH dhe është bërë hyrje me Fletë Hyrjen nr. 010081, datë 05.01.2017. Nga hulumtimi në internet për vlerën e tregut të pajisjes konstatohet se: kjo pajisje gjendet me çmimet 1,205 dollar, 760 dollar, 609 dollar. Grupi i auditimit po merr si çmim reference çmimin më të lartë të konstatuar 1,205 dollar (129,537 lekë). **Vlera 748,863 lekë** (878,400 – 129,537) përbën dëm ekonomik për APD dhe buxhetin e shtetit.

Kriteri: Çmimet e tregut

Ndikimi/efekti: Shpenzim me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Mallra jo sipas specifikimeve

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **748,863 lekë**, nga operatorit “B...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri mbi çmimet e tregut.

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “Përmirësimi dhe përditësimi i aplikacionit për telefona celularë “Smart Transport Albania”” me fond 800,000 lekë, u konstatua se operatori i renditur i pari “A...” me ofertë 690,000 lekë është paraqitur për të ofruar ndërtimin e aplikacionit. Me Akt-Pranimin nr.1 datë 28.12.2016, komisioni ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori dhe metodologjinë e hartimit të aplikacionit bashkë me specifikimet. Me Akt-Pranimin nr. 2 komisioni ka pranuar aplikacionin dhe të faturës së shërbimit nr. 7899367, date 28.02.2017, me vlerë 690,000 lekë. Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit rezulton se aplikacioni në APP store nuk ekziston në kundërshtim me specifikimet e kërkuara që duhet edhe për sistemet OI’s. Aplikacioni u gjet vetëm për sistemet smart phone u shkarkua dhe rezultoi jo funksional.

Kriteri: Specifikimet e ftesës për ofertë

Ndikimi/efekti: Shpenzim me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Mallra jo sipas specifikimeve

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **690,000 lekë**, nga operatorit A.C. shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri pasi aplikacioni “Smart Transport Albania” nuk plotëson specifikimet e ftesës për ofertë.

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “Blerje dhurata për festat e fundvitit” me fond 800,000 lekë u konstatua se operatori që është renditur i parë nuk është paraqitur, komisioni i është drejtuar operatorit të dytë “2...” Group shpk me ofertë 699,900 lekë, i cili ka sjellë mallrat për të cilat nuk vërtetohet se janë ato të kërkuara.

Kriteri: Specifikimet e vendosura në ftesë për ofertë.

Ndikimi/efekti: Shpenzim me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Mallra jo sipas specifikimeve

Rëndësia: e mesme



Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **839,880 lekë me TVSH**, nga operatori “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion **nuk provohet janë sjell mallrat e kërkuar dhe APD ka shpenzuar.**

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “Blerje furnizim vendosje material auto-fener volvo xc60” me fond limit 104,000 lekë u konstatua se 2 operatorët e renditur të parët nuk janë paraqitur dhe është vazhduar procedura me operatorin “2...” me ofertë 97,700 lekë pa TVSH. Nga auditimi kësaj procedure konstatohet se ka një ndryshim midis objektit të prokurimit i cili është furnizim dhe vendosje dhe realizimit që është vetëm furnizim, i cili ka denaturuar procedurën dhe ka ulur konkurrencën. Gjithashtu në kërkesën e lindjes së nevojës nuk janë përcaktuar rrethanat në të cilat ndodhi situata (vlerësimi teknik) dhe mbulohet/ose jo nga siguracioni i automjetit. Vlera prej 117,240 lekë me TVSH përbën dëm ekonomik pasi nuk sqarohen rrethanat e ndodhjes së defektit dhe fakti që automjeti është në periudhë garancie.

Kriteri: Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Shpenzim me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Autorizim i shpenzimeve të panevojshme

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **117,240 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me blerje furnizim vendosje pjesë këmbimi (auto-fener) për autoveturë tip Volvo me targë AA896RK, pasi në kërkesën e lindjes së nevojës për këtë blerje nuk janë përcaktuar rrethanat në të cilat ndodhi situata (vlerësimi teknik) dhe mbulohet/ose jo nga siguracioni i automjetit në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “Blerje Mobilie për Zyre” me fond limit 450,000 lekë u konstatua se 2 operatorët e renditur të parët nuk janë paraqitur dhe më pas është njoftuar operator i renditur i treti “2...” shpk me ofertë 398,800 lekë.

Nga verifikimi fizik në magazinë u konstatua se disa nga mobiljet nuk ishin tërhequr nga personat të cilët kishin bërë kërkesën dhe dy prej tyre nuk plotësojnë specifikimet e vendosura në ftesën për ofertë. Vlera prej **155,300 lekë** përbën dëm ekonomik për APD dhe buxhetin e shtetit dhe duhet të zhdëmtohet nga operatori “2...” shpk.

Kriteri: Specifikimet teknike të ftesës për ofertë

Ndikimi/efekti: Shpenzim me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Pranim i mallrave jo sipas kërkesave të APD-së

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **155,300 lekë**, nga



operatorit “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion **nuk provohet nëse janë sjellë mallrat e kërkuar dhe APD ka shpenzuar.**

Titulli i gjetjes: Mangësi në procedurat e blerjeve me vlera të vogla.

Situata: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “Blerje pjesë këmbimi dhe elektronike për elektrivinça”, Adaptor Profibus 1 copë, me fond limit 600,000 lekë u konstatua se pas skualifikimit të operatorit me ofertë më të ulët si pasojë e mangësive në fushën e veprimit në Ekstraktin e QKR është vazhduar me operatorin e renditur të dytin “2...” shpk me ofertë 519,800 lekë pa TVSH. Në datën 03.05.2018 Operatori Ekonomik i renditur i pari ka paraqitur deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike, ky dokument nuk përmban numrin e protokollit të APD për të vërtetuar se kur është dorëzuar në APD dhe nëse është zbatuar afati 24 orë i vendosur në ftesën për ofertë.

Me urdhër transfertën datë 10.05.2018 është kryer pagesa prej 623,760 lekë me TVSH kundrejt operatorit “2...”, bazuar në faturën tatimore nr. 41, datë 07.05.2018, me numër serie 47301591. Nga hulumtimi në internet për vlerën e tregut të pajisjes konstatohet se: kjo pajisje gjendet për çmimin 150 euro (18,750 lekë). **Vlera 605,010 lekë** (605,010 – 18,750) përbën dëm ekonomik.

Kriteri: Specifikimet teknike të ftesës për ofertë

Ndikimi/efekti: Shpenzim me pasojë dëm ekonomik

Shkaku: Pranim i mallrave jo sipas kërkesave të APD-së

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **605,010 lekë**, nga operatorit “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri mbi çmimet e tregut.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi rezulton se ka vetëm 2 procedura sponsorizimi, procedura të cilat janë miratuar para ardhjes së rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së. U audituan të dyja procedurat dhe tek sponsorizimi i Shoqatës Kulturore S. B. u konstatua:

Bazuar në Vendimin e Këshilli Drejtues nr. 21, datë 26.08.2016 është lidhur kontrata e sponsorizimit nr. 2637, datë 22.09.2016, pas paraqitjes së dokumenteve:

- Kërkesën e subjektit
- Vendimi i Gjykatës i noterizuar
- Preventivi
- Nipt-i

Me kërkesën për transaksion datë 27.09.2016 është kryer pagesa me vlerë 400,000 lekë paradhënie.

Me kërkesën për transaksion datë 20.10.2016 është kryer pagesa me vlerën 200,000 lekë, bashkëlidhur praktikës gjenden edhe gjithë dokumentet justifikuese për shpenzimet e kryera. Nga auditimi dhe verifikimi i dokumentacionit justifikues të shpenzimeve të kryera rezulton se shpenzimi i kryer për një nga zërat e parashikuar është tejkaluar me 100,000 lekë, konkretisht:

Nr.	Emërtimi	Vlera sipas kontratës së sponsorizimit	Vlera e likuiduar
1.	Shpenzime promovionale (baner, postera, ftesa, prodhim, spot	300,000	400,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

	promoc.)		
2.	Shpenz. Transporti	300,000	200,000
	Totali	600,000	600,000

Pagesa e kryer duke tejkaluar limitin e vendosur në kontratën e sponsorizimit prej 100,000 lekë është përfitim i pa drejtë nga Shoqata S. B. dhe përbën dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga përfituesi i shumës. Pagesa e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 21, datë 26.08.2016 .

Konsumi i karburantit

Gjatë periudhës objekt auditimi për çdo fillim viti janë ngritur grupet për përcaktimin e normativave për të gjitha automjetet dhe automekanizmat që disponon APD.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit janë fletë-udhëtime, urdhër pune, kartelat përkatëse të tyre, rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e naftës së tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr për çdo drejtues mjetei etj.

Me urdhrin nr. 232 prot., datë 23/01/2018 “Mbi ngritjen e komisionit të përcaktimit të normativave të konsumit të karburantit për mjetet e reja dhe rishikim e normativave të të gjithë automjeteve të APD”, është ngritur komisioni i përbërë nga:

1. M. R.
2. A. C.
3. N. H.

Në këtë urdhër janë përcaktuar edhe detyrat e komisionit.

Më nr. 232/2, datë 16.02.2018, komisionit i janë përcjell lista e mjeteve që duhet të testohen.

Një pjesë e mjeteve konsumin e kanë në bazë ore dhe një pjesë konsumi në bazë të lëvizjes.

Për çdo mjet janë urdhrat e punës dhe pasqyrat mujore e lëvizjes së mjeteve dhe orët e punës ku janë regjistruar orët e hyrjes në punë dhe fikjen e mjeteve dhe për automjetet çdo ditë është regjistruar kilometrazhi në fillim dhe në fund të ditës.

Nga grupi i auditimit u verifikuan kilometrat e përshkruar prej disa automjete dhe u konstata se në disa prej automjeteve kilometrat e shënuara në fletët e udhëtimit nuk përputhen me kilometrat që tregon kilometrazhi. Në disa raste kilometrat e shënuar janë më pak se kilometrat e treguara nga kilometrazhi dhe anasjelltas. Kjo tregon pasaktësinë e dokumentimit të procesit të harxhimit të karburantit dhe të dokumentimit të lëvizjeve dhe urdhrave të lëvizjes së automjeteve.

Spektori i mbështetjes materiale dhe magazinimit nuk janë kryer kryqëzim i të dhënave të deklaruara dhe verifikimi i tyre faktik, por merren të mirëqena dhe kuadrohet sasia e karburantit të harxhuar gjatë muajit.

Disa prej makinave që rezultuan me probleme:

Nr.	Taga	Kilometrazhi i shënuar	Kilometrazhi i verifikuar	Diferenca e konstatuar	Konsumi	Vlera në lekë
1	DR6625D	258,570	259,383	-813	12.5	18,495
2	AA897RK	33,020	35,524	-2504	9.9	45,117
3	AA895RK	32,190	25,040	7150	8	104,104

Nga sa më sipër:

-Për automjetet me targa DR6625D dhe AA897RK u konstata se sasia e kilometrave të përshkruara realisht është më e lartë se ato të shënuara në fletudhëtime. Pra këto automjete



kanë kryer lëvizje të cilat janë të paautorizuara e për pasojë konsiderohen lëvizje për qëllime personale.

Automjeti me targa AA895RK ka kryer realisht 25040 km, ndërkohë që në fletudhëtimet e paraqitura janë shënuar 32190 km. Pra për këtë automjet janë shënuar 7150 km më shumë nga sa ka aktualisht, e për pasojë vlera 104,104 lekë ($71.5 * 8$ litra normë konsumi * 182 lekë/litër) përbën dëm ekonomik për buxhetin e APD.

Të tre automjetet që rezultuan me mos përputhje kilometrash janë në administrim dhe përdorim nga FSPD, automjete të cilat i kryejnë lëvizjet në bazë të urdhrin të Drejtorit të FSPD dhe karburanti merret nga magazinieri i FSPD.

Gjithashtu fletët e udhëtimit të automjeteve të FSPD nuk tregojnë lëvizjet reale të automjeteve por vetë Planin e Sigurisë dhe jo sa herë në ditë ka lëvizur automjeti dhe destinacioni brenda Portit.

Nga verifikimi në sistemin e checkimit rezultoi se dy prej automjeteve të FSPD, konkretisht AA897RK dhe AA895RK kanë hyrje dhe dalje të shpeshta jashtë territorit të portit, cka tregon se lëvizjet e deklaruara të automjeteve të FSPD në fletë udhëtime nuk tregojnë lëvizjen reale të tyre.

Spektori i mbështetjes materiale dhe magazinimit nuk janë kryer kryqëzim i të dhënave të deklaruara dhe verifikimi i tyre faktik, por merren të mirëqena dhe kuadrohet sasia e karburantit të harxhuar gjatë muajit.

Nga verifikimi i kryer mbi përdoruesit e automjeteve dhe detyra e tyre në strukturën e APD rezultoi se Magazinieri i FSPD M. K. nën drejtimin e Drejtorit të FSPD kryen edhe detyrën e Shoferit për automjetin AA897RK, duke cënuar kryerjen me cilësi të detyrës funksionale për të cilën ai është emëruar në APD në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Pra si konkluzion:

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit, nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, pasi një pjesë e dokumentacionit justifikues bazë është me mangësi. Konkretisht fletë-udhëtimet nuk përputhen me distancën e dokumentuar dhe rakordime mujore dhe vjetore për sasinë e karburantit të tërhequr nga magazina me harxhimin në fakt të sasisë së tërhequr për çdo drejtues mjeti etj. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duke krijuar në këtë mënyrë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit një **dëm ekonomik** në vlerën **167,716 lekë**.

Veprimet e kryera me bankë në valutë

Autoriteti Portual Durrës operon me monedha të huaja euro dhe dollar, për periudhën objekt auditimi ka operuar me llogari në 15 banka të ndryshme në euro dhe 2 banka në dollar.

- Me kërkesën për transaksion datë 21.09.2016 është kryer pagesa prej 2,820 euro si tarifë pjesëmarrje në Konferencë në Rotterdam për tre persona (3* 940 euro) bazuar në Urdhrin nr. 2568, datë 16.09.2016, të Drejtorit Ekzekutiv me 2 pjesëmarrës

- G. Sh., Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
- J. K., Anëtar i Këshillit Drejtues

Në urdhrin e më sipërm pjesëmarrja në këtë aktivitet është konsideruar si një mundësi njohjeje me zhvillimet e reja të tregut të punës, shkëmbimin e eksperiencave si dhe mundësi promovimi për APD-në.



Bashkëlidhur pagesës gjendet gjithashtu fatura e pjesëmarrjes në konferencë edhe për G. B., i cili nuk është në urdhrin e titullarit dhe pagesa e kryer nuk është e bazuar ligjërisht. Vlera e paguar prej 940 euro përbën dëm ekonomik.

- Me kërkesën për transaksion datë 26.01.2017, është kryer pagesa prej 2,442.68 euro kundrejt IA Seminar Ltd, tarifë pjesëmarrje në seminarin me temë “International Financial Reporting Standarts - Basic” për datat 15-18.03.2017 bazuar në urdhrin nr. 216, datë 24.01.2017. Pjesëmarrja në këtë aktivitet jashtë objektit të portit

Nga auditimi i veprimeve të kryera me bankë u konstatuan pagesa të kryera për pjesëmarrje në panairë të ndryshme. Bashkëlidhur praktikës mungonin kërkesat e kryera nga sektori i promovimit, si dhe nuk është kryer asnjë analizë kosto përfitim nga pjesëmarrja në këto aktivitetin në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar, konkretisht:

- Me kërkesën për transaksion datë 06.05.2016 është kryer pagesa prej 1,248 euro drejt Expovision për pjesëmarrjen në panairin “Panairi i punës 2016” në bazë të urdhrin nr. 1302, datë 26.04.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv me motivin se është mundësi promovimi për aktivitetin e APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja në tregun e punës. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është e pa shoqëruar me kërkesë nga sektori përkatës mbi përfitimet e mundshme si dhe del jashtë qëllimit dhe objektivit kryesor të vet institucionit. APD ka një strukturë punonjësish të mirë përcaktuar dhe të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 12, datë 05.05.2015 dhe nuk ka mundësi ekspozimi te vendeve vakante të punës. Vlera prej 1,248 euro përbën dëm ekonomik

- Me kërkesën për transaksion datë 03.10.2016 është kryer pagesa prej 1,500 euro drejt Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë për pjesëmarrjen në panairin “Work & Study” në bazë të urdhrin nr. 2577, datë 16.09.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv me motivin se është mundësi promovimi për aktivitetin e APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja në tregun e punës. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është e pa shoqëruar me kërkesë nga sektori përkatës mbi përfitimet e mundshme si dhe del jashtë qëllimit dhe objektivit kryesor të vet institucionit. APD ka një strukturë punonjësish të mirë përcaktuar dhe të miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues dhe nuk ka mundësi ekspozimi te vendeve vakante të punës. Vlera prej 1,500 euro përbën dëm ekonomik

- Me kërkesën për transaksion datë 24.11.2016 është kryer pagesa prej 11,508 euro drejt Klik Expo Group për pjesëmarrjen në Panairin Ndërkombëtar të Transportit dhe Infrastrukturës në bazë të urdhrin nr. 3164, datë 15.11.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv me motivin se është mundësi promovimi për aktivitetin e APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është e pa shoqëruar me kërkesë nga sektori përkatës mbi përfitimet e mundshme si dhe del jashtë qëllimit dhe objektivit kryesor të vet institucionit. Nga Sektori i Promocionit nuk është kryer një analizë paraprake mbi mundësitë e përfitimit potencial nga pjesëmarrja në këtë aktivitet.

- Me kërkesën për transaksion datë 23.05.2017 është kryer pagesa prej 5,000 euro drejt Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë për pjesëmarrjen në panairin “Work & Study” në bazë të urdhrin nr. 1427, datë 05.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv me motivin se është mundësi promovimi për aktivitetin e APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja në tregun e punës. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është e pa shoqëruar me kërkesë nga sektori përkatës mbi përfitimet e mundshme si dhe del jashtë qëllimit dhe objektivit kryesor të vet institucionit. APD ka një strukturë punonjësish të mirë përcaktuar dhe të miratuar me Vendimin e Këshillit



Drejtues dhe nuk ka mundësi ekspozimi te vendeve vakante të punë. Vlera prej 5,000 euro përbën dëm ekonomik

- Me kërkesën për transaksion datë 04.12.2017 është kryer pagesa prej 3,942 euro drejt Klik Expo Group për pjesëmarrjen në Panairin Ndërkombëtar të Transportit dhe Infrastrukturës në bazë të urdhrin nr. 2801, datë 17.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv me motivin se është mundësi promovimi për aktivitetin e APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është e pa shoqëruar me kërkesë nga sektori përkatës mbi përfitimet e mundshme si dhe del jashtë qëllimit dhe objektivit kryesor të vet institucionit. Nga Sektori i Promocionit nuk është kryer një analizë paraprake mbi mundësitë e përfitimit potencial nga pjesëmarrja në këtë aktivitet.

- Me kërkesën për transaksion datë 27.04.2018 është kryer pagesa prej 1,200 euro drejt Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë për pjesëmarrjen në panairin “Work & Study” në bazë të urdhrin nr. 1147, datë 16.03.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv me motivin se është mundësi promovimi për aktivitetin e APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja në tregun e punës. Pjesëmarrja në këtë aktivitet është e pa shoqëruar me kërkesë nga sektori përkatës mbi përfitimet e mundshme si dhe del jashtë qëllimit dhe objektivit kryesor të vet institucionit. APD ka një strukturë punonjësish të mirë përcaktuar dhe të miratuar me Vendimin e Këshillit dhe nuk ka mundësi ekspozimi te vendeve vakante të punë.

Vlera prej 1,200 euro përbën dëm ekonomik.

Blerja e biletave

Me kërkesën për transaksion datë 02.09.2016 është kryer pagesa e biletës së avionit për Bruksel prej 398 euro drejt kompanisë P. I., pa procedurë prokurimi dhe bashkëlidhur mungon bileta ku të dokumentohet vlera e saj.

Me kërkesën për transaksion datë 01.12.2016, është kryer pagesa e biletës së avionit për Bruksel prej 355 euro drejt kompanisë P. C., pa procedurë prokurimi.

Me kërkesën për transaksion datë 22.07.2016, është kryer pagesa e biletës së avionit për Angli prej 640 euro drejt kompanisë A... shpk, pa procedurë prokurimi. Bazuar në urdhrin nr. 1371, datë 03.05.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv për shërbim në datat 09-13 maj. Në bazë të faturës tatimore nr. 6369, datë 30.05.2016 rezulton se bileta është blerë pas kryerjes së shërbimit. Bashkëlidhur me praktikën mungon bileta ku të jetë dokumentuar vlera e saj.

Me kërkesën për transaksion datë 12.08.2016, është kryer pagesa prej 1434.5 euro kundrejt kompanisë D. P. A. për blerje biletash traqeti për 5 persona, pa procedurë prokurimi, bashkëlidhur praktikës është konfirmimi i rezervimit në emër vetëm të një punonjësi për 5 persona dhe 2 automjete.

Me kërkesën për transaksion datë 13.09.2016, është kryer pagesa prej 1745 euro kundrejt A... për biletë avioni për Malaga Spanjë, për datat 22-25.06.2016 bazuar në urdhrin nr. 1624, datë 30.05.2016. Bashkëlidhur praktikës mungojnë biletat e avionit ku të vërtetohet vlera e paraqitur në faturë.

Me kërkesën për transaksion datë 29.09.2016, është kryer pagesa prej 2394 euro kundrejt A... për biletë avioni dhe hotel në Amsterdam për 2 veta bazuar në Urdhrin nr. 2568, datë 16.09.2016 (G. Sh., Drejtor i Përgjithshëm dhe J. Sh., Anëtar i Këshillit Drejtues):

Bileta avioni 2 copë *397 euro/copë

Hotel 4 netë*200 euro/nata për person*2 persona =1600 euro

Gjithashtu nga kryqëzimi i të dokumentacionit me arkën rezulton se bashkëlidhur praktikës së tërheqjes së dietave nga Anëtari i Këshillit Drejtues (5*60 euro = 300 euro) është fatura e



hotelit ku kanë qëndruar gjatë kryerjes së shërbimi me vlerë (460.84 euro +16.17 euro = 477.01 euro)

Vlera e paguar më shumë prej **646 euro** (800 euro - 477.01 euro = 322.99 euro * 2 persona) përbën dëm ekonomik.

Me kërkesën për transaksion datë 20.10.2016, është kryer pagesa e biletave të avionit për Baltimor prej 3464 euro drejt kompanisë D..., pa procedurë prokurimi. Bazuar në urdhrin nr. 2642, datë 23.09.2016 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv për shërbim në datat 09-12 tetor, me grupin e përbërë nga:

1. G. B. – Kryetar i Këshillit Drejtues
2. G. Sh. – Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv (nuk ka shkuar)
3. Sh. H. – Drejtor
4. F. S. – Drejtor
5. R. Gj. – Përgjegjëse Sektori

Bashkëlidhur me praktikën mungon bileta ku të jetë dokumentuar vlera e saj.

Qëllimi i aktivitetit është “implementimi i modeleve të hartuara nga institucionet akademike për zhvillimin e qëndrueshëm, jashtë kampuseve universitare ...” del jashtë objektivave dhe zhvillimeve institucionale. Shpenzimi total që është kryer për pjesëmarrje në këtë aktivitet duke përfshirë bileta, hotel, dieta dhe regjistrimin në konferencë është 3460 euro + 15,360 dollar, vlerë e cila përbën shpenzim jo efektiv për buxhetin e APD.

Me kërkesën për transaksion datë 13.05.2016, është kryer pagesa prej 1680 euro kundrejt A... për biletë avioni për Maltë, për datat 28-29.04.2016 bazuar në urdhrin nr. 1137, datë 05.04.2016, pa procedurë prokurimi. Bashkëlidhur praktikës mungojnë biletat e avionit dhe fatura e hotelit ku të vërtetohet vlera e paraqitur në faturë.

Me kërkesën për transaksion datë 05.01.2017, është kryer pagesa prej 575 euro kundrejt A... për biletë për Bari, për datat 06-07.12.2016 bazuar në urdhrin nr. 3350, datë 05.12.2016, pa procedurë prokurimi por janë 3 oferta nga tre operatorë. Bashkëlidhur praktikës mungojnë biletat ku të vërtetohet vlera e paraqitur në faturë.

Me kërkesën për transaksion datë 19.01.2017, është kryer pagesa prej 1,900 euro kundrejt A... për biletë avioni për Trieste, për datat 12-16.12.2016 bazuar në urdhrin nr. 3319, datë 01.12.2016, pa procedurë prokurimi por janë 3 oferta nga tre operatorë. Bashkëlidhur praktikës mungojnë biletat ku të vërtetohet vlera e paraqitur në faturë.

Bazuar në Urdhrin nr. 1734/2 prot., datë 04.06.2018 dhe kërkesën e M. D., me detyrë Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, është hartuar urdhri i prokurimit nr. 2407, datë 04.06.2018 për blerjen e biletave për Hamburg për 4 persona nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar.

Urdhri nr. 1734/2 prot., datë 04.06.2018 përcakton pjesëmarrës në event:

- A. B., Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
- I. Gj., Përgjegjës i prokurimeve
- M. D., Përgjegjëse e Sektorit të BNJZHK-së
- E. C., Moderatore Projektsh.

Vlera e biletave të avionit është 289,900 lekë (4*72,475 lekë).

Pagesa e kryer për biletën e E. C. është një kosto jo e ligjshme për APD, pasi nuk është punonjëse e institucionit dhe APD nuk ka pse shpenzon për jo punonjës dhe që nuk ka asnjë tagër ligjor të përfaqësojë institucionin në evente kombëtare apo ndërkombëtare.

Arka Euro/USD

Nga auditimi me zgjedhje i veprimeve të kryera me arkë u konstatuan 15 raste të kthimit të paradhënies së marrë për të mbuluar shpenzimet e kryera për udhëtime dieta me vonesë,



vonesë e cila shkon nga 1 muaj deri në 1 vit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën 66 të Udhëzimit Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, konkretisht:

- Me mandat pagesën nr. 10, datë 05.05.2016 është dhënë paradhënie 2,000 euro për shërbim në Angli për datat 09-13 maj. Nga auditimi rezulton se kthimi i paradhënies me mandat arkëtimin nr. 12, datë 13.03.2017 (rreth 10 muaj me vonesë).
- Me mandat pagesën nr. 14, datë 09.05.2016 është dhënë paradhënie 1,000 euro për shërbim në Kroaci për datat 11-14 maj. Nga auditimi rezulton se kthimi i paradhënies me mandat arkëtimin nr. 18, datë 14.06.2017 (rreth 1 muaj me vonesë).
- Me mandat pagesën nr. 19, datë 21.06.2016 është dhënë paradhënie 1,500 euro për shërbim në Spanjë për datat 22-25 qershor. Nga auditimi rezulton se kthimi i paradhënies me mandat arkëtimin nr. 25, datë 27.09.2017 (rreth 4 muaj me vonesë).
- Me mandat pagesën nr. 20, datë 21.06.2016 është dhënë paradhënie 1,500 euro për shërbim në Spanjë për datat 22-25 qershor. Nga auditimi rezulton se kthimi i paradhënies me mandat arkëtimin nr. 27, datë 02.08.2017 (rreth 14 muaj me vonesë).
- Me mandat pagesën nr. 33, datë 14.10.2016 është dhënë paradhënie 1,000 euro për shërbim në Maqedoni për datat 18-22 tetor. Nga auditimi rezulton se kthimi i paradhënies me mandat arkëtimin nr. 28, datë 08.02.2017 (rreth 4 muaj me vonesë).
- Me mandat pagesën nr. 39, datë 26.10.2016 janë paguar shpenzimet e udhëtimit për G. Sh. në vlerë 540 euro në bazë të urdhrit nr. 2568, datë 16.09.2016, bashkëlidhur praktikës ndodhen dy fatura taksie 2*150 euro, fatura të cilat janë të plotësuara me shkrim dore, pa vendin e nisjes dhe mbërritjes, pa orë dhe me numër serie të njëpasnjëshëm.
- Me mandat pagesën nr. 15, datë 04.10.2016 është dhënë parapagim në vlerën 5,000 USD kundrejt G. B., për pjesëmarrje në konferencë e organizuar nga “Shoqata për avancimin e zhvillimit të qëndrueshëm nga institucionet akademike”. Kthimi i paradhënies me mandat arkëtimin nr. 6, datë 10.12.2017 (15 muaj).
- Me mandat arkëtimin nr. 11, datë 26.10.2016 është kthyer paradhënie për udhëtimin e kryer në Indi në muajin prill (6 muaj me vonesë).
- Me mandat arkëtimin nr. 12, datë 18.11.2016, Sh. H. ka kthyer paradhënien për udhëtimin në SHBA. Shpenzimet janë në vlerën 3,890 dollar (hotel 1,960 dollar + taksi 350 dollar + fee conference 1,180 dollar + dieta 400 dollar).
- Me mandat pagesën nr. 139, datë 07.12.2016, është kryer pagesa prej 6,528 lekë kundrejt Y. K. për blerje aromatizues ambientesh bazuar në autorizimin nr. 3358, datë 06.12.2016 të titullarit. Pa procedure prokurimi.
- Me mandat pagesën nr. 48, datë 07.12.2016, është kryer parapagim prej 600 euro për A. G. bazuar në urdhrin nr. 3319, datë 01.12.2017, kthimi i paradhënies është bërë me mandat arkëtimin nr. 04, datë 30.01.2017 (rreth 2 muaj me vonesë).
- Me mandat pagesën nr. 47, datë 07.12.2016, është kryer parapagim prej 600 euro për M. Sh. bazuar në urdhrin nr. 3319, datë 01.12.2017, kthimi i paradhënies është bërë me mandat arkëtimin nr. 05, datë 30.01.2017 (rreth 2 muaj me vonesë).
- Me mandat pagesën nr. 3, datë 26.01.2017, është kryer parapagim prej 1,000 euro për A. L. bazuar në urdhrin nr. 229, datë 25.01.2017, kthimi i paradhënies është bërë me mandat arkëtimin nr. 35, datë 16.10.2017 (rreth 9 muaj me vonesë).
- Me mandat pagesën nr. 4, datë 26.01.2017, është kryer parapagim prej 1,000 euro për B. Dh. bazuar në urdhrin nr. 229, datë 25.01.2017, kthimi i paradhënies është bërë me mandat arkëtimin nr. 36, datë 16.10.2017 (rreth 9 muaj me vonesë).
- Me mandat arkëtimin nr. 2, datë 01.03.2017, kthim paradhënie prej 1670 dollar (rreth 1 vit me vonesë).



- Me mandat arkëtimin nr. 3, datë 31.03.2017 është kthyer paradhënia prej 540 dollar (rreth 6 muaj me vonesë).

- Me mandat pagesat nr. 8, 9, 10, datë 20.03.2017, paradhënie për udhëtim jashtë shtetit në vlerë 600 euro, kthimi i paradhënies me mandat arkëtimet nr. 36, 37, 39, datë 24.08.2017 dhe 07.09.2017 (4 dhe 5 muaj me vonesë).

Pagesa me mangësi në dokumentacionin justifikues:

Me mandat arkëtimin nr. 29, datë 02.08.2017, është kthyer nga paradhënia e marrë për shërbimin jashtë vendit. Bashkëlidhur praktikës janë dokumentet justifikuese të shpenzimeve të kryera nga auditimi konstatohet se biletat e udhëtimit janë prerë nga personi udhëtues A. Q. ka prerë biletat e avionit personalisht dhe pa procedurë prokurimi, vlera e biletave është 642.98 euro.

Me mandat arkëtimin nr. 30, datë 04.08.2017, është kthyer nga paradhënia e marrë për shërbimin jashtë vendit. Bashkëlidhur praktikës janë dokumentet justifikuese të shpenzimeve të kryera nga auditimi konstatohet se biletat e udhëtimit janë prerë nga personi udhëtues L. D. ka prerë biletat e avionit personalisht dhe pa procedurë prokurimi, vlera e biletave është 324 euro.

Me mandat pagesën nr. 4, datë 13.03.2018, është kryer pagesa për shpenzime udhëtimi dhe dieta në vlerën 1,721.76 euro për A. Q. për Venecia, Trieste dhe Koper bazuar në urdhrin nr. 287, datë 26.01.2018, konstatohet se pagesa është kryer edhe për 4 bileta ($3 \times 225 \text{ euro} + 157.26 = 832.26 \text{ euro}$) në vlerën 832.06 euro për biletat e avion të cilat nuk është kryer asnjë procedurë prokurimi.

Me mandat arkëtimin nr. 31, datë 21.06.2018, M. D. ka kthyer diferencën nga paradhënia e marrë për udhëtimin në Hamburg, bashkëlidhur praktikës u konstatua se në shpenzimet e këtij udhëtimi është futur edhe pagesa e qëndrimit në hotel ne Mynih prej **135 euro**. Pagese e kryer në mënyrë të paligjshme, ky shpenzim duhet të mbulohej nga kompania e fluturimit dhe që duhet të zhdëmtohet nga M. D..

Me mandat arkëtimin nr. 32, datë 21.06.2018, I. Gj. ka kthyer diferencën nga paradhënia e marrë për udhëtimin në Hamburg, bashkëlidhur praktikës u konstatua se në shpenzimet e këtij udhëtimi është futur edhe pagesa e qëndrimit në hotel ne Mynih prej **79 euro** dhe shpenzimet për taksinë në vlerën **137.9 euro**. Pagese e kryer në mënyrë të paligjshme, ky shpenzim duhet të mbulohej nga kompania e fluturimit dhe që duhet të zhdëmtohet nga I. Gj..

Arka Lekë

Me mandat pagesën nr. 65, datë 20.05.2016, është kryer pagesa prej 8,000 lekë kundrejt E. P. për shërbimi automjeti AA438JV bazuar në autorizimin nr. 1547, datë 20.05.2016 ku citohet: “për nevoja emergjente në lidhje me shërbimin e automjetit”. ***Pa procedurë prokurimi, jo rast emergjent.*** Bashkëlidhur praktikës ka vetëm një kupon tatimor me vlerë 8,000 lekë.

Me mandat pagesën nr. 77, datë 20.06.2016, është kryer pagesa prej 2,730 lekë nga B. Sh. për kolaudimin e mjeteve bazuar në autorizimin nr. 444, datë 14.06.2016. Pagesa e kryer nga punonjësi sipas kuptonit tatimor është 06.06.2016. Nga auditimi rezulton se autorizimi ka datë pas kryerjes së pagesës.

Banka lekë

Viti 2018

Me kërkesën për transaksion datë 19.04.2018, është kryer pagesa prej 300,000 lekë ndaj operatorit O. I. shpk për ofrimin e shërbimit të kateringut për aktivitetin e datës 19-20 shkurt 2018. Pa procedure prokurimi bazuar në urdhrin nr. 781, datë 20.02.2018.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Me kërkesën për transaksion datë 07.03.2018 është kryer pagesa prej 81,950 lekë ndaj M. M. shpk për shërbim automjetesh bazuar në urdhrin nr. 665, datë 19.02.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm dhe kërkesën nr. 08, datë 15.02.2018 të Drejtorit të FSPD, ndërkohë që fatura tatimore e kryerjes së shërbimeve nr. 348, datë 01.02.2018 dhe nr. 349 datë 01.02.2018, pra urdhri i titullarit dhe kërkesa është pas kryerjes së shërbimit. Pa procedurë prokurimi.

Me kërkesën për transaksion datë 17.04.2018 është kryer pagesa prej 38,000 lekë ndaj M. M. shpk për shërbim automjetesh bazuar në urdhrin nr. 1492, datë 12.04.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm. Ky shërbim nuk është përfshirë në garancinë e mjetit. Pa procedurë prokurimi.

Me kërkesën për transaksion datë 30.03.2018 është likuiduar kamat vonesa për detyrimet ndaj Ujësjetllës kanalizime Durrës në vlerën 1,116,335 lekë për mos likuidim në kohë për detyrimin e pagesës së energjisë elektrike, më hollësisht:

Nr.	Muaji	Vlera (në lekë)
1	Shtator 2013	473,727
2	Tetor 2013	217,703
3	Janar 2017	96,600
4	Shkurt 2017	96,600
5	Prill 2017	43,470
6	Maj 2017	9,660
7	Shtator 2017	15,120
8	Dhjetor 2017	9,904
9	Janar 2018	153,550
	Totali	1,116,335

UKD me shkresën nr. 562/2, datë 26.03.2018 i ka paraqitur APD të gjithë detyrimet dhe kamat vonesat përkatëse si dhe gjendjen e pagesës së tyre në sistemin e faturimit. Mos pagesa në kohë e detyrimeve për ujin e pijshëm ka sjell penalizimin e APD me kamat vonesa në vlerë **1,116,335 lekë**.

Me formular urdhër transfertën datë 21.05.2018 është kryer pagesa 248,167 lekë për E. C., bazuar në urdhrin nr. 1699, datë 24.04.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm A. B., “Mbi kryerjen e pagesës për prezantimin e kryer nga moderatori në kuadër të projektit SUPAIR”, dhe kërkesën e Drejtorit Teknike B. V.. Me E. C. është lidhur një Marrëveshje Shërbimi nr. 1233/1, datë 13.04.2018 (në anglisht) dhe 1233/2, datë 13.04.2018 (në shqip), konstatohet se asnjë nga këto dokumente nuk është në regjistrin e protokollit të institucionit. Gjithashtu marrëveshja bazë e projektit SUPAIR nuk është nënshkruar midis APD dhe donatorit deri më datën 27.07.2018, datë në të cilën përfundoj auditimi, si dhe nuk është kryer asnjë dizburësim. **Vlera 248,167 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik** për Autoritetin Portual dhe buxhetin e Shtetit. Praktika e mësipërme është në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003, “Për Autoritetin Portual” i ndryshuar dhe Ligji nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

Me formular urdhër transfertën datë 21.06.2018 është kryer pagesa ndaj A... shpk në vlerën 317,000, bazuar në faturën tatimore nr. 5604 (62832504) datë 29.05.2018 për 4 bileta udhëtimi me avion (4*79,250 lekë). Bazuar në urdhrin e titullari nr. 2285, datë 25.05.2018 Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv A. B., ka caktuar personat që do të marrin pjesë në trajnimin e organizuar nga ESPO group në datat 31 maj - 2 qershor 2018. Përfaqësues në këtë event do të ishin:

1. A. B. – Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv
2. B. V. – Drejtor Teknik
3. Sh. I. – Sekretare e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv



4. E. C. – Moderatore Projektesh (jo në strukturën dhe organikën e APD)

Pagesa e kryer për trajnimin e E. C. është një kosto jo e ligjshme për APD, pasi nuk është punonjëse e institucionit dhe APD nuk ka pse shpenzon për trajnimin e individëve jo punonjës dhe që nuk ka asnjë tagër ligjor të përfaqësojë institucionin në evente kombëtare apo ndërkombëtare.

Me Urdhër transfertën datë 13.06.2018, është kryer pagesa prej 56,000 lekë ndaj A. L. bazuar në urdhrin nr. 2196, datë 21.05.2018. Kjo pagesë është kryer pa u zhvilluar procedura prokurimi.

Viti 2017

Me urdhër trnsafertën datë 02.10.2017, është kryer pagesa 33,000 lekë ndaj F. H. për drekë pune për 11 persona, sipas faturës nr. 03, datë 27.09.2017, bazuar në urdhrin nr. 2422, datë 29.09.2017. (urdhri i titullarin 2 dite me vonesë dhe pa procedurë prokurimi).

Me kërkesën për transfertë datë 24.11.2017, është kryer pagesa prej 144,000 lekë drejt P. shpk për shërbim katering bazuar në urdhrin nr. 2665, datë 06.11.2017, për trajnimin “Mbi zbatimin e kontrollit shtetëror të flamurit dhe kontrollit shtetëror portual”, sektori i trajnimeve ka hatuar një procesverbal ku shprehet për ecurinë e trajnimit dhe kateringut. Ky shërbim është pa procedurë prokurimi.

Me kërkesën për transaksion datë 13.09.2017, është kryer pagesa drejt A... në vlerën 49,000 lekë, për biletë udhëtimi bazuar në urdhrin e titullarit nr. 1588, datë 26.05.2017 për shërbimin në Francë në datat 29-30.06.2017, fatura tatimore e paraqitur nga operatori është nr. 1723, datë 31.07.2017 dhe mungon bileta e avionit bashkëlidhur që të tregojë vlerën e saktë të biletës. Pa procedurë prokurimi.

- Me kërkesën për transaksion datë 02.05.2017, është kryer pagesa drejt A... në vlerën 280,000 lekë, për bileta udhëtimi bazuar në urdhrin e titullarit nr. 864, datë 23.03.2017 për shërbimin në Bali në datat 6-13.05.2017, bashkëlidhur mungon bileta e avionit bashkëlidhur që të tregojë vlerën e saktë të biletës.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, “*Paradhënia shlyhet menjëherë pas mbarimit të afatit të caktuar nga nëpunësi zbatues, duke paraqitur dokumente justifikuese për shpenzimet e kryera te nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij. Kur paradhënia nuk shlyhet në afatin e caktuar, bëhet menjëherë ndalimi nga paga e punonjësit. Paradhënia tjetër nuk jepet pa u shlyer ajo që është dhënë më parë*”

Me kërkesën për transaksion datë 13.05.2017 është kryer pagesa prej 15,360,000 lekë ndaj kompanisë Th. H. shpk. Bashkëlidhur praktikës fatura tatimore nr. 636 (41181239), datë 06.03.2017, bazuar në kontratën nr. 2371, datë 22.08.2016 me objekt “Trajtimi i stafit operacional dhe menaxherial të Autoritetit Portual Durrës”, lidhur midis kontraktuesit “Th. H.” shpk, përfaqësuar nga E. Y., dhe Autoritetit Portual Durrës, përfaqësuar nga G.Sh..

Vlerë e cila ka rënduar padrejtësisht buxhetin e APD. APD nuk duhet te miratonte këtë fond qe ne planin e biznesit te vitit 2016. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 5,8, pasi Menaxhimi i Lartë, nuk ka përcaktuar qartë domosdoshmërinë e planifikimin e këtij fondi dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike etj. APD ka një sektor trajnimi të mirë strukturuar dhe të plotësuar me stafin përkatës për të cilën APD shpenzon shuma të konsiderueshme.

Për pos sa mësipër

Përfitimi i institucionin nga ky shpenzim duke investuar në kualifikimin e stafit, në kushtet kur vetëm gjatë një periudhe prej 18 muaj janë ndërprerë marrëdhëniet e punës me 124



punonjës është jo ekzistente. Për sa më sipër mban përgjegjësi Këshilli Drejtues që ka miratuar Planin e Biznesit dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv për lidhjen e kontratës dhe kryerjen e një shpenzimi të panevojshëm me pasojë **dëmin ekonomik në vlerën 15,360,000 lekë**.

Për periudhën objekt auditimi referuar llogarisë se kontabilitetit 463001 “Kreditor konflikt gjyqësor”, nga APD janë likujduar 19 rast në vlerën 132,064 mijë lekë likujdime vullnetare për vendimet gjyqësore në shkallën e par dhe të dytë, edhe pse për dy raste është bërë rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga APD, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës Tiranë dhe Avokatuar e Shtetit, para likujdimit duhet të ishte kërkuar në objektin e rekursit dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore nga zyra e përmbarimit, duke kundërshtuar në këtë mënyrë veprimet përmbarimore.

Theksojmë se në Gjykatën e Lartë janë gjithësej 58 çështje që janë në shqyrtim.

Nga te cilat: A. 37 çështje pune që priten të merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë, nga të cilat:

- në 14 raste vendimi ka qenë në favor të APDsë
- në 21 raste vendimi nuk ka qenë në favor të APD-së
- 2 raste është pranuar padia pjesërisht por dëmshpërblimet nuk janë dhënë maksimale

B. 8 çështje që priten të merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë me pale të paditur APD

- në 3 raste vendimi ka qenë në favor të APD-së në shkallën e parë të gjykimit
- në 5 raste vendimi nuk ka qenë në favor të APD-së

C. 13 çështje që priten të merren në shqyrtim nga Gjykata e Lartë me pale paditëse APD

- 4 raste vendimi në favor të APD-së
- 7 raste vendimi nuk është në favor të APD-së + 2 raste të humbur pjesërisht nga APD

Mbi prokurimet me vlera të vogla viti 2016

“Blerje e legjislacionit Financiar me fond limit 800,000 lekë”

Bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Ekonomisë, Financës dhe Administrimit ka nisur procedura e prokurimit për blerjen e legjislacionit financiar.

Komisioni i prokurimit të vlerave të vogla ka hartuar fondin limit bazuar në tre oferta 800,000 lekë, por mesatarja e tre ofertave nuk është 800,000 por 803,966 lekë duke e tejkaluar vlerën e limitit për blerje e vogla. Me Urdhrin nr. 3720 datë 29.12.2016 ka nisur procedura e prokurimit me vlera të vogla me objekt “Blerje legjislacioni financiar” me fond limit 800,000 lekë .

Ftesa për ofertë nr. 3721, datë 29.12.2016, me afat paraqitje 24 orë dhe afati i kryerjes së furnizimit është 1 ditë.

Në sistemin e APP në datën 30.12.2016 janë paraqitur :

B... 666,600 lekë
2... 754,400 lekë
G... 755,500 lekë
Sh... 760,000 lekë
E... 786,000 lekë

Etj.

Operatori i renditur i pari nuk është paraqitur. Është njoftuar operatori që është renditur i dyti “2...”, i cili në datë 05.01.2017 ka sjell libra dhe janë bërë hyrje me Fletë Hyrjen nr. 010080, datë 05.01.2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Nga verifikimi rezulton se çmimet e librave janë shumë më të lartë se çmimi i tyre referencë në treg, i cili është caktuar nga vetë autorët e librave si dhe 3 nga librat nuk janë sjellë pasi asnjë nga punonjësit që i ka tërhequr këto libra nga magazina nuk i ka.

Titulli i Libri	Sasia sipas prokurimit	çmimi pa TVSH	çmimi me TVSH	Totali i likuiduar	sasia e ardhur	çmimi reference tregu me TVSH	Totali	Diferenca
Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Raportimit Financiar	8	4,500	5,400	43,200	-		-	(43,200)
Standardet Ndërkombëtare të Auditimit	8	4,800	5,760	46,080	-		-	(46,080)
Standardet Kombëtare të kontabilitetit të përmirësuar	8	6,500	7,800	62,400	8	2,200	17,600	(44,800)
Lista e Llogarive	8	4,200	5,040	40,320	8	500	4,000	(36,320)
Legjislacioni dhe Administrimi Tatimor e Tregtar i Biznesit	8	8,500	10,200	81,600	8	1,000	8,000	(73,600)
Legjislacioni Tatimor Kombëtar dhe Ndërkombëtar	8	9,500	11,400	91,200	8	1,200	9,600	(81,600)
Kontabiliteti i Drejtimit i Avancuar	8	4,450	5,340	42,720	8	1,000	8,000	(34,720)
Kontabiliteti Financiar i Avancuar	8	8,200	9,840	78,720	8	1,500	12,000	(66,720)
Drejtim Risku	8	7,500	9,000	72,000	8	2,000	16,000	(56,000)
Organizimi i Sistemit të Kontrollit Kontabël	8	9,800	11,760	94,080	8	1,500	12,000	(82,080)
Analiza e Pasqyrave Financiare	8	9,600	11,520	92,160	8	1,000	8,000	(84,160)
Administrimi dhe Rregullimi Fiskal	8	7,250	8,700	69,600	-		-	(69,600)
Auditimi i PF dhe Shërbimet e Sigurisë dhe të Konsulencës	8	9,500	11,400	91,200	8	1,300	10,400	(80,800)
Totali				905,280			105,600	(799,680)

Nga auditimi i procedurës me blerja me vlera të vogla “Blerje e legjislacionit Financiar” me fond limit 800,000 lekë me fitues operatorin e renditur të dytë “2...” me ofertë 754,400 lekë pa TVSH, rezulton se çmimet e librave janë shumë herë më të lartë se çmimi i tyre referencë në treg, i cili është caktuar nga vetë autorët e librave si dhe 3 nga librat nuk janë dorëzuar në APD. Grupi i auditimit ka bërë diferencën midis vlerës së faturuar dhe çmimit real të librave dhe rezulton se shoqëria “2...” ka përfituar pa të drejtë vlerën 799,680 lekë me TVSH (905,280 lekë – 105,600 lekë) dhe për pasojë i ka shkatuar APD-së dhe buxhetit të shtetit dëm ekonomik.

Legjislacioni financiar është kontabilizuar në llogarinë e mallrave të konsumit dhe jo në llogarinë e inventarit në përdorim dhe nuk janë në inventarin personal të punonjësve që i kanë tërhequr nga magazina.



“Dekori i APD-së me rastin e festave të fund vitit” me fond 800,000 lekë

Bazuar në kërkesën nr.3439 prot, date 12.12.2016 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore dhe Promocionit ka nisur procedura për testimin e tregut për blerje dekori për festa.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka testuar tregun duke marrë dy oferta mesatarja e të cilave është 978,682 lekë vlerë e cila tejkalon limitin e prokurimit me vlera të vogla dhe komisioni ka vendosur vlerën 800,000 lekë.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 3467, datë 12.12.2016, me fond limit 800,000 lekë. Me ftesën për ofertë datë 3468, datë 12.12.2016 dhe me afat 1 ditë.

Në sistemin e APP në datën 15.12.2016 janë paraqitur :

2 ...	679,800 lekë
A...	689,000 lekë
A...	698,333 lekë
D...	699,000 lekë
A...	745,850 lekë

Etj.

Në datë 15.12.2016 operatori i renditur i pari është paraqitur dhe ka sjell mallrat të shoqëruara me faturë nr.829 (23126129) datë 15.12.2016 me vlerë 679,800 lekë pa TVSh dhe 815,760 me TVSH dhe janë bërë hyrje në datën 15.12.2016 me fletë hyrjen nr. 0100068. Në datë 16.12.2016 këto materiale i janë bërë dalje A. N..

Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla **“Dekori i APD-së me rastin e festave të fund vitit”**, viti 2016 me fond 800,000 lekë , u konstatua se operatori që është renditur i pari “2...” shpk me ofertë 679,800 lekë pa TVSH është paraqitur i cili ka sjell mallrat për të cilat nuk vërtetohet se janë ato të kërkuara.

“Blerje Skedë Kontrolli me SN:CUVC 6SE7090-0XX84-0AB0” me fond limit 800,000 lekë

Bazuar në kërkesën nr.54 prot, date 21.12.2016 të Përgjegjësit SMT D. D. dhe Drejtori i Zhvillimit A. D..

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka testuar tregun duke marrë dy oferta mesatarja e të cilave është 817,000 lekë vlerë e cila tejkalon limitin e prokurimit me vlera të vogla dhe komisioni ka vendosur vlerën 800,000 lekë.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 3716, datë 29.12.2016, me fond limit 800,000 lekë. Me ftesën për ofertë datë 3717, datë 29.12.2016 dhe me afat date 30.12.2016, ora 12:00.

Në sistemin e APP në datën 30.12.2016 janë paraqitur :

A...	667,000 lekë
B...	732,999 lekë
2...	734,400 lekë
J...	749,995 lekë
Sh...	749,995 lekë

Etj.

Operatori i renditur i pari nuk është paraqitur. Është njoftuar operatori që është renditur i dyti 2, B... i cili në datë 05.01.2017 ka sjell mallin me faturën tatimore 28 (32899178), datë 05.01.2017 me vlerë 878,400 me TVSH dhe janë bërë hyrje me Fletë Hyrjen nr. 010081, datë 05.01.2017. Në datë 11.01.2017 skeda është bërë dalje nga magazina nga I. B. dhe A. C..

Nga hulumtimi në internet për vlerën e tregut të pajisjes konstatohet se:

<https://www.nexinstrument.com/6SE7090-0XX84-0AB0>

ebay
ebay

1205 dollar
760 dollar
609 dollar



Grupi i auditimit po merr si çmim reference çmimin më të lartë që konstatuam 1205 dollar (129,537 lekë). Vlera 748,863 lekë (878,400 – 129,537) përbën dëm ekonomik.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla **“Blerje Skedë Kontrolli me SN:CUVC 6SE7090-0XX84-0AB0” me fond limit 800,000 lekë, viti 2017.** Operatori i renditur i pari nuk është paraqitur. Është njoftuar operatori që është renditur i dyti, B... i cili në datë 05.01.2017 ka sjell skedën e kontrollit shoqëruar me faturën tatimore 28 (32899178), datë 05.01.2017 me vlerë 878,400 lekë me TVSH dhe është bërë hyrje me Fletë Hyrjen nr. 010081, datë 05.01.2017. Nga hulumtimi në internet për vlerën e tregut të pajisjes konstatohet se: kjo pajisje gjendet me çmimet 1205 dollar, 760 dollar, 609 dollar. Grupi i auditimit po merr si çmim reference çmimin më të lartë të konstatuar 1205 dollar (129,537 lekë). **Vlera 748,863 lekë** (878,400 – 129,537) përbën dëm ekonomik për APD dhe buxhetin e shtetit.

“Rinovim i panelit automatik të komandimit, i kompletuar për gjeneratorin 650 kWA” me fond 800,000 lekë

Bazuar në kërkesën nr.50 prot, date 13.12.2016 të Përgjegjësi i SMT B. D. dhe Drejtorit të Zhvillimit A. D. ka nisur procedura për testimin e tregut për rinovim i panelit të komandimit, i kompletuar për gjeneratorin 650 kWa.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka testuar tregun duke marrë tre oferta mesatarja e të cilave është 978,682 lekë vlerë e cila tejkalon limitin e prokurimit me vlera të vogla dhe komisioni ka vendosur vlerën 800,000 lekë.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 3718, datë 29.12.2016, me fond limit 800,000 lekë. Me ftesën për ofertë nr.3719, datë 29.12.2016 dhe me afat 1 ditë.

Në sistemin e APP në datën 30.12.2016 janë paraqitur :

E...	588,888 lekë
A...	692,000 lekë
V...	695,000 lekë
B...	733,700 lekë
E...	735,900 lekë

Etj.

Pas mosparaqitjes së operatorit të renditur të parë NJP i është drejtuar A... me ofertë 692,000 lekë, i cili është paraqitur date 05.01.2017 dhe ka kryer shërbimin e kërkuar. Grupi i monitorimit i ngritur me urdhrin nr. 3718/1 prot. datë 29.12.2016, ka verifikuar shërbimet e kryera. Nga verifikimi i kryer në sistemin myServer nuk rezulton të jetë hapur urdhër pune për defekt të gjeneratorit 650 kWA apo riparim të tij qoftë në datën kur është bërë kërkesa e as në datën e riparimit, kur është hartuar akt-pranimi i kryerjes së shërbimit nga grupi i monitorimit.

“Përmirësimi dhe përditësimi i aplikacionit për telefona celularë “Smart transport Albania” me fond 800,000 lekë

Me kërkesën e Ministrisë nr. 2066, datë 26.07.2016 “Për mbështetje për përditësimin e aplikacionit “Smart Transport Albania””, bashkë me specifikimet përkatëse dhe miratimin nga Këshilli Drejtues me Vendimin nr. 19, datë 29.07.2016, komisioni i blerjeve të vogla ka nisur procedurën e testimit të tregut.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka testuar tregun duke marrë dy oferta mesatarja e të cilave është 875,000 lekë vlerë e cila tejkalon limitin e prokurimit me vlera të vogla dhe komisioni ka vendosur vlerën 800,000 lekë.



Me Urdhrin e Prokurimit nr. 3672, datë 22.12.2016, me fond limit 800,000 lekë. Me ftesën për ofertë nr. 3772/1, datë 22.12.2016 dhe me afat 1 ditë.

Me urdhrin nr. 3672/2, date 22.12.2016, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave sipas ftesës për ofertë, përbër nga: V. H., S. K. dhe V. B..

Në sistemin e APP në datën 23.12.2016 janë paraqitur :

A...	690,000 lekë
O...	782,827 lekë
F...	732,000 lekë
S...	750,000 lekë
S...	750,020 lekë

Etj.

Është paraqitur dhe ka filluar kryerjen e shërbimit operatori i renditur i pari A... me ofertë 690,000 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “Përmirësimi dhe përditësimi i aplikacionit për telefona celularë “Smart Transport Albania”” me fond 800,000 lekë, u konstatua se operatori i renditur i pari A... me ofertë 690,000 lekë është paraqitur për të ofruar ndërtimin e aplikacionit. Me Akt-Pranimin nr.1 datë 28.12.2016, komisioni ka vlerësuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori dhe metodologjinë e hartimit të aplikacionit bashkë me specifikimet. Me Akt-Pranimin nr.2 komisioni ka pranuar aplikacionin dhe të faturës së shërbimit nr.7899367, date 28.02.2017, me vlerë 690,000 lekë. Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit rezulton se aplikacioni në APP store nuk ekziston në kundërshtim me specifikimet e kërkuara që duhet edhe për sistemet OI’s. Aplikacioni u gjet vetëm për sistemet smart phone u shkarkua dhe rezultoi jo funksional.

Vlera prej 690,000 lekë përbën dëm ekonomik i shkaktuar nga mos realizimi i objektit të prokurimit dhe duhet të zhdëmtohet nga A....

“Blerje dhurata për festat e fundvitit” me fond 800,000 lekë

Me kërkesën nr. 601, datë 19.12.2016 të Drejtorit të Burimeve Njerëzore z. A. K. për blerjen e dhuratave të fund vitit, komisioni i prokurimit me vlera të vogla ka testuar tregun duke marrë tre oferta mesatarja e të cilave është 890,000 lekë vlerë e cila tejkalon limitin e prokurimit me vlera të vogla dhe komisioni ka vendosur vlerën 800,000 lekë.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 3620, datë 19.12.2016, me fond limit 800,000 lekë. Me ftesën për ofertë nr. 3620/1, datë 19.12.2016 dhe me afat 1 ditë.

Në sistemin e APP në datën 20.12.2016 janë paraqitur :

B...	589,000 lekë
2...	699,900 lekë
I...	779,990 lekë

Etj.

Pas mosparaqitjes së operatorit të renditur të pare komisioni i është drejtuar operatorit të dytë 2..., i cili ka sjell mallrat e kërkuar dhe janë bërë hyrje në 22.12.2016 dhe dalje po në 22.12.2016 A. N., përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore.

Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “Blerje dhurata për festat e fundvitit” me fond 800,000 lekë u konstatua se operatori që është renditur i parë nuk është paraqitur, komisioni i është drejtuar operatorit të dytë “2...” shpk me ofertë 699,900 lekë, i cili ka sjell mallrat për të cilat nuk vërtetohet se janë ato të kërkuara.

Vlera **839,880 lekë me TVSH** është përfitimin i padrejtë, nga operatorit “2...” shpk pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion **nuk provohet janë sjell mallrat e kërkuar dhe APD ka shpenzuar.**



“Blerje furnizim vendosje material auto-fener volvo xc60” me fond limit 104,000 lekë

Bazuar në kërkesën datë 23.04.2018 të drejtuesit të automjetit dhe kërkesës nr. 393, datë 25.04.2018, të Drejtorit Teknik ka nisur procedura e prokurimit me vlera të vogla në zërin blerje materiale auto. Bazuar në këtë teknik komisioni i prokurimit të vlerave të vogla datë 26.04.2018 ka testuar tregun me tre oferta:

D... 103,900 lekë
2... 104,430 lekë
A... 109,500 lekë

Fondi limit është llogaritur 104,000 lekë.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1770, datë 26.04.2018, me objekt “Blerje furnizim vendosje material auto-fener volvo xc60” me fond limit 104,000 lekë.

Ftesa për ofertë nr. 1770/1, datë 26.04.2018, me afat kryerje furnizimi 1 ditë dhe afat kryerje instalimi 24 orë.

Në sistemin elektronik në datë 27.04.2018 janë paraqitur:

A... 79,000 lekë
T... 104,000 lekë
2... 97,700 lekë
B... 97,500 lekë
O... 100,000 lekë
S... 777,777 lekë

Operatori S... është skualifikuar pasi oferta e tij është mbi fondin limit.

Është njoftuar operatori A... i cili nuk është paraqitur pas 24 orëve. Më pas është kaluar tek operatori i renditur i dyti B..., i cili ka njoftuar që nuk do paraqitet.

Më pas është vazhduar me operatorin “2...” me ofertë 97,700 lekë pa TVSH.

Mallrat e kërkuar janë paraqitur në datë 03.05.2018, shoqëruar me faturën tatimore nr. 40 (47301590), datë 03.05.2018 dhe janë bërë hyrje në magazinë datë 03.05.2018 me Fletë hyrjen nr. 0100183. Likuidimi është kryer me Formular Urdhër Transferte R. Bank në datë 10.05.2018.

Nga auditimi kësaj procedure konstatohet se ka një ndryshim midis objektit të prokurimit i cili është furnizim dhe vendosje dhe realizimit që është vetëm furnizim, i cili ka denaturuar procedurën dhe ka ulur konkurrencën. Gjithashtu në kërkesën e lindjes së nevojës nuk janë përcaktuar rrethanat në të cilat ndodhi situatë dhe a mbulohet nga siguracioni i automjetit. Vlera prej 117,240 lekë me TVSH përbën dëm ekonomik pasi nuk sqarohen rrethanat e ndodhjes së defektit dhe fakti që automjeti është në periudhë garancie. Ky automjet me targë AA896RK përdoret nga A. B., Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv.

“Heqjen e dy Pilotave në basenin e Portit” me fond limit 785,000 lekë.

Bazuar në kërkesën nr. 363/1, datë 21.05.2018 të Drejtorit Teknik ka nisur procedura e prokurimit për realizimin e heqjes së dy pilotave në basenin e Portit, me afat 8 ditë.

Operatori duhet të plotësoj kriteret:

- Eskavator 120 ton
- Ponton
- Grifer

Operatori duhet të paraqes:

- Metodologjinë e punimeve
- Dokumentet përkatëse të makinerive

Komisioni i prokurimit të vlerave të vogla i është drejtuar 1 operatori nëpërmjet email-it duke e njoftuar edhe për specifikimet përkatëse dhe po nëpërmjet email-it operatori ka paraqitur



ofertën e vet në vlerën 785,000 lekë duke denaturuar procesin e llogaritjes së fondit limit në kuptimin e LPP. Komisioni ka hartuar procesverbalin e fondit limit datë 18.04.2018 duke vendosur fondin limit 785,000 lekë. (bazuar në kërkesën dhe ofertën e marrë për po këtë procedurë por që është anuluar)

Me Urdhrin nr. 2197, datë 21.05.2018 ka nisur procedura e prokurimit me vlera të vogla me objekt “Heqjen e dy pilotave ne basenin e Portit” me fond limit 785,000 lekë .

Ftesa për ofertë nr. 2198, datë 21.05.2018, me afat paraqitje 24 orë dhe kryerje punimesh 8 ditë. Në ftesën për ofertë vendosur edhe pajisjet dhe makineritë e nevojshme për realizimin e procedurës, data e zhvillimit është 22.05.2018.

Në sistemin e APP në datën 22.05.2018 janë paraqitur :

T...	785,000 lekë
F...	777,777 lekë
Sh...	785,000 lekë
O...	785,000 lekë
A...	777,770 lekë
D...	699,999 lekë
“R...	784,000 lekë

Komisioni i prpkurimit të vlerave të vogla ka skualifikuar

T...	785,000 lekë
F...	777,777 lekë
Sh...	785,000 lekë
O...	785,000 lekë

Me arsyen se në ekstraktin e tyre nuk e kanë objektin e prokurimit në fushën e veprimtarisë.

Dhe janë kualifikuar operatorët:

A...	777,770 lekë
D...	699,999 lekë
“R...	784,000 lekë

Në datë 22.05.2018 dhe 23.05.2018 janë njoftuar respektivisht operatorët dhe kanë njoftuar tërheqjen nga procedura.

Në datë 24.05.2018 është njoftuar operatori “R...”, i cili në datë 25.05.2018 ka sjellë në protokollin e institucionit nr. 2268, datë 25.05.2018 dokumentacionin e kërkuar për procedurën.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 2199, datë 21.05.2018 titullari i institucionit ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim të punimeve të përbërë nga:

1. R. R.
2. Gj. K.
3. T. S.

Ky komision ka për detyrë:

- të konfirmojë paraqitjen e operatorit fitues dhe konfirmimin e dokumentacionit të dorëzuar në përputhje me ftesën për ofertë.
- monitorimin dhe konfirmimin e kryerjes se punimeve kërkesës për ofertë.

Komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin dhe me procesverbalin nr. 506, datë 28.05.2018 është shprehur se subjekti ka paraqitur dokumentacionin e duhur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionin rezulton se operatori ka paraqitur:

- metodologjinë e punimeve,
- regjistrimin e një mjeti Proton,
- protokollin e provave për këtë mjet me datë 24.03.2017,
- dëshmi për të drejtën e lundrimit me flamur shqiptar



- dëshmi pronësie anijeje.

Nga auditimi u konstatua se dokumenti i protokollit të provave nuk është i vlefshëm pasi ka skaduar në datë 24.03.2018 dhe parametrat teknike të treguara në këto teste nuk janë të sakta dhe nuk përputhen me parametrat teknik të kërkuar në ftesën për ofertë.

Gjithashtu konstatohet se në ftesën për ofertë është kërkuar eskavator 120 ton dhe Grifer për të cilat operatori nuk ka sjell asnjë dokumentacion që disponon këto pajisje.

Në datë 31.05.2018 operatori “R...” ka paraqitur njoftimin e përfundimit të shërbimit të protokolluar në APD me nr. 2382, datë 31.05.2018, ku deklaroi se e ka përfunduar shërbimin në datë 28.05.2018.

Grupi i marrjes në dorëzim me procesverbalin nr. 2199/2, datë 04.06.2018 shprehet se pas njohjes me njoftimin e përfundimit të punimeve dhe konstaton deklaratat e shprehura nga operatori për përfundimin e shërbimit si dhe fotove të paraqitura nga subjekti dhe nuk shprehet nëse ka monitoruar punimet dhe të konfirmojë punimet e kryera. Nga operatori është paraqitur fatura tatimore nr. 06 (31709957), datë 05.06.2018. Kjo faturë është likuiduar me urdhër transfertën C. Bank datë 07.06.2018.

“Blerje Mobilie për Zyre” me fond limit 450,000 lekë.

Bazuar në kërkesën nr. 449, datë 10.05.2018 të Drejtorit të Auditit, kërkesën nr. 430 datë 10.05.2018 të përgjegjësit të sektorit të prokurimeve dhe kërkesës nr. 110/1, datë 09.05.2018 të Drejtorit të Forcave të Sigurisë ka nisur procedura e prokurimit për blerjen e mobileve të zyrave.

Komisioni i prokurimit të vlerave të vogla ka hartuar fondin limit bazuar në tre oferta 450,000 lekë.

Me Urdhrin nr. 2076, datë 10.05.2018 ka nisur procedura e prokurimit me vlera të vogla me objekt “Blerje Mobilie për Zyra” me fond limit 450,000 lekë .

Ftesa për ofertë nr. 2077, datë 10.05.2018, me afat paraqitje 24 orë dhe afati i kryerjes së furnizimit është 1 ditë, data e zhvillimit është 11.05.2018.

Në sistemin e APP në datën 21.05.2018 janë paraqitur :

2...	398,800 lekë
P...	394,000 lekë
S...	385,560 lekë

Operatori i renditur i pari është paraqitur dhe është tërhequr pa filluar zbatimin e kontratës.

Në datë 16.05.2018 është njoftuar operatori i renditur i dyti, i cili nuk është paraqitur.

Më pas është njoftuar operatori i renditur i treti “2...”.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 2084, datë 10.05.2018 titullari i institucionit ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim mallrave të përbërë nga:

1. Sh. Xh.
2. D. K.
3. M. K.

Ky komision ka për detyrë:

- Të marrë në dorëzim mallrat konform specifikimeve teknike të ftesës për ofertë.

Furnizimi është shoqëruar me faturën tatimore nr. 42 (47301592), datë 21.05.2018. Me procesverbalin nr. 2160/1, datë 21.05.2018 komisioni deklaroi se mobilet janë në përputhje të plotë me kërkesat e shprehura në ftesën për ofertë. Mobilet janë bërë hyrje në magazinë datë 21.05.2018 me fletë – hyrjen nr. 0400519. Kjo faturë është likuiduar me urdhër transfertën R. Bank datë 30.05.2018.



Nga verifikimi fizik në magazinë u konstatua se disa nga mobilet nuk ishin tërhequr nga personat të cilët kishin bërë kërkesën. Nga grupi i auditimit u konstatua se 2 nga mobilet nuk plotëson specifikimet e vendosura në ftesën për ofertë, konkretisht:

1. Dollap druri me kanata xhami (minimum 4 kanata) me vlerë 30,300 lekë
2. Tavolinë mbledhjeje ovale, me vlerë 125,000 lekë

Vlera prej **155,300 lekë** përbën dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga operatori “2...”.

“Rrethim i zonës së Interklubit” me fond limit 785,000 lekë.

Bazuar në kërkesën nr. 270, datë 26.03.2018 të Drejtorit Teknik L. B. dhe Përgjegjës të Sektorit të Zhvillimit dhe Infrastrukturës R. R. ka nisur procedura e rrethimit të zonës së Interklubit.

Komisioni i prokurimit të vlerave të vogla ka hartuar fondin limit 785,000 lekë bazuar në një ofertë të marrë.

Me Urdhrin nr. 1283 datë 30.03.2018 ka nisur procedura e prokurimit me vlera të vogla me objekt “Rrethimi i zonës së Interklubit” me fond limit 785,000 lekë .

Ftesa për ofertë nr. 1285, datë 30.03.2018, me afat paraqitje 24 orë dhe afati i kryerjes së furnizimit është 10 ditë, si dhe gjithë specifikimet përkatëse për materialet e rrethimit.

Në sistemin e APP në datën 03.04.2018 janë paraqitur 12 operator:

H...	677,000 lekë
Th...	680,000 lekë
Dh...	689,000 lekë
A...	695,100 lekë
E...	735,900 lekë
M...	760,000 lekë

5 operatorët e renditur të parët është janë tërhequr pa filluar zbatimin e kontratës. Në datë 08.05.2018 është njoftuar operatori i renditur i gjashti, i cili është paraqitur dhe me të cilin ka vazhduar dhe realizimi i shërbimit.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 1402, datë 03.04.2018 titullari i institucionit ka ngritur komisionin e marrjes në dorëzim mallrave të përbërë nga:

1. R. R.
2. Gj. K.
3. T. S.

Ky komision ka për detyrë:

- Vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga ana e operatorit të shpallur fitues
- Monitorimin e kontratës dhe marrjen në dorëzim të shërbimit të mësipërm.

Komisioni i marrjes në dorëzim ka hartuar Procesverbalin nr. 1402/1, datë 07.05.2018 ku shprehet se bazohet në njoftimet e ardhura në protokoll të institucionit për datat e fillimit dhe përfundimit të punimeve dhe konstaton se rrethimi është konform specifikimeve.

Shërbimi është shoqëruar me faturën tatimore nr. 310 (59963454), datë 08.05.2018.

Nga verifikimi fizik i rrethimit në zonën e Interklubit u konstatua se në rrethimin e Interklubit ka të stampuar logon e subjektit privat që operon në ambientet e Interklubit, specifikim ky i cili nuk është në ftesën për ofertë, duke shërbyer si promocion i subjektit privat dhe jo i vet APD.

“Blerje pjesë këmbimi dhe elektronike për elektrivinça”, me fond limit 600,000 lekë

Me kërkesën nr. 318, datë 06.04.2018, të paraqitur nga A. K., me detyrë Përgjegjës Sektorit Operativ i Mirëmbajtjes Teknike dhe miratuar nga L. B., me detyrë Drejtor Teknik, i është kërkuar E. J., me detyrë Drejtor Juridik, blerja e një adaptor profibus me specifikimet



përkatëse bazuar në planin e blerjeve, me referencë 17, në zërin “Blerje pjesë këmbimi dhe elektronike për elektrivinça”, me afat lëvrimi 7 ditë.

Komisioni i prokurimit me vlera të vogla, ngritur me urdhrin nr. 1163, datë 16.03.2018, i përbër nga:

1. I. Gj.
2. D. G.
3. J. R.

ka testuar tregun duke marrë dy oferta

1. I... 600,000 lekë
2. A... 611,000 lekë

dhe me procesverbalin nr. 0112, datë 02.05.2018, ka hartuar fondim limit bazuar në cmimin më të ulët, në vlerën 600,000 lekë.

Me Urdhër Prokurimin nr. 1868, date 02.05.2018 ka nisur procedura e prokurimit me vlera të vogla për:

1. Adaptor Profibus 1 copë, me fond limit 600,000 lekë

Ftesa për ofertë nr. 1869, date 02.05.2016, me afat kryerje së furnizimit 7 ditë, dhe operatori duhet të paraqitet brenda 24 orëve. Data e zhvillimit të tenderit ka qenë 03.05.2018, ora 13:00.

Nga Procesverbali Përmbledhës i printuar nga sistemi i APP rezulton se procedura e tenderit është hapur në orën përkatëse dhe se në procedurë i shin paraqitur 11 operatorë ekonomik me oferta si më poshtë:

1. 2... 519,800
2. D... 588,000
3. S... 589,900
4. M... 558,000
5. P... 599,500
6. Sh... 599,999
7. R... 590,000
8. D... 595,000
9. E... 590,000
10. S... 578,900
11. T... 53,500

Rezulton se Komsioni ka skualifikuar operatorët:

1. S... 589,900
2. M... 558,000
3. E... 590,000
4. T... 53,500

me arsyen se nuk e kanë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Nga verifikimi në sistemin e QKB për operatorin T... me Nip-t L01410504A, rezulton se: *“Oficinë për riparimin e mjeteve lundruese, prodhim, instalim, montim, impiante të reja mekanike, elektrike dhe elektronike në mjetet lundruese si dhe shërbimet e lidhura me to, agjensi detare, spedicioni, transporti, çdo lloj aktiviteti financiar, tregtar, industrial, ndërtimi si dhe import - eksport. Shitje mjeteve transporti rrugor, detar, dhe hekurudhor. Riparimin e mjeteve të transportit rrugor dhe hekurudhor, shitje pjesesh këmbimi, instalim, montim, impiante të reja mekanike, elektrike dhe elektronike dhe shërbimet e lidhuara me to. Furnizimi i të gjitha tipeve të mjeteve detare (ship chandler) sikurse: anije peshkimi, jahte dhe anije tregtare (mallrash), ushtarake dhe shteterore me të gjitha llojet e artikujve: ushqimore, pjese këmbimi për to, industriale, naftë, vaj, karburant, ujë, pije alkolike, cigare,*



etj. Tregtim, shërbim dhe riparime të: hidrovore e stacione pompimi, makineri e pajisje që perdoren në miniera, në aeroporte, në industrinë e nxjerrjes së naftës, tregtim artikuj të ndryshëm industrial si: instrumenta e vegla pune, kushineta, elektroda, artikuj prej çeliku, gize, bakri, alumini, si tubo, llamarinë, profile. Tregtimi i artikujve prej druri, kompesate, fibra të ndryshëm, artikuj të gomuar si: goma, rripa, permistopa ,etj. Tregtimi i games së kimikateve, artikujve të sektorit të derdhjes së gjithë metaleve dhe materialeve ndihmese që perdoren në fonderi si: karbit, betonit, solucioneve antikorozive, rere kuarcore, etj.”

Skualifikimi i kryer nga KVO është i padrejtë dhe duke zbatuar standard të dyfishtë në kundërshtim me LPP.

Në datën 03.05.2018 Operatori Ekonomik i renditur i pari ka paraqitur deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike, ky dokument nuk përmban numrin e protokollit të APD për të vërtetuar se kur është dorëzuar në APD ky dokument dhe nëse është zbatuar afati 24 orë i vendosur në ftesën për ofertë.

Bazuar në urdhrin nr. 1953, datë 04.05.2018 është përcaktuar grupi i marrjes në dorëzim:

1. A. C., Specialist SMT
2. A. C., Specialist SMT
3. A. K., Specialist SMT

Operatori Ekonomik ka paraqitur në datën 07.05.2018, mallin shoqëruar me faturën nr. 41, datë 07.05.2018, fletën e grancisë për 12 muaj dhe të dhënat teknike të skedës. Asnjë nga dokumentet nuk përmban numrin e protokollit të APD për të vërtetuar se kur është dorëzuar në APD.

Grupi i marrjes në dorëzim ka hartuar procesverbalin e marrjes në dorëzim në datë 08.05.2018, ku komisioni shprehet: “Nga kontrolli i kryer rezultoi se artikulli është në përputhje me specifikimet teknike dhe kriteret e përcaktuara në ftesën për ofertë të shoqëruara me Deklaratë mbi Përmbushjen e Specifikimeve Teknike, Të Dhënat Teknike të Pajisjes dhe Deklaratë Garancie” (komisioni nuk ka testuar mallin por ka krahasuar specifikimet e ftesës për ofertë me Të Dhënat Teknike të Skedës, të cilat janë deklaruar nga vetë operatori ekonomik).

Malli është bërë hyrje në magazinën e APD datë 07.05.2018, me Fletë Hyrjen 0100185, pra para se të malli të merret në dorëzim dhe të shihet plotësimi i kriterëve të vendosura në ftesën për ofertë nga grupi i marrjes në dorëzim.

Me Formular Urdhër Transfertën datë 10.05.2018 është kryer pagesa prej 623,760 lekë kundrejt operatorit “2...”, bazuar në faturën tatimore nr. 41, datë 07.05.2018, me numër serie 47301591, me vlerë 519800 lekë pa TVSh dhe 623,760 lekë me TVSH.

Si përfundim: Nga auditimi i procedurës së prokurimit blerje me vlera të vogla “Blerje pjesë këmbimi dhe elektronike për elektrivinça”, Adaptor Profibus 1 copë, me fond limit 600,000 lekë u konstatua se pas skualifikimit të operatorit me ofertë më të ulët si pasojë e mangësive në fushën e veprimtimit në Ekstraktin e QKR është vazhduar me operatorin e renditur të dytin “2...” shpk me ofertë 519,800 lekë pa TVSH. Në datën 03.05.2018 Operatori Ekonomik i renditur i pari ka paraqitur deklaratën e përmbushjes së specifikimeve teknike, ky dokument nuk përmban numrin e protokollit të APD për të vërtetuar se kur është dorëzuar në APD dhe nëse është zbatuar afati 24 orë i vendosur në ftesën për ofertë.

Me urdher transfertën datë 10.05.2018 është kryer pagesa prej 623,760 lekë me TVSH kundrejt operatorit “2...”, bazuar në faturën tatimore nr. 41, datë 07.05.2018, me numër serie 47301591. Nga hulumtimi në internet për vlerën e tregut të pajisjes konstatohet se: kjo pajisje gjendet për çmimin 150 euro (18,750 lekë). **Vlera 605,010 lekë** (605,010 – 18,750) përbën dëm ekonomik.



Shpenzimet telefonike

Me Vendimin nr. 6, date 02.03.2015 te Këshillit Drejtues te APD janë vendosur kategoritë qe përfitojnë pagese mbulimi te shpenzimeve telefonike:

- Kryetari Keshillit Drejtues ne vlerën 15,000 lekë
- Zv Kryetari i Keshillit Drejtues ne vlerën 15,000 lekë
- Drejtori i Pergjithshem Ekzekutiv ne vlerën 15,000 lekë
- 2 Zv Drejtoret e Pergjithshem ne vlerën 10,000 lekë
- Sekretares se Keshillit Drejtues ne vlerën 10,000 lekë

Nga auditimi konstatohet se këto limite janë respektuar dhe për diferencat ne tejkalimin e këtij limiti janë rimbursuar nga personat qe mbajnë postet përkatëse.

Autoriteti Portual Durrës ka lidhur marrëveshje me kompaninë V... datë 20.04.2014, për Autoritetin Portual Durrës S. B. dhe për V... , Ch. B., nëpërmjet të cilës punonjësit e Autoriteti Portual Durrës jane pajisur me numer telefon celular me parapagim, me afat deri ne 19.04.2017. Deri ne fund te periudhes se auditimit kjo marreveshje ka ndryshuar 8 herë:

Amendimi nr. 1, date 30.05.2014, për Autoritetin Portual Durrës S. B. dhe për V...Sh.A Ch. B. nepermjet te ciles eshte ndryshuar tarifa e pajtimit mujor.

Amendimi nr.2, date, Autoritetin Portual Durrës S. B. dhe për V... Sh.A Ch. B.

Amendimi nr.3, date 19.06.2014, Autoritetin Portual Durres S. B. dhe per V... Sh.A Ch. B., nepermjet te ciles Autoritetit Portual Durres I jane oferuar nga kompnia V... Sh.A:

4 aparate iPhone 5s me vlere 95,650 leke/copa,

13 aparate Samsung Galaxy s5 me vlere 88,100 leke/copa,

Vlera 1 = $4 * 95,650 + 13 * 88,100 = 382,600 + 1,145,300 = \mathbf{1,527,900 \text{ leke}}$

Amendimi nr. 4, date 23.06.2014, për Autoritetin Portual Durrës S. B. dhe per V... Sh.A Ch. B., i janë ofruar pajtmitarit APD:

1 aparat iPhone 5s me vlere 95,650 leke

2 aparate Samsung GalaxyS5 me vlere 88,100 leke/copa

Vlera 2 = $95,650 + 2 * 88,100 = \mathbf{271,850 \text{ leke}}$

Amendimi nr. 5 date 22.12.2014, Autoritetin Portual Durrës S. B. dhe per V...Sh.A E. L., APD i janë ofruar 2 aparate:

1 aparat iPhone 6 me vlere 95,400 leke

1 aparat iPhone 6+ me vlere 114,200 leke

Vlera 3 = $95,400 + 114,200 = \mathbf{209,600 \text{ leke}}$

Amendament nr.6 date 16.03.2015, Autoritetin Portual Durres B. Dh. dhe per V.. Sh.A E. L., APD i eshte ofruar 1 aparat

1 aparat Samsung Galaxy s5 me vlere **88,100 leke**

Amendament nr. 7, date 25.09.2015 Autoritetin Portual Durres G. Sh. dhe per V... Sh.A E. L. eshte ofruar nje aparat celular

1 aparat iphone 6 me vlere **95,400 leke**

Amendamenti nr. 8, date 05.01.2017, Autoritetin Portual Durres A. L. dhe per V... Sh.A E. L., nepermjet kesaj marrevshje jane ndryshuar disa pika te marrevshjes, afati i vlefshmerise se saj eshte deri ne 19.04.2019 dhe APD i eshte ofruar shuma prej 600,000 leke per te marre telefona celular.

Me faturen tatimore nr. 3555 (nr. Series 216870013) date 04.04.2017 V... Sh.A i ka ofruar APD 3 aparate:

1 aparat Samsung GLX S7 Edge me vlere 104,900 leke

1 aparat iPhone 7+ 128GB me vlere 132,900 leke

1 aparat iPhone 7+ 64GB me vlere 118,900 leke

Vlera **356,700 leke**



Me faturen tatimore nr. 3666 (nr. Series 216870124) date 06.04.2017 V... Sh.A i ofruar APD 1 aparat:

1 aparat iPhone 7+ 64GB me vlere **118,900 leke**

Me faturen tatimore nr. 7105 (nr. Series 216873563) date 29.06.2017 V... Sh.A i ka ofruar APD 1 aparat:

1 aparat iPhone 7+ 128GB me vlere **132,900 leke**

Vlera totale është 2,801,350 leke

Naga auditimi konstatohet se Marreveshja date 19.04.2014 dhe 8 amendimet e saj nuk janë të protokolluara ne APD dhe nuk ndodheshin kopje te tyre ne insistucion por u siguruan nga V... Sh.A.

Nga auditimi u konstatua se 29 aparatet celular me vlere totale 2,801,350 nuk jane bere hyrje ne magazinën e APD dhe nuk jane pjese e inventareve te saj.

Si përfundim: Autoriteti Portual Durrës ka lidhur marrëveshje me kompaninë V... Sh.A datë 20.04.2014, për Autoritetin Portual Durrës S. B. dhe për V... Sh.A Ch. B., nëpërmjet të cilës punonjësit e Autoriteti Portual Durrës janë pajisur me numër telefon celular me parapagim, me afat deri në 19.04.2017. Deri në fund të periudhës së auditimit kjo marrëveshje ka ndryshuar 8 herë. Nga kjo marrëveshje APD ka përfituar 29 aparate celular në vlerën **2,801,350 lekë**, aparate të cilat nuk janë bërë hyrje në magazinën e APD dhe nuk janë pjesë e inventarëve të saj në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar. Vlerë e aparateve celular prej 2,801,350 lekë përbën dëm ekonomik.

Referuar observacioneve të ardhura me shkresën nr. 3476/1, datë 10.09.2018, protokolluar në KLSH me nr. 579/4, datë 12.09.2018, ku pretendoni se:

- Mjetet kane kryer levizje hyrje e dalje jashte territorit te portit, per arsye sherbimesh teknike, te bazuara ne urdherat e brendshem te Drejtorit të Pergjithshem Ekzekutiv, vertetuar ne faturat tatimore me nr: 680 date 23/03/2018, nr: 477, date 29.03.2018, nr: 776, date 12.4.2018. Mjetet ne perdorim te FSPD kane levizur gjithmone ne baze te planit te sigurise te FSPD, urdherave te Drejtorit të Pergjithshem Ekzekutiv dhe Drejtorit te FSPD-se.

- Kjo diference justifikohet per vete faktin, se mjeti ne fjale konsumon karburant mbi normat e percaktuara nga komisioni i ngritur per kete qellim; per kete jemi drejtuar Drejtorit të Pergjithshem Ekzekutiv me nje kerkese per ringritjen edhe nje here te ketij komisioni, ku jane dhene detyrat perkatese dhe eshte ne procedure e siper zgjidhja e ketij problemi. Nga verifikimi i faturave te terheqjes se karburantit rezulton se ky mjet per periudhen Janar – Qershor 2018 nuk ka terhequr nga limiti percaktuar 850 litra karburant, per arsyen e larte permendur .

- Karburanti per mjetet e FSPD eshte terhequr dhe justifikuar me km. ne baze te planeve te sigurise te miratuar nga Drejtori i FSPD-se dhe nga Drejtori i Pergjithshem, si dhe te Urdherave te Brendshem te miratuara nga Drejtori i Pergjithshem Ekzekutiv.

- Theksojme se monitorimi i levizjeve te mjeteve te FSPD-se behet nga ana e stukturave te FSPD-se. Ne asnje rast, ekonomistja e karburantit nuk ka hedhur ne evidencat e mbajtura nga ana e saj kilometra me shume se sa jane percaktuar ne flete udhetimet e dorezuara nga ana e sektorit te FSPD-se, apo te jete hedhur gabim normativa per 100 km e cdo mjeti, dhe as te tejkalohet limiti i percaktuar nga Urdherat e Brendshem te dala ne periudha te ndryshme kohore.



Por theksojme qe, ne cdo rast, cdo shifer e dhene nepermjet ketyre flete udhetimeve eshte hedhur e sakte ne evidencat e pergatitura nga ekonomistja e Sektorit te Mbeshtetjes Materiale&Magazinat.

Për sa më sipër ju sqarojmë se grupi auditimit kryeu konstatim në teren dhe krahasoi km e regjistruar nga drejtuesit e mjeteve në fletët e udhëtimit me km e treguar nga kilometrazhi i automjetit dhe në bazë të kësaj u konstatuan diferenca në kilometra të përshkruar. Të gjitha strukturat e përfshira në këtë proces kanë pë detyrë të monitorojnë procesin.

Ndërsa përsa i përket mjeteve të FSPD-së ju sqarojmë se pikërisht në datat që ju përmendni por edhe në të tjera që grupi i auditimit i konstatoi nga sistemi i check-imit rezultoi se ka mos përputhje midis asaj që është deklaruar në fletët e udhëtimit dhe destinacionit konkret të automjetit. Observacioni nuk ka bazë ligjore.

- *përsa i përket pjesëmarrje ne aktivitet jashte objektit te portit, referuar Seminarit IA Seminar ltd, trajtuar ne faqen 59, ish drejtoresha e Drejtorise Ekonomike, Finances e Admin., M. B., pjesemarrrese ne kete trajnim sqaron se APD qysh nga viti 2008, raporton ne baze te Standarteve Nderkombetare te Raportimit Financiar, kjo ne permbushje se fundmi, te pikes 2, te Nenit 5 te Ligjit 25/2018 date 10.05.2018 "Per kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", ju sqarojmë se kualifikimi i stafit është personal dhe individual dhe në bazë të kualifikimit që kanë punonjësit punësohen pët të kryer detyrën funksionale. Observacioni nuk ka bazë ligjore.*

- *përsa i përket **pagesa te kryera per pjesemarrje ne panairot e punes**, faqja 49, trajtuar hollesisht ne faqet 59-60, rol te rendesishem per realizimin e objektiveve tregtare te APD-se, ka promovimi i sherbimeve, kapaciteteve perpunuese dhe mundesive per bashkepunim qe ofron APD. Kjo realizohet nepermjet pjesemarrjes ne panairot kombetare dhe nderkombetare, pjesemarrje ne konferenca te ndryshme, promocion reklama, etj. **Ne nje nga konstatimet e grupit te auditimit**, qe lidhet me kerkesen per transaksion, date 27.04.2018, sipas te ciles eshte kryer pagesa prej 1,200 euro drejt Dhomes se Tregetise dhe Industrise, per pjesemarrjen ne panairin "work & Study", me Urdher te Brendshem nr 1147, date. 16.03.2018:*

Me ftese te Kryetarit te Bashkise Tirane, APD ka mare pjese ne Panairin Shqiptar te Studimit dhe Punesimit - Work & Study 2018, organizuar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, Bashkia Tiranë dhe Dhoma e Tregtise e Industrise Tirane.

Për sa më sipër ju sqarojmë se grupi i auditimit në asnjë rast nuk është shprehur në lidhje me bazën ligjore por me efektivitetin dhe përfitimet e mundëshme të APD nga pjesëmarrja në këto aktivitete.

- *referuar kerkeses per transaksion, date 13.09.2016, per pagesen 1745 Euro, kundrejt A... per bilete avioni per Malaga Spanje, date 22-25.06.2017, bazuar ne Urdherin Nr. 1624, date 30.05.2017, ku sipas grupit te auditimit pretendohet qe eshte kryer pa procedure prokurimi, kjo pagese eshte realizuar sipas procedures se blerjeve te vogla (Urdher prokurimi 915, date 27.03.2017). Ju sqarojmë se bashkëlidhur praktikës së bankës mugonte dokumentacioni nga ju i cituar dhe nuk u vu në dispozicion. Observacioni qëndron dhe u bën reflektimet në material.*

- *referuar kerkeses per transaksion, date 02.05.2017, per pagesen 280.000 leke, kundrejt A... per bilete avioni per Bali, date 06-13.05.2017, bazuar ne Urdherin Nr. 864, date 23.03.2017, ku sipas grupit e auditimit pretendohet qe eshte kryer pa procedure prokurimi, kjo pagese eshte realizuar sipas procedures se blerjeve te vogla (Urdher prokurimi 157/1, date 29.03.2017). Ju sqarojmë se bashkëlidhur praktikës së bankës mugonte dokumentacioni nga ju i cituar dhe nuk u vu në dispozicion. Observacioni qëndron dhe u bën reflektimet në material.*



- Kontrata e shërbimit e lidhur nga Autoriteti Portual Durrës me znj. E. C. është nënshkruar në datën 13.04.2018. Kjo kontratë është bërë në varësi të Urdhërit të Brendshëm nr 1233 prot, datë 26.03.2018 dhe në vazhdimësi ka marrë nr 1233/1 prot. Për gabim njerëzor është harruar të lihet kopja përkatëse në protokoll. Përsa i përket Marrëveshjes së Partneritetit mes APD dhe Projektit SUPAIR, data përfundimtare e lidhjes së kësaj marrëveshjeje është 25.05.2018 por bazuar në nenin 3 të kësaj kontrate fuqia vepruese ka filluar në 01.01.2018 (datë e fillimit të projektit). Gjithashtu neni 4 i Subsidy Contract përcakton se çdo shpenzim i bërë nga data 01.01.2018 – 31.12.2019 është i ligjshëm dhe i bazuar në kontratë. Çdo shpenzim i bërë për projektin SUPAIR është i bazuar dhe i paracaktuar në planin e punës (application form) dhe do të rimburohet sipas marrëveshjes.

Pretendimet tuaja nuk janë të bazuara ligjërisht.

- Me kërkesën për transaksion datë 21.09.2016 është kryer pagesa prej 2,820 euro si tarifë pjesëmarrje në Konferencë në Rotterdam për sa i përket pagesës së tarifës së pjesëmarrjes në konferencë për z. G. B., kjo pagesa e kryer është bazuar në urdhërin e cituar më lart, kopja e të cilit në dokumentat e ndodhura në Sektorin e Finances përmend 3 pjesëmarrës në konferencë: G. Sh., J. K. dhe G. B..

Për sa më sipër ju sqarojmë se në protokollin e institucionin ky urdhër është me dy persona pjesëmarrës në aktivitet. Observacioni nuk merret parasysht.

- Përsa i përket njohjes së shpenzimit për biletën e parë në emër të A. Q. e cila nuk është përdorur, se ekziston Urdhëri i Brendshëm nr. 287/1 Prot., date 29/01/2018 të titullarit, (bashkangjitur) për anulimin e fluturimit për shkak të vizitës së Ministrit të Infrastruktura dhe Energjisë në APD, kjo e mbeshtetur në Udhezimin nr 22, date 10.07.2013, të Ministrisë së Financave, mbi zbatimin e vendimit nr. 870, date 14.12.2011 të Keshillit të Ministrave “Për trajtimin financiar të punonjesve që dergohen me shërbim jashtë vendit”, pika 7. Në raste tepër specifike, mund të ndodhe që, për arsye madhore dhe të paparashikuara, punonjësi i caktuar për kryerjen e shërbimit jashtë vendit të mos niset me shërbim ose të kthehet pa e përfunduar atë. Në keto raste, të gjitha shpenzimet e kryera deri në atë moment se bashku me penalitetet perkatese, nëse do të kete të tilla, perballohen nga institucioni. Për efekt të këtij udhezimi, si arsye madhore dhe të paparashikuara do të konsiderohen raste të tilla si: semundje e menjehershme ose ndërrim jete e punonjësit, një anetari të familjes së tij, fatkeqesi natyrore, anulime dhe vonesa të mjeteve të transportit që nuk varen nga punonjësi, të vertetuara sipas dokumentit perkates, urdher i titullarit për angazhim në ceshtje të tjera që e bejne të pamundur pjesëmarrjen në aktivitet, si dhe rastet e nderprerjes së marrëdhënieve të punësimit. Në cdo rast tjetër të ndryshëm nga sa është specifikuar më sipër, shpenzimet perballohen nga vete punonjësi. Për sa më sipër ju sqarojmë se në bazë të dokumentave shkresore shtesë që keni sjell observacioni juaj merret parasysht.

- Për sa i përket observacioneve në lidhje me procedurat e blerjeve të vogla: “Blerje furnizim vendosje materiale auto – fener për volvo xc6”, “Heqjen e dy Pilotave në basenin e Portit”, “Blerje pjesë këmbimi dhe elektronike për elektrovinca”, “Blerje Mobilje për Zyre”, “Rrethim i zones së Interklubit” dhe “Permiresimi dhe perditesimi i aplikacionit për telefona celulare “Smart transport Albania”, ju sqarojmë se ju nuk keni sjell asnjë argument shtesë por shprehni se parregullësitë qëndrojnë të marrja në dorëzim.

Në lidhje me observacionin e sjell nga z. F. S., datë 10.09.2018 dhe dokumentacioneve shtesë në cilat u vendosën në dispozicion pas përfundimit të punës në terren, ju sqarojmë se observacioni u morr parasysht dhe u bënë reflektimet në material.



6. Organizimi dhe mbajtja e evidencës kontabile, respektimi i afateve për nxjerrjen dhe miratimin e pasqyrave financiare nga organet drejtuese të Autoritetit Portual, si dhe dërgimi e miratimi i tij në institucionet eprore. Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit. Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemimi i rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

1. Titulli i gjetjes: Mos plotësim i saktë dhe i detajuar i anekseve të pasqyrave financiare

Situata: Në pasqyrat financiare për vitin 2016 dhe 2017 janë dhënë raporte për pagën neto të Drejtorit Ekzekutiv, Këshillit Drejtues, dhe Z/Drejtorët. Theksojmë se referuar informacionit të dhënë, të ardhurat në total për sa më sipër janë të ndryshme në vite të ndryshme. Ndryshueshmëria tregon se këto pagesa nuk janë kryer vetëm për të ardhurat nga paga. Për këto shuma duhej të bëhej specifikimi dhe informacioni në lidhje jo vetëm për pagën bruto, por dhe pagesa të tjera të përfituara, që aktualisht ekzistojnë, referuar shifrave të pasqyruara sa më sipër. Gjithashtu nuk janë dhënë informacion për përfituesit e ndihmës financiare gjatë vitit 2016 dhe 2017. Referuar auditimit të bankës kanë rezultuar pagesa për ndihmë ekonomike për punonjësit në kundërshtim me neni 25/2 të Ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”.

Kriteri: neni 25/2 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual” dhe 25/2c ligji nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual” “Pasqyrat vjetore financiare tregojnë pagesën e përgjithshme që i është bërë secilit prej personave të mëposhtëm, përfshirë këtu dhe ndonjë pagesë në formën e ndihmës financiare ose të ndonjë përfitimi tjetër: a) anëtarëve të Këshillit Drejtues; b) drejtorit ekzekutiv; c) nëpunësit dhe punonjësit, kur shuma kalon limitet e planifikuara”.

Ndikimi/efekti: Mos pasqyrim i drejtë dhe i detajuar i shumave të përfituara

Shkaku: Plotësim i pjesshëm i anekseve të pasqyrave

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të kryejë sistemimet përkatëse në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor, për përfitimet e marra nga anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe zv/Drejtorët jo vetëm në lidhje me pagën por edhe ndonjë përfitim tjetër të mundshëm.

2. Titulli i gjetjes: Firmosja si Nëpunës Autorizues dhe Nëpunës Zbatues e personave të pa emëruar për këtë qëllim

Situata: Nga auditimi u konstatua se me urdhrin e brendshëm nr. 2253, datë 01.08.2012 të Drejtorit Ekzekutiv në rolin e nëpunësit autorizues është caktuar zv. Drejtor i Përgjithshëm dhe nëpunës zbatues Drejtor i Administrimit dhe Financës (aktualisht Drejtori Ekonomik). Me urdhrat e brendshëm nr. 305, datë 29.01.2015 dhe nr. 1501, datë 12.04.2018 janë ndryshuar nominimet e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, me emrat e drejtorëve të emëruar. Pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017 janë të konfirmuara respektivisht nga përgjegjësi i kontabilitetit dhe Drejtorët Ekzekutive të periudhës përkatëse, të cilët referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk përfaqësonin Nëpunësin Autorizues dhe Nëpunësin Zbatues të APD, në kundërshtim me nenin 9 pika 4/d dhe nenin 12 pika 3/ë të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 9 pika 4/d dhe neni 12 pika 3/ë.

Ndikimi/efekti: Përgjegjësia menaxheriale

Shkaku: Firmosje nga persona të paautorizuar për këtë qëllim



Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Autoriteti Portual Durrës të marrë masa për caktimin e nëpunësit zbatues sipas kërkesave sipas kërkesave rregullatore në fuqi.

3. Titulli i gjetjes: Sisteme jo të integruara për llogaritjen e pagave

Situata: Llogaritja e pagave dhe shpërblimeve nuk mbahen në program financiar, por në excel, dhe hidhet me veprim ekstrakontabël. Hartohen listë-prezenca për punonjësit dhe nuk përdoren raporte të gjeneruara nga sistemi i informatizuar i menaxhimit të BNJ për të cilin është kryer investim.

Kriteri: Informatizimi i mbajtjes së llogarive kontabël, investime të kryera të pa integruara me njëra-tjetrën dhe punë e zhvilluara manualisht

Ndikimi/efekti: Menaxhim dhe kontroll i dobët mbi sistemin e pagave

Shkaku: Mos integrim i sistemeve

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria Ekonomike të merren masa për mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike duke përfshirë dhe sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), ku mund të mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit, pagat, të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike, të dhëna për raporte financiare dhe statistika etj.

4. Titulli i gjetjes: Opinioni i shprehur për pasqyrat financiare

Situata: Pasqyrat financiare të Autoritetit Portual Durrës janë audituar nga auditues të pavarur të përzgjedhur me procedurë prokurimi. Për periudhën objekt auditimi u konstatua se opinioni i shprehur nga audituesit ka qenë me rezervë duke listuar arsyet dhe duke dhënë rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës. Rezulton se Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria Ekonomike, nuk kanë marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Audituesit e Pavarur të pasqyrave financiare në mënyrë që të në auditimin e radhës të ndryshojë situata dhe përmirësohet opinioni i tyre për pasqyrat financiare.

Kriteri: Baza për dhënien e opinionit të pasqyrave financiare.

Ndikimi/efekti: Mos ndryshimi i situatës

Shkaku: Mos analizimi dhe marrja e masave për zbatimin e rekomandimeve

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa për analizimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga audituesit e pavarur të pasqyrave financiare, duke hartuar një program masash konkrete dhe duke analizuar vazhdimisht ecurinë e zbatimit të tyre, në mënyrë që opinioni për pasqyrat financiare të përmirësohet.

5. Titulli i gjetjes: Ndërrimi i stafit në magazina

Situata: Gjatë periudhës objekt auditimi ka ndryshuar stafi i Magazinës Nr. 3 “Ekonomi dhe Pajisje”, saktësisht magazinierja A. R. ka zëvendësuar A. B.. Nga auditimi u konstatua se punonjësi A. B. nuk ka dorëzuar detyrën me inventarin përkatës dhe A. R. nuk ka marrë me inventar detyrën, në kundërshtim me pikën 10 dhe 13 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Kjo magazinë fizikisht është e ndarë në



tre godina dhe një pjesë e inventarëve ndodhen në magazina të tjera duke e bërë të pa menaxhueshme dhe kontrollueshme, si dhe nuk sigurohet ruajtja e vlera materiale.

Kriteri: Udhëzim nr. 30 datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” “10. Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre

13. Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkaqe objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nepunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit.”

Ndikimi/efekti: Mos pranimi i rezultateve të inventarizimit

Shkaku: Mos dorëzimi i detyrës sipas kërkesave të ligjit

Rëndësia: e lartë

Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Mbështetjes Materiale dhe Magazinimit të marrin masa që në të ardhmen në të gjitha rastet e lëvizjeve të punonjësve të magazinës dhe jo vetëm detyra të dorëzohet dhe të merret me inventar, si dhe të hartohen procedura të mirë përcaktuara për këtë qëllim.

6. Titulli i gjetjes: Diferencat në inventar dhe masat e marra.

Situata: Nga auditimi rezulton se nga procesi i inventarizimit për vitet 2016 dhe 2017 kanë rezultuar diferenca dhe janë bërë propozimet përkatëse. Për të gjitha rezultatet dhe mangësitë e konstatuara janë nxjerrë urdhrat e zhdëmtimit dhe për punonjësit aktual po mbahet nga paga, ndërsa punonjësit e larguar janë njoftuar për mangësitë e konstatuara, por nuk janë ndjekur hapat ligjor për kthimin e vlerave që janë konstatuar mangësi nga rezultati i inventarizimit.

Kriteri: Ndjekja e arkëtimit të diferencave të dala nga rezultatet e inventarizimit

Ndikimi/efekti: Diferenca të paarkëtuara

Shkaku: Mos marrja e masave për arkëtim

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Ligjore të marrin masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjor dhe shkallët e gjykimit ndaj gjithë personave me përgjegjësi materiale që kanë rezultuar me mangësi gjatë procesit të inventarizimit.

7. Titulli i gjetjes: Urdhra në kundërshtim me aktet ligjore.

Situata: Me Urdhrin e Brendshëm nr. 1428, datë 05.04.2018 “Mbi ngritjen e komisionit të vlerësimit për aktivet e qëndrueshme dhe artikujt të inventarit”, i ndryshuar me Urdhrin e Brendshëm nr. 1428/1, datë 13.04.2018 dhe Urdhrin e Brendshëm nr. 2191, datë 21.05.2018, është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve. Në komisionet e mësipërme është vendosur Përgjegjësi i Sektorit të Kontabilitetit, vendosja e të cilit është në kundërshtim me Udhëzimin Nr.8 datë 29.03.2012 të Ministrit të Financave “Për përgjegjësitë e Nëpunësit Zbatues”.

Kriteri: Udhëzimi i Ministrit të Financave Nr.8 datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”

“Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi

Nëpunësi Zbatues i njësisë është Kryetar i komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga



përdorimi ne njësi.

Lista e aktiveve të identifikuar për vlerësim

Nëpunësi Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitim për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv

Relacioni i vlerësimit

Relacioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari-NZ i komisionit të vlerësimit.”

Ndikimi/efekti: Komisione me përbërje jo si pas akteve ligjore

Shkaku: Urdhër në kundërshtim me aktet ligjore

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrë masa që në të ardhmen në krijimin e grupeve të punës dhe komisioneve për vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme dhe artikujve të inventarit të përzgjedh punonjësit që parashikojnë aktet ligjore në fuqi, konkretisht përfshirjen e Nëpunësit Zbatues në këto grupe pune.

8. Titulli i gjetjes: Mbi auditimin e procedurave të depozitave bankare të Autoritetit Portual Durrës për periudhën objekt auditimi.

Situata: Nga auditimi konstatohet se Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, nuk kanë hartuar asnjë akt rregullator apo procedural për të përcaktuar procedurat e ri investimit në depozitë në bankë, mjetet monetare që janë gjendje në arkë dhe bankë në lekë dhe monedhë të huaj. Nuk është ngritur asnjë grup i veçantë për menaxhimin e aseteve financiare të Autoritetit Portual Durrës. Për vendosjet e mjeteve monetare në institucione financiare Drejtori i Ekonomik i është drejtuar bankave të cilat kanë sjell ofertat e tyre zyrtare. Drejtori Ekonomik harton një relacion dhe propozon bankën me interesin më të lartë. Nuk ka asnjë procedurë negociimi me bankat e nivelit të dytë për mirë menaxhimin e këtyre fondeve, duke rritur përfitim të institucionit. Duke analizuar shumën e depozituara dhe likuiditetet e institucionit konstatohet se nga niveli drejtues nuk është shqyrtuar asnjë herë mundësia e investimit të likuiditeteve në tituj qeveritar (bono thesari dhe obligacione qeveritare) dhe me afate maturimi mbi 1 vit (3 dhe 5 vjeçare) interesat e të cilave janë shumë herë më të larta se normat e interesit të bankave të nivelit të dytë me pasojë të ardhura të munguara për Autoritetin Portual Durrës.

Kriteri: Analizimi i të gjitha alternativave të investimit dhe përzgjedhja e atyre me përfitueshmëri më të lartë.

Ndikimi/efekti: Mos përfitimi maksimal nga asetet financiare

Shkaku: Procedura jo të plotë

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrin masa për:

- Të hartuar akte rregullatore apo procedurale për të përcaktuar procedurat e ri investimit në depozitë në bankë, mjetet monetare që janë gjendje në arkë dhe bankë në lekë dhe monedhë të huaj.

- Të ngritur grup të veçantë për menaxhimin e aseteve financiare të Autoritetit Portual Durrës.



- Të dokumentuar gjithë procedurën e negocimit me institucionet financiare duke kërkuar rritjen e normave të interesit dhe rritjen e përfitueshmërisë.
- Të shqyrtohet mundësia e investimit të mjeteve monetare në tituj qeveritar (bono thesari dhe obligacione qeveritare) me afate maturimi mbi 1 vit (3 dhe 5 vjeçare) interesat e të cilave janë shumë here më të larta se normat e interesit të bankave të nivelit të dytë duke optimizuar përfitimin nga investimi i aseteve financiare.

9. Titulli i gjetjes: Raportimi në Ministri

Situata: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka dërguar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës pasqyrat financiare të revizionuar për vitet ushtrimor. Nga auditimi konstatohet se nga ana e APD, nuk është hartuar asnjë raport i veçantë për sa i përket situatës ekonomike dhe financiare në kundërshtim me pikën 3, nenin 25 të Ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”, “*Autoriteti Portual i paraqet ministrin pasqyrat financiare, të revizionuara, përpara mbledhjes vjetore dhe është i detyruar t’i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko financiare*”.

Kriteri: Ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”

Ndikimi/efekti: Mos informim të Organit Epror

Shkaku: Mos hartimi i raporteve financiare

Rëndësia: e mesme

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa që ti dërgojnë Ministrin, pasqyrat financiare të revizionuara përpara mbledhjes vjetore, si dhe të hartojnë raporte duke analizuar situatën ekonomiko financiare të Autoritetit Portual Durrës.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Për periudhën objekt auditimi, kontabiliteti është i organizuar dhe mbajtur në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, si dhe në standardet kombëtare të kontabilitetit të shpallura nga Ministri i Financave.

Autoriteti ka mbajtur në llogaritë e tij aktivet, pasive dhe transaksionet financiare të rezultuara nga veprimtaria e autoritetit.

Gjatë vitit 2016, 2017 dhe 6-mujori i parë i 2018 ka qenë e siguruar vazhdimësia e aktivitetit dhe veprimtaria ekonomike autoritetit.

Autoriteti Portual Durrës sh.a., u themelua si një Shoqëri aksionare dhe u regjistrua më 04.12.1998, bazuar në vendimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit të datës 13.11.1998 dhe mbështetur në Ligjin nr. 7296, datë 20.04.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”. Përpara datës së themelimit, APD ishte një ndërmarrje shtetërore.

Bazuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 596, datë 10.09.2004 dhe Ligjit nr. 9130 datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, Shoqëria ndryshoi statusin e saj, nga shoqëri aksionare në Person Juridik Publik. Ky transformim ligjor u bë me qëllim që të përmirësonte efeciencën dhe përfitueshmërinë e portit me anë të një drejtimi të pavarur nga ana tregtare.

Deri në 30.06.2006 aksionari i ADP-së ishte Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Shqipërisë (METE) dhe që nga kjo datë, aksionari i vetëm i APD-së është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është ofrimi i shërbimeve portuale ndaj palëve të treta, si ngarkim dhe shkarkim i anijeve e mallrave, ankorim i trageteve e anijeve dhe magazinimi.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

-Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të kostos historike. Veprimet në ditarë dhe librin e madh janë në zbatim të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Veprimet kontabël aktualisht mbahen me programin “Orakle” i cili është vënë në funksionim në janar të vitit 2014.

- Për të dy vitet 2016 dhe 2017 raportimi për pagat e drejtuesve kryesorë si dhe për Këshillin Drejtues nuk është bërë konform kërkesave të nenit 25/2 të ligjit nr.9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual” në të cilën theksohet:

“Pasqyrat vjetore financiare tregojnë pagesën e përgjithshme që i është bërë secilit prej personave të mëposhtëm, përfshirë këtu dhe ndonjë pagesë në formën e ndihmës financiare ose të ndonjë përfitimi tjetër:

a) anëtarëve të Këshillit Drejtues;

b) drejtorit ekzekutiv;

c) nëpunësit dhe punonjësit, kur shuma kalon limitet e planifikuara”.

Aktualisht në pasqyrat financiare për vitin 2016 janë dhënë raporte për pagën neto të Drejtorit Ekzekutiv, Këshillit Drejtues, dhe z/Drejtorët në total si pagë neto. Theksojmë se referuar informacionit të dhënë të ardhurat në total për sa më sipër janë të ndryshme në vite të ndryshme.

në lekë

Emërtimi	Viti 2016	Viti 2017
Këshilli i Drejtues	6,109,568	5,868,748
Drejtori i Ekzekutiv	2,468,066	2,537,966
Zv/ Drejtorët	3,669,968	3,444,984

Sa më sipër kjo ndryshueshmëri tregon se këto pagesa nuk janë kryer vetëm për të ardhurat nga paga. Në shumat sa më sipër duhej të bëhej specifikimi dhe informacioni në lidhje dhe për pagën bruto, por dhe pagesa të tjera të përfituara, që aktualisht ekzistojnë, referuar shifrave të pasqyruara sa më sipër.

Gjithashtu nuk janë dhënë informacion për përfituesit e ndihmës financiare gjatë vitit 2016 dhe 2017 referuar auditimit të bankës kanë rezultuar pagesa për ndihmë ekonomike për punonjësit si dhe të tjera. Mos pasqyrimi i të dhënave sipas kërkesave të pikës 25/2c veprim që bie në kundërshtim me ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003.

-Pasqyrat financiare të vitit 2016 dhe 2017 janë të konfirmuara respektivisht nga përgjegjëset e financës dhe Drejtorët Ekzekutiv të periudhës përkatëse, të cilët referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nuk përfaqësonin N/Z dhe N/A të APD. Nga grupi i auditimit u kërkuan emërtimet në pozicionin e nëpunësit zbatues dhe nëpunësit autorizues për periudhën përkatëse në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. Referuar emërimeve të bëra nga APD rezultoi se me urdhrin e brendshëm të Drejtorit Ekzekutiv të APD nr. 2253, datë 01.08.2012 “ Mbi caktimin e aktorëve kryesorë për menaxhimin financiar dhe kontrollin në APD” pika 1, janë emëruar Nëpunës Autorizues Zv. Drejtor i Përgjithshëm dhe nëpunës zbatues Drejtore e Administrimit dhe Financës. Me urdhrat e brendshëm nr. 305, datë 29.01.2015 dhe nr. 1501, datë 12.04.2018 janë ndryshuar nominimet e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues, me emrat e drejtorëve të emëruar Ky urdhër vazhdon të jetë në fuqi. Sa më sipër sqaruam asnjë nga pasqyrat financiare të viteve 2016 dhe 2017 nuk janë të konfirmuara nga N/A dhe N/Z të periudhës, veprim ky që bie në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar neni 9 pika 4/d dhe neni 12 pika 3/ë. Përgjegjësit e financës hartuesit aktual të pasqyrave financiare, duhet të kalonin për kompetencë miratimin e tyre referuar ligjit tek N/A dhe N/Z, të cilët nuk kanë ushtruar detyrimet ligjore në këtë drejtim.



- Llogaritja e pagave dhe shpërblimeve mbahen jashtë programit financiar por në excel, dhe hidhet me veprim ekstrakontabël, hartohen listë-prezenca për punonjësit dhe nuk përdoren raporte të gjeneruara nga sistemi i informatizuar i menaxhimit të BNJ për të cilin është kryer investim.

Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer nga shoqëria G. Th. e cila ka paraqitur opinionin për pasqyrat financiare të dorëzuara me 1500/1 datë 15.05.2017, në bazë të kontratës së lidhur nr. 1653 më datë 02.06.2016. Data e fillimit të kontratës është 45 ditë mbas dorëzimit të pasqyrave financiare nga autoriteti. Autoriteti me email zyrtar ka dorëzuar në datë 31.03.2017 ka vënë në dispozicion pasqyrat financiare të vitit 2016 të cilat mbas auditimit nga shoqëria janë marrë në dorëzim me procesverbalin e datës 20.06.2017.

Gjithashtu me dokumentin me nr. 1500/4, datë 15.05.2017 “Letër për drejtimin” nga shoqëria G. Th. janë lënë një sërë rekomandimesh për Autoritetin Portual Durrës. Opinioni i auditorëve të shoqërisë G. Th. për pasqyrat financiare për vitin 2016 është *Opinion me rezervë* se pasqyrat financiare të APD paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2016. Duke u bazuar në konstatimet:

- ‘Llogaritë e arkëtueshme (neto)’, është regjistruar vlera 257,580,885 lekë më 31 dhjetor 2016 si llogari të arkëtueshme nga të cilat 185,750,846 lekë janë klasifikuar si llogari në vonesë më shumë së një vit pa zhvlerësim. Megjithëse ekzistonin të dhëna objektive për zhvlerësim të llogarive të arkëtueshme në atë datë, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të standardit Ndërkombëtar të Kontabilitetit 39 - ‘Instrumentet Financiare; Njohja dhe Matja’. Si rrjedhojë audituesit nuk kanë qenë në gjendje të përcaktojnë nëse janë të nevojshme rregullime për gjendjet e llogarive të arkëtueshme më 31 dhjetor 2016.

- ‘Aktive të tjera afatshkurtra’, Shoqëria ka regjistruar një shumë prej 148,389,239 lekë më 31 dhjetor 2016 në llogarinë Paradhënie në valutë për investime në terminale. Shoqëria nuk ka njohur ndonjë investim në proces në lidhje më këtë vlerë të parapaguar për investime në terminale dhe llogaria është në vonesë me më shumë së një vit. Megjithëse ekzistonin të dhëna objektive për zhvlerësim e kësaj llogarie në atë datë, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Si rrjedhojë audituesit nuk kanë qenë në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime për gjendjen e llogarisë së Paradhënie në valutë më 31 dhjetor 2016.

- ‘Detyrime të tjera’ të pasqyrave financiare më 31 dhjetor 2016, gjendja për llogarinë ‘Garanci mbajtur për huanë IDA dhe BERZH’ pasqyrohet respektivisht në vlerën 309,153,200 lekë.

- Shënimin 16 të pasqyrave financiare gjendja e detyrimeve tatimore të shtyra të APD më 31 dhjetor 2016 është 81,475,403 lekë. Këto detyrime tatimore të shtyra kanë lidhje më rivlerësimin e tokës në pronësi të Autoritetit Portual Durrës të bërë në vitin 2008. Detyrimi i shtyre tatimor do të përdoret vetëm nëse toka klasifikohet për shitje.

- Gjendja e grandeve qeveritare të Shoqërisë është 477,115,467 lekë. Nuk ka dokument justifikues të duhur edhe të mjaftueshëm për gjendjen e grandeve qeveritare më 31 dhjetor 2016.

- Huat më 31 dhjetor 2016, është 5,275,787,831 lekë. Nuk evidence e përshtatshme mbi gjendjet më datën 31 dhjetor 2016 dhe 2015 të Huas European Investment Bank (‘BEI’) 2 për shumën prej 12,000,000 Euro ose 1,622,760,000 lekë.

Këshilli Drejtues i APD me Vendimin nr. 8, datë 19.07.2017, ka miratuar pasqyrat financiare sipas bilancit kontabël, pasqyrave financiare dhe raportin e paraqitur nga audituesit e pavarur.



Ka miratuar shpërndarjen e fitimit neto të vitit fiskal 2016 për shumën 143,045,499 lekë, si më poshtë:

rezervë ligjore 5% 7,152,275 lekë

rezervë për zhvillim 95% 135,893,224 lekë

Me shkresën nr. 1950, datë 20.07.2017 Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv ka dërguar në Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës pasqyrat financiare të revizionuar për vitin ushtrimor. Nga auditimi konstatohet se nga ana e APD nuk është hartuar ndonjë raport i veçantë për sa i përket situatës ekonomike dhe financiare në kundërshtim me pikën 3, nenin 25 të Ligjit nr. 9130, datë 8.9.2003 “Për Autoritetin Portual”, “*Autoriteti Portual i paraqet ministrit pasqyrat financiare, të revizionuara, përpara mbledhjes vjetore dhe është i detyruar t’i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko financiare*”.

Rezulton se Këshilli Drejtues, Drejtori i përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria Ekonomike nuk kanë marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Audituesit e Pavarur të pasqyrave financiare në mënyrë që të në auditimin e radhës të ndryshojë situata dhe përmirësohet opinionin e tyre për pasqyrat financiare.

Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer nga shoqëria U. E. e cila ka paraqitur opinionin për pasqyrat financiare të dorëzuara me 2203/1 datë 21.05.2018, në bazë të kontratës së lidhur nr. 1734 më datë 14.06.2017. Data e fillimit të kontratës është 45 ditë mbas dorëzimit të pasqyrave financiare nga autoriteti. Autoriteti me email zyrtar ka dorëzuar në datë 30.03.2018 ka vënë në dispozicion pasqyrat financiare të vitit 2017 të cilat mbas auditimit nga shoqëria janë marrë në dorëzim me procesverbalin e datës 24.05.2018.

Gjithashtu me dokumentin me nr.2203/2, datë 21.05.2017 “Letër për drejtimin” nga shoqëria U. E. janë lënë një sërë rekomandimesh për Autoritetin Portual Durrës. Opinionin e auditorëve të shoqërisë U. E. për pasqyrat financiare për vitin 2017 është *Opinion me rezervë* se pasqyrat financiare të APD paraqesin në mënyrë të drejtë të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të shoqërisë më datën 31 Dhjetor 2017. Duke u bazuar në konstatimet:

- ‘Aktive të tjera afatshkurtra’, Shoqëria ka regjistruar një shumë prej 145,887,372 lek më 31 dhjetor 2017 në llogarinë Paradhënie në valutë për investime në terminale. Shoqëria nuk ka njohur ndonjë investim në proces në lidhje me këtë vlerë të parapaguar për investime në terminale dhe llogaria është në vonesë me më shumë se një vit. Megjithatë ekzistonin të dhëna objektive për zhvlerësim të kësaj llogarie në atë datë, Shoqëria nuk kreu çmuarje për zhvlerësim sipas kërkesave të standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Si rrjedhojë audituesit nuk kanë qenë në gjendje të përcaktojmë nëse janë të nevojshme rregullime për gjendjen e llogarisë së Paradhënie në valutë më 31 dhjetor 2017.

- ‘Detyrime të tjera’ të pasqyrave financiare më 31 dhjetor 2017, gjendja për llogarinë ‘Garanci mbajtur për huan IDA dhe BERZH’ pasqyrohet respektivisht në vlerën 336,841,242 lek.

- Shënimin 16 të pasqyrave financiare gjendja e detyrimeve tatimore të shtyra të APD më 31 dhjetor 2017 është 81,475,403 lek. Këto detyrime tatimore të shtyra kanë lidhje me rivlerësimin e tokës në pronësi të Autoritetit Portual Durrës të bërë në vitin 2008. Detyrimi i shtyre tatimor do të përdoret vetëm nëse toka klasifikohet për shitje.

- Gjendja e grandeve qeveritare të Shoqërisë është 448,949,282 lekë. Nuk ka dokument justifikues të duhur edhe të mjaftueshëm për gjendjen e grandeve qeveritare më 31 dhjetor 2017.



- Huat më 31 dhjetor 2016, është 4,818,193,955 lekë. Nuk evidence e përshtatshme mbi gjendjet më datën 31 dhjetor 2017 të Huas European Investment Bank ('BEI') 2 për shumën prej 12,000,000 Euro ose 1,595,400,000 ALL .

- 'Llogaritë e arkëtueshme (neto)', është regjistruar vlera 257,580,885 lekë më 31 dhjetor 2016 si llogari të arkëtueshme nga të cilat 185,750,846 lekë janë klasifikuar si llogari në vonesë më shumë së një vit pa zhvlerësim.

Këshilli Drejtues i APD me Vendimin nr. 13, datë 13.06.2018, ka miratuar pasqyrat financiare sipas bilancit kontabël, pasqyrave financiare dhe raportin e paraqitur nga audituesit e pavarur. Ka miratuar shpërndarjen e fitimit neto të vitit fiskal 2017 për shumën 121,979,092 lekë, si më poshtë:

rezervë ligjore 5% 6,098,954 lekë

rezervë për zhvillim 95% 115,880,138 lekë

Konstatohet se nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit Drejtues është firmosur vetëm 2 anëtar të Këshillit Drejtues dhe gjithashtu gjatë mbledhjes Këshilli Drejtues anëtarët e Këshillit Drejtues nuk janë shprehur për miratimin e këtyre pasqyrave por është shprehur vetëm Kryetari duke deklaruar se miratohet unanimisht.

Pasqyrat financiare nuk janë dërguar për miratim tek Ministri.

Për të dy vitet pasqyrat financiare janë dorëzuar pranë organeve tatimore brenda afateve të përcaktuara dhe konkretisht me shkresën nr. 1028, datë 31.03.2017 dhe shkresën nr. 1297, datë 30.03.2018.

Inventarizimi fizik i pasurisë, zbatimi i afateve, cilësia e inventarizimeve, si dhe mbyllja e sistemit të rezultateve në pasqyrat financiare vjetore.

Magazinat dhe Procesi i inventarizimit

Me Urdhrin nr. 2735, datë 03.10.2016 është ngritur komisioni i inventarizimit të vlerave materiale në Magazinën nr. 1, me përbërje:

1. M. M.
2. S. M.
3. A. B.
4. E. T.
5. A. C.
6. H. V.
7. B. M.

Grupi i inventarit është asistuar nga audituesit e pavarur gjatë procesit të inventarizimit.

Janë fiksuar numrat e fletë hyrjes dhe fletë daljes së fundit për të gjitha kategoritë e mallrave brenda kësaj magazine.

Nuk kanë rezultuar mungesa.

Me Urdhrin nr. 2734, datë 03.10.2016 është ngritur komisioni i inventarizimit të vlerave materiale në Magazinën nr. 2, me përbërje:

1. V. B.
2. M. R.
3. N. D.
4. L. T.
5. N. H.

Grupi i inventarit është asistuar nga audituesit e pavarur gjatë procesit të inventarizimit.

Janë fiksuar numrat e fletë hyrjes dhe fletë daljes së fundit për të gjitha kategoritë e mallrave brenda kësaj magazine.



Në përfundim të procesit nuk rezultuan mangësi por janë propozuar mallra për të nxjerr jashtë përdorimit në vlerën 803,800 lekë.

Nuk rezultuan diferenca nga inventari.

Me Urdhrin nr. 2738, datë 03.10.2016 është ngritur komisioni i inventarizimit të vlerave materiale Makineri – Pajisje të Automekanizmave, me përbërje:

1. L. M.
2. V. H.
3. G. I.

Grupi i inventarizimit në relacionin nr. 2738, datë 30.11.2016 ka paraqitur diferencat e rezultuara nga procesi i inventarizimit në zërin Grejfera dhe mjete të tjera në vlerën 2,287,314 lekë të cilat u rikonstatuan në ambientet e jashtme të portit.

Me Urdhrin nr. 2736, datë 03.10.2016 është ngritur komisioni i inventarizimit të Shesheve, Kalada dhe ndërtesa, me përbërje:

1. E. J.
2. S. D.
3. J. Xh.
4. V. Sh.
5. I. V.

Grupi i inventarizimit në relacionin nr. 2736/1, datë 25.11.2016 ka paraqitur propozimet e veta mbi ndryshimet e vlerave kontabël lidhur me rikonstruksionet e kryera.

Në përfundim të procesit të inventarizimit Përgjegjësi i Kontabilitetit ka hartuar një relacion përmbledhës me nr. 101, datë 23.02.2017, ku përmbledhur gjithë rezultatet e inventarizimit. Gjithashtu është konstatuar një diferencë në inventarët e ekonomi pajisje në vlerën 310,000 lekë, si pasojë e lëvizjeve të stafit.

Për sa më sipër Titullari i Institucionit me urdhrin nr. 638, datë 02.03.2017 ka nxjerr urdhrin e zhdëmtimit të personave të ngarkuar me përgjegjësi materiale dhe ka urdhëruar kontabilizimin përkatës.

Me Urdhrin nr. 657, datë 02.03.2017 Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv është ngritur komisioni i vlerësimit të aktiveve të qëndrueshme dhe artikujve të inventarit të APD-së me këtë përbërje:

- M. B., Kryetar, Drejtor Ekonomik
- L. B., Anëtar, Përgjegjës Sektori Sigurimi Teknik
- A. M., Anëtar, Specialist i Sektorit të Financë dhe Kontabilitet
- A. K., Anëtar, Specialist IT
- E. I., Anëtar, Specialist EN

Komisioni pas vlerësimit të aseteve ka përgatitur relacionin nr. 1362 prot., datë 28.04.2017, ku ka bërë dhe vlerësimet përkatëse.

Materiali i përgatitur i është dorëzuar Këshillit Drejtues, i cili nuk ka marrë asnjë vendim lidhur me këto material.

Bazuar në Urdhrin e Brendshëm nr. 2388, datë 22.09.2017, është ngritur komisioni për nxjerrjen nga përdorimi të pajisjeve dhe artikujve të inventarit të APD-së për vitin 2016, me këtë përbërje:

1. D. Z.
2. F. G.
3. A. H.
4. A. S.
5. B. Sh.



Komisioni ka për detyrë të procedojë me artikujt e vlerësuar për jashtë përdorimit, të cilat nuk kanë vlerë përdorimi si dhe të vlerësojë artikujt që mund të kenë një vlerë përdorimi për skrap, afati është 06.10.2017. Me Urdhrin e Brendshëm nr. 2388/1, datë 29.09.2017 është shtyrë afati i procesit deri në 30.10.2017

Deri në 30.10.2017 komisioni i ngritur për këtë qëllim nuk e ka realizuar procesin pasi ka dështuar 2 herë procesi i prokurimit me vlerë të vogël për asgjësimin e këtyre inventarëve dhe në përfundim kanë hartuar procesverbalin përmbledhës nr. 2388/2, datë 31.10.2017.

Nga auditimi konstatohet se grupi i ngritur për këtë qëllim nuk ka kryer ndonjë vlerësim për artikujt me vlerë përdorimi për skrap në kundërshtim me Urdhrin e Brendshëm nr. 2388/1, datë 29.09.2017, të ndryshuar.

Lëvizjet e stafit të magazinave

Gjatë periudhës objekt auditimi ka ndryshuar stafi i Magazinës Nr. 3 Ekonomi dhe Pajisje, A. R. ka zvendësuar A. B., konstatohet se punonjësi A. B. nuk ka dorëzuar detyrën me inventarin përkatës dhe A. R. nuk ka marrë me inventar detyrën në kundërshtim me pikën 10 dhe 13 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”:

“10. Çdo menaxher, nëpunës apo punonjës i njësisë publike është përgjegjës për ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe të dokumentacionit të njësisë kundrejt humbjeve, vjedhjeve, keqpërdorimit dhe përdorimit të paautorizuar të tyre

13. Punonjësit që kanë në ngarkim aktive, në rast se largohen ose transferohen nga puna, bëjnë më parë dorëzimin e tyre brenda afatit të përcaktuar nga Nëpunësi Autorizues i njësisë respektive sipas specifikave të aktiveve. Kur këta punonjës nuk mund të jenë të pranishëm për shkakë objektive, dorëzimi bëhet në prani të një komisioni të caktuar nga nëpunësi autorizues duke thirrur edhe një anëtar madhor të familjes së tyre. Kur punonjësit kundërshtojnë, dorëzimi bëhet vetëm në prani të komisionit.”

Viti 2017

Bazuar në urdhrin e brendshëm nr. 2722, datë 13.11.2017, është ngritur grupi i inventarizimit të kalatave dhe shesheve të APD-së., i përbërë nga:

1. F. Gj., Kryetar
2. D. Sh., Anëtar
3. A. B., Anëtar

Në përfundim të procesit grupi ka hartuar relacionin e inventarizimit dhe kanë bërë propozimet përkatëse dhe me shkresën nr. 2722/1, datë 08/01/2018 kanë përcjell materialet tek titullari.

Bazuar në urdhrin nr. 2720, datë 13.11.2017, është ngritur grupi i inventarizimit dhe etiketimit të Magazinës nr. 4, inventar ekonomik në depo dhe ekonomi pajisje në përdorim:

1. I. I., Kryetar
2. A. K.
3. V. K.
4. Gj. S.
5. E. H.
6. A. C.
7. A. H.
8. F. G.
9. E. P.



Me relacioni nr. 2720/4, datë 29.12.2017, grupi ka paraqitur situatën dhe diferencat e konstatuara. Kjo magazinë fizikisht është e ndarë në tre godina dhe një pjesë e inventarëve ndodhen në magazina të tjera duke e bërë të pa menaxheshme nga magazinieri, si dhe nuk sigurohet ruajtja e vlerës materiale, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”

Bazuar në urdhrin nr. 2719, datë 13.11.2017, është ngritur grupi për inventarizimin e magazinës së karburanteve, i përbërë nga:

1. I. H.
2. N. H.
3. A. Xh.

Nga inventari nuk kanë rezultuar diferenca.

Me urdhrin nr. 2723, datë 13.11.2017, është ngritur grupi i inventarizimit për Magazinën nr. 2, i përbërë nga:

1. B. D., Kryetar
2. K. M., Anëtar
3. I. K.,
4. M. R.
5. O. E.

Nga procesi i inventarizimit nuk kanë rezultuar diferenca dhe janë bërë propozimet përkatëse. Për të gjitha rezultatet dhe mangësitë e konstatuara janë nxjerr urdhrat e zhdëmtimit dhe për punonjësit aktual po mbahet nga paga, ndërsa punonjësit e larguar janë njoftuar për mangësitë e konstatuara.

Nga auditimi konstatohet se nuk janë ndjekur hapat ligjor për kthimin e vlerave që janë konstatuar mangësi.

Me Urdhrin e Brendshëm nr. 1428, datë 05.04.2018 “Mbi ngritjen e komisionit të vlerësimit për aktivet e qëndrueshme dhe artikujt të inventarit”, i ndryshuar me Urdhrin e Brendshëm nr. 1428/1, datë 13.04.2018 dhe Urdhrin e Brendshëm nr. 2191, datë 21.05.2018.

Në komisionet e mësipërme është vendosur Përgjegjësi i Sektorit të Kontabilitetit, vendosja e të cilit është në kundërshtim me Udhëzimi Nr.8 datë 29.03.2012 të Ministrisë të Financave “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”

, për përgjegjësitë e Nëpunësit Zbatues

“Procesi i vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga përdorimi në njësi

Nëpunësi Zbatues i njësisë është Kryetar i komisionit të vlerësimit të aktiveve të propozuara për dalje nga

përdorimi në njësi.

Lista e aktiveve të identifikuar për vlerësim

Nëpunësi Zbatues i njësisë, në bazë të gjendjes faktike të aktiveve të rezultuar nga inventarizimi, normave të amortizimit, afatit të skadencës, vitit të vënies në punë, vlerës së shtuar ndër vite, mundësitë për riaftësimin e aktiveve në raport me kosto/ përfitim për një veprim të tillë, informacionit zyrtar të marre mbi dobishmërinë e aktiveve nga drejtuesit e programeve buxhetore dhe punonjësit e tjerë të njësisë, përcakton gjendjen e aktiveve dhe harton listën e atyre që do të vlerësohen. Lista nënshkruhet nga komisioni i vlerësimit dhe përgjegjësi material dhe hartohet në tre kopje, një nga të cilat qëndron në arkiv

Relacioni i vlerësimit

Relacioni përmban procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës. Relacioni hartohet në tre kopje dhe nënshkruhet nga kryetari-NZ i komisionit të vlerësimit.”

Si dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 i ndryshuar në paragrafët 99,101,102,106.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Komisioni ka hartuar relacionin përkatës dhe e ka paraqitur tek Nëpunësi Autorizues dhe deri në përfundimin e periudhës objekt auditimi nga organet vendimmarrëse të APD.

Analiza e debitorëve, kreditorëve, derdhja e detyrimeve fiskale, sigurimeve shoqërore, etj, ndaj buxhetit të shtetit.

Provizione

Shoqëria është e përfshirë në disa çështje gjyqësore me palë të ndryshme si e paditur dhe ka krijuar provizione në vlerën 10,416,519 Lekë. (2016; 125,173,964 leke). Lëvizjet në provizione për vitin 2017 dhe 2016 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Gjendje në 1 Janar	213,255,799	92,851,246
Paguar gjatë vitit	(123,335,611)	(4,769,411)
Provizione të krijuara gjatë vitit	10,416,519	125,173,964
Gjendja më 31 Dhjetor	100,336,707	213,255,799
Shpenzime / (rrimarrje) povizione për vitin:		
	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Provizione për borxhe të këqija	22,023,776	-
Provizione për aktive te tjera	1,056,625	1,550,584
Provizione për rreziqe (si më lart)	10,416,519	125,173,964
Totali i shpenzimeve për provizione	33,496,921	126,724,548

Detyrimi tatimor i shtyrë

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Gjendja më 1 Janar	81,475,403	81,475,403
Detyrimi tatimor i shtyrë në fund të vitit	-	-
Zvogëlime gjatë vitit	-	-
Aktivi tatimor i shtyrë në fund të vitit	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor	81,475,403	81,475,403

Detyrimi tatimor i shtyrë gjëndje në Dhjetor 2017 është i llogaritur për aktivin e shtyrë të krijuar nga diferenca e rivlerësimit të trojeve që nuk janë të amortizueshme. Si rezultat ky tatim nuk do të rimerret, përveç rastit nëse trojet do të klasifikohen 'për shitje'.

Tatim fitimi

Shpenzimi për tatim fitimin përbëhet si më poshtë:

	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
Tatimi aktual mbi fitimin	34,594,556	54,412,360
Totali	34,594,556	54,412,360

Tatimi aktual mbi fitimin vlerësohet në normën 15% të fitimit të tatueshëm (2016; 15%).

Më poshtë paraqitet një rakordim i tatimit mbi fitimin të llogaritur me normën e taksës së aplikueshme me shpenzimin e tatimit mbi fitimin:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Norma efektive	Lek	Norma efektive	Lek
Fitimi para tatimit		149,815,650		204,215,859
Tatimi fillestar	15.00%	22,472,348	15.00%	30,632,379
Efekti tatimor i shpenzimeve që nuk janë të zbritshme për qëllime tatimore	8.16%	12,223,436	12.58%	23,828,305
Efekti i diferencave në të ardhura të patatueshme	-0.07%	(101,227)	-0.02%	(48,324)
Tatim fitimi	23.09%	34,594,556	23.98%	54,412,360

Më poshtë paraqitet rakordimi i fitimit të llogaritur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe fitimit të tatueshëm:

	31 Dhjetor 2017	31 Dhjetor 2016
Fitimi/(humbja) para tatimit sipas pasqyrave financiare të përgatitura sipas SNRF	149,815,650	204,215,859
<i>Te ardhurat te patatueshme</i>	<i>(674,846)</i>	<i>(647,846)</i>
	149,140,804	203,893,697
<i>Shpenzimet e pazbritshme dhe të ardhura për efekt tatimi</i>	<i>81,489,571</i>	<i>158,855,366</i>
Zhvlerësime për aktive afatgjatë material	47,422,081	29,440,315
Provizione për konflikte gjyqesore	10,416,519	126,724,548
Zhvlerësime për llogari të dyshimta klientësh	22,693,931	-
Gjoha dhe penalitete	957,040	2,690,503
Fitimi i tatueshëm	230,630,375	362,749,063
Tatim fitimi aktual sipas normës standarde 15%	34,594,556	54,412,359
Fitimi pas tatimit	115,221,094	149,803,500

Gjatë vitit 2017 Shoqëria ka bërë parapagime të tatim fitimit në shumën 52,676,627 Lekë (2016: 36,028,688 Lek), bazuar në parashikimin e organeve tatimore për detyrimet e taksave. Parapagimi i mbetur në fund të vitit është 26,431,177 Lekë (2016: 8,349,150 Lekë).

Mbi auditimin e procedurave të depozitave bankare të Autoritetit Portual Durrës për vitet 2016-2018.

Nga auditimi konstatohet se Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nuk kanë hartuar asnjë akt rregullator apo procedural për të përcaktuar procedurat e ri investimit në depozitë në bankë, mjetet monetare që janë gjendje në arkë dhe bankë në lekë dhe monedhë të huaj.

Nuk është ngritur ndonjë grup i veçantë për menaxhimin për menaxhimin e aseteve financiare të Autoritetit Portual Durrës.

Për vendosjet e mjeteve monetare në institucione financiare Drejtori i Ekonomik i është drejtuar bankave të cilat kanë sjell ofertat e tyre zyrtare. Drejtori Ekonomik harton një relacion dhe propozon bankën me interesin më të lartë. Konstatohet se një sërë bankash për shuma të cilat janë mbi një limit të caktuar normat e interesit negociohet. Konstatohet se nuk ka asnjë procedurë negociimi me bankat e nivelit të dytë për mirë menaxhimin e këtyre fondeve duke rritur përftimin e institucionit.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Viti 2016

	Banka	Afati	Shuma	Interesi
			Lekë	
1	B. G.	1 vjeçare	100,000,000	3.150%
2	B. G.	1 vjeçare	50,000,000	2.600%
3	V. B.	1 vjeçare	50,000,000	2.200%
4	V. B.	1 vjeçare	50,000,000	2.600%
5	U. B.	1 vjeçare	10,000,000	2.500%
6	B. A.	6 mujor	150,000,000	2.750%
7	B. K.	275 dite	100,000,000	2.250%
8	F. B.	3 mujore	10,000,000	2.000%
	Shuma		520,000,000	
			Euro	
1	B. A.	6 mujore	1,066,680	1.000%
2	B. A.	6 mujore	302,906	1.400%
3	F. B.	6 mujore	752,000	1.500%
4	C. B.	1 vjecare	373,991	1.900%
	Shuma		2,495,577	
			USD	
1	C. B.	6 mujore	324,895	1.400%
	Shuma		324,895	

Viti 2017

Banka	Afati	Interesi	Shuma
Monedha			Lekë
C. B.	1 vjecare	0.90%	210,000,000
V. B.	1 vjecare	1.80%	10,000,000
V. B.	1 vjecare	2.00%	200,000,000
C. B.	1 vjecare	2.05%	100,000,000
Shuma			520,000,000
Monedha			Euro
C. B.	1 vjecare	0.30%	752,000
C. B.	1 vjecare	0.40%	373,990
B. G.	1 vjecare	1.25%	370,000
C. B.	1 vjecare	0.95%	1,370,000
Shuma			2,865,990
Monedha			USD
C. B.	1 vjecare	1.20%	326,521
Shuma			326,521

Viti 2018

Banka	Afati	Interesi	Shuma
Monedha			Lekë
C. B.	1 vjecare	2.25%	1,000,000,000
Shuma			1,000,000,000
Monedha			Euro
C. B.	1 vjecare	1.10%	3,000,000
Shuma			3,000,000



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Monedha			USD
C. B.	1 vjecare	1.30%	330,435
Shuma			330,435

Duke analizuar shumat e depozituara dhe likuiditetet e institucionit konstatohet se nga niveli drejtues nuk është shqyrtuar asnjë here mundësia e investimit të likuiditeteve në tituj qeveritar (bono thesari dhe obligacione qeveritare) dhe me afate maturimi mbi 1 vit (3 dhe 5 vjecare) interesat e të cilave janë shumë here më të larta se normat e interesit të bankave të nivelit të dytë me pasojë të ardhura të munguara për Autoritetin Portual Durrës.

Referuar observacioneve të ardhura me shkresën nr. 3476/1, datë 10.09.2018, protokolluar në KLSH me nr. 579/4, datë 12.09.2018, ku pretendoni se:

- Pasqyrat Financiare te APD-se, firmosen nga Pergjegjesi i Sektorit te Finnces dhe Drejtorit Ekzekutiv, dhe jo nga N/Z dhe N/A.

Kjo pasi ka nje Urdher delegimi te kesaj pergjegjesie nga N/Z i APD-se, nr 858 Prot, date 23.03.2017, sikurse nga Drejtori Ekzekutiv nuk eshte pranuar te delegohet nje pergjegjesi e tille tek N/A.

- APD, ne permbushje pikerisht te bazes ligjore ka derguar Analizat ekonomike- financiare te saj prane Ministrise se linjes me shkrese nr. 491 Prot, date 20.02.2017 dhe me shkrese nr. 1201 Prot, date 20.03.2018)

- Për sa i përket informacionit të paraqitur në Pasqyrat Financiare per vitet 2016 dhe 2017 mbi pagesat sipas kërkesave të nenit 25/2, jane pasqyruar pagesat e pergjithshme (pra ne total, perfshire edhe masën e shpërblimit), konform kërkesave të ligjit per Autoritetin Portual, per Keshillin Drejtues (te detajuar per cdo anetar), për Drejtorin Ekzekutiv, gjithashtu dhe për dy zv. Drejtoret, pavarësisht mos përcaktimit në paragrafin e ligjit.

Përsa i përket nëpunësve dhe punonjësve kur shuma kalon limitet e planifikuara, nuk ka raste të tilla, pasi shpërblimet dhe ndihmat financiare të dhëna janë brenda parashikimit dhe planifikimit në Plan Biznesin e vitit përkatës, pra nuk ka kalim të limiteve të planifikuara për tu raportuar.

- Pasqyrat Financiare për vitin fiskal 2017, së bashku me shënimet shpjeguese, janë dërguar për t'u paraqitur Ministrin të Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën me lëndë: "Dërgohen Pasqyrat Financiare të Autoritetit Portual Durrës për vitin fiskal 2017" nr. 3085 prot., date 12.07.2018., konform Ligjit 9130 nenit 25 pika 3 ku citohet se: "Autoriteti portual i paraqet Ministrin pasqyrat financiare, të revizionuara, përpara mbledhjes vjetore dhe është i detyruar t'i raportojë atij për veprimtarinë ekonomiko-financiare".

Pasqyrat financiare te APD-se miratohen nga Keshilli Drejtues, sic sakteson edhe Ligji 9130, nenit 25, pika 5, i cili citon: Pasqyrat financiare kontrollohen nga një ekspert kontabël i autorizuar dhe miratohen nga këshilli drejtues.

Për sa më sipër ju sqarojmë se observacionet tuaja nuk qëndrojnë sepse për nga vetë natyra e institucionin dhe rëndësisë së pasqyrave financiare dhe bazës ligjore për to ato duhet të miratohen nga pronari.

7. Zbatimi i ligjshmërisë në prokurimet për investime, për blerje mallrash e shërbimesh, si dhe zbatimi i kontratave.

Auditimi i procedurave të prokurimit është kryer me zgjedhje. Rezultat e auditimit për secilin procedurë të audituar paraqiten si më poshtë vijonë.

1. Titulli i gjetjes: Procedura prokurimi, të kryera jo plotësisht konformë dispozitave ligjore.



Situata: -Në 7 raste, studimi i vlerës së kontratës është llogaritur duke u mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”.

-Për 10 procedura prokurimi, në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

- Në 12 procedura prokurimi, specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

-Në 8 procedura prokurimi, kualifikimi, shpallja fitues e operatorëve ekonomik nga KVO, si dhe lidhja e kontratave, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Ligjin 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 108-118, çka ngarkon me përgjegjësi komisionet e vlerësimit të ofertave.

-Në 24 raste për vlerën 1,543,366 mijë lekë, anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, është kryer pa analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për shkaqet subjektive që vërehen në procedurat e anuluar, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 24 dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 73, pika 2. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit. Autoriteti kontraktor publikon njoftimin për anulimin e procedurës së prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç është publikuar njoftimi i kontratës, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit për anulim.

-Në një rast për vlerën 90,316.8 lekë janë blerë pajisje të panevojshme kompjuterike (8 pajisje “UPS” si dhe 1 pajisje “Skaner”), duke rënduar buxhetin e APD.

-Në 7 raste për vlerën 157,912 mijë lekë, zbatimi i kontratave për mallra, shërbime dhe punë publike, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 60, pika 1, e cila përcakton se: “1. Kushtet e kontratës, të lidhur sipas këtij ligji, nuk ndryshojnë nga ato të përshkruara në dokumentet e tenderit dhe në ofertën fituese”.

- Në 3 raste për vlerën 34,771 mijë lekë, është rënduar kosto e investimit/shpenzimit nga realizimi i procedurave të prokurimit për mallra, shërbime dhe punë publike, është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Kriteri: Ligji nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligji 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, Ligji nr.10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, VKM nr.369, datë 27.3.2008 “Për miratimin e rregullit teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit”.

Ndikimi/efekti: Dëmë ekonomike për shoqërinë në vlerën 128,230 mijë lekë.



Shkaku: Keq interpreime të akteve ligjore dhe nëligjore të prokurimit publik, si dhe projektimit zbatimit të kontratave të punëve publike.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandimi:

Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësimit të nevojave të saj:

-Nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, përlogaritja e vlerës së kontratës, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, si dhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përlogaritjes së vlerës limit të kontratës, në raport me specifikimet teknike.

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve civile, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në varësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj APD, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore. Ky rekomandim mbështetet në frymën e Ligjit për prokurimin publik, si dhe në rregullat e prokurimit publik.

-Nga APD t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.

-Komisioni i vlerësimit të ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

-Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të zbatohen procedurat ligjore për saktësimin dhe arkëtimin e vlerës 128,230 mijë lekë, që ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave (prokurim, mbulim shpenzimesh me shoqëri sigurimi dhe zbatimi i kontratave etj).

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

7.1 Për realizimin e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje, blerje materiale elektrike për kabinën nr.14, pas dëmtimit të pjesëve elektrike të kësaj kabine, nga mbitensioni i rrymës elektrike, viti 2016.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik u konsatua se:

Më datën 10.12.2016, ora 3.15 kabina elektrike nr.14, kabinë në të cilën vjen linja e nënstacionit në territorin e APD-së, doli jashtë funksionit, si pasojë e dëmtimit të pajisjeve elektrike nga mbitensioni, duke lënë pa drita të gjithë Autoritetin Portual Durrës.



Për situatën e krijuar është mbajtur procesverbali me nr.586, datë 10.12.2016 drejtuar A. D. me Detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe të Zhvillimit, për dijeni A. L., procesverbal i mbajtur E. T. me Detyrë Përgjegjës i Sektorit të MKM, specialistët e sektorit të MKM L. M. dhe E. I. dhe përfaqësuesi i A., A. L., në të cilën pasqyrohet djegia e pajisjeve eletriike në kabinën 14, nga mbitensioni i rrymës elektrike.

Për të zgjidhur situatën e krijuar është bërë blerje për procedurën e prokurimit me procedurën me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës, veprim në kundërshtim të Ligjit 9643 dt 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, neni 33, pika 2, c), dhe VKM nr. 914 dt.29.12.2014 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 36, pika 2, germa "c".

Me kërkesë për transaksion nëpërmjet bankës B. është likuaduar subjekti H. Ll. për vlerën 10,231,206 lekë. Dokumentacioni shoqërues; Fatura nr.197, datë 14.12.2016 për vlerën 10,231,200 lekë, i firmosur nga E. T. për APD, si dhe faturat e detajura për të gjitha pajisjet. Fletë hyrje nr. 0100069, datë 15.12.2016. Akt pranimit nr.1, datë 14.12.2016 i firmosur nga E. T., V. D. dhe E. I. në të cilën është cilësuar se artikujt e furnizuar përputhen me specifikimet teknike”. Me urdhër nr.3532, datë 14.12.2016 të A. L. është ngritur komisioni i kontrollit dhe pranimit të shërbimeve.

Me fletë daljen nr.0100936 datë 15.12.2016 i firmosur nga magazinieri M. Gj., L. M. në cilësinë e ndjekësit të kontratës dhe marrës A. L. në cilësinë e sipërmarrësit A.... Me fletë daljen nr.0100940 datë 15.12.2016 i firmosur nga magazinieri M. Gj., L. M. në cilësinë e ndjekësit të kontratës dhe marrës A. L. në cilësinë e sipërmarrësit A....

Grupit të auditimit i'u servir një procesverbal që mban datën 15.12.2016, i pa protokolluar i firmosur nga Monitoruesit e kontratës L. M., E. I., magazinier A. C., si dhe A. L. për shoqërinë e mirëmbatjes I. A.... Ky proces nuk është hartuar pa marrë pjesë ing. A. B., në kundërshtim me urdhrin e brendshëm nr.2424, datë 29.09.2017 të A. L. “Mbi një ndryshim në UB nr.3741 prot, datë 31.12.2014 Mbi ngritjen e komisionit për evidentimin dhe vlerësimin e pjesëve të këmbimit të zëvendësuar dhe të kthyer në magazinat e Autoritetit Portual”, në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....për pjesët e tërhequra nga magazina për mirëmbatjen e aseteve energjitike të kthyer nga “A...” grupi përbëhet nga: E. I., L. M. dhe A. B..

Shpenzimet për riparimin e këtij difekti nuk duhet të përballoheshin nga APD, por nga shoqëria “S...” sh.a , pasi:

Më datë 04.04.2016 ndërmjet APD të përfaqësuar G. Sh. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “S...” sh.a është lidhur kontratë në vlerën 23,500,000 lekë me objekt sigurimi i pasurisë. Në këtë kontratë (termat e referencës) përveç të tjerave është përcaktuar “Mbulim shtesë-Dëmi nga aparaturat dhe pajisjet e shkaktuara nga rryma elektrike”. Ky sigurim mbulon;

-Dëmin në çdo makineri dhe apartura eletriike dhe elektronike, ose në çdo pjesë të instalimit elektrik dhe elektronik të shkaktuar nga rryma eletriike me ose pa ndodhjen e zjarrit.

-Dëmin në çdo makineri dhe aparatura eletriike dhe elektronike, ose në pjesë të instalimit elektrik/electronik si pasojë e rrufesë, nëse ky dëm nuk është shkaktuar nga goditja direkt ose indirekte e rrufesë. Shuma e siguruar e mbulimit shtesë të jetë 100 % e vlerës aktuale të objektit/pajisjeve/materialeve.

Konkretisht për kabinën 14 është mbuluar me sigurim: pajisje brenda kabinës eletriike KT 14’ Të gjitha rreziqet përfshirë “Zjarr, rrufe, ekspozion, rënie avionesh apo pjesë të tij mbi pasurinë, *dëmtime aksidentale nga mbitensioni*, stuhia, përmbytja. Bazuar në klasën 8 të sigurimit të aseteve sipas urdhërave të autoritetit të mbikëqyrjes financiare.

Si dhe



Nga A. D. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe të Zhvillimit dhe E. T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të MKM, duhet të ishte marr në konsideratë edhe fakti që që ndërmjet APD dhe Shoqërisë “A...” është lidhur kontrata nr.Reference 04PH2013 datë 01.03.2013, për mirëmbajtjen e shërbimeve elektrike. Për kë rast kjo shoqëri nuk ka zbatuar programi i mirëmbajtjes preventive dhe riparimit përkatëse në kohën e duhur në kabinën nr.14, referuar detyrimit kontraktor. Konkretisht në kontratën nr.Reference 04PH2013 datë 01.03.2013, shtojca A... në anën tjetër “Programi i mirëmbajtjes së pajisjeve energjitike”, pika 2.1 “Panele TM” është shprehur në mënyrë eksplicite në planinin e punës të muajit dhjetor 2016, sipas programit të mirëmbajtjes parandaluese të rënë dakort mindis sektorit të monitorimit të mirëmbajtjes dhe operatorit ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “.....*Simulimi i ndërhyrjes së mbrojtjes duke vepruar mekanikisht mbi dispozitivin e çkuçjes së çelësit. Për mbrojtjen nga rryma maksimale (50-51), dmbrojtjejn me tokën (50N-51N) dhe të tensionit minimal të tipit indirekt*” .

Në opinionin e grupit të auditimit

Referuar sa më sipër, A. D. me detyrë ish-drejtor i Drejtorisë Teknike dhe të Zhvillimit, E. T. me Detyrë Përgjegjës i Sektorit të MKM dhe A. L. në cilësinë e Drejtorit Të Përgjithshëm Ekzekutiv, nuk duhet të ishin nxituar për të kryer proceduren e prokurimit " Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës " në kundërshtim te ligjit nr.9643 dt 20.11.2006 " Për Prokurimin Publik", neni 33, pika 2, c) dhe VKM nr. 914 dt.29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik ", neni 36, pika2, gërma "c", duke dëmtuar APD-në dhe buxhetin e shtetit në vlerën 10,231,206 lekë, por referuar kontratës të sipërituar duhet që ky shpenzim të ishte përballuar nga shoqëria e sigurimit.

Theksojmë se në rregulloren e brendshme të APD-së të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr.8 datë 18.03.2016 është shprehur në mënyrë eksplicite se “Pika 24.2 Sektori i moninorimit të kontratave të mirëmbajtjes TIK, IC, EN *Sektori i monitorimit të kontratave TIK, IC, EN, është përgjegjës për mirëmbajtjen e aseteve duke menaxhuar dhe organizuar programet e mirëmbajtjes dhe riparimit të këtyre aseteve në pronësi të APD....*”

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 33, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar neni 36, Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligji nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Shkelja e dispozitave ligjore tëpërmendura simësipër, ngarkon me përgjegjësi A. D. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe të Zhvillimit, E. T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të MKM.

Vlera 10,231,206 lekë përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga A. D. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe të Zhvillimit dhe E. T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të MKM. Dëmshpërblimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850 datë 29.07.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Gjithsesi për arsyet dhe konstatimet e përmendura më lart, del më se e domosdoshmemarrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë të paligjshme me qëllimin e rivënisjes në vend të të drejtave të shkelura në favor të APD-së dhe për të evituar abuzimin e mëtejshëm që kryhet nga punonjësit e APD-së.



7.2. Për realizimin e procedurës së prokurimit me negociim pa shpallje, blerje emergjente furnizim vendosje 4 cillera dhe aksesori për sistemin e trajnimit të ajrit në godinën e administratës”, viti 2017.

Me urdhër nr.295, datë 30.01.2017 të A. L. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, është urdhëruar të kryhet procedura e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, për shkak të nevojës ekstreme të emergjencës së ndodhur më datë 30.01.2017, për blerje emergjente furnizim vendosje 4 cillera dhe aksesori për sistemin e trajnimit të ajrit në godinën e administratës.

Komisioni i specifikimeve teknike: E. T. Kryetar, L. M. Anetar, E. K. Antare.

Komisioni i negociimit: A. K. Kryetar, F.S. Anetar, F. M. Anetare.

Njësia e prokurimit: E. K., D. G., S. D..

Me procesverbal nr.47 prot, datë 30.01.2017 drejtuar A. D., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Teknike, për dijeni A. L., i hartuar nga E. T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të MKM-së, specialist i MKM-së L. M. dhe E. M., përfaqësuesi i A..., A. L., duke shprehur se “Sistemi i kondicionimit është jashtë pune dhe duhet të merren masa për zëvendësimin e pjesëve të dëmtuar, pasi sistemi rri në gjendje alarmi për shkak të mbingarkesës dhe të tejnxehjes për arrijtjen e temperaturave të punës. Referuar situatës së paraqitur nga operatori, shkuam tek taraca e ADM1, ku është vendosur sistemi i kondicionimit në prezencë të stafit të A... Pasi u njohëm me situatën e rëndë të ndodhur, **konstatohet se njëri nga grupet e kondicionimit ishte nxjerrë jashtë pune.** Nga operatori A... është bërë me dije me anë të shkresës nr.143 prot, datë 18.01.2017 ku është shprehur se sistemi i kondicionimit në ADM 1, **ka pasur dëmtime nga temperaturat e ulëta që kanë shkaktuar ngrirjen e ujit brenda në shkëmbyes,** pompat qarkulluese të sistemit të jashtëm, referuar urdhërit të hapur në MAINSAVER nr.CV124255 datë 09.01.2017 për zëvendësimin e pompave qarkulluese të dëmtuara dhe punojnë në kapacitet të kufizuar. Personat e sipërcituar konsatuan se situata ishte emergjente, pasi grupi i cillerave ishte jashtë pune dhe për vënien në punë të saj duhen zëvendësuar pjesët e dëmtuara. Aktualisht sistemi i trajtimit të ajrit të kondicionuar është jashtë funksionit për shkak të dëmtimeve që ka pësuar. Në këto rrethana të krijuara jemi në kushtet emergjente të zëvendësimit të këtyre pjesëve të dëmtuara, të cilat do të bënin kthimin në normalitet të sistemit të trajtimit të ajrit të kondicionuar. Kjo situatë e krijuar kërkon të merren masa urgjente për shkak se lihet në kushte të vështira pune Administra Qëndrore.

Ne dosje ekziston një dokument i firmosur nga E. T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të MKM-më, L. M. me detyrë Specialist i Sektorit të MKM-më dhe E. K. me detyrë specialist i Sektorit të Prognozes, në të cilën është shprehur në menyrë eksplicite se “I mbajtur sot me datën 30.01.2017 mbi gjendjen e avarise se ndodhur në sistemin qëndror të trajtimit të ajrit të kondicionuar në administratën kryesore të ADM-1. Në këto momente që po mbahet ky procesverbal në administratën qendrore ADM-1, nuk po punon sistemi i trajtimit të ajrit të kondicionuar për shkak të daljes nga puna të kompresorëve të grupit të cillerave dhe çarjes së shkëmbyesit, serbetin e jashtme. Për kthimin në punë me kapacitet të plotë duhen zëvendësuar pjesët.

Së pari.

Në fakt, kjo situatë nuk argumentohet si rast i një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje e paparashikuar, që nuk i ngarkohet autoritetit kontraktor dhe justifikon përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake, pasi mund të ishin bërë zgjidhje alternative për pajisje me ngrohësa administratës, deri sa të zbatoheshin procedurat ligjore për riparimin e difektit në sistemin e kondicionimit.

Së dyti.



Sic përshkruhet nga sa mësipër dëmtimi i sistemit ka ardhur nga mos kryerja e shërbimeve periodike, si përdorimi i antifrezës, deri sa deklarohet se sistemi i kondicionimit ka pasur dëmtime nga temperaturat e ulta që kanë shkaktuar ngrirjen e ujit brenda në shkëmbyes. Shërbimi periodik i sistemit të kondicionimit është rregulluar me kontratën me nr.Reference 04PH2013 datë 01.03.2013, lidhur ndërmjet APD-së dhe Shoqërisë A....

Referuar kësaj kontrate difekti i shkaktuar sistemit të kondicionimit, duhet të përballohesh nga kjo shoqëri. Por jo vetëm që nuk përballohet nga kjo shoqëri, e cila duhet të kishte marrë masa për ngrohje provizore të administratës me ngrohësa, por dhe të shpërblente dhe vlerën e dëmit të shkaktuar për riparimin e defektit.

Përpos sa mësipër, janë hequr nga puna 4 çillera, prej të cilave dy kanë qenë në gjendje pune, të cilat aktualisht janë sistemuar në magazinë, si pajisje jo rikupero.

Me procesverbal nr.326, datë 01.02.2017 E. T., L. M. dhe E. K. në cilësinë e grupit të përgatitjes së specifikimeve teknike dhe llogaritjes së vlerësimit ka përcaktuar specifikimet teknike dhe ka bërë llogaritjen e vlerësimit të kontratës.

Për llogaritjen e vlerësimit nuk ka dokumentacion se si është llogaritur vlera limit si dhe specifikimet teknike.

Me shkresën nr.309/1 prot, datë 01.02.2017 datë 01.02.2017 personi fizik G. K. në përgjigje të shkresës së dërguar nga APD-ja nr.309 prot, datë 31.01.2017, shpjegon se për momentin shoqëria jonë nuk i disponon këto materiale.

Me shkresën nr.308 prot, datë 31.01.2017 personi Shoqëria “2...” shpk në përgjigje të shkresës së dërguar nga APD-ja nr.308/1 prot, datë 01.02.2017, shpjegon se për momentin shoqëria jonë nuk i disponon këto materiale.

Me shkresën nr.310/1 prot, datë 01.02.2017 datë 01.02.2017 personi Shoqëria “A...” shpk në përgjigje të shkresës së dërguar nga APD-ja nr.310 prot, datë 31.01.2017, shpjegon se për momentin shoqëria jonë nuk i disponon këto materiale.

Me shkresën nr.311/1 prot, datë 01.02.2017 Shoqëria “M...” shpk në përgjigje të shkresës së dërguar nga APD-ja nr.311 prot, datë 31.01.2017, shpjegon se për momentin shoqëria jonë nuk i disponon këto materiale.

Me shkresën nr.342 prot, datë 02.02.2017 me titull ftesë për ofertë A. L. me Detyrë Drejtor Ekzekutiv në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, fton Shoqërinë “2...” shpk në procedurën e prokurimit negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “Blerje emergjente furnizim vendosje 4 çillera dhe aksesori për sistemin e trajnimit të ajrit në godinën e administratës”, me fond limit 12,154,229 lekë.

Me shkresën nr.341 prot, datë 02.02.2017 me titull ftesë për ofertë, A. L. me Detyrë Drejtor Ekzekutiv në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, fton Shoqërinë “2...” shpk në procedurën e prokurimit negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “Blerje emergjente furnizim vendosje 4 çillera dhe aksesori për sistemin e trajnimit të ajrit në godinën e administratës”, me fond limit 12,154,229 lekë.

Me shkresën nr.340 prot, datë 02.02.2017 me titull ftesë për ofertë, A. L. me Detyrë Drejtor Ekzekutiv në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, fton Shoqërinë “A...” shpk në procedurën e prokurimit negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “Blerje emergjente furnizim vendosje 4 çillera dhe aksesori për sistemin e trajnimit të ajrit në godinën e administratës”, me fond limit 12,154,229 lekë.

Me shkresën nr.339 prot, datë 02.02.2017 me titull ftesë për ofertë, A. L. me Detyrë Drejtor Ekzekutiv në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, fton Shoqërinë “B...” shpk në procedurën e prokurimit negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës me objekt “Blerje emergjente furnizim vendosje 4 çillera dhe aksesori për sistemin e trajnimit të ajrit në godinën e administratës”, me fond limit 12,154,229 lekë.



Me shkresen nr.338 prot, datë 02.02.2017 me titull ftesë për ofertë A. L. me Detyre Drejtor Ekzekutiv në cilesinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, fton Shoqërinë “P.I.” shpk në procedurën e prokurimit “Negocim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates me objekt “Blerje emergjente furnizim vendosje 4 cillera dhe aksesori për sistemin e trajnimit të ajrit në godinën e administratës”, me fond limit 12,154,229 lekë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga A. K., F. S. dhe F. M. ka skualifikuar shoqërinë “B.” me vlerë 12,134,000 lekë dhe ka kualifikuar shoqërinë “A...” në vlerën 11,989,200 lekë, “A...” në vlerën 12,100,360 lekë, duke shpallur fitues shoqërinë “A...” në vlerën 11,989,200 lekë.

Kontrata është lidhur me nr.348 prot, datë 03.02.2017 ndërmjet Autoritetit Portual Durrës përfaqësuar nga A. L. në cilësinë e Drejtorit të Pergjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “A...” shpk, me vlerë 14,385,840 lekë, sigurimi i kontratës në vlerën 1,438,584 lekë, pa afat të përcaktuar.

Me shkresën nr.365 prot, datë 06.02.2017, A. L. me Detyrë Drejtor Ekzekutiv në cilesinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, shkresë e pa adresuar me objekt formulari i publikimit të kontratës së nënshkruar (kopje e përmbledhur e cila do të publikohet në buletin”.

Shkeljet në procedurën e prokurimit janë pasqyruar në projektraportin e auditimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Zbatimi i kontratës

Me kërkesën për transfertë fondesh të datës 9 shkurt 2017 në vlerën 14,385,840 lekë nëpërmjet R. Bank, është likuiduar shoqëria “A.” shpk për blerje emergjente furnizim vendosje 4 cillera dhe aksesori për sistemin e trajnimit të ajrit në godinën e administratës”. Dokumentacioni që shoqëron këtë shpenzim: Fatura nr. 31, datë 08.02.2017 në vlerën 14,385,840 lekë. Situacioni i pa datuar në vlerën 14,385,840 lekë. Akt pranimi nr.1, datë 03.02.2017 i firmosur nga E. T. me profesion Inxhinier Informatike, L. M. me profesion Ing. Elektrik dhe E. K. me profesion Ekonomiste. Në këtë akt pranim është shprehur në mënyrë eksplicite se “Komisioni arriti në konkluzionin se artikujt janë në përputhje me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara”.

Me proceverbal të datës 20.02.2017 të firmosur nga L. M., E. I., operatori i mirëmbajtjes së aseteve përfaqësuar nga ing. A. L., dhe magazinieri A. C., janë lënë në ruatje grup cillera 4 copë, të cilët kanë bërë hyrje me fletë-hyrje pa numër datë 19.02.2017 të firmosur nga A. C. cillera 2x2=4. Fletë-hyrje e pa kontabilizuar.

Pajisjet e hequra (zëvendësuara) janë lënë në ruatje në magazinë, me fletë-hyrje pa nr., datë 19.02.2017. Kontabilizimi është kryer për vlerë të mbetur 6,061,713 leke në muajin Shkurt 2017 (Theksojme se 2 nga cillerat e vjetra nuk kanë paraqitur asnjë problem dhe janë në gjendje pune me vlere kontabel 8,000,000 leke-1,938,286 leke amortizim= 6,061,713). Kontabilizimi është kryer në magazinë rikupero me 0200018, datë 14.11.2017. Ndërsa 4 çillerat e reja janë kontabilizuar në muajin Shkurt 2017 në vlerën 11,988,200 lekë.

Për sa mësipër zëvendësimi i dy grupeve të çillerave është i pa nevojshëm, duke rritur koston e riparimit në mënyrë të pa justifikuar më një dëm ekonomik në vlerën 5,994,100 lekë (11,988,200 : 2=5,994,100)

Pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën “A...” shpk” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe



neni 10, si dhe VKM nr.369, datë 27.3.2008 “Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit".

Për pasojë Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të japë opinion e Tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “A...” shpk”, ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Deri në paraqitjen nga Shoqëria “A...” shpk të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “A...” shpk” ka fituar tenderin dhe është likuiduar, vlera 14,385,840 lekë për Autoritetin Portual Durres dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “A...” shpk.

Për sa mësipër mban përgjegjësi grupi i marrjes në dorezim i përbërë nga E. T., L. M., E. K.. Procedura me negociim pa shpallje paraprake të përshtetur si më sipër, nuk argumentohen si rast i një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje e paparashikuar, që nuk i ngarkohet Autoritetit Kontraktor.

Veprime në kundërshtim me:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 33, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, çka ngarkon me përgjegjësi Drejtorin e Përgjithshëm i APD-së, A.D. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Teknike, E. T. me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të MKM-së.

Koment: VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 36, ka përcaktuar “Autoriteti Kontraktor mund ta përdorë këtë procedurë në kushtet e mëposhtme:

a) Kur në përgjigje të dy procedurave të njëpasnjëshme mbi ose nën kufirin e ulët monetar, nuk është dorëzuar asnjë ofertë apo kërkesë për pjesëmarrje. Kushtet e kontratës dhe kriteret e veçanta të pranimit, që nuk lidhen përpjesëtimisht me fondin limit, nuk duhet të ndryshojnë nga ato të procedurës së fundit të anuluar. Në çdo rast, mosdorëzimi i asnjë oferte apo kërkesë për pjesëmarrje, nuk duhet të vijë si shkak i gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe/ose për shkak të ndonjë veprimi të autoritetit kontraktor.

b) Kur për arsye, që lidhen me mbrojtjen e së drejtës ekskluzive ose së drejtës së autorit, kontrata mund të lidhet me një operator të vetëm ekonomik. Ekzistenca e kushteve të mësipërme, duhet të vërtetohet dhe të dokumentohet nga autoritetet kontraktore.

c) Në rastin e një nevojë ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. “Në këtë rast, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme”

i) Shkaktimi i një ngjarjeje të paparashikuar;

ii) Autoriteti kontraktor nuk ka përgjegjësi për ngjarjen;

iii) Ngjarja mund të dëmtojë interesat e përgjithshëm të një komuniteti të gjerë;

iv) Nuk është e mundur të ndiqen procedurat standarde mbi ose nën kufirin e ulët monetar”.

Në të gjitha rastet, autoriteti duhet të vërtetojë, të argumentojë dhe të dokumentojë, se nevoja ekstreme apo situata emergjente, nuk janë shkaktuar nga veprimi a mosveprimi i tij. Neglizhenca apo vonesat në fillimin e procedurave normale të prokurimit nuk janë shkaqe, që argumentojnë zbatimin e kësaj procedure. Kjo procedurë nuk mund të zbatohet për të justifikuar lidhjen e kontratave afatgjata, por vetëm për përballimin e nevojës ekstreme. Me krijimin e nevojës ekstreme, autoriteti kontraktor duhet njëkohësisht, të marrë të gjitha masat për realizimin e procedurave normale të prokurimit.



d) Kur për lëvrime shtesë nga furnizuesi i mëparshëm, për zëvendësimin e pjesëshëm të lëvrimeve normale atë instalimeve, apo si shtesë e mallrave ose instalimeve ekzistuese, ndryshimi i furnizuesit do ta detyronte Autoritetin Kontraktor të kërkonte mallra me karakteristika të ndryshme teknike, që mund të rezultojnë në papajtueshmëri dhe në vështirësi të mëdha teknike për vënien në punë apo mirëmbajtjen e tyre.

Kontrata shtesë duhet të nënshkruhet brenda 3 muajve nga përfundimi i kontratës fillestare dhe vlera e saj nuk duhet të tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare.

dh) Për kontratat e shërbimeve ose punëve, nëse nevoja për punë/shërbime shtesë është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, që nuk varen nga autoriteti kontraktor, dhe që nuk mund të ndahen, teknikisht ose ekonomikisht, nga kontrata fillestare, pa sjellë ndikime negative ose kosto të mëtejshme për autoritetin kontraktor, por që janë të nevojshme për përfundimin e kontratës fillestare. Autoriteti Kontraktor mund ta përdorë këtë dispozitë vetëm me kusht që kontrata të lidhet me kontraktorin që po zbaton kontratën dhe vlera e plotë e kontratës shtesë të mos tejkalojë 20% të vlerës së kontratës fillestare.

3. Urdhri për prokurim, siç parashikohet në nenin 60 të këtyre rregullave, duhet të paraqesë arsyet e përdorimit të kësaj procedure. Pra nga njësia e prokurimit duhet të argumentojë në mënyrë të detajuar arsyet e përdorimit të kësaj procedure.

Në opinionin e grupit të auditimit

Procedura me negociim pa shpallje paraprake lejohet vetëm në rastin e një nevoje ekstreme, të shkaktuar nga ngjarje të paparashikuara, që nuk i ngarkohen autoritetit kontraktor. Në këtë rast, duhet të plotësohen të gjitha kushtet e përcaktuara në nenin 36/2/c të VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar. Në asnjë rast tjetër nuk legjitimohet përdorimi i kësaj procedure.

Autoritetet kontraktore me ndryshimet që ka pësuar si LPP-ja në vitin 2017 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, në datën 29.12.2017, lejohen të kryejnë procedura prokurimi para çeljes së fondeve buxhetore në vitin pasardhës. Konkretisht në VKM Nr. 914, datë 29.12.2014, neni 70 "Lidhja e kontratës", është shprehur në mënyrë eksplicite se: "*Zhvillimi i procedurës së prokurimit do të bëhet deri në momentin e shpalljes së njoftimit të fituesit, ndërsa lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 3, të nenit 21, të këtyre rregullave, dhe vetëm pasi fondi do të jetë në dispozicion (në llogarinë përkatëse) të Autoritetit Kontraktor*".

Në nenin 21/3 është shprehur në mënyrë eksplicite se "*Autoriteti Kontraktor do të ftojë operatorin ekonomik të shpallur fitues që të lidhë kontratën menjëherë pas publikimit të njoftimit të fituesit, por në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e këtij publikimi. Operatori ekonomik i shpallur fitues është i detyruar t'i përgjigjet kërkesës së Autoritetit Kontraktor për lidhjen e kontratës brenda 5 ditëve nga data e marrjes së kërkesës*".

Për sa parashtruar më lartë Autoritetet Kontraktore, për kryerjen e aktivitetit normal dhe një mbarëvajtje në kushte normale të punës dhe për të shmangur emergjencat, kanë të drejtë të zhvillojnë procedura prokurimi në përputhje me LPP-në dhe VKM Nr.914, datë 29.12.2014, duke pasur parasysh miratimin e buxhetit për vitin pasardhës, deri në shpalljen e fituesit, ndërsa kontrata nënshkruhet sipas përcaktimeve në nenin 70 të VKM nr.914, datë 29.12.2014, me çeljen e fondit në llogaritë përkatëse të Autoritetit Kontraktor.

Përpos sa mësipër shoqëria "A...", është në kushtet e Ligjit nr.9754, datë 14.06.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë" neni 3 gërma a. ku citohet:

"... Neni 3. – Përgjegjësia e personit juridik për kryerjen e veprës penale

Personi juridik ka përgjegjësi për veprat penale të kryera:

Në emër ose në dobi të tij nga organet dhe përfaqësuesit e tij; ..."



7.3. Për realizimin e procedurës së prokurimit vepër arti në ambjentet e APD-së, viti 2017.

Me urdhër transferte të datës 08.09.2017 për vlerën 8,559,500 lekë nëpërmjet bankës B. është likuajduar personi fizik A. N. për vepër arti në ambjentet e APD-së, pa dokumentacion të plotë justifikues. Konkretisht: Konkrata nr.1853, datë 04.07.2017 e lidhur ndërmjet APD-së përfaqësuar nga A. L. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe A. N. në cilësinë Artist i Diplomuar/qeramik në Fakultetin e Arteve të Bukura. Vlera 10,600,000 leke pa tvsh, afati 45 ditë nga nënshkrimi i kontratës. Vlera do të likujdohet; 95 % e shumës së kontratës do të paguhet me dorëzimin e veprës dhe 5 % në momentin e montimit të veprës. Kontraktuesi duhet ti japë Autoritetit Kontraktor garanci të sigurimit të kontratës në masën 10 % të vlerës totale të kontratës me TVSH që i korrespondon 1,060,000 lekë. Nuk ka të përcaktuar garancinë për difekte me afat respektiv, por citohet se "...Megjithatë 5 % e depozitës do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të kontratës, si dhe detyrimeve që parashikon neni 17.10 i kontratës. Në fakt në nenin 17.10 të kontratës është shprehur në mënyrë eksplicite se "Garancia e shërbimeve të furnizuara është sipas aneks kontratës. Në aneks kontratë përshkruhet projekti i veprës; formulari i ofertës; koha e realizimit; formulari i sigurimit të kontratës.

Kryerja e procedurës për realizimin e kësaj vepre arti është kryer në kundërshtim me Ligjin nr. 10352, datë 18.11.2010 "Për artin dhe kulturën", i ndryshuar, VKM nr. 510, datë 18.07.2012 "Për Shpalljen e Konkurseve Kombëtare dhe Ndërkombëtare për Realizimin e Veprave Monumentale të Artit Pamor", si dhe udhëzimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr. 1, datë 08.08.2012 "Mbi Proçedurat që ndiqen për Shpalljen e Konkurseve Kombëtare dhe Ndërkombëtare për Realizimin e Veprave Monumentale të Artit Pamor, kriteret e Vlerësimit dhe Dokumentacionin Ligjor".

Nuk është parashikuar në Plan Biznesin e Vitit 2017 dhe në asnjë Vendim të Këshillit Drejtues, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual", VKM nr.596, datë 10.09.2004 "Për miratimin e statutit të APD-së dhe për riorganizimin e tij", Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 28.12.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar".

Nga organi kompetent nuk është përcaktuar ku do të vendoset kjo vepër, si dhe nuk është nxjerrë leja e ndërtimit, në kundërshtim me Ligjin 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.408, datë 13.05.2015 "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit.

Në neni 8.1 të kontratës është përcaktuar se kontraktuesi duhet të dorëzojë film-dokumentar në cilësi, sasi dhe lloj të specifikuar në kontratë, si dhe të vendosura dhe të paketuara në mënyrë të përcaktuar në kontratën fillestare, fakt që nuk provohet të jetë dorëzuar.

Në nenin 9.1 të kontratës është përcaktuar se "Mallrat e furnizuara sipas kontratës duhet të jenë konformë kodeve dhe standarteve teknike të parashikuara në specifikimet teknike sipas Aneks Kontratës. Në fakt nuk provohet të ketë aneks kontratë. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në kodet përkatëse ose në standartet teknike, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pas aprovimit nga Autoriteti Kontraktor. Në fakt nuk provohet të ketë specifikime teknike dhe standarte, kode etj.

Në nenin 9.2 të kontratës është përcaktuar se "Me përjashtim të rasteve kur parashikohet nga ndonjë dispozitë tjetër e kontratës, kur nuk është përcaktuar asnjë standart teknik përkatës në specifikimet teknike, mallrat duhet të jenë konformë standarteve teknike ndërkombëtare të tanishme. Nëse nuk ekzistojnë standarteve teknike ndërkombëtare, mallrat



duhet të jenë konformë standarteve teknike përkatëse shqiptare. Në fakt nuk provohet të jetë zbatuar asnjë standart ndërkombëtar dhe shqiptar.

Projekti i veprës: Ka disa skicime të hartuara nga vet A. N., pa asnjë detaj teknik. formulari i ofertës ; koha e realizimit; formulari i sigurimit të kontratës.

Në dosje ndodhet llogaria bankare e A. N. tek banka B., por e pa specifikuar asnjë lloj NIPT-i, ç'ka do të thotë se A. N. nuk është person fizik tregtar, gjë që vërtetohet dhe nga mos paraqitja e asnjë dokumenti të regjistruar në organet tatimore.

Nga A. N. është lëshuar faturë blerje elektronike e datës 31.08.2017 për vlerën 10,070,000 lekë, i firmosur për blerje për APD-në nga B. M. me detyrë specialiste në Sektorin e Informacionit dhe Trajnimeve (Drejtorja e Burimeve Njerëzore) dhe A. N..

Sigurimi i kontratës fotokopje, datë 07.07.2017 nga shoqëria S... në vlerën 1,060,000 lekë.

Oferta e me numër protokoll 1799 datë 27.06.2017 në vlerën 10,600,000 lekë, firmosur nga A. N.

Njoftimi për dorëzimin e veprës së Artit Skulpturë nga A. N. është protokolluar në APD me shkresën nr.1853/4, datë 18.06.2017.

Me urdhër nr.1853/1 prot, datë 04.07.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm A. L. është ngritur grupi i marrjes në dorëzim i përbërë nga A. D., K. G., B. M..

Asnjë në grup nuk është specialist i fushës, veprim në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”.

Akt-pranimi i datës 1853/3 prot, datë 18.08.2017 është firmosur nga A. D. me profesion Ekonomist me Detyrë Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Teritorit dhe Ambjenteve dhe B. M. me Profesion Gazetare-Menaxhim Biznes, nuk ka firmosur K. G. i vetmi Inxhinier Ndërtimi në këtë komision.

Mbi bazën e këtij akt-pranimi është bërë hyrje në magazine nr.4, datë 18.08.2017 “Si mall në ruajtje” me emërtim malli “Vepër Skulptur” copë një, pa asnjë vlerë. Veprim në kundërshtim me VKM 510, datë 18.07.2012, KREU III “Procedura e realizimit të veprës” pika 2, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Artisti fitues është përgjegjës për realizimin dhe prodhimin fizik të veprës, deri në vendosjen e saj në sheshin e miratuar për vendosjen e monumentit.*”

Shkelja e dispozitave ligjore sa më sipër ngarkon me përgjegjësi ish-Drejtorin e Përgjithshëm për periudhën përkatëse, anëtarët që kanë firmosur akt pranimit A. D. dhe B. M..

Grupi i auditimit i kërkojë vlerësim teknik Drejtorisë Teknike, Sektorit Operativ të Mirëmbatjes Teknike, të një konstruksioni metalik i përbërë nga 13 struktura metalike të shkëputura, të sistemuara në magazinën nr.1, si mall në ruajtje. Ky sektor nën përgjegjësinë e tij lëshoi Vlerësimin Teknik të firmosur nga F. K. me profesion Tornitor, V. S. me profesion Saldator Oksigjenist, I. B. me profesion Mekanik Axhustator dhe H. K. me profesion Ing. Mekanik, është shprehur në mënyrë eksplicite se:

Objekti është konstruksion metalik i përbërë nga 13 struktura metalike të shkëputura, me forma të çrregullta gjeometrike, i ndërtuar:

-Llamarinë çeliku me spesor 2 mm baraz me 123.22 m².

-Profili i plotë çeliku me seksion katror 10x10 baraz 347.64 m².

-Tegel saldimi baraz me 392 ml.

Pra objekti referuar edhe këtij vlerësimi teknik nuk është vepër arti.

Për sa më sipër vlera 10,070,000 lekë përbën dëm ekonomik për APD-në dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga përfituesi A. N..

Me Urdhërin e Brendshëm të Drejtorit Ekzekutiv nr.1449, datë 09.05.2017 është urdhëruar marrja e masave për pajtimin e 2 specialistëve të jashtëm në fushën e artit skulpturë, të cilët



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

do të jenë pjesë e komisionit të jurisë të APD -së, për procedurën e realizimit e krijimit të një vepre arti- skulpture.

Për personat e lartë përmendur nga Drejtori Ekzekutiv janë nxjerrë urdhërat e emërimit të tyre si dhe janë lidhur kontrata të punës si më poshtë vijon:

1. Me Urdhërin e Brendshëm nr.1484.datë 12.05.2017, është emëruar Specialist i Parë S. P.. Marrëdhëniet financiare fillojnë më datë 15.05.2017. Është lidhur kontrata nr.316. Datë 17.05.2017 me afat 1-mujor. Me fillim të kontratës datë 15.05.2017 (me efekt prapaveprues). Me Urdhërin e Brendshëm nr.1729 datë 14.6.2017 është larguar, me ndërprerjet e marrëdhënieve financiare datë 15.6.2017.

2.Me Urdhërin e Brendshëm nr.1485. datë 12.05.2017, është emëruar specialisti i pare M. T., me fillim të marrëdhënieve financiare datë 15.05.2017. Është lidhur kontrata nr.315.datë 16.05.2017 me afat1-mujor. Me fillim të kontratës datë 15.04.2017 (me efekt prapa veprues). Me Urdhërin e Brendshëm nr.1730, datë 14.6.2017 është larguar me ndërprerje te marrëdhënieve financiare datë 15.6.2017.

3.Me shkresën nr. 1517, datë18.05.2017 ka dalë Urdhëri i Brendshëm për ngritjen e jurisë për procedurën me objekt "Shpallje e konkursit për procedurën e realizimit të ndërtimit të një vepre arti skulpturor të përbërë nga: F. S.-kryetar: S. S. dhe M. T.-Anëtar. PAGESAT E TYRE JANË KRYER NË LISTË PAGESAT E MUAJIT MAJ DHE QERSHOR 2017 (me list pagese të veçantë) kaluar në llogaritë bankare të tyre përkatësisht;

Nr.	Emërtimi	Paga bruto	Ndalesë sig.shoq. 11.2%	Ndalesë Tatim mbi të Ardhurat	Paga neto
1	S. S.	100.000 lek	11.200 lek	9.100 lek	79.700 lek
2	M. T.	100.000 lek	11.200 lek	9.100 lek	79.700 lek

Referuar për sa paraqitur sa më lart;

-Emerimet e dy specialisteve te jashtëm, lidhja e kontratave, si dhe përcaktimi i nivelit të pagës (specialisti i parë), sipas klasifikimit të strukture dhe nivelit të pagave të APD-së, janë në kundërshtim me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.5, datë 07.04.2017 "Mbi miratimin e strukturës dhe të nivelit të pagave për punonjësit e APD-së".

-Punësimi i tyre (specialist te jashtëm) është bërë në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014. "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 58 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Në rastin e mungesës së personelit Autoriteti Kontraktor mund të punësojë me kontratë si ekspert të jashtëm", pasi emërimi është bërë jo si ekspert të jashtëm por si specialist i parë dhe është lidhur kontratë individuale pune dhe jo kontratë shërbimi ku të përcaktoheshin orët e punës si dhe pagesa për orë pune.

- Ndalesa e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor është në kundërshtim me VKM nr.77, datë 28.01.2015" Për kontribute të detyrueshme përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor ". Kreu I, pika 1(Pra nuk duhej të siguroheshin).

-Ndalesa e tatimit mbi të ardhurat është në kundërshtim me Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat "të ndryshuar" neni 33, pika d ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "pagesat për shërbimet teknike të specialistëve të jashtëm janë të detyrueshme të mbahen në burim në masën 15% nga shuma e paguar".

Referuar dokumentacionit te paraqitur nga specialistët e jashtëm rezultoi se produkti punës është:

-Proces verbali datë 18.05.2017 për hartimin e kriterëve dhe mënyrën e zhvillimit të konkursit me objekt "Shpallje e konkursit për procedurën e realizimit të ndërtimit të një vepre arti skulpturore".



- Proces verbali datë 14.06.2017 mbi dorëzimin dhe hapjen e ofertave
- Proces verbal padatë i mbajtur nga M. T. mbi vlerësimin e bocetave
- Proces verbal padatë i mbajtur nga S. S., mbi vlerësimin e bocetave
- Raport përmbledhës nr.174 datë 16.06.2017 mbi realizimin e procedurës së konkursit
- Nuk ka të dokumentuar prezencën në punë për periudhën 1 mujore të paguar nga APD-ja, në kundërshtim me udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve ne njësitë e sektorit publik” neni 69, i ndryshuar.
- Fondi gjithsej i paguar për 5 specialistë të jashtëm në shumën 583.500 lekë (500.000 lekë page + 83.500 leke sig.shoq/shendetësore nga institucioni) nuk është përfshirë në fondin e pagave dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të planifikuar dhe miratuar në Plan Biznesin e Vitit 2017 nga Këshilli Drejtues.

7.4. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje Filmi”,viti 2017.

Me urdhër nr.1557/1, datë 24.05.2017 të A. L. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur grupi i punës me qëllim mbikëqyrjen, kontrollin dhe zbatimin e procedurës së realizimit të dokumentarit i përbërë nga A. M., S. T., B. M..

Me urdhër nr.1401, datë 04.05.2017 të A. L. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, është miratuar fondi limit dhe kriteret e vendosura nga komisioni i negocimit dhe është lejuar të vazhdonte me hapat e procedurës së prokurimit.

Me procesverbal të datës 12.05.2017 komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga A. K., F. H., P. B., E. I., A. P. ka zgjedhur si ofertë fituese “P. F. P.” me vlerë 5,800,000 lekë. Në këtë procedurë kanë marrë pjesë operatorët ekonomik “P. P.” për vlerë 5,770,000 lekë, “E. P. D.” për vlerën 5,780,000 lekë dhe operatori ekonomik “P. F. P.” për vlerën 5,800,000 lekë.

Me urdhër nr.735, datë 09.03.2017 të A. L. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor, është ngritur komisioni i cili do të përcaktojë objektivat dhe detyrat përkatëse për mbarëvatjen dhe realizimin sa më të mirë të këtij dokumentari, i përbërë nga M. B., E. K., B. M..

Me urdhër xhirimin nr.serie 1368596 datë 27.06.2017 në vlerën 1,680,000 lekë, nëpërmjet C. Bank është likuaduar shpenzime në favor të subjektit “P. F. P.” shpk për realizimin e filmit dokumentar për historikun dhe aktivitetin ndër vite të Portit Durrës, pa dokumentacion të plotë dhe të rregullt justifikues. Konkretisht:

Dokumentacioni; Faturë tatimore nr.15, datë 21.06.2017 për vlerën 1,680,000 lekë, likujdim kësti 20 %. Relacion drejtuar APD-së të firmosur nga D. P., ku përshkruhen filmimet që janë bërë. Akt-pranimi me nr.1557/2 prot, datë 22.06.2017 me objekt mbi marrjen pjesore në dorëzim të shërbimit të kontratës me objekt “Realizimi i një filmi dokumentar për historikun dhe aktivitetin ndër vite të Portit të Durrësit”, të firmosur nga B. M. dhe A. M..

Me urdhër transferte pa nr.Serie, datë ___- në vlerën 5,232,000 lekë, nëpërmjet C. Bank është likuaduar shpenzime në favor të subjektit P. F. P. shpk për realizimin e filmit dokumentar për historikun dhe aktivitetin ndër vite të Portit Durrës, pa dokumentacion të plotë dhe të rregullt justifikues. Konkretisht:

Dokumentacioni; Faturë tatimore nr.16, datë 24.07.2017 për vlerën 5,232,000 lekë, likujdim sipas kontratës nr.1557, datë 24.05.2017, kesti 80 %. Akt-pranimi me nr.1993 prot, datë 28.07.2017 me objekt mbi marrjen në dorëzim të shërbimit të kontratës nr.1557, datë 24.05.2017 me objekt “Realizimi i një filmi dokumentar për historikun dhe aktivitetin ndër vite të Portit të Durrësit”, të firmosur nga B. M., A. M., S. T..



Nga auditimi i termave të referencës, nuk konstatohet mënyra e përllogaritjes së fondit limit në vlerën 5.800.000 lekë pa TVSH, si dhe në termat e referencës përcaktohet që “transmetimi nuk përfshihet në kontratë”.

Veprim në kundërshtim me VKM nr.1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin e bashkëprodhimin e programeve a të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administrates shtetërore”, kreu II, pika 6, e cila përcakton se “Titullari i institucionit urdhëron, me shkrim, blerjen, zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve a të reklamave, transmetimin nga operatorët radiotelevizivë ose botimin në median e shkruar dhe procedurat për kontratat për kohë transmetimi për çdo rast, duke parashikuar objektin, nevojën e kryerjes së programit/reklamës/spotit, shpeshtësinë dhe periudhën e shfaqjes së tij, fondin limit, numrin e televizioneve dhe përbërjen e komisionit, për ndjekjen e procedurave”.

Nga testimi i tregut u konstatua se vlera e përllogaritur e kontratës duhet të ishte 1,450,000 lekë, me një diferencë në vlerën 4,350,000 lekë e cila ka rendur padrejtesisht buxhetin e APD dhe te shtetit.

Negociatat

Me shkresën datë 07.04.2015, drejtuar T. F. I., A.-F., S.-N., N.-F. dhe B. Sh., thuhet se janë dërguar ftesat për negociata. Por, grupi i auditimit nuk konstatoi asnjë provë për dërgimin e këtyre ftesave, pasi nuk ka konfirmim për dërgim zyrtar postar. Po kështu, i dyshimtë është fakti që për këto ftesa kishte vetëm një numër protokolli.

Nga ana tjetër, ftesa për negociata nuk përmbante objektin e programit/reklamës/spotit, nevojën e kryerjes së programit/reklamës/spotit, shpeshtësinë dhe periudhën e shfaqjes së tij dhe fondin limit, në kundërshtim me VKM nr.1195, datë 05.08.2008.

Shpallja

Komisioni i negociimit ka vendosur të kualifikojë e të shpallë fitues ofertën e personit fizik P. F. P. SHPK me vlerë 5.130.000 lekë pa TVSH, si dhe të skualifikojë ofertat e operatorëve të tjerë ekonomikë të tjerë për arsye se ishin mbi fondin limit.

Shkeljet e tjera në këtë procedurë prokurimi janë ato të pasqyruar në projektraportin e grupit të auditimit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Pagesat

Në kontratën e lidhur mes dy palëve u vendos kryerja e një pagese paraprake në masën 60% të vlerës së kontratës, por kur një pagesë e tillë nuk parashikohej në termat e referencës. Sipas këtij procesverbali, janë dorëzuar në CD kopje të dokumentarit “Portat e Qiellit”, me kohëzgjatje 51 minuta e 45 sekonda. Pagesa është kryer në 2 këste.

Abuzimi

Nisur nga mangësitë e konstatuara në lidhje me këtë procedurë, të kryer në shmangie të legjislacionit të prokurimit publik, si dhe faktit që për këtë film nuk provohet dhe as dokumentohet të jetë shfaqur në asnjë media, por thjesht ai marrë në dorëzim dhe lënë në arkivën e institucionit, duke mos argumentuar nevojën e kryerjes dhe përfitimit të këtij shpenzimi, vlera 6.156.000 lekë me TVSH, përbën një shpenzim të paligjshëm me pasojë dëm ekonomik për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin “Për prokurimin publik” dhe Ligjin “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Vlera 6.156.000 lekë përbën një shpenzim të paligjshëm me pasojë dëm ekonomik për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga subjekti “P. F. P.”.

Përveç shpenzimit të harxhuar për realizimin e filmit në vlerën 6.156.000 lekë me:



-Urdhër nr.1795 prot, datë 27.06.2017 të A. L. është likujduar B. M. me detyrë Specialiste në Sektorinë Promocionit dhe Trajnimeve për shpërblim 26 orë mbi kohën normale të punës për muajin Qershor 2017, për vlerën 16,797 lekë

Udhër nr.1990 prot, datë 27.06.2017 të A. L. është likujduar B. M. me detyrë Specialiste në Sektorinë Promocionit dhe Trajnimeve për shpërblim 30 orë mbi kohën normale të punës për muajin Korrik 2017, për vlerën 19,381 lekë

Si konkluzion

Shpenzimet në vlerën 36,178 lekë të B. M. janë shpenzime të dubluara (pagesë të dubluar) me kontratën nr.1557, datë 24.05.2017 me objekt “Realizimi i një filmi dokumentar për historikun dhe aktivitetin ndër vite të Portit të Durrësit”, **Vlera 36,178 lekë përbën dëm ekonomik për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit**, vlerë e cila duhet të zhdëmtohet nga B. M.. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 77 “Mbikqyrja e kontratës” të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave me nr.30 datë 27.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorin Publik”, ç’ka ngarkojnë me përgjegjësi ish-Drejtorin e Përgjithshëm për periudhën përkatëse dhe B. M. me detyrë Specialiste në Sektorinë Promocionit dhe Trajnimeve dhe A. M..

7.5. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje e 2 (dy) reduktorëve të ulje-ngritjes dhe montimi në vend në vinçin Mobil Mhc-115”,viti 2017.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit te autoriteti kontraktor A. L. Nr.296 datë 30/01/2017	Ngritur me urdhrin Nr.297 datë 30/01/2017 (me korrigjim)	Ngritur me urdhrin Nr.296 datë 30/01/2017
Vlera e përlogaritur e kontratës pa 42.000.000 lekë pa Tvsh.	1- A. K.-Shkenca Politike	1.E. K.-Jurist
Procedurë e hapur	2- L. B.- Ing. Mekanike	2.J. R.- Juriste
Bashkimi i Operatorëve ekonomikë fitues: “A...” SHPK dhe A. K. (Person Fizik), Vlera e ofertës 41.750.000 lekë pa TVSH.	3- Y. K.- Ing. Mekanike Ndryshuar me urdhrin Nr.297/1 datë 22/02/2017 Anëtarë L. B., me 2- A. Gj.- Ing. Mekanike	3.S. D.-Jurist.
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor dt.07.03.2017	Njoftim i kontratës, botuar në buletinin e APP dt. 06 Shkurt 2017	Tenderi i zhvilluar me dt. 23/02/2017, ora 10.00
Bashkimi i Operatorëve ekonomikë - “A...” SHPK dhe A. K. (Person Fizik)Kontratë Nr.944 datë 28.03.2017 me vlerë 50.100.000 Lekë me TVSH	Ofertat e paraqitura 2 Operatorë Ekonomikë	Kualifikuar 1
Njoftim klasifikimi është bërë elektronikisht.27. 02. 2017	Njoftim fituesit, botuar në buletinin e prokurimit publik 13Mars 2017	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletinin e APP 03Prill 2017, faqe 405-406



Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së, u konstatua se:

Nevoja e këtij investimi, programi i blerjeve të APD-së, i miratuar për vitin 2017.

Me shkresën e protokolluar me nr.81, datë 13.01.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje e 2 (dy) reduktorëve të ulje-ngritjes dhe montimi në vend në vinçin Mobil MHC-115”, me përbërje: A. C. me profesion Inxhinieri Fizike, E. M., me profesion Jurist, dhe D. D. me profesion Inxhinieri Elektronike.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 42.000.000 lekë, pas ofertës të ofruar për vlerën 42.000.000 lekë nga “T. C.” (Ish F.. R... – Kompania prodhuese e vinçit), për vlerën 42.000.000 lekë nga shoqëria “A...” SHPK për vlerën 44.000.000 lekë nga Shoqëria “A...” SHPK.

Vlera 42.000.000 lekë, është marrë si vlera më e vogël e ofruar. Pra në përlllogaritjen e vlerës të kontratës, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, apo çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK-ja, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementët e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”. Veprimi i cili ngarkon me përgjegjësi grupin e përbërë nga A. C., E. M., D. D..

Me shkresën e protokolluar me nr.81/8, datë 30.01.2017, drejtuar Përgjegjës të Sektorit të Prokurimeve, Kryetari i Komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje e 2 (dy) reduktorëve të ulje-ngritjes dhe montimi në vend në vinçin mobil MHC-115”, ka përcjellë dokumentacionin e plotë të përfunduar nga anëtarët e komisionit.

Me shkresën e protokolluar me nr.296, datë 30.01.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i prokurimit, me objekt “Blerje e 2 (dy) reduktorëve të ulje-ngritjes dhe montimi në vend në vinçin mobil MHC-115”, me fond limit 42.000.000 (dyzet e dy milionë)lekë pa tvsh, në të cilin janë caktuar anëtarët e njësisë së prokurimit, me përbërje: E. K., J. R. dhe S. D., të tre me profesionin jurist.

Më datë 30.01.2017, është mbajtur nga anëtarët e njësisë së prokurimit, procesverbali për hartimin e dokumentave të tenderit, i firmosur prej tyre.

Me shkresën e protokolluar me nr.297, datë 30.01.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm për ngritjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, me përbërje: A. K. me profesion Shkenca Politike, L. B. me profesion Inxhinieri Mekanike, dhe Y. K. me profesion Inxhinieri Mekanike.

Me shkresën e protokolluar me nr.297/1, datë 22.02.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm për ndryshimin e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, L. B. me A. Gj. me profesion Inxhinieri Mekanike.

Me shkresën e protokolluar me nr.298, datë 30.01.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është bërë formulimi i njoftimit të kontratës, i cili është botuar në buletin e prokurimit publik me nr.5, datë 06.02.2017.

Me procesverbal datë 23.02.2017, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali i dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

Me procesverbal datë 27.02.2017, është mbajtur nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave procesverbali paraprak mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave.



Me shkresën nr.702 prot., datë 07.03.2017, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar raportin përmbledhës për këtë procedurë prokurimi, raport i cili është miratuar prej tij.

Referuar sistemit dhe raportit përmbledhës në këtë procedurë kanë marrë pjesë:

Operatori ekonomik “N...” SH.P.K , me vlerë të ofruar 34.100.000 lekë pa T.V.Sh dhe Operatori ekonomik “A...” SH.P.K, me vlerë të ofruar 41.750.000 lekë pa T.V.Sh.

Nga KVO është kualifikuar Operatori ekonomik “A...” SH.P.K, dhe është skualifikuar Operatori ekonomik “N...” SH.P.K.

Operatori ekonomik N... SH.P.K, me **NIPT: K 81615002 O**, me vlerë të ofruar 34,100,000 lekë pa t.v.sh. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur elektronikisht në www.app.gov.al rezulton që ky operator ka mangësi në përmbushjen e kriterëve teknike dhe ligjore të kërkuara në dokumentet e tenderit pasi:

Kompania H. Gjermani, që do të bëjë furnizimin e reduktorëve të ulje ngritjes për vinxhin MHC 115;

a) Nuk ka si objekt të aktivitetit të saj prodhimin e pajisjeve dhe mekanizmave ngarkuese në porte,

b) Nuk ushtron aktivitetin e saj në fushën e prodhimit të pajisjeve dhe mekanizmave ngarkuese në industri dhe Porte, duke mos plotësuar seksionin 2.3 pika 2 e dokumentave të tenderit të publikuara ne www.app.gov.al dhe te pranuar nga ofertuesi i mësipërm,

c) Nuk ka paraqitur Akt marrëveshje ose kontratë bashkëpunimi ndërmjet tij dhe një specialisti të licensuar dhe kualifikuar nga prodhuesi.

Kompania gjermane H. GMBH, nuk ka si objekt te saj prodhimin e pajisjeve dhe mekanizmave ngarkuese vetëm në porte, por ka si objekt prodhimin e pajisjeve dhe agregateve pneumatike industriale për pajisje dhe mekanizma çfarëdo qofshin në porte apo jo. Kompania gjermane H. GmbH, nuk ushtron aktivitetin e saj vetëm në fushën e prodhimit të pajisjeve dhe mekanizmave ngarkuese në industri dhe Porte, por ushtron aktivitetin e saj në fushën e prodhimit të pajisjeve dhe mekanizmave ngarkuese në gjithë gamën e industrisë duke mos përjashtuar Portet. Kjo kompani ka lëshuar një deklaratë duke u shprehur që garanton se reduktorët e kërkuar i furnizon kjo kompani. Referuar ëbsitit të kësaj shoqërie, Kompania gjermane H. GMBH, është nje kompani e cila prodhon, konsulton dhe shpërndan pajisje hidraulike, pneumatike dhe industriale. Ajo projektton në menyre të planifikuar, riparon duke dhënë ekspertizën teknike dhe jep këshilla teknike me ekspertët e saj. Referuar profilit të kompanise gjermane H. GmbH, katalogut te paraqitur, punëve të ngjashme të paraqitura që kjo kompani përmbush kriterin e aktivitetit të saj në prodhim pajisjesh pneumatike industriale. Edhe në fushën e çertifikimit DIN ISO 9001 : 2008 të kësaj kompanie jepen qartësisht sfera e punës së kësaj kompanie. Reduktorët e kërkuar jane pajisje agregate industriale të cilat janë brenda fushës së çertifikimit të kësaj kompanie. Autoriteti Kontraktor po kërkon të furnizohet me nje agregat të një vinçi dhe nuk po blen vinç, gjë të cilën kompania gjermane H. GmbH e ka garantuar me deklaratën nën përgjegjësinë e saj.

Referuar përsëri websitit të kompanisë, kjo kompani koperon me kompani ndërkombëtare në fushën e pajisjeve hidraulike, pneumatike dhe pajisjeve industriale. Kompania gjermane H. GmbH është edhe distributor i disa kompanive të tjera siç tregohet ne ëbsitin e mëposhtëm;

<https://www.hypneu.de/en/benefits/trade/top-brands.html>

Referuar këtij websiti paraqitet lista e kompanive korente te distribucionit qe H. Group përfaqëson. Në këtë ëbsite shohim që kompania **B. P. GmbH**, e cila është prodhuese e reduktorëve të kërkuar (Shoqëria A... ka dorëzuar reduktorët e prodhuar nga kompania B...), është pjesë e partneritetit me H. Group, e cila nëpërmjet një marrëveshje biznesi me Shoqërinë N... ka marrë përsipër të furnizojë me reduktorët e kërkuar Autoritetin Portual



Durrës. Nëpërmjet dokumentit “**Marrëveshje Biznesi**”, nënshkruar nën përgjegjësinë e kompanisë Gjermane H. GmbH, kjo kompani garanton se do të prodhojë, furnizoje sipas kërkeses teknike reduktoret e kerkuar dhe do ti japi te gjithë suportin ne prodhim, testim ne fabrikë , instalim dhe të gjitha shërbimet e tjera të kërkuara në dosjen e tenderit të përmendur. Përderisa kompania Gjermane H. GmbH, ka deklaruar se do ti japi operatorit N..., “të gjithë suportin në prodhim, testim në fabrikë, **instalim dhe të gjitha shërbimet e tjera të kërkuara në dosjen e tenderit të përmendur**”, KVO-ja padrejtësisht ka skualifikuar operatorin N.. Për të saktësuar vendimarrjen e saj KVO-ja, nuk ka bërë asnjë sqarim, asnjë komunikim me Kompaninë gjermane H. GmbH për vlefshmërinë e marrëveshjes së nënshkruar nga kjo Kompani dhe garancitë për furnizimin dhe dhënien e të gjithë suportit teknik dhe montimin apo instalimin e reduktorëve në vend. Mbas këtij sqarimi të detyruar duhet të ishte shprehur për bashkëpunimin midis tij dhe një specialisti të licensuar dhe kualifikuar nga prodhuesi. Reduktoret e vincit MHC 115 janë prodhim i kompanisë B... (vertetuar nga dokumentet e dorëzuara nga operatori fitues A...) dhe kompania gjermane H. GmbH ka të drejtën e distribucionit të produkteve të kompanisë B..., kjo e vërtetuar nga websiti me sipër . Në këto kushte Ofertuesi N... është në plotësim të kërkesës për instalimin e reduktoreve në vend, pasi mosparaqitja vetem e këtij dokumenti **nuk cënon thelbin e ofertës, çmim me të ulët dhe plotësim të specifikimeve teknike.**

Nisur nga verifikimet e mësipërme KVO-ja ka skualifikuar me të padrejtë Shoqërinë N... SH.P.K , me vlerë të ofruar 34.100.000 leke pa T.V.SH. dhe duke kualifikuar kompaninë A... SH.P.K, me vlerë të ofruar 41.750.000 leke pa T.V.SH.

Me shkresën nr.703 prot., datë 07.03.2017, të firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor, është miratuar procedura e prokurimit.

Me shkresën e protokolluar me nr.704 prot., datë 07.03.2017, të firmosur nga titullari i Autoritetit Kontraktor, është bërë formulimi i njoftimit të fituesit, i cili është botuar në buletin e prokurimit publik me nr.10, datë 13.03.2017.

Protokolluar me nr.917, datë 27.03.2017, shoqëria “A...” SHPK ka paraqitur pranë APD, dokumentacionin e hedhur ne sistemin elektronik të prokurimit, për këtë procedurë prokurimi.

Kontrata është lidhur me nr.944 prot, datë 28.03.2017 ndërmjet A. L., në cilësinë e drejtorit Ekzekutiv të APD dhe kontraktuesve “A...” SHPK dhe A. K. (Person Fizik), në vlerën 50,100,000 Lekë me TVSH, kontrata duhet te fillojë zbatimin me nënshkrimin e saj (pra më datë 28.03.2017), me kohëzgjatje 30-ditë dhe ndjekës kontrate është caktuar A. C.. Kontrata shoqërohet nga sigurimi i kontratës, formulari i ofertës, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, lista e artikujve të prokuruar, oferta teknike, deklarata mbi dorëzimin e mallit, specifikimet teknike dhe katalogët përkatës, deklarata e garancisë, skeda teknike dhe kontrata e bashkëpunimit.

Referuar konstatimeve të mësipërme, operatori ekonomik “A...” SHPK, nuk duhej kualifikuar, e për pasojë Autoriteti Kontraktor duhej të vazhdonte me anulimin e kësaj procedure. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni24, pika 1dhe nenin 53, pika3, si dhe me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", indryshuar, neni73, pika1.

Për sa më sipër, lidhur me këtë pikë, ngarkon me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

Në këto kushte, kur nga ana e KVO-së është vlerësuar në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik, ku operatorët ekonomik ofertues pjesëmarrës në tender është kualifikuar pa të drejtë, vlera **prej 9,180,000 lekë** (41.750.000 -34.100.000 =7,650,000 x 1.2 TVSH =



9,180,000), që përbën diferencën midis operatorit ekonomik "A..." SHPK, që është kualifikuar pa të drejtë dhe ofertës më të ulët të ofruar nga Shoqëria "N..." SH.P.K.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar:

- neni 2, është shprehur në mënyrë eksplicite se: "*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:*

a) *mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidateve;*

b) *transparencë në procedurat e prokurimit;*

c) *barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidateve".*

- neni 12, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "*Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij".*

Parimi i barazisë përpara Ligjit është trajtuar në disa çështje të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese. Kështu që në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007 ".....Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të Kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara Ligjit, jo vetëm në të drejta themelore të parashikuara në kushtetutë, por edhe në të drejta të tjera ligjore". Parimi i barazisë është saksionuar dhe në Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Referuar sa më sipër kualifikimi, shpallja fitues e bashkimit të operatorëve "2...", si dhe lidhja e kontratës, është kryer ***në mënyrë të padrejtë***, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", i ndryshuar, Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", çka ngarkon me përgjegjësi anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Si konkluzion të argumenteve të përmendur si më sipër, grupi i auditimit konstaton se veprimet e lartë përmendura të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, janë shkelje e rëndë e legjislacionit në fuqi dhe përbëjnë një shprehje flagrante të zbatimit të gabuar të Ligjit dhe të abuzimit me detyrën.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave, ***duke sjelle një dëm ekonomik për APD-në dhe Buxhetin e Shtetit në vlerën 9,180,000 lekë.***

Gjithsesi për arsyet dhe konstatimet e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktik të paligjshme me qëllimin e rivënies në vend të të drejtave të shkelura në favor të subjekteve private dhe për të evituar abuzimin e mëtejshëm që kryhet nga punonjësit e shoqërisë.

Me shkresën nr.992 prot, datë 29.03.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, formulari i njoftimit të kontratës të nënshkruar i është dërguar APP-së, e cili është botuar në buletinin e prokurimit publik nr.13, datë 03.04.2017.

Me urdhërin e brendshëm nr.993 prot, datë 29.03.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, janë caktuar: A. C., me profesion Inxhinieri Fizike, si përfaqësues i kontratës, dhe është ngritur komisioni i kontrollit dhe pranimit të shërbimeve, me Kryetar – A. C., anëtarë: D. D., me profesion Inxhinieri Elektronike dhe E. M., me profesion Jurist.

7.6. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt "Blerje materiale elektrike dhe elektronike për elektrovinça", viti 2017 me këto të dhëna :



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor A. L. Nr.1465, datë 10.05.2017	Ngritur me urdhrin Nr.1466 datë 10/05/2017 1- A. K. – Shkenca Politike 2-M. B.-Administrim Biznesi 3-A. B.- Ing. Elektrike	Ngritur me urdhrin Nr.1465 datë 10/05/2017 1. E. K. -Jurist 2. D. G. -Ekonomist 3. S. D.- Jurist.
Vlera e përlllogaritur e kontratës 30.575.929 lekë pa Tvsh.		
Procedurë e hapur		
Bashkimi i Operatorëve ekonomikë fitues, shoqëritë: “2...” dhe “V...” SHPK, Vlera e ofertës 29.998.429lekë, pa TVSH.		
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor më datë 13.10.2017.	Njoftim i kontratës, botuar në buletin e APP dt. 15 Maj 2017	Tenderi i zhvilluar me dt. 05/06/2017, ora 10.00
BOE - “2...” dhe “V...” SHPK Kontratë Nr.2528 prot, datë 17.10.2017, me vlerë 35.998.115 Lekë me TVSH.	Ofertat e paraqitura 4 Operatorë Ekonomikë	Kualifikuar 1
Njoftim klasifikimi është bërë elektronikisht më 19.06.2017	Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik 23Tetor 2017	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletin e APP 23Tetor 2017, faqe 189-190

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit elektronik të APP-së, u konstatua se:

Nevoja e këtij investimi, programi i blerjeve të APD-së, i miratuar për vitin 2017.

Me shkresën e protokolluar me nr.150, datë 19.01.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë Urdhëri i Brendshëm mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Materiale Elektrike dhe Elektronike për Elektrovinxha”, me përbërje: L. M. (Kryetar), me profesion Inxhinieri Elektrike, A. C. me profesion Inxhinieri Fizike dhe Marsela Maksuti me profesion Ekonomiste.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 30,575,929 lekë, pas ofertës të ofruar për vlerën 30,493,629 lekë nga shoqëria “2...” shpk, për vlerën 31,165,828 lekë nga shoqëria “A.L.I.” Shpk për vlerën 29.488.530 lekë nga Shoqëria “V...” Shpk”.

Vlera 30,575,929 lekë, nuk përcaktohet se si ka dal, për arsye se edhe po të bëhet mesatarja e tre ofertave të ofruara përlllogaritja del 30,382,987 lekë dhe jo 30,575,929. Pra në përlllogaritjen e vlerës të kontratës, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, apo çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementët e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”. Veprimi i cili ngarkon me përgjegjësi grupin e përbërë nga L. M., A. C. dhe M. M..

Me shkresën nr.150/10, datë 10.05.2017, drejtuar Drejtori Ekzekutiv dhe Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimeve, Kryetari i Komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe



përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës L. M., ka përcjellë dokumentacionin e plotë të përfunduar nga anëtarët e komisionit.

Me shkresën e protokolluar me nr.1465, datë 10.05.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i prokurimit, me objekt “Blerje Materiale Elektrike dhe Elektronike per Elektrovinxha”, me fond limit 30,575,929 (tridhjetëmilion e pesëqind e shtatedhjetë e pesëmijë e nëntëqind e njëzet e nëntë) lekë pa tvsh, në të cilin janë caktuar anëtarët e njësisë së prokurimit, me përbërje: E. K. me profesion Jurist, D. G. me profesion Ekonomist, dhe S. D. me profesion Jurist.

Më datë 10.05.2017, është mbajtur nga anëtarët e njësisë së prokurimit, procesverbali për hartimin e dokumentave të tenderit për këtë procedurë prokurimi, i firmosur prej tyre.

Me shkresën e protokolluar me nr.1466, datë 10.05.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, me përbërje: A. K. (Kryetar) me profesion Shkenca Politike, M. B. me profesion Administrim Biznesi dhe A. B. me Profesion Inxhinieri Elektrike.

Me shkresën e protokolluar me nr.1467, datë 10.05.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është bërë formulimi i njoftimit të kontratës, i cili është botuar në buletin e prokurimit publik me nr.19, datë 15.05.2017.

Më datë 05.06.2017, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali i dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

Më datë 19.06.2017, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali i kualifikimit, si dhe procesverbali mbi vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave.

Me nr.1785, datë 23.06.2017, është protokolluar në APD formulari i ankesës pranë autoritetit Kontraktor nga shoqëria “S...” SHPK.

Me shkresën nr.1785/1 prot., datë 23.06.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri për pezullimin e procedurës, si dhe është ngritur komisioni për shqyrtimin e ankesës, me përbërje: F. H., L. K. dhe E. J..

Me shkresën nr.1785/2 prot., datë 28.06.2017, të firmosur nga anëtarët e komisionit për shqyrtimin e ankesës me nr.1785 prot., datë 23.06.2017, i kanë drejtuar vendimin e tyre Drejtorit Ekzekutiv të APD-së.

Me shkresën nr.1785/3 prot., datë 28.06.2017, i është kthyer përgjigje për ankesë me nr.1785 prot., datë 23.06.2017, shoqërisë “S...” SHPK.

Me nr.1888, datë 10.07.2017, është protokolluar vendimi i komisionit të prokurimit publik nr.1232/1 protokoll, datë 07.07.2017.

Me shkresën nr.1888/1, datë 12.07.2017, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion mbi procedurën e prokurimit.

Me shkresën e protokolluar në APD me nr.2121, datë 29.08.2017, ka ardhur vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik, bashkëlidhur.

Me shkresën nr.2163 prot., datë 29.08.2017, të firmosur nga Drejtori Ekzekutiv APD-së i është drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, për ç’pezullimin e procedurës së prokurimit.

Me shkresën nr.2496 prot., datë 13.10.2017, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave ka hartuar raportin përmbledhës për këtë procedurë prokurimi, raport i cili është miratuar prej tij.

Me shkresën nr.2497 prot., datë 13.10.2017, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, është miratuar procedura e prokurimit.



Me shkresën e protokolluar me nr.2498 prot., datë 13.10.2017, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, është bërë formulimi i njoftimit të fituesit, i cili është botuar në Buletinin e Prokurimit Publik me nr.42, datë 23.10.2017.

Me urdhërin e brendshëm, protokolluar me nr.2530, datë 17.10.2017, të Drejtorit Të Përgjithshëm Ekzekutiv, janë caktuar: L. M., me profesion Inxhinieri Elektrike, si përfaqësues i kontratës dhe është ngritur Komisioni i Kontrollit dhe Pranimit të Furnizimeve, me përbërje: L. M. (Kryetar), A. C. me profesion Inxhinieri Fizike dhe M. M. me Profesion Ekonomiste, asnjë nga antarët e komisionit nuk është specialist i fushës, veprim në kundërshtim me udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, i ndryshuar.

Tenderi është zhvilluar në datë 25.07.2016, ora 10:0005-06-2017, ora 10:00,

Me procesverbalin datë 17.10.2017, Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, kanë verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga bashkimi i operatorëve fitues.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi ka shqyrtuar dokumentat e ofertave të paraqitura në rrugë elektronike nga ofertuesit e mësipërm, më datë 25.07.2016, ka vlerësuar në sistemin elektronik të prokurimeve publike si më poshtë :

Bashkimi i Operatoreve ekonomik “2..&V..” Shpk me vlerë të ofruar 29,998,429 lekë pa TVSH;

Nga shqyrtimi i ofertës së paraqitur nga ky operator komisioni ka dalë me vlerësime të ndryshme, si vijon:

Anëtarët e komisionit A. K. dhe M. B. arritën në përfundimin se oferta e paraqitur nga ky operator i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhim vendosi të kualifikojë këtë ofertë.

Anëtari tjetër i komisionit A. B., ka vendosur skualifikimin e këtij operatori me argumentet e mëposhtme:

Krteret e përgjithshme:

1.Ofertuesi, nuk ka paraqitur deklaratën e garancisë së mallit të ofruar.

Kushtet teknike:

1.Artikulli me nr.27 i ofruar nq ofertqn teknike, (nuk vërtetohet që është AC-2).

2.Artikujt me nr.49,50,53,55,65 të ofruar në ofertën teknike, (kanë të njëjtin kod identifikimi, nuk gjenden ne katalog).

3.Artikulli me nr.56 i ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondon atij të kërkuar, (të ofruar I=150A nga I=160A të kërkuar).

4.Artikulli me nr.57 i ofruar në ofertën teknike mungon.

5.Artikulli me nr.62 i ofruar ne ofertën teknike nuk i korrespondon atij të kërkuar, (të ofruar AC-3, I=32A nga AC-1, I=60A të kërkuar).

6.Artikulli me nr.63 i ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondon atij të kërkuar, (të ofruar AC-3, I=150A nga AC-1, I=215A të kërkuar).

7.Artikujt me nr.66,67,68 të ofruar në ofertën teknike, (nuk gjenden në katalog).

Duke konkluduar se oferta e paraqitur nga ky operator për arsyet e mësipërme, nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhim vendosi të mos e kualifikojë këtë ofertë.

Në përfundim me shumicë votash komisioni vendosi të kualifikojë këtë ofertë.

Operatori ekonomik “S...” me vlerë të ofruar 29,031,750 lekë pa TVSH.

Nga shqyrtimi i ofertes së paraqitur nga ky operator anëtarët e komisionit vlerësuan në mënyrë të ndryshme përmbushjen e kriterëve nga ky operator.

Anëtarët e komisionit A. K. dhe M. B. vlerësuan se:



-Operatori ekonomik “S...” ka paraqitur një letër premtimi të leshuar nga P. C. me anë të së cilës nuk vërtetohet që P. C. është distributor i autorizuar i prodhuesve për mallrat Eldrot Vetefrenuese të zërit nga 80. Duke mos plotësuar në këtë mënyrë pikën 2.3.3.C). të dokumentave standarte të tenderit.

-Operatori ekonomik “S...” për zërin nr.1 në ofertën teknike ka paraqitur katalogun Laumas Elektronik me Kod:LTM8, e cila nuk përmbush të dhënat teknike sipas specifikimeve teknike përkatesisht, peshorja e dhënë në katalog nuk përmbush të dhënat teknike për përdorimin në elektrovinca, pasi parametrat e ngarkesës janë shumë më të mëdha me ato që mund të peshohen me këtë peshore asambliimi i kësaj peshore në elektroviç, nuk mund të arrihet për shkak të tensionit të furnizimit sipas të dhënave teknike është 115/230 V – 50/60 HZ.

Operatori ekonomik “S...” për zërin nr.2 dhe 3 në ofertën teknike, nuk është dhënë kodi i saktë i produktit dhe nuk është paraqitur katalogu me të dhënat teknike të produktit, sipas ofertës teknike të dhënë nga operatori ekonomik. Nuk përmbush pikën e, listë –referenca kërkohet për të vlerësuar kapacitetin teknik të ofertuesit në trajtimin e çështjeve tregtare të mallrave pajisje elektrike dhe teknologjike për përdorim industrial.

Deklarimi i të dhënave të rreme ose të pasakta në këto listë-referenca do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Operatori ekonomik “S...” për artikullin ferrotat e sistemit të ngritjes me nr. 12 dhe 13 në ofertën teknike ka paraqitur katalogun e pitschbubbenzer, katalogu nuk ka përcaktuar produktin e specifikuar si dhe të dhënat teknike të ferrotës dhe sipas kriterëve të kërkuara ne *DST Specifikimet teknike të dhëna nga Autoriteti Kontraktor ,shoqëruar me deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të firmosura dhe të vulosura nga ofertuesi, nuk do të pranohen në cilësinë e ofertës teknike të kërkuar mësipër. Mos plotësimi i kësaj pike do të sjellë pavlefshmëri të ofertës..* pasi është paraqitur skeda teknike e dhënë nga AK-ja.

Operatori ekonomik “S...” për artikullin Tub Steriningat Bobinazhi me nr.21 në ofertën teknike ka paraqitur katalogun e shoqërisë “BM connectih cable”, ka paraqitur tub të termo tkurrshëm për izolimin e kabllëve, i cili nuk përmbush të dhënat teknike, pasi nuk mund të përdoret për izolimin e telave të bobinazhit.

Për artikullin me nr. 24 deri ne nr.69 në ofertën teknike ka paraqitur katalogun e shoqërisë “ATB”, e cila nuk përmbush të dhënat teknike të kërkuara nga AK-ja.

Të gjithë produktet “ATB” të ofruara nuk përputhen me sistemin aktual të elektrovinxhave, që përdor Autoriteti Portual Durrës.

Specifikimet teknike për “Materiale Elektrike dhe Elektronike për Elektrovinca” të deklaruara nga ofertuesi duhet të përkojnë me të dhënat teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor në DT. Mos respektimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Për artikullin rrjete fiksuese kablli me nr.71 në ofertën teknike ka paraqitur katalogun e shoqërisë “B. c.”, nuk plotëson të dhënat teknike të kërkuara nga AK-ja.

Për artikullin “Eldro vetfrenuese” me nr.80 ne ofertën teknike ka paraqitur katalogun e shoqërisë “P. b.”, nuk përmbush të dhënat teknike sipas specifikimeve të kërkuara nga AK-ja as ne funksion dhe as në Dimensione.

Nuk përmbush pikën e, listë –referenca kërkohet për të vlerësuar kapacitetin teknik të ofertuesit në trajtimin e çështjeve tregtare të mallrave pajisje elektrike dhe teknologjike për përdorime industriale.

Deklarimi i të dhënave të rreme ose të pasakta në këto listë-referenca do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

Operatorit ekonomik “S.” nuk plotëson kriterin 2.3.5 pika C, pasi nuk ka paraqitur certificate Iso 27001:2013 “Për menaxhimin e sigurisë së informacionit”, në kundërshtim me kriterin e kërkuar ne D.S.T pika 2.3.5.C



Duke arritur në përfundimin se oferta e paraqitur nga ky operator nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhim vendosen të mos e kualifikojnë këtë ofertë.

Anëtari tjetër i komisionit A. B. paraqiti argumentat e mëposhtme:

Kriteret e pergjithshme:

1.Ofertuesi nuk ka paraqitur certifikatën ISO 14001:2015 .

2.Ofertuesi nuk ka paraqitur certifikatën ISO 27001:2013 .

Kushtet teknike:

1.Artikulli me nr.27 i ofruar në ofertën teknike mungon.

2.Artikujt me nr.38,39,40,41,42 te ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondojnë atyre të kërkuara.

3.Artikujt me nr.47,48,50 të ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondojnë atyre të kërkuara, (te ofruara AC-1 nga AC-2 te kerkuara).

4.Artikulli me nr.55 i ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondon atij të kërkuar, (të ofruar I=125A nga I=160A të kërkuar).

5.Artikulli me nr.56 i ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondon atij të kërkuar, (të ofruar I=125A nga I=160A të kërkuar).

6.Artikulli me nr.57 i ofruar në ofertën teknike mungon.

7.Artikulli me nr.65 i ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondon atij të kërkuar, (ofruar bllok kontakt nga kontaktor).

8.Artikulli me nr.66 i ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondon atij të kërkuar, (të ofruar AC-1, I=125A nga AC-2, I=176A të kërkuar).

9.Artikulli me nr.68 i ofruar në ofertën teknike nuk i korrespondon atij të kërkuar, (të ofruar AC-1, I=55A nga AC-3, I=62A të kërkuar).

Duke konkluduar se oferta e paraqitur nga ky operator për arsyet e mësipërme nuk i përmbush të gjitha kriteret e kërkuara në dokumentet e tenderit dhe për rrjedhim vendosi të mos e kualifikojë këtë ofertë.

Si rezultat i vleresimeve të mësipërme rezultoi se oferta e paraqitur nga ky operator nuk kualifikohet.

Ne perfundim te shqyrtimit

Oferta të kualifikuara (sipas vendimit të shumicës së komisionit):

Bashkimi i Operatoreve ekonomik “2...&V...” Shpk me vlerë të ofruar 29,998,429 leke pa TVSH;

Oferta te pakualifikuara:

“S...” me vlerë të ofruar 29,031,750 lekë pa TVSH

Në datën 19-06-2017 pas shqyrtimit të dokumentave, komisioni, për ofertat e kualifikuara të bashkimit të operatorëve:

Bashkimi i Operatoreve ekonomik “2.&V.” Shpk me vlerë të ofruar 29,998,429 lekë pa TVSH;

Bazuar ne Ligjin nr.9643 të datës 20-11-2006 “ Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 53 pika 2, dhe në zbatim të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 neni 66, pika 4, gjermës “ç”, është proceduar me kontrollin e veprimeve matematike për të identifikuar cdo gabim të mundshëm. Nga ky kontroll asnjë ofertë nuk rezultoi me gabim aritmetik.

Pas kontrollit të mësipërm, bazuar ne Ligjin nr.9643 te datës 20-11-2006 “ Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 56, dhe në zbatim te VKM Nr.914, datë 29.12.2014 neni 66, pika 5, komisioni duke përdorur formulën e kontrollit të vlerës anormale mbi ofertat e kualifikuara identifikoi se asnjë nga oferta ekonomike nuk është anomalisht e ulët;



Në përfundim të procesit të shqyrtimit KVO bëri klasifikimin e ofertave të pranuar si të vlefshme si vijon:

Bashkimi i Operatoreve ekonomik 2... dhe V... Shpk me vlerë të ofruar 29,998,429 leke pa TVSH;

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë:

Bashkimi i Operatoreve Ekonomik “2.&V.” Shpk e perfaqesuar nga Operatori ekonomik “2...” Shpk, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 29,998,429 leke pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rivlerësimi i kësaj praktike nga komisioni i ngritur për verifikim ankese.

Grupi i auditimit, pasi verifikoi dokumentacionin e vënë në dispozicion dhe atë të paraqitur në sistemin elektronik të APP-së, konstaton se Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “2.&V.” Shpk duhej skualifikuar, duke e konsideruar të drejtë vlerësimin që ka bërë antari i komisionit A. B., e për pasojë Autoriteti Kontraktor duhej të vazhdonte me anulimin e kësaj procedure. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 24, pika 1 dhe nenin 53, pika 3, si dhe me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Përmirësimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 73, pika 1.

Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar:- neni 2, është shprehur në mënyrë eksplicite se: "*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:*

a) mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;

b) transparencë në procedurat e prokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve".

-neni 12, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "*Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij*".

Parimi i barazisë përpara Ligjit është trajtuar në disa çështje të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese. Kështu që në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007 “.....Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabart përpara Ligjit, jo vetëm në të drejta themelore të parashikuara në kushtetutë, por edhe në të drejta të tjera ligjore”. Parimi i barazisë është saksionuar dhe në Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në Konventën Evropiane të të drejtave të njeriut.

Kontrata është lidhur me nr.2528 prot, datë 17.10.2017, ndërmjet A. L., në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të APD-së, dhe kontraktuesve “2...” dhe “V...” SHPK, në vlerën 35,998,115 lekë, me TVSH, me kohëzgjatje 45-ditë, ndjekës kontrate është caktuar L. M. Kontrata shoqërohet nga formulari i ofertës, formulari i njoftimit të fituesit, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, oferta teknike, katalogët, dhe sigurimi i kontratës.

Me shkresën nr. 2529 prot, datë 17.10.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, formulari i njoftimit të kontratës të nënshkruar i është dërguar APP-së, e cili është botuar në buletinin e prokurimit publik nr.42, datë 23.10.2017.

Në opinionin e grupit të auditimit, kualifikimi, shpallja fitues e bashkimit të operatorëve “2...& V...”, si dhe lidhja e kontratës, është kryer ***në mënyrë të padrejtë***, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar, Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, ç’ka ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.



Si konkluzion të argumenteve të përmendur si më sipër, grupi i auditimit konstaton se veprimet e lartë përmendura të antarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, janë shkelje e rëndë e legjislacionit në fuqi dhe përbëjnë një shprehje flagrante të zbatimit të gabuar të Ligjit dhe të abuzimit me detyrën.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

Gjithsesi për arsytet dhe konstatimet e përmendura më lart, del më se e domosdoshme është marrja e masave urgjente për të korrigjuar këtë praktikë të paligjshme me qëllimin e rivënisjes në vend të të drejtave të shkelura në favor të subjekteve privat dhe për të evituar abuzimin e mëtejshëm që kryhet nga punonjësit e APD-së.

ZBATIMI I KËSAJ PRAKTIKE

Me urdhër transferte datë 27.12.2017 nëpërmjet R. Bank, është likuiduar kompania “2...”, për vlerën 12,289,104 lekë.

Likuidimi është kryer me dokumentacion:

Akt-pranim nr.1, datë 23.11.2017 me antarë komisioni L. M., A. C. dhe M. M. në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite që : “Artikujt e furnizuar përputhen me ato të kërkuara në kontratë”...; Faturë tatimore nr.17 datë 22.11.2017 për vlerën 12,289,204 lekë e firmosur nga L. M. dhe A. K.(2..).

Nga fatura e printuar që pasqyron të gjitha pjesët e furnizura në mënyrë të detajuar, test raport janë vetëm për: Ferota sistemi rrotullimi+ecje copë $8 \times 189,000 = 1,512,000$ lekë.

Ferota sistemi ngritjes copë $8 \times 189,000 = 1,512,000$ lekë, Frena emergjence hidraulike copë $2 \times 892,500 = 1,785,000$ lekë. Shuma $4,809,000 \times 20 \% \text{ TVSh} = 5,770,800$ lekë.

Vlera e faturës $12,289,204 - 5,770,800 = 6,518,404$ lekë.

Materialet elektrike me vlerë 6,518,404 lekë janë të pashoqëruara me test raport fabrike.

Me urdhër transferte datë 28.02.2018 nëpërmjet R. Bank, është likuiduar kompania “2...” shpk, për vlerën 18,287,411 lekë.

Akt-pranimi nr.2 i datës 01.12.2017 me antarë komisioni L. M., A. C. dhe M. M. në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite që : “Artikujt e furnizuar përputhen me ato të kërkuara në kontratë”...; Faturë tatimore nr.19 datë 01.12.2017 për vlerën 18,287,411 lekë e firmosur nga L. M. dhe A. K.; Fletëhyrje nr.14 datë 01.12.2017.

Me urdhër transferte date 12.01.2018 nëpërmjet R. Bank, është likuiduar kompania “2...” shpk, për vlerën **5,193,683** leke.

Akt-pranimi nr.3 i datës 07.12.2017 me antarë komisioni L. M., A. C. dhe M. M. në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite që: “Artikujt e furnizuar përputhen me ato të kërkuara në kontratë”...; Faturë tatimore nr.21 datë 07.12.2017 për vlerën 5,409,600 lekë e firmosur nga L. M. dhe A.K.; Fletëhyrje nr.21 datë 07.12.2017.

Ne këtë akt-pranim nuk është shënuar numri serial i pajisjeve dhe nuk është bërë asnjë përshkrim i përputhjes së specifikimeve teknike të kërkuara në DST-ja me të dhënat (targeti) nr.1, datë 23.11.2017 e pajisjeve të furnizuara (test raport fabrike, liste paketim, certifikate origjine, autorizim prodhuesi etj).

Një pjesë e materialeve elektrike dhe elektromekanike të përshkruara sipas aktpranimit nr.1, datë 23.11.2017 në vlerën 6,518,404 lekë, nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të behet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën “2...&V...” ka fituar tenderin dhe është likuiduar.



Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10,489 datë 15.12.2011 “Për Trajtimin dhe Mbikëqyrjen e Tregut të Produkteve jo Ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8, neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr.369, datë 27.3.2008 “Për miratimin e rregullit teknik” “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit”, **çka ngarkon me përgjegjësi L. M. i vetmi specialist i fushës në grupin e marrjes në dorëzim.**

Për pasojë Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinion e Tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat “2...&V...”, ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Deri në paraqitjen nga “2...&V...” Shpk të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “2...&V...” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar, **vlera 6,518,404 lekë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga “2...&V...” Shpk**”.

7.7. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Për kryerjen e mirëmbajtjes së infrastrukturës së aseteve energjitike, viti 2018 me këto të dhëna “:

APD për kryerjen e mirëmbajtjes së infrastrukturës së aseteve energjitike ka lidhur kontratë me shoqërinë “A. E. “ Shpk me nr.Reference 04PH2013, për vlerën 31,392,000 lekë, për 12 muaj, me afat 5 vjet pra deri më 01.05.2018

Referuar termave të referencës pika III, 3.3 “Kohëzgjatja e kontratës në të cilën është shprehur në mënyrë eksplicite se “APD-ja dhe Operatori i Mirëmbajtjes, për një afat 5-vjecar me mundësi e zgjatjes 2 vite të tjera, nëse operatori gjatë kësaj periudhe ka realizuar atë në mënyrë të kënaqshme për APD-në. Në kontratë nuk ka një përcaktim të tillë, por siç theksuam vetëm në termat e referencës.

Është kryer amendim të kontratës nr.1788 prot, më datë 27.04.2018 me kontratë të amenduar nr.860, datë 25.03.2013 me arsyetimin:

-“Të nevojës se realizimi në vijimësi të Shërbimit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Energjitike dhe asaj Elektrike, APD ndodhet në situatën e përfundimit kontraktual ndërmjet tij si autoritet kontraktor dhe operatorit që vazhdon të kryejë shërbimin përkatës”. Duke vlerësuar rëndësinë e madhe dhe nevojën permanente për furnizim me këtë shërbim specifik, si dhe sigurinë e dokumentacionit dhe operacioneve të ndryshme të kryera gjatë aktivitetit të përditshëm në ambjentet e Autoritetit Portual Durrës. Palët bien dakort për nënshkrimin e këtij amendamenti i cili është pjesë përbërëse e kontratës nr.860 prot, datë 25.03.2013.

Kohëzgjatja e Kontratës: Sipas termave të referencës dhe qëllimit të këtij amendamenti, palët bien dakort për përcaktimin e kohëzgjatjes si më poshtë:

-Zgjatjen e afatit të kontratës fillestare deri në ditën e përfundimit të procedurave të tenderit të ri dhe firmosjen e kontratës për shërbimin MIE.

-Amendamenti hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga palët, kushtet e tjera të kontratës nuk ndryshojnë.

Për këtë shtese kontrate

-Me shkresën nr.354, datë 17.04.2018 B. V. me Detyrë Drejtor Teknik i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm me kërkesë për shtyrje afati të Kontratës së Mirëmbajtjes së Infrastrukturës së Aseteve Energjitike, me argumentin se “Referuar kontratës së prokurimit që përfundon më datën 01.05.2018, dhe duke u gjendur para faktit që nuk është zhvilluar akoma procedura e prokurimit publik, kërkojmë të shikohet mundësia e shtyrjes së kontratës ekzistuese me operatorin “A.e.”, me kohën e nevojshme për përfundimin e procedurave që do të bëhet



përzgjedhja e operatorit të mirëmbajtjes. Mundësia e shtyrjes nga Sektori Juridik është parashikuar në termat e referencës, në kreun 3, pikën 3.3.

Me e-mailin e datës 18 prill 2018, ora 1.37 E. J. me Detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike i drejtohet A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm dhe B. V. me Detyrë Drejtor Teknik me termin sugjerim, duke cituar se “Nisur nga relacioni ne attach, po ju informoj se neni 3.3 i termave te referencës përcakton qartë që mund të shtyhet afati i kontratës nga APD-ja “Në rast se operatori gjatë kësaj periudhe e ka kryer atë në mënyrë të kënaqshme për APD-në”. Në mbështetje të strukturës organizative të APD-së, është Drejtoria Teknike dhe Sektori përkatës i cili duhet të mbikqyrë kontratën me shoqërinë “A. E.”, kështu a është kjo drejtori e cila duhet të shprehet nëse është e kënaqur nga operatori gjatë 5 viteve të kontratës apo jo?. Drejtoria Juridike përpilon amendimin e kontratës mbasi është rënë dakort për plotësimin apo jo të nenit 3.3 të termave të referencës.

Me shkresën nr.392 prot, datë 25.04.2018 me objekt Informacion mbi performancën e realizimit të kontratës së shërbimit të mirëmbajtjes dhe riparimit të instalimeve të aseteve të infrastrukturës energjitike të kryer nga operatori privat “A.e.”, J. Xh. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Kontratave, E. I. me detyrë ndjekës i kontrates, sektori MKM dhe L. M. me Detyrë ndjekës kontrate sektori MKM, i drejtohen B. V. me detyrë Drejtor Teknik, dhe për dijeni A. B. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, duke shprehur se “Për sa mësipër referuar tabelës del qartë se operatori i mirëmbajtjes dhe riparimit të instalimeve të aseteve të infrastrukturës “A.e.”, ka realizuar në mënyrë të kënaqshme kontratën e lidhur me APD-në, referuar treguesve të performancës së nxjerrë për pesë vite.

Kjo shtesë kontrate nuk është *pasqyruar në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimit publik për vitin 2018.*

Mos pasqyrimi i kësaj shtese në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të procedurave të prokurimit çënon në vetvete qëllimin e “Programit të Transparencës” së APP, ku përmes saj, APP synon të ndërtojë dhe rrisë transparencën institucionale, mbështetur mbi nenin 7 të Ligjit nr.119/2014 datë 18.09.2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 7.

Sa më sipër në funksion edhe të sigurimit të informacionit për palët e interesit, si pjesë e konceptit tashmë të njohur dhe pranuar gjerësisht në vendet e BE-së e më gjerë mbi “**Qeverisjen e hapur**”, koncept ky që në gjykimin tonë duhet të gjejë zbatim veçanërisht në Autoritetin Portual Durrës.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi, A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe E. J. me Detyrë Drejtor Juridik.

7.8. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Për kryerjen e mirëmbajtjes së pajisjeve të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK),viti 2016 me këto të dhëna”:

APD-ja për kryerjen e mirëmbajtjes së pajisjeve të sistemeve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) sektori privat ka lidhur kontratë me shoqërinë “T. S. &C. “ Shpk me nr.Reference 20PH 2011, më datë 31.08.2011 për vlerën 45,336,720 lekë, për 12 muaj, me afat 5 vjet pra deri më 30.08.2016.

APD për këtë shërbim me mbarimin e afatit 5-vjecar të kontratës si mësipër, për periudhën 17.10.2016 deri më datën 05.04.2017 (pra afërsisht 5.5 muaj) ka likuiduar bashkimin e operatorëve “T.S. &C.” Shpk në vlerën 19,184,835 lekë, ose e kthyer në përqindje shtesa e kontratës është në masën 42 %. (19,184,835 : 45,336,720 = 42 %).

Këtë likuidim e ka kryer bazuar amendimit të kontratës nr.reference 20PH 2011, më datë 31.08.2011 me kontratë të amenduar nr.2850, datë 17.10.2016 me arsyetimin:



-“Të nevojës së realizimit në vijimësi të shërbimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në institucion, APD-ja ndodhet në situatën e vakumit kontraktual ndërmjet tij si autoritet kontraktor dhe operatorit që vazhdon të kryejë shërbimet përkatëse....”

Kohëzgjatja e Kontratës: Sipas termave të referencës dhe qëllimit të këtij amendamenti, palët bien dakort për përcaktimin e kohëzgjatjes si më poshtë:

-Zgjatjen e afatit të kontratës fillestare deri në ditën e përfundimit të procedurave të tenderit të ri dhe firmosjen e kontratës për shërbimin TIK.

-Amendamenti hyn në fuqi me nënshkrimin e tij nga palët, kushtet e tjera të kontratës nuk ndryshojnë.

Për këtë amendim kontrate është nxjerrë vendimi nr.2851 prot, datë 17.10.2016 i G. Sh. me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv në cilësinë e titullarit të Entit Prokurues, ku është shprehur se:

-Shtyrjen e afatit të kontratës me shoqërinë “T. S. &C.” Shpk deri në ditën e përfundimit të procedurave (sipas pikës 3 më poshtë) dhe firmosjen e kontratës për shërbimin TIK

-Miratimin e amendimit të kontratës

-Caktohet Zv/drejtor i Përgjithshëm A. Q. të ngrejë menjëherë grupin e punës për miratimin e termave të reja të referencës dhe përgatitjen e dokumenteve të tenderit. Për këtë amendim kanë shprehur dakortësinë zyrtarisht, B. Dh. me detyrë Zv/drejtor, A. Q. me detyrë Zv/drejtor, A. D. Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit, M. B. me Detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomike, A. N. me Detyrë Drejtor Çështjeve Ligjore, A. K. Drejtor i Burimeve Njerëzore, Z. D. me Detyrë Drejtor i Forcave të Sigurisë, F. S. Drejtor i Drejtorisë Operacionale.

Para daljes së vendimit ka një korrespondencë shkresore si më poshtë vijon:

-Shkresa nr.1186/1 prot, datë 08.06.2016 me titull informacion mbi ecurinë e raportit me titull “Vlerësim mbi vazhdimësinë e shërbimit të mirëmbatjes TIK në APD, drejtuar G. Sh. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, nga A. O. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Mastërplanit, Zhvillimit dhe Standarteve, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të ngritur me urdhërin nr.1186, datë 11.04.2016, me qëllim vlerësimin mbi vazhdimësinë e shërbimit të mirëmbatjes TIK në APD, me qëllimin e hartimit të një raporti, mbi alternativat që mund të ndiqen për periudhën pas përfundimit të kontratës së lidhur me operatorin aktual, duke informuar Drejtorinë e Përgjithshme se;

-Duke marrë rëndësinë e këtij raporti antarët e komisionit, inxhinierë dhe ekonomistë, po punojnë për saktësimin e të dhënave dhe përfundimin e plotë të tij. Si rrjedhojë ky material do të dorëzohet më datë 22.06.2016, pra komisionit do ti duhet një kohë afërsisht me dy muaj gjysëm (72 ditë).

-Ndërsa raporti i vlerësimit ligjor i këtij shërbimi që është përgatitur nga juristja dhe ekonomistja e komisionit do të dorëzohet më datë 08.06.2016, pra afërsisht me dy muaj kohë.

-E-mail i datë 4.10.2016, I. C. me detyrë Sekretare e Këshillit Drejtues drejtuar G. Sh. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, për dijeni G. B. me detyrë Kryetar i Këshillit Drejtues, protokolluar në APD me nr. 2687 prot, datë 04.10.2016 është shprehur në mënyrë eksplicite se “

-Në mbledhjen e datës 30 shtator 2016, këshilli drejtues, pasi shqyrtoi materialet e paraqitura nga drejtoria ekzekutive vendosi: “.....*Relacion mbi shërbimin e mirëmbatjes TIK. Këshilli drejtues pasi u njof me materialet e paraqitura në lidhje mbi kryerjen e shërbimit TIK në APD, e cila vijon të kryhet nga kompania “T. S.” është dakort me sugjerimin e Drejtorisë Ekzekutive.....*”.



G. B. në rolin si Kryetar i Këshillit Drejtues është shprehur se “ Relacioni mbi shërbimin TIK. Për mos pezullimin e punës jemi dakort me sugjerimet e drejtorisë ekzekutive”(procesverbal sipas versionit të mbajtur në librin e protokollit me shkrim).

Grupi i Menaxhimit Strategjik për marrjen në APD apo vazhdimin privat, është shprehur në datën 14.10.2016, tre ditë para se nga G. Sh. të kryente amendimin e kontratës me TIK, protokolluar në APD me nr.2832 prot, datë 14.10.2016 “Afati i shtyrjes së kontratës të mos jetë apriori dhe i papërcaktuar, ai do të jetë aq sa do të jetë dhe procedura e domosdoshme për përgatitjen e dokumenteve të tenderit (ku do të reflektohen të gjitha ndryshimet e përmendura) dhe zhvillimin e tij deri në shpalljen e fituesit sipas garës dhe rregullave që përcakton ligji i prokurimit publik. Fituesit të shpallur nga procedura do ti dorëzohet shërbimi nga “T. S.”, ashtu sikur dhe kontrata ekzistuese e përcakton. Që prej ditës së sotme të ngrihet grupi i punës për përpilimin e dokumentacionit të tenderimit”. Referuar këtij protokollit ky vendim i grupit strategjik është marrë një muaj e gjysëm, pasi ka përfunduar afati i kontratës me TIK (kontrata ka përfunduar më 30.08.2016).

Veprime në kundërshtim me:

Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 33, VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, çka ngarkon me përgjegjësi G. Sh. me Detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv në cilësinë e titullarit të entit prokurues.

Koment: VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 76, pika 4 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Autoritetet kontraktore, për plotësimin e nevojave me mallra dhe shërbime të vazhdueshme, në fillim të çdo viti, lejohen të zgjasin afatin e kontratës së fundit të lidhur pas përfundimit të një proçedure konkurruese, nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate shtesë me të njëjtin kontraktues, deri sa të kryhen proçedurat e prokurimit. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të argumentojë në mënyrë të detajuar nevojën për zgjatjen e kontratës.

Kontrata shtesë për mallrat apo shërbimet e vazhdueshme mund të bëhet deri në një vlerë maksimumi 20% të kontratës së fundit të lidhur pas përfundimit të një proçedure konkurruese dhe fondet për këtë kontratë do të përballohen nga fondet e vëna në dispozicion të autoritetit kontraktor në buxhetin e atij viti.

Në çdo rast, edhe pse nuk realizohen me proçedurë prokurimi, planifikimi dhe realizimi i këtyre kontratave shtesë me vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të proçedurave të prokurimit publik”.¹

Në çdo rast, edhe pse nuk realizohen me proçedurë prokurimi, planifikimi dhe realizimi i këtyre kontratave shtesë me vlerat përkatëse duhet të pasqyrohen në rregjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të proçedurave të prokurimit publik”.²

Kjo shtesë kontrate nuk është pasqyruar në rregjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të proçedurave të prokurimit publik për vitin 2018.

Mos pasqyrimi i kësaj shtese në regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve të proçedurave të prokurimit cënon në vetvete qëllimin e “Programit të Transparencës” së APP-së, ku përmes saj, APP-ja synon të ndërtojë dhe të rrisë transparencën institucionale, mbështetur mbi nenin 7 të Ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar neni 7.

Sa më sipër në funksion edhe të sigurimit të informacionit për palët e interesit, si pjesë e konceptit tashmë të njohur dhe pranuar gjerësisht në vendet e BE-së e më gjerë mbi



“Qeverisjen e hapur”, koncept ky që në gjykimin tonë duhet të gjejë zbatim veçanërisht në Autoritetin Portual Durrës.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër ngarkon me përgjegjësi, G.Sh. me Detyrë Drejtor Ekzekutiv.

7.9. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Rinovim i pajisjeve si dhe zgjerimi i sistemit ISPS”, viti 2016.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit të autoriteti kontraktor G. Sh. Nr.1819 datë 23/06/2016	Ngritur me urdhrin Nr.1820 datë 23/06/2016 1- A. Ç.-Ing. Mekanike 2- N. P.- Jurist 3- D.D.-Ing. Elektronik	Ngritur me urdhrin Nr.1819 datë 23/06/2016 1.S. D.-Jurist 2.A. M.- Jurist 3.I. R.-Jurist.
Vlera e përlogaritit e kontratës 51.368.887 lekë pa Tvsh.		
Procedurë e hapur		
Bashkimi i Operatoreve ekonomike fitues, shoqëritë: “A...” SHPK, “S...” SHPK dhe “B...” SHPK Vlera e ofertës 47.762.065 lekë pa TVSH.		
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor dt.10.10.2016	Njoftim i kontratës, botuar në buletin e APP dt. 27 Qershor 2016	Tënderi i zhvilluar me dt. 25/07/2016, ora 10.00
BOE - “A.” SHPK, “S.” SHPK dhe “B.” SHPK Kontratë Nr.2839 datë 14.10.2016 me vlerë 57.314.478 Lekë me TVSH	Ofertat e paraqitura 9 Operatore Ekonomike	Kualifikuar 1
Njoftim klasifikimi është bërë elektronikisht.31. 08. 2016	Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik 17 Tetor 2016	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletin e APP 24 Tetor 2016, faqe 260

Nevoja e këtij investimi, programi i blerjeve të APD-së, i miratuar për vitin 2016.

Me shkresën e protokolluar me nr.824, datë 11.03.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerësimit të kontratës së prokurimit me titull “Rinovimi i pajisjeve si dhe zgjerimi i sistemit ISPS (kalatë lindore, hyrjen e terminalit të kontinereve si dhe zonen e peshkimit), zgjerimi i kapaciteteve të ruajtjes së informacionit të imazheve të kamerave si dhe imazheve në hyrje të portave kryesore”, me përbërje:

- V. H., me profesion Inxhinier Elektronik.
- F. Gj. me profesion Inxhinier Ndërtimi.
- E. I. me profesion Inxhinier Elektrik.

Përlogaritja e vlerësimit të kontratës është përcaktuar në lekë, pas ofertës të ofruar për vlerën 50.368.587 lekë nga shoqëritë:

- “E...” SHPK për vlerën 49.553.587 lekë
- “A...”, hpk për vlerën 54.184.487 lekë
- “P...” SHPK.

Vlera 51.368.887 lekë, është marrë si mesatare e tre ofertave të paraqitura. Pra në përlogaritjen e vlerësimit të kontratës, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet



ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, apo çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK-ja, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementët e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", neni 59 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës". Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi komisionin për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

Me shkresë, pa numër protokoll dhe datë, drejtuar Përgjegjësit të Sektorit të Prokurimeve, Kryetari i komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull "Rinovimi i paisjeve si dhe zgjerimi i sistemit ISPS (Kalatë Lindore, Hyrjen e Terminalit të Kontinierëve si dhe Zonen e Peshkimit), zgjerimi i kapaciteteve të ruajtjes së informacionit të imazheve të kamerave si dhe imazheve në hyrje të portave kryesore", V. H., ka përcjellë dokumentacionin e plotë të përfunduar nga anëtarët e komisionit.

Me shkresën e protokolluar me nr. 1819, datë 23.06.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i prokurimit, me objekt "Rinovimi i paisjeve si dhe zgjerimi i sistemit ISPS (Kalatë Lindore, Hyrjen e Terminalit të Kontinierëve si dhe Zonen e Peshkimit), zgjerimi i kapaciteteve të ruajtjes së informacionit të imazheve të kamerave si dhe imazheve në hyrje të portave kryesore", me fond limit **51,368,887 lekë** pa TVSH, në të cilin janë caktuar anëtarët e njësisë së prokurimit, me përbërje: S. D., A. M. dhe I. R., të tre me profesionin jurist.

Me shkresën e protokolluar me nr.1820, datë 23.06.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë Urdhëri i Brendshëm për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, me përbërje: A. Ç. me profesion Inxhinier Mekanike, N. P. me Profesion Jurist, dhe D. D. me profesion Inxhinier Elektronik.

Me shkresën e protokolluar me nr.1821, datë 23.06.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është bërë formulimi i njoftimit të kontratës, i cili është botuar në buletin e prokurimit publik me nr.25, datë 27.06.2016.

Me shkresën nr. 318, datë 29.06.2016, komisioni për përgatitjen e specifikimeve teknike, i është drejtuar S. D., mbi kërkesën për sqarim të subjektit "A..." SHPK.

Me shkresën nr. 333, datë 07.07.2016, komisioni për përgatitjen e specifikimeve teknike, i është drejtuar sektorit të prokurimeve, mbi disa sqarime lidhur me ankesën e subjektit "S..." SHPK.

Me procesverbal datë 25.07.2016, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali i dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

Me procesverbal datë 05.08.2016, janë mbajtur nga secili anëtar më vetë procesverbalet e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

Me nr.2158, datë 09.08.2016, është protokolluar në APD formulari i ankesës pranë Autoritetit Kontraktor nga shoqëria "A..." SHPK.

Me shkresën nr.2158/1, datë 10.08.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri për pezullimin e procedurës dhe ngritjen e komisionit për shqyrtimin e ankesës.

Me nr.2164, datë 11.08.2016, është protokolluar në APD formulari i ankesës pranë Autoritetit Kontraktor nga shoqëria "T.. S.." SHPK.

Me procesverbal datë 15.08.2016, të firmosur nga kryetari i komisionit për shqyrtimin e ankesës, është shtyrë procesi i shqyrtimit të ankesës.



Me shkresën nr. 2319, datë 18.08.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, i është kthyer përgjigje ankesës së shoqërisë “T.. S..” SHPK.

Me shkresën nr. 2158/2, datë 18.08.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm për caktimin e S. K., mbi përgatitjen e kriterëve kualifikuese të ekspërtit të fushës.

Me shkresën nr. 2158/3, datë 19.08.2016, specialisti IT/ Drejtoria FSPD, S. K., i është drejtuar komisionit të prokurimit mbi përgatitjen e kriterëve kualifikuese për Inxhinier Elektronik.

Me shkresën nr. 2158/4, datë 30.08.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, i është kthyer përgjigje ankesës së shoqërisë “A...” SHPK.

Me shkresën nr. 2370, datë 22.08.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri mbi konkurimin e kandidatit për anëtar të komisionit të vlerësimit të ofertave.

Me shkresën nr.2382, datë 24.08.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri për zëvendësimin e anëtarit të komisionit për shqyrtimin e ankesës dhe përcaktimin e pagesës së ekspërtit të jashtëm.

Me shkresën nr.2434, datë 31.08.2016, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri për ri-vlerësimin e ofertave të procedurës së prokurimit.

Me nr.2459, datë 05.09.2016, është protokolluar vendimi i komisionit të prokurimit publik nr.1924/1 protokoll, datë 02.09.2016.

Me shkresën nr.2484, datë 07.09.2016, të firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor, është dërguar pranë komisionit të prokurimit publik informacion mbi procedurën e prokurimit.

Me shkresën nr.2531, datë 09.09.2016, të firmosur nga titullari i Autoritetit Kontraktor, është dërguar pranë komisionit të prokurimit publik informacion plotësues mbi procedurën e prokurimit.

Me shkresën e protokolluar në APD me nr.2744, datë 04.10.2016, ka ardhur Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik, bashkëlidhur.

Me shkresën nr.2764, datë 10.10.2016, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar raportin përmbledhës për këtë procedurë prokurimi, raport i cili është miratuar prej tij.

Me shkresën nr.2765, datë 10.10.2016, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, është miratuar procedura e prokurimit.

Me shkresën e protokolluar me nr.2766 prot., datë 10.10.2016, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, është bërë formulimi i njoftimit të fituesit, i cili është botuar në buletin e prokurimit publik me nr.41, datë 17.10.2016.

Me shkresën e protokolluar me nr.2791 prot., datë 11.10.2016, zyrtari i autorizuar i njësisë së prokurimit, A. M., i është drejtuar komisionit të vlerësimit të ofertave duke kërkuar verifikimin e dokumentacionit të ofertës së shpallur fituese, pas sjelljes së dokumentacionit nga përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Tënderi është zhvilluar në datë 25.07.2016, ora 10:00, nga kontrolli në sistemin e prokurimeve të raportit final në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë dhe janë refuzuar operatorët ekonomik të mëposhtëm me justifikimin përkatës:

Shoqëria “A.-C.” SHPK, me numer ofertë 8269/22072016 – nuk ka paraqitur vlerë të ofertës. Është konsideruar pa ofertë e për pasojë nuk është kualifikuar.

Shoqëria “C. P.” SHPK, me numër ofertë 6908/21072016 – nuk ka paraqitur vlerë të ofertës. Është konsideruar pa ofertë e për pasojë nuk është kualifikuar.

Shoqëria “E.” SHPK, me numër ofertë 0448/06072016 – nuk ka paraqitur vlerë të ofertës. Është konsideruar pa ofertë e për pasojë nuk është kualifikuar.



Shoqëria "I. T. A." SHPK, me numër ofertë 2119/19072016 – nuk ka paraqitur vlerë të ofertës. Është konsideruar pa ofertë e për pasojë nuk është kualifikuar.

Shoqëria "I..." SHPK, me numër ofertë 8795/22072016 – nuk ka paraqitur vlerë të ofertës. Është konsideruar pa ofertë e për pasojë nuk është kualifikuar.

Shoqëria "R..." SHPK, me numër ofertë 9936/25072016 – nuk ka paraqitur vlerë të ofertës. Është konsideruar pa ofertë e për pasojë nuk është kualifikuar.

Ndërsa operatorë që kanë marrë pjese dhe ofertat e të cilëve janë shqyrtuar janë:

Shoqëria "A. C." SHPK, me numër ofertë 5451/24062016 ka paraqitur ofertë me vlerë 41.001,000 lekë, pa tvsh. Shoqëria "A.." SHPK, me numër ofertë 0055/25072016 ka paraqitur ofertë me vlerë 47.762.065 leke, pa TVSH. Shoqëria "T. S." SHPK, me numër ofertë 6533/21072016 ka paraqitur ofertë me vlerë 44.678.800 lekë, pa tvsh..

Koment i grupit të auditimit.

A. Në lidhje me procedurën e shqyrtimit të dokumentacionit të ofertës së Bashkimit të Operatoreve Ekonomik (BOE) të përbere nga "A...Shpk&S... C. Shpk& B. Shpk", KVO është shprehur me qendrim individuale, por në konkluzionin përfundimtar e ka skualifikuar e tëra ofertën e paraqitur nga ky BOE. *Pas kontrollit të cdo vlerësim grupi i auditimit konkludoi se puna e KVO është e plotë dhe të gjitha argumentat qëndrojnë duke skualifikuar këtë ofertë për:*

a. Mosplotësim të kontratave të ngjashme në raport me përqindjet e cdo anëtari të BOE, përfundim lehtësisht i vërtetueshëm nga përlllogaritja matematike e vlerave të kontratave të dorëzuara në sistëm.

b. Mosplotësim kritërit të xhiros mesatare në raport me përqindjet e cdo anëtari të BOE, përfundim lehtësisht i vërtetueshëm nga përlllogaritja matematike e vlerave respektive të vërtëtimeve mbi xhiron të dorëzuara në sistëm.

c. Mungesen e 4 specialistëve të kërkuar ne DST nga Autoriteti Kontraktor.

d. Për të paktën 4 artikuj nuk plotësoheshin specififikimet teknike nga ana e BOE.

Referuar përfundimeve të KVO po paraqesim argumentat si vijon:

"A.." shpk & "S.." shpk & B..Shpk

Bashkimi i operatoreve "A.." shpk & "S.." shpk & B..Shpk sipas kontratës së bashkëpunimit me nr.1406 rep. dhe nr.299 kol. Nuk kualifikohet pasi nga verifikimi i dokumentave të paraqitur u konstatua se:

I. Nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit, pikën 2.2.1 të OST ku kërkohet: 1f...
Deshmi furnizimet e meparshme, të kryera të tri vitëve të fundit, ne vlerë prej 20,540,000 (njetzetmilion e pesëqind e dvzetmijë) lekë, 40% së përlllogaritur të kontratës prokurohet...."
Ne fillim u përlllogarit ne përputhje me pjesën e secilit operator në bashkim vlera totale e kërkuar për furnizimet e ngjashme e cila respektivisht për cdo pjestar të bashkimit të operatorëve është si vijon:

"A.." shpk 60% (e 20.540.000 lekë) = 12.324.000 lekë;

"S.." shpk 35% (e 20.540.000 lekë) = 7.189.000 lekë

"B.." shpk 5% (e 20.540.000 lekë)= 1.027.000 lekë

Nga përlllogaritja e dëshmimeve përkatëse për realizimin e këtyre vlerave furnizimi u konstatua se;

"A.." e përmbush dhe e kalon vlerën përkatëse

"S.." e përmbush e kalon përkatëse

"B.." tre vitet e duke filluar e zhvllimit të tenderit 25 .07.2016 dhe tre vite kohe më pas deri me 26 .07.2013 ka paraqitur dy fatura të periudhave me situacionet përkatëse njëra 30.11.2013 nr.83 me vlerë 478.718 lekë në përmbushje të shtësës së kontratës nr.809 të datës 31.10.2013 nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Shijak dhe tjetra e datës 30.11.2013 nr.82 me



vlerë 315.850 leke pa kontratë, të cilat tëmarra të mirëqena arrijnë në një vlerë totale 794.568 lekë duke mos përmbushur vlerën 1.027.000 lekë për pjesën 5% që ka në Bashkimin e Operatoreve.

2. Bashkimi i Operatoreve nuk plotëson kriteret e vecanta të kualifikimit, kapaciteti ekonomik dhe financiar pikën 2.2.2 ku kërkohet: "...Xhiro mesatare e tre vitëve të fundit (2013, 2014 dhe 2015) duhet ne vlerën 50.000.000, Ku në përputhje me përqindjen e secilit operator në bashkim vlera e kërkuar për xhiron mesatare e për cdo pjestar të Bashkimit të Operatoreve është si vijon:

"A.."	60% (50,000,000 lekë)	= 30.000.000 lekë;
"S.."	35% (50.000.000 lekë)	= 17.500.000 lekë;
"B.."	5% (50,000,000 lekë)	= 2.500.000 lekë

Nga përlllogaritja e dëshmimeve për realizimin e këtyre vlerave të xhirove mesatare u konstatua se :

"A.." nuk e përmbush xhiron e kërkuar pasi xhiro mesatare e tij është 26.097.076 dhe jo 30,000,000 lekë, pra me e vogël se c' duhej.

"S.." e përmbush dhe e kalon vlerën 35% të pjesës që ka marrë përsipër për të realizuar;

"B.." e përmbush dhe e kalon vlerën 5% të pjesës që ka marrë përsipër për të realizuar.

Në keto rrethana ky kriter konsiderohet i pa përmbushur nga i gjithë Bashkimi i Operatoreve.

3. Bashkimi i Operatoreve nuk plotëson pikën 2.3 Kapaciteti teknik, ku sipas verifikimeve të bëra në dokumentat e paraqitura nga Bashkimi i Operatoreve rezultoi se mungojnë specialistët e certifikuar për:

1 (nje) Specialist të certifikuar për sistemet ccrv/VMS (nuk ka)

2 (dy) të certifikuar për storage; (ka vetëm nje)

1 (nje) specialist të certifikuar për integrimin e sistemeve të sigurisë (nuk ka)

4. BOE nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara në shtojcën 10 të DST: Pas verifikimit të dokumentave të paraqitura nga operatori ekonomik u vu re se dokumentat e paraqitura nga ky operator si katalog për produktët e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor jane ne gjuhë të huaj dhe të papërkthyer dhe të pa noterizuara dhe për më tepër nuk përmbajnë asnjë shenjë dalluese që janë katalogë të ofruara nga ky operator si vula apo siglime, prandaj nuk merren në konsideratë për shqyrtim. Me pas u verifikua oferta teknike e operatorit ku u vu re se mungonin komponentët e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

I. Ne produktin Kamera IP fikse e jashtme - mungojnë Sensori i imazhit: 1/3 MOS Lentë f=2.8-10 mm, fl.6, zmadhim optic 3.6X

II. Ne produktin kamera ip speed dhome e jashtme mungojnë: Sensor 2.4 mega pixel, 1/3 " MOS me ndjeshmëri të lartë Deri ne 30 ips me madhësi imazhi 1,280 x 960 Zmadhim optic deri 45x (optical zoom) Intërval dinamik, 128 x

III. Kamera fikse dhome e brendshme Kamera HD nop deri ne 60ips Sensor MOS 1.3 Megapixel me ndjeshmeri të lartë dhe skanim progresiv 1.3 mega pixel [16 : 9] (30/60 fps) 1,280 x no/ 640 x 360 / 320 x 180/160 x 90 1.3 mega pixel [4 : 3] (30 fps) 1,280 x 960/800 x 600 /640 x 480 / 400 x 300 / 320 x 240/160 x 120

IV. Pajisje Storage Protokollet dhe standartët e -FC, optical iSCSI, SAS, InfiniBand Numri maksimal i disqeve -Të paktën 382 disqe duke përdorur shasi shtësë Software menaxhimi i CCTV (VMS) Lloji i implementimit - Server rregjistrimi Ridondant

Argumenta ligjore dhe konkluzione

Bazuar në VKM 914 datë 29.12.2014 neni 74 pika 3 nga ku citoj:

"...Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kerkesat ligjore, tq parashikuar nq nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara ne dokumentet e tenderit. Kerkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në



përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrveshjedhe në nenin 23 pika 4 nga ku citoj:

" ... për të provuar përvojën e mëparshme, Autoriteti Kontraktor kërkon dëshmi për furnizimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri vitëve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri vitëve të fundit..."

Në këto rrethana s'kualifikimi i këtij operatori sipas fakteve dhe argumentave ligjore që paraqitëm më sipër është i mirëargumentuar.

A. BASHKIMI I PËRKOHSHEM I OPERATOREVE ; "A. C." SHPK, & "E." SHPK, & " E." SHPK

a) Operatori ekonomik "E." sh.p.k, nuk ka paraqitur Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit sipas shtojca 7.

b) Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk ka paraqitur listën e ndarë në zëra dhe vlerë për secilin operator sipas marrëveshjes notëriale midis tyre

c) Operatori "E." Shpk nuk ka paraqitur vërtëtimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të matuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

d) Bashkimi i operatoreve ekonomik nuk përmbush kushtet, sipas paragrafit 2.3 Kapaciteti Teknik, në KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT:

- 1 (një) Specialist të certifikuar për sistemet storage;
- 2 (dy) Specialist të certifikuar për rrjeta.
- 1 (një) Specialist të certifikuar për sistemet server.
- 1 (një) Specialist të certifikuar për infrastrukturën "VMWARE" server.
- 1 (një) Specialist të certifikuar për sistemet video storage;
- e) Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk ka paraqitur model (nr.e produktit) dhe katalogun përkatës për artikullin e kerkuar:

- Elektropompe e zhytur
- Ethernet Multi mode Fiber transceiver
- Ethernet Single mode Fiber transceiver
- Ethernet Coppel Transceiver
- Fiber optike multimode për ambient të jashtëm 4 50/125
- Fibra optike Singlemode për ambient të jashtëm 8 9/125
- Kabllo elektrike PVC 3x1.5 mm²
- Kabllo elektrike PVC 3x2.5 mm³
- f) Operatori Ekonomik nuk plotëson specifikimet e kërkuara për produktët:
- Portë rrotulluese Tornelo (2.5 milion cikle kalimi)
- Kalun piston Ules-Ngritës (Koha e ngritjes 5 - 10 sec, Të jetë i pajisur me sinjalizues zanor gjat kohës së lëvizjes së pistonit, të ketë mekanizem për ulje emergjentë të pistonit)
- Kamera IP speed dhome e jashtme (Rezolucion 1080p@ 25 fps (PAL), Ditë/Natë)
- Pajisje Storage (Memorja fizike 24GB, minimum ; 96GB, maksimum)
- Kontroller (Joystick) për VMS (Me ndërfaqe USB nga e cila merr dhe ushqim)
- Distribution Switch me 24 Porta (Kapacitet switching - 640 Gbps; Maksimumi 32,000 Adresa MAC)
- Sëitch industrial me 8 porta POE+ (8 X 10/100/1000Base-T(X) që suportojne PoE+; 4 X SFP 1000Base-X, për realizim daisy-chain; Kapaciteti i procesimit të trafikut - 24Gbps; i montueshem në mur si dhe nëpër shinat të standardit DIN)

B. OPERATORI EKONOMIK ; "T. S." SHPK,

a) Operatori Ekonomik nuk ka paraqitur model (nr.e produktit) dhe katalogun



përkatës për artikullin e kërkuar:

- Elektropompe e zhytur
- Fiber optike multimode për ambient të jashtëm 4 50/125
- Fibra optike Singlemode për ambient të jashtëm 8 9/125
- Kabllo elektrike PVC 3x1.5 mm²
- Kabllo elektrike PVC 3x2.5 mm³

b) Operatori Ekonomik nuk plotëson specifikimet e kërkuara për produktët:

- Barrier për kembesore dhe biciklet bidireksionale (Set i përbere prej celiku AISI 304, e motorizuar 24Dc e kompletuar me skedën elektronike dhe sistemin antipanic me shtyrje; Ushqyesi të jetë tip switching 24 V DC 6 A- 7A i kompletuar me kasetën IP65 për setin e dy drejtimeve të tornelove)

- Kamera IP Fikse e Jashtme (Rezolucioni të paktën 720p@50Fps (PAL))

Sipas verifikimeve të bera, operatori "T. S." ka një kontratë aktive me Autoritetin Portual, nga ku referuar kontratës, nenit 4 për Praktikën Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve dhe konkretisht paragrafi 4.3 nga ku citoj:

"...Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndërtimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me këtë kontratë..."

Ne keto rrethana ky operator konsiderohet i s'kualifikuar sipas fakteve dhe argumentave ligjore që paraqiten më sipër.

Operatori "T. S." e ka ankimuar këtë vendim të KVO ne KPP nga i cili ka marrë përgjigje me vendimin ***Nr.747/2016, datë 30. 09. 2016 të Komisionit të Prokurimit Publik është vendosur: Të mos pranohet ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik "T. S." sh.p.k. për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur", me nr.REF-42945-06-24-2016, me objekt Furnizim vendosje – "Rinovimi i paisjeve si dhe zgjerimi i sistemit ISPS (Kalatë Lindore, Hyrjen e Terminalit të Kontinierëve si dhe Zonën e Peshkimit), Zgjerimi i kapaciteteve të ruajtjes së informacionit të imazheve të kamerave si dhe imazheve në hyrje të portave kryesore", me fond limit 51,368,887 (pesëdhjetë e një milion e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë, pa tvsh, zhvilluar në datën 25.07.2016, nga Autoriteti Kontraktor, Autoriteti Portual Durrës.***

Duke marrë shkas nga ky vendim i KPP-së dhe trajtimi i metejshëm i cdo oferte prej "T.S." duhet të kishte këtë precedentë.

Por gjatë ushtrimit të kontrollit për procedurat që kanë vijuar;

KVO i ngritur me urdhrin nr. 1820 dt 23.6.2016 i përbërë nga Kryetare A. Ç. dhe anetar N. P. - Jurist, D. D. – ***nuk ka shpallur asnjë fitues, ku secili anëtar ka dhënë arsyetimet e veta për skualifikimin nga gara për secilin operator ekonomik pjesëmarrës të cilat u përshkruan si më lartë:***

Për sa i takon procedurës së prokurimit ka pasur ankesë nga operatori ekonomik "A..." Shpk, nr. 2158 prot datë 09.08.2016, për vendimin e Komisionit të Vleresimit të Ofertave.

Për shqyrtimin e ankesës është ngritur një komision i vecantë me urdhër të ish-drejtorit Ekzekutiv G. Sh. me urdhrin nr. 2382 dt 24.08.2016. Titullari ka marrë ekspert të jashtëm IT për të kundërshtuar vendimin e KVO-së.

Përbërja e komisionit pas ndryshimeve u bë :

M. N. Specilist i Jashtëm IT

Sh. H. Veteriner

Y. K. Ing Mekanik

Komisioni i shqyrtimit të ankesës me vendimin nr. 2158/3, datë 29.08.2016 ka kundërshtuar vendimin e Komisionit të Vleresimit të Ofertave duke i dhënë të drejtë Bashkimit të



Përkohshem të Operatorëve ; " A. " shpk, & " S. " shpk, & " B. " shpk.

Me shkresën nr. 2434 , datë 31.08.2016 Drejtori ka nxjerrë urdhrin për KVO për shqyrtimin e vendimit .KVO ka vendosur shpalljen fitues të bashkimit të i përkohshem të operatoreve ; " A. " shpk, & " S. " shpk, & " B. " shpk.

Lidhur me këtë vendim vleresojmë se është i pa argumentuar sepse:

Operatori ekonomik "A." Shpk nuk plotëson:

I.

- kriterin për **kontrata të ngjashme** të përcaktuara ne Kriteret e Vecanta të Vleresimit.
- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk përmbush kushtet, sipas paragrafit 2.3 Kapaciteti Teknik, ne KRITERET E VECANTA TË KUALIFIKIMIT:
- Bashkimi i Operatoreve Ekonomik nuk ka paraqitur çertifikatë të specializimit, të leshuara nga prodhuesit e sistemeve të sigurisë.
- 1 (një) Specialist të certifikuar për infrastrukturën "VMWARE" server.

II. Bashkimi i operatoreve nuk ka përmbushur specifikimet e kërkuar në shtojcën 10 të DST për artikujt:

- Barriera me krah të ngritshëm 3m Pivot (barrierat duhet të jenë me krah të ngritshëm dhe Super të Shpejta për përdorim intensiv të vazhdueshëm. Koha e hapjes 0,8/2.2 sec)
- Portë rrotulluese Tornelo (Struktura (Materialet) : 304 Grade grained stainless steel)
- Elektropompë e zhytur (kalimi i materialeve të ngurtë max mm 15)
- Pajisje storage (Kapaciteti Raw maksimal; të paktën 3PB duke përdorur shasi shtese për zgjerim)
- Pajisje storage (Memorja fizike ; - 24GB, minimum; - 96GB, maksimum)
- Distribution sëitch me 24 porta (Kapacitet switching - 640 Gbps; Stacking bandwidth - 480 Gbps; Adresat MAC; - Maksimumi 32,000 Adresa MAC)
- Switch industrial me 8 porta POE+ (Temperatura e operimit -40 deri +75°C; I montueshem ne mur si dhe nepër shinat të standardit DIN)
- Switch industrial me 4 porta POE+ (Temperatura e operimit -40 deri +75°C; i montueshem ne mur si dhe nepër shinat të standardit DIN

Pra duhej të S'Kualifikohej.

Komision i cili ne menyre të pashpjegueshme është ndryshuar me qëllim emërimin e një specialisti të jashtëm, nevoja për të cilin është e pa justifikueshme pasi:

1. AK ka treguar gadishmërinë e saj për nisjen e kësaj procedure prokurimi duke vënë në dispozicion burimet e saj njerëzore për:

- Planifikimin e detajuar të kësaj procedure në Plan Biznesin e 2016 dhe mosplanifikimin ne këtë fazë të marrjes së një specialisti të jashtëm, duke i pasur të qarta ekspertizat e burimeve njerëzore si pjese e organogramës së APD-së.
- Hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit.
- Shqyrtimin dhe marrjen e vendimit për t'iu përgjigjur ankesës së parë të BOE në lidhje me disa pretendime për dokumentat e tenderit para hapjes së ofertave.
- Ngritjen e KVO-se dhe shqyrtimin nga ana e saj në menyre të mirëargumentuar të cdo dokumentacioni të paraqitur nga BOE në ofertën elektronike.

Madje edhe vleresimet e kandidatëve për specialistë të jashtëm jane bërë nga specialistë të brendshëm

2. Arsyet e skualifikimit kanë qenë lehtësisht të verifikueshme, pasi të paktën për përmbushjen e kontratave të ngjashme dhe xhiron mesatare mjafton një përlllogaritje e thjeshtë matematikore për të cilën specialist i Autoritetit Kontraktkor, qoftë ky edhe me arsim të mesëm, është i kualifikuar që ta ndërmarrë.



Cdo argumentim për të justifikuar kontraktimin e nje specialisti të jashtëm ka qenë nje përpjekje e dëshpëruar për t'i rikthyer kualifikimin e kërkuar BOE e përbere nga A... Shpk& S...Shpk&B...Shpk, përpjekje e cila përbën shkelje të procedurave të prokurimit, shkeljen të barazisë ne tendera dhe duke pasur parasysh që skualifikimi i BOE do të conte ne anulimin e kësaj procedure fondet e prokuruar me këtë procedure konsiderohen të keqpërdorura duke financuar nje kontratë e cila nuk i është nënshtruar procedurave të parashikuara ligjore për prokurimin publik ne LPP nr.9643 datë 20-11-2006 i ndryshuar dhe Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik",i ndryshuar:

- neni 2, është shprehur në mënyrë eksplicite se: *"Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet nëpërputhje me këto parime të përgjithshme:*

a) mos diskriminimdhjetrajtim ibarabartë i ofertuesveose kandidatëve;

b) transparencë në proceduratëprokurimit;

c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve".

-neni 12, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se *"Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij".*

Parimi i barazisë përpara Ligjit është trajtuar në disa çështje të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese. Kështu që në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007 ".....Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabartë përpara Ligjit, jo vetëm në të drejta themelore të parashikuara në kushtetutë, por edhe në të drejta të tjera ligjore". Parimi i barazisë është sanksionuar dhe në Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe në Konventën Evropiane të të drejtave të njeriut.

Si konkluzion të argumenteve të përmendur si më sipër, grupi i auditimit konstaton se veprimet e lartë përmendura të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, janë shkelje e rëndë e legjislacionit në fuqi dhe përbëjnë një shkelje flagrante të zbatimit të gabuar të Ligjit dhe të abuzimit me detyrën.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura mësipër ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor G. Sh. për mosndarje të detyrave dhe specialistëve përkatës të angazhuar në procedurat e prokurimit, detyrim i përcaktuar në VKM 914 datë 29.12.2014, neni 56 "Titullari i *Autoritetit Kontraktor ose Zyrtari i Autorizuar*", *ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Titullari i Autoritetit Kontraktor ose Zyrtari i Autorizuar prej tij është përgjegjës për ngritjen e grupeve të punës, komisioneve të përfshira në procesin e prokurimit dhe nxjerrjen e urdhrat të prokurimit. Zyrtari i autorizuar për fillimin e prokurimit duhet të jetë njëri nga drejtuesit kryesorë të Autoritetit Kontraktor, zakonisht Zëvendëstitullari. Ai duhet të sigurojë një ndarje të qartë ndërmjet detyrave të zyrtarëve/nënpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit".*

Gjithsesi për arsytet dhe konstatimet e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente për të korigjuar këtë praktikë të paligjshme me qëllimin e rivënies në vend të të drejtave të shkelura në favor të subjekteve private dhe për të evituar abuzimin e mëtejshëm që kryhet nga punonjësit e shoqërisë.

Kontrata është lidhur me nr.2839 prot, datë 14.10.2016 ndërmjet G. Sh., në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të APD-së dhe kontraktuesve "A." SHPK, "S." SHPK dhe "B." SHPK, në vlerën 57,314,478 lekë, kontrata duhet të fillojë zbatimin me nënshkrimin e saj (pra, më datë 14.10.2016), me kohëzgjatje 60-ditë, ndjekës kontrate është caktuar S. K.. Kontrata



shoqërohet me sigurimin e kontratës, deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike dhe formularin e ofertës ekonomike.

Me shkresën nr. 2840 prot, datë 14.10.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, formulari i njoftimit të kontratës të nënshkruar i është dërguar APP-së, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr. 42, datë 24.10.2016.

Me urdhërin e brendshëm nr.2839/1 prot, datë 14.10.2016, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, janë caktuar: S. K., me profesion Informatikë, si përfaqësues për Monitorimin e Zbatimit të Kontratës, dhe është ngritur Komisioni i Kontrollit dhe Pranimit të Mallrave, me Kryetar – S. K., Anëtarë – F. Gj., me profesion Inxhinier Ndërtimi, dhe E. I., me profesion Inxhinier Elektrik.

Zbatimi i kontratës.

1. Pajisje “Storage” zeri me numer 9 ne listën e specifikimeve.

Produkti i ofruar në dokumentat e tenderit është 1 set i përbërë nga këto 3(tre) pajisje:

- 1(nje) pajisje kontroller storage me emer produkti “Dell poëer vault MD 3800F” dhe
- 2 (dy) copë pajisje ruajtje informacioni - storage me emer produkti “ MD1200”.

Produkti i furnizuar dhe instaluar për këtë zë:

2 (dy) copë pajisje kontroller storage Dell Power Vault MD3800F (në ndryshim me dokumentat e tenderit ku për këtë produkt sasia është 1(nje).

1 (një) copë pajisje storage DELL MD 1200 (në ndryshim me dokumentat e tenderit ku për këtë produkt sasia është 2(dy).

Pajisja ka Memorje fizike max.16 GB kur jane të kerkur 24GB minimum dhe 96GB maksimum

2. Software VMS (Softi i menaxhimit të videos).

Paragrafi	Specifikimi i kerkuar	Komenti	
	1.7	<ul style="list-style-type: none">• Suport ndaj Active Directory	Ky intëgrim nuk është realizuar.
	2.2	<ul style="list-style-type: none">• Lidhje me kamerat nepërmjet HTTPS(të sigurtë)	Nuk është aktivizuar ky protokoll sigurie ne lidhjen midis kamerave dhe VMS.
	3.3	<ul style="list-style-type: none">• Rregjistrim video të skedulueshem.	Nuk është e aktivizuar.
	3.4	<ul style="list-style-type: none">• Video Motion Detëction me sensitivitet të rregullueshem dhe me përzgjedhje zonash.	Nuk është aktivizuar.
Arkivimi dhe kapaciteti storage	4.1	<ul style="list-style-type: none">• Arkivim i videove modular ku mund të caktohet vendosja e rregjistrimeve ne zona të ndryshme të storage ne baze të vjetërise ne menyre qe të shpejtohet aksesimi i rregjistrimeve dhe ulet kostoja e storage	Ku funksionalitet nuk është zbatuar.
	4.3	<ul style="list-style-type: none">• Enkriptim I regjistrimeve video ne databazen e sistëmit	Ky funksionalitet nuk është zbatuar.
	4.4	<ul style="list-style-type: none">• Lejon uljen e cilesise se regjistrimeve të vjetra me qellim përdorimin me efikas të storage	Ky funksionalitet nuk është zbatuar.
	4.5	<ul style="list-style-type: none">• Lejon krijimin e disa kontënitoreve video për të cilet mund të përcaktohen politika të vecantë mbi cilesine e regjistrimit dhe enkriptimin.	Ky funksionalitet nuk është aplikuar.
	4.7	<ul style="list-style-type: none">• Support dhe rregjistrim për one- ëay dhe tëo-ëay audio	Ky funksionalitet nuk është konfiguruar
Clienti për VMS	5.1	<ul style="list-style-type: none">• Suport për ëeb broëser dhe për ëindoës PC	Ky funksionalitet nuk është konfiguruar



1. Në dokumentat e tenderit artikulli nr.16. **Distribution Switchme 24 porta** është kuotuar produkti **NS4750-24S-4T-4X** , i cili është max 128 Gbps kapacitet switching nga 640 Gbps të kërkuar me Bandwidth I stack është 40Gbps nga 480Gbps i kërkuar ofron vetëm rutim static dhe jo rutim dinamik sic është kërkuar: OSPF, BGP etj, nuk ofron enkriptim ne Layer 2, Nuk ofron funksione wireless controller, ofron 16,000 MAC adresa nga 32,000 të kërkuara **Në fazën e dorëzimit** në magazinë dhe instalimit në vend është sjellë produkti Distribution Sëitch me 24 porta **Cisco C3850** qe plotëson specifikimet e kërkuara ne DST.

2. Në dokumentat e tenderit artikulli nr. 17: Switch industrial me 8 porta PoE+ është kuotuar: Produkti **NS3702-24P-4S**, nuk është sëitch industrial dhe për rrjedhoje nuk plotëson specifikimet e ambientit. Temperatura e operimit është 0-50grade nga -40-75 grade C , Nuk është i montueshem ne shine DIN (për instalime ne tërren)

Në fazën e dorëzimit në magazinë dhe instalimit në vend është sjellë produkti Switch industrial me 8 porta PoE+ brand Transition **SISPM1040-384-LRT-B**, qe plotëson specifikimet e kërkuara ne dokumentat e tenderit.

3. Ne dokumentat e tenderit artikulli nr. 18 Sëitch industrial me 4 porta PoE+ është kuotuar: Produkti **NS3502-8P-2S** nuk është sëitch industrial dhe për rrjedhoje nuk plotëson specifikimet e ambientit. Temperatura e operimit është 0-50gradë nga -40-75 gradë C. Nuk është i montueshëm në shinë DIN (për instalime në terren)

Në fazën e dorëzimit në magazinë dhe instalimit në vend, është sjellë produkti Switch industrial me 4 porta PoE+porta brand “Transition **SISTP1040-242-LRT**”, që plotëson specifikimet e kërkuara ne dokumentat e tenderit.

Sistemi dhe sot paraqet probleme ne shkarkimin e regjistrimeve

Me urdhër trasferte datë 10.02.2017 nëpërmjet Bankës B. është likuiduar shoqëria “A...” shpk me vleren 5,372,294 leke.

Dokumentacioni: Fature nr.4, datë 10.01.2016 me vleren 5,372,294leke e firmosur nga S. K. për APD dhe F. A. për shoqërinë “A...” shpk; Proces nr.8, datë 03.04.2017 me objekt shtesë kontratë nr.reference 17 PH 2016, me nr.2839, datë 10.04.2016. i firmosur nga S. K., E. I. dhe F. Gj..

Nuk ka test raport për pajisjet.

Me urdhër trasferte datë 10.02.2017 nëpërmjet Bankes B. është likuiduar shoqëria “A...” shpk me vleren 15,963,561 leke.

Dokumentacioni: Faturë nr.119, datë 13.12.2016 me vleren 15,963,561leke e firmosur nga S. K. për APD dhe F. A. për shoqërinë “A...” shpk; Proces nr.4, datë13.12.2016 me objekt shtesë kontratë nr.reference reference 17 PH 2016, me nr.2839, datë 10.04.2016. I firmosur nga S. K., E. I. dhe F. Gj..

Nuk ka test raport për pajisjet

Me urdher trasfertë datë 10.02.2017 nëpërmjet Bankes B. është likuiduar shoqëria “A...” shpk me vleren 9,508,936 leke.

Dokumentacioni: Fature nr.122, datë 13.12.2016 me vleren 9,508,936 leke e firmosur nga S. K. për APD dhe F. A. për shoqërinë “A...” shpk; Proces nr.6, datë 13.12.2016 me objekt shtesë kontrate nr.reference 17 PH 2016, me nr.2839, datë 10.04.2016. i firmosur nga S. K., E. I. dhe F. Gj..

Nuk ka test raport për pajisjet.

Me urdhër trasferte datë 10.02.2017 nëpërmjet Bankës B. është likuiduar shoqëria “A...” shpk me vlerën 2,152,671 lekë.

Dokumentacioni: Faturë nr.5, datë 12.01.2017 me vlerën 2,152,671 leke e firmosur nga S. K. për APD-në dhe F. A. për shoqërinë “A...” shpk; Proces nr.9, datë 12.01.2017 me objekt shtesë kontratë nr.reference 17 PNSH 2016, me nr.2839, datë 10.04.2016. I firmosur nga S.



K., E. I. dhe F. Gj..

Nuk ka test raport për pajisjet.

Me urdhër transferte datë 16.01.2017 nëpërmjet Bankës B. është likuiduar shoqëria "A..." shpk me vlerën 4,154,052 leke.

Dokumentacioni: Fature nr.115, datë 13.12.2016 me vleren 4,954,052 leke e firmosur nga S. K. për APD dhe R. Ç. për shoqërinë "A..." shpk; Proces nr.3, datë 13.12.2016 me objekt shtesë kontratë nr.reference reference 17 PH 2016, me nr.2839, datë 10.04.2016. I firmosur nga S. K., E. I. dhe F. Gj..

Nuk ka test raport për pajisjet.

Me urdhër transferte datë 23.12.2016 nëpërmjet Bankës B. është likuiduar shoqëria "A..." shpk me vleren 10,839,918 leke.

Dokumentacioni: Fature nr.97, datë 01.12.2016 me vleren 10,839,918 leke e firmosur nga S. K. për APD dhe R. Ç. për shoqërinë "A..." shpk; Proces nr.2, datë 01.12.2016 me objekt shtesë kontrate nr.reference 17 PH 2016, me nr.2839, datë 10.04.2016. i firmosur nga S. K., E. I.dhe F. Gj..

Nuk ka test raport për pajisjet

Me urdhër transferte datë 23.12.2016 nëpërmjet Bankës B. është likuiduar shoqëria "A..." shpk me vlerën 1,065,302 leke.

Dokumentacioni: Fature nr.92, datë 22.11.2016 me vleren 1,065,302 leke e firmosur nga S. K. për APD dhe R. Ç. për shoqërinë "A..." shpk; Proces pa numer, datë 22.11.2016 me objekt shtesë kontratë nr.reference 17 PH 2016, me nr.2839, datë 10.04.2016. I firmosur nga S. K., E. I. dhe F. Gj..

Nuk ka test raport për pajisjet

Shuma likuidur 49,056,734 lekë

Në kushtet e kualifikimit, shpalljes fitues e "A..." shpk sh.p.k nga KVO, si dhe lidhjes së kontratës, ***në mënyrë të padrejtë***, duke mos përmbushur kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit" dhe Udhëzimit MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar ***vlera 49,056,734 leke përbën dëm ekonomik për APD-në dhe Buxhetin e Shtetit, pasi APD-ja nuk është furnizuar me pajisjet sipas specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit, dhe për të cilën "A..." shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Pra paraja publike nuk është shpenzuar për plotësimin e nevojave të APD-së. Pra duhet të dëmshpërblehet nga shoqëria "A..." shpk***

Për pos sa mësipër

Pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (qe janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën "A..." shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10,489 datë 15.12.2011 "Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore", neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr.369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit".

Për pasojë Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinion e Tij, që këto pajisje janë të



njëta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “A...” shpk, ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Shtesa e kontratës nr.2839, datë 10.04.2016, afati i përfundimit është data 13.12.2016.

Theksojmë se kontrata e lidhur më datë 10.03.2017 ndërmejt APD-së të përfaqësuar A. L. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor dhe Shoqërisë “A...” shpk e përfaqësuar F. A., në vlerën 11,381,886 lekë. Kontrata nuk është sipas dokumentave standarte për mallrat, por për punët civile.

Shtesa e kontratës është realizuar referuar kërkesës nr.147 prto, datë 19.01.2017 të ish-drejtorit të FSPD drejtuar A. L. me objekt “Kërkesë për unifikimin e të gjithë sistemit CCTV. Me urdhër trasferte datë 28.04.2017 nëpërmjet Bankës B. është likuiduar shoqëria “A...” shpk me vlerën 1, 035,090 lekë.

Dokumentacioni: Fature nr.35, datë 18.04.2017 me vleren 1,092,000 leke e firmosur nga S. K. për APD dhe F. A. për shoqërinë “A...” shpk; Proces nr.2, datë 18.04.2017 me objekt shtesë kontratë nr.reference 22 PNSH 2017, me nr.742, datë 10.03.2017. i firmosur nga S. K., E. I. dhe F. Gj..

Me urdhër transferte datë 28.04.2017 nëpërmjet Bankës B. është likuiduar shoqëria “A.” shpk me vlerën 10,289,886 lekë.

Dokumentacioni: Fature nr.31, datë 03.04.2017 me vleren 10,289,886 leke e firmosur nga S. K. për APD dhe F. A. për shoqërinë “A...” shpk; Proces nr.1, datë 03.04.2017 me objekt shtesë kontratë nr.reference 22 PNSH 2017, me nr.742, datë 10.03.2017. i firmosur nga S. K., E. I. dhe F. Gj..

Shuma e likuiduar 11,381,886 lekë. Nuk është përcaktuar dhe mbajtur në kontratë garancia për difektet as në përqindje dhe as në afat.

Për pos sa më sipër

Pajisjet janë të pashoqëruara me test raport fabrike.

Pajisjet nuk janë të shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të bëhet verifikimi i specifikimeve teknike (që janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën “A...” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produktëve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr.369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit".

Për pasojë Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinion e Tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “A...” shpk, ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Deri në paraqitjen nga Shoqëria “A...” shpk të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “A...” shpk “ ka fituar tenderin dhe është likuiduar, vlera 11,381,886 lekë për APD dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “A...” shpk.

7.11. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje veshmbathje, viti 2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

	ofertave	
Urdhër prokurimi i titullarit të autoritetit kontraktor, A. L. Nr.406, datë 09.02.2017	Ngritur me urdhrin Nr.407, datë 09.02.2017	Ngritur me urdhrin Nr.406, datë 09.02.2017
Vlera e përlogaritur e kontratës 39.175.200 lekë, pa Tvsh.	1- A. K. – Shkenca Politike 2-A. D.- Ing. Ndërtimi 3-Sh.Xh.- Akademia e Rendit	1.E. K.-Jurist 2.J. R. -Juriste 3. S. D. - Jurist.
Procedurë e hapur		
Operatori Ekonomik fitues, shoqëria: “K..”SHPK, Vlera e ofertës 38.000.000 lekë, pa TVSH.		
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor më datë 13.10.2017.	Njoftim i kontratës, botuar në buletin e APP dt. 13 Shkurt 2017	Tenderi i zhvilluar me dt. 06/03/2017, ora 10.00
Operatori Ekonomik - “K.” SHPK Kontratë Nr.2528 prot, datë 17.10.2017, me vlerë Lekë me TVSH.	Ofertat e paraqitura 5 Operatorë Ekonomikë	Kualifikuar 1
Njoftim klasifikimi është bërë elektronikisht dt.06.03.2017	Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik dt.20 Mars 2017	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletin e APP, datë 03 Prill 2017, faqe 380

Nga dokumentacioni i vë në dispozicion dhe aksesit në sistemin e prokurimit elektronik të APP, u konstatua se:

Me shkresën e protokolluar me nr.165, datë 19.01.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Veshmbathje”, me përbërje: K. K. (Kryetare), me profesion Inxhinieri Mekanike, O. H. me profesion Oficer, dhe L. K. me profesion Ekonomi Agrare.

Me shkresën e protokolluar me nr.165/1, datë 02.02.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm mbi zëvendësimin e Kryetarit të Komisionit për Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Veshmbathje”, si vijon: K. K., nga S. T. me profesion Ekonomi-Financë.

Me shkresën e protokolluar me nr. 57, datë 02.02.2017, të firmosur nga kryetari komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Veshmbathje”, komisioni i është drejtuar Drejtorisë së FSPD-së.

Me shkresën e protokolluar me nr. 57/1, datë 03.02.2017, të firmosur nga Drejtori i FSPD-së i është dërguar Sektorit të Prokurimeve dhe Komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Veshmbathje”, lista me artikujt e kërkuar.

Me shkresën e protokolluar me nr. 58, datë 02.02.2017, të firmosur nga Kryetari Komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Veshmbathje”, komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Mjedisit.

Me shkresën e protokolluar me nr.58/1, datë 03.02.2017, të firmosur nga Drejtori i Drejtorisë së Mjedisit, i është dërguar Sektorit të Prokurimeve dhe komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Veshmbathje”, lista me artikujt e kërkuar.

Me shkresën e protokolluar me nr. 56, datë 02.02.2017, të firmosur nga Kryetari Komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Veshmbathje”, komisioni i është drejtuar Drejtorisë së Zhvillimit.



Me shkresën e protokolluar me nr.56/1, datë 03.02.2017, të firmosur nga Drejtori i Drejtorisë së Zhvillimit, i është dërguar Sektorit të Prokurimeve dhe Komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës së prokurimit me titull “Blerje Veshmbathje”, tabela me artikujt e kërkuar.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 39.175.200 lekë, pas ofertës të ofruar për vlerën 39.175.200 lekë nga “M...” SHPK, për vlerën 39.958.704 lekë nga shoqëria “GJ...” SHPK për vlerën 40,074,650 lekë nga Shoqëria “E...” SHPK, për vlerën 41.790.314 lekë nga Shoqëria “E...” SHPK.

Vlera 39.175.200 lekë, është marr vlera e plan biznesit, pasi mesatarja e ofertave të ofruara del 40,2439,717 lekë. Pra në përlllogaritjen e vlerës të kontratës, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, apo çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK-ja, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementët e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës”. Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi grupin e përbërë nga K. K., O. H. dhe L. K..

Me shkresën e protokolluar me nr. 406, datë 09.02.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i prokurimit, me objekt “Blerje Veshmbathje”, me fond limit 39.175.200 lekë pa tvsh, në të cilin janë caktuar anëtarët e njësisë së prokurimit, me përbërje: E. K., J. R. dhe S. D., të tre me profesionin Jurist.

Më datë 09.02.2017, është mbajtur nga anëtarët e njësisë së prokurimit, procesverbali për hartimin e dokumentave të tenderit për këtë procedurë prokurimi, i firmosur prej tyre.

Me shkresën e protokolluar me nr.407, datë 09.02.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, me përbërje: A. K. (Kryetar) me profesion Shkenca Politike, A. D. me profesion Inxhinieri Ndërtimi, dhe Sh. Xh. me profesion Akademia E Rendit.

Me shkresën (pa numër protokoll dhe pa datë), të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është bërë formulimi i njoftimit të kontratës, i cili është botuar në buletin e prokurimit publik me nr.6, datë 13.02.2017.

Më datë 06.03.2017, është mbajtur nga anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), procesverbali mbi paraqitjen dhe pranimin e mostrave të kërkuara nga AK, sipas kriterëve të DT, i firmosur prej tyre, nga ofertuesi “K...”.

Më datë 06.03.2017, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali i dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

Më datë 06.03.2017, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali i kualifikimit të ofertave.

Me shkresën nr.780 prot., datë 15.03.2017, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar raportin përmbledhës nga KVO, për këtë procedurë prokurimi, raport i cili është miratuar prej tij.

Me shkresën nr.780/1 prot., datë 15.03.2017, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, është miratuar procedura e prokurimit.

Me shkresën nr.781 prot., datë 15.03.2017, të firmosur nga Titullari i Autoritetit Kontraktor, është bërë formulimi i njoftimit të fituesit, i cili është botuar në buletin e Prokurimit Publik me nr.11, datë 20.03.2017.

Me procesverbalin datë 23.03.2017, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, kanë verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori fitues.



Koment i grupit të auditimit

Kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike nuk janë hartuar konformë dispozitave ligjore në fuqi. Konkretisht:

1. Nuk janë qartësuar dhe detajuar elementet e dokumentit ***“ofertes teknike”***, te cilët shërbejnë për një identifikim të qartë të produktit të ofruar, si në cilësi dhe origjinë, konkretisht mungon kërkesa në këtë dokument :

a. kërkesa për paraqitjen e kodit të produktit apo kodit bar element, i cili do të përcaktonte qartë se me kq produkt kemi të bëjmë, prej nga vjen (nga cili prodhues).

b. emërtimin e dokumentit të dorëzuar në ofertë, si certifikate që vërteton konformitetin e këtij produkti me normat e kerkuara.

c. faqen e katalogut ku pershkruhen specifikimet e këtij produkti të nevojshme, për tu krahasuar nga KVO me specifikimet e kerkuara nga APD.

2. Nuk është përcaktuar asnjë kusht për fituesin për t’u përmbushur në fazën e dorëzimit, si certifikata e fabrikimit apo cdo dokument ekuivalent që do dëshmonte zyrtarisht për mënyrën e fabrikimit dhe origjinën e prodhimit te produkteve te furnizuara.

3. Me ane te kriterit ne piken a.2 ***“...duhet të paraqesë raportet e analizave të kryera nga laboratore Shqiptare të akredituar në Republikën e Shqipërisë në fushën e tekstil-konfeksioneve, për treguesit fiziko-mekanik e kimik të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi në mënyrë që të vërtetohet pajtueshmëria në specifikimet teknike të kërkuara. Mosparaqitja e fletë analizave për të gjithë artikujt e kërkuar, përbën kusht për skualifikim..”***. Hartuesit e specifikimeve i kane hequr te drejten e pjesmarrjes cdo operatori, i cili artikujt e ofruar i ka te testuar analitikisht ne laboratorë të huaj minimalisht, po aq të akredituar në sferën ndërkombetare, sa c’mund Labororet Shqiptare ne Republikën e Shqipërisë. Duke ndikuar kështu në cilësinë e produkteve të ofruara dhe në përfitimin që siguron konkurueshmëria uljen e ofertave në tender.

Nga ana tjetër për produkte si këpucë, pelerinë shiu, jelek fosforeshente janë kërkuar certifikata konformiteti të standarteve ndërkombëtare, duke mos shpjeguar pse për të tjerat nuk është i nevojshëm ky konformitet.

Ne piken a.3 është kërkuar ***Autorizim prodhuesi për artikujt objekt i procedurës së prokurimit, “Stema dhe shenja krahu”, “Lëkura për prodhimin e këpucës dhe dorezave”, “Objekteve të uniformës”***. ***Autorizimi i prodhuesit duhet të jetë i noterizuar në vendin e Orgjinës, i përkthyer dhe i noterizuar në Shqipëri*** dhe jo për pjesën tjetër të artikujve të kërkuar.

Përcaktimi i mësipërm

-a.Përcakton operatorin fitues që në hartimin e dokumenteve të tenderimit

Dhe pyetja që shtrohet është cili është ai operator që e ka të mundur të prodhojë një numër të përcaktuar artikujsh dhe për pjesën tjetër ka autorizim prodhuesi? Nëse gjendet një operator i tillë ky është ***i favorizuari***, kundrejt të gjithë të tjerëve që artikujt që APD-ja kërkon t’i ofrojnë si të prodhuara prej tyre ose ndryshe te tregtuara nga një prodhues tjetër.

b. Autorizimi i prodhuesit është në kundërshtim me nenet 20, 23 dhe 46 të Ligjit 9643/2006, i ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se Autoritetet Kontraktore gjatë përcaktimit të kriterëve të veçanta duhet të shmangin çdo kërkesë apo procedurë që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomik, e cila përben diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. Por në përcaktimin apo në vendosjen e kriterëve specifike, që në thelb konsiderohen si kriterë fituese për shkak të rëndësisë që kanë, ligjvënësi i ka parashikuar kufizime autoritetit kontraktor brenda diskrecionit që ka në përzgjidhjen e tyre. Në këtë mënyrë, dispozitat e sipërpërmendura, urdhërojnë që përcaktimi i këtyre kriterëve duhet të jetë (i) në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe (ii)



jodiskriminues, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve.

Gjatë përshkrimit të objektit të prokurimit publik, autoritetet kontraktore përdorin “kritere të veçanta kualifikimi“, në të cilat përfshihen specifikimet teknike, që zakonisht, kupton tërësinë e kërkesave teknike. Këto specifikime teknike përcaktojnë karakteristikat e kërkuara nga punët, mallrat ose shërbimet që plotësojnë përdorimin të cilin ato synojnë nga Autoriteti Kontraktor. Kërkesat/specifikimet teknike shpesh përfshijn nivelin e cilësisë, performancës, sigurisë apo përmasave, garantimin e cilësisë, termologjinë, simbolet, testimet dhe metodat e testimit si dhe të paketimit, markën dhe etiketimin etj.

Autorizimi i prodhuesit është në kundërshtim edhe me jurisprudencën e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropin në Çështjen Procuroeur du Roi v. Dassnoville, 1974.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 23, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2009 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Përmiratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 61, ç'ka ngarkon me përgjegjësi komisionin e hartimit të specifikimeve teknike dhe perlllogaritjes së vlerës limit të kontratës të perbere nga S. T., O. H. dhe L. K..

Tenderi është zhvilluar në datë 06.03.2017, ora 10.00, nga kontrolli në sistemin e prokurimeve të raportit final në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë dhe janë refuzuar operatorët ekonomik të mëposhtëm me justifikimin përkatës:

1. A...- Ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet teknike dhe ligjore të kërkuara në dokumentet e tenderit. Për sa më sipër u vendos skualifikimi i këtij operatori.
2. E...- Ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet teknike dhe ligjore të kërkuara në dokumentet e tenderit. Për sa më sipër u vendos skualifikimi i këtij operatori
3. W.... - Ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet teknike dhe ligjore të kërkuara në dokumentet e tenderit. Për sa më sipër u vendos skualifikimi i këtij operatori.
4. M... - Ofertuesi nuk ka paraqitur asnjë nga dokumentet teknike dhe ligjore të kërkuara në dokumentet e tenderit. Për sa më sipër u vendos skualifikimi i këtij operatori

Ndërsa operatore që kanë marrë pjesë dhe janë kualifikuar janë:

1. K... Shpk me vlerë të ofruar 38,000,000 leke pa tvsh.

Sic del qartë nga pjësmarrja, kushtet dhe specifikat e hartuara kanë përcaktuar operatorin fitues. Ç'ka ngarkon me përgjegjësi Titullarin e Autoritetit Kontraktor, refreuar nenit 56 i VKM nr. 914 date 29/12/2014 ka ngritur komisione specifikimesh prej të cilave ka pranuar hartime kriteresh që kanë cuar në mospermbushjen e LPP nr.9643, datë 20.11.2006, ndryshuar neni 1 pika 2 ku është shprehur në mënyrë ekaplicite se

“a) të rrisë efijcencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;

b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.

Në pikën 2.3.2 në faqen 26 të DST është kërkuar që “... Kompanitë prodhuese të **“Uniforma dhe veshje pune për APD-në ”**, kërkohet të jetë e çertifikuar sipas normave **ISO 9001-2008**, të Standartit Ndërkombëtar të Menaxhimit të cilësisë, dhe/ose të njevlëshme me to që mund të të garantonin cilësinë e artikujve të kërkuara. Kompanitë prodhuese për këpucë



pune, të paraqesin certifikate konformiteti sipas standarteve EN 345, EN 344, EN 347 sipas, direktivës No 89/686 të pajisjeve mbrojtëse personale për EEC... ”

Duhet pasur parasysh që kriteri i mesipër ka qenë i detyrueshëm për cdo operator ekonomik të interesuar, fokusi i të cileve ka qenë mundësia për të siguruar apo jo i certifikatave sipas standarteve “...EN 345, EN 344, EN 347...”

Pas kontrollit të dokumentave të ofertës së operatorit “K...” Shpk rezulton se ky operator ka dorëzuar një certifikate të RICO TEST për prodhuesin Portest Ltd për produktin e tij FW90 “të zezë” modeli D (cizme të gjata), në lidhje me standartin teknik EN 20347:2012 kategoria PPE – Pajisje personale mbrojtëse kundër riskut “te mesëm” ndërkohë që standartet e kërkuara nga APD “...EN 345, EN 344, EN 347...” si mësipër nuk përmenden në certifikatën e lëshuar për këtë produkt. Në keto rrethana kriteri i pikës 2.3.2, nuk është përmbushur sic kërkon Autoriteti Kontraktor dhe për rrjedhojë KVO duhet të kishte s’kualifikuar ofertën e operatorit K... Shpk.

Gjithashtu në të njëjtën ofertë është paraqitur një certifikate e lëshuar nga “I...” për prodhuesin Port west Ltd për produktet e tij FW (14; 10; 21; 13), për konformitetin në lidhje me standartin teknik EN 20345:2012 ndërkohë që standartet e kërkuara nga APD “...EN 345, EN 344, EN 347...” si mësipër nuk përmenden në certifikatën e lëshuar për këto produkt. Në keto rrethana kriteri i pikës 2.3.2, nuk është përmbushur sic kërkon autoriteti kontraktor dhe për rrjedhojë KVO duhet të kishte s’kualifikuar ofertën e operatorit K... Shpk. Me tej nga ballafaqimi me ofertën teknike të dërguar nga ky ofertues nuk bëhet asnjë lidhje midis produkteve të etiketuara mësipër si FW qoftë 90 apo 10;13;14 dhe 21 të këtij prodhuesi me ato të ofruara prej duke i bërë lidhjet midis produktit të certifikuar dhe atij të ofruar të pavetëtueshme. Në keto rrethana kriteri i pikës 2.3.2, nuk është përmbushur sic kërkon Autoriteti Kontraktor dhe për rrjedhojë KVO duhet të kishte s’kualifikuar ofertën e operatorit K... Shpk.

Nga operatori fitues nuk është përmbushur kriteri i kërkuar që “... Kompanitë Prodhuese të “Uniforma dhe veshje pune për APD-ne”, kërkohet të jetë e Certifikuar sipas normave ISO 9001- 2008...”, pasi është paraqitur e zbardhur asnjë certifikatë e tillë për prodhuesin e veshjeve e cila të vërtetojë veshjet e prodhuara nga vetë ofertuesi K... Shpk, si dhe nuk ka asnjë certifikate të ngarkuar në sistem. I vetmi dokument me këtë karakteristike në këtë ofertë është ai i lëshuar për Portwest Ltd, emri i të cilit nuk lidhet me asnjë nga produktet e përmendura në ofertën teknike.

Pra e thënë në një formë më të qartë “KVO nuk mundet të argumentojë kualifikimin që i ka bërë këtij ofertuesi, pasi duke përdorur vetëm dokumentat e dorëzuara prej tij, nuk mundet të vërtetojë në asnjë rrethanë lidhjen midis disa kompanive të huaja, emri i të cilave përmendet në disa dokumenta në formë certifikate, me produktet që pretendon të furnizojë sipas ofertes teknike.

Ne pikën 2.1.1 të DST - Kompanitë Prodhuese duhet të ushtrojnë veprimtarinë e tyre respektivisht në fushën e prodhimit të konfeksioneve, përkatësisht

-Uniformave për Forcat e Sigurisë dhe Zjarrefikseve

- Veshje pune për punonjësit.

Sqarojme se artikujt e kërkuar mund të jenë nga disa prodhues që plotësojnë kushtet e mësipërme.

Për plotësimin e pikës 2.1.1 ofertuesi duhet të paraqesë objektin e veprimtarisë së QKR-s. Ndërsa për shoqëritë e huaja për plotësimin e kësaj pike të paraqesin prospekte zyrtare të faqeve të internetit.

Shoqëritë tregtare pjesëmarrëse duhet të paraqesin dokumentacionin e kërkuar të kompanive prodhuese .



Nga kontrolli i dokumentacionit të ofertës nuk u konstatua asnjë prospekt zyrtar i shoqërive të huaja për të cilat ofertuesi K... shpk pretendon se është i lidhur. Në këto rrethana kriteri i pikës 2.1.1, nuk është përmbushur sic kërkon Autoriteti Kontraktor dhe për rrjedhojë KVO duhet të kishte skualifikuar ofertën e operatorit K... Shpk.

Po në pikën 2.3.2 germa "b" në faqen 26 të DST është kërkuar që: "...Kompanitë prodhuese për pelerinë shiu dhe jelek fosforeshent, të paraqesin certifikatë konformiteti të standarteve EN 47..."

Pas kontrollit të dokumentave të ofertës së K... Shpk rezulton se ky operator nuk ka dorëzuar asnjë dokument për përmbushjen e këtij kriteri.

Në pikën 2.4.1 a.3 kërket: "Operatori Ekonomik ofertues, duhet të paraqesë katalog për artikujt objekt i procedurës së prokurimit, ose grupime të tyre."

Pas kontrollit të dokumentave të ofertës së K... Shpk rezulton se ky operator nuk ka dorëzuar asnjë dokument për përmbushjen e këtij kriteri.

Kontrata është lidhur me nr.867 prot, datë 23.03.2017, ndërmjet A. L., në cilësinë e titullarit të autoritetit kontraktor, dhe kontraktuesit "K..." SHPK, në vlerën 45.600.000 lekë, me TVSH, me kohëzgjatje 20-ditë nga firmosja e kontratës, ndjekës kontrate është caktuar S. T. Kontrata shoqërohet nga formulari i ofertës, deklarata për përmbushjen e specifikimeve teknike, sasia dhe grafiku i lëvrimit, oferta teknike, specifikimet teknike, dhe sigurimi i kontratës.

Referuar sa më sipër kualifikimi, shpallja fitues e "K..." sh.p.k nga KVO, si dhe lidhja e kontratës, është kryer **në mënyrë të padrejtë**, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", ç'ka ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

Me shkresën nr.668 prot, datë 23.03.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, formulari i njoftimit të kontratës të nënshkruar i është dërguar APP-së, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr.13, datë 03.04.2017.

Me urdhërin e brendshëm, protokolluar me nr.2530, datë 17.10.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, janë caktuar: L. M., me profesion Inxhinieri Elektrik, si përfaqësues i kontratës, dhe është ngritur komisioni i kontrollit dhe pranimit të furnizimeve, me përbërje: S. T. (Kryetar) me profesion Ekonomi-Financë, O. H. me profesion Oficer, dhe L. K. me profesion Ekonomi Agrar.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur më sipër ngarkon me përgjegjësi komisionin e vlerësimit të ofertave.

Me urdher transferte date 30.03.2017 nepermjet Bankes B. është likuiduar shoqëria shoqëria "K..." shpk me vlerën 45,600,000 leke.

Dokumentacioni: Fature nr.342, date 29.03.2017 me vlerën 45,600,000 leke e firmosur nga S. T. për APD dhe A. D. për shoqërinë "K." shpk; Proces pa nr., datë 29.03.2017 me objekt shtesë kontrate nr.reference 10PH 2017, me nr.867, datë 23.03.2017. i firmosur nga S. T., O. H. dhe L. K.. Urdhër i brendshëm nr.867/1 prot, datë 23.03.2017 i A. L. për ngritjen e grupit për monitorimin e kontratës i përbërë nga S. T., O. H. dhe L. K..

Në kushtet e kualifikimit, shpalljes fitues e "K..." sh.p.k nga KVO, si dhe lidhjes së kontratës, **në mënyrë të padrejtë**, duke mos përmbushur kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr.914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit" dhe Udhëzimit MF nr.30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar **vlera 45,600,000 leke përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit, pasi APD nuk është furnizuar me veshmbathje sipas specifikimeve teknike të**



përcaktuara në dokumente e tenderit, dhe për të cilën “K...” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar. Pra paraaja publike nuk është shpenzuar për plotësimin e nevojave të APD.

7.12. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Zbatimi i sistemit të administrimit të burimeve njerëzore, pagave dhe kohë-shënuesit”, viti 2017.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i drejtori të përgjithshëm ekzekutiv, A. L. Nr.712, datë 08.03.2017.	Ngritur me urdhrin Nr.713, datë 08.03.2017	Ngritur me urdhrin Nr.712, datë 08.03.2017
Vlera e përlogaritur e kontratës 12.874.300 lekë, pa Tvsh.	1- A. K. – Shkenca Politike 2-A. K.- Specialist IT 3-O.P.-Specialiste/Sek. Monit. Konkencioneve	1.E. K. -Jurist 2.D.G. -Ekonomist 3. S. D. - Jurist.
Procedurë e hapur		
Operatori Ekonomik fitues, shoqëria: “T. S.” SHPK, Vlera e ofertës 12.256.000lekë, pa TVSH.		
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor më datë 18.04.2017.	Njoftim i kontratës, botuar në buletin e APP dt. 13 Mars 2017	Tenderi i zhvilluar me dt. 31/03/2017, ora 10.00
Operatori Ekonomik – “T. S.” SHPK Kontratë Nr.900 prot, datë 27.03.2017, me vlerë 12.256.000Lekë me TVSH.	Ofertat e paraqitura 2 Operatorë Ekonomikë	Kualifikuar 1
Njoftim klasifikimi është bërë elektronikisht dt.04.04.2017	Njoftim fituesit, botuar në buletin e prokurimit publik dt.24 Prill 2017	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletin e APP, datë 02 Maj 2017, faqe 571-572.

Nevoja e këtij investimi, programi i blerjeve të APD-së, i miratuar për vitin 2017.

Me shkresën e protokolluar me nr.130, datë 18.01.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm mbi ngritjen e komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e vlerësimit të kontratës së prokurimit me titull “Zbatimin e Sistemit të Burimeve Njerëzore, Pagave si dhe të kohë-shënuesit”, me përbërje: V. H. (Kryetar) me profesion Inxhinieri Elektronike, A. N. me profesion Menaxhim Bankar (Financë), dhe K. R. me Profesion Ekonomiste.

Pas përgatitjes së specifikimeve teknike të kësaj procedure prokurimi, anëtarët e komisionit në fjalë kanë kryer përlogaritjen e vlerësimit të kontratës. Për këtë, anëtarët e komisionit u janë referuar: INSTAT-it, Institucioneve të tjera, të njohura zyrtare, si dhe hetimit të drejtpërdrejtë të tregut.

Për arsye të pamundësisë së sigurimit të informacionit nga burime të tjera, si alternativë e përshtatshme, u gjykua të ishte burimi i hetimit të tregut, duke u orientuar në kontaktin e mundshëm me shoqëri prodhuese dhe tregtuese të produkteve objekt i kësaj kontrate.

Fondi limit për prokurimin e objektit të kësaj kontrate, është përlogaritur, bazuar në vlerën mesatare të ofertave të ardhura, pas korrespondencës së komisionit me shoqëritë, si më poshtë:

- “A...” SHPK, me vlerë 13.174.700 lekë, pa tvsh;
- “A...” SHPK, me vlerë 13.122.900 lekë, pa tvsh;
- “I...” SHPK, me vlerë 11.426.400 lekë, pa tvsh;
- “T...” SHPK, me vlerë 13.773.200 lekë, pa tvsh.



Në përfundim të hetimit të tregut, fondi limit i procedurës së prokurimit, u vendos të përlllogaritë në vlerën pa TVSH, prej 12.874.300 lekë.

Përlllogaritja e vlerës së kontratës është përcaktuar në 12.874.300 lekë, pas ofertës të ofruar për vlerën 13.174.700 lekë nga "Shoqëria "A..." SHPK për vlerën 13.122.900 lekë nga shoqëria "A..." SHPK për vlerën 11.426.400 lekë nga "I..." SHPK, për vlerën 13.773.200 lekë nga "T..." SHPK.

Vlera 51.368.887 lekë, është marrë si mesatare e katër ofertave të paraqitura. Pra në përlllogaritjen e vlerës të kontratës, nuk janë harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve, si dhe çmimet e botuara nga INSTAT-i, apo çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, janë mbështetur në studimin e tregut dhe sigurimin e ofertave për të njohur nivelin aktual të tregut, por nuk është dokumentuar nëse nga AK-ja, janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementët e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit", neni 59 "Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës". Veprim i cili ngarkon me përgjegjësi komisionin për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës.

Me shkresën e protokolluar me nr.712, datë 08.03.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhri i prokurimit, me objekt "Zbatimin e sistemit të Burimeve Njerëzore, Pagave si dhe të kohë-shënuesit", me fond limit 12.874.300 lekë, pa TVSH, në të cilin janë caktuar anëtarët e Njesisë së Prokurimit, me përbërje: E. K. me profesion Jurist, D. G. me profesion Ekonomist dhe S. D., me profesion Jurist.

Më datë 08.03.2017, është mbajtur nga anëtarët e njesisë së prokurimit, procesverbali për hartimin e dokumentave të tenderit për këtë procedurë prokurimi, i firmosur prej tyre.

Me shkresën e protokolluar me nr.713, datë 08.03.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është nxjerrë urdhëri i brendshëm për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave, me përbërje: A. K. (Kryetar) me Profesion Shkenca Politike, A. K. me profesion IT, dhe O. P., me detyrë specialiste 2/Sektori i Monitorimit të Konkencioneve.

Me shkresën e protokolluar me nr.714, datë 08.03.2017, të firmosur nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, është bërë formulimi i njoftimit të kontratës, i cili është botuar në buletin e prokurimit publik me nr.10, datë 13.03.2017.

Më datë 31.03.2017, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali i dorëzimit dhe hapjes së ofertave.

Më datë 04.04.2017, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali i kualifikimit të ofertave.

Më datë 04.04.2017, është mbajtur nga anëtarët e KVO-së procesverbali mbi vlerësimin dhe klasifikimin e ofertave.

Me shkresën nr.1251 prot., datë 18.04.2017, të firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor, komisioni i vlerësimit të ofertave ka hartuar raportin përmbledhës për këtë procedurë prokurimi, raport i cili është miratuar prej tij.

Me shkresën nr.1251/1 prot., datë 18.04.2017, të firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor, është miratuar procedura e prokurimit.

Me shkresën nr.1251/2 prot., datë 18.04.2017, të firmosur nga titullari i autoritetit kontraktor, është bërë formulimi i njoftimit të fituesit, i cili është botuar në buletin e prokurimit publik me nr.16, datë 24.04.2017.

Me procesverbalin datë 21.04.2017, anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave, kanë verifikuar dokumentacionin e paraqitur nga operatori fitues.

- Në këtë në procedurë prokurimi kanë qenë pjesëmarrës ofertuesit:



- Operatori ekonomik T. S. me vlerë të ofruar 12.256.000 lekë pa TVSH, operator që është kualifikuar dhe është shpallur fitues për vlerën 12.256.000 lekë pa TVSH.

- Operatori ekonomik I. A., i cili nuk ka dorëzuar oferte, si dhe asnjë dokumentacion. Për këto arsye KVO vendosi të mos e kualifikojë këtë operator.

Kontrata është lidhur me nr.1323 prot, datë 25.04.2017, ndërmjet A. L., në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor, dhe kontraktuesit "T. S." SHPK, në vlerën 14.707.200 (katërbëdhjetë milion e shtatëqind e shtatë mijë e dyqind) lekë, me TVSH, me kohëzgjatje 4-muaj nga firmosja e kontratës, ndjekës kontrate është caktuar V. H.. Kontrata shoqërohet nga: formulari i njoftimit të fituesit, sigurimi i kontratës, formulari i ofertës, deklarata mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sasia dhe grafiku i lëvrimit, përmbajtja e ofertës teknike, kërkesa tekniko-funksionale dhe specifikimet teknike.

Me shkresën nr.1324, datë 25.04.2017, të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, formulari i njoftimit të kontratës të nënshkruar i është dërguar APP, e cili është botuar në buletin e prokurimit publik nr.17, datë 02.05.2017.

Me urdhërin e brendshëm, protokolluar me nr.1325, datë 25.04.2017, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, janë caktuar: V. H., me profesion Inxhinieri Elektronike, si përfaqësues i kontratës, dhe është ngritur komisioni i kontrollit dhe pranimi të mallrave, me përbërje: V. H. (Kryetar) me profesion Inxhinieri Elektronike, A. N. me profesion Menaxhim Bankar (Financë), dhe K. R. me profesion Ekonomiste.

Me urdhër transferte date 18.09.2017 nëpërmjet Bankes B. është likuiduar shoqëria T. S. shpk me vlerën 991,200 lekë.

Dokumentacioni: Fature nr.72 date 24.05.2017 me vlerën 991,200 lekë e firmosur nga V. H. dhe K. B.; Akt-pranim nr.1 datë 24.05.2017 i firmosur nga V. H., A. N. dhe K. R. në të cilën është cilësuar se furnizimi rezulton në parametrat teknik, cilësor dhe sasior të parashikuar në marrveshjen midis palëve; Deklarata e origjinës së mallit date 23.05.2017 shoqëria "Z. A. s.p.a"; Deklarata doganore datë 15.03.2016 eksportues Z. A. spa dhe marrësi T. S. me objekt "Pjesë për kompjuter 14 copë", Deklaratë konformiteti i datës 01.01.2017; Fletë garanci produktesh me datë 24.05.2017-24.05.2018.

Me urdhër transferte date 08.09.2017 nëpërmjet Bankes B. është likuiduar shoqëria T. S. shpk me vlerën 2,786,400 lekë.

Dokumentacioni: Fature nr.07 date 24.07.2017 me vlerën 2,786,400 lekë e firmosur nga V. H. dhe K. B.; Akt-pranimi nr. 3 date 25.04.2017 i firmosur nga V. H., A. N. dhe K. R. në të cilën është cilësuar se furnizimi rezulton në parametrat teknik, cilësor dhe sasior të parashikuar në marrveshjen midis palëve; Pajisjet nuk shoqërohen me test raport fabrike, deklarata doganore nuk e përshkruan pajisjen por përcakton "Pjesë për kompjutera", Nuk ka CMR, nuk ka manifest, nuk ka certifikatë origjine, nuk ka Euro1.

Me urdhër transferte datë 08.09.2017 nëpërmjet bankës B. është likuiduar shoqëria T. S. shpk me vlerën 120,000 lekë.

Dokumentacioni: Fatura nr.26 date 14.08.2017 me vlerën 120,000 lekë objekt "Trajnim personeli"; Akt-pranimi nr., 4 date 16.08.2017 i firmosur nga V. H., A. N. dhe K. R..

Me urdhër transferte date 08.09.2017 nëpërmjet A. Bank është likuiduar shoqëria T. S. shpk në vlerën 10,809,600 lekë.

Dokumentacioni: Fatura nr.93 date 23.06.2017 në vlerën 10,809,600 lekë; Akt-pranimi nr.2 date 10.07.2017 e firmosur nga V. H., A. N. dhe K. R. në të cilën cilësohet se furnizimi rezulton në parametrat teknik, cilësor dhe sasior të përcaktuara në marrëveshjen midis palëve. Me urdhër transferte date 18.09.2017 nëpërmjet Bankes B. është likuiduar shoqëria T. S. shpk me vlerën 991,200 lekë.



Dokumentacioni: Fature nr.72 date 24.05.2017 me vlerën 991,200 lekë e firmosur nga V. H. dhe K. B.; Akt-pranim nr.1 date 24.05.2017 i firmosur nga B. H., A. N. dhe K. R. ne te cilen është cilesuar se furnizimi rezulton në parametrat teknik, cilësor dhe sasior të parashikuar në marrëveshjen midis palëve; Deklarata e origjinës së mallit date 23.05.2017 shoqëria “Z. A. s.p.a”; Deklarata doganore date 15.03.2016 eksportues Z. A. spa dhe marresi T. S. me objekt “Pjese per kompjuter 14 cope”; Deklarate konformiteti i dates 01.01.2017; Flete garanci produktesh me date 24.05.2017-24.05.2018.

Me urdhër transferte date 08.09.2017 nëpërmjet Bankes B. është likuiduar shoqëria T. S. shpk me vlerën 2,786,400 lekë.

Dokumentacioni: Fature nr.07 date 24.07.2017 me vlerën 2,786,400 lekë e firmosur nga V. H. dhe K. B.; Akt-pranimi nr. 3 date 25.04.2017 i firmosur nga V. H., A. N. dhe K. R. ne te cilen është cilesuar se furnizimi rezulton ne parametrat teknik, cilesor dhe sasior te parashikuar ne marrveshjen midis paleve; Pajisjet nuk shoqerohen me test raport fabrike, deklarata doganore nuk e pershkruan pajisjen por percakton “Pjese per kompjutera”, Nuk ka CMR, nuk ka manifest, nuk ka certifikate origjine, nuk ka Euro1.

Me urdhër transferte date 08.09.2017 nëpërmjet bankës B. është likuiduar shoqëria T. S. shpk me vlerën 120,000 lekë.

Dokumentacioni: Fatura nr.26 date 14.08.2017 me vlerën 120,000 lekë objekt “Trajnim personeli”; Akt-pranimi nr., 4 date 16.08.2017 i firmosur nga V. H., A. N. dhe K. R..

Me urdhër transferte date 08.09.2017 nëpërmjet A. Bank është likuiduar shoqëria T. S. shpk ne vlerën 10,809,600 lekë.

Dokumentacioni: Fatura nr.93 date 23.06.2017 ne vlerën 10,809,600 lekë; Akt-pranimi nr.2 date 10.07.2017 e firmosur nga V. H., A. N. dhe K. R. ne te cilen cilesohet se furnizimi rezulton ne parametrat teknik, cilesor dhe sasior te percaktuara në marrëveshjen midis palëve. Shuma totale e likujdimit 14,707,200 lekë.

Pajisjet jane te pashoqëruara me test raport fabrike.

Pajisjet nuk janë te shoqëruara me test raport fabrike, për pasojë grupi i auditimit nuk mund të shprehet për saktësinë dhe vërtetësinë e pajisjeve. Pra nuk mund të behet verifikimi i specifikimeve teknike (qe janë pjesë e kontratës) dhe të dhënat e test-raportit të fabrikës, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën “T. S.” shpk” shpk ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.10,489 datë 15.12.2011 “Për trajtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve jo ushqimore”, neni 3 pika 11, 12, 16, 17, 18, 21 neni 8 , neni 9 dhe neni 10, si dhe VKM nr.369, datë 27.3.2008 Për miratimin e rregullit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorim brenda disa kufijve të tensionit", çka nhgarkon me përgjegjësi komisioni i kontrollit dhe pranimit të mallrave.

Për pasojë Grupi i Auditimit referuar praktikës dokumentare të vënë në dispozicion, e cila rezultoi e pasaktë dhe me mangësi, nuk mund të jap opinion e Tij, që këto pajisje janë të njëjta me ato të prokuruar dhe për të cilat Shoqëria “T. S.” shpk”, ka fituar tenderin dhe është likuiduar.

Deri në paraqitjen nga Shoqëria “T. S.” shpk” të test raport fabrike, që të konfirmohet që këto pajisje janë të njëjta me atë të prokuruar (specifikimeve teknike), dhe për të cilën Shoqëria “T. S.” shpk” ka fituar tenderin dhe është likuiduar, vlera 14,707,200 lekë për APD dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “T. S.” shpk”.



Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Përprokurimin publik", i ndryshuar:

- neni 2, është shprehur në mënyrë eksplicite se: "*Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme:*

a) *mos diskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve;*

b) *transparencë në procedurat e prokurimit;*

c) *barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve*".

- neni 12, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "*Autoriteti kontraktor është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe të akteve nënligjore, të nxjerra në zbatim të tij*".

Parimi i barazisë përpara Ligjit është trajtuar në disa çështje të shqyrtuara nga Gjykata Kushtetuese. Kështu që në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr.9, datë 26.02.2007 ".....Parimi i barazisë, i parashikuar në nenin 18 të kushtetutës, kërkon që të gjithë qytetarët të jenë të barabart përpara Ligjit, jo vetëm në të drejta themelore të parashikuara në kushtetutë, por edhe në të drejta të tjera ligjore". Parimi i barazisë është saksionuar dhe në Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe në Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Gjithsesi për arsyet dhe konstatimet e përmendura më lart, del më se e domosdoshme marrja e masave urgjente **për të korrigjuar këtë praktikë të paligjshme** me qëllimin e rivënies në vend të të drejtave të shkelura në favor të APD-së dhe për të evituar abuzimin e mëtejshëm që kryhet nga punonjësit e APD-së, duke aplikuar standart të dyfishtë për operatorët ekonomik.

Qëllimi i këtij projekti ka qenë ndërtimi i një sistemi informacioni për administrimin, vlerësimin si dhe ndjekjen e burimeve njerëzore. Nëpërmjet këtij sistemi APD ka synuar në arritjen e objektivave si, lehtësimin e mbajtjes së azhurnuar të informacionit bazë (fillestar) dhe përditësimin në vazhdim të dosjeve të personelit; regjistrimin automatik të ecurisë së karrierës dhe të historikut të punësimit; realizimin e vlerësimeve periodike të performancës së punonjësve të APD; realizimin dhe ndjekjen automatike të procesit të planifikimit të lejeve vjetore të pagueshme të punonjësve; përgatitjen automatike dhe kontabilizimin e veprimeve financiare që lidhen me pagat e punonjësve; përgatitjen automatike të listë prezencës si dhe matjen e kohës së punës për çdo punonjës; dokumentimin dhe ndjekjen e punës jashtë orarit zyrtar, etj.

Dokumentacioni i administruar mbi marrjen në dorëzim të komponentëve të projektit nga grupi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës rezultoi si më poshtë:

Kontrata është lidhur me nr.1323prot, datë 25.04.2017, ndërmjet A. L., në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të APD dhe kontraktuesit "T. S." SHPK, në vlerën 14,707,200 lekë, me TVSH.

Me anë të shkresës nr.1325, datë 25.04.2017 është ngritur urdhri i brendshëm i drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv "Mbi monitorimin dhe zbatimin e kontratës", ku është caktuar komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës i përbërë nga V. H., A. N. dhe K. R.. Dokumentacioni i bashkëlidhur akteve të mbajtura nga grupi i marrjes në dorëzim janë:

Aktpranimi nr.1 datë 24.05.2017 komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë marrjen në dorëzim të mallrave ku janë të bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues si, Fatura tatimore me nr.serie 45408372, datë 24.05.2017 me vlerë 826,000 lekë pa tvsh (991,200 lekë me tvsh), Certifikatat e origjinës për produktet e terminaleve të leximit të prezencës në punë. Certifikata e përputhshmërisë CE, fletët e garancisë për pajisjet si dhe raportin fillestar mbi zbatimin e projektit.



Aktpranimi nr.2, datë 10.07.2017 komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë marrjen në dorëzim të mallrave ku janë të bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues si, Fatura tatimore me nr.serie 45408393, datë 23.06.2017 me vlerë 9,008,000 lekë pa tvsh (10,809,600 lekë me tvsh) si dhe dokumentet e tjera bashkëlidhur këtij aktpranimi pjesë e dokumenteve të bankës.

Aktpranimi nr.3, datë 27.07.2017 komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë marrjen në dorëzim të mallrave ku janë të bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues si, Fatura tatimore me nr.serie 45408407, datë 24.07.2017 me vlerë 2,322,000 lekë pa tvsh (2,786,400 lekë me tvsh), raporti draft përfundimtar si dhe dokumentet e tjera bashkëlidhur këtij aktpranimi pjesë e dokumenteve të bankës.

Aktpranimi nr.4, datë 16.08.2017 komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë marrjen në dorëzim të mallrave ku janë të bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues si, Fatura tatimore me nr.serie 45408426, datë 14.08.2017 me vlerë 100,000 lekë pa tvsh (120,000 lekë me tvsh), raporti përfundimtar si dhe dokumentet e tjera bashkëlidhur këtij aktpranimi pjesë e dokumenteve të bankës.

Zbatimi i kontratës

Qëllimi i këtij projekti ka qenë ndërtimi i një sistemi informacioni për administrimin, vlerësimin si dhe ndjekjen e burimeve njerëzore. Nëpërmjet këtij sistemi APD ka synuar në arritjen e objektivave si, lehtësimin e mbajtjes së azhornuar të informacionit bazë (fillestar) dhe përditësimin në vazhdim të dosjeve të personelit; regjistrimin automatik të ecurisë së karrierës dhe të historikut të punësimit; realizimin e vlerësimeve periodike të performancës së punonjësve të APD; realizimin dhe ndjekjen automatike të procesit të planifikimit të lejeve vjetore të pagueshme të punonjësve; përgatitjen automatike dhe kontabilizimin e veprimeve financiare që lidhen me pagat e punonjësve; përgatitjen automatike të listë prezencës si dhe matjen e kohës së punës për çdo punonjës; dokumentimin dhe ndjekjen e punës jashtë orarit zyrtar, etj.

Dokumentacioni i administruar mbi marrjen në dorëzim të komponentëve të projektit nga grupi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës rezultoi si më poshtë:

Kontrata është lidhur me nr.1323prot, datë 25.04.2017, ndërmjet A. L., në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të APD dhe kontraktuesit “T. S.” SHPK, në vlerën 14,707,200 lekë, me TVSH.

Me anë të shkresës nr.1325, datë 25.04.2017 është ngritur urdhri i brendshëm i drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv “Mbi monitorimin dhe zbatimin e kontratës”, ku është caktuar komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës i përbërë nga V. H., A. N. dhe K. R.. Dokumentacioni i bashkëlidhur akteve të mbajtura nga grupi i marrjes në dorëzim janë:

Aktpranimi nr.1 datë 24.05.2017 komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë marrjen në dorëzim të mallrave ku janë të bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues si, Fatura tatimore me nr.serie 45408372, datë 24.05.2017 me vlerë 826,000 lekë pa tvsh (991,200 lekë me tvsh), Certifikatat e origjinës për produktet e terminaleve të leximit të prezencës në punë. Certifikata e përputhshmërisë CE, fletët e garancisë për pajisjet si dhe raportin fillestar mbi zbatimin e projektit.

Aktpranimi nr.2, datë 10.07.2017 komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë marrjen në dorëzim të mallrave ku janë të bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues si, Fatura tatimore me nr.serie 45408393, datë 23.06.2017 me vlerë 9,008,000 lekë pa tvsh (10,809,600 lekë me tvsh) si dhe dokumentet e tjera bashkëlidhur këtij aktpranimi pjesë e dokumenteve të bankës.

Aktpranimi nr.3, datë 27.07.2017 komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë marrjen në dorëzim të mallrave ku janë të bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues si, Fatura tatimore me nr.serie 45408407, datë 24.07.2017 me vlerë 2,322,000 lekë pa tvsh (2,786,400 lekë me tvsh), raporti



draft përfundimtar si dhe dokumentet e tjera bashkëlidhur këtij aktpranimi pjesë e dokumenteve të bankës.

Aktpranimi nr.4, datë 16.08.2017 komisioni i marrjes në dorëzim ka bërë marrjen në dorëzim të mallrave ku janë të bashkëlidhur dokumentacioni shoqërues si, Fatura tatimore me nr.serie 45408426, datë 14.08.2017 me vlerë 100,000 lekë pa tvsh (120,000 lekë me tvsh), raporti përfundimtar si dhe dokumentet e tjera bashkëlidhur këtij aktpranimi pjesë e dokumenteve të bankës.

Nga auditimi mbi zbatimin, implementimin dhe përdorimin në terren nga stafi i APD të këtij sistemi u konstatua se:

Nga ana teknike sistemi është një konglomerat i përbërë nga komponentë të ndryshëm software (*i ndarë në module*) dhe hardware. Më konkretisht sistemi ka në përbërje tre module kryesore, Moduli i administrimit të burimeve njerëzore, Moduli i administrimit të pagave dhe moduli për ndjekjen e prezencës në punë, si dhe ndërtimin e kohëshënuesit (hardware). Një funksionalitet tjetër e këtij sistemi është integrimi me sistemet ekzistuese që APD disponon.

Projekti përfshin të gjithë stafin e APD me lokalitet zbatimin në APD. Periudha për fillim e implementimit është përcaktuar nga data e nënshkrimit të kontratës (25.04.2017), deri në 4 muaj, periudha totale për zbatimin e projektit 4 muaj.

Nga verifikimi në terren u konstatua se në APD janë instaluar pajisjet ose terminalët e aksesit që janë pjesa hardware e projektit dhe janë implementuar modulet përkatëse për “*sistemin e administrimit të burimeve njerëzore, pagave dhe kohëshënuesit*” sipas përcaktimeve të kërkuara me qëllim administrimin, vlerësimin si dhe ndjekjen e burimeve njerëzore. Ky sistem që nga momenti i implementimit deri më datën 27.07.2018, datë në të cilën ka përfunduar auditimi në terren, nuk është vënë në përdorim nga APD. Nga ana e nivelit të lartë menaxherial nuk është marrë asnjë masë ose dhënë ndonjë dreksion në lidhje me përdorimin e plotë apo të pjesshëm të këtij sistemi duke e lënë në harresë të plotë.

Me mosvënien në përdorim të këtij sistemi me vlerë investimi **14,707,200 lekë me tvsh** për Autoritetin Portual Durrës, **nuk ka justifikuar kryerjen e këtij investimi.**

Në opinionin e grupit të auditimit:

Nga drejtuesit e APD nuk është trajtuar seriozisht implementimi i projektit “sistemin e administrimit të burimeve njerëzore, pagave dhe kohëshënuesit”, duke mos e monitoruar pothuajse asnjëherë situatën mbi përdorimin e projektit të implementuar, edhe pse janë shpenzuar para publike. Si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të drejtuesve të APD, aktualisht mund të themi së implementimi dhe përdorimi i këtij projekti në APD ka dështuar.

*Për pasojë, vlera **14,707,200 lekë me tvsh** përbën përdorim pa efektivitet të buxhetit të APD.*

Në rast të mos vënien në punë të këtij projekti, KLSH do ta konsiderojë dëm ekonomik vlerën **14,707,200 lekë** dhe do të denoncojë përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë realizuar mos përmbushjen e rregullt të detyrës, me pasojë prekjën e interesave të ligjshme të APD dhe të Shtetit, si dhe do të kërkojë dëmshpërblimin e kësaj vlere në zbatim të neneve 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr.7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, ngarkohen me përgjegjësi A. L. me detyrë ish-drejtor i APD në periudhën 04.11.2016 deri 16.10.2017, A. Q. me detyrë ish-drejtor i APD për periudhën 23.10.2017 deri 26.02.2018, A. B. me detyrë Drejtor i APD për periudhën 27.02.2018 e në vazhdim, duke dëmtuar interesat e ligjshme të APD dhe të Shtetit në vlerën **14,707,200 lekë me tvsh**. Kjo vlerë ka të bëjë me mos vënien në përdorim të “*Sistemit të administrimit të*



burimeve njerëzore, pagave dhe kohëshënuesit”, me qëllim administrimin, vlerësimin si dhe ndjekjen e burimeve njerëzore.

7.13. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje karburant”, viti 2017 me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje karburant”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.1561 prot datë 17.04.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.1562 prot datë 17.04.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”	Urdhër Nr.1561 prot datë 17.04.2017 I. R. L. K. K. O.	D. A. A. Xh. A. C.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 13,854,291 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 13,854,291 lekë (16.4%)	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 0 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 10.05.2018	9. Burimi Financimit Fondet e veta	10. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b)S’kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK - ska	13. Përgjigje Ankesës nga apo AKKP ska

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesit në sistemin elektronik të APP, u konstatua se:

-Me urdhër prokurimi nr.1561 prot, datë 17.04.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është caktuar njësia e prokurimit e përbërë nga I. R., L. K. dhe K. O..

-Me urdhërin e brendshëm nr.1562 prot, datë 17.04.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga D. A., A. C. dhe A. Xh..

-Në datën 17.04.2018 është mbajtur procesverbal mbi hartimin e dokumentave të tenderit, nga ana e njësisë së prokurimit.

-Njoftimi i kontratës është me nr.1572 prot, datë 17.04.2018.

-Në datën 14.05.2018 nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është mbajtur procesverbal mbi dorëzimin dhe hapjen e ofertave. Pjesëmarrës janë bashkimi i operatorëve “K. Sha” dhe “K. shpk” me marzh fitimi të ofruar 16.4%, dhe bashkimi i operatorëve “E...” dhe “D...” me marzh fitimi të ofruar 9.7%.

-Në datën 21.05.2018 nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është mbajtur procesverbal mbi kualifikimin e ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomik pjesëmarrës, sipas së cilit i vetmi operator i cili ka përmbushur kriteret e kualifikimit është bashkimi i operatorëve “K. Sha” dhe “K. shpk”.

-Me shkresën nr.2326 prot, datë 29.05.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është miratuar raporti përmbledhës për procedurën e prokurimit.

-Me shkresën nr.2327 prot, datë 29.05.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është miratuar procedura e prokurimit.

-Formulari i njoftimit të fituesit është nënshkruar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv me nr.2328 prot, datë 29.05.2018.



-Kontrata është nënshkruar me nr.2353 prot datë 30.05.2018.

-Me shkresën nr.2358 prot, datë 30.05.2018 është formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar.

-Me urdhërin e brendshëm nr.2357 prot, datë 30.05.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është caktuar komisioni për monitorimin e zbatimit të kontratës i përbërë nga K. O., L. K. dhe T. L..

- Nga auditimi u konstatua se nga njësia e prokurimit nuk janë argumentuar plotësisht vendosja e kërkesave për kualifikim, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, e cila ndër të tjera përcakton se: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumntohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”. Konkretisht:

1. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një dokument të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të vërtetohet xhiroja mesatare vjetore e 3 (tre) viteve të fundit (2015, 2016, 2017), në një vlerë jo më të vogël se 5,541,716 (pesë milion e pesëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

b) Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit financiare (2015, 2016 dhe 2017), të vulosura pranë organeve tatimore.

Kjo kërkesë është në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 27 Kontratat e mallrave, pika 5, ku citohet: “Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, autoriteti kontraktor kërkon: a) kopje të certifikuara të një ose më shumë bilanceve, të paraqitura në autoritetet përkatëse: **dhe/ose** b) kopje të deklaratave të xhiros vjetore. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë vlerën limit të kontratës që prokurohet. Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e ulët monetar, vlera e kërkuar nga autoriteti kontraktor nuk mund të tejkalojë 40% të 15 vlerës limit të kontratës që prokurohet”.

Nga ana e njësisë së prokurimit janë kërkuar të dyja këto dokumente dhe nuk është vendosur pjesa **dhe/ose**, veprim i cili është i ekzagjeruar dhe i pa argumentuar në procesverbalin e miratimit të dokumenteve duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në tender, në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Në kriteret e veçanta të kualifikimit, pika 2.2. Kapaciteti teknik, c) Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) stacione të tregtimit me pakicë të karburantit brenda territorit të Bashkisë Durrës, me vendndodhje sa më afer APD, për shkak të disponimit të mjeteve të rënda dhe kostove të shpenzimit të karburanteve dhe veshtirësive të qarkullimit të tyre në rrugët urbane, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës).

Duke patur parasysh se lëvizjet e mjeteve të portit janë në pjesën më të madhe të rasteve brenda territorit të portit, kriteri për pasjen e 5 pikave të karburantit brenda territorit të Bashkisë Durrës është i ekzagjeruar dhe i pa argumentuar në procesverbalin e miratimit të dokumenteve duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomik në tender, në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Për vendosjen e kriterëve të mësipërme mbajnë përgjegjësi njësia e prokurimit e përbërë nga I. R., L. K. dhe K. O..



- Nga auditimi i dokumentacionit elektronik në faqen e APP, u konstatua se komisioni i vlerësimit të ofertave ka skualifikuar në mënyrë të padrejtë bashkimin e operatorëve ekonomik me ofertën ekonomike më të ulët (marzh fitimi 9.7%) “E..” dhe “D..”, duke shpallur fitues bashkimin e operatorëve ekonomik “K. sha” dhe “K. shpk” me vlerë ekonomike të ofruar (marzh fitimi 16.7%), veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, date 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, ku citohet: *“Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose candidateve; b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose candidateve”*.

Referuar procesverbalit me datë 21.05.2018 të mbajtur nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertave, rezulton se bashkimi i operatorëve ekonomik me ofertën ekonomike më të ulët (marzh fitimi 9.7%) “E..” dhe “D..”, nuk ka përmbushur kriteret e mëposhtme:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një dokument të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të vërtetohet xhiroja mesatare vjetore e 3 (tre) viteve të fundit (2015, 2016, 2017), në një vlerë jo më të vogël se 5.541.716 (pesë milion e pesëqind e dyzet e një mijë e shtatëqind e gjashtëmbëdhjetë) lekë.

b) Kopje të çertifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit financiare (2015, 2016 dhe 2017), të vulosura pranë organeve tatimore.

2.3. Kapaciteti teknik:

c) Subjekti ofertues duhet të ketë minimalisht 5 (pesë) stacione të tregtimit me pakicë të karburantit brenda teritorit të Bashkisë Durrës, me vendndodhje sa më afër APD, për shkak të disponimit të mjeteve të renda dhe kostove të shpenzimit të karburanteve dhe vështirësive të qarkullimit të tyre në rrugët urbane, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale qeraje ose akt pronësie, ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin tregtar të operatorit ekonomik pjesëmarrës). Stacionet e tregtimit me pakicë të karburanteve detyrimisht duhet të jenë të pajisur me leje mjedisore të tipit C të lëshuar nga QKL. Vërtetim Teknik lëshuar nga ISHTI ose organe të miratuara të vlerësimit të konformitetit (OMVK), Certifikatë e mbrojtjes nga zjarri nga MZSH dhe “Policë sigurimi” në një nga shoqëritë e sigurimeve që operojnë në Shqipëri, për distributorët e shitjes me pakice, të cilat duhet të jenë brenda afatit të vlefshmërisë në datën e hapjes së ofertave.

i) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Certifikaten ISO 14001:2004, ose ekuivalente, lidhur me sistemin e menaxhimit të mjedisit, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, të jetë e akredituar si dhe të jetë e vlefshme.

Nga auditimi i kryer nga grupi i auditimit në faqen elektronike të APP, u konstatua se bashkimi i operatorëve ekonomik “E..” dhe “D..” ka paraqitur të gjitha kërkesat e mësipërme, duke u skualifikuar në mënyrë të padrejtë.

Referuar sa më sipër kualifikimi, shpallja fitues e bashkimit të operatorëve “K. sha” dhe “K. shpk”, si dhe lidhja e kontratës, është kryer në mënyrë të padrejtë, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, çka ngarkon me përgjegjësi anëtarët e komisionit të vlerësimit të ofertave.

7.14. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje kompjutera, printera, fotokopje, pajisje dhe licenca Gis, licenca MS Office”, viti 2017 me këto të dhëna:



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje kompjutera, printera, fotokopje, pajisje dhe licenca Gis, licenca MS Office”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.431 prot datë 13.02.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.432 prot datë 13.02.2017 A.K. J. Xh. L. A.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Urdhër Nr.431 prot datë 13.02.2017 E. K. J. R. D. G.	
5.Fondi Limit (pa tvsh) 5,314,840 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 4,915,656 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 399,184 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 24.02.2017	9. Burimi Financimit Fondet e veta	10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 3 OE b)S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime Nr.580 prot datë 21.02.2017	12. Përgjigje Ankesës Nr.518/2 prot datë 21.02.2017	13. Përgjigje Ankesës nga apo AKKP ska

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesit në sistemin elektronik të APP, u konstatua se:

-Me urdhrin nr.82 prot, datë 13.01.2017 të kryetarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën “Blerje kompjutera, printera, fotokopje, pajisje dhe licenca Gis, licenca MS Office”, të përbërë nga E.T., V. B. dhe A. S..

Përcaktimi i fondit limit është kryer me anë të ofertave të tregut.

-Me shkresën nr.82/6 prot, datë 10.02.2017 të grupit të ngritur për specifikimet teknike, është dërguar dokumenti për përcaktimin e specifikimeve teknike si dhe përlogaritjen e fondit limit.

-Me urdhrin prokurimi nr.431 prot, datë 13.02.2017 është caktuar lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”, fondi limit prej 5,314,840 lekë, si dhe njësia e prokurimit e përbërë nga E. K., J. R. dhe D. G..

-Më datë 13.02.2017 nga ana e njësisë së prokurimit është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumentave të tenderit. Afati kohor për hapjen e ofertave është data 24.02.2017.

-Me urdhrin nr.432 prot, datë 13.02.2017 të kryetarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni për vlerësimin e ofertave për procedurën “Blerje kompjutera, printera, fotokopje, pajisje dhe licenca Gis, licenca MS Office”, të përbërë nga A. K., J. Xh. dhe L. A..

- Me shkresën me nr.581 prot, datë 21.02.2018, operatori ekonomik “S..” është ankuar për procedurën e tenderit pranë autoritetit kontraktor.

-Me urdhrin nr.518/1 prot datë 21.02.2017 të kryetarit të autoriteti kontraktor është pezulluar procedura për arsye të ankesës së operatorit ekonomik “S..”. Gjithashtu është ngritur komisioni i shqyrtimit të ankesës i përbërë nga A. K., J. Xh. dhe L. A..

-Me shkresën nr.517/2 prot, datë 21.02.2017, nga komisioni i shqyrtimit të ankesës është marrë vendimi për refuzimin e ankesës si pasojë e tejkalimit të afatit 7 ditor të ankimimit të përcaktuar në Ligjin e prokurimit publik.

-Në datën 24.02.2017 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali për dorëzimin dhe hapjen e ofertave, sipas së cilit rezulton se kanë marrë pjesë 3 operatorë nga të



cilët vetëm njëri ka paraqitur ofertë të vlefshme. Operatori ekonomik “C..” ka paraqitur vlerë ekonomike 4,915,656 lekë pa TVSH.

-Në datën 01.03.2017 nga komisioni i vlerësimit të ofertave është mbajtur procesverbali mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave për procedurën “Blerje kompjutera, printera, fotokopje, pajisje dhe licenca Gis, licenca MS Office”, duke kualifikuar operatorin e vetëm që ka paraqitur ofertë të vlefshme, “C..”.

-Raporti përbledhës është miratuar nga kryetari i autoritetit kontraktor ëahtë miratuar me nr.743 prot, datë 09.03.2017.

-Me vendimin nr.744 prot, datë 09.03.2017 të kryetarit të autoritetit kontraktor, është miratuar procedura për shpalljen fitues të operatorit C.. me vlerë të ofruar 4,915,656 lekë.

-Formulari i njoftimit të fituesit është me nr.743, prot datë 09.03.2017. OE fitues duhet të paraqitet për lidhjen e kontratës brenda 30 ditëve.

-Kontrata është lidhur me nr.872 prot, datë 24.03.2017.

-Me urdhrin e brendshëm nr.873/1 prot, datë 24.03.2017 është ngritur komisioni për monitorimin e zbatimit të kontratës të përbërë nga E. T., V. D. dhe A. S..

-Komisioni i marrjes në dorëzim ka pranuar pajisjet në datën 08.05.2017, duke u shprehur se janë konform specifikimeve teknike të kërkuara.

-Po në datën 08.05.2017 janë bërë hyrje në magazinë me fletëhyrjen nr.0400231.

Nga auditimi i dokumentacionit të mësipërm shkresor si dhe faqes elektronike të APP, u konstatua se:

1. Me shkresën nr.581 prot, datë 21.02.2017 të operatorit ekonomik “S..” është paraqitur ankesë në AK. Për pasojë, është pezulluar procedura me urdhrin nr.518/1 prot datë 21.02.2017 të kryetarit të autoriteti kontraktor. Pasi komisioni i ngritur ka shqyrtuar ankesën, ka vendosur mospranimin e tij. Kjo ankesë nuk rezulton të jetë përfshirë në formularin e njoftimit të fituesit në kundërshtim me nenin 21 “Njoftimi i fituesit”, pika 2, “Ky njoftim publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në sistemin elektronik të prokurimit, në përputhje me nenin 58 të LPP. Njoftimi duhet të përmbajë: ...informacion nëse ka pasur ankesa”. Gjithashtu nuk ka asnjë përmbledhje të ankesave për këtë procedurë në kundërshtim me nenin 12 “Përgjegjësia e autoritetit kontraktor”, pika 2, ku citohet “Autoriteti kontraktor duhet të mbajë procesverbale dhe dokumentacion të plotë për procedurat e kryera në përcaktimin e fituesit të kontratës, në mënyrë të tillë që të lejojnë kontrollin e zbatimit të ligjit. Për çdo procedurë prokurimi, procesverbalet duhet të përmbajnë, të paktën këto të dhëna: g) një përmbledhje të ankesave dhe të zgjidhjes së tyre”.

2. Në dokumentat e tenderit rezultojnë kriteret të cilat në opinion të auditimit janë të ekzagjeruara dhe të paargumentuara, duke kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve në tender, veprime të cilat janë në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2009 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku citohet: “Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”, nenin 23, pika 1, të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet: “Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara”, si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,



neni 61, pika 2, ku citohet: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Saktësisht kriteret:

-Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 4 punonjës të certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve hardware që ofron: 2 punonjës të certifikuar (një primar dhe një back up) nga prodhuesi hardware për pajisje kompjuter desktop, 2 punonjës të certifikuar (një primar dhe një back up) nga prodhuesi hardware për pajisje printer dhe laser B&Ë si dhe për pajisje Fotokopje dhe printer;

dhe kriteri

-Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij të paktën 2 punonjës të certifikuar nga prodhuesi për Software-n Gis për desktop. Punonjësit e certifikuar duhet të garantojnë që do të dedikohen për objektin e këtij prokurimi pranë autoritetit kontraktor”;

janë të e ekzagjeruar dhe të pa argumentuar në procesverbalin e miratimit të dokumentave dhe kufizon pjesëmarrjen e operatorëve në tender.

Kontrata e kësaj procedure prokurimi ka të bëjë vetëm me blerje pajisjesh, dhe jo instalim apo mirëmbajtje, prandaj vendosja e kushteve për pjesëmarrje në këtë procedurë prokurimi, është kryer në një mënyrë të papërshtatshme (jo proporcionale) me objektin e kontratës, gjë e cila ka kufizuar rrethin e operatoreve ekonomikë potencialë, duke shkelur kështu parimin e konkurrencës së ndershme.

Për vendosjen e specifikimeve teknike në një mënyrë të papërshtatshme (jo proporcionale) me objektin e kontratës, mban përgjegjësi komisioni për përgatitjen e specifikimeve teknike i përbërë nga E. T., V. B. dhe A. S..

3. Nga verifikimi fizik në magazinë i kryer nga grupi i auditimit në datën 20.07.2018 (1 vit e 2 muaj pasi pajisjet janë bërë hyrje në magazinë) u konstatua se 8 pajisje “UPS” si dhe 1 pajisje “Skaner” nuk janë bërë ende dalje. Këto pajisje janë të pa përdorura dhe qëndrojnë në kuti të pa hapura. Për pasojë grupi i auditimit e vlerëson blerjen e këtyre pajisjeve të pajustificuar dhe jashtë kërkesave të institucionit. Për pasojë vlera prej **90,316.8 lekë me TVSH** (7,488 lekë x 8 UPS + 15,360 lekë Skaner = 75,264 lekë pa TVSH, ose 90,316.8 lekë me TVSH) **përbën efekt financiar negativ**, pasi këto pajisje janë kryer në mungesë të nevojës.

7.15. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje suporte”, viti 2017 me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje Suporte”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.639 prot datë 01.03.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapur”	Urdhër Nr.639 prot datë 01.03.2017 E. K. J. R. S. D.	Urdhër Nr.640 prot datë 01.03.2017 A. K. J. Xh. F. H.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 17,860,467 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 17,161,500 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 698,967 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 04.04.2017	9. Burimi Financimit Fondet e veta	10. Operoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 1 OE



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

11. Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK - ska	13. Përgjigje Ankesës nga apo AKKP ska
---------------------	------------------------------------	--

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesit në sistemin elektronik të APP, u konstatua se:

-Me urdhrin nr.147 prot, datë 19.01.2017 të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit të përbërë nga E. T., V. B. dhe S. K..

-Fondi limit është përcaktuar me anën e testimit të tregut, prej të cilit është përcaktuar fondi limit prej 17,860,467.

-Me Urdhrin e prokurimit nr.639 prot, datë 01.03.2017 është vendosur lloji i procedurës “E hapur”, si dhe është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga E. K., J. R. dhe S. D..

-Me urdhrin nr.640 prot, datë 01.03.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të APD, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të përbërë nga A. K., J. Xh. dhe F. H..

-Me procesverbalin e datës 04.04.2017, KVO ka hapur ofertat e dorëzuar. Pjesëmarrës në tender është 1 operatorë ekonomik.

-Me procesverbalin e datës 07.04.2017 të KVO ka vlerësuar si të vlefshme ofertën e operatorit ekonomik “I. S.” shpk me ofertë ekonomike 17,161,500 lekë pa TVSH.

-Raporti përmbledhës është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me nr.640/1 prot, datë 18.04.2017.

-Formulari i njoftimit të fituesit është me nr.1250 prot, datë 18.04.2017.

-Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar është me nr.3227 prot, datë 27.12.2017.

-Kontrata e lidhur mes palëve është me nr.1535 prot, datë 19.05.2017.

-Me Urdhrin nr.1535/1 prot, datë 19.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të APD është caktuar komisioni për monitorimin dhe zbatimin e kontratës. Komisioni është i përbërë nga E. T., V. B. dhe S. K..

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe aksesit në APP u konstatua se:

-Në kriteret e veçanta të kualifikimi, një nga kërkesat është: *“Ofertuesi duhet të jetë i autorizuar nga ofruesi i shërbimit të hostimit. Për këtë, ofertuesi duhet të paraqesë një deklaratë konfirmimi të hostuesit e cila të konfirmojë që ofertuesi është i autorizuar për shitjen e shërbimit si dhe në vijueshmëri të kontratës së hostimit, për ndjekjen dhe monitorimin e operimit të sistemeve të hostuara”.*

Vendosja e autorizimit nga ofruesi i shërbimit në kërkesat për kualifikim, ka ulur në mënyrë të ndjeshme konkurrencën duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizimin e ofruesit të shërbimit të hostimit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 46, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2009 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku citohet: *“Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”*, nenin 23, pika 1, të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet: *“Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara”*, si dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar,



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

neni 61, pika 2, ku citohet: “Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre”.

Shkelja e dispozitës ligjore të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi grupin e përcaktimit të specifikimeve teknike të përbërë nga E. T., V. B. dhe S. K..

7.16. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje pajisje palestre”, vitit 2017 me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt : “Blerje pajisje palestre”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.2847 prot datë 22.11.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.2848 prot datë 22.11.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Urdhër Nr.2847 prot datë 22.11.2017 N. P. D. G. S. D.	I. I. D. P. M. B.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 7,250,000 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 7,191,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 59,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 04.12.2017	9. Burimi Financimit Fondet e veta	10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 4 OE b)S’kualifikuar 3 OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK - ska	13. Përgjigje Ankesës nga apo AKKP ska

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesit në sistemin elektronik të APP, u konstatua se:

-Me urdhrin nr.2606 prot, datë 31.10.2017 të Kryetarit të Autoritetit Kontraktor është ngritur komisioni për përcaktimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit të përbërë nga Sh. Xh., H. B.dhe Gj. S..

-Komisioni ka relatuar me shkresën nr.2606/8 prot, datë 16.11.2017, ku ka përcaktuar si fond limit vlerën 7,250,000 lekë pa TVSH, vlerë e nxjerrë nga marrja e tre ofertave të tregut, si dhe janë përcaktuar specifikimet teknike për pajisjet e kërkuara.

-Me Urdhrin e prokurimit nr.2847 prot, datë 22.11.2017 është vendosur lloji i procedurës “Kërkesë për propozim”, si dhe është ngritur njësia e prokurimit e përbërë nga D. G., S. D. dhe N. P..

-Me urdhrin nr.2848 prot, datë 22.11.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të APD, është ngritur Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i përbërë nga M. B., D. P. dhe I. I..

-Me procesverbalin e datës 23.11.2017, njësia e prokurimit ka hartuar dokumentat e tenderit për procedurën e mësipërme.

-Me procesverbalin e datës 11.12.2017 ora 10:00, KVO ka hapur ofertat e dorëzuar. Pjesëmarrës janë 4 operatorë ekonomik, nga të cilët vetëm 1 ka paraqitur ofertë të vlefshme, ndërsa 3 të tjerët nuk kanë paraqitur ofertë.

-Me procesverbalin e datës 11.12.2017 të KVO ka vlerësuar si të vlefshme ofertën e operatorit ekonomik “T..” shpk me ofertë ekonomike 7,191,000 lekë pa TVSH.



-Raporti përmbledhës është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor me nr.3140 prot, datë 19.12.2017.

-Formulari i njoftimit të fituesit është me nr.3142 prot, datë 19.12.2017.

-Formulari i njoftimit të kontratës së nënshkruar është me nr.3227 prot, datë 27.12.2017.

-Kontrata e lidhur mes palëve është me nr.3228 prot, datë 27.12.2017. Afati për realizimin e kontratës 60 ditë.

-Me Urdhrin nr. 3229 prot, datë 27.12.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm të APD është caktuar komisioni për monitorimin dhe zbatimin e kontratës. Komisioni është i përbërë nga Sh. Xh., H. B. dhe Gj. S..

-Marrja në dorëzim është bërë në datën 05.01.2018.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, si dhe aksesit në APP u konstatua se:

1. -Specifikimet teknike janë vendosur në mënyrë të tillë të cilat zvogëlojnë së tepërmi konkurrencën e opeatorëve. Përmasat kërkuara të pajisjeve janë fikse dhe jo të ketë një tolerancë, e cila në opinion të grupit të auditimit nuk do të kishte ndikim në përmbushjen e qëllimit të kësaj procedurë prokurimi. Respektivisht, për pajisjen “Tërheqës Statik i dyanshëm” përmasat e kërkuara janë: gjatësia 450 cm, gjerësi 109 cm, lartësi 231 cm, pesha e makinerisë 396 kg. E njëjta mënyrë përcaktimi është bërë për të gjitha pajisjet.

-Në kriteret e veçanta të kualifikimi, një nga kërkesat është “*Autorizim nga kompania prodhuese apo distributorët e autorizuar të konfirmuar, për pajisjet objekt prokurimi*”.

Referuar dokumentacionit të paraqitur nga OE fitues, kompania prodhuese “P..” ka autorizuar “A..” si distributor të saj në Shqipëri. Gjithashtu kompania “A..” ka autorizuar OE pjesëmarrës dhe fitues të tenderit, “T..” shpk, si të vetmen kompani e cila mund të ofrojë, negociojë dhe të lidhë kontrata për mallrat e saj.

Vendosja e autorizimit të prodhuesit në specifikimet teknike dhe në kërkesat për kualifikim, si dhe vendosja në specifikimet teknike të paërmasave fikse të pajisjeve, ka orientuar këtë procedurë drejt pajisjeve të kompanisë të prodhuara nga kompania “P..”, e për pasojë drejt OE “T..” shpk, i cili është fitues i tenderit. Veprimet e mësipërme kanë ulur në mënyrë të ndjeshme konkurrencën duke favorizuar vetëm operatorët ekonomik të cilët gëzojnë autorizime të prodhuesve të përcaktuar në dokumentet e tenderit, çka do të thotë që procedura e tenderimit e ka përcaktuar fituesin, duke eliminuar konkurrencën.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me nenin 46, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2009 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, ku citohet: “*Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik*”, nenin 23, pika 1, të ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku citohet: “*Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara*”, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 61, pika 2, ku citohet: “*Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre*”.

Shkelja e dispozitës ligjore të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi grupin e përcaktimit të specifikimeve teknike të përbërë nga Sh. Xh., H. B. dhe Gj. S..



2. Pasi u verifikuan dokumentat e paraqitur elektronikisht nga OE fitues, konstatohet se: Pajisjet: “Biçikletë mekanike” janë të kompanisë prodhuese “M..”, “Pistë vrapimi” janë të kompanisë prodhuese “F..”. Për këto pajisje nuk ka autorizim prodhuesi, kërkesë për kualifikim në dokumentat e tenderit, e për pasojë OE ekonomik i shpallur fitues, duhet të ishte skualifikuar. Kualifikimi dhe shpallja fitues e OE “T..” shpk, pa i përmbushur kushtet dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit është në kundërshtim me VKM Nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 66, pika 3, ku citohet: “Pas mbylljes së seancës publike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit”.

Shkelja e dispozitës ligjore të përmendur mësipër ngarkon me përgjegjësi Komisionin e Vlerësimit të Ofertave.

7.17. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt objekt “Auditim financiar për dy vite”, viti 2017 me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Auditim financiar për dy vite”		
1.Urdhër Prokurimi Nr.1314 prot datë 24.04.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr.1315 prot datë 24.04.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim”	Urdhër Nr.1314 prot datë 24.04.2017 E. K. A. M. J. R.	M. B. A. M. M. M.
5.Fondi Limit (pa tvsh) 2,000,000 lekë	6.Oferta fituese (pa tvsh) 1,667,000 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 333,000 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 22.05.2017	9. Burimi Financimit Fondet e veta	10. Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 2 OE b)S’kualifikuar 0 OE, c) Kualifikuar 2 OE
11.Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës ska	13. Përgjigje Ankesës nga apo AKKP ska

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, si dhe aksesit në sistemin elektronik të APP, u konstatua se:

-Me urdhër prokurimi nr.1314 prot, datë 24.04.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është ngritur njësi e prokurimit e përbërë nga E. K., A. M. dhe J. R..

-Me urdhër të brendshëm nr.168 prot, datë 19.01.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, është ngritur komisioni për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “Auditim i bilancit për dy vite”, i përbërë nga E. P., I. K. dhe S. D..

-Me relacionin nr.168/1 prot, datë 21.04.2017 të komisionit për përgatitjen e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e prokurimit “Auditim i bilancit për dy vite”, janë përcaktuar specifikimet teknike si dhe fondi limit prej 2,000,000 lekë.

-Në datën 24.04.2017, nga njësi e prokurimit, janë hartuar dokumentat standard të tenderit.

-Me urdhër të brendshëm nr.1315 prot, datë 24.04.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave, i përbërë nga M. B., A. M. dhe M. M..



-Formulari i njoftimit të kontratës është me nr.1316 prot, datë 24.04.2017. Në formular janë përcaktuar fondi limit, koha e hapjes së ofertave si dhe kohëzgjatja prej 24 muajsh e kontratës.

-Me shkresën nr.1409 prot, datë 04.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, drejtuar APP është kërkuar heqja e pezullimit për procedurën në fjalë. Arsyeja e pezullimit të procedurës nga ana e APP është emërtimi i njëjtë me procedurën e vitit 2016. Në relacion shpjegohet se emërtimi është i njëjtë por objekti i ndryshëm.

-Me vendim nr.1440 prot, datë 08.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, është anuluar procedura e tenderit për arsye të moskthimit të përgjigjes nga ana e APP në lidhje me problemin e konstatuar.

-Me shkresën nr.1441 prot, datë 08.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është njoftuar APP për anulimin e tenderit.

-Në datën 09.05.2017, nga njësia e prokurimit, janë hartuar dokumentat standard të tenderit.

-Formulari i njoftimit të kontratës është me nr.1451 prot, datë 09.05.2017. Në formular janë përcaktuar fondi limit, koha e hapjes së ofertave datë 22.05.2017 si dhe kohëzgjatja prej 24 muajsh e kontratës.

-Në datën 22.05.2017 nga ana e KVO është mbajtur procesverbali për dorëzimin dhe hapjen e ofertave. Pjesëmarrës janë 2 operator ekonomik, “G..” dhe “U..”.

-Në datën 23.05.2017, nga ana e KVO është mbajtur procesverbali mbi shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Referuar procesverbalit, të dy operatorët ekonomik pjesëmarrës kanë përmbushur kriteret e pjesëmarrjes, dhe sipas renditjes në bazë të ofertës ekonomike të dorëzuar, në vend të parë renditet operatori ekonomik “U..”, me vlerë të ofruar 1,667,000 lekë pa TVSH.

-Raporti përmbledhës është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv me nr.1602 prot, datë 29.05.2017. Operator ekonomik fitues është shpallur “U..” shpk.

-Me shkresën nr.1603 prot, datë 29.05.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv, është miratuar procedura e prokurimit.

-Kontrata është lidhur me nr.1734 prot, datë 14.06.2017, nr.Ref. 32KP2017.

-Formulari i njoftimit të fituesit drejtuar OE fitues, me nr.1604 prot, datë 29.05.2017.

-Formulari i publikimit të njoftimit të kontratës me nr.1744 prot, datë 16.06.2017.

-Me urdhër të brendshëm nr.1747 prot, datë 19.06.2017 të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv është ngritur grupi për monitorimin dhe zbatimin e kontratës, i përbërë nga D. Z., I. I. dhe V. S..

Zbatimi i kontratës:

-Fatura tatimore e dorëzuar nga operatori ekonomik “U..” shpk është me datë 23.05.2018. Dorëzimi i pasqyrave financiare nuk është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në kontratën nr.1734 prot, datë 14.06.2017, pasi është në kundërshtim me nenin 19 “Vonesa në zbatim dhe zgjatja e afatit”. Për këto vonesa nga ana e grupit të marrjes në dorëzim janë kryer përlllogaritjet e penalitetit, saktësisht 13,336 lekë (833,500 lekë*4 ditë*4/1000). Përlllogaritja u krye duke e përcaktuar dorëzimin në datë 18.05.2018.

Nga auditimi u konstatua se raporti i auditimit është dorëzuar me nr.2203 prot, datë 21.05.2018, dhe jo në datën 18.05.2018. Pra 7 ditë me vonesë dhe jo 4 siç është përlllogaritur nga grupi i marrjes në dorëzim. Gjithashtu përlllogaritja është kryer mbi vlerën pa TVSH, ndërkohë duhet të ishte llogaritur mbi vlerën e kontratës.

-Në termat e referencës së procedurës së prokurimit ndër të tjera cilësohet: “*Periudha në të cilën audituesi do të asistojë në kryerjen e inventarizimit të shoqërisë do të jetë një periudhë 2 (dy) mujore, periudhë në të cilën APD do të kryejë procesin e inventarizimit për vitin 2017 dhe 2018. Audituesi është i detyruar, që gjatë periudhës së inventarizimit të asistojë sipas*



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

njoftimit të Autoritetit Kontraktor”. Për këtë, nuk ka dokumenta që të dëshmojnë realizimin e kësaj pike, çka nuk vërtetojnë plotësisht ezaurimin e këtij detyrimi kontraktual.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi D. Z., I. I. dhe V. S., në cilësinë e grupit për monitorimin dhe zbatimin e kontratës.

7.18. Mbi zbatimin e kontratës nr.1684 prot. datë 07.06.2017 “Rifreskim i sistemit të kontrollit të hyrjeve (makina, këmbësore) në ambientet e jashtme si dhe lëvizjet e brendshme në godina të APD-s”.

Të dhëna mbi tenderin	Komisioni i vlerësimit të ofertave	Njësia e prokurimit
Urdhër prokurimi i titullarit te autoriteti kontraktor A. L. Nr.1137 datë 05/04/2017	Ngritur me urdhrin Nr.1466 datë 10/05/2017	Ngritur me urdhrin Nr.1465 datë 10/05/2017 1.E. K. -Jurist 2.J. R. - Juriste 3. D. G. - Ekonomist
Vlera e përlogaritur e fondit limit 39.476.867 lekë pa Tvsh.	1- A. K. – Shkenca Politike 2- A. K. – IT 3- I. K. – Juriste	
Procedurë e hapur		
Operatori ekonomik fitues, shoqëria: “T. S.” SHPK Vlera e ofertës 38.082.000 lekë pa TVSH.	Ndryshuar me urdhrin Nr.297/1 datë 22/02/2017 Anëtarë A. K., me 2- J.Xh.- Informatikë	
Raporti përmbledhës miratuar nga titullari i autoritetit kontraktor dt.24.05.2017	Njoftim i kontratës, botuar në buletinin e APP dt. 10 Prill 2017	Tenderi i zhvilluar me dt. 05/05/2017, ora 10.00
Operatori Ekonomik – Shoqëria “T. S.” SHPK, Kontratë Nr.2839 datë 14.10.2016 me vlerë 45.698.400 Lekë me TVSH	Ofertat e paraqitura 2 Operatorë Ekonomikë	Kualifikuar 1
Njoftim klasifikimi është bërë elektronikisht.15.05.2016	Njoftim fituesit, botuar në buletinin e prokurimit publik 29.05.2017	Njoftim i kontratës së nënshkruar, botuar në buletinin e APP 12 Qershor 2017, faqe 513

Qëllimi i këtij projekti ka qenë rritja e sigurisë portuale si dhe thellimi i zbatimit të sigurisë ISPS³, standardizimi, modernizimi dhe lehtësimi i procedurave të kontrollit të hyrjeve dhe të lëvizjeve e hapësirën portuale, gjithashtu dhe gjurmimi e komunikimi sa më i shpejtë i problematikave që lidhen me thyerje apo moszbatim të rregullave të hyrje - daljeve të mjeteve dhe të këmbësorëve si dhe lëshimit të lejeve të hyrjeve, kontrollit automatik të lejeve hyrëse.

Nga auditimi në terren mbi zbatimin dhe implementimin e projektit të sistemit të kontrollit të hyrjeve (makina, këmbësore) në ambientet e jashtme si dhe lëvizjet e brendshme në godina të APD-s u konstatua se:

Në çdo kolonë hyrëse Lite Gate aksesit të automjeteve ka të instaluar lexuesit barcode për leximin e lejeve të hyrjes ditore dhe lexuesit RFID për lejet afatgjata. Në korsitë e makinave janë instaluar edhe lexuesit e kartave UHF Tag për aksesin në distancë të barrierave.

Në kollonat Power Gate janë të instaluar lexuesit RFID për kartat, si dhe printeri i lejeve/biletave të aksesit, për të pajisur përdoruesit me makina të pajisen me leje kalimi e cila përdoret në momentin e daljes duke u lexuar në barcode reader të kollonave në dalje të Portit. Sistemi i kontrollit të aksesit është i ndërtuar në formë modulare client-server.

³International Ship and Port Facility Security (Standardet e sigurisë portuale dhe anijeve)



Sistemi ka dy module kryesore: modulën e aksesit të këmbësorëve dhe modulën e aksesit të automjeteve. Këto module lidhen me programin e administrimit të lejeve i cili ka për qëllim administrimin e workflow dhe përdoruesve drejt moduleve të aksesit.

Programi i administrimit të aksesit ka një ndërfaqe për regjistrimin e përdoruesve dhe lejeve sipas karakteristikave. Me anë të ndërfaqes së aplikimit online në portalin e Autoritetit Portual mundësohet aplikimi online por edhe mbajtja e tarifave të shërbimit dhe kërkesat për regjistrim për marrjen e lejeve afatgjatë/afatshkurtër. Të dhënat e marra nga ky sistem dërgohen në sistemin e administrimit të lejeve nga ku këto të dhëna përpunohen në lidhje me informacionin e marrë nga ndërfaqja online. Sistemi i lejeve afatshkurtra realizon: hedhjen e informacionit minimal të kërkuar për lëshimin e lejeve ditore (*ID e kalimtarit, targën dhe lejen e qarkullimit të mjetit, etj*); lëshimin dhe printimin e lejeve ditore/ vjetore; personalizimin e lejeve me të dhënat e mjetit apo këmbësorit për të cilin është lëshuar leja (*së bashku me barcode*); përllogaritjen e tarifave të lejkalimeve; përfshirë edhe të komisioneve në rastet e thyerjes së lejeve; lidhjen automatike me kasat fiskale për evidentimin e veprimeve të arkëtimit (*të lejes apo gjobave*); shkëmbimin në kohë reale të informacionit të lejeve afatshkurtra me sistemin e kontrollit të hyrje/daljeve.

Sistemi i kontrollit të aksesit të brendshëm, është instaluar në zonat e brendshme të portit dhe lejon autentifikimin e punonjësve të APD nëpërmjet kartave RFID. Kjo nyje është integruar duke marrë pamjet live dhe të regjistruara nga sistemi Milestone.

Sistemi i kontrollit të hyrjeve të jashtme administron kontrollin e aksesit në port për përdoruesit që hyjnë e dalin nga perimetri i portit dhe në terminale. Në funksion të këtij kontrolli sistemi të integruar që të ofrojë shërbimin e kontrollit nëpërmjet kartave RFID; TAG UHF dhe LPR për automjetet si dhe lejeve ditore me Barcode; konfirmimi i leximit të targës është integruar gjatë procesit të aksesit me këto artikuj.

Dokumentacioni i administruar mbi marrjen në dorëzim të komponentëve të projektit nga grupi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës rezultoi si më poshtë:

Kontrata është lidhur me nr.1684 prot, datë 07.06.2017, ndërmjet A. L., në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të APD dhe kontraktuesit “T. S.” SHPK, në vlerën 45,698,400 lekë, me TVSH.

Me urdhrin e brendshëm nr.1684/2 prot, datë 07.06.2017, “*Mbi monitorimin e zbatimit të kontratës*”, të drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv është ngritur komisioni i ndjekjes dhe zbatimit të kontratës dhe marrjes në dorëzim të shërbimeve, me kryetar – E. T., anëtarë: S. K. me profesion Informatikë, dhe L. M. me profesion Inxhinieri Elektrike.

Me urdhrin e brendshëm nr.1684/3 datë 07.06.2017 “*Mbi zëvendësimin e anëtarit të komisionit mbi monitorimin dhe zbatimin e kontratës*” të drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv është bërë zëvendësimi i anëtarit të komisionit, S. K. (*larguar nga puna*) zëvendësohet me anëtarën V. B.. Sipas kësaj shkrese komisioni i kontrollit dhe pranimit të shërbimit ka për detyrë: verifikimin e mallrave të lëvruara, në përputhje me kërkesat e kontratës “*Rifreskimi i sistemit të kontrollit të hyrjeve në territorin e Portit si dhe lëvizjen në hapësirën e brendshme*”; verifikimin e dokumentacionit shoqëruar të realizimit të kontratës; përpilimin e aktit të pranimit të mallrave dhe dorëzimin e një kopje të tij për kontraktuesin.

Është bërë hyrja në magazinë e produkteve të prokuruarra (*fletëhyrja me nr.serial: 0400259, 0400258, aktverifikimi nr.14, datë 28.07.2017, aktverifikimi nr.31 datë 04.08.2017, aktverifikimi nr.27 datë 04.08.2017, aktverifikimi nr.32 datë 04.08.2017, aktverifikimi nr.29 datë 04.08.2017, aktverifikimi nr.28 datë 04.08.2017*), faturat e tvsh me nr.serie 45408415 datë 28.07.2018 (me vlerë 1,240,000 lekë pa tvsh), dhe nr.serie 45408414, datë 28.07.2018 (2,900,000 lekë pa tvsh), nr.serie 45408431, datë 04.08.2017 (me vlerë 2,200,000 lekë pa



tvsh), nr.serie 45408430 datë 04.08.2017 (me vlerë 3,420,000 lekë pa tvsh), nr.serie 45408427, datë 04.08.2017 (me vlerë 14,300,000 lekë pa tvsh), nr.serie 45408432, datë 04.08.2017 (me vlerë 1,040,000 pa tvsh) nr.serie 45408429, datë 04.08.2017 (me vlerë 4,482,000 lekë pa tvsh), nr.serie 45408428, datë 04.08.2017 (me vlerë 5,280,000 lekë pa tvsh).

Është mbajtur aktpranimi nr.1 (i pjesshëm), datë 28.07.2017 i mbajtur nga grupi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Bashkëlidhur këtij akti janë: fletët e garancisë për garancitë e pajisjeve; deklaratat e përputhshmërisë dhe deklaratat e origjinës.

Është mbajtur aktpranimi nr.2, datë 04.08.2017 i mbajtur nga grupi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Bashkëlidhur këtij akti janë: fletët e garancisë për garancitë e pajisjeve; deklaratat e përputhshmërisë dhe deklaratat e origjinës; printscreen të sistemit online i licencës së milestone 21.

Është mbajtur aktpranimi nr.3, datë 06.10.2017 i mbajtur nga grupi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Bashkëlidhur këtij akti janë: faturë tatimore me nr.serie 45408478, datë 06.10.2017 me vlerë 2,520,000 lekë pa tvsh; kopje e draft raportit përfundimtar të zbatimit të kontratës.

Është mbajtur aktpranimi nr.4, datë 06.10.2017 i mbajtur nga grupi për ndjekjen dhe zbatimin e kontratës. Bashkëlidhur këtij akti janë: faturë tatimore me nr.serie 55422501, datë 03.11.2017 me vlerë 700,000 lekë pa tvsh; raporti përfundimtar mbi projektin, manuali për gjenerimin e lejeve vjetore, manuali për gjenerimin e lejeve ditore, manual mbi vendosjen e keytag për sistemin e hyrje/daljeve në APD, listëprezenca me personat që kanë marrë pjesë në trajnim enë drejtim të aspekteve teknike dhe operacionale të përdorimit të përditshëm të sistemit të administrimit të lejeve ditore dhe vjetore.

Nga auditimi u konstatua se:

- Nga ana e Drejtorisë ekonomike nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenin 20 të kontratës së lidhur në datën 07.06.2017 me nr.1684 prot, përsa i përket mbajtjes së penaltetit ndaj operatorit ekonomik i cili referuar aktpranimi nr.4 të mbajtur në datë 13.11.2017 nga komisioni i marrjes në dorëzim, ka dorëzuar me vonesë produktin përfundimtar të projektit.

Referuar nenin 20 të kontratës së lidhur në datën 07.06.2017 me nr. 1684prot, në të përcaktohet që: “Dëmet e likuidueshme për kryerjen me vonesë të shërbimeve do të llogariten me tarifën e mëposhtme ditore:

a) *Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga çmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës”.*

Nga auditimi u konstatua se:

Kontrata për procedurën në fjalë ndërmjet Autoriteti Portual Durrës në cilësinë e Autoritetit Kontraktor dhe “T. S.” shpk në cilësinë e operatorit ekonomik të shpallur fitues, është lidhur në datën 07.06.2017 me nr. 1684prot. Me datë 10.11.2017 nga ana e operatorit ekonomik është dorëzuar raporti përfundimtar i projektit ndërkohë që afati i fundit i dorëzimit ka qenë data 06.11.2017. Pra produkti përfundimtar është dorëzuar 4 ditë me vonesë, veprim në kundërshtim me nenin 19 pika 19.6-19.9 të kontratës së furnizimit ku citohet “*Afati i lëvrimit të projektit do të jetë nga data e lidhjes së kontratës me afat lëvrimiti 4 muaj*”. Për pasojë Autoriteti Kontraktor duhet të kishte mbajtur vlerën e përlogarit të penaltetit nga grupi i marrjes në dorëzim të produkteve. Për pasojë (4 ditë x 38,082 lekë = 152,328 lekë pa tvsh ose 182,793 lekë me tvsh) cila përbën penaltitet të pambajtur nga autoriteti kontraktor kundrejt operatorit ekonomik dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e APD.

- Nga ana e Drejtorisë ekonomike nuk janë zbatuar përcaktimet e bëra në nenet 19 dhe 20 të kontratës së lidhur në datën 07.06.2017 me nr.1684prot, përsa i përket mbajtjes së vlerës së



zbritur ndaj operatorit ekonomik i cili referuar aktpranimit nr.3 të mbajtur në datë 06.10.2017 nga komisioni i marrjes në dorëzim, janë zbritur zëra përsa i përket instalimeve të pajisjeve të akses kontrollit për hyrje daljet e mjeteve në portën 1 dhe në terminalin e pasagjerëve. Këto zëra janë përkatësisht me vlerat 180,952.38 lekë pa tvsh dhe 271,428.57 lekë pa tvsh dhe janë përlogaritur nga grupi i marrjes në dorëzim dhe ndjekjes së zbatimit të kontratës.

Autoriteti Kontraktor duhet të kishte mbajtur vlerën e përlogaritur nga grupi i marrjes në dorëzim të produkteve përkatësisht për zërat e instalimit të pajisjeve të akses kontrollit për hyrje-daljet e mjeteve në portën 1 dhe instalimi i pajisjeve të akses kontrollit për hyrje daljet e mjeteve në terminalin e pasagjerëve si zëra të perealizuar. Për pasojë (180,952.38 lekë pa tvsh + 271,428.57 lekë pa tvsh = 452,380.95 lekë pa tvsh ose 542,857.14 lekë me tvsh) cila përbën vlerë të pambajtur nga autoriteti kontraktor kundrejt operatorit ekonomik dhe përbën dëm ekonomik për buxhetin e APD.

Në lidhje me problematikat e sipërcituara për penalitetin të pambajtur nga autoriteti kontraktor kundrejt operatorit ekonomik dhe për vlerën e pambajtur për mosrealizimin e zërave nga operatorit ekonomik, të evidentuara dhe komunikuar subjektit nga grupi i auditimit, u morën masa për arkëtimin e këtyre vlerave në datën 25.07.2018, vërtetuar kjo me një statement të llogarisë bankare në R. Bank printuar më datë 26.07.2018.

Nga auditimi në terren në lidhje me pajisjet hardware të implementuara u konstatua se:

- Dy nga pajisjet, Ski Data Lite Gate, të cilat shërbejnë për kontrollin e hyrje-daljeve në korsinë e daljes pranë terminalit të kontenerëve, janë goditur aksidentalisht nga një automjet duke pësuar dëmtime të konsiderueshme. Këto pajisje janë të çmontuara nga pozicionet e lokalizuara. Pajisjet e dëmtuara u verifikuan dhe ndodheshin në magazinë. Për këtë çështje, nga ana e policisë dhe e kompanisë që ka bërë implementimin e sistemit të hyrje daljeve, janë mbajtur procesverbalet përkatëse për dëmet e shkaktuara.

- Në gate nr.1 të portit, pajisjet Ski Data Lite Gate nuk janë implementuar ende pasi në këtë pjesë të portit është në zhvillim e sipër një projekt tjetër i cili ndikon në funksionimin operacional të Gate. Për këtë arsye pajisjet që janë destinuar për tu vendosur në këtë seksion janë në magazinën e APD, në pritje të një vendimmarrje nga niveli menaxherial i Autotitetit Portual.

- Sistemi i kontrollit të lejeve dhe i parkimit të hapur shërben për kontrollin/verifikimin nga personeli i brendshëm i APD i lejeve aktive si dhe ngarkimi i detyrimeve shtesë që lidhen me përdorimin e parkingjeve të hapura brenda hapësirës së portit. Në këtë modul duhet të përdreshin pajisjet (*Zebra MC67NA Bluetooth dhe Zebra ZQ51 Bluetooth*) së bashku me software-in mobile për administrimin e aksesit dhe lëshimin e lejeve të parkimit në terren si dhe për ofrimin e funksionaliteteve portabël pra në mënyrë të lëvizshme. Këto pajisje nuk përdoren nga Autoriteti Portual në mënyrë funksional, ato janë të magazinuara në magazinën e APD. Me përdorimin e këtyre pajisjeve punonjësit e ngarkuar të APD mund të ngarkojnë mjetet apo këmbësoret me gjopa të ndryshme në rast të evidentimit të moszbatimit të rregullave të brendshme në APD.

- Nga auditimi i shërbimit të hyrje-daljeve me anë të këtij sistemi u konstatua se jo të gjithë punonjësit janë të pajisur me kartat e reja të aksesit.

7.19. Për realizimin e procedurës e prokurimit me objekt “Sigurimi i pasurisë së APD-së”, viti 2017.



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

a.Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt :		
1.Urdhër Prokurimi Nr 1300 prot Datë 24.04.2017	3.Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Hartues Fondi Limit dhe Specifikme Urdhër Nr. 169, dt.19.01.2017	4.Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 1301 dt.24.04.2017
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Procedurë e hapur”	1.M.R. 2. Xh. L. 3.Gj.K. Nr. 1300, datë 24.04.2017 NJP 1. E. K., përgjegjës i sektorit të prokurimeve, jurist 2. A.M., specialist, jurist 3. D. G., specialist, jurist	1. M. B., Kryetare, Drejtor Ekonomik 2. A. K., Drejtor i Burimeve Njerëzore 3. F. H., Këshilltar i Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv
5.Fondi Limit 23,000,000 lekë (pa tvsh)	6.Oferta fituese (pa tvsh) 22,900,001.3 lekë	7.Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 99,998.7 lekë
8. Data e hapjes së tenderit 17.05.2017	9.Burimi Financimit Te Ardhurat e veta	10.Operatoret Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender Numër 1 OE b)S’kualifikuar 0OE, c) Kualifikuar 1 OE
11.Ankimime AK-s’ka;/APP-s’ka;/KPP-s’ka	12. Përgjigje Ankesës nga AK Shkresa nr datë ____	13.Përgjigje Ankesës nga APP apo AKKP, Shkresa nr.. datë
b.Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/ Mallrave		
14.Lidhja e kontratës Nr. 1647 Datë 02.06.2017	15.Vlera e kontratës (me tvsh) 22,900,001.3 lekë	16.Likuiduar deri dt 16.07.2018 Lekë 22,899,999.95
17-Situacioni Përfundimtar/Faturë Malli/Shërbimi dt.02.06.2017 -Vlera me tvsh. 22,899,999.95 lekë -Vlera pa tvsh 22,899,999.95 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 7 ditë	19.Zgjatja e kontratës me..... ditë Shkresa (Amendamenti) nr.. dt..... Nuk ka

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe aksesi në sistemin e prokurimit publik APP, u konstatua se:

Referuar Urdhrit të Brendshëm nr. 169 prot. datë 19.01.2017 është ngirutr komisioni me qëllim përcaktimin e specifikimeve teknike, kriteret e përlllogaritjes së vlerës së fondit limit të kontratës së prokurimit. Me shkresën nr. 169/7, pa datë, kryetari i komisionit të hartimit të specifikimeve teknike dhe përlllogaritjes së fondit limit ka përcjell specifikimet teknike dhe vlerën limit të kontratës së prokurimit me titull “Sigurimi i pasurisë”. Bashkëlidhur praktikës komisioni ka hartuar dhe nënshkruar deklaratat e konfliktit të interesit për këtë fazë të prokurimit.

Komisioni ka përdorur si specifikime ato që janë hartuar një vit më parë për po të njëjtën procedurë.

Për sa i përket përlllogaritjes së fondit limit grupi i ngitur për këtë qëllim i është drejtuar 3 kompanive sigurorese në mënyrë zyrtare për të marrë ofertat përkatëse, të cila gjithashtu kanë ardhur zyrtarisht:

1. E.. me ofertë 23,006,049 lekë pa TVSH
2. S.. me ofertë 23,187,619 lekë pa TVSH
3. I.. me ofertë 23,062,930 lekë pa TVSH

Metodologjia e përdorur për përlllogaritjen e fondit limit të kontratës është hartuar fillimisht mesatarja aritmetike e ofertave e cila është 23,085,532.67 lekë (pa TVSH), dhe duke qenë se



ofertat janë më të larta se vlera e parashikuar në plan biznesi, komisioni ka vendosur unanimitisht që fondi të jetë sa vlera e parashikuar në plan biznesi pra 23,000,000 lekë. Mënyra e përdorur nga ky komisioni nuk përputhet me asnjë nga mënyrat e parashikuara në LPP dhe denatyon procesin e hartimit të fondit limit.

Me Urdhrin e Prokurimit nr. 1300, datë 24.04.2017, ka nisur procedura e prokurimit “Sigurimi i Pasurisë së APD-së”, me fond limit 23,000,000 lekë, lloji i procedurës e hapur dhe me njësinë e prokurimit përkatëse.

Në datën 24.04.2017 ka filluar procedura në sistemin elektorik në APP dhe janë publikuar dokumentat standarde të tenderit me njoftimin nr. 1302, datë 24.04.2017, njoftimi është publikuar në Buletinin nr. 17, datë 02.05.2017.

Afati i dorëzimit të dokumentave të tenderit është vendosur data 17.05.2017 ose 23 ditë nga publikimi në sistem, afat minimal i parashikuar në të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”.

Njësia e prokurimit me procesverbal të datës 24.04.2017, ka miratuar dokumentet e tenderit, si dhe kriteret e vlerësimit. Kriteri i përzgjedhjes së fituesit është përcaktuar çmimi më i ulët.

-Në hartimin e dokumenteve të tenderit, nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri të veçantë për kualifikim, vetëm sa është bërë përcaktimi i kërkesave për kualifikim. Ky veprim bie në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit”, i ndryshuar.

Me Urdhrin nr. 1301, datë 24.04.2017 është ngritur komisioni i vlerësimit të ofertave. Komisioni ka plotësuar deklaratat përkatëse të konfliktit të interesave në caktimin e detyrës dhe në momentin e hapjes së procedurës.

Në datën 17.05.2017, ora 10:00 komisioni i vlerësimit të ofertave ka hapur procedurën në sistem dhe ka konstatuar se në procedurë është paraqitur 1 ofertues:

- BO E..& S..&I.. me vlerë 22,900,001.3 lekë

KVO ka shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur nga BO E.. & S..&I.. dhe ka kualifikuar BO duke u shprehur se plotëson të gjitha kriteret e vendosur në DST.

Nga auditimi u konstata se një nga OE konkretisht S.. sh.a e cila ka një pjesëmarrje 31% në bashkimin e operatorëve është në proces gjyqësor me kompaninë S.. sh.a për shkak se kompania S.. sh.a refuzon të paguajë detyrimet që rrjedhin nga mos përmbushja e kontratës “Furnizim vendosje e checkin-it elektronik i terminalit të pasagjerëse”, në cilësinë e sigurueses së kontratës. Detyrimet e pretenduara nga APD ndaj kompanisë janë 282,073.3 euro. Kompania S.. sh.a ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit me APD, konflikt i cili mund të ndikojë në zbatimin e kontratës së sigurimit të pasurisë. Ky operator duhet të ishte skualifikuar dhe si rrjedhojë gjithë bashkimi i operatorëve. Kualifikimi i saj është në kundërshtim me LPP.

KVO ka hartuar procesverbalin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

KVO ka hartuar raportin përmbledhës nr. 1599, datë 29.05.2017, i cili është miratuar nga Titullar i Autoritetit Kontraktor.

Me shkresën nr. 1600, datë 29.05.2017, është miratuar procedura e prokurimit dhe formulari i njoftimit të fituesit nr. 1601, datë 29.05.2017.

Në datë 02.06.2017 BO E.. & S..&I.. është paraqitur në APD për lidhje kontrate dhe ka dorëzuar dokumentacionin e tenderit, të cilat janë verifikuar nga KVO dhe kanë hartuar procesverbalin nr. 1646, datë 02.06.2017.

Operatorët kanë paraqitur sigurimin e ofertës në vlerën 2,290,000.13 lekë në formën e Policës së Sigurimit pranë shoqërisë A...



Është lidhur kontrata midis palëve nr. 1647, datë 02.06.2017 midis APD e përfaqësuar nga A. L. dhe kontraktuesit E., përfaqësuar Xh. K., S..përfaqësuar nga A.P. dhe I. përfaqësuar nga E. H..

Po në këtë datë BO E.. & S..&I.. kanë paraqitur policat e sigurimit.

Me urdhrin e brendshëm nr. 1669, datë 06.06.2017 “Mbi monitorimin e zbatimit të kontratës Sigurimi i Pasurisë së APD-së” është caktuar M. R. si monitorues i zbatimit të kontratës dhe i janë përcaktuar edhe detyrat përkatëse, si dhe M. R., Xh. L. dhe Gj. K., si komision kontrolli dhe pranimi malli.

Me urdhër transfertën datë 13.06.2017, është kryer pagesa me vlerë 22,899,999.95 lekë bazuar në:

Faturën nr. 21984, datë 02.06.2017 me vlerë 19,284,478 lekë

Faturën nr. 22114, datë 02.06.2017 me vlerë 359,228 lekë

Faturën nr. 22118, datë 02.06.2017 me vlerë 232,028.7 lekë

Faturën nr. 21987, datë 02.06.2017 me vlerë 1,188,000 lekë

Për çdo rast janë hartuar akt-pranimet përkatëse.

Grupi i monitorimit nuk ka hartuar asnjë raport mbi zbatimin e kontratës dhe në asnjë rast nuk është raportuar tek kompania siguruuese.

8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.

Titulli i gjetjes: Mangësi në zbatimin e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Situata: Nga auditimi u konstatua se nga Autoriteti Portual Durrës nuk janë zbatuar të gjitha kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, saktësisht:

- Në rregulloren e organizimit dhe menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës të miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.08 datë 18.03.2016, nuk janë të përcaktuara detyrat për çdo pozicion pune. Përshkrimet e punës janë deri në nivel sektori apo njësie.

- Mungon deklarata e vizionit dhe misionit strategjik, e cila duhet të kontrollohet dhe miratohet nga Titullari, si dhe të komunikohet nga lart poshtë në të gjitha nivelet e njësisë publike.

- Autoriteti Portual Durres ka një Master Plan, të miratuar me vendim të KM, nr.546, datë 28.05.2009, por nuk është i azhornuar.

- Delegimi i detyrave dhe përgjegjësi nuk dokumentohen gjithmonë sipas ligjit nr.10296/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), i ndryshuar. Në rregulloren e brendshme nuk janë të përcaktuara kriteret dhe rregullat e delegimit.

- Për vitet 2016 dhe 2017 nuk ka Urdhër të Titullarit për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

- Nuk ka regjistra risku të hartuara specifikisht për çdo drejtori.

- Nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara nënenin 18, të ligjit dhe pikat nr.4 e 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se “Deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave”, veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.



Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Mangësi procedurale të konstatuar gjatë verprimtarisë së APD.

Shkaku: Mosnjohje e duhur e ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Rëndësia: E lartë.

Rekomandim: Nga Sektori i Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar të Kontrollit në APD të merren masa për implementimin dhe zbatimin e plotë të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me qëllim dhënien e një sigurie të arsyeshme mbi veprimtarinë e Autoritetit Portual Durrës në përputhje me parimet e këtij ligji.

Titulli i gjetjes: Mosevidentim risku.

Situata: Nga auditimi u konstatuan mjaft situata të cilat në opinion të grupit të auditimit janë me risk të lartë, por nga ana e Sektorit të Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar të Kontrollit nuk janë të trajtuara si të tilla. Saktësisht:

- Nga auditimi në terren u konstatua së në territorin e portit ushtrojnë apo kanë ushtruar veprimtari operatorë ekonomik privat, të cilat përbëjnë risk të lartë për ndotjen e mjedisit tokësor dhe ujqor të portit. Ky aktivitet (riparimi i trageteve) është aktivitet i cili nuk është përcaktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të plotë të standarteve dhe të kërkesave të Kreut III, neni 7 “Dokumentimi i veprimeve ekonomiko financiare”, me nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Rregulloren e APD-së, Autoriteti Portual Durrës të hartojë dhe të regjistrojë në kohë dokumentimin e proceseve administrative- operacionale para faktit të kryerjes së tyre, për të berë të mundur faturimin e saktë në kohë, në përputhje me nenin 11, nenit 17, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë Financiare me nr.30, datë 27.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorin Publik”, në kundërshtim me Ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqiperise” i ndryshuar, neni 50, 51, pika 1.

Referuar fotorgrafimit të forcës së sigurisë më datë 20.06.2018, ora 12.40, si dhe nga verifikimi në vend, në ish-kantierin detar ishte akostuar dhe po riparohej, lysterje me bojë etj, tragei V..., R....

Sektori i Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin, është treguar pasiv në trajtimin e problematikës financiare dhe mos informimin e plotë dhe në kohë të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe më tej organeve drejtuese të APD.

- Nga auditimi i investimeve kapitale të kryera nga Autoriteti Portual Durrës u konstatua se ato nuk janë trajtuar sipas parimit të prioritarizmit, por janë kryer në mënyrë të rastësishme, çka për APD përbën risk të lartë mbi realizimin e atyre investimeve jetësore dhe me rëndësi funksionale.

- Nga auditimi i kryer mbi sistemin e check-imit të punonjësve u konstatua se një numër relativisht i lartë i vizitorëve dhe automjeteve që hyjnë në port, nuk paguajnë tarifën përkatëse. Tarifat e papaguara përbëjnë të ardhura të munguara për Autoritetin Portual Durrës, duke ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në situatën financiare të tij në vlerën 23,113,200 lekë, e për pasojë nga grupi i auditimit vlerësohet si një çështje me risk mjaft të lartë.



- Procedurat e dorëzimit të punës nga njëri punonjës në një tjetër në rast të largimit nga puna të personelit të magazinës përbën risk të lartë në lidhje me asetet e APD, veprimtari e cila nuk është e pasqyruar në regjistrin e riskut si dhe nuk ka sinjalizime në lidhje me këtë problematikë.

- Fondet IPA janë përdorur për mbulimin e investimeve dhe shpenzimeve të pasqyruara në plan biznesin, ndërkohë që Fondet IPA janë fonde përpara aderimit në bashkimin Europian. Janë Grante dhe nuk ka se si të perdoret nga fondet Grande termi Kursim, pasi janë fonde falas dhe kuptimi i saj janë që të dish ti përdosh ti shpenzosh konform kushteve të percaktuara në kontrata.

IPA-është instrumenti para Anëtarësimit (Para Aderimit), është një mekanizëm i bashkëdyzuar i krijuar nga BE për të ofruar ndihmë efikase Ballkanit Perendimor. IPA ndihmon vendet candidate që të implementojne legjislacionin e BE. Pra nuk ka dhe nuk mund të ketë KURSIM në termin GRANTE.

- Në APD, gjatë periudhës objekt auditimi janë kryer investime të cilat nuk e kanë përligjur qëllimin për të cilat janë realizuar. Përmendim këtu: Blerja e peshores elektronike, Sistemi i burimeve njerëzore, arkiva elektronike etj. Këto raste dhe të tjera mund të konsiderohen si investime të cilat nuk kanë gjetur përfundimin e pritur duke shkaktuar efekte financiare për buxhetin e APD.

- Ndryshimi i kursit të këmbimit vitin e fundit, duke ndikuar negativisht në depozitat në euro të APD, përbën risk të lartë të mjeteve monetare të portit, i cili gjithashtu nuk rezulton të jetë trajtuar në regjistrin e riskut.

- Konflikti i interesit i drejtorit të auditit të brendshëm ka risk të kompromentojë realizimin e detyrës funksionale të tij. Emërimi i tij është kryer nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të APD dhe jo nga Këshilli Drejtues. Gjithashtu, në lidhje me veprimtarinë e tij, janë konstatuar urdhëra të titullarit, pjesë e të cilit është Drejtori i Auditit të Brendshëm.

Kriteri: Ligji nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Ndikimi/efekti: Riske në aktivitetin e APD.

Shkaku: Nuk është arritur të evidentohet risku.

Rëndësia: I lartë.

Rekomandim: Nga ana e Sektorit të Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar të Kontrollit në APD të merren masa të menjëhershme për trajtimin e situatave të mësipërme e të tjera, të cilat përbëjnë risk të lartë për aktivitetin e Autoritetit Portual Durrës, duke i adresuar këto risqe edhe tek organet drejtuese të portit, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion u konstatua se:

APD është organi drejtues i portit të Durrësit. Autoriteti Portual Durrës është person juridik publik i cili funksionon në bazë të Ligjit 9130 dt 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual” Statuti i APD është miratuar me V.K.M Nr.596 datë 10.09.2004 “Për miratimin e Statutit të APD dhe riorganizimin e tij” i cili përcakton edhe menyrën e organizimit dhe funksionimit të tij. Në kuptim edhe të ligjit Nr.9130 “Për Autoritetin Portual”, AP i kalon e drejta e administrimit të pronës shtetërore dhe çdo e drejtë e lidhur me të, duke respektuar strukturën e organizimit si “port administrues toke”. Autoriteti Portual i Durrësit kërkon të nxisë investimet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në zhvillimin dhe modernizimin e tij.



Në APD ekziston kontrata kolektive e punës e cila hartohet çdo tre vjet. Kontrata e fundit kolektive është nënshkruar në datën në 09.05.2017, ndërmjet ish-Drejtorit të APD dhe Sindikatës të Pavarur të APD.

Me Vendimin nr.1, datë 10.01.2018 të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, për një ndryshim në strukturën organizative të APD-së, u ngrit Struktura e Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, në varësi direkte të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv. Struktura e Sektorit të MFK-së është e përbërë nga tre punonjës, një përgjegjës sektori dhe dy specialist.

Me urdhër të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr.892 prot, datë 01.03.2018 “Mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e përshkrimeve të punës”, sektori i MFK-së hartoi përshkrimet e punës për të tre punonjësit e sektorit dhe i ka dorëzuar elektronikisht pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.

Me kërkesë të sektorit të MFK-së, drejtuar Ministrisë së Financave dhe ASPA-s, u zhvillua trajnimi për tre punonjësit e sektorit të MFK-së mbi “Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, në periudhën 16-20 prill 2018.

Me urdhër të brendshëm nr.2253 prot, datë 01.08.2012 “Mbi caktimin e aktorëve kryesorë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në APD”, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, në cilësinë e Titullarit të Njesisë Publike, ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik dhe ka caktuar Nënpunës Autorizues zv/Drejtorin e Përgjithshëm Ekzekutiv, si dhe Nënpunës Zbatues Drejtorin e Drejtorisë Ekonomike, Administrimit dhe Financës.

Me urdhërat e brendshëm nr.305 prot, datë 29.01.2015 dhe nr.1501 prot, datë 12.04.2018, janë ndryshuar nominimet e Nënpunësit Autorizues dhe Nënpunësit Zbatues, me emrat e Drejtorëve të emëruar.

Ndryshimet që ka pësuar ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, janë në objektin e diskutimeve të Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Me shkresën nr.480 prot, datë 22.05.2018 me objekt “Për diskutim dhe miratim të “Pyetësorit të etëvlerësimit për komponentët e MFK-së” dhe “Plan veprimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, sektori i MFK-së i ka dërguar Grupit të Menaxhimit Strategjik pyetësorin e vetëvlerësit për komponentët e MFK-së dhe planin e veprimit për MFK-në.

Sipas sektorit të MFK-së, plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin është bazuar në mangësitë e zbuluara pas vlerësimit të pyetësorit të vetëvlerësimit, në rekomandimet e pazbatuara/pjesërisht/në proces të auditit të brendshëm për vitin 2017 dhe KLSH-së në raportin e vitit 2016, si dhe janë marrë në konsideratë rekomandimet e lëna në projektraportin e lëna nga auditimi i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjetikës.

Me urdhër të brendshëm nr.2234 prot, datë 23.05.2018 “Mbi krijimin e regjistrit të riskut në APD”, ka filluar procesi i hartimit të regjistrave të riskut, matricave dhe planeve të veprimit për minimizimin e tij nga çdo drejtori e APD-së, i cili do të vijojë me hartimin e regjistrit vjetor të riskut dhe plan veprimit vjetori, nga sektori i MFK-së. Me urdhër të brendshëm nr.2269 prot, datë 25.05.2018 “Mbi hartimin e planeve vjetore të punës” janë ngarkuar të gjithë drejtorët të hartojnë planet vjetore sipas formatit standard të urdhërit të Ministrisë së Financave nr.108, datë 17.11.2016 “Për miratimin e manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”.

Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njesisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njesisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive



efektive, efiçente dhe me ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Në nenin 8 pika b të Ligjit Nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar citohet: “*Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike, në përputhje me kërkesat e nenit 27 të këtij ligji*”. Me urdhër të brendshëm nr.2253 prot, datë 01.08.2012 “Mbi caktimin e aktorëve kryesorë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin në APD”. Për vitet objekt auditimi nuk ka urdhëra për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik.

Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në APD, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi, si dhe monitorimi, në zbatimin e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar.

Me urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të Autoritetit Portual Durrës nr.1501 prot, datë 12.04.2018 “Mbi caktimin e aktoreve kryesor për menaxhimin financiar dhe kontrollin në Autoritetin Portual Durrës”, është caktuar zv/Drejtori i Përgjithshëm P. C. si Nënpunës Autorizues dhe Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, Financës dhe Administrimit D. A. si Nënpunës Zbatues.

Në drejtim të Mjedisit të Kontrollit.

Mjedisi i kontrollit është një element i rëndësishëm i menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke siguruar vendosjen e objektivave në përmbushjen e misionit të institucionit, etikën personale dhe profesionale, dhe mënyrën e organizimit të strukturës organizative të Autoritetit Portual Durrës.

Struktura aktuale e APD është e miratuar me Vendimin nr.45/1 datë 24.04.2018 të Këshillit Drejtues. Sipas kësaj strukture, Autoritetit Portual Durrës drejtohet nga Këshilli Drejtues. Drejtoria e auditit të brendshëm është drejtori e pavarur nga Drejtori i Përgjithshëm. Në strukturë janë 2 zv/drejtor, forcat e sigurisë si dhe 6 drejtori, saktësisht: drejtoria e shërbimeve operationale, drejtoria teknike, drejtoria e mjedisit, drejtoria e burimeve njerëzore dhe promocionit, drejtoria e ekonomise, financës dhe administrimit dhe drejtoria juridike. Në total numri i miratuar aktualisht është 455.

Rregullorja e organizimit dhe menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës është miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.08 datë 18.03.2016. Nga auditimi u konstatua se në këtë rregullore nuk janë të përcaktuara detyrat për çdo pozicion pune. Përshkrimet e punës janë deri në nivel sektori apo njësie.

Bazuar në Ligjin Nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar titullarët e sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit. Duhet theksuar se nuk ka një rregullore të veçantë apo procedurë për implementimin e kërkesave të këtij ligji, por elemente të tij janë të implementuar në rregullorene e brendshme të organizimit dhe menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës.

Deklarata e vizionit dhe misionit strategjik mungon. Në zbatim të parimeve të MFK, duhet hartuar një deklaratë vizioni (konsiston në parashtrimin e drejtimit afatgjatë dhe përshkrimin se çfarë dëshiron të arrijë njësia), dhe misioni (përmban aspekte të aktiviteteve, vlerave dhe



objektivave të saj). Kjo deklaratë duhet të kontrollohet dhe miratohet nga Titullari, si dhe të komunikohet nga lart poshtë në të gjitha nivelet e njësisë publike.

Autoriteti Portual Durrës ka një Master Plan, të miratuar me vendim të KM, nr.546, datë 28.05.2009, por nuk është i azhurnuar.

Objektivat e planit për vitin 2017 janë matur. Çdo drejtori ka përgatitur analizën vjetore për drejtorinë përkatëse, dorëzuar në protokoll, në muajin shkurt të vitit 2018. Objektivat nuk janë arritur në masën 100% për çdo drejtori.

Me Vendim të Këshillit Drejtues të APD-së, nr.8, datë 18.03.2016, është miratuar “Rregullorja Organizative dhe e Menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës”, dhe mbështetur në këtë rregullore, si dhe në Ligjin për APD, stafi drejtues monitoron etiken si personale, ashtu dhe profesionale të çdo punonjësi/përgjegjësi. Monitorimet mbi etiken personale e profesionale të punonjësve janë vizuale. Prezenca dhe respektimi në punë bëhet sipas sistemit IT i check-in, ashtu dhe nga stafi i Burimeve Njerezore. Monitorimi kundër pirjes së duhanit bëhet vizualisht nga Drejtoria e Mjedisit, në respekt të legjislacionit, dhe në zbatim të Urdhrit të Brendshëm nr.54 prot, datë 09.01.2018.

Çdo shkelje trajtohet duke u bazuar në Kodin e Punës, Kodin e Etikës, Rregulloren Organizative dhe të Menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës, Kontratës Kolektive nr.1446 prot, datë 09.05.2017 dhe administrohet në dosjen personale të çdo punonjësi.

Në rregulloren e brendshme të APD-së janë të percaktuara detyrat funksionale të çdo sektori e drejtorie, por jo për secilin pozicion pune specifik.

Nga auditimi u konstatua se delegimi i detyrave dhe përgjegjësive nuk dokumentohen gjithmonë sipas Ligjit nr.10296/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK)”, ndryshuar me Ligjin nr.110/2015. Në rregulloren e brendshme nuk janë të percaktuara kriteret dhe rregullat e delegimit.

Për çdo rast të delegimit nuk realizohen urdhëra të veçantë me titull, detyra dhe afate qartësisht të percaktuara .

Në praktikën e përditshme të punës nuk plotësohet një “skedë deleguese”, ku të përcaktohen personat përgjegjës, rekomandimet e nevojshme, si dhe afatet për përgjigje/realizim detyre.

Për çdo ndryshim/delegim detyrash nga nëpunësit autorizues apo nëpunësit zbatues, tek vartësit e tyre, delegimi dokumentohet me Urdhër të Brendshëm, ku specifikohet personi i deleguar, detyra, përgjegjësitë dhe afatet e delegimit. Nuk plotësohen formatet tip të delegimit të Nëpunësit Autorizues dhe/ose Nëpunësit Zbatues.

Vlerësimet e punonjësve në APD janë vjetore. Ato kryhen si për personelin menaxhues, ashtu dhe për atë operativ. Drejtoria e Burimeve Njerezore ndan me të gjithë drejtuesit “Formularin për Vlerësimin e Punës”, i cili plotësohet në dy kopje, një për punonjësin dhe një për tu arkivuar në dosjen personale të çdo punonjësi. *Nga auditimi i dosjeve të personelit u konstatua se ky formular mungon shpesh në këto dosje.*

- Për vitet 2016 dhe 2017 nuk ka Urdhër të Titullarit për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

- Nuk ka politika për menaxhimin e burimeve njerëzore, pasi mungon një rregullore, ku janë percaktuar detyrat sektorëve dhe linjat e raportimit. Nuk ka të miratuar përkrahje detyrash individuale e cila do të evidentonte ngarkesën konkrete me punë si dhe kërkesa lidhur me kualifikimet e nevojshme për secilin punonjës. Nuk ka vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që kryejnë ato. Nga menaxheri i institucionit nuk ka politika dhe praktika që të garantojnë ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të stafit.

Në drejtim të Menaxhimit të Riskut.



Koordinatori i Riskut për APD është Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues. Sektori i Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, u ngrit dhe miratua me Vendim të Këshillit Drejtues nr.1, datë 10.01.2018. Si sektor i ngritur për të zbatuar kërkesat e Ligjit të MFK-së, ngarkohet për të mbështetur Nëpunësin Autorizues në përmbushjen e detyrave të Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Riskut.

Nuk ka një strategji të riskut të miratuar në përputhje me nenin 21, të ligjit nr.10296/2010, të ndryshuar. Nuk ka procedurë për menaxhimin e riskut që të përmbajë identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këta objektiva do të realizohen. Ka një regjister risku, i hartuar për vitin 2016 me nr.138/1 prot, datë 15.01.2016. Nuk ka regjistra rrisht të hartuara specifikisht për çdo drejtori.

Në mbledhjet e GMS, të organizuara gjatë vitit 2017, janë diskutuar çështjet që paraqesin risk të lartë e pengojnë përmbushjen e objektivave të njësisë. Nga keto mbledhje, është mbajtur protokoll, në vetëm 3 të tyre. Gjatë këtij 4 mujori të vitit 2018, janë organizuar rregullisht mbledhjet e GMS, për të gjitha çështjet me rëndësi dhe efekt në arritjet e objektivave, duke i dokumentuar dhe informuar të gjithë stafin drejtues e vendosur skandena për përmbushjen e detyrave të lëna. Ky protokoll është mbajtur nga Asistentja e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

Për menaxhimin e riskut nuk është miratuar asnjë strategji, e cila duhet përditësuar çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, në kundërshtim me Ligjin nr.10296 për “Menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Nëpunësi autorizues duhet të analizojë dhe përditësojë kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit.

Pjesa me e madhe e stafit drejtues nuk janë të trajnuar mbi çështjet e MFK-së, dhe si rrjedhojë, është e nevojshme të merren masat për trajnimin e tyre në lidhje me Menaxhimin e Riskut dhe çështjeve të MFK-së. Në vitin 2017, në trajnimin e zhvilluar nga Ministria e Financave dhe shkolle e Administrimit Publik, mbi çështjet e MFK-së, morën pjesë 4 punonjës të APD-së. Në prill të 2018, morën pjesë 7 punonjës, nga të cilët 3 të sektorit të harmonizimit të MFK-së, dhe 4 nga Drejtoria Ekonomike. Në shtator të vitit 2017, është bërë kërkesë MF, për të trajnuar Stafin e APD-së, në ambientet e këtij të fundit, mbi çështjet e MFK-së, por ky trajnim nuk është arritur të zhvillohet akoma.

Në Drejtim të Aktiviteteve të Kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë politikat dhe procedurat e vendosura për të adresuar risqet dhe për të arritur objektivat e institucionit. Ato përfshijnë një gamë veprimesh kontrolluese me karakter parandalues dhe zbulues. Në lidhje me aktivitetet e kontrollit, është e rëndësishme një ndarje e përshtatshme e detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy ose më shumë detyrave që lidhen me: miratimin, zbatimin dhe rregjistrimin e operacioneve, vendosja e rregullave të brendshme mbi kontrollin para faktit ose paraprak të ligjshmërisë, veprime të përshtatshme kontrolli për sistemet e TI-së, etj.

Nga auditimi u konstatua se nuk ka manuale procesesh për aktivitete operacionale dhe financiare, të bazuara në hartat e proceseve të punës dhe në procedurat e shkruara, dhe sipas formateve të ofruara nga Manuali i MFK, si dhe të miratuara nga Titullari i Njësisë Publike, sipas kërkesave të ligjit të MFK-se.

Angazhimet financiare nënshkruhen nga nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues i institucionit. Për çdo rast zbatohet sistemi i firmës së dyfishtë. Në rastin e pasqyrave financiare, i është deleguar nga Nëpunësi Zbatues, përgjegjësit të sektorit të financës.



Sektori i Mirëmbajtjes dhe Mbështetjes Materiale është përgjegjës për zbatimin dhe ruajtjen e aseteve. Për këtë nuk ekziston një procedurë e shkruar. Të dhenat personale (dosjet personale të punonjësve) administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Zhvillimit të Karrierës, dhe është në detyrat funksionale të stafit të këtij sektori dhe në përgjegjësi të tyre, ruajtja nga përdorimi i pa autorizuar. Materialet e Arshivës ruhen nga përdorimi i pa autorizuar në zbatim të dispozitave ligjore të Arkivave.

Në rregulloren e brendshme të APD-së janë të përcaktuara “Rregullat e përdorimit të aseteve të teknologjisë së informacionit”. Në varësi të Drejtorisë së Zhvillimit, është krijuar Njësia e Sigurisë së Informacionit, e cila është përgjegjëse dhe monitoron sistemet IT nga pikëpamja e ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të përshtatshëm të sistemeve IT.

Institucioni ka një sistem rezervë (back-up) IT, “Disaster recovery Room” në Elbasan, ku mbahen të duplikuara sistemet kryesore të APD-së, dhe replikohet në kohë reale me linjë të dedikuar.

Nga auditimi u konstatua se nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara nënenin 18, të ligjit dhe pikat nr.4 e 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se “*Deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave*”.

Në drejtim të Monitorimit dhe Verifikimit.

Sistemet e kontrollit të brendshëm duhen monitoruar për të vlerësuar cilësinë e sistemit të performancës në kohë. Monitorimi kryhet nëpërmjet një monitorimi në vazhdimësi, nëpërmjet vlerësimeve të shkëputura ose duke i kombinuar të dyja. Monitorimi i aktiviteteve të kontrollit të brendshëm duhet të dallohet qartë nga verifikimi dhe monitorimi i operacioneve të institucionit.

Nuk ka sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv nuk merr raporte periodike në mënyrë shkresore nga Drejtorët e Drejtorive, por vetëm nga disa sektor/drejtorie. Raportimi kryhet në formën e relacioneve, emaile apo verbale gjatë mbledhjeve, mbi aktivitetet apo operacionet që shfaqin probleme.

Drejtorja e Auditit të Brendshëm auditon të gjitha drejtoritë, mbi bazen e planit vjetor, të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Në Drejtim të Informimit dhe Komunikimit.

Nga auditimi rezultoi se rezultoi se në Autoritetit Portual Durrës, nuk ka një procedurë të shkruar për mënyrën e komunikimit brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit, e cila duhej të ishte pjesë e rregullores së brendshme, por shkëmbimi i informacionit dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore, verbale dhe elektronike.

Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave. Nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave.

Për vitin 2018:

Me shkresën nr.562 prot, datë 14.06.2018 të përgjegjëses së sektorit të Harmonizimit i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i është dërguar Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv



“Plani vjetor i punës”, në zbatim të urdhërit të brendshëm nr.2269 prot, datë 25.05.2018 “Mbi hartimin e planeve vjetore të punës”.

Me shkresën nr.586 prot, datë 22.06.2018 të përgjegjëses së sektorit të Harmonizimit i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, i është dërguar Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv për diskutim dhe miratim “Regjistri vjetor i konsoliduar i riskut”.

Si përfundim:

Implementimi i kërkesave të ligjit nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, ka filluar të gjejë zbatim me krijimin e strukturës së Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar në Autoritetin me Vendimin nr.1, datë 10.01.2018 të Këshillit Drejtues të Autoritetit Portual Durrës, për një ndryshim në strukturën organizative të APD-së. Gjithsesi nga auditimi konstatohet se mangësitë në zbatim të këtij ligji vazhdojnë të jenë të shumta si:

- Rregullorja e organizimit dhe menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës është miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.08 datë 18.03.2016. Nga auditimi u konstatua se në këtë rregullore nuk janë të përcaktuara detyrat për çdo pozicion pune. Përshkrimet e punës janë deri në nivel sektori apo njësie.

- *Deklarata e vizionit dhe misionit strategjik mungon.* Në zbatim të parimeve të MFK, duhet hartuar një deklaratë vizioni dhe misioni. Kjo deklaratë duhet të kontrollohet dhe miratohet nga Titullari, si dhe të komunikohet nga lart poshtë në të gjitha nivelet e njësisë publike.

- Autoriteti Portual Durres ka një Master Plan, të miratuar me vendim të KM, nr.546, datë 28.05.2009, por nuk është i azhurnuar.

- Delegimi i detyrave dhe përgjegjëseve nuk dokumentohen gjithmonë sipas ligjit nr.10296/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), i ndryshuar. Në rregulloren e brendshme nuk janë të përcaktuara kriteret dhe rregullat e delegimit.

- Për vitet 2016 dhe 2017 nuk ka Urdhër të Titullarit për krijimin e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS).

- Nuk ka një strategji të riskut të miratuar në përputhje me nenin 21, të ligjit nr.10296/2010, të ndryshuar.

- Nuk ka regjistra rrisku të hartuara specifikisht për çdo drejtori.

- Nuk është hartuar Deklarata Vjetore mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe nuk janë dorëzuar sipas afateve ligjore të caktuara nënenin 18, të ligjit dhe pikat nr.4 e 6 të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.28, datë 15.12.2011, që përcaktojnë se “*Deklarata së bashku me raportin i paraqitet paraprakisht titullarit të njësisë publike dhe brenda muajit shkurt të çdo viti tek Nëpunësit të Parë Autorizues në Ministrinë e Financave*”.

Situata të vlerësuara nga grupi i auditimit me risk të lartë.

1. Nga auditimi në terren i grupit të auditimit u konstatua së në territorin e portit ushtrojnë apo kanë ushtruar veprimtari operatorë ekonomik privat, të cilat në opinion të grupit të auditimit përbëjnë risk të lartë për ndotjen e mjedisit tokësor dhe ujqor të portit, risk i cili edhe pse i konstatuar, nuk është trajtuar nga ana e Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin. Ky aktivitet (riparimi i trageteve) është aktivitet i cili nuk është për caktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit. Nga grupi i auditimit është kërkuar informacion lidhur me këtë problematikë, duke diktuar edhe riskun specifik, dhe nga ana e përgjegjëses së Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin, A. M., në datën 24.07.2018 është relatuar situata e mësipërme. Referuar këtij relacioni konstatohet se nga ana e Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin kjo ngjarje është vlerësuar me risk të ulët dhe nuk



është marrë asnjë masë në lidhje me sinjalizimin e kësaj situatë tek eprori direkt apo nëpunësi autorizues, veprim në kundërshtim me nenin 17 “Procedura e sinjalizimit” të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar. Nga auditimi i regjistrit të riskut të APD, u konstatua se mungon një trajtim specifik për këtë risk apo problematikë, e cila në opinion të grupit të auditimit ndotja e mjedisit tokësor dhe ujon të portit përbën risk të lartë.

Kjo situatë ka ardhur si rezultat i mos zbatimit të plotë të standarteve dhe të kërkesave të Kreut III, neni 7 “Dokumentimi i veprimeve ekonomiko financiare”, me nenin 3, pika 1, të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Rregulloren e APD-se, Autoriteti Portual Durrës të hartojë dhe të regjistrojë në kohë dokumentimin e proceseve administrative- operacionale para faktit të kryerjes së tyre, për të berë të mundur faturimin e saktë në kohë, në përputhje me nenin 11, nenin 17, të Ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë Financiare me nr. 30 datë 27.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorin Publik”, në kundërshtim me Ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 50,51, pika 1.

Referuar fotorgrafimit të forcës së sigurisë më datë 20.06.2018, ora 12.40, si dhe nga verifikimi në vend, në ish-kantierin detar ishte akostuar dhe pa riparohej, lysterje me bojë etj, trageti V., R. 1.

Spektori i Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin, janë treguar pasiv në trajtimin e problematikës financiare dhe mos informimin e plotë dhe në kohë të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe më tej organeve drejtuese të APD.

2. Nga auditimi i investimeve kapitale të kryera nga Autoriteti Portual Durrës u konstatua se ato nuk janë trajtuar sipas parimit të prioritarizimit, por janë kryer në mënyrë të rastësishme, çka për APD përbën risk të lartë mbi realizimin e atyre investimeve jetësore dhe me rëndësi funksionale. Nga ana e Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin është trajtuar ky fenomen i cili ka risk të lartë pasi mund ta përballë Autoritetin Portual me pamundësinë e kryerjes së atyre investimeve kapitale të cilat do të mundësonin vazhdimësinë normale të punës.

3. Nga auditimi i kryer mbi sistemin e check-imit të punonjësve u konstatua se një numër relativisht i lartë i vizitorëve dhe automjeteve që hyjnë në port, nuk paguajnë tarifën përkatëse. Tarifat e papaguara përbëjnë të ardhura të munguara për Autoritetin Portual Durrës, duke ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë në situatën financiare të tij në vlerën 23,113,200 lekë, e për pasojë nga grupi i auditimit vlerësohet si një çështje me risk mjaft të lartë. Për këtë problematikë nuk janë konstatuar sinjalizime nga ana e Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

4. Rastet e konstatuara si të parregullta nga grupi i auditimit në lidhje me procedurat e dorëzimit të punës nga njëri punonjës në një tjetër në rast të largimit nga puna të personelit të magazinës përbën risk të lartë në lidhje me asetet e APD, veprimtari e cila nuk është e pasqyruar në regjistrin e riskut si dhe nuk ka sinjalizime në lidhje me këtë problematikë.

5. Fondet IPA janë përdorur për mbulimin e investimeve dhe shpenzimeve të pasqyruara në plan biznesin, ndërkohë që Fondet IPA janë fonde përpara aderimit në bashkimin Europian. Janë **Grante** dhe nuk ka se si të perdoret nga fondet Grande termi **Kursim**, pasi janë fonde falas dhe kuptimi i saj janë që të dish ti përdosh ti shpenzosh konform kushteve të percaktuara në kontrata.

IPA-është instrumenti para Anëtarësimit (Para Aderimit), është një mekanizëm i bashkëdyzuar i krijuar nga BE për të ofruar ndihmë efikase Ballkanit Perendimor. IPA



ndihmon vendet candidate që të implementojne legjislacionin e BE. Pra nuk ka dhe nuk mund të ketë KURSIM në termin GRANTE.

6. Në APD, gjatë periudhës objekt auditimi janë kryer investime të cilat nuk e kanë përlligjur qëllimin për të cilat janë realizuar. Përmendim këtu: Blerja e peshores elektronike, Sistemi i burimeve njerëzore, arkiva elektronike etj. Këto raste dhe të tjera mund të konsiderohen si investime të cilat nuk kanë gjetur përfundimin e pritur duke shkaktuar efekte financiare për buxhetin e APD.

7. Ndryshimi i kursit të këmbimit vitin e fundit, duke ndikuar negativisht në depozitat në euro të APD, përbën risk të lartë të mjeteve monetare të portit, i cili gjithashtu nuk rezulton të jetë trajtuar në regjistrin e riskut.

8. Konflikti i interesit i drejtorit të auditit të brendshëm ka risk të kompromentojë realizimin e detyrës funksionale të tij. Emërimi i tij është kryer nga ana e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të APD dhe jo nga Këshilli Drejtues. Gjithashtu, në lidhje me veprimtarinë e tij, janë konstatuar urdhëra të titullarit, pjesë e të cilit është Drejtori i Auditit të Brendshëm.

Për sa më sipër, për mossinjalizimin e problematikave të mësipërme, të cilat janë me risk mjaft të lartë për aktivitetin e Autoritetit Portual Durrës, mban përgjegjësi A. M. me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin.

Vlerësimi i funksionimit të auditit të brendshëm.

Misioni i Auditit të Brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësisë të tyre.

Auditi i Brendshëm ndihmon dhe keshillon menaxhimin e lartë duke ofruar analiza, rekomandime, këshillime, informacione, lidhur me veprimtaritë që ai ka vlerësuar.

Nëpërmjet planit vjetor përcaktohen objektivat që do të arrijë, treguesit e matjes së performancës, kapacitetet në dispozicion dhe vlerësimin e menaxhimit të riskut, fushat me risk të lartë.

Referuar organigramës aktuale të Autoritetit Portual Durrës, Drejtorja e Auditit të Brendshëm është në varësi të Këshillit Drejtues.

Aktualisht Drejtorja e Auditit të Brendshëm ka në përbërje 3 punonjës, nga të cilët 1 Drejtor dhe 2 Specialistë Auditit.

Të tre audituesit janë të pajisur me çertifikatë si “Auditues i Brendshëm në sektorin publik”, nga Ministria e Financave.

Për vitin 2016, Drejtorja e Auditit Brendshëm në bazë të nenit 20, ligjit nr. 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ka kryer trajnimet e detyrueshme.

1. F. M. IPA Projekt 2012 –AL 12 IB FI 01.

2. R. P. IPA Projekt 2012 –AL 12 IB FI 01.

Për vitin 2017, Drejtorja e Auditit Brendshëm në bazë të nenit 20, ligjit nr. 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ka kryer trajnimet e detyrueshme.

1. R. P. Çertifikate nr.: MPBA 09-08-2017/21.

2. F. M. Çertifikate nr.: MPBA 09-08-2017/22.

3. N. K. Çertifikate nr.: MPBA 09-08-2017/23.

Për vitin 2018, me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.3, datë 10.01.2018, Drejtorja e Auditit Brendshëm ka pësuar ndryshime në përbërje personeli. R. P. lirohet nga detyra si Drejtor Auditit Brendshëm dhe kalon specialiste, N. K. kalon specialist në Sektorin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin. E. K. emërohet Drejtor i Drejtorisë Auditit Brendshëm.

Për vitin 2018, Drejtorja e Auditit Brendshëm në bazë të nenit 20, ligjit nr. 114/2015 “Për Auditin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ka kryer trajnimet e detyrueshme.

1. E. K. Çertifikate nr.: B1.3 01-02-2018/5.

2. R. P. Çertifikate nr.: B1.3 01-02-2018/17.



3.F. M. Çertifikate nr.: B1.3 01-02-2018/8.

Gjatë vitit ushtrimor në bazë të planit vjetor 2016, janë kryer 11 (njembedhjetë) Auditime të plota, dhe 1 (një) auditim tematik “Ndjekje dhe zbatimimi i rekomandimeve”.

Plani vjetor për vitin 2016 dhe strategjik për vitet 2016-2019, është miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues me nr.33, datë 06.11.2015. Dërguar Drejtorisë së Harmonizimit në Ministrinë e Financave me shkren nr.33/1, datë 10.11.2015.

Me Vendimin e Keshillit Drejtues nr.30, datë 20.10.2016 është bërë një ndryshim në Planin Vjetor të Auditimit për vitin 2016. Me shkresën e APD me nr. 134/2, datë 25.10.2016, dhe protokolluar në Ministrinë e Financave me nr.11722, datë 28.10.2016, është bërë njoftimi “Për ndryshim të planit vjetor të Auditimit,për vitin 2016”.

Për periudhën 01.01.2016-31.07.2016, struktura e Auditit Brendshëm ka funksionuar me dy punonjës (1 Drejtor dhe 1 Specialist).

Për periudhën 01.08.2016 e në vazhdim struktura e Drejtorisë së Auditit Brendshëm është plotësuar me 3 punonjës (1 Drejtor dhe 2 Specialiste).

Me shkresën me nr. 429, datë 13.02.2017 është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit për Auditin e Brendshëm “Raporti Përmbledhës dhe pasqyrat e evidencave të Auditit Brendshëm në APD-për vitin 2016”.

Plani vjetor për vitin 2017 dhe strategjik për vitet 2017-2019, është miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.31, datë 20.10.2016. Dërguar Sektorit të Harmonizimit në Ministrinë e Financave me shkresën nr.135/2, datë 25.10.2016.

Në bazë të planit vjetor të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues me nr.31, datë 20.10.2016, u planifikuan për t’u kryer 10 auditime të plota dhe 1 auditim mbi zbatimin e rekomandimeve. Gjate vitit 2017, u kryen 9 (nëntë) Angazhim Auditime të plota.

Drejtorja Auditit Brendshëm me shkresën me nr.43, datë 13.10.2017 njofton Keshillin Drejtues të APD-së dhe Ministrinë e Financave - Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit Brendshëm “Për një ndryshim në planin vjetor të auditimit për vitin 2017”, me objekt:

“... Me ndryshimin e strukturës organizative të APD-së, Auditimi nr. 6 i planifikuar në Drejtorinë Juridike me fushë auditimi Sektorin e prokurimeve, do të zhvillohet në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe zhvillimit të karrieres”.

Auditimi nr. 9, me Program Angazhim Auditimi me nr.49, datë 26.10.2017, i planifikuar sipas planit vjetor të auditimit për vitin 2017 në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, u zhvillua me Auditin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë sipas Urdhrit nr.166, datë 31.10.2017. Auditimi ishte Tematik në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Me shkresën me nr.2504, datë 16.10.2017, njoftohet Drejtorja e Përgjithshme e Harmonizimit “Njoftim për një ndryshim objekt auditimi, të planit Vjetor të Auditit Brendshëm për vitin 2017”.

Në periudhën Nëntor-Dhjetor 2017, Drejtorja Auditimit të Brendshëm ka qenë pjesë e angazhimit në Programin e Auditimit të Ministrisë së Infrastruktures dhe Energjisë me nr. 166/1 datë 10.11.2017.

Sipas planit vjetor të vitit 2017, janë realizuar të gjithë Auditimet janë relatuar në Këshillin Drejtues dhe janë evaduar:

1. Drejtorja Operacionale “Terminali Konteniervë D.”, evaduar me Vendimin e Këshillit Drejtues me nr.29, datë 10.04.2017.

2. Drejtorja Operacionale “Terminali Lindor E.”, evaduar me Vendimin e Këshillit Drejtues me nr.30, datë 10.04.2017.

3. Drejtorja Operacionale “Terminali Trageteve A.”, evaduar me Vendimin e Këshillit Drejtues me nr.42, datë 20.07.2017.



4. Drejtoria Teknike “Kontratat e shërbimit T. S. -A. E.-V.”, evaduar me Vendimin e Këshillit Drejtues me nr. 43, datë 20.07.2017.

5. Drejtoria Mjedisit, evaduar me Vendimin e Këshillit Drejtues me nr.57, datë 24.10.2017.

6. Drejtoria Ekonomike, evaduar me Vendimin e Këshillit Drejtues me nr.58, datë 24.10.2017.

7. Drejtoria Operacionale “Terminali Mallrave Gjenerale ”, evaduar me Vendimin e Këshillit Drejtues me nr.56, datë 24.10.2017.

8. Drejtoria e FSPD-së, evaduar me Vendimin e Këshillit Drejtues me nr.13, datë 14.02.2018. Për vitin 2017, nga gjetjet e konstatuara janë lënë gjithsej 69 rekomandime, nga këto:

- Masa organizative 64 rekomandime.

- Masa zhdëmtuese nga personat përfitues 5 rekomandime.

Me shkresën me nr.556, datë 14.02.2018 është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit për Auditin e Brendshëm “Raporti Përmbledhës dhe pasqyrat e evidencave të Auditit Brendshëm në APD-për vitin 2017”.

Plani vjetor për vitin 2018 dhe strategjik për vitet 2018-2020, është miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues me nr.11, datë 23.10.2017. Dërguar Sektorit të Harmonizimit në Ministrinë e Financave me shkresën nr.54/1, datë 24.10.2017.

Për vitin 2018 janë parashikuar të kryhen 8 objekte auditimi të plota (të gjithë sistemet dhe 1 objekt auditimi mbi ndjekjen dhe zbatimin e detyrave dhe rekomandimeve).

Për periudhën deri 30.06.2018, janë kryer auditimet:

1. Auditim i Drejtorisë Operacionale

1.1. Auditim i Terminalit Konteniervë D..

1.2. Auditim i Terminalit Lindor E..

1.3. Auditim i Terminalit Trageteve A..

1.4. Auditim i Terminalit Perëndimor.

2. Auditim i Drejtorisë së Mjedisit.

Është kryer 1 (një) Auditim jashtë planit me kërkesë të Kryetarit të Këshillit Drejtues dhe Drejtorit Auditit Brendshëm në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore me Urdhrin e Brendshëm nr.918, datë 02.03.2018.

2 .Auditim i Drejtorisë Teknike është në proces Auditimi.

Në lidhje me observacionin me nr. 3343/1 prot, datë 02.08.2018 të dërguar nga A. M. me detyrë Përgjegjëse e sektorit të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për procesverbalin nr. 22 me nr. 3343 prot, datë 27.07.2018 si dhe observacionin dërguar me shkresën përcjellëse nr. 3476/1 datë 10.09.2018, protokolluar në KLSH me nr. 579/4, datë 12.09.2018, mbi konstatimet e bëra për menaxhimin financiar dhe kontrollin në APD sqarojmë se: Nuk keni paraqitur prova dhe fakte të reja, të argumentuara ligjërisht dhe të shoqëruara me dokumentacion vërtetues, për pasojë nuk janë marrë në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimi.

9. Zbatimi i dispozitave ligjore për dhënien me qira të ambienteve dhe trojeve të depozitimit.

Auditimi i kësaj pike u krye me zgjedhje

1.Titulli i gjetjes: Përdorim nga persona të tretë të aseteve të Autoritetit Portual Durrës ,pa vjelur detyrimin e qirasë.



Situata: Autoriteti Portual Durrës më datë 29.03.2017 ka lidhur kontratë qiraje me Shoqërinë “J..” me objekt “Dhënie me qira të sheshit për zyrë mobile, me vendodhje pranë parkimit TIR, me afat 1 vit, me pagesë 7 lekë/m² në muaj pa TVSH, lloji i aktivitetit shërbime shitje biletash.

Për periudhën 5.04.2017-1.03.2018, kjo shoqëri nuk ka paguar detyrimet kontraktuale në vlerën 515,948 lekë. Me shkresën nr.1750, datë 26.04.2018, APD, ka njoftuar shoqërinë “J..” sh.p.k, një muaj pas përfundimit të kontratës për ndalim përdorimi të portit. Me urdhrin e brendshëm nr. 2063, datë 10.05.2018 “Mbi ndalimin e përdorimit të portit”, APD ka urdhëruar ndalimin e përdorimit të portit të Durrësit për subjektin “J..”, për shkak të moslikujdimit të detyrimit financiar të krijuar kundrejt APD-së. Me zbatimin e këtij urdhri është ngarkuar FSPD dhe Sektori i Administrimit të Territorit dhe Ambjenteve.

Referuar historikut të pagesave të qirasë subjekti “J..” ka rezultuar debitor që në muajin e parë të përdorimit të ambjenteve të APD-së dhe njoftimi për ndalimin e përdorimit të portit i është bërë më datë 26.04.2018, pra një muaj pas përfundimit të kontratës 1-vjeçare, në kundërshtim me nenin 7 të kontratës së qerasë. Ndërsa urdhri i ndalimit ka dalë 2 muaj pas përfundimit të kontratës së qerasë me datë 10.05.2018. Mosmarrja e masave për monitorimin dhe zgjidhjen e kontratës me subjektin debitor “J..”, siç përcaktohet në nenin 7 të kontratës së qerasë në kushtet e shkeljes së përsëritur të subjektit qiramarrës ndaj APD-së, ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Administrimit të Ambjenteve të APD-së. **Vlera 515,948 lekë përbën dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga Shoqëria “J..” sh.p.k.**

Kriteri: Neni 7, Kontrata nr.982, datë 29.03.2017

- Kontrata konsiderohet e zgjidhur :

“Kur shoqëria nuk paguan detyrimet e parashikuara në nenin 3 pika 3, pas përfundimit të afatit të përcaktuar në njoftimin e bërë për këtë qëllim;.....”

Ndikimi/efekti: Mosarkëtim i detyrimit të qerasë nga përdorimi i aseteve të Autoritetit Portual Durrës subjekti “J..” sh.p.k në vlerën **515,948 lekë** .

Shkaku: Moszbatim i monitorimit të kontratave nga sektori i administrimit të ambjenteve për periudhën objekt auditimi për ambjentet e dhëna me qira që janë nën përgjegjësinë e Autoritetit Portual Durrës.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

Nga Autoriteti Portual Durrës, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik në vlerën **515,948 lekë** nga Shoqëria “J..” sh.p.k , për llogari të Autoritetit Portual Durrës.

2.Titulli i gjetjes:

Nga auditimi u konstatua se Autoriteti Portual Durrës, nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të aseteve në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës në 7 raste, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

- Në dy raste ka ndryshim të destinacionit të dhënies me qira të shesheve të hapur për shërbime portuale të ngarkim shkarkimit.

Ndikimi/efekti: Keq përdorim të aseteve të APD .

Kriteri: Ligji nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.



Shkaku: Mos zbatim plotesisht të procedurave ligjore për regjistrimin e pasurisë dhe mos monitorim me rigorozitet të kontratave të dhëna me qira.

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi:

- Nga Autoriteti Portual Durrës të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në “Zërin troje” në kontabiliet, në zbatim të Ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

-Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa për monitorimin me rigorozitet të kontratave të dhënies të shesheve të hapur për shërbime portuale të ngarkim shkarkimit, duke mos lejuar ndryshimin e destinacionit të përdorimit tyre, në zbatim të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Autoriteti Portual Durrës në bazë të VKM-së nr.586, Datë 10.9.2004 “Për miratimin e listave të inventarëve të pronave të paluajtshme shtetërore të cilat u kalojnë në përgjegjësi administrimi shoqërive anonime dhe ndërmarrjeve të sistemit të transportit detar dhe ajror ka një sipërfaqe totale toke 654943.69 m², nga të cilat : Kalata – 32009.39 m², ndërtesa - 29.517.55 m², mure, trotuar, rruge, lulishte - 56198.84 m², sheshe - 539797.82 m². Ndërsa në bazë të VKM nr. 583 ,datë 10.08.2011 “Për kalimin në përgjegjësi administrimi të pasurisë së paluajtshme të ish-“Kantierit Detar Durrës dhe Akuatoriumit” ka në përgjegjësi administrimi ; kantieri detar – 82000 m², akuatoriumi - 40000 m², objekte – 21013.5 m², ndërtime speciale 8466 m². Në bazë të VKM nr.61, datë 01.02.2012 “Kalimi në përgjegjësi administrimi të APD –së për zonën e karburanteve”, ka një sipërfaqe trualli - 36116.78 m² dhe objekte – 627.88 m² dhe bazuar në VKM nr. 569, datë 27.06.2013 ‘Sipërfaqe shtesë në zonën lindore’ ka një sipërfaqe prej 29300 m². Referuar institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre, brenda territorit të portit për të cilën disponohet dokumentacioni tekniko ligjore për objektet dhe truallin që u është kaluar me Vendime të Këshillit të Ministrave etj, sipërfaqet që zene referuar dokumentacionit dhe aty ku nuk ka qene e mundur referuar informacionit të Sektorit të inxhinierise, janë: Trualli – 3778 m². Ndërtesa - 2212.81 m²; Parkim - 416.1 m²; Kalate - 365.9 m².

Nga auditimi u konstatua se Autoriteti Portual Durrës, nuk ka përfunduar procesin e regjistrimit të asetëve në Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme përkatëse në 7 raste, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

Dhënia me qira e ambienteve dhe trojeve të depozitimit në Autoritetin Portual Durrës u krye me zgjedhje. Konkretisht u audituan kontratat si më poshtë:

-Më datën 29.03.2017 me nr. 982 prot, është lidhur kontratë ndërmjet Autoritetit Portual Durrës të përfaqësuar nga A. L. me detyrë ish-drejtor i përgjithshëm ekzekutiv dhe Shoqërisë “J..” e përfaqësuar nga R. S., me objekt “Dhënie me qira të sheshit për zyrë mobile, me vendodhje pranë parkimit TIR, me afat 1 vit, me pagesë 7 lekë/m² në muaj pa TVSH, lloji i aktivitetit shërbime shitje biletash.

Nga auditimi i zbatimit të kontratës së qerasë nga subjekti “J..”, është konstatuar se ky subjekt është debitor ndaj APD në vlerën 515,948 lekë për moslikujdim të detyrimit financiar të krijuar kundrejt APD.Referuar historikut të detyrimit financiar të klientit konstatohet se për



periudhën nga data 5.04.2017 -1.03.2018 subjekti nuk ka paguar detyrimet që rrjedhin nga kontrata e qerasë me APD. Me njoftimin nr.1750, datë 26.04.2018, APD, ka njoftuar subjektin “J..” sh.p.k një muaj pas përfundimit të kontratës për ndalim përdorimi të portit. Me urdhrin e brendshëm nr.2063, datë 10.05.2018 “Mbi ndalimin e përdorimit të portit”, APD ka urdhëruar ndalimin e përdorimit të portit të Durrësit për subjektin “J..”, për shkak të moslikujdimit të detyrimit financiar të krijuar kundrejt APD-së dhe i ngarkuar me zbatimin e këtij urdhri është FSPD dhe Sektori i Administrimit të Territorit dhe Ambjenteve.

Referuar historikut të pagesave të qirasë subjekti “J..” ka rezultuar debitor që në muajin e parë të përdorimit të ambjenteve të APD-së dhe njoftimi për ndalimin e përdorimit të portit i është bërë me datë 26.04.2018, pra një muaj pas përfundimit të kontratës 1 vjeçare, kjo në kundërshtim me nenin 7 të kontratës së qerasë. Ndërsa urdhri i ndalimit ka dalë 2 muaj pas përfundimit të kontratës së qerasë me datë 10.05.2018. Mosmarrja e masave për monitorimin dhe zgjidhjen e kontratës me subjektin debitor “J..”, siç përcaktohet në nenin 7 të kontratës së qerasë në kushtet e shkeljes së përsëritur të subjektit qiramarrës ndaj APD-së, ngarkon me përgjegjësi Sektorin e Administrimit të Ambjenteve të APD-së. Vlera 515,948 lekë është dëm ekonomik për APD dhe Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërlehet nga subjekti “J..”. Ndërmjet APD-së së përfaqësuar nga A. Q. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe subjektit Pastrimi Detar të përfaqësuar nga I. K. në cilësinë e Administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr. 2449/1 prot, datë 04.10.2017. Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim e shesheve të përdorimit për mallra gjenerale, sipas librit të tarifave referuese. Vendodhja: Mjet lundrimi pranë kalatës zero 180 m², anije e vogël “A..”, afati i përdorimit të sheshit 180 ditë. Kjo kontratë është lidhur pas kërkesës që kjo shoqëri ka bërë me datë 4.10.2017, kërkesë e protokolluar me nr. 2449 datë 4.10.2017 në të cilën cilësohet “Kërkesë për përdorim sheshi tek kalata zero, drejtuar A. L.: Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv ku ndër të tjera është cilësuar “.../Kompania e jonë është prezente në zonën portuale, me të gjitha fasilitet për ushtrimin e veprimtarisë konformë rregullave dhe legjislacionit në fuqi. Mqs një nga anijet e kompanisë sonë “A..” duhet të riparohet për ndrrimin e motorrit, kërkojmë nga ana e juaj të na miratoni në disponibilitetin e nje sheshi 150 m², pranë kalatës 0, ku janë akostuar anijet tona.

Planimetria është përcaktuar nga N. S. me detyrë Inspektor i Administrimit të Territoreve, hartuar nga ing. K. G., miratojë G. A. me Detyrë Përgjegjës i Sektorit të Administrimit të Territorit dhe mbjenteve.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. L. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe subjektit Pastrimi Detar të përfaqësuar nga I. K. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr. 969 prot, datë 29.03.2017. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallrave gjenerale, sipas librit të tarifave referuese, sipërfaqja 200². Vendodhja: Pranë kalatës 0, lloji i akitivitetit shërbim portuale (mjete shërbimi). Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap më nën qira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”.

Planimetria e hartuar nga ing. A.L. dhe ing. K P..

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. L. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “C.” shpk të përfaqësuar nga E. S. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr. 961 prot, datë 29.03.2017. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallrave gjenerale, sipas librit të tarifave referuese, sipërfaqja 200 m². Vendodhja: Pranë kalatës 0, lloji i akitivitetit shërbim portuale (mjete shërbimi). Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh në



nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo tja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”. Theksojmë se oferta nga kjo shoqëri është bërë më datë 06.03.2017 ku është ofertuar A. 4 lekë/m² në ditë pa tvsh dhe B. 7 lekë/m² në ditë pa tvsh. Planimetria e hartuar nga ing. A.L. dhe ing. K P.. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo tja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. L. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “R. O. I.” SHPK të përfaqësuar nga P. Gj. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.973 prot, datë 29.03.2017. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit të mallrave gjenerale, sipas librit të tarifave referuese, sipërfaqja 200 m². Vendodhja: Pranë kalatës 0, lloji i aktivitetit shërbime portuale (mjete shërbimi). Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo tja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”. Theksojmë se oferta nga kjo shoqëri është bërë më datë 06.03.2017 ku është ofertuar A. 4 lekë/m² në ditë pa tvsh dhe B. 7 lekë/m² në ditë pa tvsh. Planimetria e hartuar nga ing. A.L. dhe ing. K P.. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”. Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “C.” shpk të përfaqësuar nga E. S. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.1361 prot, datë 30.03.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallra gjenerale, sipas librit të tarifave referuese, sipërfaqja 200 m². Vendodhja: Pranë kalatës 0, lloji i aktivitetit shërbim portuale (mjete shërbimi). Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”. Planimetria e hartuar nga ing. A.L. dhe ing. K. P.. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”.

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie: Shërbime portuale, furnizim, transport uji, pastrim detar, transport karburanti. Pastrim i sipërfaqeve urbane, furnizim i anijeve me ushqime. Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve lundruese me kapacitet të vogël si skafe, barka, anije të shërbimeve kufitare dhe portuale, bar kafe. Pastrim akuariumi, rikonstruksion i mjeteve të vogla detare deri në 20 m² për shërbime portuale.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “C.” shpk të përfaqësuar nga E. S. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.1362 prot, datë 30.03.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit për zyrë imobilare (sheshe për tavolina), sipërfaqja 100 m². Vendodhja: Pranë kalatës 0, lloji i aktivitetit shërbime në anije. Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 7 lekë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo tja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”. Planimetria e hartuar nga Redi Sefa. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”.

Objekti i veprimtarisë së kësaj shoqërie: Shërbime portuale, furnizim, transport uji, pastrim detar, transport karburanti. Pastrim i sipërfaqeve urbane, furnizim i anijeve me ushqime. Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve lundruese me kapacitet të vogël si skafe, barka, anije të



shërbimeve kufitare dhe portuale, bar kafe. Pastrim akuariumi, rikonstruksion i mjeteve të vogla detare deri në 20 m² për shërbime portuale.

- Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “R. O. I.” shpk të përfaqësuar nga P. Gj. i në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.1380/1 prot, datë 30.03.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallra gjenerale, sipas librit të tarifave referuese, sipërfaqja 200 m². Vendodhja: Pranë kalatës 0, lloji i akivititetit shërbime portuale (mjete shërbimi). Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”. Planimetria e hartuar nga ing. A.L. dhe ing. K. P.. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “R. O. I.” shpk të përfaqësuar nga P. Gj. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.1380 prot, datë 30.03.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit për zyrë imobilare, sipërfaqja 50 m². Vendodhja: Pranë kalatës 0, lloji i akivititetit shërbime agjensi doganore, Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 7 lekë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”. Nuk ka planimetri. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “A. ” shpk të përfaqësuar nga A. J. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.1370 prot, datë 30.03.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit për zyrë imobilare, sipërfaqja 15 m². Vendodhja: Pranë kalatës 0, lloji i akivititetit shërbime eksport, transport detar. Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 7 lekë pa tvsh . Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”.

Referuar ekstraktit të regjistrit tregtar objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është “ *Import eksport i mallrave industriale dhe elektroshtepiake si tv, kompjuter, video, frigorifere, fshesa me korent etj. Artikuj e mallra ushqimor si vaj, sheqer, oriz, makarona etj. Agjensi detare dhe spedicionere, agjensi doganore. Ushtrimi i veprimtarisë së ormexhimit*”.

Referuar shkresës përcjellëse me nr.128/2 prot, datë 27.06.2018 të Drejtorit të FSPD-së, janë paraqitur foto për kalatat 0, 7, 8 dhe peshkimi i vjetër, për një periudhë nga data 21.04.2018 deri 20.06.2018. Nga fotot konstatohet se:

-Tek kalata 0, u konstatuan 3 anije të cilat po riparoheshin nga data 21.04.2018 deri në datën 20.06.2018.

-Tek Terminali i Trageteve, në datën 20.06.2018 gjendet e akostuar anija “V. F.”, e cila po kryente shërbime lyerjeje. Deri në datën 30.05.2018 anija nuk ndodhet në këtë Terminal. Prej datës 30.05.2018 deri 20.06.2018, sistemi nuk mundësonte pamje, për pasojë nuk mund të shprehemi për datën e saktë të akostimit të anijes.

-Tek Peshkimi i vjetër, në datën 20.06.2018 gjendet e akostuar anija “V. F.”, si dhe një anije tjetër në territorin tokësor, të cilat po kryenin shërbime lyerje. Deri në datën 30.05.2018 anijet nuk ndodhen në këtë terminal. Prej datës 30.05.2018 deri 20.06.2018, sistemi nuk mundësonte pamje, për pasojë nuk mund të shprehemi për datën e saktë të akostimit të anijes. Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. Q. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe personi M. Ç. është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr. 2612/1 prot, datë



01.11.2017. Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim e shesheve të përdorimit për mallra gjenerale, sipas librit të tarifave referuese. Vendodhja: Pranë kalatës 0 141 m², Lloji i aktivitetit: Shërbime portuale (mjete shërbimi) afati i përdorimit të sheshit 1 vit. Pagesa në lekë 4 lekë m²/ditë pa tvsh. Theksojmë se kërkesa është bërë nga M. Ç. me nr. 2611 prot, datë 31.10.2017 (prot i APD-së), ku ndër të tjera është cituar se për nevoja të aktivitetit tim, kërkoj të marr me qira pranë APD-së sipas legjislacionit në fuqi, në teritorin e ish-kantjerit detar një hapësirë për një periudhë 1 vjecare për mallëra rifuxho.

Me kërkesën nr. 2612 prot, datë 31.10.2017 (prot i APD-së), ku ndër të tjera është cituar se për nevoja të aktivitetit tim, kërkoj të marr me qira pranë APD sipas legjislacionit në fuqi, në teritorin e ish-kantjerit detar një hapësirë për një periudhë 1 vjecare për mallra gjeneralë.

Referuar ekstraktit të regjistrit tregtar fusha e veprimtarisë së tij është zënie, tregëtim peshkim.

Referuar kërkesës dhe regjistrit tregtar për fushën e veprimtarisë, nuk ka lidhje me objektin e kontratës “Shërbime portuale (mjete shërbimi)”, si dhe vendin e kërkuar që nuk është kalata zero, por ish-kantjeri detar.

Planimetria e hartuar nga: N. S. me detyrë Inspektor i Sektorit të Administrimit të Teritorit dhe Ambjenteve. Hartuar nga ing. K. G., miratuar nga G. A. me detyrë Përgjegjës Sektorit të Administrimit të Teritorit dhe Ambjenteve

Me njoftim të datës 28.06.2018 drejtuar Kapitenerisë së Portit Durrës, M. Ç. njofton se do të ulë në ujë në basenin e Portit Durrës, mjetin i cili është në proces ndërtimi dhe kompletimi, për t’u transferuar në bankinën e peshkimit të vjetër brenda portit.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe personi fizik M. Ç., është lidhur kontratë qiraje me nr.2556/2 prot, datë 02.07.2018 për vinçin MHC 200. Objekti i kontratës: Qiradhënie e pajisjeve (mjeteve, mekanizma). Mjeti MHC vinc portual mobile, mekanizatori L. R.. Malli i përpunuar : Shkarkim anije peshkimi nga toka në det. Afati i kontratës: 1 orë pune nga ora 13 deri në orën 14.00, datë 28.06.2018. tarifa për orë pune 29.792 pa TVSh.

Referuar regjistrit të dispecerit, puna është kryer më datë 30.06.2018 nga ora 13.00 deri në 14.00, në kalatën nr. 5.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe personi fizik M. Ç., është lidhur kontratë qiraje me nr. 2556/1 prot, datë 28.06.2018 për vinçin MHC portual mobile, mekanizatori Y. T.. Objekti i kontratës: Qiradhënie e pajisjeve (mjeteve, mekanizma). Mjeti MHC vinc portual mobile, mekanizatori Y. T.. Malli i përpunuar: Shkarkim anije peshkimi nga toka në det. Afati i kontratës: 1 orë pune nga ora 11 deri në orën 12.00, datë 28.06.2018, tarifa për orë pune 29.792 pa TVSh.

Pra referuar si më sipër nga personi fizik M. Ç. në sipërfaqet e marra me kontratat respektive të përshkruara, është kryer riparimi i dy anijeve të peshkimit, ku APD-ja i ka mundësuar jo vetëm këtë shërbim në sipërfaqet e dhëna me qira, jashtë destinacionit të qirasë, por i ka vënë në dispozicion dhe mjetet më të rënda të saj për të bërë uljen në basenin e portit (vinci MHC 200).

Ky aktivitet (riparimi i anijeve) është aktivitet i cili nuk është përcaktuar në kuadrin rregullor të APD-së, të dal në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Ndërmjet APD të përfaqësuar nga A. Q. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “A...” përfaqësuar B. T., është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr. 211/1 prot, datë 22.01.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim e shesheve të përdorimit për mallra gjenerale, sipas librit të tarifave referuese. Vendodhja: Pranë kalatës



zero 148 m², Lloji i aktivitetit : Shërbime portuale (mjete shërbimi) afatin i përdorimit të sheshit 1 vit. PAGESA në lekë 4 lekë/ditë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap me nenqira sendin apo të kaloj kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”.

Kërkesa nga ky subjekt është me nr. 201 prot, datë 19.01.2018, ku ndër të tjera është cituar “Shoqëria jonë ka importuar nga Italia një skaf anije (peshkatore) me qëllim kompletimin e saj për gjueti. Ky skaf ka nevojë për t’u transportuar dhe për t’u kryer punimet e kompletimit në zonën e kalatës 0. Gjatësia e këtij skafi është 23 m dhe gjerësi 6.3 m. Lutemi na krijoni mundësinë për të realizuar duke na vënë në dispozicion dhe një autovinc për ulje ngritje dhe një mjet transporti për transportimin nga vendi ku do të lidhet anija “F..” deri në kalatën 0, kërkesë e bërë më datë 10.01.2018. Planimetria e hartuar nga: N. S. inspektor i sektorit të administrimit të teritorit dhe ambjenteve. Hartuar nga ing. K. G., miratuar nga G. A. me detyrë Përgjegjës Sektorit të Administrimit të Territorit dhe Ambjenteve.

Me njoftim të datës 02.07.2018 drejtuar Kapitenerisë së Portit Durrës, B. T. në emër të shoqërisë “A.”, njofton se do të ulë në basenin e Portit Durrës, mjetin i cili është në proces ndërtimi dhe kompletimi, për t’u transferuar në bankinën e peshkimit të vjetër brenda portit.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Shoqërisë “A.” i përfaqësuar nga B. T., është lidhur kontratë qiraje me nr. 2789 prot, datë 02.07.2018 për vinçin portual mobile me mekanizator Y. T.. Objekti i kontratës: Qiradhënie e pajisjeve (mjeteve, mekanizma). Mjeti MHC vinc portual mobile, mekanizatori Y. T.. Malli i përpunuar: Shkarkim anije peshkimi nga toka në det. Afati i kontratës: 1 orë pune nga ora 14 deri në orën 15.00, datë 28.06.2018. tarifa për orë pune 29.792 pa TVSH.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “R..” shpk të përfaqësuar nga A. Sh. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.1368 prot, datë 30.03.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallrave gjenerale, sipas librit të tarifave referuese, sipërfaqja 200 m². Vendodhja: Pranë pontilit dhe ish-kantjerit, lloji i aktivitetit shërbim portuale (mjete shërbimi). Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar “Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap me nenqira sendin apo t’ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit”. Planimetria e hartuar nga ing. A.L. dhe ing. K P.. Planvendosja: Punoi ing. K. G..

Nga verifikimi u konstatua se në këtë ambjet kryhet riparim anije (fotografitë e firmosura nga verifikimi në vendriparimet).

Ky aktivitet (riparimi i anijeve) është aktivitet i cili nuk është përcaktuar në kluadrin ligjor dhe rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Vendosja e skafeve ne magazine nr. 5.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “E..” shpk të përfaqësuar nga R. R. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.2159/1 prot, datë 21.05.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallra gjenerale, sipas tarifave me të dhënat referuese, sipërfaqja 200 m². Vendodhja: Terminali Perendimor (mbrapa magazinës 4+5). Lloji i aktivitetit: Manipulim i ngarkesave në sheshe depozitimi. Afati kohor i kontratës 21.05.2018 (jo më shumë se një vit kalendarik), pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh. Plan vendosja: Punoi ing. E. J., përcaktoi sipërfaqen në terren K. O. me detyrë Përgjegjësi i



Terminalit Perëndimor, miratoi sipërfaqen për qiradhënie I. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Operacionale.

Kontrata është lidhur referuar kërkesës me nr. 2159 prot, datë 18.05.2018 të shoqërisë “E..” shpk , për lidhje kontrate sheshë 200 m² me qira, objekti i kërkesës është “.....si dhe nisur nga kërkesat që kemi nga subjektet që operojnë në Portin e Durrësit për kryerjen e manipulimit të ngarkesave në sheshe e depozitimitb teritorit të APD-së”.

Me e-mailin e datës 21.05.2018 ora 11.35 AM, I. H. drejtuar K. O., dhe në CC L. K. shprehet në mënyrë eksplicite se “ Përshëndetje, Kryeni procedurën sipas kërkesës së kompanisë stivadore”.

Me e-mailin e datës 18.05.2018 ora 7.04 AM, I. H. drejtuar K. O., dhe në CC L. K.. Subject FË nr.2159,datë 18.05.2018 “E..”, kërkesë, ku shprehet në mënyrë eksplicite se “Për ndjekje”, Kryeni procedurën sipas kërkesës së kompanisë stivadore.

Më datën 20.06.2018 grupi i auditimit konstaton se në magazinën 5 ishin vendosur 5 skafe.

Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorit të FSPDS ti vinte në dispozicion fotot (pamjet), se kur ishin vendosur vendosur keto skafe, i cili tregoj të gjithë gadishmërinë dhe vullnetin për vënien në dispozicion, duke ngarkuar me këtë detyrë A. K. në cilësinë e specialistit të IT të FSPD. Për arsye teknike, keto nuk u bë e mundur dhenia e informacionit.

Vendosja e skafeve është kryer në kundërshtim me kontratën e lidhur nr. 362 prot, date 31.05.2005 me shoqërinë “E..” shpk dhe licencën si shoqëri stivadore, ku në nenin 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Operatori merr përsipër të bëjë shërbimet e ngarkim shkarkimit të anijeve në Portin e Durrësit për mallra gjenerale dhe rifuzo (vetëm drithëra), në sheshet e magazinimit dhe magazinat... ”.*

Në opinionin e grupit të auditimit

Kompanitë stivadore marrin me qera magazinat transit, sheshet tranzit brenda Zonës Operacionale të Terminalit, për të kryer shërbimet e operacioneve që kanë lidhje me mallin që ngarkohet dhe shkarkohet nga anija. Ndërsa sheshe depozitimi, përdoren për depozitim të mineraleve në Terminalin Lindor.

Terminali nuk i ofron kompanive stivadore shërbime për të tretë, por vetëm për mallra që përpunohen me procesin e ngarkim shkarkimit të anijeve.

Ky aktivitet (parkimi i skafeve) është aktivitet i cili nuk është për caktuar në kluadrin ligjor dhe rregulltor të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e portit.

Në përgjigje të observacionit me nr.3331/3 prot, datë 01.08.2018 (protokol APD) nr.3331/4 prot, datë 02.08.2018 (protokol APD) në lidhje me procesverbalin nr. 10, datë 27.07.2018, si dhe me nr. 3476/1 prot, datë 10.09.2018 (protokol APD), protokolluar në KLSH me nr.579/4 datë 12.09.2018 për projekt raportin e auditimit të bërë nga A. B. me detyrë drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe G. A. me detyrë përgjegjës i sektorit të administrimit të territorit dhe ambjentëve, ju sqarohet se keni paraqitur pjesërisht prova dhe fakte të reja, të argumentuara ligjërisht dhe të shoqëruara me dokumentacion vërtetues, për pasojë janë marrë pjesërisht në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Konkretisht, pretendimi se, APD ka një liber tarifash të miratuar nga Ministria e Transporteve dhe e Financave, ku për shërbime të ndryshme ka tarifa të ndryshme të miratuara. Kështu dhe kontratat e qirave të lidhura me subjektet e mesiperme, janë lidhur mbi bazën e kërkesës së subjekteve dhe shërbimit të kërkuar duke aplikuar tarifën e miratuara.

Per sa kohë që kemi tarifa të ndryshme të miratuara për shërbime të ndryshme, APD është e detyruar të përgjigjet kërkesave të subjekteve që operojnë ose kanë lidhje me aktivitetin e tyre



me portin, ndryshe ne librin e tarifave duhet te kishim dy tarifat e miratuara; nje per siperfaqe sheshi deri 200 m², dhe nje per siperfaqe sheshi mbi 200 m², per rastet e procedurave per konkurim, eshte konsideruar i drejt.

10. Respektimi i dispozitave ligjore në lidhjen dhe zbatimin e kontratave me subjektet private që operojnë në port, si dhe zbatimi i tarifave përkatëse.

1. Titulli i gjetjes. Kryerje aktivitet (shërbimi) i cili ka të bëjë me mbushjen dhe zbrazjen e kontenierëve me tarifën 120 euro/kontenier 20 FEET dhe 150 euro/kontenier për kontenierin 40 FEET, i cili nuk është përcaktuar në Marrëveshjen Konçensionare dhe në Librin e Tarifave të APD-së.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit arkivor elektronik në lidhje me korrespondencën e ndërsjelltë ndërmjet kompanisë konçensionare “D..” dhe APD, dokumentacion i cili u vu në dispozicion nga APD-ja edhe në format shkresor (i zbardhur), u konstatua se nga kompania konçensionare “D..”, kryhet aktivitet (shërbim) i cili ka të bëjë me mbushjen dhe zbrazjen e kontenierëve me tarifën 120 euro/kontenier 20 FEET dhe 150 euro/kontenier 40 FEET, i cili nuk është përcaktuar në kontratën konçensionare dhe në Librin e Tarifave të APD-së, si dhe duke mos deklaruar në APD të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet, me pasojë jo vetëm mos zbatimin e marrëveshjes, por duke mos derdhur dhe detyrimin që rrjedh nga kryerja e këtij aktiviteti (shërbim për llogari të APD-së dhe Ministrisë) vlerë e cila përbëhet nga 21% që i takon APD-së dhe 2% Ministrisë. Konkretisht për periudhën 01.05-15.07.2018 nga konçensionari janë përpunuar 3548 kontenierë 20 FEET dhe 3286 kontenierë 40 FEET, pra në total 6834 kontinier.

Në observacion është paraqitur si dokument justifikues edhe shkresa Konçensionarit “D..” nr. 150 prot, datë 28.08.2018, protokolluar në APD me nr. 3508/2 prot, datë 28.08.2018. Referuar kësaj shkrese numri i kontinierëve që janë përfshirë në procesin e mbushjes/zbrazjes është 334, nga këto 38 kontinierë 20 FEET dhe 296 kontinierë 40 FEET.

Referuar këtij raportimi (deklarimi), nëse llogariten të ardhurat përfituara nga ky proces shkojnë afërisht në vlerën 7,396,289 lekë x 0,23 (21 përqin APD dhe 2 përqind Minsitria) = 1,701,146 lekë, **vlerë e cila është absolutisht e pabesueshme për tu marrë në konsideratë për arsyë se:**

1. Numri i kontinierëve të përpunuar referuar shkresës së “D..” me nr. 150 prot, datë 28.08.2018, protokolluar në APD me nr. 3508/2 prot, datë 28.08.2018, është bërë në mënyrë të njëanshme nga konçensionari mbi bazën e vetëdeklarimit, pra nuk ka rakordim nëpërmjet pranimit siç i raporton konçensionari, rikontrollit apo regjistrimit të çdo formulari për çdo turn/ditë, nga ana e Autoritetit Portual Durrës. Për pasojë konçensionari dhe APD kanë vepruar në kundërshtim me protokollin e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të terminalit të konteinereve në Portin e Durrësit, me nr. 456 prot, datë 06.02.2013, dhe nr. 456/1, datë 07.02.2013, anekseve 4, dhe 6, “Formulareve të raportimit “bashkëlidhur të cilët përfaqësojnë mënyrën e raportimit të aktivitetit të terminalit: Modeli: DSHO-SK-7/3, DSHO-SK-7/4, DSHO-SK-7/5, DSHO-SK-0/9, DSHO-SK-10, evidence ditore e shërbimit të energjisë elektrike dhe konteinereve frigoriferike.

Si dhe

- Përqindja shumë e vogël e kontinierëve të deklaruar si mësipër 334 kontenierë ose 4.8% e kontinierëve të përpunuar. Konkretisht për periudhën 01.05-15.07.2018 nga konçensionari janë përfshirë në këtë proces 3548 kontenier 20 FEET dhe 3286 kontenier 40 FEET, shuma totale 6834 kontinierë (334 : 6834 =4.8%).



2. Të dhënat mbi volumet e punës dhe të shërbimeve mbështetese, *janë tregues të njëanshëm*, vetëm nga koncensionari “D..”, dhe si të tilla ato janë marrë të mirëqena, dhe mbi këto të dhëna të sjella nga koncensionari firmosen akt rakordimet në fund të muajit. Pra akt rakordimet mujore të nënshkuara mes Koncensionarit dhe Njësisë së Monitorimit në bazë të marreveshjes me nr. 456/1, datë 07.02.2013, për të gjitha volumet e punës të shprehura këto në vlera, merren të mirëqena, siç i deklaroi Koncensionari, pa u monitoruar nga APD.

3. Koncensionari “D..” nuk raportoi mbi aktivitetin në terminal për çdo turn të ditës për tre turne në ditë, por në përfundim të proceseve të ngarkim shkarkimit të anijeve, me mbarimin e përpunimit të Anijes, veprime këto në kundërshtim me pikën e) “Shkëmbimi i informacionit” i protokollit të dorëzimit me nr. 456, datë 06.02.2013 “Protokollit i dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të terminalit konteniervë në portin e Durrësit” “.....D. pranon dhe me anë të kësaj është dakort që informacioni përfshirë formularët dhe dokumentat përkatëse sipas aneksit 6 por dhe çdo dokument shtesë i nevojshëm do të dorëzohet APD-së, për çdo turn të ditës në tre turne në ditë... ”.

4. Mos zbatim i kushteve të kontratës koncensionare në lidhje me pikën 12.1.7 “Sistemi dhe rrjeti kompjuterik”. Mungesa e marrjes së informacionit on-line, për çdo hyrje-dalje konteniervë, nga Koncensionari tek Njësia e Monitorimit, implementimi i një sistemi dhe rrjeti kompjuterik, e bën të pamundur monitorimin e kësaj kontrate për një administrim sa më të mirë të vlerave monetare, detyrim ky i bazuar në pikën 12.1.7 “Sistemi dhe rrjeti kompjuterik”, i kontratës së koncensionit datë 22.06.2011.

5. Observacioni për projekt raportin ka sjellë një fakt shumë domethënës kur shpreheni se: *“Ofrimi i shërbimeve të mbushje/zbrasjes së kontinjerve në terminalin e konteinereve (D..), është shërbim i cili është kryer nga momenti i dhënies me koncesion të terminalit, në mënyrë të pa ligjshme nga APD dhe Autoriteti Kontraktor.*

Sot APD, nën drejtimin tim si titullar ka marrë masa për të ndaluar këtë operacion deri në momentin që operacioni i mbushje/zbrasjes së konteinereve të rregullohet brenda kuadrit ligjor”. Referuar këtij fakti grupit të auditimit nuk i janë vënë të dhëna në dispozicion për datën e fillimit të procesit të zbrasjes dhe mbushjes së kontinjerve dhe numrin respektiv të tyre, për të bërë llogaritjet përkatëse për dëmin ekonomik shkaktuar APD dhe Buxhetit të Shtetit.

6. Mos zbatimi nga koncensionari (D..) i shkresës nr. 2044/1 prot, datë 11.05.2018 të dërguar nga ana e Juaj, e cila ka të bëjë me fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrasjes së kontinjerve, ku përveç të tjerave është shprehur në mënyrë eksplicite se: *“.....Në lidhje me faturimin e këtij shërbimit do të shtoja se ai do të kryhet me vlerën e përcaktuar nga tarifat të cilat do të vendosen nga mbledhja e Këshillit Drejtues, ndërsa evidencat për rakordimet të nisnin që nga dita e sotme që ky shërbim do të ofrohet”*. Pra nuk ka evidencë dhe rakordime siç ju keni kërkuar. Në opinionin e grupit të auditimit, shkresat dërguar nga APD për D.. me nr. 2044/1 prot, datë 11.05.2018 dhe nr. 3508/1 prot, datë 24.08.2018 dhe shkresa dërguar nga D.. për APD me nr. 150 prot, datë 28.08.2018, protokolluar në APD me nr. 3508/2 prot, datë 28.08.2018, janë në kundërshtim me:

-Kontratën Koncensionare të lidhur datë 26.06.2011 midis D..-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

-Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual” nenin 20, “Përgjegjësia e Drejtorit Ekzekutiv dhe Marrëdhëniet me Nënpunësit”.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010” Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4, pika 9 “Përgjegjshmëria Menaxheriale”, Kreu II “Përgjegjshmëria Menaxheriale”, neni 8 “Përgjegjshmëria Menaxheriale e Titullarit”.



- Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

- VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”
-Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e Normës së Interesit, Limitet e Debisë dhe Afatit të Pagesës në APD”.

Për sa më sipër, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë të grupit të auditimit, mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin ka ushtruar aktivitetin Kompania “D. K. Sh. & G. L. I. & M.” s.p.a (D..) në zbatim të Kontratës së Koncensionit, datë 22.06.2011, miratuar me VKM nr. 532, dt.13.07.2011, amenduar me kontratën dt. 24.09.2012, të miratuar me VKM nr. 665, datë 26.09.2012, grupi i auditimit nuk mund të japë opinion për vlerën monetare të të ardhurave të munguara në dëm të APD dhe Buxhetit të Shtetit, për procesin e mbushjes/zbrazjes së kontinjerëve nga kompania D..., ***pra grupi i auditimit refuzon dhënien e opinionit.***

Kriteri: Ligji nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, Vendimi i Këshillit drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit të pagesës në APD” dhe Kontrata Koncensionare e lidhur datë 26.06.2011 midis D..-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot MIE).

Shkaku: Drejtori i Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri), ka autorizura dhe lejuar të kryhet aktivitet (shërbim) jashtë kontraktor nga kompania koncensionare “D..”, i cili ka të bëjë me mbushjen dhe zbrazjen e kontenierëve me tarifën 120 euro/kontenier për kontinjerët 20 FEET dhe 150 euro/ kontenier për kontinjerët 40 FEET, i cili nuk është përcaktuar në librin e tarifave të APD-së, si dhe duke mos deklaruar në APD të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet, me pasojë jo vetëm mos zbatimin e marrëveshjes, por duke mos derdhur dhe detyrimin që rrjedh nga kryerja e këtij aktiviteti.

Rëndësia: I Lartë

Rekomandimi:

- Nga Këshilli Drejtues të analizohet autorizimi, lejimi dhe ndalimi i kryerjes së aktivitetit (shërbimit), jashtë kontraktor nga kompania koncensionare “D..”, i cili ka të bëjë me mbushjen dhe zbrazjen e kontenierëve me tarifën 120 euro/kontenier për kontinjerët 20 FEET dhe 150 euro/kontenier për kontinjerët 40 FEET, i cili nuk është përcaktuar në kontratën koncensionare dhe në librin e tarifave të APD-së, në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e Portit, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës disiplinor.

- Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrin masa për të negociuar me koncensionarin “D..”, me qëllimin e rikuperimit të ardhurave të munguara nga procesi i mbushjes dhe zbrazjes së kontenierëve 20 dhe 40 FEET, për periudhën që është ushtruar ky aktivitet, konform tarifave të vendosura sipas procedurave ligjore.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

-Kryerje aktivitet (shërbim) i cili ka të bëjë me mbushjen dhe zbrazjen e kontenierëve me tarifën 120 euro/kontenier për kontenierët 20 FEET dhe 150 euro/kontenier për kontenierët 40 FEET, i cili nuk është përcaktuar Marrëveshja Koncensionare dhe në Librin e Tarifave të APD-së.

Nga auditimi i dokumentacionit arkivor elektronik në lidhje me korrrespondencën e ndërsjelltë ndërmjet kompanisë koncensionare “D..” dhe APD, dokumentacion i cili u vu në dispozicion



nga APD-ja edhe në format shkresor (i zbardhur), u konstatua se nga kompania konçensionare “D.”, kryhet aktivitet (shërbim) i cili ka të bëjë me mbushjen dhe zbrazjen e kontenierëve me tarifën 120 euro/kontenier 20 FEET dhe 150 euro/ kontenier 40 FEET, i cili nuk është përcaktuar kontratën konçensionare dhe në Librin e Tarifave të APD-së, si dhe duke mos deklaruar në APD të ardhurat e përfituara nga ky aktivitet, me pasojë jo vetëm mos zbatimin e marrëveshjes, por duke mos derdhur dhe detyrimin që rrjedh nga kryerja e këtij aktiviteti (shërbim për llogari të APD-së dhe Ministrisë) vlerë e cila përbëhet 21 % i takon APD-së dhe 2 % Ministrisë. Konkretisht për periudhën 01.05-15.07.2018 nga konçensionari janë përpunuar në 3548 kontenier 20 FEET dhe 3286 kontenier 40 FEET, shuma 6834 kontinjer.

Në observacionn është paraqitur si dokument justifikues edhe shkresa D.. nr. 150 prot, datë 28.08.2018, protokolluar në APD me nr. 3508/2 prot, datë 28.08.2018. Referuar kësaj shkrese numri i kontinjerëve që i janë përfshirë në procesin e mbushjes/zbrazjes është 334, nga këto 38 kontinjer 20 FEET dhe 296 kontinjer 40 FEET.

Referuar këtij raportimi (deklarimi), po të llogariten të ardhurat përfituara nga ky proces shkojnë afërisht në vlerën 7,396,289 lekë x 0,23 (21 përqin APD dhe 2 përqind Minsitria) = 1,701,146 lekë, **vlerë e cila është absolutisht e pa besueshme për tu marrë në konsideratë për arsyse se:**

-1.Numri i kontinjerëve të përpunuar referuar shkresës së “D.” me nr. 150 prot, datë 28.08.2018, protokolluar në APD me nr. 3508/2 prot, datë 28.08.2018, është bërë në mënyrë të njëanshme nga konçensionari mbi bazën e vetdeklarimit, pra nuk ka rakordim nëpërmjet pranimit siç i raporton konçensionari, rikontrollit apo regjistrimit të çdo formulari për çdo turn/ ditë, nga ana e Autoritetit Portual Durrës. Për pasojë konçensionari dhe APD kanë vepruar në kundërshtim me protokollin e dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të terminalit të konteinereve në Portin e Durrësit, me nr. 456, datë 06.02.2013, dhe nr. 456/1, datë 07.02.2013, anekseve 4, dhe 6, “Formulareve të raportimit “bashkellidhur të cilet përfaqesojnë menyren e raportimit të aktivitetit të terminalit: Modeli:DSHO-SK-7/3, DSHO-SK-7/4, DSHO-SK-7/5, DSHO-SK-0/9, DSHO-SK-10, evidence ditore e shërbimit të energjisë elektrike dhe konteinereve frigoriferike.

Si dhe

- Përqindja shume e vogël e kontinjerve të deklaraur si mësipër 334 kontinjer ose 4.8 % e kontinjerëve të përpunuar. Konkretisht për periudhën 01.05-15.07.2018 nga konçensionari janë përfshirë në këtë proces 3548 kontenier 20 FEET dhe 3286 kontenier 40 FEET, shuma totale 6834 kontinjer (334 : 6834 =4.8 %).

-2.Të dhënat mbi volumet e punës dhe të shërbimeve mbështetese, **janë tregues i njëanshëm**, vetëm nga konçensionari “D.”, dhe si të tilla ato janë marrë të mirëqena, dhe mbi këto të dhëna të sjella nga konçensionari firmosen akt rakordimet në fund të muajit. Pra akt rakordimet mujore të nënshkuara mes Konçensionarit dhe Njesisë së Monitorimit në bazë të marreveshjes me nr. 456/1, datë 07.02.2013, për të gjitha volumet e punës të shprehura këto në vlera, merren të mirëqena, siç i deklaroi Konçensionari, pa u monitoruar nga APD.

-3. Konçensionari “D.” nuk raporton mbi aktivitetin në terminal për çdo turn të dites për tre turne në ditë, por në perfundim të proceseve ngarkim shkarkimit të anijeve, me mbarimin e përpunimit të Anijes, veprime këto në kundërshtim me pikën e, “Shkëmbimi i informacionit’ i protokollit të dorëzimit me nr. 456, date 06.02.2013”Protokol i dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të terminalit konteinerve në portin e Durrësit”.....D. pranon dhe me anë të kësaj



është dakort që informacioni përfshirë formularet dhe dokumentat përkatëse sipas aneksit 6 por dhe çdo dokument shitesë i nevojshëm do të dorëzohet APD-së, për çdo turn të ditës në tre turne në ditë...

4. Mos zbatim i kushteve të kontratës koncensionare në lidhje me piken 12.1.7 “Sistemi dhe rrjeti kompjuterik”. Mungesa e marrjes së informacionit on-line, për çdo hyrje, dalje konteneri, nga Koncensionari tek Njësia e Monitorimit, implementimi i një sistemi dhe rrjeti kompjuterik, e bën të pamundur monitorimin e kësaj kontrate për një administrim sa më të mirë të vlerave monetare, detyrim ky i bazuar në piken 12.1.7 “Sistemi dhe rrjeti kompjuterik”, i kontratës së koncensionit datë 22.06.2011.

5. Observacioni i juaj për projekt raportin ka sjell një fakt shumë domethënës kur shpreheni se “Ofrimi i shërbimeve të mbushje/zbrasjes së konteinereve në terminalin e konteinereve (D.), është shërbim i cili është kryer nga momenti i dhenies me koncesion të terminalit, në mënyrë të pa ligjshme nga APD dhe Autoriteti Kontraktor.

Sot APD, nën drejtimin tim si titullar ka marrë masa për të ndaluar këto operacione deri në momentin që operacioni i mbushje/zbrasjes së konteinereve të rregullohet brenda kuadrit ligjor”. Referuar këtij fakti grupi i auditimit nuk i janë dhënë të dhëna në dispozicion për datën e fillimit të procesit të zbrastjes dhe mbushjes së kontinjereve dhe numrin respektiv të tyre, për të bërë llogaritjet përkatëse për demin ekonomik shkaktuar APD dhe Buxhetit të Shtetit.

6. Mos zbatimi nga koncensionari (D.) i shkresës nr. 2044/1 prot, datë 11.05.2018 të dërguar nga ana e Juaj, e cila ka të bëjë me fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrastjes së kontinjerve ku përveç të tjerave është shprehur në mënyrë eksplicite se “.....Në lidhje me faturimin e këtij shërbimit do të shtojë se ai do të kryhet me vlerën e përcaktuar nga tarifët të cilat do të vendosen nga mbledhja e Këshillit Drejtues, ndërsa evidencat për rakordimet të nisur që nga dita e sotme që ky shërbim do të ofrohet”. Pra nuk ka evidencat dhe rakordimet sic ju keni kërkuar. Në opinionin e grupit të auditimit, shkresat dërguar nga APD për D. me nr. 2044/1 prot, datë 11.05.2018 dhe nr. 3508/1 prot, datë 24.08.2018 dhe shkresa dërguar nga D. për APD me nr. 150 prot, datë 28.08.2018, protokolluar në APD me nr. 3508/2 prot, datë 28.08.2018, janë në kundërshtim me kontratën Koncensionare të lidhur datë 26.06.2011 midis D.-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Korrespondenca shkresore e kryer në funksion të këtij procesi.

Koncensionari D., me shkresën nr. 84 prot, datë 24.04.2018 prot i APD nr. 1716, datë 24.04.2018 “Në lidhje me tarifën e mbushjes dhe zbrastjes së konteinereve me mallra gjenerale”, i drejtohet APD-së duke kërkuar miratimin e tarifës së propozuar nga vetë koncensionari D. -120 euro.

Mbi këtë shkresë A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm urdhëron D. A., me detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomisë, Financës dhe Administrimit për lejimin e këtij aktiviteti (shërbimi) duke u shprehur në mënyrë eksplicite se “data 24.04.2018, Z. A., Të shikohet dhe veprohet shpejt mos pengohet biznesi”.

Koncensionari D., me shkresën nr.92 prot, datë 02.05.2018 prot i APD nr. 1931, datë 03.05.2018 “Propozim për tarifët e mbushjes dhe zbrastjes së konteinereve dhe për tarifën e konteinereve me lëndë të rrezikshme”, i drejtohet APD-së duke kërkuar miratimin e tarifës së propozuar nga vetë koncensionari D. -120 euro për konteinertë 20 FEET dhe 150 euro për konteinertë 40 FEET.

Mbi këtë shkresë A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm urdhëron D. A., me Detyrë Drejtor i Drejtorisë Ekonomisë, Financës dhe Administrimit për lejimin e këtij aktiviteti (shërbimi) duke u shprehur në mënyrë eksplicite se “data 03.05.2018, Z. A., Të mbyllet çmimet e tarifave dhe ti fusim në Këshillin Drejtues.”



Konçensionari D., me shkresën nr.97 prot, datë 09.05.2018 prot i APD nr. 2044, datë 09.05.2018 "Në lidhje me fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontenierëve", i drejtohet APD-së duke i kërkuar të japë miratimin e shërbimit të kërkuar me shkresën nr.92 prot, datë 02.05.2018 prot i APD nr. 1931, date 03.05.2018, duke u shprehur në mënyrë eksplicite se " *Kërkojmë që APD të jap miratimin për fillimin e ofrimit të këtij shërbimi nga D.-ja sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të shmagem rrezikshmërinë e futjes në terminal të personave të pa autorizuar në mënyrë që të ardhurat e këtij shërbimi të grumbullohen nga D.-ja dhe APD-ja "si tarifë konçensionare, sipas tarifave të propozuara nga ne..."*

Mbi këtë shkresë A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm *tërheq vëmendjen* D. A., me Detyrë Drejtor i Drejtorise Ekonomisë, Financës dhe Administrimit duke u shprehur në mënyrë eksplicite se "*Data 09.05.2018; Z. A.*".

Shkresa e APD-së, drejtuar konçensionarit D.,

Me shkresën nr. 2044/1, date 11.05.2018" Në përgjigje të shkresës tuaj me nr. 97, date 09.05.2018", Në lidhje me fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontenierëve", Drejtori i Përgjithshëm u drejtohet: M. Y., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm "Terminalit të Kontenierëve"

Për dijeni

- D. A. – Drejtor i Drejtorise Ekonomisë, Financës dhe Administrimit

- S. S. – Drejtor i Drejtorise së FSPD-së, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se;

Ju bëjë me dije se : Për shmangien e incidenteteve në kryerjen e këtij shërbimi të personave ose subjekteve që nuk janë kualifikuar ose licensuar për kryerjen e këtyre operacioneve, ose subjekteve që nuk janë të kualifikuar ose të licensuar për kryerjen e këtyre operacioneve, si dhe në mënyrë që këto të ardhura mund të përfitohen nga APD-ja, sipas marrëveshjes konçensionare, **jap miratimin për fillimin e ofrimit të këtij shërbimi.** Marrjen e masave nga forcat e sigurisë për mos lejimin e personave ose subjekteve jo të specializuar dhe të licensuar që pretendojnë të bëjnë këtë shërbim. Në lidhje me faturimin e këtij shërbimi do të shtoja se ai do të kryhet me vlerën e përcaktuar nga tarifat të cilat do të vendosen nga mbledhja e Këshillit Drejtues, ndërsa evidencat për rakordimet të nisin që nga dita e sotme që ky shërbim do të ofrohet.

Pra ky aktivitet është urdhëruar të kryhet nga A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri).

Konçensionari D., me shkresën nr.101 prot, datë 23.05.2018 prot i APD nr. 2287, datë 24.05.2018 "Kërkesë për vendosjen e tarifës së hapjes së kontenierit për marrjen e mostrave", i drejtohet APD-së duke kërkuar miratimin e tarifës së propozuar nga vetë konçensionari 40 euro për shërbimin e hapjes së kontenierëve për marrjen e mostrave të jetë 40 euro/konteiner. Në mënyrë eksplicite në këtë shkresë është shprehur se"

Në vijimësi të ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, ka lindur nevoja e ofrimit të shërbimit të hapjes së konteinerëve dhe zbrazjes së një pjese të kargos vetëm për marrjen e mostrave për kryerjen e analizave, si përshembull te mishit dhe ushqimeve të tjera. Duke qenë se ky lloj operacioni nuk përfshin të gjithë ciklin e zbrazjes së konteinerit, kostoja e ofrimit të tij është më e ulët dhe si rrjedhojë edhe tarifa e këtij shërbimi duhet të jetë më e ulët.

Sigurisht që ky shërbim ofrohet edhe nga porte të tjera të botës dhe rajonit. Bashkangjitur po ju dërgojmë tarifën e ofruar për këtë shërbim në portin e Rijekës në Kroaci dhe në Portin e Barit në Mal të Zi. Tarifa e këtij shërbimi në Rijeka është 58 euro/ konteiner dhe në Portin e Barit është 55 euro/ konteiner.



D. sipas një analize kostoje që ka bërë (bashkëgjatur), propozon që tarifa për shërbimin e hapjes së konteinerëve për marrjen e mostrave të jetë 40 euro/ konteiner.

Mbi këtë shkresë A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm vë në dijeni D. A., me Detyrë Drejtor i Drejtorise Ekonomisë, Financës dhe Administrimit duke u shprehur në mënyrë eksplicite se “data 26.05.2018, Z A.”

Me shkresën nr. 2287/1, date 30.05.2018” Në përgjigje të shkresës tuaj me nr.101, date 14.05.2018”, Në lidhje me tarifën e hapjes së konteinerëve për marrjen e mostrave”, Drejtori i Përgjithshëm u drejtohet: M. Y., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm “Terminali i Kontenierëve”, duke sqaruar se;

“Kërkesës tuaj për shërbimin e hapjes së konteinerëve dhe zbrazjes së një pjese të kargos vetëm për marrjen e mostrave për kryerjen e analizave do të shqyrtohet nga grupi i punës i tarifave.

Në lidhje me faturimin e këtij shërbimi do të shtoja se ai do të kryhet me vlerën e përcaktuar nga tarifat të cilat do të vendoset nga mbledhja e Këshillit Drejtues. Po e cilësor dhe një herë pasi në asnjë rast nuk duhet të aplikohen tarifa shërbimesh të pa miratuara dhe rrjedhimisht të pa botuara në Librin e Tarifave”

Me shkresën nr. 597 prot, datë 26.06.2018 drejtuar A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe për dijeni E. J. me Detyrë Drejtor Juridik me lëndë “Informacion mbi operacionet për mbushjen dhe zbrazjen e konteinerëve nga shoqëria koncensionare D., E. M. në cilësinë e Përgjegjësit të Sektorit Operacional, pasi jep argumentimin e mos respektimit të Kontratës Koncensionare nga D. respektivisht në nenin 2, pika 2.1, pika 2.3, neni 8, pika 8.3, si dhe aneksi 6 “Tarifat e shërbimeve portuale, kapitulli 2, pika 3.12, në pikat 2i,ii,iii dhe 3,I,ii,iii shprehet në mënyrë eksplicite se “ ... në përfundim sa më sipër, ushtrimi i operacioneve të mbushjes dhe zbrazjes së konteinerëve, si dhe aplikimi i një tarife nga ana e shoqërisë koncensionare për këto të fundit, në situatën kur nuk është miratuar nga instancat përkatëse dhe nuk është publikuar zyrtarisht në librin e tarifave portuale, konsiderohet i jashtëligjshëm, deri në momentin e plotësimit të kësaj procedure”.

E-maili i dërguar nga Xh. F., datë 26.06.2018, ora 2.29 PM, drejtuar E. J. me detyrë Drejtor Juridik, me subjekt shkresa nr. 597 prot, datë 26.06.2018.

E-maili i dërguar nga E. J., datë 26.06.2018, ora 3.47 PM, drejtuar A. B. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, për dijeni P. Ç., D. A., me subjekt shkresa nr.597 prot, datë 26.06.2018, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se ” *Përsëritje z, drejtor, Nisur nga relacioni i sektorit të monitorimit të kontratave koncensionare, po ju informoj që operacioni i mbushje/zbrazjes së konteinerëve nga D. vazhdon të kryhet. Gjithashtu koncensionari aplikon tarifën 120 euro dhe 150 euro për konteiner në kundërshtim me shkresën e dërguar nga ana e juaj me nr. 2287/1, date 30.05.2018. Jam i mendimit që D.-se duhet ti dërgohet një shkresë ku ti kërkohet në mënyrë urgjente ndalimi i kryerjes së këtij shërbimi deri në momentin e miratimit të tarifës portuale sipas legjislacionit në fuqi”.*

E-maili i dërguar nga D. G., datë 28.06.2018, ora 3.43 PM, drejtuar E. M. dhe për dijeni E. J. me detyrë Drejtor Juridik, me subjekt akt konstatim D..

E-maili i dërguar nga E. J., datë 29.06.2018, ora 9.35 PM, drejtuar A. B. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, për dijeni P. Ç., me subjekt akt konstatim i D.-së datë 28.06.2018, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Përsëritje z, drejtor Po ju përcjell akt konstatimin e mbajtur dje nga inspektorët e monitorimit të kontratave koncensionare në terminalin e kontenierëve. Në zyrën e D. në terminal janë afishuar tarifat që ky koncensionar po vendos ndaj subjekteve për aktivitetin e mbushjes/zbrazjes të konteinerëve. (Bashkëgjatur fotot). Ky fakt është mjaft i rëndë dhe në shkelje të kontratës ndaj operatorëve biles duke i afishuar*



ato, veprim ky haptaz i kundraligjshëm. Kjo është e drejtë ekskluzive e APD-së. Sa më sipër, z drejtor propozoj që të merren masa që ky operacion të ndërpritet menjëherë”.

Me shkresën nr. 3106, datë 16.07.2018” Mbi marrje masash”, Drejtori i Përgjithshëm i drejtohet M. Y., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm “Terminalit të Kontenierëve” Për dijëni:

-P. Ç. në cilësinë e Kryetarit të Njësisë së Zbatimit të Projekteve D., ku është shprehur se ...në vijim ju kërkojmë të ndërpritet ofrimi i këtij shërbimi nga ana e juaj dhe si argument të kësaj kërkesë ka kërkuar zbatimin e nenit 2.5 “Deklarime dhe garancitë e palëve” dhe neni 8 “Çështjet koncensionare” të kontratës koncensionare të lidhur datë 26.06.2011 midis D. dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Në fakt kërkesa për ndërprerje ka ardhur pas 17 ditësh nga kërkesa që ka bërë Drejtor Juridik dhe 21 ditë nga kërkesa që ka bërë Përgjegjësi i Sektorit Operacional.

Si dhe nga informacioni verbal edhe më datë 27.07.2018 (datë në të cilën përfundoi auditimi), ky process ka vazhduar të kryhet.

Për sa trajtua më sipër, në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm për dhënien e një opinionit të plotë dhe të saktë të grupit të auditimit, mbi zbatimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbi të cilin ka ushtruar aktivitetin Kompania “D. K. Sh. & G. L. I. & M.” s.p.a (D.) në zbatim të Kontratës së Koncensionit, datë 22.06.2011, miratuar me VKM nr. 532, dt.13.07.2011, amenduar me kontratën dt. 24.09.2012, të miratuar me VKM nr 665, dt.26.09.2012, grupi i auditimit nuk mund të jap opinion për vlerën monetare në dëm të APD dhe Buxhetit të Shtetit për procesin e mbushjes/zbrazjes së kontinjerëve nga kompania D., pra grupi i auditimit refuzon dhënien e opinionit.

Ky aktivitet është autorizuar dhe lejuar të kryhet nga A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri) në kundërshtim me:

-Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual” nenin 20, “Përgjegjësia e Drejtorit Ekzekutiv dhe Marrëdhëniet me Nënpunësit”.

-Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010” Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4, pika 9 ”Përgjegjshmëria Menaxheriale”, Kreu II “Pergjegjshmëria Menaxheriale”, neni 8 “Përgjegjshmëria Menaxheriale e Titullarit”.

- Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

- VKM nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”- Vendimin e Këshillit Drejtues nr.29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e Normës së Interesit, Limitet e Debisë dhe Afatit të Pagesës në AP

-Kontratën Koncensionare të lidhur datë 26.06.2011 midis D.-së dhe Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër, ngarkon me përgjegjësi A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv.

Sqarim

-Kontinjerët 20 FEET, janë kontinjerët me shumicë që përdoren sot, dhe kanë gjatësi 6 m, gjerësi 2.4 m dhe lartësi 2.6 m. Ndërsa kontinjerët 40 FEET kanë gjatësoi 12 m, gjerësi 2.4 m dhe lartësi 2.6 m.

-Intepretimi i shkresës derguar nga D.. per APD me nr. 150 prot, datë 28.08.2018, protokolluar në APD me nr. 3508/2 prot, datë 28.08.2018 i pasqyruar si më sipër, shërben



edhe per pergjigjen e observacionit te derguar per procesverbalin dhe projektraportin per kete ceshtje.

Dokumentacioni shkresor mbi të cilin është dhënë opinion i grupit të auditimit

Shkresa e konçensionarit D., drejtuar APD-së ,me 84 prot, datë 24.04.2018 prot i APD nr. 1716, date 24.04.2018”Në lidhje me tarifën e mbushjes dhe zbrazjes së konteniervë me mallra gjeneralë”.

-Shkresa nr.92 prot, datë 02.05.2018 prot I APD nr. 1931, date 03.05.2018 ”Propozim për tarifën e mbushjes dhe zbrazjes së konteniervë dhe për tarifën e konteniervë me lëndë të rrezikshme”, 3. Shkresa e konçensionarit D., drejtuar APD-së ,me nr. 2044, datë 09.05.2018 “Në lidhje me fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteniervë”.

- Shkresa nr.97 prot, datë 09.05.2018 prot I APD nr. 2044, datë 09.05.2018 ”Në lidhje me fillin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së konteniervë”,

-Shkresa nr. 2044/1, date 11.05.2018”Në përgjigje të shkresës tuaj me nr.97, datë 09.05.2018”, Në lidhje me fillimin e ofrimit të shërbimit të mbushjes dhe zbrazjes së kontinjervë”

-Shkresa nr.101 prot, datë 23.05.2018 prot I APD nr. 2287, datë 24.05.2018 ”Kërkesë për vendosjen e tarifës së hapjes së konteniervë për marrjen e mostrave”

-Shkresa APD nr. 2287/1, datë 30.05.2018 “Në përgjigje të shkresës tuaj me nr.101, datë 14.05.2018”, Në lidhje me tarifën e hapjes së konteniervë për marrjen e mostrave”.

Shkresa nr.597 prot, datë 26.06.2018 drejtuar A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe për dijeni E. J. me Detyrë Drejtor Juridik me lëndë “Informacion mbi operacionet për mbushjen dhe zbrazjen e konteniervë nga shoqëria koncensionare D..

-E-maili I dërguar nga Xh. F., datë 26.06.2018, ora 2.29 PM, drejtuar E. J. me Detyrë Drejtor Juridik, me subjekt Shkresa nr.597 prot, datë 26.06.2018.

- E-maili I dërguar nga E. J., datë 26.06.2018, ora 3.47 PM, drejtuar A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, për dijeni P. Ç., D. A., me subjekt Shkresa nr.597 prot, datë 26.06.2018.

- E-maili I dërguar nga D. G., datë 28.06.2018, ora 3.43 PM, drejtuar E. M. dhe për dijeni E. J. me Detyrë Drejtor Juridik, me subjekt akt konstatim D..

- E-maili I dërguar nga E. J., datë 29.06.2018, ora 9.35 PM, drejtuar A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, për dijeni P. Ç., me subjekt Akt Konstatim i D. datë 28.06.2018.

Shkresa APD-së nr. 3106, datë 16.07.2018” Mbi marrje masash për ndërprirje shërbimi”.

-Shkresa APD-së nr. 3508/1 prot, datë 24.08.2018 “Kthim përgjigje Mesut Yanar” Kompania D..

-Shkresa D.-së nr. 159, date 28.08.2018 “Përgjigje shkresës suaj me nr. 3508/1 prot, datë 24.08.2018”.

Për pos sa mësipër

Detyrimi që Konçensionarit D. duhet që do të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 32,500,000 USD, deri më datën 27.07.2017 ka investuar 0 lekë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit.

Për këtë situatë, nga APD i është kërkuar informacion zyrtar njësisë së zbatimit të projektit pranë MTI, me shkresat shkresën nr.2362 prot, datë 30.05.2018, e cila nuk ka vënë në dispozicion asnjë lloj informacioni në lidhje me investimet e kryera nga kompania koncensionare D., edhe pse është një detyrim kontraktual.

Deri më datë 27.07.2017, nga APD-ja nuk konfirmohet asnjë investim i kryer prej tyre.

Theksojmë: Referuar observacioneve: Me shkresën nr. 2325, datë 05.06.2018 nga ana e shoqërisë koncensionare është dërguar në APD dokumentacioni tekniko-ligjor, duke listuar të



gjitha investimet e kryera nga kjo kompani për 5 vitet e para të periudhës koncensionare. Për verifikimin e këtyre investimeve drejtori i përgjithshëm ekzekutiv me urdhërat e brendshëm nr. 2602 prot, datë 19.06.2018 dhe nr. 2602/1, datë 11.07.2018 ka ngritur grupin e punës për marrjen në shqyrtim të investimeve të realizuara nga shoqëria. Aktualisht anëtarët e grupit të punës së Urdhërit të sipërcituar janë në progres analizimi, shqyrtimi dhe inspektimi të dokumentacionit përkatës për të vijuar me përpilimin dhe përcjelljen e raportit përmbyllës së këtij Urdhëri i cili do ti përcillet NJZP-së për Shoqërinë Konçesionare D.-së si dhe Autoritetit Kontraktor respektivisht Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Sipas opinionit tonë:

Marrëveshja e datës 26.06.2011 ka dëmtuar interesat e ligjshme të Shtetit dhe ka favorizuar kompaninë “D.” çka përbën jo vetëm shkelje të rëndë të legjislacionit në fuqi, por është dhe një shprehje flagrante e mos zbatimit të ligjit.

Marrëveshja e datës 26.06.2011 me kompanitë koncensionare “D.”, duke mos kryer investimet e përcaktuara në kontratën koncensionare, si dhe duke kryer me arrogancë aktivitet (shërbim) jashtë kontraktor, i palejueshëm si në aspektin legal, procedurial, kontraktual dhe informal, ka dëmtuar interesat e ligjshme të Shtetit si dhe kanë favorizuar këtë kompani, çka përbën jo vetëm shkelje të rëndë të Legjislacionit në Fuqi, por është dhe një shprehje flagrante e mos zbatimit të ligjit.

Në rast mos-kryerjes së investimeve të përcaktuara në marrëveshjet koncensionare, si dhe mos ndërprerjes së aktivitetit jashtë kontraktor, nga APD-ja të merren masa për pezullimin e menjëhershëm të marrëveshjeve koncensionare, deri në kryerjen e investimeve sipas marrëveshjes si dhe ndërprerjes së aktivitetit jashtë kontraktor, e në rast të kundërt të zbatohen procedurat ligjore për sanksionet përkatëse.

Observacioni i bër nga I. H. për proçersverbalin dhe projektraportin për mos përgjegjësinë e tij për çështjen e trajtuar si më sipër është i drejt, për pasoj është marr në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar.

2.Titulli i gjetjes: Vendosja e skafeve ne magazinën nr. 5, është kryer në kundërshtim me kontratën e lidhur nr. 362 prot, date 31.05.2005 me shoqërinë “E.” shpk dhe licencën si shoqëri stivadore, ku në nenin 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Operatori merr përsipër të bëjë shërbimet e ngarkim shkarkimit të anijeve në Portin e Durrësit për mallra gjenerale dhe rifuzo (vetëm drithëra), në sheshet e magazinimit dhe magazinat...*”.

Situata: Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “E.” shpk të përfaqësuar nga R. R. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje e shesheve me nr. 2159/1 prot, datë 21.05.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira e sheshit të hapur të depozitimit për mallra gjenerale, sipas tarifave me të dhënat referuese, sipërfaqja 200 m2. Më datën 20.06.2018 grupi i auditimit konstatoi se në magazinën 5 ishin vendosur 5 skafe.

Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorit të FSPDS të vendoste në dispozicion fotot (pamjet) se kur ishin vendosur vendosur këto skafe, i cili tregoi të gjithë gadishmërinë dhe vullnetin për vënien në dispozicion, duke ngarkuar me këtë detyrë A. K. në cilësinë e specialistit të IT të FSPD. Për arsye teknike, nuk u bë e mundur vendosja e informacionit.

Vendosja e skafeve është kryer në kundërshtim me kontratën e lidhur nr. 362 prot, datë 31.05.2005 me shoqërinë “E.” shpk dhe licencën si shoqëri stivadore, ku në nenin 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Operatori merr përsipër të bëjë shërbimet e ngarkim shkarkimit të anijeve në Portin e Durrësit për mallra gjenerale dhe rifuxho (vetëm drithëra), në sheshet e magazinimit dhe magazinat...*”.



Kriteri: Ligji nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit të pagesës në APD”, Kontrata e lidhur nr. 362 prot, date 31.05.2005 me shoqërinë “E.” shpk dhe licencën e Saj si shoqëri stivadore.

Shkaku: Drejtori të Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri), ka autorizuar dhe ka lejuar të kryhet aktivitetet (vendosja e skafeve në magazinën 5), duke hartuar kontratë formale me shoqërinë “E.” shpk për dhënien me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallra gjenerale, sipas tarifave me të dhënat referuese, sipërfaqja 200 m² dhe në fakt destinacioni ka qenë vendosja e skafeve, i cili nuk është përcaktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e Portit.

Rëndësia: I mesëm

Rekomandimi:

Nga Këshilli Drejtues të analizohet autorizimi dhe lejimi i Drejtorit të Përgjithshëm i kryrjes së aktivitetit (vendosja e skafeve në magazinën 5), në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e Portit, si dhe të merren masa të menjëhershme për ndalimin dhe mos kryerjen e këtij aktivitetit, pa pasur kuadrin e plotë ligjor dhe rregullator.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

-Vendosja e skafeve ne magazine nr.5

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “E.” shpk të përfaqësuar nga R. R. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.2159/1 prot, datë 21.05.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallra gjenerale, sipas tarifave me të dhënat referuese, sipërfaqja 200 m². Vendodhja: Terminali Perendimor (mbrapa magazinës 4+5). Lloji i aktivitetit: Manipulim i ngarkesave në sheshe depozitimi. Afati kohor i kontratës 21.05.2018 (jo më shumë se një vit kalendarik), pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh. Plan vendosja: Punoi ing. E. J., përcaktoi sipërfaqen në terren K. O. me detyrë Përgjegjësi i Terminalit Perendimor, miratoi sipërfaqen për qiradhënie I. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Operacionale.

Kontrata është lidhur referuar kërkesës me nr.2159 prto, datë 18.05.2018 të shoqërisë “E.” shpk, për lidhje kontrate sheshë 200 m² me qira, objekti i kërkesës është “.....si dhe nisur nga kërkesat që kemi nga subjektet që operojnë në Portin e Durrësit për kryerjen e manipulimit të ngarkesave në sheshe e depozitimitb teritorit të APD-së”.

Me e-mailin e datës 21.05.2018 ora 11.35 AM, I. H. drejtuar K. O., dhe në CC L. K. shprehet në mënyrë eksplicite se “Përshëndetje, Kryeni procedurën sipas kërkesës së kompanisë stivadore.

Me e-mailin e datës 18.05.2018 ora 7.04 AM, I. H. drejtuar K. O., dhe në CC L. K.. Subject FW nr. 2159, datë 18.05.2018 “E.”, Kërkesë, ku shprehet në mënyrë eksplicite se “Për ndjekje”, Kryeni procedurën sipas kërkesës së kompanisë stivadore.

Më datën 20.06.2018 grupi i auditimit konstatoj se në magazinën 5 ishin vendosur 5 skafe. Grupi i auditimit i kërkoi Drejtorit të FSPDS ti vinte në dispozicion fotot (pamjet) se kur ishin vendosur vendosur keto skafe, i cili tregoj të gjithë gadishmërinë dhe vullnetin për vënien në dispozicion, duke ngarkuar me këtë detyrë A. K. në cilësinë e specialistit të IT të FSPD.



Per arsye teknike, keto nuk u be e mundur vendosja e informacionit.

Vendosja e skafeve është kryer në kundërshtim me kontratën e lidhur nr.prot 362, date 31.05.2005 me shoqërinë “E.” shpk dhe licencën si shoqëri stivadore, ku në nenin 2 është shprehur në mënyrë eksplicite se “Operatori merr përsipër të bëjë shërbimet e ngarkim shkarkimit të anijeve në Portin e Durrësit për mallra gjenerale dhe rifuzo (vetëm drithëra), në sheshet e magazinimit dhe magazinat...”.

Në opinionin e grupit të auditimit

Kompanitë stivadore marrin me qera magazinat transit, sheshet tranzit brenda Zonës Operacionale te Terminalit, për të kryer shërbimet e operacioneve që kanë lidhje me mallin që ngarkohet dhe shkarkohet nga anija. Ndërsa sheshe depozitimi, përdoren për depozitim e mineraleve në Terminalin Lindor.

Terminali nuk i ofron kompanive stivadore shërbime për të tretë, por vetëm për mallra që përpunohen me procesin e ngarkim shkarkimit të anijeve.

Ky aktivitet (parkimi i skafeve) është aktivitet i cili nuk është për caktuar në kluadrin ligjor dhe rregulltor të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e portit.

Ky aktivitet është autorizuar të kryhet nga A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri).

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, Vendimin e Këshillit drejtues nr.29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit pagesës në APD”.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendur si më sipër, ngarkon me përgjegjësi A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv.

Obsdervacioni i bër nga I. H. për procersverbalin dhe projektraportitn për mos përgjegjësinë e tij për çështjen e trajtuar si më sipër është i drejt, për pasoj është marr në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar.

Titulli i gjetjes: Procesi i shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës, është realizuar nga kompania E.-A. dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë.

Situata Drejtori të Përgjithshëm Ekzekutiv në kundërshtim me marrëveshjen konçensionare, ka autorizuar dhe ka lejuar procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjve të erës nga kompania E.-A. dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij, sipas profilit të mallrave. APD-ja disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjve të erës, duke krijuar një të ardhur të munguar për APD-në dhe Buxhetin e Shtetit ***në vlerën 4,281,902 lekë***. Konkretisht:

Shkarkimi i tubacioneve të mullinjve të erës, është kryer pa licencën e stivadorit, në kundërshtim me pikën 3.1.2.1 “Autoriteti kontraktues merr përsipër dhe bie dakort” të kontratës konçensionare, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se: “Do t’i sigurojë Konçesionarit Lejet, Autorizimet, Liçensat e kërkuara për zbatimin e kësaj kontrate, që janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktues apo APD, me kusht që Konçesionari të ketë plotësuar dhe paraqitur të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor për lëshimin e tyre”.



-Nga mos pajisja me licencën së stivadorit, kompania E.-A. nuk i ka paguar tarifën e ushtrimit të një aktiviteti të tillë, **në vlerën 3,600,000 lekë, vlerë e cila është e ardhur e munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit.**

-E.-A., edhe pse e pa pajisur me licencën e stivadorit, ka vendosur monopol në këtë shërbim, pasi Porti i Durrësit nuk ka zhvilluar një procedurë për të përzgjedhur kompaninë stivadore, pra nuk ka patur një konkurrencë në këtë shërbim, në kundërshtim me Ligjin nr. 9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Autorizimi dhe lejimi i procesit të shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës nga kompania E.-A. dhe jo nga Porti i Durrësit nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv është në kundërshtim me:

-Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Autoriteti Portual”, neni 15 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Këshilli Drejtues i një porti është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual dhe që ushtron të drejtat mbi pronën si “Port administrues i pronës”*”. Neni 20 “Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv dhe marrëdhëniet me nënpunësit”, pika 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Drejtori Ekzekutiv është Menaxheri i Përgjithshëm i Autoritetit Portual dhe vepron sipas autoritetit të deleguar nga Këshilli Drejtues, duke i raportuar drejtpërdrejt atij*”.

-VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij”, neni 9 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual Durrës është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual dhe ushtron të drejtat mbi pronën si “Port administrues i pronës” dhe neni 10 “Përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të nënpunësve”, pika c dh ç, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:*

“c) Të ndjekë hap pas hapi objektivin e kthimit të portit në një “Port Administrues Toke”, zbatimin e legjislacionit për Autoritetin Portual dhe rregullat e këtij statuti;

ç) Të sigurojë përdorimin e mundësive dhe të rrisë shfrytëzimin maksimal të portit, për të plotësuar kërkesat e klientit dhe të tregut”

-Me shkresën e Ministrit E. H. nr.1164/2 prot., datë 23.03.2015 drejtuar Zotit M. M., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë “E.A.”, shkresë e dërguar në përgjigje të shkresës nr. 400 prot, datë 05.02.2015 të dërguar nga S. B. në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv, është shprehur në mënyrë eksplicite se: “*Në vijim të shkresës së APD nr.409, datë 05.02.2015 mbi ndalimin e përpunimit të kontinierëve në terminalin Lindor, ju tërheqim vëmendjen se çdo veprimtari jashtë objektit të kontratës konçensionare përbën shkelje të kontratës konçensionare. Për këtë arsye duke ju referuar konstatimit të ardhur nga APD, ky rast nuk duhet të përsëritet, në të kundërt, Autoriteti Kontraktor do të marrë të gjitha masat e nevojshme për ndalimin e veprimtarive që kryeni në kundërshtim me kontratën konçensionare”*.

Në fakt Porti i Durrësit, është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij sipas profilit të mallrave. APD disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës.

Sipas opinionit tonë: Referuar dokumentacionit të cituar mësipër, grupi i auditimit nuk mund të jap një opinion të plotë dhe të saktë, mbi zbatimin e kuadrit rregullator mbi të cilin ka vepruar Autoriteti Portual Durrës, për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës, si dhe grupi i auditimit shprehet me rezervë për saktësinë dhe vërtetësinë e **vlerës 4,281,902 lekë** (vlerë e cila në këto kushte vlerësohet si e ardhur e munguar për llogari



të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit), si dhe përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, të: Autoritetit Portual Durrës, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer mospërbushjen të rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave të ligjshme të APD dhe të Shtetit dhe në veçanti nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv A. B..

Vlera 4,281,902 lekë përbën të ardhur e munguar për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit.

Kriteri: Ligji nr.9130, datë 08.09.2003 “Autoriteti Portual”, neni 15 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1, VKM nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij” neni 9 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1, shkresa e Ministrit E. H. nr.1164/2 prot, datë 23.03.2015 drejtuar Zotit M. M., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë “E. A.”, shkresë e dërguar në përgjigje të shkresës nr.400 prot, datë 05.02.2015 të dërguar nga S. B. në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv,

Shkaku: Drejtori të Përgjithshëm në kundërshtim me marrëveshjen konçesionare, ka autorizuar dhe ka lejuar procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës nga kompania E.-A. dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij, sipas profilit të mallrave.

Rëndësia: Lart

Rekomandimi:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të prezantohet në organet drejtuese:

-Vlera **4,281,902 lekë** (për pjesën 11% të kontratës që i takon APD), që ka të bëjë me kryerjen e procesit të shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës, proces i cili nuk është pjesë e objektit të Kontratës Konçesionare “Për dhënie me koncesion Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Përmirësimin Teknik të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit e nënshkruar në datën 06 Maj 2013 midis Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot MIE) dhe Kompanisë “E. Sh.& T.”.

Titulli i gjetjes: Nga auditimi u konstatua se kompanitë konçesionare E.-A., D. dhe A., nuk kanë zbatuar detyrimin kontraktor për të investuar në терминаlet respektive të marra me koncesion.

Situata: Detyrimi që Konçesionari “E.A.” duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 2,069,371,737 lekë. Deri në datën 27.07.2018, nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MIE, si autoritet kontraktor për këtë kontratë konçesionare për investimin e kryer.

Detyrimi që Konçesionari A. duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 4,143,000 EURO. Deri në datën 27.07.2018, nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MIE, si autoritet kontraktor për këtë kontratë konçesionare, për investimin e kryer.

Detyrimi që Konçesionarit D. duhet të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 32,500,000 USD. Deri në datën 27.07.2018, nuk provohet të ketë investuar asnjë vlerë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MIE, si autoritet kontraktor për këtë kontratë konçesionare, për investimin e kryer.

Për këtë situatë, nga APD i është kërkuar informacion zyrtar njësisë së zbatimit të projektit pranë MIE, me shkresën nr. 2362 prot, datë 30.05.2018, e cila nuk ka vënë në dispozicion asnjë lloj informacioni në lidhje me investimet e kryera nga kompanitë konçesionare E.-A., D., edhe pse është një detyrim kontraktual.



Deri më datë 27.07.2018, datë në të cilën përfundoi auditimi, nga APD nuk konfirmohet asnjë investim i kryer prej tyre.

Rëndësia: Lart

Rekomandimi:

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të prezantohet në organet drejtuese vlerat e investimeve që kompanitë koncensionare kanë detyrimin kontraktor për ti investuar, konkretisht Konçesionari E.-A. në vlerën **2,069,371,737 lekë**, Konçesionari A. në vlerën **4,143,000 EUR** dhe Konçesionari D. në vlerën **32,500,000 USD**. Deri më datë 27.07.2018, nga APD nuk konfirmohet asnjë investim i kryer prej tyre.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

-Procesi i shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga APD-ja, u konstatua se procesi i shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës, është realizuar nga kompania E.-A. dhe jo nga Porti i Durrësit, i cili është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij, sipas profilit të mallrave. APD-ja disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës, duke krijuar një të ardhur të munguar për APD-në dhe Buxhetin e Shtetit në vlerë **4,281,902 lekë**. Konkretisht:

Shkarkimi i tubacioneve të mullinjëve të erës, është kryer pa licencën e stivadorit, në kundërshtim me pikën 3.1.2.1 “Autoriteti kontraktues merr përsipër dhe bie dakort” të kontratës koncensionare, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Do t’i sigurojë Konçesionarit Lejet, Autorizimet, Liçensat e kërkuara për zbatimin e kësaj kontrate, që janë në kompetencë të Autoritetit Kontraktues apo APD, me kusht që Konçesionari të ketë plotësuar dhe paraqitur të gjithë dokumentacionin e rregullt ligjor për lëshimin e tyre”.

-Nga mos pajisja me licencën së stivadorit, kompania E.-A. nuk i ka paguar tarifën e ushtrimit të një aktiviteti të tillë, në vlerën **3,600,000 lekë**, vlerë e cila është e ardhur e munguar për APD dhe Buxhetin e Shtetit.

-E.-A., edhe pse e pa pajisur me licencën e stivadorit, ka vendosur monopol në këtë shërbim, pasi Porti i Durrësit nuk ka zhvilluar një procedurë për të për zgjedhur kompaninë stivadore, pra nuk ka patur një konkurrencë në këtë shërbim, në kundërshtim me Ligjin nr.9251, datë 08.07.2004 “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kompania koncensionare E.-A., edhe pse e pa pajisur me licencën e stivadorit, nuk ka lejuar shoqëritë e licencuara të ngarkim-shkarkimit (stivadorët) të kryejnë përpunimin e anijeve duke krijuar, në këtë mënyrë një monopol të paligjshëm në ofrimin e shërbimeve në Terminalin Lindor dhe goditur në këtë mënyrë konkurrencën. Kompania E.-A., ka pretenduar se ka kontratë për administrimin e këtij terminali dhe ka kërkuar që asnjë konçesionar (ose spedicionar) tjetër të mos hyjë brenda zonës së veprimit të kësaj kompanie.

Në fakt në Terminalin Lindor për periudhën 01.05.2016-30.06.2018 2016 kanë operuar kompanitë stivadore: A. C., P., A., N., V. A., D. Sh., G., E. etj. si dhe Agjencitë Detare: D. K., A. T., V., R., P., A., R., E., A., I. L., G. A. L., N. etj.

- Disa nga dokumentet shkresore që komprometojnë procesin e ngarkim shkarkimit të mullinjëve të erës, si dhe përfshirjen e personave zyrtarë të implikuar në këtë proces (Drejtori i APD, Kryetari I Këshillit Drejtues, Ministri i MIE dhe vetë kompaninë koncensionare E.-A.), janë si më poshtë:

-Me e-mailin e datës 08.05.2018, ora 18.37 A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm, i drejtohet Përgjegjësit të Sektorit të Dispeçerisë Qendrore.



-Me e-mailin e datës 08.05.2018, ora 18.33 G. Ll. në emër të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, i drejtohet A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv. Theksojmë se G. Ll. është njëkohësisht dhe Kryetari i Këshillit Drejtues.

-Me e-mailin e datës 08.05.2018, ora 5.46 PM, Prof.Dr. F. P. i drejtohet E. chartering, H. L., D. Gj., G. Ll., me subjekt: Versioni përfundimtar MOU(Memorandum of Understanding), ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Të nderuar. Mendoj se kemi arritur një marrëveshje përfundimtare. Ju falenderoj të gjithëve. Aktualisht H. ose M., shprehin dakortësinë e tyre për E.. Ministri do t’i kërkojë anijes të hyjë në Port. Me pikën e re 6, ne ju bëjmë të qartë se MOU nuk përbën ndonjë ndryshim të situatës ligjore aktuale. Ju këshilloj ti përmbahemi këtij teksti (e-maili është shkruajtur në gjuhën angleze).

-E-mailin e datës 3 maj 2018, ora 12,51 dërgur nga A. Gj. për Dispeceria Qendrore, me subject: Njoftim për mbërritjen M. N. më datë 06.05.2018 Ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “ Ju lutem gjeni bashkëngjitur njoftimin e mbërritjes për anijen M. N..

-E-mailin e datës 5 maj 2018, ora 14.55 të dërgura nga Dispeceria Qendrore për A. Gj., me subjekt: Njoftim për mbërritjen M. N. më datë 06.05.2018, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Në përgjigje të njoftimit tuaj për mbërritje anije, ju bëjmë me dije se APD nëpërmjet shkresës nr.823/3 prot, datë 13.04.2018 ka kërkuar që operatori E.-A. që ti dërgoj një plan operacional të detajuar dhe ti vej në dispozicion kontratën me operatorin stivador të licensuar në portin e Durrësit”.

-E-mailin e datës 5 maj 2018, ora 13.58 dërgura nga Ch. G. për Dispeceria Qendrore, me subjekt: Njoftim për mbërritjen M. N. më datë 06.05.2018, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Sapo kemi marrë e-mailin tuaj dhe nuk është i zakonshëm dhe jo i bazuar në kontratën koncesionare dhe as i bazuar në procedurat standarte të Portit Durrës. Ju lutem nga siguroni me referencat ligjore për kërkesat tuaja. Ju rikujtojmë se, ndalimi i E.-A. për të ushtruar veprimtarinë e saj për të përpunuar mallra në projektin në terminalin lindor është një shkelje e vendimit të formës së prerë gjykatës, për të cilën parashikohen pasoja ligjore për shkelësi”. Në fakt referuar vendimit të gjykatës, ose gjykatave nuk ka vendim të formës së prerë.

-E-mailin e datës 5 maj 2018, ora 16.13 dërgura nga E. J. për Dispeceria Qendrore, me subject : E-mail për g., ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “ Z G.

Ne pergjigje te e-mailit tuaj po ju bejme me dije si me poshte :

*Autoriteti Portual Durrës në vijim të shkresave dërguar E.-A. gjithmonë është mbështetur në kuadrin ligjor në fuqi, konkretisht Ligji 9130 datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual Durrës” neni 22: **Autoriteti Portual, nëpërmjet Drejtorit Ekzekutiv, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mëposhtme:***

a)Veprimtarinë portuale për transportin e mallrave, lundrimin (drejtimin e anijeve), transportin e pasagjerëve, ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave, magazinimin e mallrave, që bëhen prej tij ose prej sektorit privat;

b)Veprimtari të tjera, të nevojshme për mbështetjen e veprimtarive të përshkruara në shkronjën “a” të pikës I të këtij neni.

Ky nen i Ligjit 9130 parashikon qarte kompetencat e Drejtorit te Përgjithshëm.

Gjithashtu ju rikujtojmë qe ju nuk keni permbushur nenin 13.1.1 te Kontrates Koncesionare ku citohet :

Lejet e aplikueshme:

“Konçesionari, gjate kohezgjatjes se periudhes se koncesionit, duhet të zbatojë dhe të jetë në përputhje me Lejet, Autorizimet, Licensat për kryerjen e shërbimeve të parashikuara në këtë Kontratë



Deri në këto momente Ju nuk keni licensën për ngarkimin dhe shkarkimin e mallrave gjeneralë por vetëm atë të mallrave rifuxho.

Referenca juaj per vendimin e gjykatës nuk qëndron sepse gjykata nuk shprehet që koncesionari do të ushtroje aktivitetin e tij në shkelje te ligjit dhe kontratave koncesionare.

Ne perfundim po ju rikujtojmë që Autoriteti Portual Durres nuk është kunder akostimit te Anijes N. ne kalaten nr.10 por ne kerkojme qe ju te plotesoni 2 kerkesat tona te cilat jane te mbeshtetura totalisht ne ligj dhe në kontraten koncesionare.

Faleminderit për bashkepunimin”,

-E-mailin e datës 5 maj 2018, ora 16.07 dërgura nga E. Sh. për dispeçerinë qendrore, me subjekt :Anija N., ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Të nderuar Zotërinj,

Në bazë të mospranimit tuaj për dorëzimin e kontratës të anijes N. (kontrata orgjinale e firmosur dhe vulosur nga palët sipas procedurës), po ju a nisim të skanuar së bashku me dokumentacionin përkatës”.

-E-mailin e datës 29 Qershor 2018, ora 12.31 dërguar nga I. H. për E. Gj., me subjekt: Letër proteste, forword (përcjellje e-maili).

-E-mailin e datës 7 maj 2018, ora 21.33 dërguar nga E. J. për Përgjegjësin e Sektorit të Dispeçerisë Qendrore, me subjekt: Letër proteste, ku është shprehur në ligjëratë të drejtë se “ Përshëndetje z D., Ju rikujtojmë edhe njëherë që kontrata me stivadorin e licensuar është e detyrueshme nga ana e juaj. Kjo kërkesë është e bazuar në rregulloren e APD, lutemi edhe njëherë që kjo kërkesë të plotësohet sa më parë nga ana e juaj që mund të akostojmë anijen N..

-E-mailin e datës 7 maj 2018, ora 21.06 dërguar nga F. D. për A. B., me subject: Letër proteste, ku është shprehur në ligjëratë të drejtë se “ I nderuar z drejtor, Sic ju informuam si dhe nga informacioni që keni nga Dispeceria, agjensia G. ka dorëzuar dokumentacionin e plotë pranë kësaj dispecerie përfshi dhe lejen e shkarkimit nga dogana durrës. Në vazhdim akoma nuk kemi përgjigje pozitive për të akostuar anijen N. në kalatën nr.10 “Terminali lindor”, me arsyetimin se mungon kontrata e kompanisë së licensuar stivadore. Përveç të tjerash, ju rikujtojmë që kjo nuk është detyrë e agjensisë detare edhe pse ju kemi dorëzuar kontratën e rregullt të shkarkimit G._E.-A.. Për këto arsye kërkojmë nga ju dhënien e lejes për të futur anijen në kalatën e sipërpërmendur. Vazhdojmë të protestojmë për të drejtat tona deri në zgjidhjen pozitive të situatës nga ana e APD për dëmtimet financiare të shkaktuara.

-E-mailin e datës 6 maj 2018, ora 21.42 dërguar nga F. D. për A. B., me subject: Letër proteste, ku është shprehur në ligjëratë të drejtë se “ I nderuar z drejtor, Bashkëngjitur po ju dërgojmë zyrtarisht letrën e protestës mbi refuzimin nga ana e juaj për futjen e anijes në kalatën 10, Terminali Lindor me ngarkesë “Projekt kargo” për G. E..

-E-mailin e datës 7 maj 2018, ora 10.25 dërguar nga E. K. për Dispeçerinë Qendrore, me subjekt: Plan, ku është shprehur në ligjëratë të drejtë se “ Përshëndetje, Anija N. do të akostohet e para në kalatën nr.10, Anija A. do të akostohet në kalatën nr.11, mbas akostimit të anijes N..

-E-mailin e datës 6 maj 2018, ora 23.28 dërguar nga Përgjegjësi i Sektorit të Dispeçerisë Qendrore për z D., me subjekt: Përgjigje letër porosië, ku është shprehur në ligjëratë të drejtë se “.... Deri më datën e sotme nga E.-A. nuk janë plotësuar 2 kushte të nevojshme për akostimin e anijes....APD nuk kundërshton përpunimin e kësaj ngarkese në Terminalin Lindor, por duhet të ndodh duke u mbështetur në kontratën koncensionare dhe në Ligjin për APD.....

-E-mailin e datës 7 maj 2018, ora 21.40 dërguar nga E. J. për Dispeceria Qendrore, me subjekt : Letër proteste.



-E-mailin e datës 7 maj 2018, ora 21.06 dërguar nga F. D. për A. B., me subjekt : Letër proteste.

-E-mailin e datës 7 maj 2018, ora 21.50 dërguar nga Dispeçeria Qendrore për F. D., me subjekt : Letër proteste.

-E-mailin e datës 7 maj 2018, ora 21.33 dërguar nga E. J. për Përgjegjësin e Sektorit të Dispeçerisë Qendrore, me subjekt : Letër proteste.

-E-mailin e datës 29 qershor 2018, ora 12.33 dërguar nga I. H. për E. Gj., me subject : MOU final version.

-E-mailin e datës 8 maj 2018, ora 18.33 dërguar nga G. LL. për A. B., me subject : MOU final version:

“Te nderuar,

Mendoj se kemi arritur në një marrëveshje. Ju falenderoj të gjithëve. Aktualisht H. dhe M. shprehin dakordësinë për E.-në, Ministri do ti kërkojë anijes që të hyjë në port. Me pikën e re 6 ne ju bëjmë të qartë që MoU nuk konsiston në ndonjë ndryshim të situatës aktuale ligjore. Ju këshilloj të vazhdoni sipas këtij teksti. Me nderime, I juaji F.”

-Marrëveshje me nr.2168 prot, datë 19.05.2018 prot APD dhe nr.110, datë 19.05.2018 lidhur ndërmejt APD dhe E.-A. lidhur mbi çmontimin e pengesave fizike për kalimin e ngarkesës projekt i firmosur për APD nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe E.-A. nga Ch. G. në cilësinë e Drejtorit. Kjo marrëveshje ka si objekt lejimin e çmontimit të pengesave fizike të ndodhura tek rrethimi pranë hyrjes 5, në funksion të krijimit të një dalje të përkohshme të kamionëve me fletët e mullinjeve të erës të ngarkesës projekt të G. E.....”

-Marrëveshje me nr.2169 prot, datë 19.05.2018 prot APD dhe nr.5111 prot, datë 19.05.2018 lidhur ndërmejt APD dhe Shoqërisë “Sh.”, lidhur mbi çmontimin e pengesave fizike për kalimin e ngarkesës projekt e firmosur për APD nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë “Sh.” nga L. O., në cilësinë e administratorit. Kjo marrëveshje ka si objekt lejimin e çmontimit të pengesave fizike të ndodhura tek rrotullimi i daljes së portit me qëllim kalimin e sigurt të trajektorës së ngarkesës, sipas referencave dhe përshkrimit të bërë në kërkesën e shoqërisë “Shpresa -Al”.

Veprimet sa më sipër janë në kundërshtim me:

-Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Autoriteti Portual”, neni 15 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Këshilli Drejtues i një porti është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual dhe që ushtron të drejtat mbi pronën si “Port administrues i pronës”. Neni 20 “Përgjegjësitë e Drejtorit Ekzekutiv dhe marrëdhëniet me nënpunësit”, pika 3, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “Drejtori Ekzekutiv është Menaxheri i Përgjithshëm i Autoritetit Portual dhe vepron sipas autoritetit të deleguar nga Këshilli Drejtues, duke i raportuar drejtpërdrejt atij”.

-VKM nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statusit të Autoritetit Portual Durrës dhe për riorganizimin e tij” neni 9 “Detyrat dhe të drejtat e Këshillit Drejtues”, pika 1, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se “ Këshilli Drejtues i Autoritetit Portual Durrës është organi i vetëm përgjegjës për drejtimin e veprimtarisë së Autoritetit Portual dhe ushtron të drejtat mbi pronën si “Port administrues i pronës” dhe neni 10 “Përgjegjësia e anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe të nënpunësve”, pika c dh ç, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se:

“c) Të ndjekë hap pas hapi objektivin e kthimit të portit në një “Port Administrues Toke”, zbatimin e legjislacionit për Autoritetin Portual dhe rregullat e këtij statuti;

ç) Të sigurojë përdorimin e mundësive dhe të rrisë shfrytëzimin maksimal të portit, për të plotësuar kërkesat e klientit dhe të tregut”



-Me shkresën e Ministrit E. H. nr.1164/2 prot, datë 23.03.2015 drejtuar Zotit M. M., në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Shoqërisë “E. A.”, shkresë e dërguar në përgjigje të shkresës nr.400 prot, datë 05.02.2015 të dërguar nga S. B. në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv. Në shkresën e Ministrit është shprehur në mënyrë eksplicite se “*Në vijim të shkresës së APD nr.409, datë 05.02.2015 mbi ndalimin e përpunimit të kontinjërve në terminalin Lindor, ju tërheqim vëmendjen se çdo veprimtari jashtë objektit të kontratës konçensionare përbën shkelje të kontratës konçensionare. Për këtë arsye duke ju referuar konstatimit të ardhur nga APD, ky rast nuk duhet të përsëritet, në të kundërt, Autoriteti Kontraktor don të marr të gjitha masat e nevojshme për ndalimin e veprimtarive që kryeni në kundërshtim me kontratën konçensionare*”.

Në fakt Porti i Durrësit, është i vetmi Autoritet Portual në Republikën e Shqipërisë, që gëzon të drejtën e dhënë nga ligji, për organizimin e shpërndarjen e ngarkesave (cargo) nëpër терминаlet e tij sipas profilit të mallrave. APD disponon asetet e nevojshme infrastrukturore, makineritë dhe pajisjet për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës.

Sipas opinionit tonë: Referuar dokumentacionit të cituar si mësipër, grupi i auditimit nuk mund të jap një opinion të plotë dhe të saktë, mbi zbatimin e kuadrit rregullator mbi të cilin ka vepruar Autoriteti Portual Durrës, për procesin e shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjëve të erës, si dhe grupi i auditimit shprehet me rezervë për saktësinë dhe vërtetësinë e **vlerës 4,281,902 lekë** (vlerë e cila në këto kushte vlerësohet si e ardhur e munguar për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit), si dhe përgjegjësinë ligjore dhe ekonomike të personave zyrtarë të përfshirë në këtë proces, të: Autoritetit Portual Durrës, që me veprimet dhe mos veprimet e tyre në zbatim të kompetencave që ju jep ligji, kanë kryer përmbushjen të rregullt të detyrës, me pasojë prekjen e interesave të ligjshme të APD dhe të Shtetit dhe në vencanti nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv A. B..

Vlera 4,281,902 lekë përbën të ardhur e munguar për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit.

-Shkarkimi, depozitimi dhe evadimi i tubacioneve, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP.

Për periudhën objekt auditimi nga kompani E.-A. janë shkarkuar, depozituar dhe evaduar tubacione, materialeve të nevojshme, si dhe makinerive të projektit TAP në sasinë 4,000 ton, në kundërshtim me marrëveshjen konçensionare dhe pa lincencën përkatëse, me një përlllogaritje si e ardhur e munguar për APD-në dhe buxhetin e shtetit në vlerën 20,695,240 lekë. Fenomen që është trajtuar në mënyrë të detajuar në auditimin e kaluar. Nga mos përpunimi i tubacioneve të TAP nga APD Durrës, APD Durrës dhe Buxhetit të Shtetit i është krijuar një e ardhur e munguar në **vlerën 24,295,240 lekë (20,695,240 përpunimi dhe 3,600,000 detyrim për pajisje me kontratë licence).**

Shënim.

Fenomen që është trajtuar në mënyrë të detajuar në auditimin e kaluar. Sasia 4,000 ton me vlerë 24,295,240 lekë tubacione, pjesë të tyre dhe makineri të Projektit TAP është pjesë e fazës së parë të projektit 16 anije, në linjën tokësore me sasi totale 130,000 ton (në këtë sasi nuk është përfshirë sasia për linjën detare). Pra në auditimin ne par është pasyruar vlera në nivel kontrate 130,000 ton. Sasia 4,000 ton me vlerë 24,295,240 lekë është pjesë e kësaj kontrate e realizuar për periudhën objekt auditimi.

Aktualisht APD-ja është në proces gjyqësor me kompaninë E.-A.. Konkretisht: Me vendim të gjykatës së rrethit gjyqësor Tiranë nr.9808, datë 15.12.2015, kjo është shprehur në favor të paditësit kompanisë E.-A.. Në lidhje me shpërblimin e kësaj kompanie në shumën 20,047,499 lekë dhe interesat në shumën 366,243 lekë, si pasojë e pengimit në përmbushjen e kontratës



koncensionare si dhe të mos kryejë asnjë veprim në të ardhmen që pengon operimin e paditësit, sipas kontratës së koncensionit.

Me vendim të gjykatës së Apelit Tiranë nr.659, datë 17.03.2017, vendosi lënien në fuqi vendimit nr.9808, datë 15.12.2015 lidhur me shumën e dëmit si më lart, dhe prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e gjykimit për pikën e dytë që ka lidhje “Si dhe të mos kryejë asnjë veprim në të ardhmen që pengon operimin e paditësit, sipas kontratës së koncensionit”.

APD ka bërë rekurs në Gjykatën e Lartë me nr.1235, datë 14.04.2017.

Për pos sa mësipër

Titulli i Gjetjes

Nga auditimi u konstatua se shoqëria E. Sh. & T. nuk zbaton kontratën Koncesionare “Për dhënien me koncesion Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Përmirësimin Teknik të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit, të nënshkruar në datën 06 Maj 2013, midis Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe E. Sh. & T.. Konkretisht përsa i përket tarifës për kontratat e lidhura nga koncensionari E. për shesh përdorimi, depozitimi, dhe truall i lirë, të cilat nuk pasqyrohen, as për çdo ditë dhe as për çdo turn, por dorëzohen nga koncensionari E.-A. në mënyrë të njëanshme tek APD, në fund të muajit, kjo në kundërshtim me pikën e, të protokollit të dorëzimit, me nr.1810, datë 12.07.2013 “Protokolli dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”, si dhe në kundërshtim me pikën 6, “Tarifat e dhënies me qira”, pika 6.1 “Tarifat për dhënien me qira të shesheve” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Punëve Publike me nr. 581/1, datë 06.02.2013 ”Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve në APD”, dhe me pikën 2, të “Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit”.

Rekomandimi

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të prezantohet në organet drejtuese moszbatimi i kontratës nga koncensionari E.-A., në lidhje me llogaritjen e tarifës për kontratat e lidhura për shesh përdorimi (përdorimi, depozitimi, truall i lirë), të cilat nuk pasqyrohen, as për çdo ditë dhe as për çdo turn, por dorëzohen nga koncensionari “E.-A.” në mënyrë të njëanshme tek APD, në fund të muajit, kjo në kundërshtim me pikën e, të protokollit të dorëzimit, me nr. 1810, datë 12.07.2013 “Protokolli dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”, si dhe në kundërshtim me pikën 6, “Tarifat e dhënies me qira”, pika 6.1 “Tarifat për dhënien me qira të shesheve” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Punëve Publike me nr. 581/1, datë 06.02.2013 ”Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve në APD”, dhe me pikën 2, të “Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit”.

Në rast moszbatimi të detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen koncensionare nga E.-A., si dhe mos ndërprerjes së aktivitetit jashtë kontraktor, nga organet drejtuese të merren masa për pezullimin e menjëhershëm të marrëveshjeve koncensionare, deri ndërprerjen e aktivitetit jashtë kontraktor, dhe në rast të kundërt të zbatohen procedurat ligjore për aplikimin e sanksioneve përkatëse.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Kompania “E. Sh. & T.”, T. L. (E.-A.):

Kontrata Koncesionare “Për dhënien me koncesion Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Përmirësimin Teknik të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit, është nënshkruar në datën 06 Maj 2013, midis Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit dhe E. Sh. & T.. Periudha Koncesionare 35 vjet.



Brenda territorit të Terminalit që prej fillimit të implementimit të Kontratës Koncesionare janë kryer dhe vazhdojnë të kryhen operacione të cilat nuk janë pjesë e Objektivit të saj, konkretisht:

- a) Ajo e depozitimit të konteinerëve bosh. Për këtë qëllim brenda në Terminal është krijuar dhe një shesh i posaçëm në krahun veri-lindor të Terminalit Lindor, i pa deklaruar në planimetrinë e territoreve paraqitur në kontratë, protokollin e dorëzimit apo në planin e investimit.
- b) Proçeset e transportimit, nga terminali në terminal
- c) Ulje-ngritje e konteinerëve
- d) Mbushje e konteinerëve me mineral,
- e) Përpunimi i pjesshëm i mineralit në territorin e Terminalit, qoftë ky me mënyrë artizanale apo edhe me makineri seleksionuese,
- f) Procesi i peshimit të mjeteve mbi 7.5 ton,

Proçese pune të cilat janë jashtë objektivit të kontratës dhe që të gjitha u faturohen nën kontraktorëve, në kundërshtim me nenin 2, pika 2.1 “Objekti i Konçesionit”, apo pika 2.3 “Përpunimi i ngarkesave të tjera”, nenin 8 të Kontratës “Çështje Financiare dhe të pagesës”, ku tarifat e aplikuara nga ana e operatorit E.- A. duhet të jenë në përputhje me librin e tarifave të APD-së dhe të ardhurat e përfituara, duhet të ndahen midis, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës sot Ministria e Infrastrukturs dhe Energjisë, APD-s dhe E.-A. sipas përqindjeve të përcaktuara (Fee Koncesionare).

-Marrja e informacioneve në lidhje me volumet e punës, të shoqëruar me formularët e miratuar, sipas përcaktimeve të bëra shkresën nr. 1810 prot., datë 18.07.2013, për çdo turn/dite, pasqyrohet vetëm për treguesit e volumeve të punës për ngarkimin & shkarkimin e anijeve, *ndërsa për treguesit për zënien e shesheve* (përdorimi, depozitimi, truall i lirë), nuk pasqyrohen, as për çdo ditë dhe as për çdo turn, por dorëzohen nga koncesionari “E..” në mënyrë të njëanshme tek APD-ja, në fund të muajit, kjo në kundërshtim me pikën e, të protokollit të dorëzimit, me nr.1810, datë 12.07.2013 “Protokolli Dorëzimit dhe Marrjes në Dorëzim të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”.

-Detyrimi, bazuar në pikën 12.1.7 “Sistemi dhe Rrjeti Kompjuterik”, i Kontratës Koncesionare, nuk ka qenë i përcaktuar dhe detajuar saktë në funksionet e tij dhe grafikun kohor të implementimit, një gjë e tillë mungon edhe në ofertën teknike, procesverbalin e dorëzimit si edhe në planin e investimit të koncesionarit. Për pasojë, mungesa e shkëmbimit dhe marrjes së informacionit “on-line”, për çdo shërbim të kryer nga koncesionari tek Njësia e Monitorimit, është një prej arsyeve kryesore në shkeljet e referuara më sipër për monitorimin dhe deklarimin e volumeve, të kontratave nënkontraktore, të sipërfaqeve etj.

Ka paqartësi në kontratë, në lidhje me përfshirjen në mënyrë të pa drejtë dhe apriori të tarifës së hyrjes të mjeteve të transportit mbi 7.5 Ton në tarifë shërbimi dhe ndarjes së saj sipas fee koncesionare. Kjo tarifë është vlerësuar dhe vjelë si tarifë e infrastrukturës edhe para “Studimit Përfundimtar të Tarifave për Autoritetin Portual Durrës”, bërë nga HPC, dorëzuar Nr.3257 Prot. Datë 09/10/2008, studim ku u mbështet ndërtimi i Librit të Tarifave të APD të vitit 2009 dhe në vazhdim dhe përcakton qartë këtë tarifë si tarifë të infrastrukturës dhe që vilet 100% nga APD-ja.

-Ka shkelje të nenit 2.3 pika 2 dhe neni 12.1.1 pika f, të kontratës koncesionare në të cilin citohet se: “...koncesionari në zbatim të detyrimeve kontraktuale nuk duhet të imponojë në asnjë rast klientët për të përzgjedhur operatorët e tij të përpunimit”, si dhe moszbatim të Urdhrit të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Transporteve Nr.1164/3 prot, datë 23/03/2015 dhe nr.2526/1 prot, datë 15/05/2015, në lidhje me ndalimin e operimit në Terminal të Stivadorëve



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

të liçensuar dhe me Kontratë shërbimi me APD. Këto shkelje kanë krijuar nga njëra anë konflikte tepër të mprehta midis koncesionarit dhe subjekteve të tjera private që operojnë në Portin e Durrësit, por edhe më gjerë sikurse janë agjencitë detare, kompanitë e transportit detar dhe subjektet që ato përfaqësojnë në marrëdhënie me koncesionarin E.-A..

E.-A. ka vazhduar me arrogancë dhe mospërfillje të kryejë aktivitetet e mëmesipërme, edhe pse i është kërkuar ndërprejen e tyre me shkresat nr.3212 prot, datë 22.12.2017 dhe nr.1119 prot, datë 18.03.2018.

Sipas opinionit tonë: Marrëveshja e datës 6 Maj 2013 ka dëmtuar interesat e ligjshme të Shtetit dhe ka favorizuar kompaninë “E. Sh. & T.”, çka përbën jo vetëm shkelje të rëndë të legjislacionit në fuqi, por është dhe një shprehje flagrante e mos zbatimit të ligjit.

Detyrimi që Koncesionari “E.-A.” duhet që do të investojë për të gjithë periudhën e koncesionit, është në vlerën 2,069,371,737 lekë, deri më datën 27.07.2018 ka investuar vlerën 0 lekë. Nuk ka raportim zyrtar nga njësia e zbatimit të projektit pranë MTI, si autoritet Kontraktor për këtë Kontratë Koncesionare për investimin e kryer.

Për këtë situatë, nga APD-ja i është kërkuar informacion zyrtar Njësisë së Zbatimit të Projektit pranë MTI, me shkresën nr.2362 prot, datë 30.05.2018, e cila nuk ka vënë në dispozicion asnjë lloj informacioni në lidhje me investimet e kryera nga kompania koncesionare D., edhe pse është një detyrim kontraktual.

Deri më datë 27.07.2017, nga APD nuk konfirmohet asnjë investim i kryer prej tyre.

Në rast mos-kryerjes së investimeve të përcaktuara në marrëveshjet koncesionare, nga APD-ja te merren masa për pezullimin e menjëhershëm të marrëveshjeve koncesionare, deri në kryerjen e investimeve sipas marrëveshjes, e në rast të kundërt të zbatohen procedurat ligjore për sanksionet përkatëse.

10.d . Titulli i gjetjes: "Performanca e treguesve ekonomiko-financiare" pas dhenies me konçension të terminalit lindor, terminalit të trageteve dhe terminalit të kontinjerve paraqitet si më poshtë:

Situata:

Emërtimi i treguesve		2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
		Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt
Të ardhurat	lekë	2,644,740,590	2,726,885,191	2,692,095,787	2,356,956,628	2,178,313,365	2,729,836,090	1,899,990,877	2,092,044,295
Shpenzimet	"	2,499,478,130	2,475,051,287	2,208,515,788	2,071,573,924	1,785,838,475	1,936,157,846	1,695,775,017	1,942,228,645
Fitimi Bruto	"	145,262,460	251,833,904	483,579,999	285,382,704	392,474,891	793,678,244	204,215,859	149,815,649
Tatim fitimi	"	77,398,909	63,519,237	67,875,193	51,559,014	54,555,475	56,135,475	54,412,360	34,594,557
Fitimi neto	"	67,863,551	188,314,667	415,704,806	233,823,690	337,919,416	737,542,769	149,803,499	115,221,092
Shpërndarja e Fitimit									
Rezervë Ligjore 5%	lekë	3,393,178	9,415,733	20,785,240	11,691,185	16,895,971	36,877,138	7,490,175	5,761,055
Rezervë për zhvillim 95%	"	64,470,373	178,898,934	394,919,566	222,132,506	321,023,445	700,665,631	142,313,324	109,460,038
Nr. Punonjësve	Nr	588	612	455	612	373	442	439	459
Fondi i pagës gjithsej	lekë	482,824,000	524,854,000	552,237,000	403,918,000	331,446,000	377,205,552	397,552,000	459,880,512
Paga mesatare mujore	"	68,427	71,467	75,196	73,978	76,165	74,560	75,465	82,749
Paga mesatare	"	821,129	857,605	902,352	887,736	913,978	894,720	905,580	992,993



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

vjetore									
Investimet	"			557,278,264	596,000,000	74,491,148	94,065,382	71,884,243	344,200,230

1. Treguesi kryesor i të ardhurat të realizuara perpara periudhes se koncensionit kapnin shifrat 2.6 miljaard lek, ndersa pas dhenies me koncension (Shkurt 2013. Korrik 2013, Shtator 2013) te ardhurat jane ulur ndjeshem per shkak te ndarjes se tyre sipas % koncensionare. Duhet theksuar se në rritjen e të ardhurave në vitin 2013 dhe 2014 ka ndikuar dhenia me qera e dy vincave MHC koncensionarit te konteniereve qe ka cuar ne rritjen e tyre perkatesisht gjate viti 2013 ne vleren 149 920 681 lekë dhe 2014 ne vleren 121 394 344 lek1. Po ashtu tek te ardhurat e vitit 2015 ka ndikuar nje gjyq i fituar nga APD qe ka rritur shifren e afarizmit ne vleren 410 miljon leke .

Po te zhveshen keto tre vite 2013-2014-2015 nga efektet e sipercituara te ardhurat do te rezultonin

Emërtimi i treguesve		2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
		Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt
Të ardhurat	lekë	2,644,740,590	2,726,885,191	2,692,095,787	2,207,035,947	2,056,919,021	2,319,836,090	1,899,990,877	2,092,044,295

2. Dhenia me koncension duhet të ishte shoqeruar me shkurtim te stafit drejtues dhe të punonjësve, pasi eshte kryer procedura e transferimit te punonjeve qe punonin tek keto terminale, gje qe reflektohet te renia e fuqise nga 621 ne vitin 2013 ne 373 ne vitin 2014, por ky numer ka vazhduar te rritet 442 ne vitin 2015, 439 ne vitin 2016 dhe 459 ne vitin 2017. Duke qene se shpenzimi i pagave eshte zeri i dyte per nga pesha specifike e shpenzimeve te pergjithshjme te APD-se, kjo rritje e numrit e pajustificuar nuk ka bere gje tjeter vecse ka renduar situaten financiare te APD-se.

Emërtimi i treguesve		2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017
		Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt	Fakt
Nr. Punonjësve	Nr	588	612	455	612	373	442	439	459

Indikatorët e performancës

Rendimi is situates ekonomiko-financiare e APD del dukshem edhe tek llogaritja e indikatoreve te performances. Konkretisht:

Raport i kapitalit përhershëm, viti 2012 = 96 %, viti 2013= 94 %, viti 2014 = 94 %, viti 2015 = 93 %, viti 2016 = 92 %, viti 2017 = 93 %;

Raport i Detyrimeve afatshkurtra, viti 2012 = 4 %, viti 2013= 6 %, viti 2014 = 6 %, viti 2015 = 7 %, viti 2016 = 8 %, viti 2017 = 7 %

Raport i kapitalit te vet, viti 2012 = 50 %, viti 2013= 51 %, viti 2014 = 54 %, viti 2015 = 57 %, viti 2016 = 58 %, viti 2017 = 61 %

Raport i detyrimeve afatgjata në %, ky raport për vitin 2012 = 46 %, viti 2013= 42 %, viti 2014 = 41 %, viti 2015 = 36 %, viti 2016 = 34 %, viti 2017 = 32 %

Raport i përgjithshëm i aftësisë paguese, për vitin 2012 = 3.16, viti 2013= 1.96, viti 2014 = 2.95, viti 2015 = 3.35, viti 2016 = 3.27, vitin 2017 = 3.55.

Marxhi i fitimit neto (fitimi neto: te ardhura shitja) për vitin 2012 = 16 %, viti 2013= 11 %, viti 2014 = 17 %, viti 2015 = 39 %, viti 2016 = 9 %, viti 2017 = 6 %



Kthimi ne kapitalin e vet – ROE, për vitin 2012 = 6 %, viti 2013= 3 %, viti 2014 = 4 %, viti 2015 = 9 %, viti 2016 = 2 %, vitin 2017 = 1 %

Kthimi ne aktive -ROI opsioni 1, për vitin 2012 = 4 %, viti 2013= 2 %, viti 2014 = 3 %, viti 2015 = 7 %, viti 2016 = 2 %, vitin 2017 = 2 %

Raporti Borxhit ndaj kapitali vitin 2012 = 86 %, viti 2013= 81 %, viti 2014 = 74 %, viti 2015 = 62 %, viti 2016 = 57 %, viti 2017 = 52 %

Borxhi ndaj totalit të pasivit viti 2012 = 43 %, viti 2013= 42 %, viti 2014 = 40 %, viti 2015 = 35 %, viti 2016 = 34 %, viti 2017 = 32 %.

11. Administrimin e mbetjeve urbane të rrezikshme.

Titulli i gjetjes: Kryrje aktivitet (riparimi i dy trageteve dhe tre anijeve të peshkimit) i cili nuk është për caktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit. Ky aktivitet është autorizuar të kryhet nga A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri).

Situata: Në Terminalin e Trageteve, Ish-Kantieri Detar dhe në kalatën zero është kryer riparimi i dy trageteve dhe tre anijeve të peshkimit.

Ky aktivitet (riparimi i dy trageteve dhe tre anijeve të peshkimit) nuk është përcaktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Ky aktivitet është autorizuar të kryhet nga A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri).

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit të pagesës në APD”, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 28.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar”, Udhëzimin Nr.182 datë 16.02.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr.4 dt 21.05.2015 “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së Transportit Ndërkombetar, Detar për automjetet ose udhëtarët dhe shkaqet e pezullimit apo rregullimit të tyre, i ndryshuar”.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkon me përgjegjësi A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, Agjencinë Detare D., si dhe A. M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Riskut.

Përpos sa mësipër Agjensia “D. P. A.”, për kryerje të aktivitetit jashtë marrë veshjes kontraktore me APD dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit të pagesës në APD”, është ne kushtet e Ligjit nr. 9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” neni 3 gërma a. ku citohet:



“... Neni 3. – Përgjegjësia e personit juridik për kryerjen e veprës penale

Personi juridik ka përgjegjësi për veprat penale të kryera:

Në emër ose në dobi të tij nga organet dhe përfaqësuesit e tij; ...”

Kriteri: Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit të pagesës në APD

Shkaku: Drejtori të Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri), ka autorizuar dhe ka lejuar të kryhet aktivitet (riparimi i dy trageteve dhe tre anijeve të peshkimit) i cili nuk është përcaktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Rëndësia: I Lart

Rekomandimi:

1. Nga Këshilli Drejtues të analizohet autorizimi i Drejtorit të Përgjithshëm, për aktivitetin (riparimi i dy trageteve dhe tre anijeve të peshkimit) pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri), aktivitet i cili nuk është përcaktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e Portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, si dhe të merren masa të menjëhershme për ndalimin dhe mos kryerjen e këtij aktivitetit, pa pasur kuadrin e plot ligjor dhe rregullator.

2. Nga Autoriteti Portual Durrës të ndërmerren procedurat ligjore për zgjidhjen e kontratës me "D. P. A.", për kryerje të aktivitetit jashtë marrëveshjes kontraktore me APD dhe në kundërshtim me Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr.596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit të pagesës në APD”, Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar”, Udhëzimin Nr.182 datë 16.02.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr.4 dt 21.05.2015 “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së Transportit Ndërkombëtar, Detar për automjetet ose udhëtarët dhe shkaqet e pezullimit apo rregullimit të tyre, i ndryshuar”.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

-Riparim i dy Trageteve në Terminalin e Trageteve dhe ish-Kantieri Detar.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe nga verifikimi në terren u konstatua se:

Në Terminalin e Trageteve dhe ish-kantieri detar po kryhej riparim i dy trageteve.

Ky aktivitet (riparimi i trageteve) është aktivitet i cili nuk është përcaktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Ky aktivitet është autorizuar të kryhet nga A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri).

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet



përkatese “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit të pagesës në APD”.

Nga auditimi u konstatua se nuk janë të pajisura me leje ose autorizimi mjedisore nga Agjencia Rajonale e Mjedisit.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 26, datë 28.12.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar”, Udhëzimin Nr.182 datë 16.02.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr.4 dt 21.05.2015 “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së Transportit Ndërkombëtar, Detar për automjetet ose udhëtarët dhe shkaqet e pezullimit apo rregullimit të tyre, i ndryshuar”.

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkon me përgjegjësi A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv, Agjencinë Detare D., si dhe A. M. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Riskut.

Përpos sa mësipër Agjencia “D. P. A.”, është në kushtet e Ligjit nr.9754, datë 14.06.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”, neni 3 gërma a, ku citohet:

“... Neni 3. – Përgjegjësia e personit juridik për kryerjen e veprës penale

Personi juridik ka përgjegjësi për veprat penale të kryera:

Në emër ose në dobi të tij nga organet dhe përfaqësuesit e tij; ...”

Konkretisht

-Në Terminalin e Trageteve

1.Kontrata me nr. 2404/1, date 05.06.2018 e lidhur midis APD –së, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm A. B. dhe subjektit “D. P. A.”, përfaqësuar nga P. N., është lidhur 5 ditë pasi trageti është ankoruar(akostuar) në kalatat 7-8.

Akostimi i tragetit sipas akt rakordimit datë 18.06.2018 midis APD-së dhe Agjencisë “D. P. A.” në kalatë është nga data 01.06.2018, kjo në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave me nr. 30 date 27.12.2010”Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorin Publik”, në kundërshtim me Ligjin 9920, date 19.05.2008 “Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 50, 51, pika 1.

2.Në pikën 1, të kontratës me nr. 2404/1 date 05.06.2018 emri i mjetit lundrues është ”B..” në faturen me nr.52600336 datë 19.06.2018 është R....

3.Kontrata është lidhur sipas nenit 2, *afati kohor i kontratës.....vjecare (jo më shumë se 12 muaj)*, kur kërkesa nga subjekti “D. P. A.”, me nr.1481, datë 11.04.2018 është për periudhën 01.06.2018-30.06.2018., pra 1(një) muaj.

4.Nuk disponohet asnjë dokument që të vertetojë që Trageti R..., nuk është në gjendje operacionale, e konfirmuar kjo nga akt konstatimet e Sektorit të Inspektimit dhe Monitorimit të Kontratave Konçensionare të datave 4,7,11,13,14.06.2018, veprime këto në kundërshtim me nenit 4, pika 3, renditja 4, të kontratës nr.2404/1 date 05.06.2018, ...*Defekte emergjente të anijes(vertetuar me deklaratën e kapitenit të anijes dhe Kapitenerise së Portit).*

5.Kontrata me nr.2404/1, datë 05.06.2018, nuk ka efekt zbatimi administrativo-ligjor, për sa kohë në zbatim te nenit 4, pika 3, renditja 6,...*Për çdo rast,anija nuk mund të rrijë e akostuar ne kalatat kryesore, me shume se 4 ore... ,pra kjo kontratë nuk specifikon qartë*



qëllimin për të cilën lidhet kjo kontratë, afatin, saktësinë e emrit të anijes, tragetit, veprime këto në kundërshtim me pikën 36, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në të cilën citohet..*Dokumentacioni quhet i rregullt kur përshkruan me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkaktun e veprimit, datën, treguesit sasiorë dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar. Dokumentet duhet të jenë pa korigjime,të lexueshme dhe të eliminojnë mundësinë për gabime, harresa, numërim të dyfishtë si dhe ato të mashtrimeve.....*

6.Në nenin1, të kontratës nr.2404/1 date 05.06.2018, është specifikuar gjatësia m.l 116.51, në Akt-Konstatimet e Sektorit të Inspektimit dhe Monitorimit të Kontratave Konçensionare të datave 4,7,11,13,14.06.2018, paragrafi 4, është cilësuar..*në kalatën 7-8 qëndron i akostuar prej orës 15:50 të datës 01.06.2018 trageti “R..”, me GT 12281 ton dhe Gjatësi 122 m, i cili aktualisht nuk është në gjendje operationale....*

Nga kjo mospërputhje të dhenash nga m/l e kontraktuar në kontratë nga m/l e zënë në fakt, bazuar në pikën 9, të kontratës nr.2404/1 date 05.06.2018, në të cilën citohet “...*Në çdo rast kur konstatohet se mjeti lundruar jashtë kushteve të përcaktuara në këtë kontratë zë një hapësirë më të madhe se ajo e kontraktuar, faturimi do t’i bëhet sipas hapësirës së zënë faktikisht mbi bazën e proces – verbalit të mbajtur nga kjo strukturë për këtë qëllim.....”.*

7. Sipas nenit 2,të kontratës me nr.2404/1 date 05.06.2018, afati i kontratës është ... vjeçare(jo me shumë se 12 muaj, bazuar në nenin 6 të kësaj kontrate “Zgjidhja e Kontrates”,pika 3, ...*Kjo kontratë mund të zgjidhet nga secila palë 30 ditë pas njoftimit me shkrim për këtë qëllim. Përfaqësuesi i mjetit lundruar do të përgjigjet për pagimin e tarifës portuale edhe gjatë periudhës së njoftimit.....*

II. Sipas proces-verbaleve të datës 20.06.2018, midis Sektorit të Inspektimit të Monitorimit të Kontratave Konçensionare, nga Specialisti K. N. dhe FSPD nga Shefi i sallës Operative D. K., specifikohet ;

-Në datën 03.06.2018 ora 7.30 për Raportim i Operacioneve me vinç ne tragetin “R..” ...

-Në datën 19.06.2018 ora 09.15 për Raportim i Operacioneve me lyerje ne tragetin “R..” ...

-Operacionet e riparimit të defekteve të raportuara, nuk disponohet asnjë dokument në kundërshtim me nenin 4, pika 3, renditja 4, të kontratës nr.2404/1 datë 05.06.2018, ...Defekte emergjente të anijes(vërtetuar me deklaratën e kapitenit të anijes dhe Kapitenerisë së Portit).

-Nga Drejtoria e Mjedisit të APD-së, nuk disponohet asnjë raport inspektimi për monitorimin e gjithë zonës ku po kryhen operacionet e shërbimit, në zbatim të planit mjedisor, veprime këto në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme të Funksonimit të APD-së, në kundërshtim me pikën 3, të urdhërit të brendshëm nr.996/1, datë 30.03.2016 “Mbi funksionimin e monitorimit të Kontratës së Konçensionit “Për Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen e Përmirësimin Teknik të Terminalit të Trageteve në Portin e Durrësit”,

Konkluzione - Risku vlerësohet i lartë.

Mangësitë e trajtuara më sipër, kanë ardhur si rezultat i mos zbatimit të plotë të standarteve dhe të kërkesave të Kreut III, neni 7 “Dokumentimi i veprimeve ekonomiko financiare”, me nenin 3, pika 1, të Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, Rregulloren e APD-se, Autoriteti Portual Durres të hartojë dhe të regjistrojë në kohë dokumentimin e procesev administrative- operationale para faktit të kryerjes së tyre, për të berë të mundur faturimin e saktë në kohë, në përputhje me nenin11, nenit 17, të Ligjit nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave me nr.30 datë 27.12.2010 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e



Sektorin Publik”, në kundërshtim me Ligjin 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore ne Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 50,51, pika 1.

Referuar fotografimit të forcës së sigurisë më datë 20.06.2018, ora 12.40, si dhe nga verifikimi në vend, në ish-kantierin detar ishte akostuar dhe pa riparohej, lysterje me bojë etj, trageti V.. F., R...

Në ish-kantierin detar

Për riparimin e tragecit grupit të auditimit nuk ju në dispozicion kontratë midis Agjencisë “D.P.A.”, dhe APD-së ose Kapitenerisë së Portit.

Nga FSPD-ja dokumentacioni i vënë në dispozicion është si më poshtë vijon:

-Njoftim i Agjencisë “D. P. A.”, datë 23.05.2018, për Kapitenerinë e Portit, Drejtoria e Doganës Durrës, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Durrës, Forca e Sigurisë Portuale Durrës, Dispeceria Portit Durrës, Albanian Ferry Terminal Operator, me objekt: Ju njoftojmë për lëvizjen e tragecit F/B..., nga kalata e ish-kantierit për në kalatën 7-8 më datë 25.05.2018, për të qëndruar 2-3 ditë dhe për të rifilluar linjën Durrës-Bari-Durrës. Me rifillimin e linjës nga trageti F/B ..., F/B.... do të qëndrojë pranë kalatës së terminalit 3-4 ditë për të rregulluar grafikun.

-Njoftim i Agjencisë Detare D..., datë 31.05.2018, për Kapitenerinë e Portit, Drejtoria e Doganës Durrës, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit Durrës, Forca e Sigurisë Portuale Durrës, Dispeceria e Portit Durrës, Albanian Ferry Terminal Operator, me objekt: Ju njoftojmë për lëvizjen e tragecit F/B..., pa ngarkesë nga kantieri në Maltë. Trageti do të ankorohet pranë kalatës së ish-kantierit detar. Trageti F/B... më datë 03.06.2018 do të ndalojë në kalatën 7-8 për një periudhë 7-ditore.

-Me e-mailin e nisur nga salla operative më datën 05.06.2018, ora 14.11, drejtuar D. P., me subjekt akostim trageti. Trageti “B...” akostohet në ish-kantier.

-Libri i shërbimit të forcës së sigurisë, ka të pasqyruar akostimin e tragecit B.. më datën 05.06.2018, ora 9.00 duke e shprehur në mënyrë eksplicite se “Trageti B.. po bën manovër dhe vendoset tek ish-kantieri detar. Njofim dispeceria.

Referuar fotografimit nga verifikimi në vend më datë 20.06.2018, ora 12.40, në ish-kantierin detar ishte akostuar dhe pa riparohej, lysterje me bojë etj, trageti V.. F., B.. L...

-Riparimi në kalatën zero i tre i anijeve të peshkimit dhe një në ish-kantierin detar

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. Q. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe personi M. Ç. është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.2612/1 prot, datë 01.11.2017. Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim e shesheve të përdorimit për mallra gjenerale, sipas librit të tarifave referuese. Vendodhja: Pranë kalatës 0 141 m², Lloji i aktivitetit: Shërbime portuale (mjete shërbimi) afati i përdorimit të sheshit 1 vit. Paguesa në lekë 4 lekë m²/ditë pa tvsh. Theksojmë se kërkesa është bërë nga M. Ç. me: Nr.2611 prot, datë 31.10.2017 (prot i APD-së) ku ndër të tjera është cituar se për nevoja të aktivitetit tim, kërkoj të marr me qira pranë APD-së sipas legjislacionit në fuqi, ***në teritorin e ish-kantierit detar*** një hapësirë për një periudhë 1 vjecare për ***mallra rifuxho***. Në kontratë n nr.2612 prot, datë 31.10.2017 (prot i APD-së) ku ndër të tjera është cituar se për nevoja të aktivitetit tim, kërkoj të marr me qira pranë APD sipas legjislacionit në fuqi, ***në teritorin e ish-kantierit detar*** një hapësirë për një periudhë 1 vjecare për ***mallra gjeneralë***.

Referuar ekstraktit të regjistrit tregtar fusha e veprimtarisë së tij është zënie, tregëtim peshkim.

Referuar kërkesës dhe regjistrit tregtar për fushën e veprimtarisë, nuk ka lidhje me objektin e kontratës “Shërbime portuale (mjete shërbimi)”, si dhe vendin e kërkuar që nuk është kalata zero, por ish-kantieri detar.



Planimetria e hartuar nga: N. S. Inspektor i Sektorit të Administrimit të TERITORIT dhe Ambjenteve. Hartuar nga ing. K. G., miratuar nga G. A. me detyrë Përgjegjës Sektorit të Administrimit të Teritorit dhe Ambjenteve

Me njoftim të datës 28.06.2018 drejtuar Kapitenerisë së Portit Durrës, M. Ç. njofton se do të ulë në ujë në basenin e Portit Durrës, mjetin i cili është në proces ndërtimi dhe kompletimi, për t'u transferuar në bankinën e peshkimit të vjetër brenda portit.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe personi fizik M. Ç., është lidhur kontratë qiraje me nr.2556/2 prot, datë 02.07.2018 për vinçin MHC 200. Objekti i kontratës: Qiradhënie e pajisjeve (mjeteve, mekanizma). Mjeti MHC vinc portual mobile, mekanizatori L. R.. Malli i përpunuar : Shkarkim anije peshkimi nga toka në det. Afati i kontratës: 1 orë pune nga ora 13 deri në orën 14.00, datë 28.06.2018. tarifa për orë pune 29.792 pa TVSh.

Referuar regjistrimit të dispecerit, puna është kryer më datë 30.06.2018 nga ora 13.00 deri në 14.00, në kalatën nr.5.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe personi fizik M. Ç., është lidhur kontratë qiraje me nr.2556/1 prot, datë 28.06.2018 për vinçin MHC portual mobile, mekanizator Y. T.. Objekti i kontratës: Qiradhënie e pajisjeve (mjeteve, mekanizma). Mjeti MHC vinc portual mobile, mekanizatori Y. T.. Malli i përpunuar: Shkarkim anije peshkimi nga toka në det. Afati i kontratës: 1 orë pune nga ora 11 deri në orën 12.00, datë 28.06.2018. tarifa për orë pune 29.792 pa TVSh.

Pra referuar si më sipër nga personi fizik M. Ç. në sipërfaqet e marra me kontratat respektive të përshkruara si më sipër është kryer riparimi i dy anijeve të peshkimit, ku APD-ja i ka mundësuar jo vetëm këtë shërbim në sipërfaqet e dhëna me qira, jashtë destinacionit të qirasë, por i ka vënë në dispozicion dhe mjetet më të rënda të saj për të bërë uljen në basenin e portit (vinci MHC 200).

Ndërmjet APD të përfaqësuar nga A. Q. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë "A.." përfaqësuar B. T. është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.211/1 prot, datë 22.01.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia në shfrytëzim e shesheve të përdorimit për mallra gjenerale, sipas librit të tarifave referuese. Vendodhja: Pranë kalatës zero 148 m², Lloji i aktivitetit :Shërbime portuale (mjete shërbimi) afatin i përdorimit të sheshit 1 vit. PAGESA në lekë 4 lekë/ditë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar "Qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap me nenqira sendin apo të kaloj kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit.

Kërkesa nga ky subjekt është me nr.201 prot, datë 19.01.2018 ku ndër të tjera është cituar "Shoqëria jonë ka importuar nga Italia një skaf anije (peshkatore) me qëllim kompletimin e saj për gjueti. Ky skaf ka nevojë për t'u transportuar dhe për t'u kryer punimet e kompletimit në zonën e kalatës 0. Gjatësia e këtij skafi është 23 m dhe gjerësi 6.3 m. Lutemi na krijoni mundësinë për të realizuar duke na vënë në dispozicion dhe një autovinc për ulje ngritje dhe një mjet transporti për transportimin nga vendi ku do të lidhet anija "F.." deri në kalatën 0, kërkesë e bërë më datë 10.01.2018. Planimetria e hartuar nga: N. S. inspektor i sektorit të administrimit të teritorit dhe ambjenteve. Hartuar nga ing. K. G., miratuar nga G. A. me detyrë Përgjegjës Sektorit të Administrimit të Territorit dhe Ambjenteve.

Me njoftim të datës 02.07.2018 drejtuar Kapitenerisë së Portit Durrës, B. T. në emër të shoqërisë "A.", njofton se do të ulë në basenin e Portit Durrës, mjetin i cili është në proces ndërtimi dhe kompletimi, për t'u transferuar në bankinën e peshkimit të vjetër brenda portit.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Shoqërisë "A." i përfaqësuar nga B. T., është lidhur kontratë qiraje me nr.2789 prot, datë 02.07.2018 për vinçin portual mobile me mekanizator Y. T.. Objekti i kontratës: Qiradhënie



e pajisjeve (mjeteve, mekanizma). Mjeti MHC vinc portual mobile, mekanizatori Y. T.. Malli i përpunuar: Shkarkim anije peshkimi nga toka në det. Afati i kontratës: 1 orë pune nga ora 14 deri në orën 15.00, datë 28.06.2018. tarifa për orë pune 29.792 pa TVSH.

Ndërmjet APD-së të përfaqësuar nga A. B. në cilësinë e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv dhe shoqërisë "R.." shpk të përfaqësuar nga A. Sh. në cilësinë e administratorit, është lidhur kontratë qiraje të shesheve me nr.1368 prot, datë 30.03.2018. Objekti i kësaj kontrate është dhënia me qira të sheshit të hapur të depozitimit për mallrave gjenerale, sipas librit të tarifave referuese, sipërfaqja 200 m². Vendodhja: Pranë pontilit dhe ish-kantjerit, lloji i aktivitetit shërbim portuale (mjete shërbimi). Afati i kontratës 1 vit, pagesa në lekë m²/ditë 4 lekë pa tvsh. Në nenin 5/3 është përcaktuar qiramarrësi nuk ka të drejtë të jap më nënqira sendin apo t'ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit. Planimetria e hartuar nga ing. A.L. dhe ing. K P.. Në nenin 5/3 është përcaktuar qiramarrësi nuk ka të drejtë të japë më nënqira sendin apo t'ja kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit.

Planvendosja: Punoi ing. K. G..

Nga verifikimi u konstatua se në këtë ambjete kryhet riparim anije (fotografitë e firmosura nga verifikimi në vendriparimet).

Riparimi i anijeve siç u përshkrua si më sipër, është aktivitet i cili nuk është përcaktuar në kluadrin ligjor dhe rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë aktivitetin e portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit.

Ky aktivitet është autorizuar të kryhet nga A. B. me detyrë Drejtor i Përgjithshëm, pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri).

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr.44/2015 datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë", Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 "Për Autoritetin Portual", VKM nr.596, datë 10.09.2004 "Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij", Vendimin e Këshillit drejtues nr.29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse "Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit pagesës në APD".

Nga auditimi u konstatua se nuk janë të pajisura me leje ose autorizimi mjedisore nga Agjencia Rajonale e Mjedisit, si dhe nuk paguajnë asnjë detyrim për ujin e përdorur; nuk janë të pajisura me leje e ushtrimit të aktivitetit nga Bashkia Durrës (riparim anije).

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.26, datë 28.12.2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr.9115, datë 24.07.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", Ligjin nr.10,431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", Ligjin nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.8905, datë 06.06.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit detar", Udhëzimin Nr. 182 datë 16.02.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 4 dt 21.05.2015 "Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së Transportit Ndërkombëtar, Detar për automjetet ose udhëtarët dhe shkaqet e pezullimit apo rregullimit të tyre, i ndryshuar".

Shkelja e dispozitave ligjore të përmendura si më sipër, ngarkon me përgjegjësi A. B. me Detyrë Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv.

Titulli i gjetjes: Mungesa e një regjistri për ngjarjet me ndikim në mjedisin e portit.



Situata: Nga auditimi u konstatua se nuk ka një regjistër të ngjarjeve të ndodhura apo që mund të ndodhin në të ardhmen, të cilat kanë ndikuar apo mund të ndikojnë negativisht në ndotjen e mjedisit detar dhe tokësor të Portit të Durrësit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, neni 40 pika 3 ku citohet: “*Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit regjistron të gjitha rastet e veprimeve që çenojnë mjedisin dhe zbaton rregulloret, vendimet dhe udhëzimet e autoritetit portual, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, me sistemet dhe praktikën e pranuar nga shteti shqiptar për mbrojtjen e mjedisit dhe të tokës së portit*”.

Kriteri: Ligji nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”.

Ndikimi/efekti: Mungesa e një regjistri për ngjarjet me ndikim në mjedisin e portit.

Shkaku: Mosnjohje e mirë e legjislacionit.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Nga ana e Drejtorisë së Mjedisit në APD të merren masa për hartimin e një regjistri ngjarjesh të ndodhura apo që mund të ndodhin në të ardhmen, të cilat kanë ndikuar apo mund të ndikojnë negativisht në ndotjen e mjedisit detar dhe tokësor të Portit të Durrësit, me qëllim parandalimin e ndotjeve mjedisore në të ardhmen në territorin e Autoriteti Portual Durrës.

Titulli i gjetjes: Mosaplikim penaliteti për rastet e ndotjes së mjedisit.

Situata: Për periudhën 01.05.2016-30.06.2018, nga ana e Drejtorisë së Mjedisit janë konstatuar 20 raste të cilat kanë ndikuar në ndotjen e mjedisit të Autoritetit Portual Durrës. Nga këto situata, vetëm në 1 rast është aplikuar masa e dënimit me gjobë, saktësisht me “Vendimin për Dënim Administrativ” nr.12 datë 05.06.2017 të inspektorëve të ISHMP për operatorin “E..”, i cili më pas është rrëzuar nga gjykata duke i dhënë të drejtë koncesionarit, ndërsa në asnjë rast tjetër nuk është dhënë masa gjobë për këto subjekte, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, i ndryshuar, neni 14 pika 1, ku citohet: “*Personat fizike dhe juridike, që kanë shkaktuar ndotjen e mjedisit detar, detyrohen të pastrojnë zonën e ndotur, ta sjellin atë në gjendjen e mëparshme, si dhe të shpërblejnë dëmet*”, si dhe nenin 19/1 pika 1, ku citohet: “*Dënimet administrative të dhëna në zbatim të këtij ligji klasifikohen si më poshtë: a) Gjoba është dënim kryesor*”.

Kriteri: Ligji nr.8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, i ndryshuar.

Ndikimi/efekti: Penalitete të paaplikuara për rastet e ndotjes së mjedisit.

Shkaku: Moszbatim i legjislacionit për aplikim penaliteti.

Rëndësia: E mesme

Rekomandim: Në vijimësi nga Drejtoria e Mjedisit në APD të merren masa për aplikimin e penaliteteve në rastet e konstatimit të ndotjes së mjedisit në territorin e Autoritetit Portual Durrës, me qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomik të cilët kryejnë veprimtari në port, dhe pse jo për rritjen e arkëimeve të portit nga këto penalitete.

Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:

Administrimin e mbetjeve urbane të rrezikshme (Problemet mjedisore).

Porti i Durrësit ndodhet në pjesën veriore të gjirit të Durrësit përgjatë vijës bregdetare me shtrirje 1.4 kilometra dhe me një sipërfaqe tokësore prej rreth 650,000 metra katror. Porti i Durrësit, është një nga portet më të vjetra të Europës në detin Adriatik dhe një nga urat ballkanike të komunikimit të perëndimit me lindjen dhe anasjelltas. Ambientet e Portit mirëpresin anije me mallra të natyrave dhe përmasave të ndryshme. Kjo realizohet nëpërmjet 4 Terminaleve që operojnë në Port. Në portin e Durrësit ngarkohen dhe shkarkohen të gjitha



Ilojet e mallrave: minerale, karburante, çimento dhe artikuj të kategorive të ndryshme. Terminali i Konteniereve është i pajisur me të gjithë mekanizmat për përpunimin e tyre.

Drejtoria e Mjedisit në Autoritetin Portual Durrës është krijuar në vitin 2004, me Vendim të Këshillit Mbikqyrës nr.226, datë 11.02.2004 “Për miratimin e krijimit të Departamentit të Mjedisit të APD”.

Aktualisht Sektori i Monitorimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është nën varësinë e Drejtorisë së Mjedisit, Sigurimit Teknik dhe Emergjencave, sipas organogramës aktuale. Sektori i Monitorimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit është i përbërë nga dy njësi, Standartet dhe Monitorimi Mjedisor i përbërë nga 6 specialistë dhe Laboratori Mjedisor i përbërë nga 3 specialistë, si dhe një përgjegjës sektori.

Sipas rregullores organizative të Autoritetit Portual Durrës miratuar në vitin 2016 me Vendim të Këshillit Drejtues nr.8, datë 18.03.2016, Sektori i Monitorimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, është emërtuar si Sektori i Monitorimit dhe Zhvillimit të Mjedisit.

Referuar rregullores organizative dhe menaxhimit të Autoritetit Portual Durrës, ndër të tjera, ky sektor duhet të kryejë detyrat e mëposhtme:

- Garanton dhe monitoron që operacionet dhe projektet e zhvillimit në Autoritetin Portual Durrës, të kryhen në përputhje të plotë me kërkesat e legjislacionit mjedisor dhe Konventave Ndërkombëtare të ratifikuara në Republikën e Shqipërisë.

- Monitoron dhe bashkëpunon në aplikimin e procedurave të dokumentacionit për pajisje me Leje Mjedisore të Projekteve në Autoritetin Portual Durrës.

- Bashkëpunon në hartimin e politikave mjedisore në Autoritetin Portual Durrës në zbatim të legjislacionit mjedisor në Republikën e Shqipërisë.

- Informon personelin në Autoritetin Portual Durrës mbi rëndësinë e çështjeve mjedisore dhe promovon një kulturë biznesi ku brenda zonës portuale, gjithësecili, pavarësisht nga roli dhe pozicioni, inkurajohet të marrë përgjegjësinë për veprimet dhe impaktet mjedisore që gjeneron.

- Promovon politikat mjedisore dhe rëndësinë e tyre tek kontraktorët, nënkontraktorët, qiramarrësit dhe të tjerët që kanë interesa biznesi në territorin e Autoritetit Portual Durrës.

- Sektori është përgjegjës për masat e parandalimit të ndotjeve në mjedis, si për organizimin dhe mbajtjen në gadishmëri të strukturave kundërvepruese në emergjencë dhe për raportimin e situatës tek Drejtoria e Mjedisit, Sigurimit Teknik dhe Emergjencave.

- Në bashkëpunim me PMNZSH dhe FSPD përgatit Planin e Emergjencës dhe ua bën të njohur të gjithë subjekteve bashkëveprues në emergjencë duke bërë kontrolle sistematikë të ndryshimeve në elementët e Planit.

- Zbaton, ndjek dhe bashkërendon punën për përballimin e emergjencave me Drejtorinë e Përgjithshme Detare/Kapitenerinë e Përgjithshme të Porteve, me kompaninë e pastrimit detar të kontraktuar nga APD, FSPD-në, Sektorin e PMNZSH si dhe me subjektet me kapacitete kundërvepruese në rast ndotjeje të ambientit.

- Bashkëpunon në përgatitjen e publikimeve në faqen zyrtare të Autoritetit Portual Durrës të politikave mjedisore në port si dhe organizimin e eventeve mjedisore.

- Kryen monitorimin e Planeve të Menaxhimit Mjedisor për minimizimin e impakteve ambientale gjatë implementimit të projekteve në Autoritetin Portual Durrës, duke hartuar dokumentacionin përkatës si Akt-Inspektime, Raport Monitorimi dhe rekomandimet përkatëse, në përputhje me kërkesat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në lidhje me çështjet mjedisore, aktet e nxjerra nga organet drejtuese të APD-së, marrëdhëniet kontraktuale midis palëve, përsa i takon monitorimit të kontratave koncensionare apo edhe aktiviteteve të ndryshme



- Kryen monitorim periodik të parametrave mjedisorë, si cilësia e ajrit, ujit dhe niveli i zhurmave nëpërmjet pajisjeve laboratorike bashkëkohore.
- Kujdeset për pajisjet e laboratorit dhe bën planifikimin për materialet e konsumit, për të qenë në efikasitet të plotë, konform Standardit Shqiptar për Laboratorin, S.SH.EN ISO/IEC: 17025:2006.
- Njësia e Laboratorit Mjedisor funksionon në bazë të një Rregulloreje “Për organizimin dhe funksionimin e Laboratorit Mjedisor” miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues, nr.11, datë 19.04.2018.

D....

Kalata nr.6

Në zbatim të Urdherit të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr. 1291 Prot, datë 21.04.2017 “Mbi ngritjen e Grupit të Monitorimit të Kontratës së Koncesionit “Për menaxhim, operim, mirëmbajtjen, e përmirësimin teknik të Terminalit të Konteniereve në Portin e Durrësit”, përfaqësuesit e autorizuar duhet të ndjekin Monitorimin Mjedisor dhe Social të Zhvillimit të aktivitetit nga kompania koncesionare.

Çdo muaj, përfaqësuesit e autorizuar duhet të protokollojnë:

- Tabelën mbi Raportimin Mjedisor & Social, të konfirmuar nga përfaqësuesit e autorizuar të monitorimit, në përbërje të Sektorit të Monitorimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Akt-konstatimet nga përfaqësuesit e autorizuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.

Në çdo akt-konstatim duhet të përshkruhet situata mjedisore gjatë inspektimit të kalatës nr.6 dhe sheshit të depozitimit.

E...

Kalata nr.10-11

Bazuar në Urdhrin e Brendshëm nr.1298, datë 21.04.2017 “Për një ndryshim në Urdhrin e Brendshëm nr.996, datë 30.03.2016, mbi funksionimin e monitorimit të kontratës së koncesionit “Për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen e Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”, përfaqësuesit e autorizuar raportojnë nëpërmjet akt-konstatimeve:

- Raporti ditor i anijeve;
- Konstatime vizuale gjatë monitorimit;
- Informacione shoqëruese (temperatura e ditës, shpejtësia e erës, etj);
- Komente për situatën gjatë monitorimit;

Bashkëlidhur akt konstatimeve, përfaqësuesit e laboratorit raportojnë analizat e laboratorit mjedisor në lidhje me ndotjet akustike, ndotjet e ajrit dhe ujit të detit.

A...

Kalata nr.7-8

Në zbatim të Urdhërit të Brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr.966/1, datë 30.03.2016 “Mbi ngritjen e Grupit të Monitorimit të Kontratës së Koncesionit për menaxhimin, operimin, mirëmbajtjen e përmirësimin teknik të Terminalit të Tragetëve në Portin e Durrësit”, i ndryshuar me Urdhrin nr.1290, datë 21.04.2017.

Çdo muaj përfaqësuesit e autorizuar duhet të protokollojnë:

- Tabelën mbi Raportimin Mjedisor & Social, të konfirmuar nga përfaqësuesit e autorizuar të monitorimit, në përbërje të Sektorit të Monitorimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit;
- Akt-konstatimet nga përfaqësuesit e autorizuar me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv.



Në çdo akt-konstatim duhet të përshkruhen analizat e kryera dhe vlerat e parametrave mjedisore për ambientet e mbyllura si temperatura, trysnia atmosferike, sasia e lagështisë, sasia e monoksidit të karbonit CO dhe sasia e dioksidit të karbonit CO₂.

Kontratat e licencës për Ngarkim-Shkarkim

Kalata nr.1

Në zbatim të Urdhrit nr.1285, datë 21.04.2017 “Për një ndryshim në Urdhrin e Brendshëm nr.2851, datë 30.09.2010 “Mbi përcaktimin e pozicioneve përgjegjëse për Monitorimin e Kontratave për ngarkimin dhe shkarkimin e mallit në Portin e Durrësit”, i ndryshuar me urdhërin nr.378, datë 09.02.2011 dhe për një ndryshim në Urdhrin e Brendshëm nr.3422, datë 09.11.2010 “Mbi emërimin e përfaqësuesit të Autoritetit Portual Durrës në çeshtjet, lidhur me zbatimin e kontratave të lidhura ndërmjet këtij autoriteti dhe kompanive të ngarkim shkarkimit”, i ndryshuar me Urdhrin e Brendshëm nr.540, datë 15.02.2016 dhe gjithashtu me kontratën nr.2197, e lidhur me kompaninë A... me datë 21.07.2009 dhe udhëzimit nr.2834, datë 29.09.2010 “Për menaxhimin dhe monitorimin e kontratave të ngarkim shkarkimit në Portin e Durrësit” dhe në Planin e Menaxhimit Mjedisor nr.2820, datë 14.11.2012, përfaqësuesit e autorizuar raportojnë çdo muaj nëpërmjet akt-inspektimeve:

- Raportin Ditor të anijeve;
- Konstatime gjatë Monitorimit;
- Informacione shoqëruese (temperatura e ditës, shpejtësia e erës, etj);
- Foto gjatë monitorimit.

Kalata nr.4-5

Në zbatim të Urdhërit nr.1285, datë 21.04.2017, “Për një ndryshim në Urdhrin e Brendshëm nr.2851, datë 30.09.2010 “Mbi përcaktimin e pozicioneve përgjegjëse për Monitorimin e Kontratave për ngarkimin dhe shkarkimin e mallit në Portin e Durrësit”, i ndryshuar me urdhër nr.378, datë 09.02.2011 dhe për një ndryshim në Urdhrin e Brendshëm nr.3422, datë 09.11.2010 “Mbi emërimin e përfaqësuesit të Autoritetit Portual Durrës në çeshtjet lidhur me zbatimin e kontratave të lidhura ndërmjet këtij autoriteti dhe kompanive të ngarkim shkarkimit”, i ndryshuar me Urdhrin e Brendshëm nr.540, datë 15.02.2016 dhe gjithashtu me kontratën nr.362 e lidhur me datë 31.05.2005 me kompaninë E..., Amendamentin e kontratës nr.1605 prot, datë 22.05.2015 dhe Udhëzimit nr.2834, datë 29.09.2010 “Per menaxhimin dhe monitorimin e kontratave te ngarkim shkarkimit në Portin e Durrësit”, si dhe Planit të Menaxhimit Mjedisor nr.2902, datë 24.11.2011, përfaqësuesit e autorizuar raportojnë çdo muaj nëpërmjet akt-ispektimeve:

- Raportin Ditor të anijeve;
- Konstatime gjatë Monitorimit;
- Informacione shoqëruese (temperatura e ditës, shpejtësia e erës, etj);
- Foto gjatë monitorimit.

Laboratori Mjedisor

Përfaqësuesit e autorizuar raportojnë çdo muaj në kuadër të kontrollit rutinë të parametrave mjedisore të Autoritetit Portual. Në programin vjetor të monitorimit janë përzgjedhur pikat e monitorimit: cilësisë së ajrit, nivelit të zhurmave dhe të ujit në akuarium, duke marrë në konsideratë faktorë të ndryshëm si:

- Tipologjia e aktivitetit të zonës portuale;
- Tipi dhe numri i mjeteve që përdoren;
- Afërsia me aktivitete të tjera të cilat ndikojnë në efikasitetin e matjes;



- Fluksi i anijeve;
- Largësia nga zonat e banuara në vijë ajrore;
- Aktivitetet gjatë orëve të ditës dhe të natës, etj.

Në çdo raportim përcaktohen aparaturat e përdorura dhe pikat e matjes së cilësisë së ajrit duke përmbledhur rezultatin e matjeve si më poshtë:

- Përmbajtje grimcash totale në ajer;
- Lagështi relative, presion dhe temperaturë e ajrit;
- Përmbajtje në ajër e dioksitit të karbonit CO₂;
- Niveli i zhurmave;
- Kripshmëria, Ph, temperatura, konduktiviteti, P-PO₄: N-NO₂: Fe, Ni, Cu, Fe, Cr, Na, Cl, Ca, Al, N-NH₄, Zn.

Pastrimi i tokës

Në përputhje me kontratën nr. 55, datë 09.01.2018, dhe në zbatim të UB me nr.61 prot, datë 11.01.2018, do të bëhet monitorimi ditor i pastrimit të territorit të APD nga firma e pastrimit “R...” shpk.

Pastrimi i detit

Në zbatim të Kontratës me Nr. Reference 36 PH 2011, me objekt “Pastrimi i akuatoriumit”, do të bëhet monitorimi ditor i punës për mirëmbajtjen e akuariumit nga kontraktori privat “Pastrimi Detar” shpk.

- Çdo muaj Drejtoria e Mjedisit harton një plan pune për muajin pasardhës si dhe raporton për veprimtarinë e kryer në muajin e përfunduar. Këto raporte hartohen nga përgjegjësi i sektorit dhe miratohen nga drejtori i mjedisit. Raportet përmbajnë objektivin, përshkrimin e objektivit, personat përgjegjës, afatin për realizimin e objektivit, si dhe personin kontrollues. Referuar raportimit të muajit maj 2018, objektivat për këtë muaj janë: menaxhimi ambjental i tokës, verifikim i përditshëm i burimeve ndotëse në akuarium, monitorim i kontratave liçencë për shërbimin e ngarkim – shkarkimit, monitorim i kontratave koncensionare, mbi pjesëmarrjen në komisionin për përgatitjen e informacionit specifik dhe përlllogaritjen e fondit limit për “Shërbim – hartim projekti për shtimin e sipërfaqeve të reja në zonën lindore të portit i integruar me projektin e thellimit”, mbi mirëfunksionimin e laboratorit mjedisor, mbi marrjen e masave për sezonin veror, plani mjedisor & social si dhe monitorimi mjedisor & social për terminalin e trageteve Durrës, faza e shfrytëzimit, pjesëmarrje në trajnim, mbi komisionin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit me titull “Mirëmbajtje Gjelbërimi” dhe blerje kite për laboratorin mjedisor.

- Referuar analizës vjetore 2017 të përgatitur nga Drejtoria e Mjedisit, gjatë vitit 2017 janë konstatuar problematikat e mëposhtme:

Gjatë monitorimit të kontratave të shërbimit gjatë vitit 2017 në Sektorin e Mjedisit ka patur një sërë vonesash apo mosrealizimesh të detyrave të Sektorit që konsistojnë në:

a) Mungesën e shërbimit të pastrimit për 6 muajorin e dytë të vitit 2017. Kontrata e pastrimit të ambjenteve të jashtme të APD përfundoi në muajin Qershor të vitit 2017, më pas gjatë vitit pati shumë probleme me menaxhimin e mbetjeve të gjeneruara nga zyrat dhe përpunimi i anijeve, problematikë e cila zgjati deri në fund të vitit 2017. Kontrata e re është lidhur më 9 Janar 2018.



b) Mos realizimi i procedurës së tenderit për kontratën e Mirëmbajtjes së Gjellbërimit për 6 mujorin e dytë të vitit dhe aktualisht nuk ka shërbim. Procedura do të realizohet pas miratimit të Plan Biznesit 2018.

c) Mbetet e pa miratuar nga ana e Drejtorisë Ekzekutive Draft Rregullorja e Laboratorit Mjedisor, e cila në zbatim të rekomandimeve të KLSH dhe Auditit të Brendshëm, është rishikuar dhe ridërguar 2 herë për miratim gjatë vitit 2017.

Gjatë monitorimit të kontratave Koncesionare dhe të Kompanive të Ngarkim Shkarkimit nga Sektori i Mjedisit në 2017 paraqiten problematikat si më poshtë:

Monitorimi i kontratave liçencë për kompanitë e ngarkim – shkarkimit, gjatë vitit ka patur problematika në mënyrën si përpunohen mallrat dhe gjendja jo e mirë e kalatave dhe shesheve pas përpunimit të mallit.

a) E...

Ky operator në përgjithësi kryen proceset e ngarkim – shkarkimit në mallrat rifuxho siç janë: grurë rifuxho, dap rifuxho, çimento rifuxho, xhama me arka dhe paleta, etj. Gjatë monitorimit të këtij operatori janë hasur problematika në ndotjen e ajrit për shkak të mallrave rifuxho që ky operator përpunon, veçanërisht në kalatat 4 dhe 5. Këto kalata janë në një pozicion të afërt me qytetin dhe shpesh herë në prezencë të erës ka patur probleme gjatë përpunimit. Operatori është njoftuar nga Drejtoria e Mjedisit për problemet mjedisore dhe janë marrë masa për minimizimin e këtij problemi.

b) A...

Ky operator kryen procesin e ngarkim – shkarkimit të mallrave me paleta ose lidhje, veçanërisht melaminë dhe në pak raste mall rifuxho. Gjatë monitorimit të këtij operatori është vënë re se në kalatën 2 ku përpunohet malli apo edhe gjatë sistemimit të tij në sheshin e magazinës 4 – 5 krijohen pirgje mbeturinash. Shpesh ndodh që mbeturinat të depozitohen në gropat e hapura në kalatë dhe sheshin e kësaj kalate për shkak të amortizimit të saj. Është konstatuar se pas përfundimit të procesit të ngarkim – shkarkimit, kalata apo sheshi nuk pastrohet direkt nga operatori. Përgjithësisht është njoftuar verbalisht për kthimin e kalatës në gjendjen e mëparshme.

c) L...

Ky operator në shumicën e rasteve përpunon mallra rifuxho si: grurë rifuxho, sojë, bërsi ulliri, çimento rifuxho, misër rifuxho, hekur me lidhje apo hekur rrotativ, etj. Në monitorimet periodike të punës që kryen operatori, janë konstatuar ndotje të ajrit dhe tokës sidomos në rastet kur përpunohet mall rifuxho dhe kur kushtet atmosferike nuk janë të favorshme (erë e fortë). Ky operator i kryen proceset e ngarkim - shkarkimit në kalatat 1, 4 dhe 5.

Monitorimi i kontratave konçensionare.

a) E...

Në këtë terminal kryhet procesi i ngarkim – shkarkimit të mallrave rifuxho siç janë: qymyr rifuxho, çimento rifuxho, pirit rifuxho, nikel rifuxho dhe skrap. Gjatë monitorimeve të vazhdueshme kemi konstatuar se në sheshin e kalatës 11 është i depozituar minerali nikel. Në këtë shesh ndodhen puseta të ujrave të shiut, për këtë arsye në kohë me shi ka prezencë të mineralit nikel në akuarium. Minerali derdhet në det nga kanali i ujrave të shiut i cili ndodhet në fillimin e kalatës 10. Në këtë shesh në kohë me shi ka grumbullim të ujit dhe bllokim të kanaleve kulluese të ujrave të shiut. Operatori është njoftuar për këtë problem dhe herë pas here ka marr masa për pastrimin e zonës por çedimi i gjithë sheshit bën që ky mineral të depozitohet përsëri në det.

b) D....



Në këtë terminal përpunohen kontenerierë. Në përgjithësi përpunimi i mallit në këtë terminal nuk ka probleme, me përjashtim të problematikës së një ofiçine të ngritur pa leje brenda ambienteve të terminalit, e cila shkakton ndotje vizuale, ndotje fizike, ky problem është raportuar herë pas herë nga ana e Drejtorisë së Mjedisit. Drejtoria ka informuar me shkresën nr.545 prot, datë 13.12.2017 edhe Drejtorin Ekzekutiv, njëkohësisht u zhvillua një takim me përfaqësuesit e terminalit, u la detyrë largimi i ofiçinës brenda 10 ditëve. Momentalisht ofiçina e cila ka qenë në ambjentet e D...-së, është zhvendosur tek ambjenti i ri që kanë marrë me qera pranë ofiçinës së APD-së. Gjithashtu si pasojë e rrjedhjes së vinçit kalata ndotet herë pas herë me vaj. Në raste të tilla kompania merr masa për pastrimin kalatës dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme. Konkretisht ky proces është kryer 8 herë për vitin 2017.

c) A...

Në këtë terminal punohet me tragete dhe pasagjerë. Është një terminal që nuk paraqet probleme mjedisore, edhe për vet natyrën e punës që kryen. Gjatë vitit 2017 ka patur dy incidente të cilat kanë marrë zgjidhje edhe me bashkëpunimin e përfaqësuesve të kompanisë A....

Konkretisht, në muajin Shkurt 2017 ka patur një incident vajor në zonën e parkimit doganor. Një autobus me naftë i sekuestruar dhe i parkuar në ambjentet e A...-s u konstatua që kishte rrjedhje. Gjithashtu në Maj 2017 u njoftuam nga salla operative për një ndotje vajore në tokë. Kishte rrjedhje karburanti nga një makinë e cila ishte e vendosur mbi një karrotrec. Për të dyja rastet u komunikua me përfaqësuesit terminalit, të cilët nga ana e tyre morën masa të menjëhershme për pastrimin e zonës.

Si përfundim:

- Për periudhën 01.05.2016-30.06.2018, nga ana e Drejtorisë së Mjedisit janë konstatuar 20 raste të cilat kanë ndikuar në ndotjen e mjedisit të Autoritetit Portual Durrës. Nga këto situata, vetëm në 1 rast është aplikuar masa e dënimit me gjobë, saktësisht me “Vendimin për Dënim Administrativ” nr.12 datë 05.06.2017 të inspektorëve të ISHMP për operatorin “E...”, i cili më pas është rrëzuar nga gjykata duke i dhënë të drejtë koncesionarit, ndërsa në asnjë rast tjetër nuk është dhënë masa gjobë për këto subjekte, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar nga ndotja dhe dëmtimi”, i ndryshuar, neni 14 pika 1, ku citohet: “*Personat fizike dhe juridike, që kanë shkaktuar ndotjen e mjedisit detar, detyrohen të pastrojnë zonën e ndotur, ta sjellin atë në gjendjen e mëparshme, si dhe të shpërblejnë dëmet*”, si dhe neni 19/1 pika 1, ku citohet: “*Dënimet administrative të dhëna në zbatim të këtij ligji klasifikohen si më poshtë: a) Gjoha është dënim kryesor*”.

- Nga auditimi u konstatua se nuk ka një regjistër të ngjarjeve të ndodhura apo që mund të ndodhin në të ardhmen, të cilat kanë ndikuar apo mund të ndikojnë negativisht në ndotjen e mjedisit detar dhe tokësot të Portit të Durrësit, veprim në kundërshtim me Ligjin nr.9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, neni 40 pika 3 ku citohet: “*Shërbimi i mbrojtjes së mjedisit regjistron të gjitha rastet e veprimeve që çenojnë mjedisin dhe zbaton rregulloret, vendimet dhe udhëzimet e autoritetit portual, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, me sistemet dhe praktikatat e pranuar nga shteti shqiptar për mbrojtjen e mjedisit dhe të tokës së portit*”.

Në lidhje me observacionin me nr. 3349/1 prot, datë 01.08.2018 të dërguar nga B. H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Mjedisit, Sigurimit Teknik dhe Emergjencave, për aktkonstatimin nr. 3 me nr. 3349 prot, datë 27.07.2018, si dhe observacionin dërguar me shkresën përcjellëse nr. 3476/1 datë 10.09.2018, protokolluar në KLSH me nr. 579/4, datë



12.09.2018, sqarojmë se: argumentat e paraqitura janë sqarues dhe jo kundërshtues të konstatimeve të grupit të auditimit. Gjithashtu theksojmë se këto konstatime janë në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të mbetjeve dhe ndotjeve në portin e Durrsit, dhe duhet te kihen ne konsiderate nga ana juaj ne zhvillimin e punes per permiresimin mjedisor te APD.

Observacioni i bërë nga I. H. për proceverbalin dhe projektraportin për mos përgjegjësinë e tij për çështjen e trajtuar si më sipër është i drejt, për pasoj është marrë në konsideratë në hartimin e Raportit Përfundimtar.

12. Zbatimi i procedurave për arkivimin e dokumentacionit referuar Modeli nr. 8 “Norma tekniko profesionale dhe metodologjisë të shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”.

Funksionimi i arkiv–protokoll në Autoritetin Portual Durrës është ndërtuar bazuar në Ligjin nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivin”. Të gjitha dokumentet që kanë dalë nga Autoritetin Portual Durrës janë të përpiluara me: Logon e miratuar dhe emërtimin e shoqërisë, siglën e njësisë përpiluese, numrin e protokollit të korrespondentit, formulën në përgjigje ose vijim të shkresës, numrin e lidhjeve, tekstin e dokumentit, funksionin, emrin e personit që nënshkruan dokumentin dhe nënshkrimin e tij, numrin e kopjeve, datën e punimit, numrin e kopjeve, afatin e ruajtjes si dhe vulën. Këto dokumente kanë datën, numrin e protokollit dhe firmën e titullarit.

Protokolli është sektori që merret me regjistrimin e korrespondencës që hyn dhe del në Autoritetin Portual Durrës në mënyrë shkresore, fax, postë ku protokollohet dhe përcillet për te administratori për të përcaktuar afatet e trajtimit që varjon 5-30 ditë dhe ajo urgjente brenda ditës.

Përgatitja e dërgimit për të gjitha kopjet e shkresës duhet të ketë 1 origjinale dhe 2 kopje dhe pas dërgimit i kthehet njësisë përpiluese për konfirmim dërgimi. Në zarfe duhet të figurojë adresa e dërguesit si dhe numri i dokumentit në regjistrin e korrespondencës si dhe adresa e marrësit. Firma për dokumente jashtë shoqërisë duhet të vendoset nga Administratori ose një person i autorizuar me prokurë ndërsa për njësi të tjera te shoqërisë nga persona të autorizuar. Kriteret e Protokollimit nga ky sektor konsistojnë në kontrollin, kompletimin dhe rregullsinë e shkresës që plotëson vlerën juridike të aktit. Vendos datën dhe numrin e protokollit. Regjistrohet në librin e protokollit si për shkresat që vijnë dhe për ato që dalin.

Çdo vit libri i protokollit fillon me numër të ri rendor, pra numrin 1 dhe vazhdon në mënyrë progresive si për shkresat hyrëse dhe dalëse. Në libër shënohet qartë institucioni ose personi nga vjen letra dhe i dërgohet personave përkatës.

Një statistikë e dokumenteve të hyra dhe të dala gjatë gjithë periudhës së auditimit jepet si më poshtë:

Tabela nr.1, Të dhënat e shkresave në arkiv e protokoll për vitet 2016, 2017, 6 mujori i parë 2018

Viti	Arkiv 2016	Protokoll 2016
	Dokumente të hyra	Dokumente të hyra/dalëse pa fraksione
	1540	3843
Viti	Arkiv 2017	Protokoll 2017
	Dokumente të hyra	Dokumente të hyra/dalëse pa fraksione



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

	1655	3379
Viti	Arkiv 2018	Protokoll 2018
	Dokumente të hyra	Dokumente të hyra/dalëse pa fraksione
	1115	2821

Burimi i të dhënave: AP Durrës

Dokumentet e arkivuara për periudhën 2016, 2017, 6 mujori i parë 2018, janë shkresa të cilat janë dokumente të përpunuara në këtë periudhë, të cilat i përkojnë periudhës së vitit paraardhës të përpunuara në arkiv gjatë viteve 2016, 2017, 6 mujori i parë 2018.

Në total për periudhën 2016, 2017, 6 mujori i parë 2018, në protokoll kanë hyrë dhe dalë shkresa, pa përfshirë shkresat me fraksione, që vijnë si rezultat i plotësim të vendeve të zëna në regjistrin e protokollit për shkresa dhe mbyllje procedurash për kthim përgjigje. Në shume raste janë evidentuar shkresa që kanë kaluar afatet kohore për mbylljen e procedurave dhe ato rezultojnë të hapura, sidomos shkresa të iniciuara ose të deleguara në departamentin e çështjeve juridike të cilat zgjasin në kohë.

Të gjitha dokumentet e brendshëm të cilat i janë dërguar një organi tjetër, janë shoqëruara me shkresë përcjellëse. Këto dokumente janë të gjitha të protokolluara dhe të firmosura nga titullari i institucionit.

Dokumentet që dalin jashtë subjektit shtetëror, janë të mbyllura në zarfe ose në pako. Në anën e majtë të tyre kanë të shënuar adresën e dërguesit dhe numri që ka marrë dokumenti në regjistrin e korrespondencës, kurse në të djathtë është vënë shënimi “sekret” kur dokumenti është klasifikuar, dhe vula. Në dokumentet të cilat janë dërguar në emër të titullarit, mbi zarf vihet shenja “personale”. Të gjitha dokumentet e dala jashtë subjektit janë të evidentuara në librin e dorëzimit.

Për sa i përket dokumenteve hyrëse, ato janë të regjistruara në regjistrin e korrespondencës. Është bërë shënimi në to numri i protokollit dhe data e marrjes, i janë dhënë titullarit dhe sipas drejtimit, janë shpërndarë në sektorët përkatës kundrejt firmës.

Është kontrolluar inventari i dosjeve i cili është hartuar nga arkivi në bashkëpunim me sektorët përkatës. Është konstatuar se inventari i dosjeve, është hartuar duke u bazuar në inventarin e dosjeve të viteve të mëparshme, në drejtimet e veprimtarisë së subjektit dhe në listën e dokumenteve të subjektit me afatet e ruajtjes.

Gjatë auditimit është konstatuar se janë përpiluar pasqyrat emërtuese në regjistër, në bazë të gjitha kriterëve arkivore të cilat janë: të objektit, të autorit, të korrespondentit, të ndarjes territoriale – administrative, të llojit të dokumentit, të kohës. Kjo pasqyrë hyn në fuqi mbasi miratohet nga titullari.

Të gjitha pasqyrat emërtuese të çeljeve të dosjeve janë hartuar veç për ato me vlerë ruajtje të përkohshme dhe janë bërë në dy ekzemplar ku njëri qëndron në arkiv që është i përgjithshëm për të gjithë sektorët dhe tjetri është i veçantë për çdo sektor dhe ju është shpërndarë sektorëve përkatëse.

Është konstatuar se arkivi brenda 6- mujorit të parë të çdo viti pasardhës ka mbyllur dosjet e hapura sipas pasqyrës emërtuese të çeljes së tyre.

Zyra Arkivore Autoriteti Portual Durrës është zyra që merret me grumbullimin, përpunimin, ruajtjen (fizike e teknologjike) të dokumenteve, si dhe administrimin e vënien në shfrytëzim të fondit dokumentar (arkivor) Autoriteti Portual Durrës të, i cili është pjesë e Fondit Arkivor Kombëtar.

Bazuar në rregulloren e brendshme të Autoriteti Portual Durrës detyrat e Zyrës Arkivore janë:



Pranimi i dokumenteve nga sekretaria e sektorët si dhe evidentimi i tyre në regjistrin e inventarit të fondit.

Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve. Ruajtja fizike e teknologjike e dokumenteve (pasurisë dokumentare) që ndodhet në Arkiv (nëpërmjet pastrimit të ambienteve dhe sigurimit të kushteve të ruajtjes).

Organizimi punës për shfrytëzimin e dokumenteve për plotësimin e kërkesave operative, duke hartuar për këtë qëllim edhe mjete të ndryshme informative.

Bazuar në Ligjin nr.9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe në Rregulloren “Norma tekniko-profesionale dhe metodologjike e shërbimit arkivor në RSH”, administrimi i dokumenteve në zyrën Arkivore e Autoriteti Portual Durrës bëhet nëpërmjet:

- Regjistri inventarit të fondeve model 14
- Regjistri inventarit të dokumenteve teknike.
- Regjistri i shfrytëzimit model 15.
- Dosja e fondit ku futen këto dokument (Historiku i fondit krijuesit, procesverbale të pranimit të dokumenteve në Arkiv dhe dorëzimit apo të lëvizjes së dokumenteve. Vendimet e Autoriteti Portual Durrës, listën e dokumenteve me afatet e ruajtjes model 11. Listat e veçimit për asgjësim model 10 të dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes dhe procesverbalet e asgjësimit model 12, inventarët model 7 të dokumenteve RHK dhe të përkohshme).

Aktualisht në zyrën arkivore kryhen këto detyra:

- Marrja e grumbullimi i dokumenteve nga protokolli dhe nga sektorët.
- Përpunimi tekniko-shkencor i dokumenteve sipas planit.
- Përgatitja dhe dërgimi i fotokopjeve të dokumenteve që kërkohen nga sektorët. Pastrimi dhe sistemimi i dosjeve në vend ruajtjen e dokumenteve.
- Ndiqen procedurat e veçimit dhe asgjësimit të dokumenteve që kanë plotësuar afatin e ruajtjes.

13. Auditimi i databazës së sistemit të hyrje-daljeve në territorin e APD

Nga auditimi në terren mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës u konstatua se:

Mënyra e aplikimit për leje në territorin e APD është e rregulluar sipas udhëzimit të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr.2972/1, datë 25.09.2009 “Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës”. Në këtë udhëzim janë përcaktuar dhe formularët tip për aplikimin dhe për pajisje me leje hyrje-dalje në port sipas kategorive të përcaktuara.

Nga auditimi u konstatua se:

- Nga auditimi u konstatua se udhëzimi nr.2972/1, datë 25.09.2009 “Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës”, i drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv dhe formularët tip për aplikimin dhe për pajisje me leje hyrje-dalje në port sipas kategorive të përcaktuara janë bazuar në sistemin e vjetër të chekimit në APD e për pasojë kanë nevojë për tu përshtatur me kushtet e reja të sistemit të chekimit të ri në port të implementuar së fundmi.

Gjatë printimit të lejeve ditore të vizitorëve kërkohet miratim nga stafi i sigurisë së FSPD (Forcat e Sigurisë Porti Durrës) në mënyrë manuale nga oficeri i sigurisë në postin e punës ose me konfirmim nga salla operative për ti dhënë dakortësinë ose jo të kalimit të vizitorit që aplikon për leje.



Gjatë këtij procesi u vu re se leja ditore e vizitorit që aplikonte dhe merrte statusin OK mund të gjenerohej më shumë se njëherë, duke rritur rrezikun e përdorimit të kësaj leje nga persona të tjerë pavarësisht se leja duhet të kontrollohet fizikisht nga oficeri i sigurisë mbi përputhshmërinë e gjeneraliteteve të personit që e posedonte.

Në lidhje me këtë çështje grupi i auditimit në bazë të udhëzimit të brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr.2972/1, datë 25.09.2009 “*Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës*”, kërkoi ti vihej në dispozicion informacioni si më poshtë:

- Loget e të dhënave të hyrje-daljeve që popullohen nëpërmjet fotografimit dixhital të kamerave nga sistemi i ri i implementuar në APD “Sistemi i kontrollit të hyrje-daljeve (makina, këmbësorë) në ambientet e jashtme dhe lëvizjet e brendshme në godina të APD-s” që nga momenti i implementuar i sistemit deri më datë 30.06.2018;
- Loget për targat e makina që futen dhe dalin në territorin e APD të cilat kanë kryer pagesën përkatëse;
- Listën e mjeteve që janë të lejuar (autorizuar) të futen në APD pa pagesë;
- Listën e lejeve vjetore për vitin 2017.

Në dispozicion të grupit të auditimit u vu:

-Loget e të dhënave të hyrje-daljeve që popullohen nëpërmjet fotografimit dixhital të kamerave nga sistemi i ri i implementuar në APD “Sistemi i kontrollit të hyrje-daljeve (makina, këmbësorë) në ambientet e jashtme dhe lëvizjet e brendshme në godina të APD-s” u vunë për periudhën nga 22.01.2018 deri më 31.03.2018. **Nuk u vu në dispozicion informacioni nga muaji shtator 2017 deri 22 janar 2018 si dhe 01.04.2018 deri 30.06.2018. Pra është vënë në dispozicion pjesërisht.**

- Loget për targat e makina që futen dhe dalin në territorin e APD të cilat kanë kryer pagesën përkatëse;

- Listën e mjeteve që janë të lejuar (autorizuar) të futen në APD pa pagesë;

- Listën e lejeve vjetore për vitin 2017.

Nga auditimi i bazës së të dhënave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, të cilat janë gjeneruar nga sistemi i kontrollit të hyrjeve dalje mbi efektivitetin e mbledhjes së të ardhurave të gjeneruara nga lëshimi i lejeve të ndryshme të përcaktuara në udhëzimin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr.2972/1, datë 25.09.2009 “*Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës*” u konstatua se për periudhën 22 janar – 31 mars 2018 janë futur në territorin e Autoritetit Portual Durrës në total 96305 automjete pa paguar tarifën e hyrjes port, veprim në kundërshtim me udhëzimin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr.2972/1, datë 25.09.2009 “*Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës*”.

Periudha	Nr.i automjeteve të hyra	Nr.i automjeteve që nuk kanë kryer pagesën e tarifës hyrëse	Tarifa e miratuar (në lekë)	Vlera e munguar (në lekë)
22-31 janar 2018	27589	23529	240	5,646,960
1-14 shkurt 2018	19639	16351	240	3,924,240
15-28 shkurt 2018	19588	16616	240	3,987,840
1-15 mars 2018	20230	16618	240	3,988,320
16-31 mars 2018	27077	23191	240	5,565,840



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT AUDITIMI I USHTRUAR NË AUTORITETIN PORTUAL DURRËS

Totali	114123	96305	240	23,113,200
---------------	---------------	--------------	------------	-------------------

**përpunuar nga grupi i auditimit*

Nga sa më sipër konstatohet se për periudhën 22-31 janar 2018 kanë hyrë në port pa paguar tarifën e hyrjes 23529 automjete, për periudhën 1-14 shkurt 2018 kanë hyrë në port pa paguar tarifën e hyrjes 16351 automjete, për periudhën 15-28 shkurt 2018 kanë hyrë në port pa paguar tarifën e hyrjes 16616 automjete, për periudhën 1-15 mars 2018 kanë hyrë në port pa paguar tarifën e hyrjes 16618 automjete dhe për periudhën 16-31 mars 2018 kanë hyrë në port pa paguar tarifën e hyrjes 23191 automjete.

Në total numri i automjeteve të hyra në port pa paguar tarifën është 96305 dhe vlera 23,113,200 lekë ($96305 \text{ automjete} \times 240 \text{ lekë} = 23,113,200 \text{ lekë}$) përbën të ardhura të munguara për buxhetin e APD.

Referuar sa cituar si mësipër, grupi i auditimit nuk mund të jap një opinion të plotë dhe të saktë, mbi zbatimin e kuadrit rregullator mbi të cilin ka vepruar Autoriteti Portual Durrës për **regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës**, si dhe grupi i auditimit shprehet me rezervë për saktësinë dhe vërtetësinë e vlerës 23,113,200 lekë, vlerë e cila në këto kushte vlerësohet si e ardhur e munguar për llogari të Autoritetit Portual Durrës dhe Buxhetit të Shtetit.

Veprimet e mesiperme janë në kundërshtim me udhëzimin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr. 2972/1, datë 25.09.2009 “Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës” dhe Urdhërin e Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 24, datë 08.01.2018 Për miratimin e Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e strukturës së sigurisë portuale të Autoritetit Portual Durrës”. Vlera 23,113,200 lekë përbën të ardhura të munguara për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, cka ngarkon me përgjegjësi A. B. me detyrë drejtor i APD, S. S. me detyrë drejtor i FSPD, dhe D. P. me detyrë oficer i sigurisë portuale.

Kthim përgjigje Observacioneve për pikën të ndryshme të dala gjatë auditimit, “mbi rregjimin e hyrje daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e APD” si dhe observacionet mbi Projektraportin e Auditimit.

Observacionet mbi Procesverbalin Nr. 17, datë 27.07.2018 si dhe observacionet mbi Projektraportin e Auditimit

1. Lidhur me observacionin “mbi mos vënien në kohë në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar nga grupi i auditimit mbi të dhënat e hyrje daljeve nga sistemi i ri i chekimit në APD” ardhur me shkresën nr. 3338/1, datë 31.07.2018 të APD mbi Procesverbalin nr. 17 datë 27.07.2018 si dhe shkresën nr. 3476/1, datë 10.09.2018 mbi Projektraportin e Auditimit, sqarojmë se:

Nga ana e APD janë paraqitur argumenta përshkruese të cilat nuk japin fakte të reja në lidhje me këtë çështje. Gjatë fazës së terrenit pjestarët e grupit të auditimit kanë të drejtë të kërkojnë informacion në formë shkresore si edhe në mënyrë verbale, bazuar në ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Procesi ose hapat administrative që ndjek subjekti nën auditim për dhënien e informacionit, nuk duhet të jetë pengesë për vonesën e informacionit.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi si më poshtë:

Argumentet nuk merren në konsideratë.



2. Lidhur me observacionin mbi “udhëzimin nr. 2972/1, datë 25.09.2009 “Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës”, i drejtorit të përgjithshëm ekzekutiv dhe formularët tip për aplikimin dhe për pajisje me leje hyrje-dalje në port sipas kategorive të përcaktuara janë bazuar në sistemin e vjetër të chekimit në APD e për pasojë kanë nevojë për tu përshtatur me kushtet e reja të sistemit të chekimit të ri në port të implementuar së fundmi” ardhur me shkresën nr. 3338/2, datë 01.08.2018 të APD mbi Procesverbalin nr. 17 datë 27.07.2018, si dhe shkresën nr. 3476/1, datë 10.09.2018 mbi Projektraportin e Auditimit, sqarojmë se:

Ky udhëzim i përmendur më lart që rregullon hyrje daljet në APD është në fuqi dhe përdoret nga APD, pavarësisht se ju citoni në observacione se “në Planin e Sigurisë së Portit Durrës të miratuar nga Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës është përcaktuar mënyra e kontrollit të lejeve dhe zbatimi i regjimit të hyrje daljeve në APD”. Grupi i auditimit në lidhje me këtë çështje ka rekomanduar që Udhëzimi dhe formularët të përditësohen me sistemin e ri me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të procesit të punës në APD.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi si më poshtë:

Argumentet nuk merren në konsideratë.

konkludoi si më poshtë: 3. Lidhur me observacionin mbi “vendosjen në dispozicion të informacionit mbi bazën e të dhënave të hyrje-daljeve që popullohen nga sistemi i ri i implementuar nga APD” ardhur me shkresën nr. 3338/2, datë 01.08.2018 të APD mbi Procesverbalin nr. 17 datë 27.07.2018, si dhe shkresën nr. 3476/1, datë 10.09.2018 mbi Projektraportin e Auditimit, sqarojmë se:

Grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion informacioni nga muaji shtator 2017 deri 22 janar 2018 si dhe 01.04.2018 deri 30.06.2018. Pra është vënë në dispozicion pjesërisht. Regjistrimi 6-mujor i të dhënave nga backup i sistemit përfshin periudhën (janar-qershor), ku siç është sqaruar më sipër nuk janë dhënë informacioni për të gjithë periudhën.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi si më poshtë:

Argumentet nuk merren në konsideratë.

4. Lidhur me observacionin mbi “auditimin e bazës së të dhënave të vëna në dispozicion të grupit të auditimit të gjeneruara nga sistemi i kontrollit të hyrje daljeve dhe procesin e data analysis që grupi i auditimit ka kryer” ardhur me shkresën nr. 3338/2, datë 01.08.2018 të APD mbi Procesverbalin nr. 17 datë 27.07.2018, si dhe shkresën nr. 3476/1, datë 10.09.2018 mbi Projektraportin e Auditimit, sqarojmë se:

Në bazë të bazës së të dhënave të sistemit të hyrje daljeve që grupi i auditimit mori nga APD u zhvilluan data analysis duke përdorur teknikat CAAT. Përfundimi mbi këtë analizë të të dhënave i është vënë në dispozicion subjektit të audituar APD. Ju sqarojmë se të gjitha pikat që ju keni observuar në lidhje me këtë çështje janë konsideruar gjatë analizës së të dhënave. Janë zbritur:

Lista e personave që kanë leje vjetore;

Lista e personave që kanë akses dhe leje si institucionet si (prokuroria, dogana, policia e kufirit dhe migracionit, antkontrabanda, etj);

Lista e punonjësve të APD;

Lista e lejeve ditore;

Targat e dublikuara;

Lista e targave në output, etj.

Të gjitha listat e sipërcituara janë zbritur nga analiza e të dhënave.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion



Argumentet nuk merren në konsideratë.

Kthim përgjigje Observacioneve për pikën zbatimi i kontratave, “Mbi zbatimin e sistemit të administrimit të burimeve njerëzore, pagave dhe kohëshënuesit”.

Observacionet mbi procesverbalin nr. 18, datë 27.07.2018 si dhe observacionet mbi Projektraportin e Auditimit

1. Lidhur me observacionin mbi “*implementimin dhe përdorimin e projektit “sistemin e administrimit të burimeve njerëzore, pagave dhe kohëshënuesit”* ardhur me shkresën nr. 3339/1, datë 02.08.2018 të APD mbi Procesverbalin nr. 18 datë 27.07.2018, si dhe shkresën nr. 3476/1, datë 10.09.2018 mbi Projektraportin e Auditimit. Në lidhje me observacionet tuaja për vendosjen në punë të disa prej moduleve të këtij sistemi ju sqarojmë se:

Nga verifikimi në terren në lidhje me implementimin e sistemit u konstatua se në APD janë instaluar pajisjet ose терминаlet e aksesit që janë pjesa hardware e projektit dhe janë implementuar modulet përkatëse për “*sistemin e administrimit të burimeve njerëzore, pagave dhe kohëshënuesit*” sipas përcaktimeve të kërkuara me qëllim administrimin, vlerësimin si dhe ndjekjen e burimeve njerëzore. Ky sistem që nga momenti i implementimit deri më datën 27.07.2018, datë në të cilën ka përfunduar auditimi në terren, nuk është vënë në përdorim nga APD.

Grupi i auditimit, pasi shqyrtoi me vëmendje këtë observacion konkludoi si më poshtë:

Argumentet nuk merren në konsideratë.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

- Nga Autoriteti Portual Durrës, të merren masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat nga auditimet kanë rezultuar të pazbatuara, si dhe të ndiqen me vëmendje të posaçme ato të cilat janë në procese gjyqësore.

Menjëherë dhe vazhdimisht

- Për rritjen e efikasitetit në shpenzimet publike, duke zhvilluar procedura prokurimi në përmbushje të kriterëve ligjore, kapaciteteve ekonomike, financiare dhe profesionale, në përzgjedhjen e ofertës më të mirë ekonomike, duke siguruar që Autoriteti Kontraktor të pranojë oferta të cilat janë të përballueshme, të qëndrueshme, të pakushtëzuara dhe të plotësisht të nevojave të saj:

-Nga zyra, ose personat e ngarkuar nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, përllogaritja e vlerës së kontratës, të bëhet duke analizuar koston e mallrave që do të prokurohen, si dhe duke harmonizuar metodat dhe alternativat e përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, në raport me specifikimet teknike.

-Autoriteti Kontraktor, në vijim duhet të hartojë kërkesa të veçanta për kualifikim, që të sigurojë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit në blerjen e mallrave, shërbimeve dhe punëve civile, për të arritur rezultate të dëshirueshme në efektivitetin e përdorimit të fondeve. Këto kërkesa duhet të kenë në konsideratë edhe faktin që të kushtëzojnë kualifikimin e operatorëve në varësi të shlyerjes/ose jo të detyrimeve financiare ndaj APD, zgjidhjes së njëanshme të kontratave, ose mos përmbushjes të të gjitha detyrimeve kontraktore. Ky rekomandim mbështetet në frymën e Ligjit për prokurimin publik, si dhe në rregullat e prokurimit publik.



-Nga APD t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit nga komisionet e vlerësimit të ofertave, i dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve, pasi në disa raste konstatohet jo korrekt.

-Komisioni i vlerësimit të ofertave të vlerësojë drejtë kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të miratuara në dokumentet e tenderit, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organet kompetente.

-Anulimi i procedurave të prokurimit nga autoriteti kontraktor, të kryhet duke analizuar dhe nxjerrë përgjegjësitë për arsyet e procedurave të anuluar, në zbatim të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 "Rregullat e Prokurimit Publik", i ndryshuar. Arsyet për anulimin e procedurës duhet të jenë mjaftueshmërisht bindëse dhe duhet tu komunikohen të gjithë pjesëmarrësve në procedurën e prokurimit.

-Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të zbatohen procedurat ligjore për saktësimin dhe arkëtimin e vlerës 128,230 mijë lekë, që ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave (prokurim, mbulim shpenzimesh me shoqëri sigurimi dhe zbatimin e kontratave etj).

Menjëherë dhe në vijimësi

- Për pajisjet e cekimit elektronik "Ski Data Lite Gate", Terminali i kontenierëve, strukturat drejtuese në APD, duke marrë në konsideratë kohën dhe burimet e nevojshme, të marrin masa për:

a. Riparimin sa më të shpejtë të dy pajisjeve Ski Data Lite Gate, pajisje për kontrollin e hyrje-daljeve në korsinë e daljes tek Terminali i kontenierëve të cilat janë dëmtuar si pasojë e goditjes dhe vendosjen e tyre në funksion.

b. Vendosjen e të gjitha funksionaliteteve të reja të përfituara nga sistemi i ri i checkimit, si dhe pajisjen e të gjithë punonjësve të portit me kartat e reja të aksesit me qëllim uljen e riskut të dublikimit apo interferimit të sistemit të ri të checkimit me atë ekzistues.

Brenda datës 31.12.2018

- Në të ardhmen nga ana e drejtorisë së ekonomisë, financës dhe administrimit në APD të bëhet kujdes dhe të merren masa për disbursimin e pagesave në përputhje me përcaktimet kontraktuale, në përputhje me aktpranimet e mbajtura nga komisionet e marrjes në dorëzim, duke zbritur penalitetet e evidentuara, apo mangësitë në zëra.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Këshilli Drejtues të marrin masat e nevojshme për funksionim e Këshilli Konsultativ, në zbatim të Ligjit nr. 9130, datë 08.09.2003, i ndryshuar.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Nga Autoriteti Portual Durrës të zbatohen procedurat ligjore, për të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, të gjitha objektet që janë regjistruar në "Zërin troje" në kontabiliet, në zbatim të Ligjit nr. 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme", i ndryshuar.

Brenda datës 31.03.2019



-Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa për monitorimin me rigorozitet të kontratave të dhënies të shesheve të hapur për shërbime portuale të ngarkim shkarkimit, duke mos lejuar ndryshimin e destinacionit të përdorimit tyre, në zbatim të VKM nr. 54, datë 5.2.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiotezë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Nga Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masat e nevojshme për përditësimin dhe rishikimin e udhëzimit të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr. 2972/1, datë 25.09.2009 “Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës, si dhe formularët tip për aplikimin dhe për pajisjen me leje hyrje-dalje në port sipas kategorive të përcaktuara, sipas sistemit të ri të chekimit në APD me qëllim përshtatjen me kushtet e reja të sistemit të chekimit të implementuar së fundmi në port.

Brenda datës 31.12.2018

- Drejtoria Ekonomike të kryejë sistemimet përkatëse në kontabilitet dhe në pasqyrat financiare të vitit ushtrimor, për përfitimet e marra nga anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe zv/Drejtorët jo vetëm në lidhje me pagën por edhe ndonjë përfitim tjetër të mundshëm.

Brenda datës 31.12.2018

- Autoriteti Portual Durrës të marrë masa për caktimin e nëpunësit zbatues sipas kërkesave sipas kërkesave rregullatorë në fuqi.

Menjëherë

- Nga Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtoria Ekonomike të merren masa për mbajtjen e evidencës kontabël në programe financiare elektronike duke përfshirë dhe sistemet e reja të rëndësishme IT për raportimin financiar, si Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë (SIFQ), ku mund të mbahen të dhëna të transaksioneve dhe balancave financiare, lidhur me ekzekutimin e buxhetit, pagat, të dhëna për kodifikimin dhe klasifikimin buxhetor e kontabël të të dhënave financiare, në përputhje me bazën ligjore për financat publike, të dhëna për raporte financiare dhe statistika etj.

Brenda datës 31.03.2019

- Këshilli Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa për analizimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga audituesit e pavarur të pasqyrave financiare, duke hartuar një program masash konkrete dhe duke analizuar vazhdimisht ecurinë e zbatimit të tyre, në mënyrë që opinioni për pasqyrat financiare të përmirësohet.

Menjëherë

- Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Mbështetjes Materiale dhe Magazinimit të marrin masa që në të ardhmen në të gjitha rastet e lëvizjeve të punonjësve të magazinës dhe jo vetëm detyra të dorëzohet dhe të merret me inventar, si dhe të hartohen procedura të mirë përcaktuara për këtë qëllim.

Menjëherë dhe në vijimësi



- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria Ligjore të marrin masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjor dhe shkallët e gjykimit ndaj gjithë personave me përgjegjësi materiale që kanë rezultuar me mangësi gjatë procesit të inventarizimit.

Brenda datës 31.12.2018

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrë masa që në të ardhmen në krijimin e grupeve të punës dhe komisioneve për vlerësimin e aktiveve të qëndrueshme dhe artikujve të inventarit të përzgjedh punonjësit që parashikojnë aktet ligjore në fuqi, konkretisht përfshirjen e Nëpunësit Zbatues në këto grupe pune.

Në vijimësi

Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrin masa për:

- Të hartuar akte rregullatore apo proceduriale për të përcaktuar procedurat e ri investimit në depozitë në bankë, mjetet monetare që janë gjendje në arkë dhe bankë në lekë dhe monedhë të huaj.

- Të ngritur grup të veçantë për menaxhimin e aseteve financiare të Autoritetit Portual Durrës.

- Të dokumentuar gjithë procedurën e negocimit me institucionet financiare duke kërkuar rritjen e normave të interesit dhe rritjen e përfitueshmërisë.

- Të shqyrtohet mundësia e investimit të mjeteve monetare në tituj qeveritar (bono thesari dhe obligacione qeveritare) me afate maturimi mbi 1 vit (3 dhe 5 vjeçare) interesat e të cilave janë shumë here më të larta se normat e interesit të bankave të nivelit të dytë duke optimizuar përfitimin nga investimi i aseteve financiare.

Brenda datës 31.12.2018

- Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv dhe Drejtoria Ekonomike të marrin masa që ti dërgojnë Ministrin, pasqyrat financiare të revizionuara përpara mbledhjes vjetore, si dhe të hartojnë raporte duke analizuar situatën ekonomiko financiare të Autoritetit Portual Durrës.

Në vijimësi

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrin masa që punonjësit e APD të ushtronjë detyrën funksionale konform strukturës organizative të miratuar nga Këshilli Drejtues, si dhe përgjegjësi specifike të vendit të punës referuar kontratës individuale.

Menjëherë dhe në vijimësi

- APD dhe Sektori i Promocionit dhe Trajnimeve të marrin masa që përpara marrjes së vendimeve dhe kryerjes së shpenzimeve për pjesëmarrje në aktiviteteve promovimi, si për shembull panairë, të analizojnë përfitimet potenciale nga pjesëmarrja në këto aktivitete duke i krahasuar me kostot përkatëse.

Në vijimësi

- APD dhe drejtoria Ekonomike të marrin masa që në të ardhmen të gjithë punonjësit e APD që dërgohen me punë jashtë vendit të kthejnë paradhëniet e marra për mbulimin e shpenzimeve brenda afateve të përcaktuara.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa në të ardhmen, që shpenzimet për udhëtim dhe dieta për jashtë shtetit të mirë programohen nga sektori përkatës dhe të ndiqet me rigorozitet zbatimi i tyre.



Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa në të ardhmen, që pasojat financiare që vijnë nga kompanitë e fluturimeve, të bëhen prezente në kohën e duhur, duke kërkuar zbatimin Ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi ajror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe duke kërkuar dëmshpërblimin nga agjencitë ku APD ka prerë biletat e udhëtimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa për ndjekur me përgjegjësi të gjitha procedurat gjyqësore dhe në veçanti për ato çështje që janë me rekurs në Gjykatën e Lartë me përfaqësim tekniko-juridik me profesionist me eksperiencë, për minimizuar dëmshpërblimet që mund të vijnë si rezultat i vendimeve në disfavor të APD, si dhe në të ardhmen për çështje e ankimuar të zbatohet me rigorozitet Ligji nr. 8116, datë 29.3.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, i ndryshuar.

Në vijimësi

1. Nga Këshilli Drejtues të analizohet autorizimi i Drejtorit të Përgjithshëm, për aktivitetin (riparimi i dy trageteve dhe tre anijeve të peshkimit) pa delegim kompetence nga autoriteti përkatës (Këshilli Drejtues dhe Ministri), aktivitet i cili nuk është përcaktuar në kuadrin rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e Portit, si dhe dispozitave të tjera që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit, si dhe të merren masa të menjëhershme për ndalimin dhe mos kryerjen e këtij aktivitetit, pa pasur kuadrin e plot ligjor dhe rregullator.

2. Nga Autoriteti Portual Durrës të ndërmerren procedurat ligjore për zgjidhjen e kontratës me "D.P.A.", për kryerje të aktivitetit jashtë marrë veshjes kontraktore me APD, dhe në kundërshtim me Ligjin nr. 9130, datë 08.09.2003 “Për Autoritetin Portual”, VKM nr. 596, datë 10.09.2004 “Për miratimin e statutit të APD dhe për riorganizimin e tij”, vendimin e Këshillit Drejtues nr. 29, datë 15.12.2011 me ndryshimet përkatëse “Mbi miratimin e normës së interesit, limitet e debisë dhe afatit të pagesës në APD”, Ligjin nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, Ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 8905, datë 06.06.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit detar”, Udhëzimin Nr. 182 datë 16.02.2018 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Udhëzimin nr. 4 dt 21.05.2015 “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së Transportit Ndërkombetar, Detar për automjetet ose udhëtarët dhe shkaqet e pezullimit apo rregullimit të tyre”, i ndryshuar.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga ana e Drejtorisë së Mjedisit në APD të merren masa për hartimin e një rregjistri ngjarjesh të ndodhura apo që mund të ndodhin në të ardhmen, të cilat kanë ndikuar apo mund të ndikojnë negativisht në ndotjen e mjedisit detar dhe tokësor të Portit të Durrësit, me qëllim parandalimin e ndotjeve mjedisore në të ardhmen në territorin e Autoriteti Portual Durrës.

Brenda datës 31.12.2018

-Në vijimësi nga Drejtoria e Mjedisit në APD të merren masa për aplikimin e penalteteve në rastet e konstatimit të ndotjes së mjedisit në territorin e Autoritetit Portual Durrës, me qëllim ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomik të cilët kryejnë veprimtari në port, dhe pse jo për rritjen e arkëimeve të portit nga këto penaltete.

Brenda datës 31.12.2018



- Nga Këshilli Drejtues të analizohet autorizimi, lejimi dhe ndalimi i kryrjes së aktivitetit (shërbimit), jashtë kontraktor nga kompania konçensionare “D...”, i cili ka të bëjë me mbushjen dhe zbrazen e kontenierëve me tarifën 120 euro/kontenier për kontinierët 20 FEET dhe 150 euro/kontenier për kontinierët 40 FEET, i cili nuk është përcaktuar në kontratën konçensionare dhe në librin e tarifave të APD-së, në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e Portit, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës disiplinor.

- Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të marrin masa për të negociuar me konçensionarin “D...”, me qëllimin e rikuperimit të ardhurave të munguara nga procesi i mbushjes dhe zbrazes së kontenierëve 20 dhe 40 FEET, për periudhën që është ushtruar ky aktivitet, konform tarifave të vendosura sipas procedurave ligjore.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të **prezantohet** në organet drejtuese vlerat e investimeve që kompanitë konçensionare kanë detyrimin kontraktor për ti investuar, konkretisht Konçesionari E..-A.. në vlerën **2,069,371,737 lekë**, Konçesionari A.. në vlerën **4,143,000 EUR** dhe Konçesionari D.. në vlerën **32,500,000 USD**. Deri më datë 27.07.2018, nga APD nuk konfirmohet asnjë investim i kryer prej tyre.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të analizohet autorizimi dhe lejimi i Drejtorit të Përgjithshëm i kryrjes së aktivitetit (vendosja e skafeve në magazinën 5), në kundërshtim me kuadrin ligjor dhe rregullator të APD-së, të dalë në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë aktivitetin e Portit, si dhe të merren masa të menjëhershme për ndalimin dhe mos kryerjen e këtij aktivitetit, pa pasur kuadrin e plotë ligjor dhe rregullator.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të prezantohet në organet drejtuese moszbatimi i kontratës nga konçesionari E..-A.., në lidhje me llogaritjen e tarifës për kontratat e lidhura për shesh përdorimi (përdorimi, depozitimi, truall i lirë), të cilat nuk pasqyrohen, as për çdo ditë dhe as për çdo turn, por dorëzohen nga konçesionari “E..-A.. në mënyrë të njëanshme tek APD, në fund të muajit, kjo në kundërshtim me pikën “e” të protokollit të dorëzimit, me nr. 1810, datë 12.07.2013 “Protokolli dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit”, si dhe në kundërshtim me pikën 6, “Tarifat e dhënies me qira”, pika 6.1 “Tarifat për dhënien me qira të shesheve” të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Punëve Publike me nr. 581/1, datë 06.02.2013 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve në APD”, dhe me pikën 2, të “Kontratës mbi dhënien në shfrytëzim të sheshit të përdorimit”. Në rast moszbatimi të detyrimeve të përcaktuara në marrëveshjen konçensionare nga E..-A.., si dhe mos ndërprerjes së aktivitetit jashtë kontraktor, nga organet drejtuese të merren masa për pezullimin e menjëhershëm të marrëveshjeve konçensionare, deri ndërprerjen e aktivitetit jashtë kontraktor, dhe në rast të kundërt të zbatohen procedurat ligjore për aplikimin e sanksioneve përkatëse.

Deri në 30.11.2018

- Këshilli Drejtues dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, në vijimësi të miratojnë planin e biznesit dhe ndryshimet e tij gjatë vitit, tek Ministri, si dhe të marrin masa për zbatimin



rigoroz të zërave të buxhetit, si për të ardhurat dhe shpenzimet, duke bërë analiza periodike dhe nxjerrë përgjegjësitë përkatëse për devijimet nga programi i miratuar.

Në vijimësi

-Nga ana e të gjitha strukturave të APD në vijimësi të tregohet kujdes maksimal në parashikimin vjetor të planit të biznesit, me qëllim dhënien e një pasqyre parashikimi sa më të saktë të aktivitetit ekonomiko-financiar vjetor.

-Në vijimësi të merren masa për kategorizimin e investimeve, duke i klasifikuar ato në prioritare dhe jo prioritare, me qëllim realizimin fillimisht të atyre investimeve me rëndësi jetike për zhvillimin normal të aktivitetit të Autoritetit Portual Durrës.

Në vijimësi

- Nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore të merren masat e nevojshme për plotësimin e dosjeve të personelit me të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në VKM nr. 117, datë 05.03.2014.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Nga Autoriteti Portual Durrës të merren masa për hartimin e një rregulloreje për rekrutimin e punonjësve të rinj si dhe vendosjen e kriterëve për vlerësimin e performancës së punonjësve, duke përfshirë përshkrimet e punës për çdo funksion të caktuar pune, me qëllim krijimin e procedurave transparente dhe rekrutimin e një stafi sa më profesional.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Sektori i Harmonizimit dhe Menaxhimit Financiar të Kontrollit në APD të merren masa për implementimin dhe zbatimin e plotë të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, me qëllim dhënien e një sigurie të arsyeshme mbi veprimtarinë e Autoritetit Portual Durrës në përputhje me parimet e këtij ligji.

B.1 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 190,910 lekë nga E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejtë të nivelit të pagës nga B1 në A2. ***Vlera 190,910 lekë përbën dëm ekonomik për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij.***

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës 80,454 lekë nga E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit Brendshëm. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejtë të pagesës për orët jashtë orarit për vitin 2018, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimi përkatës disiplinor. ***Vlera 80,454 lekë përbën dëm ekonomik për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij.***

Brenda datës 31.12.2018



-Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **3,034 euro dhe 54,690 lekë** nga E. K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Auditit Brendshëm. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejt pagese për pjesmarrje në trajnimin me objekt “Monitorim, Vlerësim dhe Auditimi i Performancës së Projekteve të BE” në Berlin 14-15 qershor 2018, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimi përkatës disiplinor. **Vlera 3034 euro dhe 54,690 lekë përbën dëm ekonomik për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, vlerë e cila duhet të dëmshpërblehet prej tij.**

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Autoriteti Portual Durrës, të merren masat duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative e ligjore për arkëtimin e shpërblimit të dëmit ekonomik **në vlerën 515,948 lekë** nga Shoqëria “J...” sh.p.k , për llogari të Autoritetit Portual Durrës.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “A...” shpk, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje nuk janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 14,385,840 lekë** nga Shoqëria “A...” shpk”.

Brenda datës 30.10.2018

-Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshijë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “2...” Shpk, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje nuk janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 6,518,404 lekë** nga Shoqëria “2...” Shpk.

Brenda datës 30.10.2018

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën **9,180,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit “blerje e 2 reduktorëve të ulje-ngritjes dhe montimi në vend në vinçin Mobil Mhc-115”, viti 2017 e cila ka ardhur si pasojë e diferencës ndërmjet operatorit fitues “A...” Shpk dhe bashkimit të operatorit ekonomik “N...” Shpk, duke rënduar padrejtësisht koston e këtij shpenzimi. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 30.10.2018



- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi **në vlerën 10,231,206 lekë** nga A. D. me detyrë ish-Drejtor i Drejtorisë Teknike dhe të Zhvillimit dhe E. T. me detyrë Përgjegjës i Sektorit të MKM. Dëshmërimi mbështetet në nenin 31 dhe 32 “Përgjegjësia e personit juridik” të Ligjit nr. 7850 datë 29.07.1994, Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 10,070,000 lekë**, nga A. N. për mos përmbushje të detyrimeve kontraktore në procedurën e prokurimit “Vepër arti” në ambjentet e APD-së”, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2018

-Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i **vlerës 6.156.000 lekë**, nga subjekti “P. F. P.”, për mos përmbushje të detyrimeve kontraktore në procedurën e prokurimit “Blerje Filmi”, viti 2017, vlerë e cila për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

-Të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 36,178 lekë** nga B. M. me detyrë specialiste në sektorinë promocionit dhe trajnimeve. Kjo vlerë ka të bëjë me përfitim të padrejtë (pagesë të dubluar për 56 orë shtesë me vlerë 36,178 lekë) me kontratën nr. 1557, datë 24.05.2017 me objekt “Realizimi i një filmi dokumentar për historikun dhe aktivitetin ndër vite të Portit të Durrësit ” (likujduar subjekti “P. F. P.” për vlerën 6.156.000 lekë, likujduar dhe B. M. për vlerën 36,178 lekë), vlerë e cila për Autoritein Portual Durrës” dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2018

-Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përfshirë ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga bashkimi i operatorëve “A..” Shpk & “S..” Shpk & “B..” Shpk, nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje nuk janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 60,438,620 lekë** nga bashkimi i operatorëve “A..” Shpk & “S..” Shpk & “B..” Shpk. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2018

-Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtojë vlerën 45,600,000 lekë. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje veshmbathje, viti 2017, e cila ka ardhur si pasojë e kualifikimit, shpalljes fitues të Shoqërisë “K..” Shpk nga KVO, si dhe lidhjes së kontratës, **në mënyrë të padrejtë**, duke mos përmbushur kërkesat për kualifikim dhe specifikimet teknike të kërkuara në dokumentet e tenderit. Të evidentohen



përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, përbën dëm ekonomik.

Brenda datës 30.10.2018

-Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të merren masa të menjëhershme për ngritjen e një grupi teknik me specialistë të fushës (përjashtuar ata që kanë qenë pjesë e procesit të kolaudimit dhe të marrjes në dorëzim), i cili të kryejë ekzaminimet teknike dhe të përcaktojë autenticitetin e pajisjeve.

Në rast se nga procesi i verifikimit rezulton se pajisjet e furnizuara nga Shoqëria “T. S.” Shpk nuk garantojnë zbatimin e kontratës në cilësi dhe brenda standardeve të kërkuara dhe të konfirmohet që këto pajisje nuk janë të njëjta me ato të prokuruar, konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit arkëtimi i **vlerës 14,707,200 lekë** nga Shoqëria “T. S.” Shpk.

Brenda datës 30.10.2018

- Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **15,360,000 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shpenzimet për “Trajtimi i stafit operacional dhe menaxherial të Autoritetit Portual Durrës”, të kryera nga kompania “Th. H.” shpk. Vlerë e cila ka rënduar padrëjtësisht buxhetin e APD. APD nuk duhet të miratonte këtë fond që në planin e biznesit të vitit 2016. Veprimet janë në kundërshtim me Ligjin 10296, date 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" neni 5,8, pasi menaxhimi nuk ka përcaktuar qartë domosdoshmërinë e planifikimin e këtij fondi dhe zbatimin e rregullave dhe procedurave që sigurojnë përdorim eficient, efektiv dhe ekonomik të burimeve financiare publike etj. APD ka një sektor trajnimi të mirë strukturuar dhe të plotësuar me stafin përkatës për të cilën APD shpenzon shuma të konsiderueshme. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, pasi kjo vlerë për Autoritetin Portual Durrës dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëmin ekonomik**.

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **100,000 lekë** nga Shoqata Kulturore “S. B.”. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në zbatimin e kontratës së sponsorizimit nr. 2637, datë 22.09.2016, si përfitim i padrejtë nga kjo shoqëri pasi ka tejkalluar shpenzimin që do të mbulonte kontrata.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të shqyrtohet vlera **167,716 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpenzimet për karburant për automjetet e APD, për të cilat nuk vërtetohet plotësisht kryerja e këtij shpenzimi, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik**.

Brenda datës 30.10.2018

- Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **940 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e kryer për pjesëmarrje të G. B. me detyrë ish-kryetar i këshillit mbikëqyrës në konferencën



“Asambleja e Qytet-Porteve për vitin 2016” në Rotterdam, pasi nuk është përshirë në urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr. 2568, datë 16.09.2016 i Drejtorit Ekzekutiv. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merret vendimi përkatës, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **8,948 euro**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesat e kryera për pjesëmarrje në panairët “Work and Study” dhe “Panair i punës” me motivin për promovimin e aktivitetit të APD-së dhe njohjet me zhvillimet e reja në tregun e punës, që në fakt këto pagesa nuk ka lidhje me objektivat institucionale por me një pjesëmarrje pa qëllim në vetvete. Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **646 euro** nga operatori “A...”. Ky vlerë ka të bëjë me përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri pasi ka faturuar më shumë se shpenzimet reale të kryera gjatë shërbimit.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **72,475 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e biletave të udhërimit për Hamburg te E. C. me detyrë moderatore projektsh (jo punonjëse e APD). Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **248,167 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e kryer për E. C., për prezantimin e projektit “SUPAIR”, pasi marrëveshja bazë e projektit “SUPAIR” nuk është nënshkruar midis APD dhe donatorit deri më datën 27.07.2018, datë në të cilën përfundoj auditimi, si dhe nuk është kryer asnjë disbursim.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **79,250 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me pagesën e biletave të udhëtimit për Rotterdam te E. C. me detyrë moderatore projektsh (jo punonjëse e APD), Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **2,801,350 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me 29 aparatet celular që nuk janë bërë hyrje në magazinë, në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**



Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës, arkëtimin e vlerës **799,680 lekë** ndaj operatorit “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri pasi ka faturuar vlera të librave më të larta se ato të tregut.

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **815,760 lekë**, nga operatorit “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk provohet se janë sjell mallrat e kërkuara nga APD.

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **748,863 lekë**, nga operatorit “B...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri mbi çmimet e tregut.

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **690,000 lekë**, nga operatorit “A...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri pasi aplikacioni “Smart Transport Albania” nuk plotëson specifikimet e ftesës për ofertë.

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **839,880 lekë me TVSH**, nga operatori “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion **nuk provohet janë sjell mallrat e kërkuar dhe APD ka shpenzuar.**

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **117,240 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me blerje furnizim vendosje pjesë këmbimi (auto-fener) për autoveturë tip Volvo me targë AA896RK, pasi në kërkesën e lindjes së nevojës për këtë blerje nuk janë përcaktuar rrethanat në të cilat ndodhi situata (vlerësimi teknik) dhe mbulohet/ose jo nga siguracioni i automjetit në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin dhe kontrollin financiar”, i ndryshuar.

Të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimet përkatëse, vlerë e cila për APD dhe Buxhetin e Shtetit, **përbën dëm ekonomik.**

Brenda datës 31.12.2018

- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimi i vlerës **155,300 lekë**, nga operatorit “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri, pasi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion **nuk provohet nëse janë sjellë mallrat e kërkuar dhe APD ka shpenzuar.**

Brenda datës 31.12.2018



- Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si edhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimi i vlerës **605,010 lekë**, nga operatorit “2...” shpk për përfitimin e padrejtë nga kjo shoqëri mbi çmimet e tregut.

Brenda datës 31.12.2018

B.2. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

Nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv të prezantohet në organet drejtuese:

-Vlera **4,281,902 lekë** (për pjesën 11% të kontratës që i takon APD), që ka të bëjë me kryerjen e procesit të shkarkimit, depozitimit dhe evadimit të mullinjve të erës, proces i cili nuk është pjesë e objektit të Kontratës Koncesionare “Për dhënien me koncesion Menaxhimin, Operimin, Mirëmbajtjen dhe Përmirësimin Teknik të Terminalit Lindor në Portin e Durrësit e nënshkruar në datën 06 Maj 2013 midis Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit (sot MIE) dhe Kompanisë “E...”.

Brenda datës 30.11.2018

- Nga APD të analizohen në mënyrë të detajuar rastet e largimit nga puna, si dhe krijimin e detyrimeve të shtuara përmbare, duke evidentuar përgjegjësitë individuale, humbje të cilat janë në vlera të konsiderueshme për Institucionin, si dhe në të ardhmen të merren masa për ndjekjen me përgjegjësi të procedurave gjyqësore për dëmshpërblimet që vijnë si rezultat i zgjidhjes së kontratës së punësimit pa shkaqe të arsyeshme.

Menjëherë dhe në vijimësi

- Nga organet drejtuese të Autoritetit Portual Durrës të analizohet vlera **33,821,301 lekë**, e cila përbën efekt financiar negativ për Autoritetin Portual Durrës, si dhe në të ardhmen nga APD të akordohet dhënia e shpërblimeve vjetore jo më shumë se një pagë mujore në vit bazuar në performancën individuale të punonjësve, pas daljes së rezultatit financiar vjetor, si dhe pas miratimit nga Ministri përkatës.

Brenda datës 30.11.2018

- Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **4,364,500 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpërblimin financiar të këshillit drejtues për periudhën 2016-2017, shpërblim i cili në opinionin e grupit të auditimit nuk provohet plotësisht bazueshmëria ligjore e përfitimit të tij nga ky organ. Vlerë e cila ka rënduar buxhetet e viteve respektive.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **5,671,164 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në punësimin e punonjësve mbi strukturën organike të miratuar nga Këshilli Drejtues për periudhën 01.05.2016-30.06.2018, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për APD, si dhe në të ardhmen të tregohet kujdes maksimal për mostejkalim të strukturës organizative të miratuar nga Këshilli Drejtues.

Brenda datës 31.12.2018



- Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **4,072,460 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në shpërblimin e punonjësve të cilët gjatë vitit ushtrimor kanë marrë masën disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, vlerë e cila përbën efekt financiar negativ për APD për periudhën 01.05.2016-30.06.2018, si dhe në të ardhmen të tregohet kujdes maksimal për shpërblimin e vetëm atyre punonjësve të cilët nuk janë nën masën “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të rishqyrtohet vlera **385,656 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në dhënijen e orëve shtesë për punonjësit në kundërshtim me VKM nr. 463, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin të Këshillit të Ministrave nr. 511, datë 24.10.2002 “Për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit në institucionet shtetërore”, të ndryshuar”. Në vijimësi nga Autoriteti Portual Durrës të merren masat e nevojshme për zëvendësimin e orëve shtesë mbi kohën normale të punës me ditë pushimi. Shpërblimi financiar të aplikohet vetëm në ato raste kur zëvendësimi me ditë pushimi, për shkaqe të përligjura, çenohet funksionaliteti i institucionit.

Brenda datës 31.12.2018

-Nga Autoriteti Portual të analizohet vlera **90,316.8 lekë** e cila përbën efekt financiar negativ për buxhetin e APD e krijuar si pasojë e blerjes së panevoshjme të pajisjeve të lëna në magazinë për më shumë se 1 vit, si dhe në vijimësi të kryhen analiza më të sakta në lidhje me nevojat reale të institucionit.

Brenda datës 31.12.2018

- Nga Këshilli Drejtues të shqyrtohet vlera **23,113,200 lekë**. Kjo vlerë ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në sistemin e kontrollit të hyrjeve Autoritetin Portual Durrës. Konkretisht për periudhën 22 janar – 31 mars 2018 janë futur në territorin e Autoritetit Portual Durrës në total 96305 automjete pa paguar tarifën e hyrjes port me vlerë totale të përlllogaritur 23,113,200 lekë në kundërshtim me udhëzimin e brendshëm të Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv nr. 2972/1, datë 25.09.2009 “Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe kontrollin e qarkullimit në territorin e Autoritetit Portual Durrës”, të evidentohen përgjegjësitë dhe të merren vendimi përkatës disiplinor. **Vlera 23,113,200 lekë përbën të ardhura të munguara për APD dhe Buxhetin e Shtetit.**

Brenda datës 31.12.2018

IV. KONKLUZIONE DHE OPINIONI I AUDITIMIT

Baza për opinionin mbi ligjshmërinë dhe rregullshmërinë (ISSAI 4100 dhe 4200¹) e shpenzimeve:

Nga auditimi mbi përputhshmërinë (pajtueshmërinë) dhe rregullshmërinë sa i takon shkallës së ndjekjes nga subjekti - Autoriteti Portual Durrë s të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, (kriteret e auditimit të përputhshmërisë), u konstatuan devijime materiale në:

-**Dëm ekonomik** me vlerë **203,462 mijë lekë**, në procedurat e prokurimit dhe zbatimin e kontratave të punëve publike, shpenzimet operative.



-Efekte negative financiare me vlerë 89,620 mijë lekë, si pasojë e zgjidhjes së pa arsyeshme të kontratave të punësimit.

Konkluzion:

Nga auditimi i përputhshmërisë mbështetur në standardet INTOSAI dhe në Manualin e Auditimit të përputhshmërisë (pajtueshmërisë) dhe rregullshmërisë së KLSH-së, i kryer në subjektin - Autoriteti Portual Durrë s rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi (kriteret), që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur nuk janë të përhapura dhe nuk janë materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënie opinionit të kualifikuar.

1. ISSAI 4100 – Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi bëhet lidhur me çështje të veçanta.

2. ISSAI 4200 - Objektivi i audituesve në një auditim përputhshmërie është të japë siguri të arsyeshme nëse informacioni i mbledhur sa i takon një çështjeje të veçantë është në përputhje, në të gjitha aspektet materiale, me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi, kur auditimi behet lidhur me auditimin e pasqyrave financiare.

3. Mbështetur mbi Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”.

V. ANEKSE

Shkurtime

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
NJP	Njësia e Prokurimit
AK	Autoriteti Kontraktor
DT	Dokumentet e Tenderit
LPP	Ligji prokurimit publik
RRPP	Rregullat e prokurimit publik